



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ", GIROKASTËR

**KONFERENCË SHKENCORE  
QENDRAT E BANUARA TË SHQIPËRISË -  
GJENDJA DHE E ARDHMJA**  
(17 dhjetor 2021)

**LIBRI I KUMTESAVE**

Tiranë, 2023

Botimi i këtij libri u realizua në kuadër të projektit “Studimi i Qendrave të Banuara të Shqipërisë”, të drejtuar nga prof. dr. Perikli Qiriazi dhe u mundësua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan dhe Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastrë. Ai përmban referimet në Konferencën Shkencore “Qendrat e Banuara të Shqipërisë – Gjendja dhe e Ardhmja” të zhvilluar më 17 dhjetor 2021 në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan.

### **Redaktorë shkencorë**

Prof. dr. Perikli Qiriazi (Kryeredaktor)

Prof. asoc. Dr. Merita Koka Karaguni

Prof. asoc. Dr. Jostina Dhimitri

### **Recensentë:**

Prof. dr. Dhimitër Doka

Prof. dr. Bilal Draçi

Prof. asoc. dr. Zhuljeta Kandilli

**Redaktore letrare:** Brunilda Prifti

**Përgatiti për botim:** Prof. as. dr. Jostina Dhimitri

**Redaktore teknike:** Enkelejda Misha

ISBN: 978-9928-339-91-1

© Të gjitha të drejtat e shumëfishimit i ka botuesi

## **Komisioni shkencor**

Prof. dr. Perikli Qiriazhi

Prof. as. Rudina Mita

Prof. as. Albina Sinani

Prof. dr. Dhimitër Doka

Prof. dr. Skënder Sala

Prof. dr. Bilal Draçi

Prof. dr. Qamil Lirëza

Prof. as. dr. Merita Koka Karaguni

Prof. as. dr. Jostina Dhimitri

Prof. as. dr. Jaho Cana

Dr. Artan Lila

Dr. Rudina Lucka Uruci

Dr. Florinka Gjevori

Dr. Ermiona Braholli



## PËRMBAJTJA

<b>Seanca Plenare</b> .....	9
Fjala e hapjes: Rudina Mita, përgjegjëse e departamentit të Histori – Gjeografisë në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan .....	11
<i>Përshëndetje: Marenglen Verlit, akademik, në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.</i> .....	13
<i>Përshëndetje: Peçi Naqellari, zëvendësrektor i universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”</i> .....	16
<i>Përshëndetje: Jaho Cana, zëvendësrektor i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë</i> .....	18
<i>Përshëndetje: Elsa Dhuli, drejtore e INSTAT-it.</i> .....	21
<i>Perikli Qiriazi - Studimi i qendrave të banuara të Shqipërisë - problem kompleks dhe ndërdisiplinar</i> .....	24

### PANELI I

<b>Gjendja dhe prirjet e përgjithshme të zhvillimeve të vendbanimeve në Shqipëri</b> .....	33
<i>Perikli Qiriazi - Qendrat e banuara në dhe afër siteve të trashëgimisë natyrore shqiptare dhe raporti midis tyre.</i> .....	35
<i>Dhimitër Doka - Vendbanimet e braktisura si rezultat i pabarazive të theksuara rajonale pas vitit 1990.</i> .....	60
<i>Bilal Draci, Gentian Ruspi - Sistemi dhe hierarkia urbane në Shqipëri - përpyetje për klasifikim.</i> .....	75
<i>Merita Koka Karaguni, Jostina Dhimitri - Zhvillimi i qëndrueshëm urban në Shqipëri- realitet apo prirje?</i> .....	89
<i>Romeo Eftimi - Aspekte hidrogjeologjike të furnizimit me ujë të qyteteve të Shqipërisë; përvoja dhe probleme</i> .....	107
<i>Hajri Haska - Një vështrim mbi gjelbërimin urban në qendrat e banuara në Shqipëri – e kaluara, gjendja aktuale dhe sfidat e së ardhmes.</i> .	132
<i>Sherif Lushaj &amp; Vezir Muharremaj - Hapësirat e gjelbra në funksion të qëndrueshmërisë së qyteteve</i> .....	156
<i>Emil Lafe - Për standardizimin e emërtimeve të qendrave të banimit në Republikën e Shqipërisë.</i> .....	172

*Mariglen Sherifaj & Valbona Duri* - Roli i elementeve të mjedisit natyror në emërtimin e vendbanimeve në Shqipëri. Fenomeni i “përsëritjes së të njëjtit emërtim” .....182

## PANELI II

**Aspekte historike, urbanizimi dhe organizimi i vendbanimeve .....205**

*Skënder Aliu* - Vendbanimet prehistorike në Shqipërinë Juglindore ...207

*Irakli Koçollari* - Progresi urban dhe mjeshtrit e ndërtimeve në Pashallëkun e Ali pashë Tepelenës. ....227

*Zhuljeta Kadilli & Majlinda Peza* - Banesa me hajat (elbasanase) pas ndryshimeve ekonomiko-politike të viteve 1990 në zonën e Elbasanit. ....240

*Dorian Koçi* - Rindërtimi i kujtesës urbane të qendrës historike të Tepelenës. ....258

*Rudina Mita* - Organizimi administrativ në prefekturën e Elbasanit në vitet 1925-1939 dhe ndikimi i saj në zhvillimin e qendrave të banuara .....269

*Artan Lila* - Historia e vendbanimeve dhe tiparet e popullimit në zonën e Gollobordës sot. ....291

*Flora Gjoni & Bresena Koplaku & Nevila Dibra* - Tipologjia e vendbanimeve në bashkinë e Shkodrës, ndryshimet që kanë pësuar gjatë tranzicionit, potencialet për zhvillim të tyre.....303

*Ermiona Brahollli* - Kushtet natyrore dhe historia e krijimit të vendbanimeve rurale në pellgun më të sipërm ujëmbledhës të Devollit.....328

*Florinka Gjevori* - Ndikimi i organizimit ekonomik e social në tiparet e qendrave të banuara të prefekturës së Elbasanit në vitet 1925 – 1939 .....346

*Manjola Xhaferri & Mirela Tase* - Arkitektura e banesës në rrethinat e Tiranës dhe transformimet e reja pas viteve ‘50 të shek XX.....369

## PANELI III

**Funksionet, zhvillimi dhe tipologjia e vendbanimeve në rajone të Shqipërisë .....391**

*Valbona Duri & Fatlinda Shkurti & Niko Rogo* - Rrjeti i qendrave të banuara, shtrirja dhe shpërndarja hipsometrike e tyre në qarkun e Gjirokastrës (1989-2009).....393

<i>Jaho Cana &amp; Kozeta Sala</i> - Vendbanimet kryesore të krahinës së Labërisë. .....	407
<i>Nehat Collaku &amp; Selman Meziu</i> - Lëvizjet demografike në qendrat e banuara dhe ndryshimet në përdorimin e territorit në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit të qarkut të Dibrës.....	420
<i>Florian Fusha</i> - Popullsia dhe vendbanimet në hapësirën gjeografike dhe etnografike të Dukagjinit.....	436
<i>Fatlinda Shkurti &amp; Albina Sinani</i> - Qendrat urbane të qarkut të Vlorës - prirjet e sotme të zhvillimit. ....	455
<i>Sami Behrami &amp; Fadil Bajraktari</i> - Shpërndarja e popullsisë dhe vendbanimeve në Regjionin Verior të Kosovës - roli i relievit dhe pasurive natyrore. ....	480
<i>Adriatik Balla</i> - Ndikimi i rrugës së Arbrit në riorganizimin gjeografik të luginës së Bulqizës. ....	501
<i>Arben Belba &amp; Amarildo Shallas</i> - Shpërndarja hapësinore e qyteteve dhe modelet e lëvizjes në nivel bashkie dhe qarku. ....	518

#### **PANELI IV**

##### **Funksionet, zhvillimet dhe tipologjia e vendbanimeve në njësi**

<b>administrative në Shqipëri</b> .....	539
<i>Skënder Sala</i> - Natyra dhe vendbanimet në njësinë administrative të Baldushkut.....	541
<i>Adelajda Halili &amp; Pal Nikolli</i> - Vlerësimi dhe analiza e rritjes urbane të qytetit të Vlorës me anën e gis/remote sensing.....	567
<i>Qamil Lirëza</i> - Evolucioni hapësinor i njësisë administrative Zhepë, bashkia e Çorovodës, për një zhvillim të qëndrueshëm. ....	583
<i>Shyqyri Hysi &amp; Arben Hysi</i> - Probleme administrative në bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj 1944 -2014 dhe ndikimi i tyre në tiparet dhe zhvillimin e këtyre qendrave të banuara. ....	598
<i>Albina Sinani &amp; Fatlinda Shkurti</i> - Tipologjia funksionale dhe madhësia e vendbanimeve rurale në qarkun e Gjirokastrës. ....	616
<i>Rudina Uruçi</i> - Ndikimi i faktorëve natyrorë dhe socialë në ecurinë e numrit dhe të shpërndarjes së vendbanimeve dhe popullsisë në bashkinë e Kolonjës. ....	642
<i>Blerita Avdia &amp; Klementina Ngjeci</i> - Emigracioni dhe e ardhmja e qendrave të banuara në bashkinë e Hasit dhe të Kukësit. ....	658
<i>Edlira Menkshi &amp; Ermiona Braholli</i> - Analiza e morfologjisë urbane të qytetit të Korçës. ....	671

<i>Jostina Dhimitri &amp; Xhuliana Zdrava</i> - Karakteristika gjeohapësinore të vendbanimeve të Lushnjës.....	691
<i>Mirela Tase &amp; Manjola Xhaferri</i> - Vlerësimi i potencialeve natyrore dhe kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit në zonën e Shëngjergjit .....	710
<i>Edlir Dervishi</i> - Ekonomia e vendbanimeve të bashkisë së Belshit.....	725



# SEANCA PLENARE



**Fjala e hapjes: Prof. as. dr. Rudina Mita, përgjegjëse e Departamentit të Histori – Gjeografisë në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan**

I nderuar akademik Marenglen Verli, përfaqësues i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë!

I nderuar prof. as. dr. Jaho Cana, zëvendësrektor i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër!

I nderuar prof. dr. Perikli Qiriazli!

I nderuar prof. asoc. dr. Peçi Naqellari, zëvendësrektor i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan!

E nderuara dr. Elsa Dhuli, drejtore e INSTAT-it!

Përshëndetje të gjithëve!

Ndihem e nderuar dhe e privilegjuar që sot më është besuar hapja e seancës plenare që shënon dhe nisjen e punimeve të Konferencës shkencore: “Qendrat e banuara të Shqipërisë-gjendja dhe e ardhmja”.

Së pari, ju uroj të gjithë pjesëmarrësve mirëseardhjen në Elbasanin e traditës dhe kulturës, të arsimit e gjuhës shqipe, të Normales dhe të personaliteteve elbasanase, që kanë dhënë kontribute të çmuara për zhvillimin e shkencës, arsimit dhe kulturës shqiptare.

Në vazhdë të traditës së ndjekur në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, e sidomos në traditën e Departamenteve Histori–Gjeografi, Gjuhë Shqipe e Letërsi në Fakultetin e Shkencave Humane, organizojmë edhe sot këtë konferencë shkencore, si fryt i

bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe universitetin “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës.

Kjo konferencë u finalizua me mbështetjen e plotë e të pakursyer të akademik Skënder Gjinushit, Kryetar i Akademisë së Shkencave; prof. dr. Skënder Topi, rektor i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan; prof. dr. Bektash Mema, rektor i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë; prof. as. dr. Albert Riska, dekan i Fakultetit të Shkencave Humane në UE; ajo është rezultat i punës së komisionit shkencor dhe organizues të konferencës. Mirënjohje dhe falënderime pa fund të gjithëve ju që kontribuuat në organizimin dhe zhvillimin e konferencës sonë!

Pa humbur kohë, ftoj për fjalën përshëndetëse akademik Maringlen Verlin – përfaqësues i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në vazhdim, sipas programit, fjala përshëndetëse e zëvendësrektorëve, prof. dr. Peçi Naqellarit të UE-së, prof. as. dr. Jaho Cana të UGj-së dhe dr. Elsa Dhuli, drejtore e INSTAT-it.

Kjo seancë plenare mbyllet me referimin e kolegut të nderuar dhe mikut tonë të mirë prof. dr. Perikli Qiriazit “Studimi i qendrave të banuara të Shqipërisë - problem kompleks dhe ndërdisiplinar”, në të cilin, me të drejtë, ai thekson domosdoshmërinë dhe drejtimit kryesorë të këtij studimi, që ka nderin dhe meritën ta iniciojë kjo konferencë.

Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj të vyer shkencor që do prezantoni në këtë konferencë,

Ju uroj të gjithëve suksese!

## **Përshëndetje e prof. dr. Marenglen Verlit, akademik, në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**

Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë shumë të veçantë shkencore!

I nderuar organizator i konferencës, prof. dr. Perikli Qiriaz, i

E nderuara prefekte, znj. M. Peza!

Të nderuar kolegë,

Është nder dhe kënaqësi për mua t'ju përshëndes në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe personalisht të kryetarit të saj, akad. Skënder Gjinushi.

Rëndësia e Konferencës “Qendrat e banuara të Shqipërisë – gjendja dhe e ardhmja” që mbahet sot, më 17 dhjetor 2021, përcakton angazhimin e Akademisë së Shkencave në organizimin e saj, përkrah dy institucione me shumë përvojë dhe arritje në veprimtaritë shkencore e pedagogjike si universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit dhe universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës.

Një vështrim sado i shpejtë i temave që do të trajtohen në këtë konferencë, të krijon bindjen se është e para konferencë shkencore për qendrat e banuara të vendit, ku marrin pjesë studiues të disa fushave: gjeografë, historianë, arkeologë, gjuhëtarë, inxhinierë hidrogjeologë dhe të pyjeve, urbanistë, arkitektë, ambientalistë etj. Për përgatitjen e saj është punuar me shumë kujdes e profesionalizëm që të trajtohen të gjitha aspektet e problemeve të shumta dhe tepër urgjente të vendbanimeve tona. Midis tyre do të veçonim analizën dhe rekomandimet shkencore për zgjidhjen e problemeve, si: degradimi mjedisor dhe polarizimi social, që

gjenerojnë pabarazi dhe paqëndrueshmëri; problemet e shumta të infrastrukturës të banimit, prodhimit, pushimit, lëvizjes, furnizimit me ujë, energji, komunikim; të infrastrukturës të gjelbër e blu; braktisja e shumë qendrave të banuara dhe mbingarkimi i qyteteve më të mëdha në përfundim të vendit etj.

Në konferencë vërehet një alternim logjik i temave që analizojnë historinë e vendbanimeve urbane, duke vlerësuar pozitën gjeografike dhe rrethanat politike, ekonomike, sociale etj., që ndikuan në zhvillimin e tyre në periudha të ndryshme historike, që nga antikiteti deri në periudhën e re moderne. Në këtë kuadër trajtohet arkitektura, tipologjia e banesave, ndikimi i organizimit ekonomik e social në tiparet e vendbanimeve, mandej organizimi administrativ e deri te transformimet ose braktisja dhe zëvendësimet e drejtimeve të zhvillimit ekonomik, të tipologjisë së banesave tradicionale etj., në periudha të ndryshme, veçanërisht gjatë shek. XX-XXI e sidomos gjatë 30 viteve të fundit.

Me shumë rëndësi aktuale e ndikim konkret për strategjinë e zhvillimit perspektiv, janë temat e parashtruara të mbahen sot në konferencë, të cilat trajtojnë lëvizjet demografike, gjithashtu prirjet e zhvillimit të sotëm të qendrave urbane, të zgjidhjes së problemeve të tyre në kuadër të zhvillimit, si furnizimi me ujë dhe reduktimi i ndotjeve, temat që trajtojnë ndikimin e infrastrukturës rrugore; temat që propozojnë zhvillim perspektiv të qëndrueshëm për vendbanimet në rajone të ndryshme të vendit, duke shfrytëzuar potencialet rajonale natyrore e kulturore, traditën pozitive etj., që mundësojnë zhvillimin e turizmit, të degëve specifike të ekonomisë etj.

Këto i japin kësaj konference jo vetëm vlera teorike, por edhe praktike. Rezultatet dhe rekomandimet shkencore të saj duhet të konvertohen në veprimtari, projekte e investime racionale e produktive nga politikëbërësit e vendimmarrësit në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe bizneset private. Padyshim

kjo do t'i rriste vlerat e vendbanimeve tona në të gjithë spektrin e zhvillimit të qëndrueshëm, deri te ndikimi në rritjen dhe rentabilitetit të ekonomisë në të gjithë vendin; do të ndihmonte në zbutjen e ndryshimeve klimatike, të pasojave dhe të përshtatjes ndaj tyre; do të përmirësonte cilësinë e jetës së popullsisë; do të kontribuonte në proceset e integritit kombëtar, rajonal, europian dhe më gjerë; do të ndihmonte në forcimin e ndërgjegjes regjionale, të lidhjeve shpirtërore të popullsisë me vendbanimin, rajonin dhe gjithë vendin dhe në formimin e forcimin e identitetit vendor, rajonal dhe kombëtar, si një proces me kahe pozitive, por njëherazi me shumë probleme dhe të panjohura etj.

Shkurt, veprimtaria e sotme është një konferencë shumë e vlefshme, e pritur prej kohësh, me ndikim që do të reflektohet veçanërisht pasi aktet e saj të botohen, të studiohen e të bëhen nxitje për studime të mëtejshme e veprime konkrete.

Ju uroj sukses organizatorëve e kontributorëve të konferencës dhe njëherësh i falënderoj për punën e tyre të shkëlqyer.

## **Përrshëndetja e prof. as. dr. Peçi Naqellari, zëvendësrektor i universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

Të nderuar organizatorë dhe pjesëmarrës, është një kënaqësi e nder i veçantë për mua t`ju uroj mirëseardhjen në punimet e kësaj konference në mjediset e universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, në saje të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër.

Dua t`ju shpreh mirënjohjen për të gjithë ju që keni zgjedhur të jeni pjesë e kësaj konference shkencore, pavarësisht sfidave që pandemia na bëri të përjetojmë, jemi sot këtu për të diskutuar së bashku.

Universiteti i Elbasanit, si një universitet i traditës dhe suksesit, prej vitesh organizon veprimtari të ndryshme kërkimore shkencore, në bashkëpunim me institucionet vendëse dhe të huaja. Këto veprimtari nuk janë vetëm vendtakime mes kolegësh dhe miqsh, por gjithashtu janë tryeza diskutimi dhe vlerësimi të ideve, inovacioneve dhe shkencës.

Më lejoni të theksoj rëndësinë dhe ndikimin e këtij institucioni në qytetin tonë. Universiteti i Elbasanit është kthyer në promotor vlerash, profesionalizmi dhe kulture. Është shumë i lartë numri i të diplomuarve, të cilëve sot u janë besuar poste shumë të rëndësishme drejtuese. Të tjerë kanë zgjedhur të zhvillojnë karrierën e tyre jashtë vendit dhe janë pikat e kontaktit për bashkëpunime të vazhdueshme. Këto bashkëpunime janë kthyer në motivacion dhe janë bërë shkak për realizimin e projekteve të



ndryshme apo punësimeve me kohë të pjesshme në ndërmarrje autoritare brenda dhe jashtë vendit.

Me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, organizimi i përbashkët i kësaj konference ka qenë një kënaqësi e veçantë, sepse është pikërisht bashkëpunimi në kërkimin shkencor që çon përpara zhvillimin akademik e kulturor të secilit prej nesh.

Gjatë konferencës ju do të keni mundësi të njiheni me 43 kumtesa dhe punime shkencore të ndara në 4 panele tematike. Prezantimet shoqërohen me diskutime dhe reflektime mbi tematikën, duke pasuruar mendimin kritik dhe debatin akademik.

Universiteti i Elbasanit, ka mbështetur dhe do të mbështesë çdo ftesë për bashkëpunim, ku aktorët kryesorë janë studentët dhe bota akademike.

Për këtë arsye, më lejoni të falënderoj nismëtarët, organizatorët dhe pjesëmarrësit të cilët zgjodhën të jenë sot këtu.

Punë të mbarë dhe suksese!

## **Përshëndetja e prof. as. dr. Jaho Cana, zëvendësrektor i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë**

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndihem vërtet i privilegjuar që në emër të universitetit “E. Çabej” të Gjirokastrës dhe personalisht në emër të rektorit të këtij universiteti, prof. dr. Bektash Mema, t’u përcjell përshëndetjet më të ngrohta punimeve të kësaj konference.

Kjo konferencë me temë “Qendrat e banuara të Shqipërisë – gjendja dhe perspektiva” e organizuar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me universitetin “E. Çabej” të Gjirokastrës dhe universitetin “A. Xhuvani” të Elbasanit, mbahet në një kohë kur vërtet vendi ynë është kapur nga një sërë lëvizjesh të ndryshme emigratore. Këto lëvizje e kanë zanafillën qysh në fillimet e viteve ’90 të shekullit që lamë pas, por vitet e fundit duket sikur drejtimi i këtyre lëvizjeve në vend që të fitonte një farë stabiliteti, përkundrazi, po ecën në kahun e kundërt.

Në dhjetëvjeçarin e fundit këto lëvizje të popullsisë janë bërë akoma edhe më të dukshme. Problemet e shumta ekonomike, por edhe zhvillimet politike që kanë mbërthyer vendin tonë kanë ndikuar negativisht duke sjellë që këto lëvizje të popullsisë të mos reshtin për asnjë moment.

Të gjitha këto lëvizje të popullsisë kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në krijimin e situatave të reja jo vetëm ekonomike, por edhe politike e sociale. Qarqet më të prekura nga ky fenomen janë: qarku i Gjirokastrës, i Kukësit, i Shkodrës, por edhe në qarqe të tjera këto lëvizje kanë qenë të shumta dhe si pasojë fshatra të tëra të këtyre rajoneve po shkojnë drejt shpopullimit të plotë të tyre. Më

problematike kjo situatë paraqitet, sidomos, në zonat e thella malore, ku gjendja nuk është thjesht shqetësuese, por është alarmante. Kjo do të thotë se ka ardhur një pikë ku shteti si rregullator duhet të ndërhyjë menjëherë për të përmirësuar në mënyrë urgjente situatën e krijuar. Kjo sepse aktualisht në mjaft krahina të vendit tonë, kur dikur gëlonte jeta nga rinia dhe aktiviteti ekonomik, sot gjendja paraqitet mjaft e zyrtë. Shtëpi të tëra janë të braktisura dhe ata pak banorë që jetojnë në to u përkasin grupmoshave të treta të popullsisë. Në këto rrethana, aktiviteti ekonomik në këto krahina, pothuajse, është paralizuar. Moshë aktive e popullsisë, pra rinia, është larguar në drejtim të qyteteve të mëdha të vendit, por edhe jashtë shtetit, si: në Itali, Greqi dhe kudo tjetër nëpër Europë e më gjerë. Pyetja që shtrohet është: përse ndodhemi në një situatë të tillë dhe cilat janë shkaqet që kanë çuar në këto shpopullime masive të mjaft krahinave dhe fshatrave? Natyrisht, në vija të përgjithshme përgjigja do të ishte: vështirësitë ekonomike janë ato që kanë diktuar këto lëvizje. Por në qoftë se do ta kërkonim përgjigjen vetëm te ky shkak, atëherë ne nuk do të ishim plotësisht të saktë, sepse, në të vërtetë, në këtë drejtim kanë ndikuar edhe faktorët e tjerë.

Prandaj mendojmë se kumtesat e ardhura në këtë konferencë do të jenë një kontribut i jashtëzakonshëm për të gjetur shkaqet e vërteta që na kanë sjellë në këtë situatë. Dhe, mbi të gjitha, konkluzionet e nxjerra në fund të kësaj konference do të jenë një kontribut i jashtëzakonshëm për t'i paraprirë parandalimit të mëtejshëm të këtij eksodi të frikshëm të popullsisë. Eksodi i cili, nëse do të vazhdojë me këto ritme, do të çojë deri në zhdukjen nga harta politiko-administrative e Republikës së Shqipërisë të shumë qendrave të banuara, të cilat dikur ishin qendra jo pak të rëndësishme të aktiviteteve të shumta ekonomike. Unë jam mjaft i bindur se punimet e sjella prej studiuesve të shumtë, të cilët janë bërë pjesë e punimeve të kësaj konference, do të na mundësojnë jo

vetëm për të zbuluar shkaqet reale të këtij fenomeni, por mbi të gjitha, ato do të na japin rrugët e duhura për ta eliminuar këtë problem. Përfundimet që do të vijnë nga kjo konferencë, do të jenë një kontribut i çmuar për organet e pushtetit qendror, por edhe të atij lokal, sepse nëpërmjet tyre do të jepen mendime të kualifikuara për rrugët dhe mënyrat që do të çonin në reduktimin e këtyre lëvizjeve të popullsisë. Në fakt, organet e pushtetit qendror, por edhe të atij lokal, kohët e fundit kanë filluar të marrin disa masa për përmirësimin e situatës, siç janë: ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore, ngritja e disa fabrikave ose fabrikave të vogla për përpunimin e lëndëve të para, që vijnë nga produktet blegtorale dhe bujqësore, subvencionimit të aktiviteteve të ekonomive dhe fermave fshatare apo të ndonjë projekti në fushën e turizmit si, fjala vjen, projekti i 100 fshatrave turistike etj. Këto masa deri diku kanë qenë efektive. Por duhet thënë se këto masa, për mendimin tonë, janë të pamjaftueshme ose në disa raste ato janë tepër të vonuara. Për ta bërë sa më tërheqëse jetën në fshat, investimet shtetërore nuk duhet të jenë thjesht dhe vetëm në infrastrukturën rrugore, por edhe në drejtime të tjera, si: në shëndetësi, arsim, kulturë etj. Vetëm duke bërë një plan strategjik afatgjatë dhe tepër kompleks mund të arrijmë në rezultate të kënaqshme për parandalimin njëherë e përgjithmonë të këtij fenomeni.

Së fundmi, në këtë përshëndetje nuk mund të anashkalojmë kontributin e prof. dr. Perikli Qirjazit, i cili duke i shpërfillur të gjitha pengesat dhe vështirësitë, falë përkushtimit dhe përpikërisë së tij, arriti të gjejë energjitë e duhura për organizimin e këtij eventi të rëndësishëm shkencor. I urojmë profesorit jetë të gjatë dhe, njëkohësisht, shprehim bindjen tonë të patundur se profesor Perikliu do të na ideojë dhe frymëzojë akoma dhe më tej për të organizuar aktivitete të tjera shkencore.

Punë të mbarë konferencës!

## Përshëndetja e dr. Elsa Dhuli, drejtoreshë e INSTAT-it

I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave,

Të nderuar profesorë e kolegë,

Në radhë të parë më lejoni t'ju përgëzoj për organizimin e kësaj konference mjaft të rëndësishme që na prek në përditshmërinë tonë!

Studimet mbi qendrat e banuara në Shqipëri janë të një rëndësie të veçantë jo vetëm për studiuesit shkencorë, por edhe për Institutin e Statistikave, për administratën shtetërore qendrore dhe atë lokale.

Shqipëria është një vend që karakterizohet nga lëvizja e popullsisë, si brenda territorit të vendit, ashtu dhe jashtë tij, duke pasqyruar ndryshime në peizazhin shqiptar.

Kjo lëvizje mekanike e popullsisë ka ndikimet e saj të forta dhe në strukturën dhe fizionominë e vendbanimeve në vendin tonë, duke krijuar pabarazi në popullsi, sidomos zonat Tiranë-Durrës, të cilat janë të populluara; tendencat e migrimit të brendshëm, japin një pamje jo të njëtrajtshme të popullsisë apo dinamikat e ndërtimit, të cilat jo kudo ndjekin lëvizjet e popullsisë.

Të dhënat statistikore për zonat qytetare dhe fshatare janë me rëndësi të konsiderueshme për qeverinë qendrore dhe për autoritetet vendore, pasi ata janë përdoruesit kryesorë dhe iu nevojiten për planifikimin dhe menaxhimin e shërbimeve për komunitetet e tyre.

Për shembull, shpërndarja e fondeve për shërbimet shëndetësore, kujdesin social, strehimin, rrugët, ujësjellësin,

kanalizimet, mirëmbajtja e shkollave, kanë të gjitha aspekte të ndryshme në zonat e qytetit apo fshatit. Punësimi ka gjithashtu karakteristika të ndryshme për popullsinë në qytete apo fshatra.

Ndërkaq është e rëndësishme të ketë një përkufizim të mirëfilltë për konceptet *zonë urbane* apo *zonë rurale* të popullsisë, pasi kjo do të ndihmonte në një shpërndarje sa më të saktë të popullsisë sipas këtyre zonave. Kjo për të bërë të mundur edhe një krahasim të mundshëm të statistikave tona me ato të shteteve të tjera sipas këtyre përkufizimeve.

Instituti i Statistikave nga ana e tij ka bërë disa përpjekje për të trajtuar këtë temë, duke përdorur të dhënat e përfutuara nga Censet e Popullsisë dhe Banesave në vitet 2001 dhe 2011. Mbështetur në rezultatet e këtyre censeve, u realizuan tri studime dhe analiza të thelluara: një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014, tipologjia e komunave dhe përkufizimi i aglomeracioneve në Shqipëri 2010 dhe tipologjia e komunave e bashkive në Shqipëri 2014. Në këto studime, tashmë të botuara, janë trajtuar në mënyrë të veçantë fenomenet e qendrave të banuara në vendin tonë. Këto botime janë në dispozicion të publikut, universiteteve, Akademisë së Shkencave dhe të gjithë studiuesve të tjerë të interesuar për këto tematika.

Duke qenë se INSTAT-i është në prag të organizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022, komunikimi me institucionet kërkimore-shkencore dhe universitetet është i një rëndësie të veçantë!

Shpreh bindjen se nëpërmjet një komunikimi aktiv mes palëve, censi i ardhshëm i popullsisë dhe banesave do të jetë edhe më i vlefshëm dhe do të nxjerrë të dhëna edhe më të sakta, mes të tjerave dhe ato që kanë lidhje me shpërndarjen e popullsisë sipas tipologjisë së vendbanimit të tyre.

Analizat e thelluara do të jenë instrumente të rëndësishme për të përcaktuar politikat demografike, socio-ekonomike, kushtet e banesës apo tipologjinë e vendbanimit!

Të nderuar profesorë e kolegë, duke ju falënderuar për zemërsisht për ftesën, Ju uroj suksese në punimet e kësaj konference, mjaft të rëndësishme, me një larmi studimesh dhe analizash, nëpërmjet të cilave do të dalin gjetjet më të fundit për këtë fushë kaq të nevojshme dhe të domosdoshme për t'u trajtuar, të cilat do të ndihmojnë për përmirësime në të ardhmen dhe do të nxisin studime të mëtejshme bashkëkohore lidhur me vendbanimet, tipologjinë apo lëvizjet demografike!

Pranë Institutit të Statistikave do të gjeni një partner të besueshëm!

**Prof. dr. Perikli Qiriazhi<sup>1</sup>**

## **STUDIMI I QENDRAVE TË BANUARA TË SHQIPËRISË - PROBLEM KOMPLEKS DHE NDËRDISIPLINAR**

Qendrat e banuara, ku zhvillohet veprimtaria jetësore dhe prodhuese e shoqërisë njerëzore, kanë lindur qysh në lashtësi. Në funksion të zhvillimeve historike, politike, ekonomike, demografike, shkencore, teknologjike, por edhe të kushteve natyrore, ato vazhdimisht kanë evoluar dhe ndryshuar pozicionin, formën, shtrirjen, strukturën, funksionet, tipologjinë deri sa morën pamjen aktuale. Shumë qendra të banuara kanë lindur në periudha të caktuara, por janë zhdukur në periudhat pasuese. Shumë të tjera kanë vazhduar në shekuj jetën e tyre deri në ditët e sotme, ndërsa vazhdimisht kanë lindur qendra të reja të banuara.

Përpjekjet për t'iu përshtatur globalizimit të kapitalit, punës dhe kulturës; ristrukturimit ekonomik dhe formimit të ekonomisë së re; pasojave të teknologjive të reja të informacionit e komunikimit dhe ndryshimeve klimatike, shoqërohen me shfaqjen e tipareve, funksioneve e tipologjive të reja, të cilat duhen studiuar me vëmendje për të shmangur pasojat e padëshirueshme dhe për të nxitur dukuritë pozitive, si: rritja e efektivitetit ekonomik, kulturor, arsimor, komoditetin dhe cilësinë e jetës së banorëve.

---

<sup>1</sup> E-mail: [perikli.qirjazi@gmail.com](mailto:perikli.qirjazi@gmail.com)



Por është fakt i pamohueshëm se në qendrat e banuara, gjithmonë e më tepër po ashpërsohen problemet, si: degradimi mjedisor dhe polarizimi social, që gjenerojnë pabarazi dhe paqëndrueshmëri; probleme të infrastrukturës, të lëvizjes, të furnizimit me ujë, energji, komunikim; braktisja e shumë vendbanimeve dhe mbingarkimi i qendrave më të mëdha urbane në perëndim si rasti i vendit tonë etj.

Qendrat tona të banuara kanë qenë objekt studimi i disa fushave kërkimore, si: gjeografia, historia, arkeologjia, urbanistika, etnografia etj. Secila prej këtyre fushave, nën këndvështrimin e vet, ka dhënë ndihmesë jo të vogël në sqarimin dhe studimin e problemeve të veçanta të këtyre qendrave.

Kjo është e para konferencë shkencore për qendrat e banuara të vendit, ku marrin pjesë studiues të disa fushave: gjeografë, historianë, arkeologë, gjuhëtarë, inxhinierë hidrogeologë dhe të pyjeve, urbanistë, arkitektë, ambientalistë etj.

E konsiderojmë një nga arritjet më të rëndësishme të kësaj konference që në të janë të përfshira e të përfaqësuara, përveç Akademisë së Shkencave, edhe dymbëdhjetë universitete të Shqipërisë dhe të Kosovës. Janë 59 referues dhe bashkëreferues në 44 kumtime shkencore, të cilat do të hedhin dritë mbi aspekte të veçanta të qendrave tona të banuara.

Referuesit nga disa fusha të ndryshme nuk janë të paktë. Por, gama jashtëzakonisht e madhe e problemeve të qendrave të banuara do të kërkonte pjesëmarrjen e shumë studiuesve të fushave të tjera, si: gjeologë e sizmologë, klimatologë e hidrologë, hartografë dhe specialistë të sistemit të informacionit gjeografik, ekonomistë, stacionarë, demografë, sociologë, politikanë, juristë, ambientalistë, kulturologë, etnografë, antropologë socialë dhe kulturorë; studiues dhe menazhues të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, të turizmit dhe shumë të tjerë.

Para tre vjetësh u ndërmor projekti i madh i 100 + fshatrave, me objekt vizionar studimin dhe ndërtimin e programeve të zhvillimit të shpejtë, të qëndrueshëm dhe në harmoni me vlerat e natyrës të këtyre fshatrave. Projekti do të vazhdonte me idenë e shkëlqyer të promovimit dhe aplikimit të këtyre programeve si modele zhvillimi të qëndrueshëm në të gjitha vendbanimet dhe zonat rurale të vendit. Me gjithë rezultatet jo të vogla, përsëri projekti pati jo pak probleme, të cilat e kishin burimin në konceptimin e ngushtë të objektit, të metodës së studimit dhe të specialitetit të autorëve, të cilët ishin kryesisht urbanistë dhe arkitektë. Pa mohuar aspak rolin e madh të tyre në këtë ndërmarrje të madhe dhe me shumë përgjegjësi, ka qenë dhe mbetet e domosdoshme, si u theksua, pjesëmarrja edhe shumë studiuesve dhe specialistëve të tjerë.

Por le ta konsiderojmë këtë konferencë si një fillim të mbarë. Rezultatet e saj do të shërbejnë si bazë dhe nxitje për të ndërmarrë studime të thelluara dhe gjithëpërfshirëse mbi qendrat e banuara të vendit për t'u konkretizuar në botimin e monografive në rang njësisish administrative dhe kombëtar. Kjo do ta radhiste Shqipërinë në radhën e vendeve të përparuara, të cilat kanë kohë që studiojnë me themel qendrat e banuara ku zhvillohet jeta, veprimtaria jetësore e prodhuese e popullsisë. Ne duhet të marrim shembull nga Kosova, ku ka kohë që i është kushtuar vëmendje e veçantë studimit të qendrave të banuara. Monografitë e botuara për këto qendra përbëjnë një kontribut të vyer të shkencës kosovare në shërbim të kulturës dhe të zgjidhjes së problemeve shpesh të rënda të vendbanimeve rurale dhe urbane.

Zhvillimet e fundit në Shqipëri, shumica spontane dhe kaotike, kanë shumëfishuar problemet e vendbanimeve tona. Lëvizjet e mëdha të popullsisë nga zonat malore e kodrinore drejt zonës fushore dhe qyteteve të mëdha janë shoqëruar me braktisjen e shumë qendrave rurale, por edhe të disa qendrave urbane; krahina

të tëra, me pasuri të mëdha natyrore, janë drejt shkretimit të plotë demografik. Kjo ka sjellë probleme të mëdha në shpërndarjen gjeografike të popullsisë dhe të ekuilibrave demografikë; në zhvillimin social e ekonomik dhe rritjen e madhe të pabarazive midis rajoneve të vendit; në zhdukjen e pasurive kulturore dhe të traditave shumë të pasura të vendbanimeve të braktisura; në rritjen e vazhdueshme të proceseve të shkretirizimit të tokave të shumta të punueshme, tashmë të braktisura, dhe të peizazheve të tëra gjeografike.

Edhe në zonat fushore, sidomos perëndimore të vendit tonë, ku është grumbulluar pjesa më e madhe e popullsisë, qendrat e banuara, sidomos qendrat e mbingarkuara urbane, po përballen me probleme të mëdha sociale, ekonomike, urbane, mjedisore etj, të cilat, duke u agravuar vazhdimisht, po e vështirësojnë zhvillimin socioekonomik dhe jetën e banorëve, po e bëjnë atë gjithmonë e më stresuese. Prej kohësh ka dalë domosdoshmëria e studimeve mbi gjetjen e zgjidhjeve më të mira të këtyre problemeve të mëdha. Krahas studimeve të veçanta, tepër të rëndësishme, janë të domosdoshme edhe studimet gjithëpërfshirëse, si këto që kërkon të promovojë kjo konferencë.

Qendrat e banuara po përballen me sfidën e madhe mjedisore të ngrohjes globale të klimës me pasoja katastrofike për të sotmen dhe sidomos për të ardhmen jo të largët. Strategjitë dhe programet konkrete të zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes ndaj tyre, veç të tjerave, pa mëdyshje, duhet të mbështeten edhe në studimet e thelluara e gjithëpërfshirëse të vendbanimeve, me rol kryesor në suksesin e realizimit të këtyre strategjive dhe programeve.

Pa asnjë dyshim, rëndësinë e këtyre studimeve e kanë rritur edhe proceset tashmë të përcaktuara qartë të integritimit kombëtar, rajonal, europian dhe më gjerë, procese të cilat kërkojnë edhe ekspertizën shkencore të studiuesve të qendrave të banuara.

Bazuar edhe në termat e referencës së kësaj konference, midis problemeve të shumta të studimit të qendrave të banuara do të theksonim:

- Roli i kushteve gjeografiko-natyrore në formimin, evoluimin, shpërndarjen dhe funksionimin e vendbanimeve shqiptare; mundësitë e komunikimit e marrëdhëniet me vendbanimet dhe hapësirat e afërta e të largëta. Vendbanimet dhe rreziqet natyrore.

- Historia e vendbanimeve në hapësirën shqiptare. Historia e popullimit, lindja dhe etimologjia, fazat historike të zhvillimit dhe të evolucionit.

- Popullsia dhe vendbanimet. Ecuria e numrit të popullsisë, përqendrimet e saj, heterogjeniteti/ homogjeniteti i popullsisë; shtimi natyror, migrimet dhe faktorët natyrorë, socialë, politikë, shëndetësorë etj., efektet e tyre; strukturat sasiore dhe cilësore të popullsisë; gjendja sociale, cilësia e jetës; kultura, traditat materiale e jo materiale; trashëgimia kulturore.

- Urbanistika dhe infrastruktura. Lidhjet rrugore, sigurimi i energjisë, ujit, komunikimit, aksesit në internet etj. Morfologjia urbane/rurale, tipologji/tiparet e zhvillimit materiale të objekteve / lagjeve, zoonimi funksional hapësinor/modele, gravitacioni urban, lëvizjet pendulare etj.

- Përdorimi i GIS-it në planifikimin dhe menazhimin e qëndrueshëm të qendrave të banuara.

- Klasifikimi i vendbanimeve sipas origjinës, vendndodhjes dhe funksioneve. Vendbanim i vjetër apo i ri, fushor, kodrinor apo malor, me funksione banimi, pushimi, prodhues, aktivitete shërbimi, kompleksi i botës së punës të qytetit/fshatit. Tipologjitë bazë të funksioneve, roli dhe perspektiva e tyre funksionale; tipi i qendrës së banuar: qytet/fshat, administrative, industriale, bujqësore, turistike, tregtare, universitare, ushtarake etj. Vendbanimet rurale dhe cilësia e peizazhit.

- Vendbanimet e braktisura ose/dhe të zhvendosura. “Qytete të rinj” monostrukturorë të periudhës së komunizmit dhe dilema e mbijetesës së tyre pas vitit 1990. Faktorët e mundësitë e rivitalizimit/rifunksionimit të tyre dhe të qendrave të tjera të banuara.

- Vendbanimet dhe territori, resurset humane dhe proceset urbanizuese. Vendbanimet dhe përdorimi i tokës; evolucioni i tyre dhe peizazhi. Potenciali human e gjendja social-ekonomike, të ardhurat, cilësia e jetës, struktura e popullsisë dhe prirjet, profili ekonomik/funksional, përdorimi i tokës, ndryshimet hapësinore dhe strukturore.

- Administrimi i vendbanimeve. Reformat territoriale dhe efektet e tyre në menazhimin dhe kontrollin e territorit. Evolucioni hapësinor i njësive administrative dhe prirjet.

- Ekonomia e vendbanimeve. Aktivitetet prodhuese dhe sigurimi i të ardhurave. Struktura e prodhimit në qytet dhe fshat. Mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe siguria e vazhdimësisë së qëndrueshme në bazë të kapitalit natyror, human, ekonomik dhe territorial. Rivitalizimet urbane/rurale dhe zhvillimet turistike me fokus historik dhe aktual. Mbajtja e lidhjeve dhe rikthimi i banorëve të larguar.

- Fshatrat dhe Qytetet e “Zgjuara”, si koncept relativisht i ri në politikën dhe strategjitë zhvillimore të BE-së. Mundësitë e aplikimit të këtij koncepti edhe në vendin tonë, duke përdorur teknologjitë, telekomunikacionin, inovacionin digjital etj., të cilat mbështetin pikat e forta e asetet ekzistuese dhe krijojnë premisa për mundësi të reja zhvillimi të qëndrueshëm, të fortë e të shëndetshëm ekonomik dhe sociokulturor. Ndër to mund të përmendim: investime efektive në infrastrukturë, në kapitalin njerëzor dhe ngritjen e kapacitetit të komunitetit, qeverisjen e mirë me përfshirje të qytetarëve, përdorimin efikas të burimeve natyrore me sa më pak probleme mjedisore, zgjidhjen inovative të tyre edhe

nëpërmjet aplikimit të ekonomisë rrethore të mbetjeve bujqësore, urbane, industriale; përdorimin efektiv të vlerave natyrore, rurale e urbane; promovimin e produkteve vendore të mbështetura nga teknologjia dhe TIK-u; specializim të zgjuar, turizmit etj.; përmirësimin e cilësisë së jetës, ngritjen e standardit të jetesës, të shërbimeve publike etj.

- Probleme të përgatitjes dhe zbatimit të strategjive dhe programeve të veprimitarisë jetësore dhe prodhuese në vendbanimet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, të pasojave dhe të përshtatjes ndaj tyre. Infrastruktura e gjelbër dhe blu e qyteteve për përmirësimin e cilësisë së jetës.

- Peizazhet e bujqësisë urbane, si element i ri i territorit, pjesë integrale e strukturës urbane dhe e strategjisë të rigjenerimit urban; elemente të bujqësisë urbane, si faktorë për ribalancimin e territoreve dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile që mbart vetëdije të fortë ekologjike si vlerë identitare; riaktivizimin ekologjik dhe social i zonave të gjelbra urbane të braktisura dhe të degraduara. Roli i dyfishtë i bujqësisë urbane: ekosisteme cilësore urbane, si e mirë publike dhe për prodhimin e mallrave ushqimore, për shërbime, hapësira të reja sociale etj.

- Probleme të koshiencës regjionale, të lidhjeve shpirtërore të popullsisë me vendbanimin, rajonin dhe gjithë vendin, shkaqet e tronditjes së këtyre lidhjeve dhe strategjitë, rrugët dhe programet e forcimit të tyre.

- Ndërveprimi i faktorëve gjenetikë, historikë, por edhe natyrorë në formimin e identitetit vendor, rajonal dhe kombëtar, si një proces i ri me kahe pozitive, por njëherazi me shumë probleme dhe të panjohura.

Shumë nga këto probleme studimore janë edhe të fushës së albanologjisë. Por këtu shprehim mendimin se pasurimi i Albanologjisë në Kuvendin e saj të madh (2021) me studime nga etnoflora e etnofauna, etnobotanika e etnobilimësia,

antropogjenetika dhe antropomjekësia, të konsideruara larg studimeve albanologjike, duhet të pasohet edhe me përfshirjen e studimeve gjeografike mbi natyrën dhe shoqërinë tonë; me studime komplekse dhe gjithëpërfshirëse mbi qendrat tona të banuara. Këto studime, krahas të tjerave, do të ndihmojnë në sqarimin e shumë çështjeve dhe problemeve albanologjike.

U përqendruam kryesisht në disa prej prirjeve më të rëndësishme dhe specifike të sotme në studimin e vendbanimeve tona, duke theksuar se këto konkluzione janë thjesht shprehje përgjegjësie për të informuar njëri-tjetrin. Shpreh bindjen se në referimet dhe në diskutime tuaja do të dalin mendime e konkluzione më të plota dhe më të argumentuara rreth konsiderimit albanologjike të studimeve të plota dhe komplekse të vendbanimeve; rreth tematikës dhe domosdoshmërisë së ndërmarjes së tyre gjithëpërfshirës.

Së fundi, më lejoni që të shpreh bindjen e thellë se studimi i vendbanimeve tona do të jetë objekt e metodë shkencore e institucioneve studimore shqiptare, në radhë të parë i Akademisë së Shkencave si koordinatorë, por edhe të gjitha universiteteve të vendit. Garanci për këtë janë studiuesit e afirmuar, mendjendritur dhe me kontribute të mëdha. Njëherazi shprehim kënaqësinë se shkenca e sotme shqiptare ka një gjeneratë të re studiuesish të ditur dhe të apasionuar, që po i thellojnë dhe i çojnë përpara arritjet në studimin e vendbanimeve tona. Natyrisht ne, gjithë brezi ynë, u jemi tepër mirënjohës për këtë dedikim të tyre.

Ju uroj të gjithëve suksese në referimet tuaja të vyera shkencore!





## **PANELI I**

### **GJENDJA DHE PRIRJET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMEVE TË VENDBANIMEVE NË SHQIPËRI**



**Prof. dr. Perikli Qirjazi<sup>1</sup>**

## **QENDRAT E BANUARA NË DHE AFËR SITEVE TË TRASHËGIMISË NATYRORE SHQIPTARE DHE RAPORTI MIDIS TYRE**

### **Abstrakt**

Ekziston perceptimi se kufizimet jo të vogla në shfrytëzimin e resurseve natyrore të zonave të mbrojtura frenojnë zhvillimin, pakësojnë mjetet e jetesës së popullsisë dhe ulin nivelin e jetesës së saj. Por duhet theksuar se menazhimi shkencor i siteve të trashëgimisë natyrore, i integruar me planet e zhvillimit rajonal dhe me pjesëmarrje lokale, promovon konceptin e “kapitalit natyror e njerëzor” të këtyre zonave, mbron vlerat e tyre natyrore dhe njëherazi krijon premisa për të transformuar pasuritë natyrore në mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për rritjen e mirëqenies; ruan dhe forcon identitetin; mbron dhe rivlerëson trashëgiminë kulturore; ristrukturon dhe ndryshon funksionet e qendrave të banuara, duke i bërë ato më komode për jetesë dhe modele të harmonisë midis natyrës dhe zhvillimit socioekonomik.

Mbi bazën e këtyre koncepteve të reja për zgjidhjen e sfidës së madhe të ditës “zhvillim socioekonomik, duke respektuar natyrën”, në artikull jepen problemet, rrugët dhe metodat e menazhimit të orientuar ekologjikisht të zonave tona të mbrojtura dhe gjithë territorit, ku ato ndodhen. Interes ka analiza për shfrytëzimin shkencor të integruar dhe kompleks të vlerave të çmuara natyrore dhe kulturore të siteve të trashëgimisë sonë natyrore dhe të qendrave të banuara për rritjen e qëndrueshme të territorit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të komuniteteve vendore. Këto konkretizohen me rrugët dhe format e menaxhimit të integruar të monumenteve të natyrës (rasti i Shpellës së Zezë, afër Tiranës, rrapet në qendrat e banuara, objektet natyrore të shenjta fetare etj.). Për këtë qëllim propozohet që, nëpërmjet aktiviteteve ekonomike, sidomos

---

<sup>1</sup> E - mail: [perikli.qirjazi@gmail.com](mailto:perikli.qirjazi@gmail.com)

tradicionale, sociale, kulturore e rekreative të komunitetet vendore, zhvillimi i ekoturizmit të qëndrueshëm.

*Fjalë çelës: resurse natyrore, zona të mbrojtura, menazhimi shkencor, kapitali natyror dhe njerëzor, zhvillim socio- ekonomik, ekoturizmi.*

### **Abstrakt**

There is a perception that significant restrictions on the use of natural resources in protected areas inhibit development, reduce the livelihood of the population and reduce its standard of living. But it should be noted that the scientific management of natural heritage sites, integrated with regional development plans and local participation, promotes the concept of "natural and human capital" of these areas, protects their natural values and at the same time, it helps to transform natural assets in new opportunities for sustainable economic development and for increasing welfare; preserves and strengthens identity; protects and re-evaluates cultural heritage; restructures and changes the functions of inhabited centers, making them more comfortable for living and models of harmony between nature and socio-economic development.

Based on these new concepts for solving the great challenge of the day "socio-economic development, respecting nature", are listed the problems, the ways and methods of ecologically oriented management of our protected areas and the whole territory where they are located. Of interest is the analysis of the integrated and complex scientific exploitation of the precious natural and cultural values of our natural heritage sites and inhabited centers for the sustainable growth of the territory and the improvement of the quality of life of the local communities. These are concretized with the ways and forms of integrated management of natural monuments (the case of the Black Cave, near Tirana, maples trees in inhabited centers, sacred natural religious sites, etc.). For this purpose, it is proposed the development of sustainable ecotourism through economic activities, especially traditional, social, cultural and recreational of local communities.

*Keywords: natural resources; protected areas; scientific management; natural and human capital; socio-economic development, ecotourism.*

### **Hyrje**

Qysh nga shpallja e zonës së parë të mbrojtur në botë në vitin 1872 (Parku Kombëtar Yellowstone) në SHBA (<https://www.nps.gov/yell/index.htm>), krahas rritjes së interesit

shkencor, ekologjik, ekonomik, kulturor etj. për sitet e mbrojtura, lindi edhe kontradikta e madhe midis mbrojtjes së vlerave të natyrës dhe zhvillimit socioekonomik, interesit imediat të popullsisë të vendbanimeve (VB) në ose afër siteve të mbrojtura dhe kufizimeve ligjore për formën e përmasat e shfrytëzimit të pasurive natyrore. Zgjidhja e kësaj kontradikte kërkon studime mbi rrugët e zhvillimit socioekonomik dhe të rritjes së mirëqenies së popullsisë, duke ruajtur e mbrojtur zonat e mbrojtura (ZM) dhe gjithë mjedisin.

Njëherazi, studimi, vlerësimi, mbrojtja dhe menazhimi shkencor i trashëgimisë natyrore e kulturore (TNK) përbën nevojë urgjente ndaj sfidave dhe pasojave të zhvillimeve të fundit në botë, si: globalizmi, i cilësuar “rul i madh ngjeshës dhe rrafshues i identitetit” (*Civici, 2009*); urbanizimi me ritme galopante<sup>1</sup>, probleme mjedisore dhe zhvillimi i shpejtë e jo rrallë kaotik i turizmit. Këto po rrezikojnë të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit, i cili “po shkon drejt kolapsit të pashmangshëm, të pakthyeshëm të ekosistemeve” (*Arne, 2012*); po dëmtojnë e shkatërrojnë edhe vlerat e rralla të siteve të TNK.

Evidentimi i siteve me vlera të rralla natyrore, shpallja ZM dhe menazhimi shkencor, me të drejtë, u cilësua si rruga më e mirë për mbrojtjen e tyre dhe vendosjen e harmonisë midis natyrës dhe zhvillimit, rritjes së kërkesave për mjete jetese të popullsisë, që po shtohet shpejt. Studimet e drejtuara nga FUUT (Forumi Unesco - Universitet – Trashëgimi) ndihmuan në sigurimin e mbështetjes ligjore dhe institucionore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare (ligjet e vendimet për ZM, Konventa e Trashëgimisë Botërore, 1972 (KTB) etj); në përgatitjen e strategjive të rritjes së sipërfaqes së mbrojtur, të ruajtjes së saj dhe në përgatitjen e studiuesve e

---

<sup>1</sup> Shumë autorë (*Christophe, 2012, 2013 etj*) qytetet e rritura nga emigracioni kaotik i cilësojnë “përbindështa” të qenieve humane dhe të territoreve”.

menazhuesve ZM për t'i mbrojtur dhe për t'i kthyer ato në gjeneratorë të fuqishëm të zhvillimit të qëndrueshëm të VB (Qiriazhi, 2020).

Lista e Trashëgimisë Botërore (LTB) numëron 1154 site nga të cilat 897 kulturore, 218 natyrore dhe 39 mikse (2021) (<https://whc.unesco.org/fr/list/>). Janë ndërmarrë edhe programe të tjera në shkallë botërore (Ligatina Ramsar, Rezerva të Biosferës etj) dhe europiane (Natyra 2000, rrjeti EMERALD, i Parqeve të Harkut Dinarik, i zonave të mbrojtura detare të Mesdheut, Brezi i Gjëlber European etj.).

Zona e parë e mbrojtur e vendit tonë konsiderohet Kune-Vaina, e shpallur “Rezervë Gjietie Shtetërore” (1940). Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar u shpallën disa site të mbrojtura: parqe kombëtare (PK), monumente natyre (MN) dhe rezervate gjietie, që në vitin 1990 zinin 1.8% të vendit (Qiriazhi, 2020). Pas vitit 1990, u njohën programet e UNESCO-s, KTB, përvoja e vendeve të zhvilluara për ZM etj. TN u bë objekt i disa shkencave natyrore dhe sociale. Për herë të parë, grupe studiuesish të fushave të ndryshme, vendës e të huaj, propozuan strategji e programe të mbështetjes ligjore e institucionore për vlerësimin, shpalljen, mbrojtjen, menazhimin shkencor të TN e përfshirjen e saj në planet e zhvillimit të qëndrueshëm etj. Po, për herë të parë, në bashkëpunim me grupe speleologjike të huaja, u evidentuan rreth 2000 shpella karstike (Tetide APS, 2021). Disa prej tyre u eksploruan e u shpallën MN, u përgatitën projekte për kthimin e tyre në turistike etj. Mbi bazën e kriterëve, në disa raste joshkencore, në vitet e fundit u riorganizua e zgjerua rrjeti i ZM, që zë rreth 604 000 ha ose rreth 21% të vendit (VKM nr 10, 2020 & nr.60, 2022).

Midis siteve të Listës së Trashëgimisë Botërore, me dinjitet e vlera unike, qëndrojnë sitet tona: Rajca dhe Gashi me pyje primare e të vjetra ahu të Karpateve etj.; Butrinti, Gjirokastra, Berati, rajoni i

liqenit të Ohrit. Krahas tyre, janë shpallur: Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Prespë-Ohër dhe ligatina Ramsar; sitet e rrjetit "EMERALD", të harkut dinarik dhe të Mesdheut, të Brezit të Gjellbër European; pjesëmarrja në programin "Natyra 2000" etj.

Zgjerimi i sipërfaqes së mbrojtur, në kushtet e ndikimit të pasojave negative të globalizmit, të ritmeve të urbanizimit intensiv, më tepër kaotik, dhe të problemeve mjedisore, nxori urgjencën e përgatitjes së studiuesve e specialistëve të trashëgimisë dhe të edukimit të brezit të ri me ndjenjat e respektit, mbrojtjes të ZM. Ndaj, kurrikulat parauniversitare e universitare u pasuruan me programe mbi trashëgiminë. Doli nevoja e njohjes dhe e aplikimit të koncepteve të reja për zgjidhjen e kontradiktës midis kërkesave në rritje për burime natyrore nga popullsia e qendrave të banuara (QB) dhe nevojës për mbrojtjen e ZM. Ka pak përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi. Ky artikull inicion studimin e tij.

I mbështetur në konceptet e reja për zgjidhjen e sfidës "*zhvillim socioekonomik, duke respektuar natyrën*", artikulli thekson menazhimin shkencor ekologjik të kapitalit natyror e njerëzor të ZM, duke i integruar me planet e zhvillimit rajonal të territorit dhe me pjesëmarrje vendore. Kjo krijon premisa për t'i kthyer pasuritë natyrore të ZM në mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; ndihmon rritjen e qëndrueshme të territorit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të komuniteteve vendore; ruan dhe forcon identitetin; mbron dhe rivlerëson trashëgiminë kulturore (TK); ristrukturon dhe ndryshon funksionet e QB, duke i bërë ato komode për jetesë dhe modele të harmonisë midis natyrës dhe zhvillimit socioekonomik; ndihmon në integrimin e vendit në BE. Këto ide konkretizohen me format e menazhimit të integruar të MN (rasti i Shpellës së Zezë, rrapet në QB, objektet natyrore të shenjta fetare etj).

## I. Hapësira e studimit

Përfshin territorin e ZM, brezin tampon përreth tyre e më gjerë, hapësirën e zënë nga QB dhe aktivitetin jetësor e prodhues të popullsisë së tyre. Sitet e mbrojtura, si u tha, zënë rreth 21 % të vendit dhe përfshijnë gati të gjithë larminë e natyrës së vendit. Por natyra jonë, ky muze i madh natyror, ka edhe shumë vlera të tjera që meritojnë statusin e ZM, por ato duhen studiuar e propozuar për këtë status (*Doka, Qiriazi, 2021*).

VB gjenden në brendësi dhe në rrethina të ZM, ndërsa disa MN në brendësi të tyre. Sitet e mbrojtura shtrihen nga deti e zonat bregdetare deri në lartësitë e vendit; në territore fushore, kodrinore e malore; në të gjitha brezat klimatikë, të tokave e të bimësisë, në ekosisteme dhe pellgje të ndryshme hidrografike; në hapësira me popullim, dendësi, përmasa dhe aktivitet jo të njëjtë të QB. Ndaj, tiparet, vlerat, ekuilibri natyror dhe resurset e larmishme natyrore të tyre kërkojnë forma specifike menazhimi, të ruajtjes së harmonisë midis zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe mbrojtjes së vitalitetit të ZM. Kjo arrihet kur studimet e raportit midis siteve të mbrojtura dhe QB, bëhen të diferencuara sipas kategorive, tipareve të veçanta të ZM dhe sipas karakterit, përmasave, tipit, funksioneve dhe perspektivës së VB.

## II. Metoda

Marrëdhëniet midis siteve të TN dhe QB janë tepër të ndërlikuara, sepse kushtëzohen nga shumë faktorë: natyrorë, socialë e humane, historikë, të traditës, aktualë e të perspektivës, ekonomikë e politikë, vendorë, rajonalë, kombëtarë e më gjerë, teknikë etj. Studimi i tyre kërkon dhe analiza të ndryshimeve në kohë e hapësirë të sfidave të zhvillimit socioekonomik. Ende nuk ka studime të tilla.

Për përgatitjen e artikullit, me qëllim kryesor raportin TN - VB dhe inicimin e studimit të tij, u njohën konceptet e reja dhe përvoja



në disa ZM të huaja për përgatitjen e zbatimit e strategjive e programeve të zgjidhjes së kontradiktës midis tyre dhe zhvillimit të qëndrueshëm të QB. Vëmendje iu kushtua njohjes së shkallës së dëmtimit dhe shkaqeve, lidhjeve ekonomike dhe shpirtërore të VB me ZM. Për këtë qëllim u shfrytëzuan të dhënat zyrtare e statistikore, plane menazhimi, botime, ekspeditat në terren, ku u bënë biseda me banorë e specialistë mbi shkallën e njohjes të vlerave natyrore, për masën e format e shfrytëzimit të resurseve të ZM; për lidhjet shpirtërore të banorëve me këto site etj.; u njohën strategji zhvillimi të njësive administrative, ku nuk flitet për përdorimin miqësor të ZM dhe as për integrimin e tyre në këto strategji. Mbi këtë bazë, u ballafaquan rastet tona me konceptet e reja e modele menazhimit të ZM; u formuluan drejtime të integritit të planeve të menazhimit të ZM me plane zhvillimi të territorit e të njësive administrative; u analizuan rastet e MN të Shpellës së Zezë, të rrapeve në VB e të objekteve të shenjta.

### **III. Rezultate**

#### **III.1 Rishikimi i rrjetit të zonave të mbrojtura (2019-2022) dhe probleme me vendbanimet**

Pas rishikimit të fundit, rrjeti i ZM ka këtë përbërje: 11 PK; 721 monumente natyre (MN), 23 parqe natyrore (PN), 10 peizazhe të mbrojtura (PM); 3 parqe natyrore bashkiake (PNB) të propozuar dhe ekomuzeu Aos/Vjosa (*VKM nr.303, 2019& nr.60,2022*). Nisur nga objekti i artikullit, theksojmë disa konkluzione:

- U zgjerua sipërfaqja e mbrojtur duke shpallur site të reja, ndër të cilat dallohen: PN Lugina e Vjosës, Shalës, Gjergjevicës, Munella, të cilat kanë vlera të mëdha ekologjike, shkencore, turistike etj.

- Për të ruajtur vlerat e Vjosës, si “i vetmi lumë i egër i Europës”, lugina, madje pellgu ujëmbledhës i saj duhet të kishte marrë statusin e PK, i cili do të siguronte mbrojtje më të madhe ligjore.

- Rishikimi bëri ndryshime të pastudiuara të disa kufijve të ZM: a) u hoqën fshatrat në rrethinat dhe sektorët e aktivitetit turistik e të antenave në PK Mali i Dajtit e të PN Mali me Gropa; u hoqën qyteti i Divjakës dhe fshatrat në bregun lindor të lagunës së Karavastasë (PK Divjakë-Karavasta); b) ndërtimi i aeroportit të Vlorës në PM Nartë-Pishë Poro, me peizazhe magjepsëse e biodiversitet të pasur, redukton rreth 45% të sipërfaqes të sitit (Lika, 2020); c) reduktimi i PK të Butrintit, i PM Bunë – Velipojë etj. Si shihet në hartat e siteve në fjalë (Fig.1,2,3) në brendësi të tyre, por edhe të disa të tjera u krijuan njolla të bardha, ishuj pa mbrojtje, duke u hapur rrugë bujqësisë intensive dhe impianteve të energjive të rinovueshme, që shkatërrojnë habitatet dhe korridoret e shtegtimit të shpendëve. Këto njolla të bardha, duke copëtuar ekosistemet, cenojnë rëndë biodiversitetin dhe vlerat e tjera natyrore të ZM etj.

- Me sa duket, në këtë rishikim, ZM dhe QB, aktiviteti ekonomik i tyre, u trajtuan si kontradiktorë, deri në mohim të njëra – tjetrës. Ky koncept, krejtësisht i gabuar, i ka çuar autorët e rishikimit në absurditete: *“meqë nuk mundemi ta mbrojmë ZM e heqim fare nga lista”* (MN Plazhi i Gjeneralit, Tarraca detare e Dajtit etj.), duke i hapur rrugë shfrytëzimit legal intensiv, brutal të tyre; ose *“i ndryshojmë statusin, i ulim kategorinë dhe shkallën e mbrojtjes”*: rasti i PK Bredhi i Drenovës, i cili, i shtrirë deri në Sinicë, tani ka statusin e PM. Përveç vlerave të mëdha shkencore dhe ekologjike, ky park ka edhe vlera shpirtërore për korçarët, të cilët, përmes piknikëve të famshëm shijojnë peizazhin mahnitës, pyjet e bredhit, ujin e pastër të burimit të Bozdovecit, që, si thotë kënga e vjetër korçare: *“... edhe plakun e bëjnë të ri”*. Lidhjet e forta shpirtërore i japin ish-parkut edhe vlera identiteti për banorët e qytetit të Korçës dhe fshatrave përreth ish-parkut. Të njëjtin fat patën edhe site të tjera të mbrojtura: dy RSM, PK i Qafë Shtamë, tani me statusin e PN; PN i

Rrushkullit në PM; RSM Bredhi i Kardhiqit në PN etj. (VKM nr. 10 dt. 28.12.2020 dhe nr.60 dt. 26.1.2022).



Fig.1 Ndryshime në PK të Dajtit, PN Qafë Shtamë e Mali me Gropa (Diku, 2021, me modifikime).



Fig.2 Ndryshime në PK Divjakë – Karavasta (Diku, 2021, me disa modifikime) (Diku, 2021, me modifikime).



Fig.3 Sektori ku po ndërtohet aeroporti i Vlorës në PM Nartë- Pishë Poro (Lika, 2020)

- Problemi i siteve të mbrojtura është shumë kompleks dhe mjaft i ndërlikuar. Evidentimi, shpallja, rishikimi dhe menazhimi i tyre kërkon studime ndërdisiplinore dhe afatgjata. Numri i kufizuar i specialistëve që punuan për këtë rishikim dhe koha tepër e shkurtër pamundësuan studime afatgjata, të mbështetura në vrojtime e matje të përsëritura në terren. Duket sikur ky rishikim është bërë në plotësim të kërkesave për të liruar nga detyrimi ligjor mbrojtjen e hapësirave të ZM me aktivitet intensiv ekonomik.

### **III. 2 Koncepte të reja mbi raportin midis siteve të mbrojtura dhe vendbanimeve**

Studimet ndërdisiplinore në vendet e zhvilluara përcaktuan konceptet bazë që zgjidhin kontradiktat e këtij raporti, duke treguar rrugët e zhvillimit të VB në harmoni me natyrën e ZM dhe duke i kthyer ZM në mundësi të reja për jetesë cilësore të komunitetit të ndërgjegjësuar e bashkëpunues. Midis tyre theksojmë:

- Njohje e aplikim i koncepteve “kapital territorial”, me komponentë kryesorë: prodhues, njohës, socialë, mjedisorë, vendbanim, infrastrukturorë, njerëzorë etj (*Brasili, 2012*); “kapital natyror”, me tërësinë e pasurive e vlerave të natyrës (*Donati, Messori e al. 2011*) dhe “kapital njerëzor e social”, me rëndësi për zhvillim vendor endogjen, shtylla bazë e parakusht për suksesin e politikave territoriale (*D’Alessio, Manente, 2014*).

- Kapitali njerëzor sigurohet përmes përgatitjes dhe trajnimeve në: mbikëqyrja e ZM; shërbimet turistike për promovimin e marketingun territorial të produktit të ZM; menazhimin e destinacionit, sipërmarrjen e mbështetjen e biznesit; marketingun agroushqimor e promovimin e produkteve tradicionale të bujqësisë e të origjinës; rimëkëmbja e zanateve tradicionale e të reja (punë të gjelbra); njohja e gjuhëve të huaja; fermat arsimore e sociale, si organizim territorial për ruajtjen e peizazheve e mjedisit, si prodhues i produkteve cilësore vendëse dhe si bazë zhvillimi rural, falë multifunksionalitetit etj (*D’Alessio, Manente, 2014*).

- Shkretirizimi demografik dhe plakja e popullsisë në krahinat tona të brendshme malore e kodrinore si pasojë e migrimit masiv sollën humbjen e kapitalit njerëzor, i domosdoshëm për zhvillimin e tyre. Ndaj, është urgjente gjetja e rrugëve të vlerësimit e shfrytëzimit të kapitalit të pasur natyror dhe të TN të larmishme, e shprehur në numrin e shtrirjen më të madhe të ZM. Me potencialet e kapitalit natyror, njerëzor e kulturor, ZM mundësojnë sektorë të rinj punësimi, figura të reja profesionale, ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm endogjen ekonomik të rajoneve të varfra. Vetëm PK sigurojnë 3% të PBB të Italisë (*Cfr. CNR, 2012*). Kjo motivon rikthimin e të larguarve, ripopullimin e QB të braktisura.

- ZM dhe rrjeti ekologjik janë elemente lidhjeje midis misionit të tyre prioritar (mbrojtja e natyrës, biodiversitetit etj.) dhe mbështetjes për aktivitete të qëndrueshme mjedisore, ekonomike e sociale (*Quaglia, Montanari & al, 2011*); një nga burimet strategjike

të zhvillimit të territorit përmes ekoekonomisë (Caprotti, 2020), rikualifikimit të trashëgimisë natyrore arkeologjike e historike; mbështetjes për sipërmarrjen e re në ZM; promovimit të kapitalit njerëzor, me rol kryesor në kualifikimin territorial (Ferro & Ponte, 2014).

- BE-ja ka ndjeshmëri ndaj qëndrueshmërisë mjedisore, që sigurohet përmes integritit të politikave e pjesëmarrjes së përbashkët të niveleve të qeverisjes dhe aktorëve të tjerë; përmes integritit të planeve e programeve kombëtare për rritjen e punësimit, solidaritetit social, politikave të kohezionit territorial dhe instrumenteve për mbrojtjen e mjedisit (D'Alessio, Manente, 2014).

- Zhvillimi i rajoneve kërkon: menazhim shkencor territorial edhe të ZM, që u ofrojnë komunitetit të tyre vlera të kapitalit natyror e territorial, duke i kthyer këto zona në pika referimi për politika mbrojtjeje të mjedisit e të nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe modele ekuilibri në integrimin midis zhvillimit dhe ruajtjes së TN; kërkon marrëdhënie të reja midis VB dhe ZM dhe ristrukturimin e politikave territoriale.

- Integrimi i këtyre menazhimeve me politikat e planifikimit urban e territorial dhe me politikat e programet e koordinimit dhe zhvillimit socioekonomik territorial rajonal e kombëtar, mundëson: promovimin dhe aplikimin e konceptit të ri “kapital territorial, natyror dhe njerëzor” të ZM dhe të peizazheve përreth VB; një strategji të përgjithshme për vendosjen dhe ruajtjen e ekuilibrit natyror mbron vlerat e rralla natyrore; krijon premisa për të kthyer pasuritë natyrore të ZM në mundësi të reja zhvillimi të qëndrueshëm dhe për rritjen e mirëqenies; mbron dhe rivlerëson trashëgiminë kulturore; ruan dhe forcon identitetin; ristrukturon dhe ndryshon funksionet e QB, duke i bërë ato: komode për jetesë shumë më cilësore, modele të harmonisë midis natyrës dhe zhvillimit socioekonomik; mundëson zgjidhjen e sfidës së madhe

të ditës “*zhvillim socioekonomik, duke respektuar natyrën*” (D’Alessio, Manente, 2014).

- ZM ka rol qendror në politikat e planifikimin urban e territorial. Vlerësimi i rëndësisë së saj ekonomike, territoriale e kulturore ndihmon në përcaktimin e strategjive të reja për: strukturimin e hapësirave urbane të lidhura me sistemet natyrore të ZM; rigjenerimin urban e territorial; për projektimin e qyteteve më elastike, të afta për t’iu përgjigjur ndryshimeve klimatike; për të njohur e shfrytëzuar shërbimet e ekosistemit nga banorët e tyre. Të flasësh sot për ZM do të thotë të flasësh për planifikim urban (Sargolini, 2004).

- Trashëgimia rurale, objektiv prioritar zhvillimi i BE-së, e vlerësuar njësoj si trashëgimia historiko-artistike, peizazhore e mjedisore, në shoqërinë e sotme të globalizuar, të projektuar kryesisht nga jashtë, krahas të tjerave, duhet të konsiderohet si bartëse e identitetit (Zanovello, Pirredda & et al, 2007). Por çdo territor, me tiparet natyrore dhe mbartës i historisë e i kulturës, është i veçantë, unik, ka identitetin e tij, i cili duhet njohur, mbrojtur dhe pasqyruar në planet e zhvillimit rural dhe rajonal. Për këtë qëllim duhet: krijimi i databazës mbi burimet natyrore, peizazhore, arkeologjike, historike, artistike, etnografike etj., i nevojshëm për vlerësimin e trashëgimisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural; transmetim te përdoruesit i identitetit territorial edhe përmes itinerareve, si mjete për njohjen e shijimin e ZM dhe gjithë peizazhit, trashëgimisë mjedisore, kulturore artistike, rurale etj. Mbi këtë bazë është projektuar dhe po aplikohet projekti i madh “Shtigjet e Europës” (Messina, 2016); aftësimi i kapitalit njerëzor; strukturimi e rikualifikimi territorial dhe urban; diversifikimi i aktivitetit jetësor e prodhues i QB etj.; zhvillimi i turizmit rural, të gjelbër etj.

### III.3 Monumentet e natyrës – mundësi zhvillimi të qendrave të banuara

Lista kombëtare numëron 721 MN me vlera unike: shkencore, kulturore, didaktike, fetare e turistike. Ka ende objekte natyrore që meritojnë statusin e MN. Me vlera të panjohura, pa plan menazhimi, jashtë vëmendjes së strategjive zhvillimore, jashtë planeve të strukturimit e rikualifikimit urban dhe të zhvillimit të QB, shumë MN janë dëmtuar e shkatërruar, disave iu hoq statusi. Por ekzistojnë kushtet për menazhimin e MN për qëllime shkencore, kulturore, didaktike e turistike: numri e larmia e madhe, studime e botime jo të pakta; përpjekje për përgatitjen e planeve të menazhimit, projekteve etj.

Planet e menazhimit të MN duhet të kenë trajtesa të veçanta, që burojnë nga specifika e tyre: përmasa e kufizuar dhe shtrirja në kategori të ndryshme të ZM dhe peizazheve, madje edhe brenda QB; vlera unike që gëzojnë mbrojtje ligjore maksimale; natyra e ndryshme, që lidhet me botën e gjallë dhe jo të gjallë etj.

#### III.3.1 Menazhimi i MN Shpella e Zezë, model i zhvillimit të turizmit të shpellave dhe sfidë për zhvillimin e fshatit dhe pjesës juglindore të bashkisë së Tiranës

Shpella e Zezë ose sensacioni i speleologjisë shqiptare, rreth 20 km nga Tirana, në grykën e Skoranës; 482 m mbi nivelin e detit, 360 m e gjatë, me korridore dhe salla të mëdha mbi 30 – 40 m të gjera e të gjata, mbi 20 - 30 m të larta<sup>1</sup>. Ndër vlerat e saj dallohen: a) Burim i pazëvendësueshëm informacioni gjeologo-gjeografik, paleontologjik, biologjik, arkeologjik etj; b) Skelete të arinjve të shpellave (*Ursus speleaus*), që kanë jetuar nga 10000 në 400000 vjet

---

<sup>1</sup> U eksplorua nga Grupi Speleologjik Faentino (1995) dhe LA VENTA Esplorazioni Geografiche (2016).



më parë<sup>1</sup>, e rrallë në Europë e botë, të kthyer në muze, tepër të vizituar nga turistë; c) shpella jonë ka vlera më të mëdha se simotrat e saj, sepse ka mbetje humane të periudhës nga neoliti në mesjetën e hershme (*Muça, 2015*). d), laborator i proceseve karstike dhe ekosistem interesant nëntokësor karstik me botë të pasur të gjallë etj. e) konkrecionet e kalcitit me bukuri mahnitëse (stalaktite, stalagmite, kolona, ujëvara të gurta, perla etj.), liqene (Foto 1,2,3,4,5) me vlera turistike, të shtuara nga gjetjet humane e paleontologjike (*Qiriazhi, Sala, 2015; Sala, Qiriazhi & al, 2021*).

Para disa vitesh u përmirësua rruga këmbësore që të çon në Shpellën e Zezë dhe u instalua sinjalistika<sup>2</sup>. Kjo e rriti numrin e vizitorëve të shpellës dhe interesin e biznesit, i cili po investon në ndërtimin e lokaleve në Pëllumbas, ku është rritur edhe çmimi i tokës. Kjo përpjekje spontane ka më shumë pasoja negative se pozitive. Vizitorët, jashtë kontrollit, kanë dëmtuar stalaktitet e stalagmitet me vlera të pakthyeshme, ndërsa mungesa e infrastrukturës së shpellës e bën të rrezikshme vizitën në të.

Për t'i vënë vlerat e kësaj shpelle në shërbim të studiuesve dhe të turizmit, u përgatit projekti (2010), që synoi: studimin e vlerave të saj; kthimin e shpellës në muze gjeologo-gjeografik, paleontologjik dhe arkeologjik, ku të vendosen mjediset e jetesës së arinjeve dhe të njeriut të shpellave etj. Ky muze si dhe homologët e vet europianë, do të jetë ndër objektet më të vizitueshme dhe me vlera për një rreth të gjerë njerëzish të moshave dhe të profesioneve të ndryshme, vendës dhe të huaj.

Në vitin 2015, për Shpellën e Zezë shprehën interes dhe premtuan mbështetje financiare bashkia e Tiranës, Ministria e Mjedisit dhe e Zhvillimit Urban, si dhe TIFF-i. Njëherazi, përparoi ideja e autorëve të projektit (*Qiriazhi, Sala, 2015*), të cilët theksojnë se

<sup>1</sup> Vlerësim i dhëmbëve të ariut nga Muzeu i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Firences, 2002.

<sup>2</sup> Mundësuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Republikën e Shqipërisë.

atraksioni turistik i shpellës do të shumëfishohej nëse vlerat e saj do të menazhoheshin të integruara me potencialet natyrore e kulturore të gjithë zonës Shpella e Zezë–Pëllumbas–Skoranë–Murdhar- Pashkashesh dhe nëse shpella do të trajtohet si bërthamë nga ku të marrin udhë aktivitete turistike në objektet afër saj; realizimi i projektit në disa faza:




Foto 1,2 Lakuriq nate dhe mbetje të skeletit të ariut të shpellave (I.Fabbri)



Foto 3,4,5 Ariu i shpellave, skeleti i tij (Muzeu i Universitetit të Firences (P. Qiriaz) e Ujëvara të gurta (I. Fabbri).

- e para, menazhimi i shpellës, e dyta shtrihet në gjithë kompleksin, e treta bashkohet me parkun turistik Shën Gjergj - Mali me Gropa.

Kjo mundëson: ofertë turistike më të plotë e më të larmishme; rritet efektiviteti i investimeve dhe zhvillimi socioekonomik do të shtrihet në një zonë më të gjerë, me varfëri të madhe. Në këtë park turistik ka site të tjera natyrore që mundësojnë turizmin e aventurës (speologjik, alpinizmin, ekskursione në natyrën etj.), ekoturizmin kulturor etj. Midis tyre dallohen:

- *Gryka e kanioni i Skoranës dhe i Murdarit*, MN, rreth 1 km të gjata, mbi 120 m të thella dhe nga rreth 20-30 m të gjera deri në formën e kanionit të thellë, me shpate të thepisura, ndërsa, në shtratin e lumenjve ka pellgje uji, ujëvara, mikroforma të çuditshme (syri i Ciklopit, Zemra e Bishës etj.);

- *Mali i Pashkasheshit dhe i Priskës* (850 m dhe 1336 m), me forma karstike dhe shpate të thepisura, kreshhta gati të sheshta. Nga lartësitë e tyre shpalosen pamjet mahnitëse.

- *Shëngjergji dhe Mali me Gropa*, rreth 40 km nga Tirana, në malësinë e Tiranës. Quhet edhe “thesari i fshehur i Tiranës” me peizazhe magjepsëse; MN rrapi shekullor Kom Ka, ujëvara e Shëngjinit, rreth 30 m e lartë; fortifikime prehistorike-antikiteti i vonë, rrënojat e kalave e të kishave të vjetra (*Muçaj, 2015*); PN Mali me Gropa (1848 m), me gropat karstike aq pranë njëra-tjetrës sa të kujtojnë hojet e bletëve etj.

- *Qendrat karakteristike të banuara* (Pëllumbas, Pashkashesh, Killojkë, Fag, Shëngjergj, Vërri, Shëmri, Shëngjin, Façesh etj.) kanë tradita të pasura etnografike, folklorike, të kulinarisë tradicionale, arkitekturës së banesave etj. Oferta turistike pasurohet me objekte e vlera të tjera kulturore, si: rrënoja të kalave të shekullit të 17-të e 18-të, të banesave, të kultit etj. (*Muçaj, 2015*); mundësi për organizimin e lojërave popullore tradicionale, të festivaleve krahinore etj.; mundësi për hapjen e muzeut të kulturës materiale e shpirtërore të popullsisë, ditës së pazarit me prodhimet bujqësore bio; për përshtatjen e banesave për vizitorë etj. Popullsia e tyre mikpritëse vlerëson ofertat e MN për aktivitete të reja zhvillimi dhe për rritjen e mirëqenies së saj. Këtë ata e kanë ndjerë qysh tani: u rritën vizitat në shpellë, Pëllumbasi, pjesë e projektit 100+fshatra, iu rikualifikua qendra e u ndërtuan objekte turistike, u përmirësuan rrugët, u rrit vlera e pronës etj. (Foto 6,7,8). Zona do të bëhet rajon rekreacioni turistik për popullsinë e madhe të Tiranës, Durrësit, Elbasanit etj.

Për suksesin e këtij projekti janë të gjitha kushtet: baza e plotë ligjore, shpella pronë publike; institucione të specializuara vendëse e të huaja dhe studiues të aftë; njihet përvoja botërore për kthimin në muze dhe trajtimin turistik të shpellave; rajoni Tirana, Durrësi, Elbasani etj., ka mundësi për investime; bindja tek organet shtetërore mbi vlerat turistike të shpellave për ngritjen e cilësisë së jetës të popullsisë etj.

Në verën e vitit 2016, filloi realizimi i projektit: u rikualifikua qendra e Pëllumbasit; LA VENTA Esplorazioni Geografiche përgatiti prospektin e parkingut, të mjediseve të pritjes së vizitorëve, muzeut, rrugës parking – shpellë, këmbësore ose për mjete elektrike transporti; u përgatit prospekti i infrastrukturës turistike në brendësi të shpellës: rugicat, dritat, mjediset e ariut e njeriut të shpellave (Fig.4,5,6,7,8,9,10,11,12,13).



Foto 6,7,8 Impulse zhvillimi të turizmit dhe pikë sinjalistike informuese për turistët në Pëllumbas.




Fig.4,5 Pritja e vizitorëve dhe muzeu speleologjik



Fig.6,7 Variante të rrugës për në shpellë




Fig.8,9,10 Duke shijuar bukuritë e shpellës dhe para ariut të shpellave e njeriut neolitik



Fig 11,12,13. Variante, përballë njeriut neolitik, Odeoni dhe kafe pas vizitës.

Por donatorët dhe financuesit e projektit, pa asnjë arsye, ndërprejnë mbështetjen e këtij projekti pionier për zhvillimin e turizmit të aventurës së shpellave e atij malor, të ekoturizmit etj. Kemi bindjen se institucionet e mjedisit e turizmit, donatorët vendës e të huaj, do ta mbështesin këtë projekt madhor për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në korridorin Tiranë-Pëllumbas-Shëngjergj-Mali me Gropa.

### **III. 3.2 Menazhimi i MN me vlera shpirtërore (Rrapet në qendrat e banuara, objekte të shenjta fetare)**

Midis disa MN e kategorive të tjera të ZM dhe popullsisë së QB, prej kohësh, janë vendosur lidhje të forta shpirtërore. Ja disa shembuj konkretë:

- *Rrapet në qendrën e qytetit ose të fshatit*, apo Guri i Qytetit në Përmet etj., duke shërbyer si pikënisje e rritjes së qendrës së banuar dhe vend takimesh e kuvendesh me rëndësi vendore, madje edhe kombëtare, janë kthyer në simbol për banorët. Vlerat e tyre u janë përcjellë brezave, duke u bërë pjesë e botës shpirtërore dhe e lidhjeve të forta me VB. Ndaj, të gjithë tregojnë për to kujdes të posaçëm. Përreth rrapit ka një infrastrukturë të thjeshtë si: vende për t'u ulur, çezma, lule, tabela për njoftime etj. Për këto lidhje të forta shpirtërore flet edhe rasti i Zhulatit, ku skulptori, bir i fshatit, në trungun e rrapit të tharë (MN), gdhendi bustin e legjislatorit popullor Idriz Sulli, që, tani ngrihet në vend të rrapit shekullor (*Qiriazi, 2020*).

- Me formën e tyre të çuditshme, shumë nga MN kanë tërhequr vëmendjen e njeriut, i cili u ka veshur atyre fuqi të mbinatyrshme, duke i kthyer në objekte për rite fetare, si: shpella e Sarisalltëkut dhe Shpella për Mirë (në Krujë), Shpella e Mirë (Tiranë) dhe Gjurma e Abaz Aliut në buzë të kanionit të Osunit e në Kulmak për besimtarët bektashinj; shpella e Llangës në Mokër për besimtarët ortodoksë; shpella e Shën Andout (Laç) dhe Guri i

Shenjtë (Pukë) për besimtarët katolikë etj. Pranë disa MN kryhen rite pagane që vijnë nga lashtësia e njerëzimit. Dallohen burimet e kripura të Golemasit në bashkinë e Kavajës, pranë të cilave vajzat dhe nusët e reja parashikojnë realizimin e dëshirave të tyre, sipas forcës së shpërthimit të “papazëve”, siç i quajnë vendësit këto burime (*Qiriazi, Sala 2006*).

Këto vlera shpirtërore, lidhja e tyre me legjenda, rite fetare e pagane dhe me ngjarje historike, duhet të studiohen e thellohen në të ardhmen, sepse kështu njihet e ruhet më mirë historia dhe bota jonë e pasur shpirtërore, rrënjohet më tej identiteti ynë kombëtar, traditat tona, ndërsa MN bëhen më interesante për t’u vizituar (*Qiriazi, Sala, 2006; Qiriazi, 2019, 2020*). Nisur nga kjo, theksojmë se strategjitë dhe planet e zhvillimit territorial, të rikualifikimit të QB dhe zhvillimit të tyre, planet e menazhimit të ZM, të integruara dhe të koordinuara midis tyre, gjithmonë duhet të ruajnë MN dhe, duke respektuar vlerat shpirtërore të tyre, të aplikojnë projekte që i mbrojnë dhe i ekspozojnë këto vlera për edukimin e brezave dhe për turizëm.

#### **IV. Diskutim**

Dy mendime dhe qëndrime të kundërta mbi raportin midis siteve të mbrojtura dhe qendrave të banuara:

- Kufizimet në shfrytëzimin e resurseve natyrore në ZM dhe afër tyre frenojnë zhvillimin, pakësojnë mjetet e jetesës së popullsisë dhe ulin mirëqenien e saj.

- ZM ofrojnë mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm socioekonomik dhe për rritjen e cilësisë të jetës në QB, afër, apo në brendësi të tyre.

Mendimi i dytë është i drejtë, racional dhe përcaktues në ndërtimin e zbatimin e strategjive dhe programeve zhvillimore vendore, rajonale e kombëtare në harmoni me natyrën e ZM e më gjerë.

Debati mbi politikat për ZM dhe VB duhet të mbështetet në: bashkëpunimin ndërdisiplinor (shkencat natyrore, sociale, ekonomike, rajonale etj., të përfshira pak nga planifikimi urban-territorial); në aplikimin e metodave të reja për të zgjidhur çështjet mjedisore e territoriale (mbrojtja e tokës, menaxhimi i ujit dhe i ndotjes, kursimi i energjisë, rritja e diversitetit e cilësisë së territorit); për të zgjidhur dilema të marrëdhënieve midis interesave vendore e globale, midis vlerave natyrore e kulturore, të drejtës së pronës dhe të drejtës mjedisore etj.

## V. Përfundime

Mbi 1/5 e territorit të vendit tonë është shpallur trashëgimi natyrore (2022), që kërkon trajtim, menazhim e mbrojtje ndryshe nga pjesa tjetër e vendit; marrëdhënie e raporte miqësore e bashkëpunuese me popullsinë e QB në apo në afërsi të siteve të saj. Edhe te ne duhet të aplikohet koncepti se ZM nuk janë pengesë, por mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm socioekonomik dhe për rritjen e cilësisë së jetës në QB.

Shkretirizimi demografik dhe plakja e popullsisë si pasojë e migrimit masiv në krahinat tona malore e kodrinore, sollën humbjen e kapitalit njerëzor, i domosdoshëm për zhvillimin e tyre; braktisjen e resurseve të mëdha natyrore; humbjen e trashëgimisë së pasur kulturore e traditave të këtyre krahinave. Ndaj është urgjente, veç të tjerave, gjetja e rrugëve të vlerësimit e shfrytëzimit të kapitalit të pasur natyror dhe të TN të larmishme, e shprehur në numrin e shtrirjen më të madhe të ZM. Me potencialet e kapitalit natyror, njerëzor e kulturor, ZM mundësojnë sektorë të rinj punësimi, figura të reja profesionale, ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm endogjen ekonomik të rajoneve të varfra. Kjo motivon rikthimin e të larguarve, ripopullimin e krahinave të braktisura.



Vitalizimi dhe zhvillimi i krahinave të braktisura dhe i qendrave të tyre të banuara kërkon menazhim shkencor ekologjik të kapitalit natyror e njerëzor të ZM, të integruar me politikat, strategjitë dhe programet e planifikimit dhe zhvillimit urban e socioekonomik territorial rajonal e kombëtar, mundëson kthimin e pasurive natyrore të ZM në alternativa të reja për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme socioekonomike të territorit; ristrukturon dhe ndryshon funksionet e QB; përmirëson cilësinë e jetës së komuniteteve vendore dhe i bën ato modele të harmonisë midis natyrës dhe zhvillimit socioekonomik; mbron dhe rivlerëson trashëgiminë kulturore; ruan dhe forcon identitetin; ndihmon integrimin e vendit në BE.

Menazhimi shkencor turistik i Shpellës së Zezë si muze gjeologo-gjeografik, paleontologjik e arkeologjik; i MN e objekteve të tjera natyrore, si dhe i trashëgimisë së pasur kulturore të QB të integruar me strategjitë dhe programet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në korridorin Pëllumbas – Shëngjergj, i dalluar për varfëri të madhe, do ta kthente këtë korridor në një park të madh të rekreacionit turistik për rajonin qendror të vendit, tepër të populluar dhe do t'i jepte zhvillim gjithë pjesës juglindore të bashkisë së Tiranës.

### **Literatura**

Arné, M. Approaching a state-shift in Earth's biosphere, *Natyr* 3/2012.

*Brasili, C., (2012), Gli indicatori per la misura del capitale territoriale, Regioss - Cycles & Trend, Bologna.*

Caprotti, F., (2020) Smart to green: smart eco-cities in the green economy. Chapter in: Willis, K. S. and A. Aurigi, eds. *The Routledge Companion to Smart Cities* London, Routledge.

Cfr. CNR Almanacco della Scienza n. 16 e 17 ottobre 2012

Christophe, M.,19.06.2012. L'extension anarchique des villes est une véritable menace écologique pour l'humanité, [notre-planete.info](http://notre-planete.info),

Convention pour la protection du patrimoine mondial, culturel et naturel de l'UNESCO, 1972.

D'Alessio, F. Manente, etj. (2014), Le aree protette: vincolo o opportunità? Indagine empirica nelle regioni Ob. CONV sul ruolo del capitale umano nello sviluppo territorial. ISFOL, i Libri del Fondo Sociale Europeo,

Doka, Dh., Qiriazzi, P., 2021, Geography of Albania, Springer.

Donati, F., Messori, L., e al (2011), Valutazione economica del capitale naturale. Aree protette e sviluppo sostenibile, Un piano per la conservazione della Biodiversità e lo sviluppo dell'economia locale nel Delta Del Po. Università IUAV di Venezia.

Fabbri, I., (1995), Relazione sull'esplorazione della Grotta Nera.

Ferro, D., Ponte, G., (2014), Reti ecologiche e pianificazione ambientale. Aree protette e sviluppo sostenibile ....

LA VENTA Esplorazioni Geografiche. The Black Cave - EcoTouristic Route – Museum, Pëllumbas, 2016

Ligji nr. 81, dt 4.05.2017 "Për Zonat e Mbrojtura"

Lika, R., (2020), Së bashku të dëgjojmë zërin e Lagunës së Nartës, INCA

Messina, G., (2016), Identità e luoghi: il caso Di Menfi

Muça, S., (2015), Raport mbi eksplorimin arkeologjik të Shpellës së Zezë,

Qiriazzi, P., (2019), Gjeografia fizike e Shqipërisë, MediaPrint.

Qiriazzi, P., (2020) Trashëgimia natyrore e Shqipërisë, Ribotim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Qiriazzi, P., Sala, S., (2006), Monumentet e natyrës së Shqipërisë

Qiriazzi, P., Sala, S., (2015), Parashtresë "Projekti Kompleksi Turistik "Pëllumbas – Shpella e Zezë–Murdhar".

Quaglia, T., Montanari, I., & al. (2011), Aree protette e sviluppo sostenibile, Un piano per la cnservazione della Biodiversità e lo sviluppo dell'economia locale nel Delta Del Po. Università IUAV di Venezia.

Sala., S., Qiriazzi, P., Nikolli, P., (2021), Trashëgimia natyrore dhe peizazhet tërheqëse të bashkisë së Tiranës.

Sargolini, M., (2004), Scritti sulla pianificazione delle aree protette, Trento, Temi Editrice.

Tetide APS- Marina di Camerota. Speleomedit Mediteranean Speleology, 2021

VKM nr.303, dt.10.05.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës.

VKM nr.60, datë 26.1.2022.

VKM Për shpalljen "Park Natyror" të ekosistemit natyror "Lugina e lumit Vjosa".

Zanovello, P., Pirredda, S., & e al. Valorizzazione del patrimonio rurale e sviluppo sostenibile dei territori dei Colli

Euganei e della Bassa Padovana (2007), Universita di Padova & al.

<https://www.nps.gov/yell/index.htm> <https://whc.unesco.org/fr/list/>

**Prof. dr. Dhimitër Doka<sup>1</sup>**

## **VENDBANIMET E BRAKTISURA SI REZULTAT I PABARAZIVE TË THEKSUARA RAJONALE PAS VITIT 1990**

### **Abstrakt**

Transformimi i Shqipërisë pas vitit 1990 ka qenë i shumanshëm duke përfshirë jo vetëm politikën, por edhe gjithë ndryshimet në zhvillimet demografike, ekonomike, sociale etj. Të gjitha këto ndryshime janë shprehur jo vetëm në gjendjen e përgjithshme të vendit, por edhe midis zonave dhe rajoneve të ndryshme. Dhe, në këtë kuadër, tendenca e përgjithshme ka qenë thellimi i madh i pabarazive në zhvillimet rajonale e lokale midis zonave të ndryshme të vendit. Kjo tendencë ka shoqëruar gjithë këto tri dekadat e fundit dhe ajo pritet të vazhdojë edhe më tej në vitet që do pasojnë, duke çuar kështu jo në zbutjen e këtyre pabarazive, por përkundrazi në thellimin e mëtejshëm të tyre. Në këto kushte, është urgjente përgatitja dhe realizimi i koncepteve të reja për zhvillimin rajonal dhe lokal (*Doka, 2015*).

Në këtë kontekst të rritjes së këtyre pabarazive rajonale dhe lokale në Shqipëri, më shumë e kanë pësuar ato që sot cilësohen zonat dhe vendbanimet e braktisura. Këto gjenden veçanërisht në rajone periferike, në të cilat u krijuan gjatë periudhë së komunizmit të ashtuquajturit “Qytete të Reja”. Për shkak të një funksioni të vetëm të tyre si qytete kryesisht minerare dhe industriale, ato pas vitit 1990 do të përballeshin me dilemën e mbijetesës dhe prandaj edhe do të braktiseshin në masë prej popullsisë së mëparshme.

Por jo vetëm këto qytete. Edhe popullsia e shumë vendbanimeve rurale të zonave periferike të vendit do të gjenin si shpëtim të vetëm pas vitit 1990 largimin prej tyre dhe përfshirjen në emigracionin e jashtëm apo migrimin e brendshëm. Ato që mbeten pas gjithë këtyre largimeve janë hapësirat e braktisura dhe të harruara (*McKay, 2019*).

Pyetjet që shtrohen në këtë situatë janë të shumta, si:

- Në çfarë mase është shkalla e braktisjes dhe sa është potenciali human i mbetur akoma?

---

<sup>1</sup> *Universiteti i Tiranës E-mail: dhdoka@yahoo.com*

- Çfarë potencialesh ofrojnë këto vendbanime dhe zonat përreth për një zhvillim të mundshëm në të ardhmen?

- Cilat mund të jenë rrugët dhe mënyra e shpëtimit të tyre?

**Fjalë çelës:** *Hapësirat e braktisura, qytete me një funksion, emigrim masiv, mbijetesë.*

### **Abstract**

Socio-economic transformation as a result of the change of the political system in the early 1990s and its impact on regional developments in Albania have become a very important object of scientific treatment in the last three decades.

The result of large and rapid demographic, economic and social changes is, among other things, the deepening of inequalities in regional and local developments between different areas of the country. Such a situation has accompanied all these recent years and the tendency is more towards further deepening of these inequalities than mitigating these inequalities. In these conditions, it is urgent to prepare and implement new concepts for regional and local development.

In this context of increasing regional disparities in Albania, the reference in question is devoted to the so-called "abandoned settlements". These are found especially in peripheral regions, in which the so-called "New Cities" were created during the communist period. Due to their monofunctional as mainly mining and industrial cities, they after 1990 would face the dilemma of their survival and therefore would be abandoned en masse by the diseased population.

But not just these cities. Even many populations of rural settlements in the suburbs of the country would find as the only salvation after 1990 their departure and involvement in external emigration or internal migration. What remains behind all these departures are abandoned and forgotten spaces.

The questions posed in this situation are numerous, such as:

- To what extent is the abandonment rate and how much human potential is still left?
- What potentials do these settlements and surrounding areas offer for a possible future development?
- What can be their ways and means of salvation?

It is around these issues and questions that the reference in question is oriented.

**Keyword:** *abandoned spaces, cities with a function, mass emigration, survival.*

## **I. Metoda**

Metodologjia e punës në realizimin e këtij artikulli u bazua fillimisht në krijimin e një baze të dhënash përkatëse me informacion statistikor nga INSTAT-i dhe autoritetet rajonale dhe vendore. Paralelisht me këtë u realizuan ekspedita dhe intervista në terren në disa nga qendrat më të braktisura të pjesës veriore të

Shqipërisë. Mbi këtë bazë u kalua në përpunimin e rezultateve të punës empirike dhe në analizën e gjendjes së tyre në dy periudha: para 1990 dhe pas këtij viti e deri më sot, faktorëve që kanë ndikuar, problematikat aktuale dhe mundësitë për mbijetesë e zhvillim në të ardhmen. I gjithë ky material shërbeu fillimisht si bazë për referimin e konferencës së organizuar në Universitetin e Elbasanit më 17.12.2021 dhe tashmë për artikullin përkatës. Ndërkohë që ky studim do të thellohet edhe më tej në kuadër të bashkëpunimit me kolegë gjermanë dhe mbështetur nga Fondacioni i Humboldt – Gjermani.

## **II. Ecuria e zhvillimeve rajonale e lokale në Shqipëri pas vitit 1990 dhe pasojat e tyre**

Zhvillimet rajonale dhe lokale në Shqipëri dhe efektet me të cilat ato janë shoqëruar përbën njërën nga temat më të rëndësishme studimore, debatuese dhe mediatike këto tri dekadat e fundit. Kjo, sepse këto zhvillime janë pasqyrë e shumë ndryshimeve që kanë përfshirë vendin në shumë aspekte. Kështu, me to lidhen si shumë trajtesa teorike e kuptimore rreth procesit të rajonizimit të vendit, organizimit administrativ dhe funksionimit të tij, rregullimit dhe menazhimit të territorit, ashtu edhe shumë ndryshime të shpejta dhe shpesh të paparashikueshme demografike, ekonomike, sociale etj (*Göler, Doka, 2014*).

Në këto kushte, studimet rajonale dhe lokale, veçanërisht në kushtet e Shqipërisë, janë një domosdoshmëri e madhe. Nga njëra anë, zhvillimet e reja dhe shpeshherë kaotike në 30 vitet e fundit kërkojnë koncepte të përshtatshme zhvillimi rajonal dhe lokal që marrin në mënyrë konkrete parasysh kontekstin individual për të qenë të qëndrueshme. Nga ana tjetër, përpunimi i koncepteve të tilla dhe marrja e masave për zhvillimin rajonal dhe lokal është një nga kushtet për integrimin e vendit në BE (*Doka, 2005*).

Faktori kryesor i të gjitha ndryshimeve socio-ekonomike dhe

rajonale pas vitit 1990 është mbi të gjitha migrimi në tërësi dhe ai i brendshëm në veçanti. Kjo sepse migrimi nuk konsiderohet më sot thjesht si një lëvizje e popullsisë nga vendbanimi A në atë B, por si një faktor me shumë konsekuenca. Aq më tepër në kushtet e Shqipërisë së pas viteve 1990, kur ky migrim do të ndodhte shumë i shpejt, masiv dhe kaotik. Në një kuptim të ngushtë ai argumentohet si nevojë individuale e njerëzve për një jetë më të mirë, por në një kuptim më të gjerë duhet parë si një nevojë e plotësimit të difiziteve strukturore që paraqesin hapësira të ndryshme të vendit. Prandaj edhe migrimi i brendshëm shfaqet në Shqipëri me dimensione të mëdha hapësinore (*Göler, Doka, 2015*).

Rezultati më kryesor i gjithë kësaj lëvizjeje migruese në Shqipëri është nga njëra anë largimi masiv i popullsisë nga ato rajone ku mungojnë konceptet dhe masat për të ngadalësuar eksodin e demografik dhe nga ana tjetër ardhjet e shumta, të shpejta dhe shpesh kaotike në rajone me infrastrukturë më të mirë, por edhe me situatë të vështirë në tregun e banimit dhe punës, probleme me pronësinë, dëmtime të rënda mjedisore etj. Mjafton të përmendim faktin se më shumë se 2/3 e popullsisë së sotme që ndodhet në Shqipëri ka ndërruar të paktën me një herë vendbanimin në krahasim me regjistrimin e vitit 1989 për të gjykuar rreth përmasave të këtij fenomeni (*INSTAT 2020*).

Tendenca e këtij migrimi ka qenë pothuaj një e vetme, largimi nga rajonet dhe zonat periferike drejt pjesës qendrore dhe perëndimore të vendi, e veçanërisht atij që cilësohet rajoni i kryeqytetit (Tiranë-Durrës-Fushë-Krujë).



Fig. 1. Drejtimet e migrimit të brendshëm në Shqipëri  
*Burimi: Ideart, Gjeografia 9. Tiranë 2019*

Kjo ka bërë që vendbanime të vogla urbane e shumë rurale të braktisen e rrënohen, ndërsa rajoni i kryeqytetit, e veçanërisht Tirana, të mbipopullohet.

Një fluks kaq i madh migrimi, aq më tepër në një kohë shumë të shkurtër dhe në kushtet e një vendi të papërgatitur për një fenomen të tillë, kuptohet që do të shoqërohej me një sërë pasojash të karakterit demografik, ekonomik, sociale dhe hapësinore. Dhe,



një nga pasojat më të mëdha dhe problematike të këtij procesi ka të bëjë me krijimin e pabarazive të theksuara midis rajoneve dhe zonave të ndryshme të vendit (*Doka, 2005*).

Arsyet e këtyre pabarazive të theksuara dhe efektet që po i shoqërojnë ato në zhvillimet rajonale dhe lokale në Shqipëri duhen kërkuar në shumë drejtime, ndër të cilat theksojmë:

1. Në kushtet e ndryshme natyrore midis rajoneve dhe pjesëve të vendit. Ndonëse një vend i vogël, në Shqipëri vërehen dallime të theksuara midis zonave të ndryshme për sa u përket kushteve të relievit, klimës, sipërfaqes së tokës bujqësore etj. Këto kushte të ndryshme natyrore përbëjnë pikërisht premisën e parë për krijimin e pabarazive në zhvillimet rajonale dhe lokale.

2. Problemet e shumta infrastrukturore dhe në përgjithësi gjendja e vështirë ekonomike, veçanërisht në zonat malore, e bënë të pamundur zbutjen e pabarazive që krijojnë kushtet natyrore në zhvillimet rajonale dhe lokale. Përkundrazi, kjo gjendje i thellon akoma më tej këto pabarazi.

3. Ekzistenca e këtyre dallimeve e pabarazive është e trashëguar nga periudha të ndryshme. Kështu edhe gjatë periudhës së komunizmit (1945-1990), me gjithë politikën ekonomike të asaj kohe për një zhvillim të njëtrajtshëm të vendit dhe subvencionin që u jepej nga shteti zonave e rajoneve më pak të zhvilluara, nuk u arrit që të mënjanohen pabarazitë e midis rajoneve të ndryshme të vendit.

4. Me lejimin e lëvizjes së lirë të njerëzve pas vitit 1990, promotori i gjithë këtyre pabarazive të theksuara në zhvillimet rajonale dhe lokale në Shqipëri është migrimi në tërësi dhe ai i brendshëm në veçanti.

### III. Situata e braktisjes në qytetet e vogla industriale – rast studimi Veriu i Shqipërisë

Historia e vendbanimeve urbane në Shqipëri është shumë e hershme dhe gjurmët e qyteteve që nga ato ilire dhe të antikitetit, tek ato mesjetare e deri të kohës moderne gjenden në zona të ndryshme të vendit. Megjithatë, për arsye të faktorëve të ndryshëm historikë, ekonomikë dhe socialë është më e lehtë të flasësh sot për model të banesës shqiptare, si p.sh. tipi kullë në veri të vendit, shtëpi elbasanase në pjesën qendrore, apo shtëpi vilë e jugut të Shqipërisë, por e vështirë për të folur për tipin apo llojin e qytetit shqiptar. Pamjen e tyre qytetet e sotme kryesore shqiptare do ta merrnin kryesisht duke filluar nga shekulli i 18-të e në vazhdim (Voskopoja, Korça, Shkodra, Elbasani, Tirana etj). (*Alain, 2020*).

Edhe në periudhat që vazhduan, shek. i 19-të dhe i 20-të, këto qytete mbeten relativisht të vogla pasi në Shqipëri nuk ndodhi ndonjë proces i madh urbanizimi dhe krijimi i qendrave metropole, siç ndodhi, qoftë edhe në rajonin tonë të Ballkanit me kryeqendra të tilla urbane si Beogradi, Bukureshti apo Sofja (*Bickert, Göler 2021*).

Përrjashtim nga ky rregull do të bënte në një masë të caktuar qyteti i Tiranës pas shpalljes së tij kryeqytet dhe veçanërisht me ndikimin italian të viteve '30 dhe '40 të shekullit të 20-të, ku për herë të parë do kishte plane të qarta të zhvillimit urban dhe rritjes së qytetit.

Periudha e komunizmit do të shoqërohej me ndryshime të shumta të pamjes urbane të Shqipërisë dhe kjo, si në prishjen e shumë strukturave të mëparshme arkitektonike dhe zëvendësimin e tyre me elementet e qytetit socialist, ashtu edhe në krijimin e shumë qendrave të reja qytetare.

Tabela si më poshtë na pasqyron ecurinë e krijimeve të vendbanimeve urbane në Shqipëri.

Tab.1: Ecuria e marrjes së statusit të qytetit në Shqipëri

Kishin statusin e qytetit deri 1918 15 qytete	Deri 1925 shtohen 8 qytete	Marrin statusin e qytetit 1950 - 1960	Qytete të reja 1961 - 1970	Qytete të reja 1971 - 1989
Durrës Berat Korçë Gjirokastrë Shkodër Elbasan Vlorë Tiranë Fier Lushnjë Përmet Lezhë Pogradec Kavajë Krujë	Bilisht Delvinë Peqin Tepelenë Leskovik Shijak Kukës Peshkopi	Kuçovë (1951) B. Curri (1955) Burrel (1955) Cërrik (1955) Patos (1955) Memaliaj (1955) Sarandë (1957) Bulqizë (1958) Çorovodë (1958) Ersekë (1958) Krrabë (1958) Maliq (1958) Pukë (1958) Rrogozhinë (1958) Selenicë (1958) Ulzë (1958) Gramsh (1960) Librazhd (1960)	Rrëshen (1961) Shëngjin (1961) Fushë-Arrës (1962) Kurbnesh (1962) Përrenjas (1962) U. Vajgurore (1962) Rubik (1962) Këlcyrë (1963) Orikum (1963) Laç (1965) F. Krujë (1967) Poliçan (1967) Konispol (1968) Libohovë (1968) Himarë (1969) Milot (1969) Roskovec (1969) Vorë (1970) Ballsh (1970) Reps (1970)	Klos (1971) Mamurras (1972) Krumë (1972) Belsh (1979) Kraštë (1979) Fierzë (1982) Koplik (1984) Kamzë (1989)  <b>Pas vitit 1990 :</b>  Bajzë (1992) Kam (1992) Sukth i Ri (1992) Vau Dejës (1992) Divjakë (1995)

Burimi: INSTAT, A. Bërçholi, Alain

Nga të dhënat e tabelës duket qartë që deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria numëronte vetëm 23 vendbanime që kishin statusin e qytetit. Ndërkohë që numri i tyre u rrit dukshëm gjatë periudhës 1945-1990 me plot 46 vendbanime që morën statusin e qytetit, 23 prej të cilëve nuk ekzistonin fare më parë si qendra të banuara (Sjöberg, 1991). Pas vitit 1990 shtohen edhe 5 qytete të reja, duke e çuar sot në 74 numrin total të tyre.

Shpërndarja gjeografike e qyteteve në Shqipëri, sipas madhësisë dhe periudhës së krijimit, deri në vitin 1990 jepet në hartën si më poshtë.



Nga paraqitja në hartë duket qartë përqendrimi më i madh i vendbanimeve urbane në pjesën qendrore dhe perëndimore, por edhe krijimi i shumë qyteteve të reja, në pothuaj gjithë pjesët e vendit.

Një numër i konsiderueshëm i tyre u themeluan në zona të largëta e të thella malore të Veriut të Shqipërisë, të vështira për t'u aksesuar dhe kryesisht larg fshatrave ekzistuese. Shumë prej tyre morën statusin administrativ të një qyteti, kryesisht për shkak të strukturës së tyre të punësimit në industri. Në të njëjtën kohë, ato mezi përmbushnin kërkesat funksionale përkatëse, si ofrimi i një game të gjerë shërbimesh dhe mallrash, si qendër furnizimi për një zonë të zgjeruar përreth etj. Bëhej fjalë për vendbanime njëfunksionale me numër të paktë banorësh që varionin nga disa qindra në disa mijëra dhe infrastruktura të kufizuara urbane. Ato përdorëshin pothuajse ekskluzivisht për nxjerrjen dhe ndonjëherë edhe për përpunimin e burimeve minerale (*Bickert, Göler 2021*).

Gjithashtu, popullsia e këtyre qendrave të reja urbane ishte në masë të konsiderueshme jo e zonës ku ndodheshin, por e dërguar në to nga zona dhe rajone të tjera të vendit prej shtetit totalitar të asaj kohe. Bëhej fjalë jo vetëm për punëtorë, por edhe për inxhinierë, mësues, mjekë etj.

*Burimi: Alain Nicolas JARNE, Géohistoire de l'Albanie moderne. Une lecture des recensements de 1918 à 2011. Leusanne 2020*

Pas transformimeve politike dhe ekonomike që ndodhën në Shqipëri pas vitit 1990, ndryshoi tërësisht edhe situata e këtyre qendrave të vogla urbane. Mbyllja në to e aktivitetit të mëparshëm industrial, dalja pa punë e një numri të madh punonjësish, kushtet e vështira natyrore dhe infrastrukturore të jetesës, dërgimi i detyruar i banorëve nga zona të tjera të vendit dhe ekzistenca e një numri shumë më tepër të njerëzve në krahasim me mundësitë e mbajtjes, duke mos lejuar lëvizjen e lirë të tyre, do të ishin faktorët

kryesorë që do të stimulonin largimin në masë të popullsisë nga këto qytete. Ky proces ka vazhduar pa ndërprerje deri në ditët e sotme, duke çuar në zvogëlimin e pothuaj zhdukjen totale të vendbanimeve të tilla (Göler, Doka, 2020).

Kështu, nga ekspeditat dhe anketimet që u zhvilluan në muajt nëntor 2021- janar 2022 në disa prej ish-qendrave industriale të Veriut të Shqipërisë (Reps, Fushë-Arrës, Kalimash, Krumë, Kam, Fierzë dhe Bajram Curri) rezultoi se në to ka mbetur shumë pak popullsi, e cila ndryshon nga vetëm rreth 300 banorë në Reps, në rreth 3000 banorë Fushë-Arrësi dhe Kruma dhe rreth 8000 banorë qyteti i Bajram Currit. Ndërkohë që disa ish-qendra të tjera urbane janë drejt braktisjes totale. Rasti më ekstrem është ai i ish-qytezës Kam ku në fund të nëntorit 2021 numëroheshin vetëm 28 banorë, Fierza me vetëm 18 familje dhe rreth 60 banorë, apo miniera e Kalimashit ku nuk ka më asnjë banor.

Nga anketimet e kryera me banorët e paktë të mbetur në këto qyteza rezulton që shumica janë të prirë që të largohen prej tyre në rastin më të parë që t'u jepet. Arsyet për këtë janë kushtet e vështira të jetesës, mundësitë e pakta të punësimit, mungesat e infrastrukturës, shërbimit të dobët shëndetësor, niveli i ulët arsimor, largimi i fëmijëve etj.

Ky fenomen largimi në masë i popullsisë ka përfshirë gjithnjë e më shumë jo vetëm qytezat e rajonit, por edhe popullsinë e fshatrave. Kështu që jo vetëm që janë braktisur shumë fshatra, por prej tyre nuk ka më popullsi që të kompensonte në një masë të caktuar popullsinë e qyteteve, tendencë që ishte prezente në vitet '90 (Göler et al. 2005).

Si destinacione kryesore largimi shikojnë Tiranën dhe Durrësin brenda vendit, si dhe shtete të Europës Perëndimore (Angli, Gjermani, Francë, Belgjikë etj.) jashtë vendit.

Edhe pse shumica e banorëve nuk dëshirojnë që pas largimit t'i shesin banesat apo pasuritë e tjera që kanë, pothuaj asnjëri nuk

parashikon rikthim në vendbanimin apo zonën e tyre, përveç vizitave apo pushimeve.

Një tendencë e tillë largimi edhe të asaj pak popullsie të mbetur në këto zona do të thotë rrënim dhe humbje e mëtejshme e tyre. Ajo që mbetet pas janë banesa dhe vendbanime të braktisura dhe rrënuara, mbyllje institucionesh arsimore dhe shëndetësore, largim investimesh, degradim i territorit etj. Pamjet e mëposhtme janë ilustrim i gjendjes aktuale.



*Reps*



*Kam*



*Fierzë*



*Fushë-Arrës*

(Foto nga Dh. Doka, nëntor 2021)

#### **IV. Mbijetesja dhe e ardhmja**

Gjendja e vështirë aktuale dhe me tendencë përkeqësimi të mëtejshëm në qytezat ish-qendra industriale të Veriut të Shqipërisë, kërkon në radhë të parë mbështetjen për mbijetesë të tyre dhe rikthim të shpresës.

Një gjë e tillë duhet të fillojë me studimin konkret të tyre për rivlerësimin e potencialeve dhe mundësive zhvillimore, qofshin këto natyrore, ekonomike, humane dhe kulturore. Mbi këtë bazë të kalohet në propozime konkrete rreth një orientimi të ri ekonomik të tyre dhe me efekte mundësisht të shpejta në punësim dhe përmirësim jetese. Si alternativa të tilla mund të ishin ekoturizmi dhe turizmi familjar, produktet dhe ushqimet bio, shfrytëzimi i ujërave dhe pyjeve, pasurive nëntokësore në bazë të kërkesave të tregut, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore etj.

Realizimi i këtyre mundësive zhvillimore kërkon mbështetjen financiare me subvencione nga shteti dhe donatorë të ndryshëm vendës e të huaj, nëpërmjet të cilave duhet synuar si në përmirësimin e infrastrukturës bazë të jetesës në këto zona, ashtu edhe në mbështetjen e ideve konkrete zhvillimore. Kjo para së gjithash do të krijonte besimin te njerëzit, që edhe në këto zona jetohet dhe se ato mund të kenë të ardhme.

Ndonëse në një situatë të vështirë prej vitesh e shoqëruar me rrënim dhe braktisje, qendra dhe zona të tilla kanë shanse dhe mundësi shpëtimi dhe rigjallërimi. Pikërisht gërshetimi i potencialeve të shumta natyrore me të veçantat historike e kulturore të tyre, si dhe me trashëgiminë në formën e mbetjeve të komunizmit të ngulitura dhe akoma të pranishme në to, mund t'i bëjë këto zona atraktive jo vetëm për investitorë dhe programe të ndryshme, por edhe në aspektin turistik. Kjo bazohet në interesin e turistëve të ndryshëm europianë për të njohur trashëgiminë komuniste në ish-vendet e bllokut Lindor, ku Shqipëria përbën një rast ekstrem. Mbi këtë bazë do ishin me interes itinerare të ndryshme turistike në zona të tilla, në të cilat mund të kombinohet shumë mirë peizazhi i bukur natyror me jetën e veçantë në male dhe trashëgiminë arkitekturore të mbetjeve nga periudha e komunizmit. Për këtë nevojiten fillimisht përmirësime infrastrukturore të këtyre zonave nëpërmjet lidhjeve rrugore,



mundësive të akomodimit dhe ushqimit, trajnimin e personave të nevojshëm etj.

Ndërkohë që për një zhvillim më afatgjatë dhe të qëndrueshëm të këtyre zonave është i nevojshëm hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit rajonal dhe lokal, mirëmenazhimi i resurseve në funksion të prioriteteve zhvillimore, realizimi i programeve të zhvillimit human për të mbajtur në rajon popullsinë e nevojshme në numër dhe cilësi si potencial i domosdoshëm human për zhvillimin e mëtejshëm etj....

### **Literatura**

Bërxfholi, A., (2000), Regjistrimet e përgjithshme të popullsisë në Shqipëri. Tiranë

Bickert, M. & Göler: (2021), Albaniens kommunistische Neustädte. Eine Betrachtung aus raum- und kulturwissenschaftlicher Perspektive. In: Ludwig, Andreas (Hrsg.): Neue Städte: vom Projekt der Moderne zur Authentisierung. Göttingen: Wallstein-Verlag, S. 55-70.

Doka, Dh., (2005), Zhvillime rajonale dhe lokale në Shqipëri – shembuj të përzgjedhur. Potsdam

Doka, Dh., (2015), Gjeografia e Shqipërisë (Popullsia dhe Ekonomia) Tiranë

Göler, D. with Contributions by Becker, H., Bërxfholi, A., Doka, Dh., Draçi, B., Friemer, M., & Standl, H., (2005), European Shrinking Regions: Applied Regional Geography in Peripheral Areas (with Case Studies from Albania and Germany). (= Geographical Studies 16). Tirana. [zugleich: Hapësirat evropiane që braktisen: Studim gjeografik rajonal i zbatuar në hapësirat periferike (shembuj studimi nga Shqipëria dhe Gjermania). (= Studime Gjeografike 16)]. Tirana.

Göler, D., Doka, Dh., (2014), "Should I stay or should I go?" Out-migration, return-migration and development in Albania – The migration-development-nexus at a dangerous crossroads. In: Pichler, Robert (edt.): Legacy and Change. Albanian transformation. Austri

Göler, D., Doka, Dh., (2020), Busting the Scales: From Small-Scale Informal to Investor-Driven Urban Developments. The Case of

Tirana/Albania In: Mitteilungen der Österreichischen Geographischen Gesellschaft, 162. Jg.: S. 65–90. Vjenë

Göler, D., Doka, Dh.: (2015), ReEMigration in Albanien – Von der Emigration zur Remigration und vice versa? In: Südosteuropa-Mitteilungen 55, H. 1, S. 22-31. Mynih

INSTAT: Manuale të popullsisë së Shqipërisë 2019, 2020.

Jarne, Alain Nicolas: (2020), Géohistoire de l'Albanie moderne. Une lecture des recensements de 1918 à 2011. Leusanne

McKay, L., (2019), Left behind' people, or places? The role of local economies in perceived community representation. Electoral Studies 60 102046.

Qiriazhi, P., Doka, Dh., (2019), Gjeografia 9- Tekst Shkollor. Shtëpia Botuese Ideart, Tiranë

Sjöberg, S., (1991), Urban Albania: developments 1965-1987. Stockholm

**Prof. dr. Bilal Draci**<sup>1</sup>  
**Doc. dr. Gentian Ruspi**<sup>2</sup>

## **SISTEMI DHE HIERARKIA URBANE NË SHQIPËRI - PËRPPJEKJE PËR KLASIFIKIM**

### **Abstrakt**

Lindja dhe zhvillimi i vendbanimeve e në veçanti i qyteteve ka qenë i pabarabartë në kohë e hapësirë. Por me zhvillimin e infrastrukturës u rrit ndërlidhja, ndërvarja dhe ndërveprimi sidomos midis qyteteve, duke krijuar sisteme urbane. Në këto sisteme, qytetet në varësi me madhësinë e popullsisë urbane, funksionet, kompleksitetin e specifikave urbane, pozicionimin në sistem si dhe hapësirat e mbulimit të tyre me shërbime e veprimtari, zhvillohen e funksionojnë në nivele të ndryshme hierarkie urbane duke mbuluar territorin me funksione urbane.

Këto studime e kanë bazën në disa teori, ku më e rëndësishmja është teoria e vendeve qendrore me aplikim studimesh në gjeografinë urbane.

Mbi këto koncepte, teori dhe metodologji studimore bazohet ky studim, si përpjekje për qëllime praktike klasifikimi. Rëndësia qëndron edhe në aspektet e zhvillimit racional e të qëndrueshëm urban, si dhe rajonizimin shkencor gjeografik.

*Fjalë çelës: sistem urban; hierarki urbane; hapësira e influencës urbane; klasifikim urban; teori e vendit qendror.*

### **Abstract**

The birth and development of settlements, especially cities, has been unequal in time and space. But with the development of infrastructure, interconnection, interdependence

---

<sup>1</sup> *Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, E-mail: bilal\_draci@yahoo.it*

<sup>2</sup> *Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën. Fakulteti i Studimeve Profesionale Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, E-mail: gengjeo@yahoo.com*

and interaction increased, especially between cities, creating urban systems. In these systems, cities depending on the size of the urban population, functions, complexity and urban specifics, positioning in the system as well as their coverage areas with services and activities, are developed and function at different levels of urban hierarchy covering the territory with urban functions.

These studies are based on several theories, where the most important is the theory of central countries with the application of studies in urban geography.

Our study has also referred to these concepts, theories and study methodologies as an attempt at practical classification purposes. The importance of study lies in aspects of rational and sustainable urban development in the territory as well as scientific geographical regionalization.

*Keywords:* urban system; urban hierarchy; space of urban influence; urban classification; central place theory.

## I.Hyrje

Gjeografët urbanë studiojnë dallimet dhe ndërvarësitë hapësinore: brenda qyteteve, përmes zonimeve funksionale urbane; midis qyteteve; qyteteve e rrethinave të tyre, qofshin rurale, në ndërlidhje funksionale të krijuara nga sistemi urban, të cilat vijnë duke u rritur edhe nga zhvillimet revolucionare në transport dhe komunikacion. Ky sistem urban është pjesë e sistemit botëror të zhvillimit, i cili mendohet se i ka fillimet që në kohën e zbulimeve të mëdha gjeografike, pra të zbulimit të territoreve të reja nga europianët. Disa i lidhin me perandoritë. Kjo gjë bëri të mundur që qytetet europiane të rriteshin në saje të importimit të lëndëve të para dhe më vonë edhe eksportimit të produkteve industriale. Kështu u krijua sistemi i marrëdhënieve të varësisë, ndërvarësisë, bashkëpunimit dhe shfrytëzimit që çoi në pushtimet koloniale dhe e organizoi botën në mënyrë të diferencuar në rajone të zhvilluara, në zhvillim dhe të prapambetura. Qyteti dhe urbanizimi ishin pikënisja dhe baza e procesit të zhvillimit në sistem urban, falë kjo edhe tipologjive e specifikave lokale e rajonale. Në fillim qytetet dhe hapësirat rrethuese funksionale rurale u zhvilluan si komplementare me njëra-tjetrën dhe më vonë u zhvilluan në nivele/madhësi të

ndryshme popullsie e pasurie, të cilat u bënë baza e sistemit dhe hierarkisë urbane lokale, rajonale e sot globale, përmes qyteteve botërore (*Herbert T. David & Colin J. Thomas. (1982)*). Sistemet urbane të pjesës më të madhe të rajoneve shfaqin një strukturë të qartë hierarkike. Kjo vjen dhe nga një trashëgimi e kaluar paraindustriale, kur qytetet kishin funksione kryesisht si qendra tregu për hapësirat rrethuese bujqësore. Sot gjithashtu disa rajone si të tilla ekzistojnë edhe në Shqipëri, funksionet e pjesës më të madhe të qyteteve ende dominohen nga tregjet dhe pazaret lokale. Gjeografët sot, gjejnë disa elemente dhe hapësira ku ekzistojnë sisteme dhe hierarki të vendosjeve urbane qendrore, me një shkallë rregullsie/ligjësie të lidhur me përmasat dhe hapësirat funksionale të tyre. (*Knox, 1999. f. 99.*)

## II. Metoda

Referuar teorive dhe koncepteve të fushës së gjeografisë urbane mbi sistemet dhe hierarkitë urbane, kemi tentuar një konkretizim përafres mbi disa tipare të zhvillimeve urbanizuese në Shqipëri, nga aspekti i sistemit dhe hierarkisë urbane shqiptare. Metodologjia e sistemeve dhe hierarkizimit të qendrave urbane bazohet te teoria e vendeve qendrore (*Christaller, 1930*), ku çdo qytet i vogël (town) ose/dhe qyteti i madh (city), deri metropol etj., është pjesë e një prej sistemeve bashkëvepruese urbane që lidhet në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në një rrjet kompleks ndërvarësie dhe hierarkie. Këto sisteme urbane organizojnë hapësirën territoriale përmes hierarkive të qyteteve në marrëdhënie të drejtë me funksionet dhe përmasat e tyre. Pra, sa më e madhe të jetë popullsia dhe funksionet urbane si dhe hapësira e mbulimit territorial, aq më qendror (autori i quante funksione të vendosjes qendrore urbane) është vendi i tij për nga rëndësia dhe hapësira e mbulimit. Të tjerat (qytetet), vijnë të

nënvendosura, në varësi të zvogëlimit të madhësisë së popullsisë e funksioneve.

Pra, në koncept, sistemi urban përbën një lidhje të ndërvarur funksionale të vendbanimeve urbane (dhe rurale) brenda një rajoni, të cilat organizojnë hapësirat përmes hierarkisë së qyteteve, primare, sekondare, terciare etj. Ndërsa hierarkia urbane konsiderohet si rruga më efektive për të njohur se si janë të organizuara sistemet urbane, pra një renditje e qyteteve bazuar në përmasën e tyre dhe kompleksitetin funksional. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se hierarkia është si piramida ku qytetet më të mëdha dhe funksionalisht komplekse janë në majë, ndërsa ato më të vogla e më të thjeshta për nga funksionet vendosen më poshtë piramidës. Përherë, ka më shumë qytete të vogla se të mëdha, prandaj baza e piramidës është më e gjerë (*Fjalori terminologjik i Gjeografisë Humane dhe Urbane, 1994*). Ndarja gjeografike lokale e rajonale e punës do të thotë që disa qytete të përmasave mesatare tregojnë funksionim ekonomik më të specializuar dhe kështu fitojnë disa karaktere të dallueshme. Hierarkia urbane si mënyrë vendosjeje në sistem, që ndikohet në përpjesëtim të drejtë nga përmasa dhe funksionet, përfshin gjeografikisht dhe zonën e influencës urbane që përbën hapësirat e ndërveprimit jashtë qytetit, që ndikohen e afektohen nga ai qytet. Cilido qoftë pozicioni në hierarkinë urbane, qendrore, sekondare, terciare etj., çdo qytet ushtron një influencë në hapësirën e vet rrethuese. Referuar literaturës së fushës, përgjithësisht, një qytet i vogël mund të influencojë në një rajon lokal në një hapësirë prej më shumë se 1000 km<sup>2</sup>, p.sh. në shpërndarje shtypi. Përtej kësaj hapësire, një qytet tjetër mund të ketë një dominancë influence. Një qytet i madh me deri 100 km distancë nga një qytet i vogël mund ta influencojë këtë të fundit përmes shërbimeve më të avancuara terciare. Koncepte të tjera si qytet primat (si një raport mbi 2, krahasimi, përmasë urbane dhe mbulim me funksione ndaj qytetit të dytë e në vazhdim); dhe

qendërzim urban (pozicionim hapësinor, dominancë në hapësira të vogla, të popullsisë dhe funksioneve) etj., janë disa nga termat kyçë të analizës dhe vlerësimeve (Knox, P., Marston S., 1998).

Në aplikimin e kësaj problematike të re studimore, përveç koncepteve teorike të referuara, ne jemi bazuar edhe në disa studime shqiptare urbanistike, statistika dhe përditësime zhvillimore etj.

### III. Problematika dhe diskutime

Analizat dhe vlerësimet nga literatura teorike janë përgjithësuese dhe kanë nevojë për specifikime e konkretizime me zhvillimet gjeohistorike të secilit vend.

Tipologjia e sistemit dhe hierarkisë urbane tentojnë për analiza me tregues e të dhëna: të standardizuara; gjithëpërfshirëse; funksione komplekse për zonat urbane dhe rurale përreth; grupime hierarkike. Shpesh problematika qëndron te:

- konceptimet dhe përkufizimet e ndryshme p.sh., qytet/fshat; rural/urban; funksione urbane e rurale; ndarje administrative territoriale etj.

- metodologjia, metodat dhe përlllogaritja e tyre, pesha specifike e funksioneve etj., (matrica dhe përlllogaritja dinamike e të dhënave; funksionet dhe hapësirat/mbulimi i tyre në ndryshim kohor e hapësinor etj.

- dinamikat kohore e hapësinore të zhvillimeve urbane e rurale, sidomos për vende si Shqipëria.

- mungesa e saktësisë; qëndrueshmërisë; standardizimit, të treguesve klasifikues shumë të diskutueshëm, sidomos ndarja qendër urbane sekondare, terciare, e nivelit të katërt, të cilat do të trajtohen si më poshtë.

- gjithashtu, ka disa qendra të vogla e të mesme urbane, por me sipërfaqe të madhe administrative (si Librazhdi, Peshkopi, Divjaka, Gramshi etj.), që u shërbejnë një zone mjaft të gjerë rurale

dhe për këtë arsye mund të kenë burime të mira për funksione të ndryshme, shumë herë më të larta sesa numri i popullsisë rezidente të tyre.

- ashtu si ka dhe qendra të vogla urbane, me disa funksione tipike specifike ose të zhvilluara “monostrukturore” nga punësimi vajtje-ardhje nga disa qytete ose komuna me qëllime punësimi...(dikur Ballshi, Orikumi, Fushë Kruja; etj.), të cilat janë disi raste shmangieje nga ligjësitë ose kriteret për klasifikime.

### **Analiza dhe vlerësime – tipologji sistemi hierarkie urbane në Shqipëri.**

#### **Hierarkia brenda sistemit urban shqiptar - kriteret për klasifikim**

Përveç literaturës bazë teorike dhe problematikave të diskutuara më lart, në klasifikimin e hierarkisë në sistemin urban shqiptar, ne kemi marrë parasysh dhe disa specifika të zhvillimeve tona urbane. Në këtë mënyrë, si kriteret e klasifikimit janë konsideruar:

- popullsia, përmes madhësisë së saj; dendësisë; shpërndarjes; specifikave demografike etj. përbën kriter të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë klasifikues dhe indirekt edhe për funksionet, morfologjinë urbane, zonën e influencës etj. Për Shqipërinë, më shprehëse është për Tiranën, në veçanti me ndryshim mbi pesëfish ndaj kategorive të tjera urbane, si dhe te qendrat urbane primare (*Draçi B., Çaro D., Nikolli, P., 2014*) me mbi dyfish popullsi ndaj qendrave sekondare, terciare etj., te të cilat madhësia e popullsisë ka më pak peshë specifike për klasifikim (shih më poshtë tipologjia e klasifikimit).

- Funksionet, si madhësia, kompleksiteti i funksioneve urbane (bazike dhe jobazike) ose/dhe funksionet specifike (si trashëgimia historike me role të rëndësishme, si qendra historike me rëndësi kombëtare deri ndërkombëtare; ose porta hyrje-daljeje



ndërkombëtare), për Shqipërinë mbeten baza e klasifikimeve me peshë më të madhe specifike. Matja dhe vlerësimi i tyre, megjithëse kompleks, është i mundshëm statistikisht edhe si vlerësim për klasifikim.

- Hapësira e mbulimit funksional urban; infrastruktura si shërbim dhe aksesibilitet urban si dhe pozicioni në sistemin, qendror, ndërmjetës, periferik etj., (p.sh., infrastruktura me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare; akset/korridore rrugore; korridore gazsjellësish; porte; aeroporte; roli si “qytete – porta” në kuptimin e mundësisë së mbulimit sa më të gjerë), megjithëse në matricë janë të vështira për t’u matur e vlerësuar, por janë të rëndësishme për këtë klasifikim.

- Roli i prirjeve perspektive të zhvillimeve urbane, lokale e rajonale (*Fuga, A., 2011*), përmes integritit të resurseve ekonomike me rëndësi kombëtare e rajonale dhe në tërësi perspektiva e zhvillimit ekonomik e shoqëror, si në rastin e Sarandës dhe Kukësit, p.sh. referuar strategjisë kombëtare të zhvillimit të Shqipërisë janë të rëndësishme për klasifikim dhe kanë po rol të konsiderueshëm, megjithëse edhe këta tregues kanë vështirësi për t’u matur e vlerësuar. Po në këtë aspekt, (*MZHU, 2014, f.60-71*) në vlerësimin perspektiv urban 20-30-vjeçar te funksionet urbane mund të shtohen: dinamizimi i qyteteve si intensifikim i marrëdhënieve njerëz – mallra - teknologji; atraktiviteti dhe roli tërheqës i tyre si rivlerësim i tipareve unike dhe investim në asetet natyrore e urbane për zhvillim, pra roli i turizmit dhe cilësisë së jetës urbane; konkurrenca në zhvillimin e qyteteve dhe sektorëve karakteristikë/bazikë me perspektivë zhvillimore.


## **Rezultate empirike**

### **Klasifikimi dhe tipologjia e klasifikimit hierarkik**

Bazuar në ndarjen ligjore administrative-territoriale (2014), sistemi i qendrave urbane/vendbanime në territorin shqiptar

përbëhet nga 61 bashki; 73 qytete; 2994 fshatra, pra gjithsej 3067 vendbanime. Analiza dhe vlerësimet nga kriteret e mësipërme e bëjnë sistemin urban shqiptar të klasifikohet sipas kësaj hierarkie:

Metropoli (1 - Tirana); Qendra primare urbane (12); Qendra sekondare urbane (9); Qendra terciare urbane (39); Qendra lokale (373); Lokalitete (2994).



Burim: punuar nga autori

## 1 - Tirana- metropol

(referuar literaturës dhe kriterëve, mund të konsiderohet dhe si qytet primar, por, me të drejtë, cilësimi metropol i ka lënë vend për nënrenditje qyteteve të tjera si primare, kryesisht qyteteve qendra qarku).

Tirana ka tipologji, shprehje dhe diferencime të qarta urbane si për nga:

- *madhësia e popullsisë*, me mbi 850 000 banorë, zona metropolitane 932.110 banorë (*Instat, 2014*), dendësi e shtrirje më të madhe popullsie e vendbanimi;

- me *funksi*one të dallueshme madhore, komplekse, kombëtare, rajonal-ballkanike, si kryeqytet, me funksione politiko-administrative përfaqësuese e vendimmarrëse dhe monitoruese; me zonë funksionale përreth, të përbëra nga disa aglomeracione urbane të ndërlidhura me njëra-tjetrën, me infrastrukturë transporti/pendolare për në punë dhe e lidhur me të gjitha qendrat e tjera urbane; me madhësi e specializim ekonomik me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare, qendër ekonomike, shkencore, kulturore, arsimore, sportive, tregtare, turistike, zhvillim të ekonomive konkurruese; me funksionet me karakter simbolik historik kombëtar,

- *hapësira e mbulimit funksional urban e zhvillimor* me rëndësi qendrore jo vetëm për territorin kombëtar, rajonal e më gjerë, ku në metropol garantohen dhe zhvillohen më tej funksionet e qendrave primare urbane, përtej përqendrimit të funksioneve metropolitane,

- si dhe *disa specifika* të tjera të pozicionimit qendror në sistem etj.

## **2. Qendra primare urbane - qendrat e qarqeve**

Qendrat primare urbane mund të konsiderohen qytetet: Shkodër, Lezhë, Kukës, Peshkopi, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, si dhe në perspektivë Saranda (si përjashtim për shkak të funksionit të veçantë turistik, rolit si qytete - “porta” për hyrje – daljet ndërkombëtare, numrit të popullsisë në rritje nga trendet pozitive të zhvillimit, infrastruktura aeroportuale, me aeroportin e propozuar në Vrion etj.

- numri i popullsisë së qyteteve, me mbi 30.000 banorë (me pak përjashtime është mbi dyfish i qyteteve të rangut të dytë) dhe

dendësia për qendrat e bashkive, mbi 10.000 banorë/km<sup>2</sup> (Instat, 2014).

- funksionet për nga madhësia, kompleksiteti, specificiteti etj., përqendrohen tek ato me rëndësi primare të kujdesit, të shërbimit të përgjithshëm e të specializuar: funksione administrativo-politike; ekonomike kryesisht të sektorit të dytë e të tretë; të tregtisë me shumicë dhe pakicë; të nyjave të rëndësishme të qarkullimit; me rëndësi e shtrirje rajonale arsimore, shëndetësore, të përkujdesjes sociale, shkencore, të rendit publik, kulturore dhe të rekreacionit; të qendrave të banimit (saldo/bilanc i qëndrueshëm ose pozitiv); me disa specifika dhe përmbajtje të vlerave të trashëgimisë historike, kulturore, arkeologjike, deri në UNESCO, me rëndësi ndërkombëtare.

- hapësira e mbulimit fokusohet te qarqet, bashkitë si dhe në kuadër sistemi, pjesërisht edhe në të gjithë territorin kombëtar.

- nga aspekti specifik dhe perspektiv këto qytete kanë disa tipare të qendrave primare urbane dhe rol si qytete-porta, me rëndësi kombëtare, hyrje dhe dalje të vendit me rajonin, me infrastrukturë ndërlidhëse e shërbime me rëndësi kombëtare e rajonale.

P.s. jo të gjitha qytetet e vlerësuara si qendra primare urbane i plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme. Por shihen edhe në dinamikë si plotësimi i kriterëve në perspektivë, realizimi i disa investimeve në projekte strategjike etj.

### **3. Qendra sekondare urbane – qendrat bashkiake**

Janë qendra urbane të cilat ndonëse jo në nivelin hierarkik të qendrave primare, janë mjaft të rëndësishme pasi identifikohen edhe me disa funksione të specializuara, domethënëse për lokalitetet dhe rajonin ku ndodhen si Pogradeci, Lushnja, Kuçova, Përmeti, Bajram Curri, Bulqiza, Kruja, Kavaja, Librazhdi.

- popullsia si madhësi ndryshon, ajo është e vogël kryesisht nën 20 000 banorë dhe nuk është shprehëse si kriter bazë klasifikues. (*Instat, 2014*)

- si kriter bazë përfshihen disa funksione dhe tipare të specifikuara të zhvillimit ekonomik: si drejtimet unike të ekonomisë, bujqësi, minerare, logjistikë, industri ushqimore, resurse natyre, turizëm etj. Në qendrat sekondare urbane ka sektorë/funksione ndërlidhëse/ndërmjetëse të kujdesit parësor bashkiak deri me rëndësi rajonale; administrative-politike; ekonomike; të tregtisë me pakicë; arsimore, kulturore, shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale, rekreacionit, të shërbimeve bazë, por edhe të specializuara të nivelit të lartë, si p.sh. institute kërkimore në fusha specifike (si Instituti Kërkimor Bujqësor, Lushnjë..); të rrjeteve/nyjave të rëndësishme të transportit bashkiak e më gjerë, të vendbanimeve me tipare të qendrave karakteristike të qendrës urbane.

- hapësira e zonave të mbulimit ndodhet në distancë kohore deri/rreth 30 minuta nga qendra më e afërt primare. Në bashkëpunim me qendrën primare urbane ato përbëjnë bazën për zhvillimin e zonave funksionale ekonomike.

#### **4. Qendra terciare urbane - bashki**

Qendrat terciare urbane (39) janë qendrat e bashkive sipas reformës së re administrative territoriale (2014). Shih më sipër profilin skematik.

Ato kanë popullsi më të vogël, nën 10 mijë banorë. (*Instat, 2014*). Përcaktimi i tyre është i rëndësishëm për sa i përket mbulimit me funksione të disa shërbimeve bazë, arsimore, shëndetësore, rendit, shërbimeve shoqërore, të nivelit të tretë, me funksione: administrative; ekonomike, tregtisë me pakicë; arsimore- shkolla të mesme, shkolla profesionale (primare e sekondare); shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale (primare e më pak sekondare);

kulturore dhe të rekreacionit; funksione të vendbanimeve (por me problematika të qëndrueshmërisë nga largimet). Ndërsa zona e mbulimit fokusohet kryesisht te territori i bashkive dhe njësisve administrative.

### **5. Qendra lokale - njësitë administrative (ish-komunat - 373)**

Si qendra lokale vlerësohen qendrat e banuara me karakter rural dhe suburban, ku popullsia e tyre është shumë e ndryshme dhe pa ndonjë rol klasifikues, tani për tani. Si bazë klasifikimi e rendi hierarkie është vlerësuar aspekti funksional: administrativ, i zvogëluar në kompetenca, të cilat përputhen me qendrat e komunave të mëparshme; si dhe ekonomike, sektori i parë kryesisht dhe më pak të shprehura sektori i dytë dhe tretë. Mbulimi hapësinor fokusohet kryesisht te njësia administrative.

### **6. Fshatrat - qendra të vogla të banuara me karakter rural. (2994)**

Fshatrat, si pjesë integrale territoriale e njësisve administrative dhe bashkive, përbëjnë njësinë më të vogël të organizimit territorial (me status ligjor), ku popullsia ndryshon shumë dhe si e tillë, në këtë rast, nuk mund të ketë rol klasifikues. Funksionet kufizohen te vendbanimi; ekonomia bujqësore si dhe disa aktivitete të sektorit të parë, të dytë dhe të tretë.

### **Rëndësia e klasifikimit sipas hierarkisë urbane**

Vlerësime të tilla sipas hierarkisë në sistemin urban shqiptar kanë vlerë pasi:

- vendoset dhe kuptohet një farë rregullsie territoriale, mbulimi me funksione (sipas një ligjësie, teorike dhe praktike): qendrat urbane të shkallëve më të larta në hierarki, përmbushin gjithashtu edhe funksionet e qendrave urbane të shkallëve më të ulëta, më shumë e me kompleksitet më të madh.

- mbi këtë bazë përcaktimi është i rëndësishëm edhe për sa i përket mbulimit hierarkik me funksione të shërbimeve: “të larta”; “të mesme”; “bazike”; komplekse; speciale si strukturë shërbimesh, duke organizuar dhe territorin.

- vendosja e kategorizimit hierarkik përbën elementë të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe territorial, duke përqendruar dhe diferencuar sasinë dhe tipin e projekteve sektoriale sipas karakteristikave dhe veçorive të tyre.

- sigurohet dhe zhvillohet një rrjet i qëndrueshëm i diferencuar i infrastrukturës teknike dhe sociale, si përgjigje ndaj kërkesave të niveleve zhvillimore hierarkike.

- përbën gjithashtu një bazë për kuptime të drejta të zhvillimeve të diferencuara urbanizuese e zhvilluese, lokale e rajonale.

- kjo analizë mund të shërbejë si element dhe instrument reformimi administrativo-territorial.

### **Rezultate empirike e diskutime**

Qytetet shqiptare po zhvillohen në një sistem urban funksional, të organizuar në hierarki urbane, në modele e prirje të njohura të zhvillimeve urbane: falë zhvillimeve infrastrukurore; distancave të vogla (rreth 30 km); aksesibilitetit dhe ndërveprimit më të lartë urban, sidomos në metropol dhe qytetet primare.

Hierarkia urbane është e shprehur/bazuar në:

faktorë historikë; zhvillimet e diferencuara/të pabarabarta hapësinore; resurset zhvilluese; pozicionimet gjeografike dhe vendosjet në sistemin urban; perspektivat e zhvillimit...

- Shprehja më e qartë hierarkike varet më shumë nga: funksionet; popullsia; (Tirana dhe qendrat primare urbane me shkallë diferencimi më të lartë); resurset e zhvillimit dhe aspekte perspektive.

- Hierarkia e shprehur urbane (sidomos Tirana dhe qendrat primare urbane me shkallë diferencimi më të lartë) ka thelluar pabarazinë e zhvillimeve rajonale.

- Megjithatë, në këto zhvillime territoriale, falë dhe infrastrukturës, sistemi mbulon në mënyrë të qëndrueshme e komplekse me shërbime urbane (NJ-M-I) gjithë territorin e më gjerë.

- Këto zhvillime urbane të pabarabarta kërkojnë studime, reformime administrative dhe ndërhyrje ekuilibruese, për të mos mbingarkuar sistemin.

## Literatura

*Christaller, Central place theory, 1930.*

Draçi B., Çaro D., Nikolli, P., (2014). Center - Periphery Urban Territorial Dynamics: The Case of Durrës Municipality - Albania. *The Mediterranean Journal of Social Sciences*, Vol. 5, No. 6. Romë. Italy.

Fellman, Getis, Getis. (1990). *Human Geography – landscapes of human activities. Central place theory.* Wv. C. Brown publishers, USA

Fjalor terminologjik i Gjeografisë Humane dhe Urbane (1994)

Fuga, A., (2011). "The Fall of the the City". Tirana 2010 and today's crisis is a crisis of urban centers, and not the suburbs.

Herbert T. David & Colin J. Thomas. (1982). *Urban geography. A first approach.* London, New York. USA

Institute of Statistics. INSTAT, (2014). Albania.

Knox, P., Marston S. *Human Geography.* (1998). pp.424-439, *Central Place Theory.*

Knox, P., *Urbanization.* (1999). Pp.99. *Central Place Theory*

Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU). *Plani i përgjithshëm kombëtar, Shqipëria (2015- 2030).* (2014). Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT). Dokumenti i parë kombëtar për planifikimin e territorit (f.60-71)



**Prof. asoc. dr. Merita Koka Karaguni<sup>1</sup>**  
**Prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri<sup>2</sup>**

## ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM URBAN NË SHQIPËRI- REALITET APO PRIRJE?

### Abstrakt

Zhvillimi i qëndrueshëm është prej kohësh kryefjala e zhvillimeve globale, veçanërisht në realitetin e sotëm kur cenimi i tij po bëhet gjithnjë e më shumë sa shqetësues, aq edhe i prekshëm për komunitete të veçanta e për mbarë shoqërinë. Zhvillimet urbane, nëpërmjet aspekteve të ndryshme që lidhen si me mënyrën se si funksionojnë e zhvillohen vendbanimet urbane, ashtu edhe me procesin e urbanizimit, ushtrojnë ndikimin e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm në tërësi. Parimet e gjithëpranuara të zhvillimit të qëndrueshëm urban si në nivele studimore, ashtu edhe vendimmarrjeje, mund dhe duhet të respektohen nëpërmjet konceptimit të vizioneve, strategjive e politikave të zhvillimit duke e çuar zhvillimin e qëndrueshëm urban përtej thjesht një aspirate. Natyrisht që mund të gjykohet në kontekste konkrete gjeohapësinore në mënyrë analitike e vlerësuese, në lidhje me shkallën e respektimit të këtyre parimeve, por, që politikat të jenë që në konceptim sa më efikase, nevojiten gjithashtu edhe tregues konkretë të sintetizuar që përfaqësojnë me gjuhën e të dhënave aspektet më të rëndësishme të realiteteve urbane në kontekste të ndryshme zhvillimore, hapësinore dhe kohore. Kështu, analiza e zhvillimit të qëndrueshëm urban i shërben më mirë evidentimit dhe vlerësimit si të realiteteve, ashtu dhe prirjeve të zhvillimit.

*Fjalë çelës: Zhvillim i qëndrueshëm urban, parime, tipare, tregues, politika*

### Abstract

Sustainable development has long been at the forefront of global developments, especially in today's reality when its vulnerability is becoming more and more troubling

---

<sup>1</sup>Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë/Universiteti i Tiranës,  
E-mail: mkkaraguni@fhf.edu.al

<sup>2</sup>Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë/Universiteti i Tiranës,  
E-mail: jostina.dhimitri@unitir.edu.al

as well as tangible for particular communities and for the whole society. Urban developments, through various aspects related to both the way urban settlements function and develop and the process of urbanization, exert their influence on sustainable development as a whole. The universally accepted principles of sustainable urban development, both at the academic and decision-making levels, can and should be respected through the conception of visions, strategies and development policies leading sustainable urban development beyond a mere aspiration. It can be judged of course in terms of concrete geospatial contexts in an analytical and evaluative way, regarding the degree of taking into consideration the observance of these principles, but in order to the policies to be conceived as efficiently as possible, concrete synthesized indicators that represent the most important aspects of urban realities in different developmental, spatial and temporal contexts, are needed. Thus, the analysis of sustainable urban development better serves to identify and assess both realities and development trends.

*Keywords: Sustainable urban development, principles, features, indicators, policies*

## I. Hyrje

Duke gjykuar mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm urban<sup>1</sup>, realiteti urban në Shqipëri është karakterizuar vazhdimisht nga problematika për sa u takon zhvillimeve në vendbanimet apo zonat urbane, ashtu edhe midis tyre (Karaguni, 2009). Pabarazia e zhvillimit në tërësi dhe atij urban në veçanti reflektohet dhe reflekton çështje ekonomike, gjeopopullative apo edhe të zhvillimeve në territor, ende të pazgjidhura. Ecuria e këtyre zhvillimeve ushtron ndikimin e vet në mjedis duke shkaktuar dëme shpesh të pariparueshme. Pavarësisht vëmendjes së shtuar që kanë marrë zhvillimet urbane në Shqipëri vitet e fundit, problematika ende mbetet dhe bën apel për ndërhyrje të mëtejshme të mirëmenduara për zhvillim të qëndrueshëm urban. Matja e këtij zhvillimi përbën një bazë të mirë vendimmarrjeje. Qytete, shtete apo rajone të ndryshme në botë kanë bërë përpjekjet e tyre për të matur shkallën e ndikimit të zhvillimeve urbane në mjedis. Prej kohësh janë matur dhe përllogaritur tregues dhe indekse të ndryshme zhvillimi në nivel rajonesh, shtetesh madje edhe qytetesh. Tashmë ekziston edhe një rrjet treguesish të

---

<sup>1</sup> Shënim: i referohemi në vazhdim si ZHQU

konceptuar për të reflektuar situatën në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm urban edhe në rang global. Numri i konsiderueshëm i treguesve dhe indekseve, edhe pse të ndryshme në kohë dhe hapësirë, dëshmon ndërgjegjësimin e vendimmarrësve mbi nevojën emergjente për ndërhyrje nëpërmjet politikave të zhvillimit bazuar në tregues që të sintetizuar në indekse, mund të flasim edhe më shumë. Është koha që edhe në Shqipëri të konceptohet një rrjet lokal treguesish, në përputhje me specifikën e zhvillimeve urbane në vend dhe gjithashtu i krahasueshëm krahas nivelit global edhe me rajone të tjera, sipas ngjashmërisë së problematikës ose marrëdhënieve funksionale apo të synuara që Shqipëria ka. Nëpërmjet këtij rrjeti, dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm urban bëhen të prekshme dhe të vlefshme duke u vënë në shërbim të vendimmarrjes.

## II. Metoda

Shqyrtimi i bibliografisë me synimin për të evidentuar parime, komponentë dhe tregues të thjeshtë apo sintezues/agregatë të ZHQU-së, është përdorur në funksion të evidentimit të situatës reale mbi bazën e të dhënave ekzistuese që reflekton ndikimin e zhvillimeve urbane në problematikën mjedisore në Shqipëri. Kjo ka mundësuar gjykimin mbi aspektet pozitive dhe mangësitë në sfidën për realizimin e objektivave të *Agjendës 2030* dhe veçanërisht Objektivit të 11-të. Qasja krahasuese dhe vlerësuese e botimeve dhe dokumenteve të rëndësishme ndaj realiteteve sa të ngjashme, aq edhe të ndryshme në lidhje me matjen e ZHQU-së në Shqipëri, ka mundësuar disa sugjerime që mund të vihen në shërbim të një prirjeje më të konsoliduar për zhvillim të qëndrueshëm urban.

### III. Rezultate dhe diskutime

#### • Domosdoshmëria e vëmendjes ndaj zhvillimit të qëndrueshëm urban

Qytetet vlerësohen veçanërisht si qendra të inovacionit duke qenë njëkohësisht qendra të ideve, të tregtisë, të kulturës, të shkencës, të prodhimit e të zhvillimit social dhe ekonomik, duke bërë që roli ekonomik i tyre të jetë i një rëndësie të veçantë, pasi ato sigurojnë 80% të Produktit të Brendshëm Bruto në nivel global (*UNDP, 2021/b*). Nga ana tjetër, në optikën e ndikimit në mjedis, në shëndet, në ndryshimet klimatike dhe në atë të ekzistencës së jetës në Tokë, qytetet konsiderohen si problematike. Planifikimi urban, sistemet e transportit, të ujit, të pastrimit, menazhimi i mbetjeve, reduktimi i risqeve natyrore, aksesit ndaj informacionit, arsimimi dhe zhvillimi i kapaciteteve etj., janë të gjitha çështje që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm urban (*UN, 2021/a*). Ky ndikim theksohet gjithnjë e më shumë si rrjedhojë rritjes së shkallës së urbanizimit dhe rritjes së numrit të qyteteve të përmasave shumë të mëdha, veçanërisht atyre me mbi 10 000 000 banorë. Sipas *UNDP (2021/b)*, 55% (4.2 miliardë) e popullsisë së botës jetonte në qytete në vitin 2018 dhe kjo shifër pritet që në vitin 2050 të arrijë në 6.4 miliardë banorë. Edhe pse qytetet në rang global zënë vetëm 3% të sipërfaqes së rruzullit, ato konsumojnë 60-80% të energjisë dhe konsiderohen përgjegjëse për 70% të emetimit të karbonit. Ndërkaq, popullsia në zonat e banimit me status shumë të ulët social-ekonomik (*UNDP, 2021/b*), të njohura në literaturën ndërkombëtare si “slums”, “bidonville” etj., rritet gjithnjë e më shumë, për shkak të shtimit në vendet në zhvillim të numrit të qyteteve me mbi 10 000 000 banorë. Këto zona banimi konsiderohen si mjaft problematike në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm urban në veçanti dhe atë në tërësi. Parashihet që në vitin 2050, 9 nga 10 qytetet me mbi 10 000 000 banorë do t’u përkasin vendeve në zhvillim. Edhe në Shqipëri ka referenca

zyrtare në lidhje me këto zona banimi të nivelit të ulët (*INSTAT, 2022*), pavarësisht shkallës së shprehjes së tyre në qasje krahasuese me fenomenin në rang rajonal apo global dhe nevojës për saktësim e përshtatje të terminologjisë.

Këto zhvillime përbëjnë arsye madhore për të tërhequr vëmendjen e politikëbërjes drejt zhvillimit të qëndrueshëm urban. Që vendimmarrja të jetë e suksesshme, duhet të bazohet në tregues e indekse konkrete, që evidentojnë me gjuhën e shifrave problematikën dhe që mundësojnë edhe qasje krahasuese në kohë e hapësirë.

#### • **Dimensione, parime dhe tregues të zhvillimit të qëndrueshëm urban (ZHQU)**

Si qasje teorike, ashtu edhe ajo konkrete (në terma treguesish apo indeksesh) ndaj zhvillimit të qëndrueshëm urban, evidentojnë faktin se ai ka disa dimensione, komponentë apo aspekte që janë tradicionalisht ato ekonomike, mjedisore dhe shoqërore. Ka studime që krahas këtyre aspekteve evidentojnë apo veçojnë edhe aspektin institucional (*Michalina, et.al, 2021*) apo atë politik dhe demografik (*Knox & McCarthy, 2005*). Këto aspekte reflektohen në vizionet e zhvillimit urban në formë parimesh e politikash urbane. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm urban janë konceptuar e rikonceptuar në kohëra në përputhje me zhvillimet urbane dhe me problematikat që kanë nxjerrë krye herë pas here. Kjo, pasi gjetja e balancës midis mirëqenies ekonomike, sociale e mjedisore përbën kurdoherë një sfidë të vështirë.

Në pikëpamje të analizës territoriale, me zhvillimin e qëndrueshëm në tërësi dhe atë urban në veçanti lidhet respektimi i parimeve të tilla si: parimi gjeografik i barazisë territoriale në shpërndarjen e vendbanimeve dhe zonave urbane; parimi ekonomik i përforcimit të potencialit të brendshëm; parimi ekologjik i ruajtjes së ekosistemit; parimi sociologjik për barazi

sociale si dhe parimi politik i autonomisë territoriale (*Cunha & Racine, 2000*). Thelbi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm urban mbetet i njëjtë dhe reflekton dimensionet e sipërpërmendura, edhe pse ato mund të detajohen apo organizohen dhe sistemohen ndryshe. Kështu p.sh. gjatë periudhës 2006-2015, flitet për gjashtë parime të zhvillimit të qëndrueshëm urban që përcaktohen si: integriteti në marrëdhënien njeri-mjedis; mirëqenia njerëzore; barazia në dhe midis brezave; mirëmbajtja dhe efienca e resurseve; qeverisja demokratike; parandalimi dhe përshtatja (*Luederitz & Beatrice, 2015*).

Shkalla e respektimit të këtyre parimeve dhe situata në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm urban, mund të reflektojë realitetin konkret në rang lokal, shtetëror, rajonal apo global, vetëm nëse ekzistojnë tregues specifikë për gjithçka nënkupton secili prej tyre. Në fakt, shtimi i vëmendjes dhe përpjekjet e para për të shkuar drejt përlogaritjes së indekseve të zhvillimit të qëndrueshëm urban, i përkasin vitit 1992 dhe pasqyrohen në Agjendën 2021, seksioni IV/40. Kjo Agjendë e ka fillesën te Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila ndër të tjera në fillim të shekullit XXI, afirmonte nevojën e mbajtjes së një Konference të OKB-së mbi mjedisin dhe zhvillimin, ku do të konceptoheshin dhe shtjelloheshin strategjitë dhe masat për të ndalur dhe korrigjuar efektet e degradimit mjedisor nëpërmjet përpjekjeve në nivel kombëtar e ndërkombëtar (*UN, 2021/b*). Kjo konferencë u mbajt në Rio de Zhaneiro nga 3 deri 14 qershor 1992 (*UN, 2021/b*).

Në këtë frymë, shumë vende apo rajone kanë konceptuar tregues dhe indekse të zhvillimit të qëndrueshëm urban. Studime të ndryshme evidentojnë ekzistencën e një sërë treguesish apo indeksesh të tilla qoftë në nivel lokal, shtetëror, rajonal apo edhe në nivel global, të konceptuar pikërisht për të matur zhvillimin e qëndrueshëm urban referuar dimensioneve apo komponentëve që mbulon koncepti sipas qasjeve teorike (*Michalina, et.al 2021*)

Indekset dhe treguesit ku ata bazohen kanë ndryshuar kohë pas kohe, duke reflektuar zhvillimet urbane, por edhe specifikat e zhvillimeve globale, rajonale apo lokale.

### • **Objektivat Globalë të Zhvillimit të Qëndrueshëm<sup>1</sup> dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban**

Prej vitit 2015, vërehet një vëmendje e shtuar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, në kuadër të implementimit të Agjendës 2030 ku janë konceptuar OGZHQ-të. Në kuadër të këtyre objektivave bën pjesë edhe zhvillimi i qëndrueshëm urban, i reflektuar në Objektivin e 11-të “Qytete dhe komunitete të qëndrueshme” që synon shndërrimin/transformimin e qyteteve dhe vendbanimeve të tjera humane në gjithëpërfshirës, të sigurt, fleksibël dhe të qëndrueshëm. Programi i Zhvillimit të OKB-së dhe Programi i Vendbanimeve Humane të OKB-së janë të angazhuar dhe bashkëpunojnë (*UNDP, 2021/a*) për të ndihmuar vendet dhe qytetet të tejkalojnë krizat e zhvillimit dhe të përparojnë në realizimin e Objektivave Globalë të Zhvillimit të Qëndrueshëm bazuar në Agjendën 2030, Marrëveshjen e Parisit dhe Agjendën e Re Urbane (*UNHABITAT, 2021*). OGZHQ-të kanë të bëjnë me: 1) eliminimin e varfërisë dhe të gjithë formave të saj; 2) eliminimin e urisë, arritjen e sigurisë ushqimore, përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme; 3) sigurimin e jetës së shëndetshme dhe nxitjen e mirëqenies në çdo moshë; 4) sigurimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës, të barabartë dhe krijimin e mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës për të gjithë; 5) arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave; 6) sigurimin e ujit dhe menazhimit të qëndrueshëm të tij dhe të higjienës për të gjithë; 7) sigurimin e energjisë së pastër, moderne, të besueshme dhe të përballueshme nga të gjithë; 8) nxitjen e rritjes ekonomike të

---

<sup>1</sup> Shënim: i referohemi në vazhdim si OGZHQ

qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe punësimit dinjitoz; 9) nxitjen e industrializimit të qëndrueshëm e përfshirës, novacionit dhe infrastrukturës fleksibël; 10) reduktimin e pabarazive në e midis vendeve; 11) *nxitjen e gjithëpërfshirjes, sigurisë, fleksibilitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të qyteteve dhe vendbanimeve humane në tërësi*; 12) sigurimin e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm; 13) ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre; 14) ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të oqeanëve, deteve dhe resurseve detare për zhvillim të qëndrueshëm; 15) ruajtjen, rikthimin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menazhimin e qëndrueshëm të pyjeve, luftën ndaj dezertifikimit dhe frenimin e degradimit të tokave, si edhe përmirësimin e tyre dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit; 16) promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, drejtësisë për të gjithë dhe ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet; 17) forcimin e mjeteve për zbatim dhe rivitalizimin e bashkëpunimit global për zhvillim të qëndrueshëm. (UN, 2021/d).

Për secilin prej synimeve që përfaqësojnë reflektimin për realizimin e OGZHQ-ve, nevojiten të dhëna specifike që konvertohen në tregues sipas udhëzimeve të OKB-së dhe agjencive përkatëse (UN, 2021/c). Në këtë kuadër, edhe për Objektivin e 11-të ofrohen disa kategori të dhënash sasiore e cilësore që duhen përpunuar statistikisht e interpretuar, për të reflektuar zhvillimet reale.

Objektivi i njëmbëdhjetë, natyrisht që nuk mund të konsiderohet i shkëputur nga të tjerët pasi vetë problematika urbane ndërthuret me disa prej objektivave të sipërpërmendur, si objektivi i parë, i gjashtë, i shtatë, i tetë, i nëntë, i dymbëdhjetë, i pesëmbëdhjetë, i shtatëmbëdhjetë e ndonjë tjetër (UN, 2021/a).



Në Agjendën 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm, ashtu si çdo objektiv tjetër, Objektivi i 11-të, zërthehet në synime konkrete që orientojnë dhe dëshmojnë tendencën në rrugën për realizimin e tij drejt shndërrimit të qyteteve dhe vendbanimeve humane në tërësi, në vendbanime gjithëpërfshirëse, të sigurta, fleksibël dhe të qëndrueshme. Këto synime në mënyrë të përmbledhur (UN, 2021/c), lidhen me:

- krijimin e mundësive për banesa të përshtatshme, të sigurta, ekonomikisht të përballueshme dhe për shërbime për të gjithë kategoritë e popullsisë; (treguesi 11.1.1)

- krijimin e mundësive për të përdorur veçanërisht sistemin e transportit publik, të sigurt e ekonomikisht të përballueshëm për të gjithë; (treguesi 11.2.1)

- pjesëmarrjen në vendimmarrje për një urbanizim e planifikim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës; (treguesit 11.3.1 dhe 11.3.2)

- mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore; (treguesi 11.4.1)

- reduktimin e vdekshmërisë dhe zbutjen e efekteve negative në ekonomi, të fatkeqësive natyrore, veçanërisht përmbytjeve e sidomos mbrojtjes së shtresave në nevojë; (treguesit 11.5.1 dhe 11.5.2)

- ndotjen e ajrit dhe menazhimin e mbetjeve në nivel lokal e jo vetëm; (treguesit 11.6.1 dhe 11.6.2)

- krijimin e mundësive për të frekuentuar hapësirat e gjelbra dhe publike, sidomos për kategoritë më vulnerabël të popullsisë; (treguesit 11.7.1 dhe 11.7.2)

- marrëdhënien ekonomike, sociale e mjedisore midis zonave urbane, periurbane dhe rurale për një planifikim më të mirë të zhvillimit rajonal e kombëtar; (treguesi 11.a.1)

- rritjen e ndjeshme të numrit të qyteteve dhe vendbanimeve humane që implementojnë politikat dhe planet e integruara për përfshirje, përdorim efikas të resurseve, reduktim dhe përshtatje

ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësive; (treguesi 11.b.1 dhe 11.b.2)

- ndërtime të qëndrueshme, fleksible dhe të bazuara në resurse lokale në vendet pak të zhvilluara, me asistencë teknike e financiare dhe jo vetëm. (treguesi 11.c.1)

Ekziston një kategorizim (*UN,2021/ h*) i këtyre treguesve si më poshtë:

- për treguesit 11.1.1; 11.5.2; 11.6.2; 11.b.1, ekziston si përkufizimi i mirëpërcaktuar i treguesit, ashtu edhe metodologjia e pranuar ndërkombëtarisht e përlllogaritjes dhe standardet. Për këtë grup treguesish të dhënat vihen rregullisht në dispozicion nga rreth 50% e shteteve dhe popullsisë së rajonit përkatës.

- për treguesit 11.2.1; 11.3.1; 11.5.1; 11.6.1; 11.b.2, ekziston si përkufizimi i mirëpërcaktuar i treguesit, ashtu edhe metodologjia e përlllogaritjes dhe standardet. Nuk janë të dhëna të cilat janë të disponueshme nga një numër i konsiderueshëm shtetesh.

- për treguesit 11.3.2, 11.4.1, 11.7.1, 11.7.2, 11.a.1; 11.c.1, ekziston përkufizimi i mirëpërcaktuar i treguesit, por ende jo metodologjia e përlllogaritjes dhe standardet.

Ndryshimi midis treguesve të grupit të parë dhe të dytë, lidhet pikërisht me rregullsinë e prodhimit të të dhënave dhe për pjesën e shteteve që i ofrojnë ato. Ky diferencim i treguesve në këto tri kategori, mund të shërbejë edhe për të kuptuar disi edhe mungesat në bazën e të dhënave të OKB-së, por edhe një pjesë të mangësive në treguesit e Objektivit të 11-të të raportuar nga Shqipëria, krahas treguesve të tjerë.

## **2. OGZHQ dhe angazhimi institucional në Shqipëri**

Në paragrafët 72, 78 e 79 të Agjendës 2030, inkurajohen qeveritë dhe parlamentet kombëtare të kontrollojnë rregullisht progresin në nivel vendi, në përputhje me kontekstin, prioritetet dhe politikat

kombëtare. Ky proces duhet të udhëhiqet nga vendi përkatës dhe të realizohet mbi baza vullnetare siç përcaktohet në paragrafin 74/a. (UN, 2021/d). Shqipëria ka shprehur gatishmërinë e saj për implementimin e Agjendës 2030 në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe procesin e integrimit evropian, duke angazhuar institucionet përgjegjëse në sigurimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e treguesve që përmbajnë synimet e secilit prej OGZHQ-ve (RSH, *Këshilli i Ministrave & UN-Albania*, 2017).

Ky angazhim ka filluar në tetor 2017 me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi të 25 universiteteve e fakulteteve publike e private për të luajtur rol aktiv në përparimin për zbatimin e Agjendës 2030, duke u pasuar pas dy muajsh me miratimin e një rezolute nga Parlamenti shqiptar ku konfirmohet angazhimi i vendit në implementimin e Agjendës 2030 (REC-Albania, 2022). Në funksion të këtij angazhimi, midis të tjerash, në korrik 2018, Shqipëria paraqiti Raportin Kombëtar Vullnetar në Forumin politik të nivelit të lartë të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin e qëndrueshëm, ku reflektohet integrimi midis prioriteteve të qeverisë shqiptare dhe OGZHQ-të.

## 2.1 OGZHQ në kontekstin lokal<sup>1</sup>

Realizimi i secilit prej synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm mundësohet nëpërmjet politikave të zhvillimit bazuar në të dhëna që i janë nënshtruar një procesi konceptimi, përzgjedhjeje dhe më pas përpunimi statistikor. Treguesit e rezultuar nga ky proces, mundësojnë njohjen dhe studimin e situatës në rang global për të evidentuar shkaqet në bazë të diferencimeve në tregues në rajonet më të mëdhenj të botës në shërbim të politikëbërjes.

---

<sup>1</sup> Shënim: Në këtë rast, Shqipëria

Të dhënat ekzistuese dhe ato të raportuara nga Shqipëria, në lidhje me OGZHQ-të gjenden në webfaqen e INSTAT-it (*INSTAT, 2022*) dhe në webfaqen e OKB-së ku figuron raporti më i fundit i dorëzuar nga qeveria shqiptare në vitin 2018, i cili është përgatitur me bashkëpunimin e institucioneve kryesore në vend që drejtojnë reformat në fushat prioritare dhe nën koordinimin e grupit teknik të punës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm së bashku me agjencitë e OKB-së në Shqipëri (*UN, 2021/f*). Agjencitë e OKB-së në Shqipëri e mbështesin arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në mënyra të ndryshme nëpërmjet sistemit MAPS<sup>1</sup> që nënkupton integrim të Agjendës 2030 në zhvillimin dhe politikat kombëtare; mbështetje të progresit të përshpejtuar të vendit për OZHQ-të duke shënjestruar fushat prioritare kombëtare të identifikuar në procesin kryesor; mbështetje me ekspertizë në kohën e duhur e me kosto minimale sa është e mundur (*UN, 2021/f*). Procesi i përgatitjes së raportit thuhet se ka kaluar nëpër një proces konsultimi duke përfshirë edhe qeverisjen lokale, Akademinë e Shkencave, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit në vend për të diskutuar dhe vlerësuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet që janë reflektuar në raportin përfundimtar (*UN, 2021/g*).

Raporti i Shqipërisë, në mbështetje të Agjendës 2030 (*UN, 2021/f*) paraqet situatën për 140 synime të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, 83% e të cilëve vlerësohet se lidhen me komponentë specifike të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2015-2020. Në raport evidentohen disa prej OGZHQ-ve si të ndërlidhur në një pjesë të mirë me Strategjinë Kombëtare të zhvillimit të vendit. Kështu objektivi që vlerësohet të jetë në një masë të konsiderueshme në një linjë me politikën kombëtare është objektivi

---

<sup>1</sup> Inicialet në gjuhën angleze për: Mainstreaming, Acceleration and Policy Support

7 që lidhet me energjinë (në masën 90%). Objektivat 8, 9 dhe 16 kanë një përputhje nga 70-79%, ndërsa objektivat 2,5, 6,11,17 në masën nga 55 në 65%. Përzgjedhja e treguesve të përfshirë në raport është bërë mbi bazën e disa kritereve si: përshtatshmëria me realitetin në Shqipëri, publikimi tashmë në dokumente zyrtare, përputhshmëria e tyre me dokumentet e strategjisë së zhvillimit kombëtar, të përlllogaritur sipas udhëzimeve dhe me saktësi maksimale etj. Secili prej tyre është paraqitur sipas organizimi standard nëpër rubrika të cilat sqarojnë konceptin që lidhet me treguesin, burimin e informacionit, përputhshmërinë me përcaktimin nga OKB-ja, objektivin dhe të përkatësinë kohore të të dhënave të paraqitura grafikisht. Për Objektivin e 11-të paraqiten vetëm dy tregues.

## **2.2 Objektivi i 11-të i OGZHQ, në kontekstin lokal**

Në Raportin Vullnetar të Shqipërisë (*UN, 2021/f*) dorëzuar në OKB, në lidhje me Objektivin e 11-të renditen arritjet në kuadër të Programit “Rilindja urbane” ku si synimi kryesor i të cilit cilësohet “.....rilindja urbane nëpërmjet rivitalizimit të kohezionit të komunitetit”, synim i cili është riformuluar së fundmi në “Rilindja urbane nëpërmjet rivitalizimit të potencialeve për ekonominë lokale dhe rajonale”, duke u përafëruar kështu me Objektivin e 9-të të OZHQ. Vlerësohet se disa prej prioriteteve në kuadër të këtij programi lidhen me synimet e detajuara për realizimin e Objektivit të 11-të. Po ashtu, si pjesë e përpjekjeve, përmendet edhe programi “Rilindja rurale” në kuadër të të cilit u ndërmor procesi i rivitalizimit të 100 fshatrave në vend për t’i shndërruar ato në motorë të zhvillimit nëpërmjet investimeve në aktivitete bujqësore dhe infrastrukturë. Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030 (*MZHU/AKPT, 2016*) vlerësohet si dokumenti i parë dhe më i rëndësishëm që kontribuon direkt në realizimin e Objektivit të 11-të (*UN, 2021/f*)

Të dhëna në lidhje me OGZHQ-të gjenden në webfaqet e INSTAT-it dhe OKB-së. Midis të tjerave në webfaqen e INSTAT-it, për Objektivin e 11-të rezultojnë të paraqitur vetëm 2 tregues nga 15 që i përkasin atij. Ata janë “përpjesa e popullsisë urbane që jeton në slums-e, vendbanime informale ose banesa të papërshtatshme” dhe “përpjesa e mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura rregullisht dhe të depozituara sipas normave ndaj sasisë gjithsej të mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara sipas qyteteve” (INSTAT, 2022). Këta janë të njëjtë me treguesit që figurojnë në Raportin e Shqipërisë në lidhje me Objektivin e 11-të. (UN, 2021/f) Ndërsa në webfaqen e OKB-së, në profilin e Shqipërisë, rezulton i paraqitur vetëm një tregues për Objektivin e 11-të. Ky tregues është treguesi mesatar i përqendrimit në ajër të grimcave më diametër më pak se 2.5 mikron në vitin 2016 (UN, 2021/e,) duke e evidentuar Objektivin e 11-të si objektivin me më pak tregues të përllogaritur.

Një dokument tjetër ku rezultojnë të paraqitur tregues të OGZHQ-ve, është Raporti për OGZHQ (Sachs et.al, 2021), që konsiderohet plotësues ndaj informacionit që sillet në webfaqen e OKB-së për tregues të ndryshëm të synimeve që u përkasin 17 OGZHQ-ve. Shqipëria paraqitet me një indeks performance për OGZHQ, 71, duke u renditur në vendin e 64-t midis 165 vendeve. Për sa i takon Objektivit të 11-të, i gjithë Rajoni i Europës Lindore dhe Azisë Qendrore ku Shqipëria është kategorizuar, krahasuar me rajonet e tjera të botës, paraqet një situatë të njëjtë si edhe më parë, ashtu si edhe Shqipëria. Nga 15 tregues, për 7 synime në kuadër të Objektivit të 11-të, në rang kombëtar janë paraqitur vetëm 3 prej tyre.

Në këtë raport, në një optikë krahasuese me vendet e tjera të rajonit, performanca e Shqipërisë për Objektivin e 11-të, nuk rezulton të jetë më e mira e mundshme, pasi vlerësohet se puna për realizimin e këtij objektivit paraqet situatë mbetjeje në vend (stanjacioni) dhe me sfida të mëdha përpara. Treguesit ku janë

bazuar këto gjykime janë: zonat e banimit me status të ulët social-ekonomik; mesatarja vjetore e grimcave më të vogla se diametri 2.5 mikron (në përmirësim të moderuar); aksesit në burimet e përmirësuar të ujit në tubacione ku konstatohet përsëri mbetje në vend (% e popullsisë urbane); shkalla e kënaqësisë ndaj shërbimit të transportit publik (konstatohet rënie). Këta janë tregues të ndryshëm nga ata të paraqitur në Raportin Vullnetar të Shqipërisë.

Këtë situatë e paraqesin edhe vende të tjera të rajonit të Europës Lindore dhe Azisë Qendrore si Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Rumania, Serbia, por edhe Afganistani, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani. Pra, ndër 27 vende të këtij rajoni të paraqitur në raport, 8 prej tyre karakterizohen nga mungesa të ndryshimit (stanjacion) në lidhje me objektivin e 11-të të OGZHQ. Lihtenshtein dhe San Marino vlerësohet se e kanë realizuar tashmë këtë objektivi, ndërsa Malta, Monako dhe Andorra janë në rrugën e duhur drejt realizimit të objektivit. Vendet e tjera të këtij rajoni paraqesin një situatë në përmirësim e sipër.

Do të ishte më e arsyeshme edhe dobiprurëse në lidhje me politikëbërjen që, në analiza të tilla Shqipëria të përfshihej në një rajon me vende që kanë histori e problematikë të ngjashme të zhvillimit në tërësi dhe të zhvillimeve urbane në veçanti, për ta vlerësuar performancën në realitete të ngjashme dhe për të shkëmbyer eksperiencën dhe modele zhvillimi. Ky sugjerim bazohet edhe në faktin e evidentuar nga studimet (*Michalina, et.al, 2021*), se ekzistojnë diferencime në treguesit që përdoren për matjen e ZHQU-së në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, që bazohen përkatësisht më së shumti në tregues mjedisorë dhe në tregues ekonomikë dhe socialë.

### **Përfundime e rekomandime**

Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe i të dhënave, në funksion të matjes së situatës në lidhje me ZHQU-në, rezulton se treguesit e

Objektivit të 11-të për Shqipërinë paraqiten në një numër shumë të kufizuar, krahasuar me objektivat e tjerë të zhvillimit të qëndrueshëm duke mos mundur kështu gjykime e analiza për realitetin urban në raport me zhvillimin e qëndrueshëm. Rrjedhimisht, duhen bërë përpjekje më të mëdha për përlogaritjen e raportimin e sa më shumë treguesve në shërbim të konstatimeve dhe strategjive globale.

Baza e të dhënave të detajuara dhe organizuara në funksion të këtij qëllimi është e një rëndësie të veçantë, por ajo duhet të vijë pas evidentimit dhe përcaktimit të mirëmenduar të problematikës në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm urban në vend, duke iu referuar dhe duke marrë për bazë modele nga realitete të ngjashme përpos treguesve globalë.

Duke vlerësuar vullnetin dhe përpjekjen e shtetit shqiptar, për t'iu bashkëngjitur iniciativës globale për vënien në jetë të Agjendës 2030, në lidhje me matjen e zhvillimit të qëndrueshëm në tërësi dhe atij urban në veçanti, do të rekomandonim se konceptimi me prioritet i një kuadri lokal kategorish dhe treguesish, referuar specifikave lokale zhvillimore në vend dhe i një indeksi lokal për zhvillimin e qëndrueshëm urban, do të ndihmonte së pari në njohjen e situatës sipas specifikave të vendit dhe do të mundësonte gjithashtu qasjen krahasuese midis vendbanimeve apo zonave urbane në rang vendi. Agjenda e Re Urbane e UN-Habitat e cilësuar plotësuere dhe e miratuar me një dokument përfundimtar nga Konferenca Habitat III e vitit 2016, mundëson udhëzime në nivele lokale e kombëtare mbi rritjen dhe zhvillimin e qyteteve deri në vitin 2036 (*UN, 2021/a*).

Unifikimi i kategorive dhe treguesve në nivel rajonal (konceptualë dhe metodologjikë) për përcaktimin e indeksit për zhvillimin e qëndrueshëm urban sipas interesave të bashkëpunimit ose specifikave të zhvillimit, do të mundësonte gjithashtu jo vetëm ballafaqimin në kontekst rajonal të situatës në lidhje me ZHQU-në,



por edhe shkëmbimin e eksperiencave dhe bashkëpunimin për të ndërhyrë si duhet me politika zhvillimi drejt realizimit të këtij objektivi, që duket se, tani për tani, mbetet në kufijtë e një prirjeje pozitive.

## Literatura

Cunha, A/Racine.J.B., (2000): Sustainable development, the quality of the urban environment and governance: issues in urban research, or hoë to change the process of of change in integrated urban systems and sustainability of urban life, Bucharest. EDITURA TEHNICA

INSTAT (2022), URL: <http://www.instat.gov.al/al/sdgs/> shqyrtuar më 03.12.2021

Karaguni, M., (2009): Zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe Shqipëria urbane, UT/FHF-Studime albanologjike, viti XIV/4.

Knox, P.L., McCarthy. L., (2005) Urbanisation, Pearson

Luederitz, Christopher & John, Beatrice, (2015). Principles for sustainable urban places: the why, what and how. (2015) <https://www.researchgate.net/publication/280875675>, shqyrtuar më 01.12. 2021

Michalina, D., Mederly, P., Diefenbaher, H., Held, B., Sustainable Urban Development: a review of Urban Sustainability Indicator Frameworks. Sustainability 2021, 13, 9348. <https://doi.org/10.3390/su13169348>, shqyrtuar më 02.12.2021

MZHU/AKPT, (2016), Plani i Përgjithshëm Kombëtar. Dokumenti i parë kombëtar për planifikimin e territorit 2015-2030

REC- Albania, (2022) [http:// www.recshqiperi.org/news-al.php?id=26](http://www.recshqiperi.org/news-al.php?id=26), shqyrtuar më 10.12.2021 Republika e Shqipërisë dhe UN-Albania (2017), Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara. (Kudri për Zhvillim të Qëndrueshëm i Kombeve të Bashkuara), [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20\(Final\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Albanian%20Version%20-%20GoA-UN%20Programme%20of%20Cooperation%20for%20Sustainable%20Development%202017-2021%20(Final).pdf), shqyrtuar më 06.12.2021

Sachs, J., Kroll, C., Lafortune, G., Fuller, G., Woelm, F. (2021). The Decade of Action for the Sustainable Development Goals: Sustainable Development Report 2021. Cambridge: Cambridge University Press, [https:// www.sdgindex.org/reports/sustainable-development-report-2021/](https://www.sdgindex.org/reports/sustainable-development-report-2021/)

UN (2021/a), URL: <https://sdgs.un.org/topics/sustainable-cities-and-human-settlements>, shqyrtuar më [03.12.2021](https://www.sdgs.un.org/topics/sustainable-cities-and-human-settlements)

UN (2021/b),  
URL:(<https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/Agenda21.pdf>), shqyrtuar më 03.12.2021

UN (2021/c), URL: <https://unstats.un.org/sdgs/metadata/>, shqyrtuar më [04.12.2021](https://unstats.un.org/sdgs/metadata/)

UN (2021/d), URL: <https://sdgs.un.org/2030agenda>, shqyrtuar më [04.12.2021](https://sdgs.un.org/2030agenda)

UN (2021/e), URL:  
<https://unstats.un.org/sdgs/UNSDG/countryprofiles/alb#goal-12>, shqyrtuar më 04.12.2021

UN (2021/f), URL:  
[https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA\\_VNR\\_2018\\_FINAL2.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf), f.10, shqyrtuar më 05.12.2021

UN 2021/g, URL:  
<https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania> shqyrtuar më 05. 12.2021

UN 2021/h URL: UN: <https://unstats.un.org/sdgs/iaeg-sdgs/tier-classification/> shqyrtuar më 05. 12.2021

UNDP 2021/a, URL: [https:// www.undp.org/press-releases/undp-and-un-habitat-sign-new-fra-me-work-urban-action](https://www.undp.org/press-releases/undp-and-un-habitat-sign-new-fra-me-work-urban-action) shqyrtuar më 11.01.2022

UNDP, 2021/b, URL: <https://www.undp.org/sustainable-development-goals#sustainable-cities-and-communities> , shqyrtuar më 06.12.2021

UNHABITAT 2021, URL:  
<https://unhabitat.org/sites/default/files/2019/05/nua-english.pdf> shqyrtuar më 06.12.2021

**Prof. dr. Romeo Eftimi<sup>1</sup>**

## **ASPEKTE HIDROGJEOLOGJIKE TË FURNIZIMIT ME UJË TË QYTETEVE TË SHQIPËRISË, PËRVOJA DHE PROBLEME**

### **Abstrakt**

Historia e furnizimit me ujë e qyteteve në Shqipëri fillon në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të. Viti 1945 e gjeti Shqipërinë me shtatë ujësjellës me prurje të përgjithshme rreth 150 l/s, ose baras me rreth 9.5 l/ditë për banor. Sot ujësjellësit e qyteteve të Shqipërisë kanë kapacitet të përgjithshëm rreth 11.000 l/s, që do të thotë mbi 400 l/ditë për banor.

Sipas burimeve të furnizimit me ujë, qytetet e Shqipërisë grumbullohen në pesë grupe:

a) Me shpime në shtresat aluviale zhavorrore; b) burime karstike; c) puse në shtresa ujëmbajtëse karstike; d) burime në shkëmbinj magmatikë; e) furnizim i përzier si burime karstike, shpime në shtresa zhavorrore, ujëra sipërfaqësore. Në artikull analizohen karakteristikat e shfrytëzimit të burimeve ushqyese të qyteteve, duke ndaluar në veçanti në dy burimet ujore më të pasura, shtresat ujëmbajtëse zhavorre dhe ato karstike.

Burimet e furnizimit me ujë dallohen edhe për problematikën që ato shfaqin gjatë shfrytëzimit. Problemet kryesore që shfaqin shtresat ujëmbajtëse zhavorrore janë: a) Ndotja e lartë e zonave të ushqimit të ujërave nëntokësore (nga derdhja në lumenj e ujërave industriale dhe ujërave të zeza të papërpunuara, dhe nga veprimtari prodhuese në këto zona, si marrja e zhavorreve në shtretërit e lumenjve etj.); b) Prishja e cilësisë së ujërave nëntokësore nga intruzioni i mundshëm i ujërave detare në zonat bregdetare.

Problematika e burimeve karstike mund të përmblihet në: a) Luhatja e madhe e prurjes së burimeve gjatë vitit, në veçanti zvogëlimi i saj në stinën e verës; b) Ndotshmëria e lartë e burimeve nga aktivitetet prodhuese industriale apo bujqësore. Sidoqoftë, problem kryesor i ujësjellësve në Shqipëri mbetet humbja e madhe e ujit, e cila

---

<sup>1</sup> Studiues i pavarur, Rr. Rreshit Çollaku, Pll. Klasik Konstruksion, Nr. 43, Tiranë

mbërrin rreth 50 deri 70 % e sasisë së ujit, e cila dëshmon administrimin e dobët të ujës jellësve dhe ndjeshmërinë e ulët qytetare.

**Fjalë çelës:** *Furnizimi me ujë i qyteteve, burim karstik, pus shpimi për ujë, ndotja e burimeve ujore*

### **Abstract**

Albanian cities have a short history of the centralized water supply; they began to develop in the second half of the 19<sup>th</sup> century. Today, all the cities of Albania have new water supply systems with a total capacity of about 11,000 l/s, corresponding to over 400 l/s per capita. The territory of Albania consists of uneven distribution of very different rocks regarding the age, origin and lithology, as well as of very heterogenous hydrogeological characteristics (Fig. 1). In accordance to this the water supply sources of the cities are different, also. The main types of the water supply sources could be summarized in five groups: a) Water supply wells in alluvial gravel layers; b) karst springs; c) water supply wells in karst aquifers; d) springs of igneous rocks, and e) mixed water sources like: karst springs, drilling wells in gravelly layers and surface water.

There are several problems encountered when using different water supply sources. The main concern regarding the gravelly aquifers is the high vulnerability of groundwater near to recharge areas, and deterioration of quality by sea water intrusion in case of intensive groundwater pumping in coastal aquifers. The common contamination sources are the discharge of industrial water and untreated wastewater into rivers, as well as intensive production activities in the groundwater recharge areas; for example, by the gravel production in river beds.

Regarding the karst springs the main concerns are related to the large seasonal fluctuation of the spring discharge, especially the large decrease during the summer season, and high vulnerability to pollution of the karst water resources by the industrial or agricultural productive activities in their recharge areas, as for example the quarrying.

However, the main problem of water supply in Albania remains the great water loss of water supply systems, which varies about 50 to 70% of the total water amount which testifies to poor water management and low civic sensitivity.

**Keywords:** *City water supply, karstic spring, water supply well, contamination of water sources*

## **I. Hyrje**

Ndërtimi i veprave të furnizimit të qyteteve me ujë është një veprimtari tepër e lashtë; atje është manifestuar gjithë kultura dhe njohuritë inxhinierike të civilizimeve të hershme. Një pjesë e madhe këtyre veprave funksionojnë edhe sot në mënyrë të përsosur, duke merituar gjithë admirimin tonë. Duke mos dashur të zgjatemi në këtë temë, megjithëse shumë intriguese edhe e

mbushur me shembuj të panumërt, po përmendim vetëm furnizimin me ujë të Romës së lashtë. Ajo kishte 11 akuadote që transportonin  $>13 \text{ m}^3/\text{s}$  ujë të burimeve karstike drejt qytetit të Romës së vjetër, nga largësi 16 deri 91 km (Lombardi & Corrazza 2008). Në përgjithësi, në lashtësi shumë qytete janë vendosur afër burimeve karstike ose furnizoheshin prej tyre. Kjo përvojë vazhdon edhe sot në botë me shembuj të ndryshëm, duke përfshirë edhe Shqipërinë (Stevanović & Eftimi 2010, Stevanović 2019).



Fig. 1 Pusi i gërmuar i cili ndodhet afër qendrës së qytetit të Peqinit, si dhe furnizuesi me ujë i disa punishteve të vogla të qytetit; furnizimi kryhej me krahë (Foto e vitit 1967).

Qytetet e Shqipërisë nuk kanë histori të gjatë, ato filluan të ndërtohen kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të. Furnizimi me ujë i tyre fillimisht bazohej në përdorimin e rezervave ujore që ndodheshin brenda vetë qyteteve. Këto rezerva, në pjesën më të madhe të tyre, ishin burime natyrore apo ujëra të mbulesava të reja aluviale (lumore), të cilat shfrytëzoheshin me puse të gërmuara (puse fshati) me mure guri. Por ka pasur edhe raste të veçanta ku popullsia e qyteteve grumbullonte reshjet atmosferike në stera (depozita) të ndërtuara enkas në qilarët e shtëpive. Kjo ka qenë karakteristike për qytetin e Gjirokastrës, i cili vendosej në faqen shkëmbore (gëlqerore) të Malit të Gjerë, ku

reshjet atmosferike infiltrohen në formacionet gëlqerore dhe drenohen (shkarkohen) me shpejtësi pa mundur të krijojnë burime të përhershme. Po kështu, uji i shiut është përdorur për furnizimin me ujë edhe nga banorët e fshatrave të bregdetit jugor të vendit.

Ujësjellësit e parë në qytetet e Shqipërisë kanë filluar të ndërtohen mbas vitit 1920. Fundi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Shqipërinë me shtatë ujësjellës me prurje të përgjithshme 150 l/s, të cilët përcillnin ujin me rrjedhje të lirë duke siguruar kështu 9,5 l/s për banor. Në fig. 1 tregohet një pus fshati (foto e vitit 1967), i cili ndodhej afër qendrës së qytetit të Peqinit si dhe punëtori që paguhej nga shteti për të furnizuar me ujë furrën e bukës, restorantin dhe ndonjë punishte tjetër shtetërore. Kjo gjendje ndryshoi në vitin 1969 kur u ndërtua ujësjellësi i Peqinit, i cili e merrte ujin nga pusët e shpuara në aluvionet e lumit Shkumbin, në largësi rreth 3 km.

Sot, gjithë qytetet e Shqipërisë kanë ujësjellës të rinj me prurje të përgjithshme rreth 11.000 l/s, që do të thotë mbi 400 l/s për banor. Furnizimi me ujë i qyteteve përbëhet nga dy aspekte: e para, nga sasia e ujit e siguruar për furnizimin e një qyteti të dhënë; dhe e dyta, nga gjendja teknike e ujësjellësit dhe niveli menazherial, të cilat sigurojnë që një sasi sa më e madhe uji të mbërrijë te konsumatorët. Për të kuptuar në çfarë niveli teknik dhe menazherial janë ujësjellësit e Shqipërisë mjafton të përmendim se, me ndonjë përjashtim, humbjet e ujit në to zakonisht luhaten nga rreth 50 deri në rreth >70%.

Në këtë artikull do trajtojmë vetëm aspektin e parë të ujësjellësve të qyteteve shqiptare, i cili lidhet me burimet ujore dhe që mund t'i përmbledhim si probleme hidrogjeologjike.

## **II. Zona e studimit**

Qytetet e Shqipërisë shpërndahen në gjithë territorin e vendit, por pjesa më e madhe e tyre, dhe në veçanti ato më të mëdhatë

duke përfshirë edhe Tiranën, ndodhen në pjesën e ulët perëndimore të vendit. Pjesa më e madhe e tyre vendosen në lartësi të vogël, rreth 10 deri në rreth 100-200 m mbi nivelin e detit (mnd). Disa qytete si Bajram Curri, Puka, Kukësi, Çorovoda dhe Gjirokastra vendosen në lartësi rreth 300 deri 450 m mnd. Qytetet me lartësi më të madhe janë Peshkopia 650-700 m mnd, Kruja 450-650 m mnd, Pogradeci rreth 700 m mnd dhe Korça rreth 900 m mnd. Qytetet me lartësi hipsometrike të ulët, zakonisht deri në rreth 200 m mnd vendosen mbi depozitime dherash të rinj (depozitime kuaternare), kurse qytetet të cilat kanë lartësi hipsometrike më madhe zakonisht vendosen mbi depozitime shkëmbore kryesisht, flishore-ranore ose gëlqerore.

### III. Metoda

Për realizimin e këtij studimi u vlerësuan gjithë studimet hidrogjeologjike që ndodhen në arkivin e ish-Nd.Hidrogjeologjike (sot ato ruhen në Arkivin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar). Studimi i parë hidrogjeologjik shumë i rëndësishëm është ai i burimit të Selitës i kryer nga Kalinina (1951), mbi bazën e të cilët në vitin 1951 u ndërta ujësjellësi për furnizimin me ujë të Tiranës. Me themelimin në vitin 1959 të Nd. Hidrogjeologjike fillon studimi i planifikuar i ujërave nëntokësore në vendin tonë, i cili fillimisht u përqendrua në sigurimin me ujë të qyteteve. Këto studime janë kryer nga shumë specialistë hidrogjeologë, ndër ta fillimisht në vitet 1958-1961 kishte edhe specialistë rusë, si Ljasnikova SS, Fomin BJ, Rusajev NJ. Mbas vitit 1961 studimet hidrogjeologjike u kryhen nga specialistët shqiptarë, të cilët të renditur kronologjikisht janë: Gjata A., Mitro S., Lako A., Tafilaj I., Tyli N., Keta Z., Babameto A., Sara F., Eftimi R., Tartari M., Bisha G., Kondo M., si dhe Prenga G., Rama R. dhe Kashar B. Mbas vitit 1993, ish-Nd.Hidrogjeologjike u bë pjesë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Studimet e shumta dhe të thelluara hidrogjeologjike

shërbyen si bazë për ndërtimin e ujësjellësve të gjithë qyteteve të Shqipërisë.




Fig. 2 Harta e hidrogeologjike e Shqipërisë (e thjeshtuar nga Harta hidrogeologjike e Europës shk. 1:1.500.000, Eftimi etj. 2009)



#### IV. Karakteristikat hidrogeologjike të Shqipërisë

Megjithëse gjeografikisht është një vend i vogël, Shqipëria ka një larmi shumë të madhe gjeologjike. Shkëmbinjtë që e ndërtojnë atë, sipas moshës së formimit luhaten nga *ordoviku* deri në *kuaternar*, ndërsa sipas prejardhjes ata janë sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë (*Meço & Aliaj 2000, Xhomo etj 2002*). Po të kemi parasysh edhe shpërndarjen e çrregullt të tyre, edhe karakteristikat hidrogeologjike të Shqipërisë janë tepër të larmishme (*Eftimi etj 1985, Eftimi 2010*), ato në mënyrë të thjeshtuar jepen në Fig. 2. Sipas karakteristikave hidrogeologjike shkëmbinjtë e Shqipërisë ndahen në gjashtë grupe, nga të cilat shtresat e shkriçeta zhavorrore dhe shkëmbinjtë karbonatikë karstikë janë më të pasurit më ujëra nëntokësore, mbas tyre renditen shtresat zhavorrore të përziara me argjila, shkëmbinjtë ranorikë dhe ata magmatikë. Në fund renditen shkëmbinjtë argjilorë, ata flihorë dhe metamorfikë, të cilët praktikisht nuk përmbajnë ujëra nëntokësore. Ky grup i shkëmbinjve, i cili në hartë (Fig. 2) tregohet me ngjyrë kafe, zë një sipërfaqe e cila përbën rreth 40% të territorit të Shqipërisë dhe kjo padyshim përbën një faktor që e vështirëson shumë problemin e furnizimit me ujë të qyteteve, por edhe të gjithë vendit në përgjithësi.

#### Grupimi i qyteteve sipas mënyrës së furnizimit me ujë dhe analiza hidrogeologjike

Sipas burimeve të furnizimit me ujë, qytetet e Shqipërisë mund të grumbullohen në pesë grupe:

- Me shpime nga shtresa ujëmbajtëse zhavorrore lumore:
- Nga burime karstike:
- Nga shpime të vendosura në shkëmbinj karstikë:
- Nga shpime të vendosura në shkëmbinj magmatikë:

- Me dy apo më shumë burime të ndryshme të furnizimit me ujë.

- **Furnizimi me ujë me shpime në shtresa ujëmbajtëse zhavorrore lumore**

Në këtë grup përfshihen qytetet Shkodra, Lezha, Laçi, Fushë Kruja, Shijaku, Durrësi, Kavaja, Lushnja, Elbasani, Korça, Fieri, Patosi, Orikumi dhe Saranda. Përcaktimi i vendit më të përshtatshëm për vendosjen e puseve të furnizimit me ujë bazohet në njohjen e thellë të karakteristikave të shtresave ujëmbajtëse, si dhe në respektimin e disa parimeve, nga të cilat dy janë më kryesore (*Nonner 2003*): E para, pusët parapëlqehet të vendosen sa më afër zonës së ushqimit (lumit) për të garantuar qëndrueshmërinë e rrymës së ujërave nëntokësore si dhe për ta rritur atë nëpërmjet infiltrimit të nxitur (*Walton 1960, Eftimi 1982a, 1982b*), dhe e dyta, pusët duhet të vendosen në zonat me ujëmbajtje sa më të lartë në mënyrë që numri i puseve të shfrytëzimit të jetë sa më i vogël. Shtresat ujëmbajtëse zhavorrore përhapen zakonisht në zonat fushore, sikurse janë fushat e pjesës perëndimore të Shqipërisë nga Shkodra në Vlorë, luginat e lumenjve si dhe ultësirat e brendshme ndërmallore si ajo e Korçës. Këto shtresa kanë zakonisht trashësi më të madhe se 10-15 m dhe mbërrijnë deri mbi 50–100 m. Ato kanë tregues hidraulikë të lartë; koeficientët e ujëpërcjelljes (T) luhaten rreth 500 deri mbi 10.000 m<sup>2</sup>/ditë dhe në përputhje me këtë vlerat e prurjeve specifike (q) të puseve luhaten zakonisht nga rreth 5 deri mbi 100 l/s/m, kurse prurjet e përgjithshme të puseve në sektorët e shfrytëzimit (Fig. 3) luhaten nga rreth 10 deri në rreth 200 l/s (*Eftimi 1982a, 1982b*).

Vendosja e fushave të puseve të furnizimit me ujë të qyteteve të Shqipërisë në përgjithësi i ka respektuar dy parimet e lartpërmendura, por megjithatë këto shtresa përballen me dy

probleme të mëdha: mundësia e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe intruzioni i mundshëm nga deti.

1. Vendosja e puseve të shfrytëzimit afër zonës së ushqimit rrit pjerrësinë hidraulike dhe shpejtësinë e lëvizjes së rrymës së ujërave nëntokësore, dhe si rrjedhim shkurton kohën e lëvizjes së ujërave nëntokësore nga burimet e ushqimit (lumenjtë) deri te puset e shfrytëzimit. Kjo lehtësohet edhe nga fakti se në këto zona përshkueshmëria e shtresave zhavorrore zakonisht është e madhe. Një situatë e tillë është veçanërisht e padëshirueshme kundrejt ndotësve bakteriologjikë, si mikrobe e viruse, të cilët kanë qëndrueshmëri të lartë dhe zhduken plotësisht kur qëndrojnë nën tokë jo më pak se 50 ditë. Nga kjo rrjedh se, që të përjashtohet ndotja, zona e mbrojtjes së rreptë sanitare e ujërave nëntokësore duhet të jetë kaq e gjerë, sa koha e lëvizjes së viruseve (të cilat janë më të qëndrueshme) nga zona e ushqimit deri te puset e shfrytëzimit duhet të jetë jo më pak se 50 ditë. Ndotësit kryesorë janë ujërat e zeza të qendrave të banuara dhe të shesheve të plehrave urbane dhe *industriale* (Chiesa 1998, Drew & Hötzell 1999). Marrja e zhavorreve nga shtretërit e lumenjve për qëllime ndërtimi është një burim tjetër ndotjesh nga karburantet e makinave, ndërsa disiplina në përdorimin e plehrave e pesticideve pothuaj mungon plotësisht. Si rrjedhim, ndotja e lumenjve është tashmë një gjë e zakonshme dhe po kështu është dhe risku i ndotjes së ujërave nëntokësore që ushqehen prej tyre.

2. Ujërat nëntokësore mund të ndoten edhe nga intruzioni i ujit të detit si rezultat i pompimit intensiv në zonat bregdetare, i cili shoqërohet me ulje të nivelit të ujërave nëntokësore nën nivelin e detit. Ekuilibri ndërmjet ujërave nëntokësore dhe ujërave detare i nënshtrohet ligjit të Gyben-Herberg sipas të cilit thellësia e ujërave detare në një pikë të dhënë në zonat bregdetare është 40 herë më e madhe se lartësia e nivelit të ujërave nëntokësore mbi nivelin e detit (Bear & Verruijt 1994, Bonaci 2015). Kjo do të thotë se

ulja e nivelit të ujërave nëntokësore gjatë pompimit do shoqërohet me zvogëlimin e thellësisë të ujërave detare në fushën e puseve të shfrytëzimit duke kërcënuar prishjen e cilësisë së ujërave nëntokësore që pompohen.

Niveli relativ i detit në bregdetin shqiptar rreth 5000 vjet më parë ka qenë 3-4 m më poshtë se niveli i sotëm. Gjatë pleistocenit të vonë dhe holocenit të hershëm niveli relativ i detit u ngrit shpejt dhe ishte një periudhë transgresioni i madh kur vija bregdetare përparoi drejt Tokës (kontinetit) nëpër ish-fushën bregdetare (*Ciavola etj 1995*). Kjo u shoqërua me intruzionin e plotë të ujërave detare në shtresat ujëmbajtëse bregdetare. Më pas, gjatë tërheqjes së detit, rryma e ujërave të freskëta i shtyu (i shpëlau) ujërat detare, të cilat mund të kenë mbetur pjesërisht në zonat periferike (bregdetare) të shtresave ujëmbajtëse; ky quhet intruzioni mbetës.

Më poshtë do japim një shembull se si janë vendosur pusët e shfrytëzimit në fushën aluviale Lezhë-Mamurras, nga ku furnizohen me ujë qytetet Lezhë, Milot, Laç, Shijak dhe Durrës, pa përmendur edhe dhjetëra fshatra të kësaj zone (Fig. 3). Fusha Lezhë-Mamurras ka një sipërfaqe rreth 200 km<sup>2</sup> dhe është formuar kryesisht nga aluvionet e lumit Mat dhe më pak nga ato të lumit Drin në veri, si dhe nga lumi Droja në jug. Trashësia më e madhe e depozitimeve aluviale mbërrin në mbi 200 m, kurse ajo e zhavorreve i kalon 100 m. Shtresa e zhavorreve dallohet për ujëpërcjellshmërinë e tyre shumë të lartë, e cila në një pjesë të madhe të zonës qendrore i kalon 4000 m<sup>2</sup>/ditë (Fig. 3), dhe në përputhje me këtë janë edhe prurjet specifike të puseve, vlerat e të cilave kalojnë 40 l/s/m. Zona kryesore e ushqimit të ujërave nëntokësore është lumi Mat, ku zhavorret e shtratit kanë lidhje hidraulike të drejtpërdrejtë me shtresat ujëmbajtëse zhavorrore të fushës. Fushat e puseve (Fig. 3) përdoren si vijon; Barbulloja për Lezhën, Rrila është përdorur për ujitje, Fushë Kuqe dhe Fushë Miloti përdoren për Milotin, Durrësin, Laçin dhe Shijakun. Gjithë

fushat e lartpërmendura të puseve janë vendosur në sektorët me ujëpërcjellshmëri të lartë të shtresave ujëmbajtëse. Ky parim është zbatuar në përgjithësi në vendosjen e fushave të puseve në gjithë shtresat ujëmbajtëse zhavorrore të Shqipërisë së ulët (*Eftimi 1982a*). Mirëpo fushat e puseve jo gjithmonë vendosen në pozicione optimale lidhur me problemet sasiore dhe cilësore.

Fusha e puseve të Fushë Kuqes nga e cila pompohen rreth 600 l/s për furnizimin me ujë të Durrësit dhe Shijakut ndodhet në pjesën qendrore të Fushës së Matit, e baraslarguar nga deti Adriatik dhe nga zona e ushqimit që është lumi Mat. Sipas vrojtimeve hidrokimike të kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, megjithëse përmbajtja e Cl dhe Na ka një rritje të lehtë në 20 vitet e fundit, cilësia e ujërave nëntokësore respekton normat e ujit të pijshëm. Fusha e puseve të Fushë Milotit, ku pompohen gjithashtu rreth 600 l/s, përdoret po për furnizimin me ujë të Durrësit dhe Shijakut, është vendosur disa qindra metra nga lumit Mat. Afërsia e puseve me zonën e ushqimit garanton ujëbollshmërinë e puseve, por vë në pikëpyetje cilësinë e tyre, e cila varet nga cilësia e ujit të lumit Mat. Vrojtimet hidrokimike kanë treguar se deri tani vlerat e komponentëve kimikë nuk kalojnë vlerat e normave të ujit të pijshëm, por kjo nuk është një garanci që do vazhdojë kështu gjithmonë.

Në shtratin e lumit Mat ushtrohet një veprimtari intensive për marrjen e zhavorreve për material ndërtimi dhe risku i ndotjes së lumit dhe ujërave nëntokësore nga karburantet dhe vajrat e automjeteve është tepër i lartë, megjithatë deri tani është ende i pavlerësuar me analiza laboratorike.

Rritja e sasisë së ujit që pompohet nga shtresat zhavorrore shoqërohet gjithmonë me krijimin e uljeve rajonale të nivelit të ujërave nëntokësore. Kjo nga ana e saj rrit intensitetin e infiltrimit nga zonat e ushqimit dhe gjithashtu tërheqjen e ujërave nga shtresa të tjera ujëmbajtëse. Po përmendim se në sektorin Turan të fushës

së Korçës ulja rajonale e nivelit të ujërave nëntokësore është rreth 14 m (Sara & Eftimi 2021).

Në praktikën e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore të shtresave ujëmbajtëse zhavorrore ka edhe mjaft shembuj të padëshiruar. Kështu, në afërsi të periferisë lindore të Elbasanit, në fushën e Krastës së Vogël, e vendosur buzë lumit Shkumbin, ka tri puse secili me kapacitet rreth 100 l/s, por ujërat nëntokësore atje janë bakteriologjikisht të ndotura (Eftimi 1999). Kjo është pasojë e ndërtimeve të panumërta të bëra në fushën e Krastës së Vogël dhe nga mungesa përpunimit të ujërave të zeza dhe të mbetjeve urbane. Po kështu, fusha e puseve e Dobraçit që pompon rreth 700-800 l/s për furnizimin me ujë të Shkodrës, është rrethuar nga zhvillimi i një zone të re urbane e cila kërcënon seriozisht ndotjen e ujërave nëntokësore.

Në praktikën e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore të shtresave ujëmbajtëse zhavorrore ka edhe mjaft shembuj të padëshiruar. Kështu, në afërsi të periferisë lindore të Elbasanit, në fushën e Krastës së Vogël, e vendosur buzë lumit Shkumbin, ka tri puse secili me kapacitet rreth 100 l/s, por ujërat nëntokësore atje janë bakteriologjikisht të ndotura (Eftimi 1999). Kjo është pasojë e ndërtimeve të panumërta të bëra në fushën e Krastës së Vogël dhe nga mungesa përpunimit të ujërave të zeza dhe të mbetjeve urbane. Po kështu, fusha e puseve e Dobraçit që pompon rreth 700-800 l/s për furnizimin me ujë të Shkodrës, është rrethuar nga zhvillimi i një zone të re urbane e cila kërcënon seriozisht ndotjen e ujërave nëntokësore.

Nga parashtrimi i mësipërm rrjedh se vrojtimet hidrogjeologjike mbi sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore janë një domosdoshmëri për të garantuar shfrytëzimin e suksesshëm të tyre në fushat aluviale të Shqipërisë, të cilat përdoren për furnizimin me ujë të shumë qyteteve të vendit.




Fig. 3 Harta e ujëpërcjellshmërisë së shtresave ujëmbajtëse zhavorrore të fushës aluviale Lezhë – Mamurras shk. 1:50.000 (Eftimi 1982a)

- **Furnizimi me ujë nga burime karstike**

Shkëmbinjtë karstikë zënë një sipërfaqe prej 6750 km<sup>2</sup>, ose 24% të territorit të Shqipërisë dhe formojnë 25 rajone karstike, nga të

cilat 23 në formacione karbonatike dhe 2 në formacione evaporitike (gipse). Rezervat e përgjithshme të ujërave nëntokësore të rinovueshme të Shqipërisë janë llogaritur në 227 m<sup>3</sup>/s, dhe përbëjnë rreth 80% të gjithë rezervave të ujërave nëntokësore të vendit tonë (Eftimi, 2020). Rreth 70% e popullsisë së qyteteve të vendit, furnizohen me ujë nga burimet karstike; të tilla janë Bajram Curri, Kukësi, Peshkopia, Burreli, Kruja, Librazhdi, Pogradeci, Berati, Kuçova, Çorovoda, Tepelena, Vlora, Himara, Erseka si edhe një pjesë e madhe e Tiranës. Megjithëse rezervat e ujërave karstike janë shumë të mëdha, furnizimi me ujë nga këto burime përballet me dy probleme të mëdha sasiore dhe cilësore.

**Tabela 1** Prurjet minimale (min), mesatare (mes) dhe më të mëdha për burimet Selita, Shëmria dhe Bovilla

Burimi	Q <sub>min</sub> – l/s	Q <sub>max</sub> – l/s	Q <sub>mes</sub> – l/s
Selita	215	1200	507
Shëmria	613	>2000	894
Bovilla	113	640	381



**Fig. 4** Stacioni i pompimit i burimit karstik Uji i Ftohtë – Vlorë. Zona e re urbane, pa infrastrukturë për grumbullimin dhe përpunimin e ujërave të zeza, zhvillohet mbi tunelet ujëgrumbulluese që ndodhen në brendësi të formacioneve ujëmbajtëse gëlqerore.





**Fig. 5** Burimi i Tushemishtit: **a** Perdja nëntokësore ujizoluese gjatë ndërtimit; **b** Pamja përfundimtare e veprës ujëmarrëse

Ushqimi i burimeve karstike bëhet nga infiltrimi i reshjeve atmosferike në zonat karstike dhe meqenëse regjimi i reshjeve është tepër i ndryshueshëm, edhe prurjet e tyre janë të tilla. Kjo bën që shumë qytete të ndiejnë mungesë uji veçanërisht në muajt e verës, kur burimet karstike zvogëlojnë ndjeshëm prurjet. Për të ilustruar këtë le të krahasojmë ndryshimin e prurjeve karstike që përdoren për furnizimin me ujë të Tiranës (Tabela 1). Për shkak të ndryshimit të madh të prurjes të burimeve karstike shpesh sasi të nevojshme të ujit gjatë minimumeve të tyre plotësohen me ujë sipërfaqësor, ose nga burime të tjera ujore nëntokësore ose sipërfaqësore.

Problemet e cilësisë të ujërave karstike lidhen me dy shqetësime: Ndotja e shtresave nga ndotjet urbane dhe nga intruzioni i mundshëm i ujërave detare. Ujërat karstike janë tepër të çmueshme, por gjithashtu janë lehtësisht të cenueshme (vulnerabël). Kjo lidhet me praninë e çarjeve dhe kanaleve karstike, të cilat lehtësojnë infiltrimin e ndotësve, aq më tepër kur ujërave e zeza nuk përpunohen dhe depozitimi i mbetjeve urbane nuk bëhet i rregullt. Si shembuj negativë lidhur me ndotjen e burimeve

karstike mund të përmendim shtimin e turbullirës në burimin e Bogovës, i cili përdoret për furnizimin me ujë të Beratit e Kuçovës, nga guroret e malit të Tomorit (*Eftimi & Zojer, 2015*). Mirëpo shembulli më negativ është ai i ndotjes së burimit Uji i Ftohtë, i cili furnizon me ujë Vlorën (Fig. 4). Burimi Uji i Ftohtë afër Vlorës ka prurje mesatare  $2.5 \text{ m}^3/\text{s}$  dhe është i vetmi burim karstik bregdetar në Shqipëri që ka ujë të pijshëm (*Tafilaj, 1979*). Megjithatë, cilësia e tij po cenohet rëndë nga zona e re urbane e ndërtuar mbi burim, në drejtim të ardhjes të rrymës së ujërave karstike (*Eftimi & Zojer, 2015*). Në disa raste, për mbrojtjen e burimeve karstike ndërtohen vepra hidroteknike speciale. Një shembull i tillë është ndërtimi i perdes nëntokësore të çimentimit në burimin e Tushemishtit i cili del buzë liqenit të Pogradecit dhe përdoret për furnizimin me ujë të qytetit. Perdja rrethon veprën ujëmarrëse dhe ndalon infiltrimin brenda veprës ujëmarrëse të ujërave eventualisht të ndotura të liqenit të Pogradecit (Fig. 5).

Për mbrojtjen e burimeve propozohen deri katër zona të mbrojtjes sanitare (*Chiesa, 1994*) si dhe masa të tjera ndihmuese, por për fat të keq në Shqipëri ato zakonisht caktohen pa studime të thelluara hidrogjeologjike, ose dhe kur përcaktohen nuk respektohen. Vitet e fundit janë ndërtuar disa vendgrumbullime mbetjesh si në Tiranë, në Bushat për Shkodrën dhe Lezhën, në Maliq për Korçën dhe Pogradecin, si dhe djegëse plehrash në Tiranë, Elbasan dhe Fier. Ato patjetër kanë një ndikim përmirësues në mbrojtjen e kushteve mjedisore në përgjithësi dhe të ujërave nëntokësore në veçanti.

Dukuria e intruzionit të ujit të detit në shtresat ujëmbajtëse të bregdetit shqiptar nuk është shumë e zhvilluar, sepse në këtë zonë nuk ka puse që pompojnë ujëra karstike, por atje ndodh përzierje natyrore e ujërave karstike me ato detare të cilat drenohen si burime të kripura e të papijshme, ose në mënyrë të shpërndarë-difuzive (*Eftimi & Parise 2022, dhënë për shtyp*).

- **Furnizimi me ujë nga shpime të vendosura në shkëmbinj karstikë**

Në këtë grup përfshihen vetëm qytetet Mamurras dhe Bilisht. Praktika ka treguar se shpimet për furnizim me ujë nga shkëmbinjtë karstikë janë më ujëbollshëm në rastet kur vendosen pranë burimeve karstike, në rastet kur kjo mundësohet nga kushtet hidrogeologjike (Stevanovic at al. 2007). Këto kushte duhet të jenë të tilla që pusët e vendosura në shtresat karstike të pompojnë rezervat statike të këtyre shtresave, të cilat rimbushen gjatë periudhës së lagësht të vitit. Kjo është realizuar më së miri nga shpimet e kryera për furnizimin me ujë të qyteteve Mamurras dhe Bilisht. Furnizimi me ujë i këtyre qyteteve më parë bëhej nga dy burime karstike, çdonjëri prej tyre me prurje rreth 10 l/s, kurse shpimet e kryera pranë burimeve kanë kapacitet rreth 70 l/s në Mamurras (Fig. 6) dhe rreth 30 l/s në Bilisht.



**Fig. 6** Shpimi i kryer në shkëmbinj karstikë për furnizimin me ujë të Mamurrasit jep me vetëderdhje rreth 50 l/s (Eftimi, 2002)



Fig. 7 a Shkëmbinj magmatikë të çarë, dhe b një burim çarjesh të përjimit)

- **Furnizimi me ujë nga burime në shkëmbinj magmatikë**

Në këtë grup përfshihen vetëm Puka dhe Fushë-Arrëzi. Shkëmbinjtë magmatikë takohen në pjesën e brendshme të Shqipërisë dhe zënë një sipërfaqe rreth 4,200 km<sup>2</sup>. Ata përfaqësohen kryesisht nga shkëmbinj ultrabazikë si dunite, harzburgite dhe serpentine, si dhe nga shkëmbinj bazikë si gabbro etj. Ujëmbajtja e këtyre shkëmbinjve lidhet me çarjet e shkëmbinjve (Fig. 7). Ata përmbajnë dy tipa çarjesh, të përjimit dhe tektonike. Ndërsa çarjet e përjimit janë të shpeshta, por zhvillohen zakonisht deri në thellësinë rreth 30-40m nën sipërfaqen e tokës, ato tektonike janë më të rralla, por mund të takohen në thellësi deri mbi disa qindra metra dhe më shumë. Burimet e shkëmbinjve magmatikë zakonisht janë të vogla, prurjet e tyre luhaten rreth 0.1 l/s deri në 2-3 l/s, por nga zonat e çarjeve tektonike dalin burime me prurje deri rreth 10-20 l/s. Puset e ujit në rastet kur takojnë zona çarjesh tektonike të thella mund të japin ujë me vetëderdhje deri 8 l/s. Nga qytetet e Shqipërisë vetëm Puka dhe Fushë-Arrëzi furnizohen me ujë nga burime në shkëmbinjtë magmatikë; prurjet e tyre luhaten nga rreth 5 deri në rreth 10 l/s. Cilësia e ujërave nëntokësore është shumë e mirë, përcjellshmëria elektrike luhatet rreth 200 µS/cm, kurse fortësia luhatet rreth 6-7° gjermane. Meqenëse burimet relativisht të mëdha në shkëmbinjtë magmatikë

janë të rralla, rritja e kapacitetit të ujësjellësve të Pukës dhe Fushë-Arrëzit përbën gjithmonë një problem ende të pazgjidhur. Deri më sot kërkimi i sasive plotësuese të ujërave nëntokësore me anë të shpimeve gabimisht nuk është shtruar si një mundësi reale.

- **Furnizimi me ujë nga dy ose më shumë burime të ndryshme furnizimi me ujë**

Në Shqipëri vetëm dy qytete, Tirana dhe Gjirokastra kanë furnizim me ujë nga dy ose më shumë burime të ndryshme. Tirana furnizohet me ujë nga tri burime karstike, nga disa ujësjellës që marrin ujë nga puse në depozitimet zhavorrore si dhe nga ujëra sipërfaqësore (Fig. 8). Sasia e ujit të burimeve karstike që përdoren për furnizimin me ujë të Tiranës nuk varet vetëm nga luhatja natyrore e prurjeve të burimeve (Tabela 1), por edhe nga kapaciteti i ujësjellësve (Tabela 2). Ndërsa prurja mesatare vjetore e burimeve të Selitës, Shëmrisë dhe Bovillës është 1782 l/s, prodhimi mesatar vjetor i tyre është 1320 l/s. Për të balancuar zvogëlimin e prurjeve të ujit të burimeve në stinën e verës si dhe për të plotësuar sasinë e ujit që i nevojitet Tiranës, në vitet 1975-1990 u ndërtuan disa ujësjellës me puse të cilët marrin ujin nga depozitimet zhavorrore në sektorin Bërxull-Laknas dhe periferia jugperëndimore e qytetit të Tiranës (Fig. 8). Prurja e përgjithshme e tyre luhatet rreth 200-300 l/s, sasi kjo që i përmirëson, por nuk i zgjidh aspak nevojat e qytetit për ujë. Rritja shumë e shpejtë e popullsisë së Tiranës mbas vitit 1990 u shoqërua me rritjen e paparashikuar të kërkesës për ujë. Kjo u zgjidh me ndërtimin e një ujësjellësi që ushqehet nga ujërat e rezervuarit të Bovillës, të cilat para se të futen në rrjetën e shpërndarjes përpunohen në impiantin e pastrimit në Paskuqan. Fillimisht ky ujësjellës kishte kapacitet 600 l/s dhe më vonë u zmadhua deri në 1800 l/s.



**Fig. 8** Harta hidrogeologjike e zonës të Tiranës. Shtresat ujëmbajtëse të pasura që përdoren për furnizimin me ujë të Tiranës (Eftimi etj. 1985): fusha blu e errët - zhavorre lumore; fusha e gjelbër e errët - shtresa karstike. Shenja të tjera: kuadrat i kuq – burim që përdoren për furnizim me ujë ose stacione pompimi në shtresat zhavorrore; vijat e kuqe – linjë ujësjellësi

**Tabela. 2** Prodhimi mesatar vjetor i ujësjellësve të Tiranës

Tipi i rezervave ujore	Ujësjellësi	Prurja mesatare vjetor, l/s
Burime karstike	Selita dhe Shëmria	939
	Bovilla	381
Shpime në shtresa ujëmbajtëse zhavorrore	Laknas, Bërxull, Tiranë	200
Ujëra sipërfaqësore	Rezervuari i Bovillës	1800
Gjithsej	3320	

Treguesit e cilësive kimike të burimeve ujore të Tiranës, megjithëse janë mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra, respektojnë normat e ujit të pijshëm (Eftimi etj. 2000), por herë pas here burimet janë të ngarkuara në pikëpamje bakteriologjike. Ndërsa te shpimet nuk respektohen zonat e ruajtjes sanitare, liqeni i Bovillës

kërcënohet nga ndotjet në pellgun ujëmbledhës (kryesisht nga fshatrat).

Gjirokastra tradicionalisht deri rreth vitit 1938-39, furnizohej me ujë nga sterat (depozitat) që kishte çdo shtëpi në qilar, ku grumbulloheshin ujërat e shirave. Në vitin 1939 u ndërtua ujësjellësi i burimit të Tranoshishtit, prurja e të cilit luhatet nga 25 deri në rreth 150 l/s dhe rreth vitit 1970 u ndërtua ujësjellësi i burimit karstik të Hosit, prurja e të cilit luhatet nga rreth 40 në rreth 80 l/s. Cilësitë kimike dhe bakteriologjike të këtyre burimeve janë shumë të mira, ato respektojnë normat e ujit të pijshëm. Me rritjen e popullsisë së Gjirokastrës doli nevoja e rritjes së kapacitetit të ujësjellësit dhe kjo u realizua me anë të shpimeve në fushën e Budukut, të cilat shfrytëzojnë ujërat nëntokësore me cilësi të mirë të depozitimeve zhavorrore të fushës së Drinosit.

## V. Diskutime dhe përfundime

Furnizimi me ujë i qyteteve përmban dy aspekte, ato hidrogjeologjike dhe ato të menazhimit. Padyshim që për qytetarët rëndësi ka që ujësjellësit t'i furnizojnë qytetet normalisht me sasinë e nevojshme të ujit dhe me cilësi të mirë. Kjo realizohet vetëm atëherë kur problemet hidrogjeologjike edhe ato menazheriale zgjidhen nëpërmjet ndërthurjes krijuese të problemeve teknike, organizative dhe monetare. Në këtë artikull kemi përgjithësuar shkurtimisht vetëm aspektet hidrogjeologjike të këtij problemi. Këto aspekte kanë të bëjnë me karakteristikat e shtresave ujëmbajtëse që sigurojnë burimet e ushqimit të ujërave nëntokësore dhe problematika e tyre. Shtresat ujëmbajtëse kryesore ku mbështetet furnizimi me ujë i qyteteve të Shqipërisë janë dy; shtresat zhavorrore të depozitimeve lumore dhe shtresat karstike (gëlqerore-dolomitke).

Në shtresat ujëmbajtëse zhavorrore uji sigurohet kryesisht me anë të puseve të shpimit, vendosja e të cilave bëhet nëpërmjet një

kompromisi të menduar mirë ndërmjet kapacitetit të tyre sa më të madh dhe mbrojtjes nga ndotjet sipërfaqësore. Vendosja e puseve afër zonave të ushqimit rrit kapacitetin e puseve, por edhe mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe për t'i mbrojtur ato nga ndotjet duhet të përcaktohen dhe të respektohen zonat e mbrojtjes sanitare. Një tjetër problem i shfrytëzimit të ujërave të shtresave ujëmbajtëse zhavorrore është edhe shpimi i puseve private, shfrytëzimi i të cilave rrit në mënyrë të pakontrolluar uljen rajonale të nivelit të ujërave nëntokësore. Kjo nga ana e saj intensifikon si infiltrimin nga zonat lumore të ushqimit, ashtu edhe intruzionin e ujit të detit në zonat bregdetare, dukuri këto që kërcënojnë prishjen e cilësisë së ujërave nëntokësore të puseve të vendosura në këto zona.

Burimet e mëdha karstike kanë gjithashtu një rëndësi të jashtëzakonshme për furnizimin me ujë të qyteteve. Përdorimi i burimeve karstike për furnizimin me ujë të qyteteve përmban gjithashtu disa kontradikta; ndërsa prurjet mesatare të burimeve karstike janë zakonisht të larta, prurjet e tyre më të vogla gjatë stinës së thatë janë mjaft më të vogla. Zvogëlimi i prurjeve të burimeve karstike në stinën e thatë plotësohet me ndërtimin e ujësjellësve të tjerë, që bazohen në puse të vendosura në shtresa ujëmbajtëse zhavorrore ose në ujëra sipërfaqësore (rezervuarë dhe lumenj). Burimet karstike gjithashtu janë lehtësisht të prekshme nga ndotjet dhe për mbrojtjen e tyre duhet të përcaktohen dhe të respektohen zonat e mbrojtjes sanitare.

Një rast i veçantë i shfrytëzimit të ujërave karstike është ai i shpimit të puseve në afërsi të burimeve karstike, por kjo realizohet vetëm kur ekzistojnë kushte të veçanta hidrogeologjike që e favorizojnë pompimin nga rezervat statike të ujërave karstike.

Aspektet hidrogeologjike të furnizimit me ujë të qyteteve janë të shumëllojshme dhe lidhen si me probleme sasiore, ashtu edhe cilësore të burimeve ujore. Shpesh këto probleme kanë zgjidhje



kontradiktore dhe vendimi për shfrytëzimin e një burimi ujor përbën një kompromis ndërmjet sasisë dhe cilësisë. Mirëpo këta tregues kanë luhatje të madhe vjetore dhe prandaj duhet të vrojtohen në mënyrë të rregullt, aq më tepër që ata mund të theksohen edhe më tepër nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Rritja e shpejtë e qyteteve dhe qendrave turistike lidhet me rritje të kërkesave për ujë, zgjidhja e të cilave të shtyn gjithnjë e më shumë drejt shfrytëzimit të rezervave ujore të liqeneve. Prania e liqeneve të Vaut të Dejës, Shkopetit, Ulzës dhe Banjës në periferinë e zonës fushore të Shqipërisë përbëjnë një rezervë të madhe ujore, e cila mund të përballojë shumë sfida të furnizimit me ujë të qyteteve në të ardhmen.

Aspektet hidrogjeologjike të furnizimit me ujë të qyteteve po bëhen gjithnjë e më të koklavitura dhe kjo e bën të domosdoshme thellimin në njohjen e gjithanshme të tyre krahasuar me deri tani. Një ndër hapat e parë që duhet bërë është ngritja e shërbimit hidrogjeologjik pranë ujësjellësve (të paktën në ata më të mëdhenj), për realizimin e vrojtimeve hidrogjeologjike sasiore dhe cilësore të pikave ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore, me synim mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të rezervave ujore.

### **Literatura**

Bear, J., & Verruijt, A., (1994) Modelling groundwater flow and pollution. Theory and applications of transport in porous media - Reidel Publishing Company, pp 414, Dordrecht, The Netherlands.

Bonaci, O., (2015) Karst hydrogeology of Dinaric chain and isles. Environ Earth Sci (2015) 74:37-55. DOI 10.1007/s12665-014-3677-8

Chiesa, G., (1994) Inquinamento delle acque sotterranee, Hoepli-Milano ISBN 88-203-2120-3;696

Ciavola, P., Arthurton, RS., Brew, DS., and Lewis, PM., (1995) Coastal Change in Albania: Case studies at Karavasta and Patok. Tec British Geological Survey Technical Repor WC/95/18, 46p

Drew D and Hötzl H Eds (1999) Karst hydrogeology and human activities. Balkema pp322

Eftimi & Zojer, (2015) Human impacts on karst aquifers of Albania. *Environ Earth Sci* 74:57-70 Doi 10.1007/s12665-015-4309-7

Eftimi, R., (1982a) Treguesit hidraulikë të shtresave ujëmbajtëse poroze-zhavorrore të Shqipërisë së Ulët Perëndimore dhe vendosja e fushave ujëmarrëse. Teza e Doktoratës për fitimin e titullit “Kandidat i shkencave”

Eftimi, R., (1982b) Vlerësimi sasior i infiltrimit të nxitur-kriteret bazë për shfrytëzimin intensiv të ujërave nëntokësore në zonat breglumore. *Bul. Shk. Gjeologjike* Nr.4, pp 103-126

Eftimi, R., (1999) Kushtet e ndotjes së ujërave nëntokësore të fushës ujëmbajtëse të Krastës së Vogël – Elbasan dhe udhëzime për të ardhmen. Arkiva e ITA Consult, Tiranë

Eftimi, R., (2002) Mundësia e gjetjes së rezervave të reja plotësuese për furnizimin me ujë të qytetit të Mamurrasit. Arkiva e ITA Consult, Tiranë

Eftimi, R., (2010) Hydrogeological characteristics of Albania, AQUAmundi - Am01012: 079-092

Eftimi, R., (2020) Karst and karst water resources of Albania and their management. *Carbonates and evaporites* 35: 1-14. <https://doi.org/10.1007/s13146-020-00599-0>

Eftimi, R., Bisha, G., Tafilaj, I., Habilaj, L., (1985) Hydrogeological map of Albania, scale 1: 200,000. Tirana: Nd. Hamid Shijaku

Eftimi, R., Bisha, G., Tafilaj, I., Habilaj, L., (2009) International Hydrogeological Map of Europe sc. 1:1.500.000, Sheet D6 Athinai, Albanian share, Hanover

Eftimi, R., Parise, M., (2022) Formation and drainage factors of the karst groundwater along the southern Albanian coastal area. submitted for publication

Eftimi, R., Shehy, K., dhe Lano, L., Cilësia e ujit e sistemit të ujësjellësve të Tiranës. ECAT Tiranë

Kalenina, PI., (1951) Otçjot ob inženjerno-geollogičskih isledovanija v rajone istočnikov Selita. Leningrad

Lombardi, L., Corraza, (2008) L'aqua e la città in epoca antica. La Geologia di Roma, del centro storico alla periferia. Part I, Memorie Serv. Geol. D'Italia, Vol LXXX

Meço, N., Aliaj, Sh., (2000) Geology of Albania. Gebrüder Bornatraeger Berlin, Stuttgart, pp 246

Noner, J.C., (2003) Introduction to hydrogeology, Balkema, ISBN 90 2 65 1930 3; 248

Sara, F., & Eftimi, R., (2021) Hidrogeologjia dhe hidrokimia e pellgut artezian ndërmalor të Korçës.

Stevanović, Z., & Eftimi, R., (2010) Karstic sources of water supply for large consumers in south-eastern Europe – sustainability, disputes and advantages. Conference of karst, Plitvice Lakes, Croatia – 2009, 181-185

Stevanović, Z., (2019) Karst water in potable water supply: a global scale overview. Environmental Earth Science (2019) 78:662 <https://doi.org/10.1007/s12665-019-8670-9>

Stevanović, Z., Jemcov, I., Milanović, S., (2007) Management of karst aquifers in Serbia for water supply. Environ Geol (2007) 51: 743-748 DOI 10.1007/s00254-006-0393-z

Tafilaj, I., (1979). Hydrogeology of Uji Ftohte karst springs. Albanian hydrogeological Service. In: Collection of groundwater studies, Tirana, pp 1-13

Walton, W.C., (1970) Ground water resources evaluation: Mc Graw-Hill Book Company, 1970., pp 664

Xhomo, A., Kodra, A., Xhafa, Z., Shallo, M., (2002) Gjeologjia e Shqipërisë (tekst sqarues i Hartës Gjeologjike të Shqipërisë. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. 410'

**Prof. dr. Hajri Haska<sup>1</sup>**

## **NJË VËSHTRIM MBI GJELBËRIMIN URBAN NË QENDRAT E BANUARA NË SHQIPËRI – E KALUARA, GJENDJA AKTUALE DHE SFIDAT E SË ARDHMES**

### **Abstrakt**

Shoqëria njerëzore ka kaluar stade të ndryshme në spiralen e saj të zhvillimit. Kalimi nga epoka e mesjetës në atë të qytetërimit solli edhe lindjen e qendrave urbane, ku njerëzimi filloi të shoqërizohej. Dekadat e fundit, bota sa vjen e është bërë më e urbanizuar. Rreth 50 % e popullsisë jetonte në zonat urbane në vitet '80, dhe parashikohet të arrijë në rreth 70 % në vitin 2050. Veç rrugëve, pallateve, spitaleve, shkollave etj., ky mbipopullim ka nevojë për më shumë gjelbërim, përfshi këtu dhe drurët e shkurret. Mjaft prijës, monarkë, dikur shkonin për gjah, shëtitje në natyrë, më pas ndërtuan kopshte me drurë në zonat e banuara, pra nisën të sillnin natyrën në qytet. U krijuan kopshte të mrekullueshme nga Athina e Roma e lashtë, por dhe në Angli, Francë, Gjermani, Austri, në SHBA etj.

Në vendbanime të hershme në vendin tonë, qysh në lashtësi, vërehet prania e gjelbërimit, drurëve, kjo nga zbulimet arkeologjike, shkrime të udhëtareve të huaj, foto, vizatime e skalitje të lashta në gur e dru. Drurë vihen re pranë varrezave si selvi, rrape; në afërsi të kishave, xhamive; objekteve publike; pranë pazareve, dyqaneve, sarajeve apo shtëpive të njerëzve të shquar të pasur, në sheshet e ndryshme të qyteteve të vendit tonë; në anë të rrugëve, brenda kalave, në oborre e dritare të familjeve qytetare nuk mungonin kurrsesi lulet e gjelbërimi. Elemente të gjelbërimit janë vërejtur qysh në kohë të lashta, në

---

<sup>1</sup> *Fakulteti i Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, E-mail: hhaskaj@ubt.edu.al*

vendbanime të tilla si; në Butrint, Apoloni, Berat, në Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër etj.

Por, dekadat e fundit qytete si Tirana, Durrësi apo Korça etj., janë mbipopulluar në mënyrë të skajshme, dhe tani sasia  $m^2$ /gjelbërim për banorë ka rënë ndjeshëm. Në një botë që sa vjen po mbipopullohet, gjelbërimi në përgjithësi dhe pylltaria urbane në veçanti së fundi janë bërë një domosdoshmëri jetike në zonat e banuara urbane.

Për pylltarinë urbane ka mjaft përcaktime; ai që e përcakton pylltarinë urbane si: arti, shkenca dhe teknologjia e menazhimit të drurëve/pemëve dhe burimeve pyjore në dhe përreth ekosistemeve të komunitetit urban për përfitimet fiziologjike, sociologjike, ekonomike dhe estetike që drurët/pemët i japin shoqërisë. Sipas FAO–Food and Agricultural Organization 2016, janë përcaktuar pesë lloje kryesore të pyjeve urbane.

Qëllimi i këtij studimi është të vërë në dukje rolin e rëndësishëm të gjelbërimit dhe pylltarisë urbane në lidhje me kontributin që ato japin në vendosjen dhe ruajtjen e ekuilibrave natyrorë dhe përmirësimin e jetesës të komuniteteve në zonat e urbanizuara.

*Fjalë çelës: Pylltari urbane, drurë, urban, përfitime, qytete, shoqëri.*

### **Abstract**

Human society has gone through different stages in its spiral of development. The transition from the medieval era to that of civilization also brought the birth of urban centers, where humanity began to socialize. In recent decades the world has become more urbanized. About 50% of the population lived in urban areas in the 80s, and is projected to reach about 70% by 2050. In addition to roads, palaces, hospitals, schools, etc., this overcrowding needs more greenery, including trees and shrubs. Many leaders, monarchs once went hunting, nature walks, and then built forest gardens in residential areas, thus bringing nature to the city. Magnificent gardens were created from ancient Athens and Rome, but also in England, France, Germany, Austria, USA, etc.

In ancient settlements in our country, since ancient times the presence of greenery, trees can be noticed, this from archaeological discoveries, writings of foreign travelers, photos or drawings and ancient carvings in stone and wood. Trees are found near cemeteries eg cypress, plane; in the vicinity of churches, mosques; public buildings; near the bazaars, shops, palaces or houses of prominent reach peoples, in the various squares of many of the cities of our country; on the streets, inside the castles, in the yards, and windows of civic families, there was no lack of flowers and greenery. Elements of greenery have

been observed since ancient times, settlements such as; in Butrint, Apoloni, Berat, in Elbasan, Durrës, Lezha, Shkodra, etc.

But, in recent decade's cities like Tirana, Durrës or Korça, etc. has been extremely overcrowded, and now the amount of m<sup>2</sup> of greenery has dropped significantly. In a world that is becoming increasingly overcrowded, greenery in general and urban forestry in particular has recently become a vital necessity in urban residential areas.

For Urban Forestry, there are many definitions; but the defines Urban Forestry is used as: art, science and technology of management of trees and forest resources in and around the ecosystems of the urban community for the physiological, sociological, economic and aesthetic benefits that trees give to society. According to FAO-Food and Agricultural Organization 2016, five main types of urban forests have been identified.

The purpose of this study is to highlight the role and importance of greenery and Urban Forestry in relation to the contribution they make in establishing and preserving natural balances and improving the lives of communities in urbanized areas.

*Keywords: Urban forestry, trees, urban, benefits, cities, society.*

## I. Hyrje

Shoqëria njerëzore në spiralen e saj të zhvillimit ka kaluar stadi të ndryshme, por ajo që duhet theksuar është se në fazat e para të lindjes së saj njeriu ka qenë më afër natyrës, pra jetonte në natyrë dhe me natyrën. Konijnendijk thekson se: “çdo gjë që njerëzit bëjnë, dhe idetë tona për botën natyrore, ekzistojnë në një kontekst që është historikisht, gjeografikisht dhe kulturalisht i veçantë dhe nuk mund të kuptohen veçmas nga ai kontekst” (Konijnendijk, 2008).

Kështu, në stadi të para të shoqërisë njerëzore ai jetonte me pyjet, shpellat, natyrën në përgjithësi, ku gjente strehë, ushqim dhe kushte apo mjete minimale jetese, gjithnjë më shumë në luftë e konkurrencë të ashpër mjaft herë edhe me vetë natyrën apo botën tjetër të egër.

Kalimi nga epoka e mesjetës në atë të qytetërimit solli edhe lindjen e zhvillimit të qendrave urbane, ku njerëzimi filloi të

shoqërizohej dhe përfaqëson stadin më të lartë të shoqërisë njerëzore, ku tani njerëzit jetonin vërtet në familje të veçuara, por në të njëjtën kohë duke ndarë dhe përdorur mjaft gjëra të përbashkëta, si mjedise jo vetëm natyrore, por dhe në qendrat e urbanizuara. Kultura dhe natyra janë koncepte komplekse, veçanërisht kur lidhen me njëra-tjetrën (Konijnendijk, 2008).

Nga qendra të vogla banimi në fshatra, me kalimin e kohës në mjaft vende të globit, filluan të lindnin qytetet urbane dhe më vonë qytetet, si qendra urbane më moderne dhe stade më të larta të zhvillimit shoqëror në të gjitha drejtimet – ekonomike, sociale, shoqërore etj. Dhe me kalimin e dhjetëvjeçarëve shoqëria njerëzore filloi të popullonte më shumë qendrat urbane, për arsye nga më të ndryshmet. Kështu rreth viteve 1980 në mbarë botën (Harrison, & Pearce, 2000-AAAS), pothuajse rreth 50 % e popullsisë jetonte në zonat urbane në qytet/qyteza, dhe parashikohet që kjo shifër popullimi e zonave urbane të arrijë në rreth 70 % në harkun kohor të viteve 2050. Ky mbipopullim i zonave urbane, gjithnjë e më shumë, veç rrugëve, pallateve, spitaleve, shkollave etj., ka nevojë edhe për më shumë sipërfaqe të gjelbra, përfshi këtu edhe drurët dhe shkurret. Në botë janë krijuar sipërfaqe të vërteta gjelbërimi, me lule, bar, shkurre, drurë dhe pemë të ndryshme, fillimisht si nevojë estetike dhe më pas edhe për vetë funksionet e shumta që realizon ky gjelbërim në qytete. Ato janë si të aspektit ekologjik, por dhe në drejtim ekonomik, fiziologjik, social, estetik etj.

Lindja e elementeve të pylltarisë urbane në mjaft qytete ka të bëjë me atë që fillimisht mjaft prijës, monarkë, udhëheqës nga gjuetia e shëtitjet që bënin në natyrë, filluan të ndërtonin edhe në zonat urbane kopshte apo sipërfaqe të mëdha me drurë e pyje, që frekuentoheshin fillimisht nga njerëz të caktuar, por në shumë vende u bënë ambiente të aksesueshme për krejt shoqërinë. Deri në shekullin e 19-të, drurët e qytetit ishin një çështje private. Kopshtet

private u bënë vendet e para pothuajse publike; mes tyre ato ishin të hapura për pjesë të publikut (*Konijnendijk, 2008*).

Pra, në pamundësi që të shkonin vazhdimisht në natyrë, në male etj., ata tentuan në një kuptim figurativ të sillnin natyrën në qytet, në zonat urbane. Kështu u krijuan kopshte të bukura apo dhe pyje të vërteta, qysh nga Athina e Roma e lashtë, në Greqi dhe Itali, por dhe në Angli, Francë, Gjermani, Austri, deri te parku i madh i New York-ut në SHBA etj.

Edhe në vendin tonë, në mjaft qendra të banuara, qysh në lashtësi, vërehet prania e gjelbërimit dhe me konkretisht e drurëve dhe shkurreve në gjelbërimin e vendbanimeve të hershme. Kjo rezulton edhe nga zbulimet arkeologjike, por edhe nga gjendja reale e disa vendbanimeve tona të lashta.

Pavarësisht se këto nuk zhvilloheshin nën emërtimin e *pylltarisë urbane*, e rëndësishme është se drurët dhe shkurret kanë qenë vazhdimisht në vendjetesat shqiptare e të paraardhësve tanë. Shqipëria, për vetë pozicionin e saj gjeografik dhe kushtet klimatike, i qëndron përcaktimit se: janë të rralla vendet në botë të krahasueshme me Shqipërinë për nga sipërfaqja me larmi natyrore kaq të madhe, cilësuar me të drejtë “muze i madh natyre” (*Sala et al, 2021*).

Prania e drurëve dhe e shkurreve vihej re në qytete në forma nga më të ndryshmet dhe më konkretisht mund të përmendim disa prej tyre si; pranë varrezave ka pasur vazhdimisht gjelbërim dhe drurë, si: selvi, rrape, e deri lisa të mëdhenj në Lezhë apo Apoloni; pranë objekteve të kultit kishave, xhamive etj.; pranë objekteve publike dhe administrative; pranë pazareve apo dyqaneve që organizoheshin në vendbanimet dhe qytete në ditë të caktuara të javës; afër ndërtesave, sarajeve apo shtëpive të njerëzve të shquar dhe të pasur; parisë së vendit; në sheshet e ndryshme të disa prej qyteteve të vendit; në anë të rrugëve dhe rrugicave nëpër qytete apo vendbanime të ndryshme; në afërsi apo brendësi të kalave apo



fortifikimeve etj. Pa diskutim elemente të dukshme të gjelbërimit urban shfaqeshin në çdo oborr apo kopshtije të shtëpive private në qytete apo vendbanime të shqiptarëve, ashtu si nuk mungonin kurrsesi lulet në oborret apo dritaret e shumë prej familjeve tashmë qytetare. Këto elemente të gjelbërimit dhe *pylltarisë urbane* janë vërejtur qysh në kohë të lashta, me gjurmë të dukshme dhe sot në qytete dhe vendbanime, si: në Butrint, në Berat, Voskopojë, në Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër etj. (*Haska, 2021; Haska, 2022*).

## II. Hapësira e studimit

Përfshin në përgjithësi territore dhe zona të urbanizuara të vendit, dhe më konkretisht disa nga qytetet më kryesore si Tirana, por hedh një vështrim të shpejtë edhe më gjerë mbi disa zhvillime të gjelbërimit dhe *pylltarisë urbane* edhe në disa qytete kryesore në Europë dhe me gjerë: New York, Chicago, Florida etj. Marrëdhënia midis qyteteve, duke përfshirë format e tyre më "*urbane*" të hapësirës së gjelbër urbane, dhe pyjeve ka qenë komplekse (*Konijnendijk, 2008*)

Qendrat tona të banuara urbane, në arkitekturën e tyre ndërtimore gjithnjë e më shumë, përveç hapësirave të aktivitetit kryesor prodhues dhe jetësor të popullsisë së tyre, po planifikojnë në planet e tyre zhvillimore dhe po realizojnë sipërfaqe të gjelbra, dhe më konkretisht sipërfaqe të mbuluara me drurë dhe shkurre që tani kanë fituar qytetarinë duke u quajtur pylltari urbane në rrethet shkencore dhe në mbarë komunitetet që banojnë në qyteza të vogla dhe qytete të mëdha me popullsi mijëra banorësh si Tirana etj.

## III. Metoda

Lidhja midis qendrave të banuara urbane dhe gjelbërimit është sa e vjetër, por edhe po aq e domosdoshme dhe sa vjen e bëhet më domethënëse. Nuk mund të kuptohen objekte apo hapësira

ndërtimore, institucione të tilla si rrugë, stadione, shkolla etj. pa u shoqëruar me gjelbërim dhe pylltari urbane. Raportet midis hapësirës ndërtimore dhe asaj të gjelbër synohet që të shkojnë në favor të gjelbërimit. Përveç sipërfaqeve të gjelbra kryesisht me bar dhe lule, filluan të lindin dhe ato që u quajtën pylli i qytetit. Pyjet e qytetit janë peizazhe pyjore kulturore që janë konstruksione sociale dhe kulturore, të krijuara në pikëtakim të kulturës dhe natyrës, të këndvështrimit njerëzor dhe jonjerëzor. Nga perspektiva eksperimentale, ato mund të jenë të dyja, hapësirë dhe vend (Konijnendijk, 2008)

Kjo dukuri, në dekadat e fundit, po vihet re edhe në Shqipëri. Në planet zhvillimore të qyteteve të vendit nuk po i kushtohet rëndësi vetëm anës arkitekturore ndërtimore, por dhe botës së gjelbër, duke i parë të lidhura ngushtë raportet midis sipërfaqeve ndërtimore dhe të gjelbra dhe duke favorizuar në mjaft raste këto të fundit.

Marrëdhënia e ngushtë midis trashëgimisë natyrore dhe komuniteteve njerëzore është analizuar në këtë artikull. Për realizimin e këtij punimi jemi bazuar në një metodë të thjeshtë dhe efektive, pra në analizën e periudhave të ndryshme kohore: fazat e hershme të antikitetit, gjatë mesjetës, pas pavarësisë kombëtare, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, gjatë regjimit komunist dhe pas vitit 1990. U analizuan zhvillimet pyjore urbane në vend, sidomos në qytetin e Tiranës.

Metodologjia konsiston në mbledhjen dhe analizën e të dhënave që lidhen me pylltarinë urbane në disa zona urbane, qytetet kryesore në Shqipëri, duke i parë këto elemente të pylltarisë urbane në krahasim me vende të tjera të zhvilluara; me normat e gjelbërimit të nevojshëm për banor dhe shërbimet e pyjeve urbane për popullsinë e qyteteve dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve natyrore. Janë dhënë disa konkluzione dhe rekomandime për të përmirësuar elementet e pylltarisë urbane në

funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së ekosistemeve natyrore në zonat urbane dhe cilësinë e jetës së komuniteteve në këto zona urbane. Natyrisht, pyjet e qyteteve karakterizohen nga lidhjet e tyre të ngushta ekonomike, por edhe kulturore dhe sociale, të parë në një qytet të caktuar. Kjo marrëdhënie e ngushtë është shpesh rezultat i një historie të gjatë (*Konijnendijk, 2008*).

## IV Rezultate

### *IV.1. Gjelbërimi dhe pylltaria urbane në Europë dhe më gjerë.*

Si në mjaft fusha të jetës, edhe problemet e gjelbërimit urban dhe të pylltarisë urbane i kanë fillësat në mjaft qytete të Europës, qysh nga antikiteti deri sot, pavarësisht se nuk ishin nën emërtimet gjelbërim urban apo pylltari urbane, por quheshin përsëri kopshte të gjelbra etj.

Drurët/pemët, pyjet dhe zonat pyjore kanë kohë që janë lidhur me qytetet europiane. Toponime të tilla si rrapet e Londrës, pishat e Romës dhe të Vjenës, Woods (*Wienerwald*), tregojnë se si drurët/pemët janë bërë pjesë e fjalorit të qyteteve. Qytetet janë zgjeruar në periferinë e tyre me zona pyjore, si: pyjet Epping në Londër dhe në Foret de Soignes në Bruksel; Bois de Boulogne dhe Bois de Vincennes në Paris dhe Kenwood në Londër, për t'u bërë më pas një nga parqet urbane më të rëndësishëm. Drurët/pemët u kanë dhënë emrin e tyre mjaft rrugëve: Unter den Linden në Berlin (*Konijnendijk, et al, 2005*) etj.

Qysh në lashtësi shfaqen drurët dhe pyjet në/ose afër qyteteve, pra fillon ajo që quhet “a History of Urban Forests and Trees in Europe” (*Konijnendijk, et al, 2005*). Kjo ka kaluar nëpër disa etapa zhvillimi: përmenden pyjet në Greqinë antike, pyjet në mesjetë sidomos në shekujt e 17-të dhe të 18-të. Në Greqi u zbulua një dekret i gdhendur në një pllakë varri Gazoros e vitit 158 pas Krishtit, ku jepet mbjellja e drurëve. Pyjet mesjetare të ruajtura në

disa vende europiane: Angli, Francë, Belgjikë, Gjermani etj., janë vlera të mëdha urbane (*Konijnendijk, et al 2005*).

Në shekullin e 17-të dhe të 18-të pyjet ekzistuese u shndërruan dhe u transformuan edhe me mbjellje të reja në afërsi të qyteteve, dhe pati frekuentim dhe përdorim kryesisht nga aristokracia dhe më vonë nga tregtarët e pasur për qëllime rekreative. Në Francë u ridisenjuan Foret de Saint-Germain, Bois de Boulogne dhe Rambouillet afër Parisit. Filluan të futen modelet Star ose Resaux Etoiles, për të lehtësuar gjuetinë (*Konijnendijk, et al 2005*). Sot këto modele disenjimi të pyjeve urbane shfrytëzohen për zbutjen e të ashtuquajturit efektit “hot islands”, pra për futjen e ajrit të freskët nga rrethinat e qyteteve në qendër të tyre, ku ajri i nxehtë ngrihet lart, duke siguruar shkëmbimin e domosdoshëm dhe zbutjen e efektit të “hot island”. Ky efekt shfaqet në shumë qytete me qendra të nxehta, ndërsa rrethinat e tyre janë më të freskëta (*Haska, 2021; Haska, 2022*).

Pas Luftës së Dytë Botërore, kur filloi bumi industrial dhe u rritën kërkesat për lëndë drusore, u shtua prerja e pyjeve. Në mjaft vende të Europës dhe të botës filluan të mbilleshin pyje jo vetëm për lëndë drusore, por edhe në zonat urbane ku po përdreshin për funksionet e tyre estetike dhe rekreative. U krijuan zona të gjelbra ku u ndaluan ndërtimet dhe breza të gjelbër me drurë dhe pyje përreth qyteteve. Kështu: Mbretëresha Elisabeth në Londër, në fillim të vitit 1580 përcaktoi një brez të tillë të gjelbër tre milje; Këshilli i qytetit të Vienës më 1905 caktoi mbi 4 000 ha pyje me funksione ekologjike dhe rekreacioni të qytetarëve; në Holandë u planifikuan zhvillime urbane në formën e “*yjeve të gjelbër*”, të përbërë nga pyje, hapësira të hapura dhe sipërfaqe ujore me funksione rekreacioni (*Konijnendijk, et al 2005*).

Dekada më vonë, vende të tjera si: Belgjika, Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar filluan programin e pyllëzimit urban. Amsterdamse Bos, i themeluar në fillim të viteve 1930, pas Luftës

së Dytë Botërore u zhvillua sipas modelit të "yjeve të gjelbra", të përbërë nga pyje, zona të hapura dhe sipërfaqe ujore sa më afër me qendrat urbane. Këto u analizuan me detaje në punime serioze të botuara dekadat e fundit (*Konijnendijk, et al 2005*).

Ka mjaft piktura, gravura, vizatime apo gjetje të ndryshme arkeologjike që tregojnë drurë, lule, gjelbërime në ambiente aristokrate dhe publike. Interesante është piktura e titulluar *Pranvera – Spring* pikturuar nga Pieter Breughel (1525–1569) dhe riprodhuar nga J. Cock në vitin 1570. Kjo pikturë pasqyron në plan të parë njerëzit duke mbjellë, ndërsa shtëpitë në sfond janë të rrethuara me drurë/pemë dhe disi në perspektivë duken zonat dhe sipërfaqet pyjore (*Konijnendijk, et al 2005*).



Pikturë nga Pieter Breughel (1525–1569) "Spring-Pranvera"  
(Riprodhuar nga J. Cock, 1570)

Si përfundim, theksojmë se Europa, ky kontinent i vjetër, por mjaft i zhvilluar në qytetërimet e tij, në etapa kohore të ndryshme ka dhënë ndihmesë të madhe si në fillesat, edhe në konsolidimin e jetës urbane, të arkitekturës urbane, të gjelbërimit urban dhe zhvillimin e pylltarisë urbane. Këto ndihmesa, tani në kohet moderne, po kristalizohen si domosdoshmëri për mirëmenazhimin

dhe mbrojtjen e mjedisit; për përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve.




Foto 1. Pak tokë, por shumë drurë (Mrekullia Upsala, Suedi & Florida, US (H. Haska).



Foto 2. Pylltaria urbane brigjeve të Danubit, Belgrade & bli nën arborikulture, Bryzh, Belgjikë (H. Haska).




Foto 3. Marianska Lazne, Czechia & New Yourk, US (H.Haska)

#### IV.2 Përkufizime dhe koncepte të reja mbi pylltarinë urbane, FAO 2016

Pavarësisht emërtimeve, elemente të pylltarisë urbane janë shfaqur në botë qysh herët, por rreth viteve '80 përmendet termi *pylltari urbane*/Urban Forestry. Për pylltarinë urbane ka mjaft koncepte e përkufizime, por në rrethet shkencore më shumë përdoret përcaktimi i *Konijnendijk, et al 2005*: dhënë në Fjalorin e Pyjeve (Helms, 1998) ku pylltaria urbane është përshkruar sipas përcaktimit të zhvilluar nga Miller (1997), që e përcakton *pylltarinë urbane* - Urban Forestry si: *arti, shkenca dhe teknologjia e menazhimit të drurëve/pemëve dhe të burimeve pyjore në/dhe rreth ekosistemeve urbane komunitare për benefitet fiziologjike, sociologjike, ekonomike, estetike etj., që drurët/pemët i sigurojnë shoqërisë.*

Novak (2016) thekson: pyjet urbane përbëhen nga të gjithë drurët brenda tokave tona urbane. Përkufizimi konceptualisht shtrihet duke përfshirë komponentët e ndryshëm të ekosistemit që shoqërojnë këta drurë (tokat ose flora e nënkatit), megjithëse ne nuk i identifikojmë në mënyrë të qartë të gjithë këta përbërës. Pyjet urbane mund të përmbajnë grumbuj të pyllëzuar, si në zonat rurale, por ato përmbajnë gjithashtu drurë që gjenden përgjatë rrugëve, në zona banimi, në parqe dhe në përdorime të tjera të tokës. Pyjet janë një përzierje e drurëve të mbjellë dhe atyre të rigjeneruar në mënyrë natyrale (Novak,2016)

Sipas FAO – Food and Agricultural Organization 2016 janë përcaktuar pesë lloje kryesore të pyjeve urbane dhe ne kemi realizuar studimin tonë në lidhje me përkufizime të tilla bashkëkohore dhe të njohura zyrtarisht. Pyjet urbane dhe drurët në qendrat urbane dhe në afërsi të tyre kanë një sërë benefitesh/përfitimesh dhe shërbimesh që i ofrojnë shoqërisë, por pa diskutim që në to nënvizohen ato për ruajtjen dhe mbështetjen e ekuilibrave natyrorë të ekosistemeve si dhe benefite të tilla të rëndësishme si ai i përmirësimit të jetës sociale dhe shëndetësore të shoqërisë dhe individit.

Në fakt, deri kohët e fundit, FAO, si një nga organizmat kryesorë që merret me pyjet në mbarë globin, ka pasur në fokus të saj vetëm pyjet me funksione prodhuese, pyjet që rriten në gjendje natyrore dhe plantacionet e mëdha të mbjella për qëllime prodhuese të lëndës drusore ose funksione të tjera prodhuese, pa pasur në fokus pyjet urbane. Vetëm në vitin 2016 pyjet urbane u vunë në fokusin e FAO-s, e cila ka hartuar edhe udhëzuesin për këtë problem. Disa nga çështjet më specifike të tij do t'i trajtojmë më poshtë.



#### IV.2.1. Çfarë është një pyll urban sipas FAO-s?

Të gjitha qytetet ndajnë një strukturë të ngjashme fizike (FAO, 2016), duke përfshirë infrastrukturën “gri” (p.sh. ndërtesat rezidenciale dhe industriale, rrugët, shërbimet dhe parkingjet), infrastrukturën blu (p.sh. lumenjtë, liqenet, pellgjet dhe kanalet e ujit) dhe infrastrukturën e gjelbër (drurët, shkurret dhe bari/kulloso në parqe, pyjet, kopshtet dhe rrugët). Optimizimi i ndërveprimeve midis këtyre elementeve është çelësi për riorganizimin apo ndërtimin e qyteteve të afta për t’iu përgjigjur sfidave urbane.

Pyjet urbane mund të përkufizohen si rrjete ose sisteme që përfshijnë të gjitha pyjet, grupet e drurëve/pemëve dhe drurët/pemët individuale të vendosura në zonat urbane dhe periurbane; ato përfshijnë, pra, pyjet, drurët/pemët e rrugëve, drurët/pemët në parqe dhe kopshte dhe drurë/pemë në vendet/pjesët/qoshet e braktisura. Pyjet urbane janë shtylla kurrizore e infrastrukturës së gjelbër, një urë lidhëse midis zonave rurale e atyre urbane, që përmirësojnë mjedisin e qytetit.

Ka shumë mënyra për të klasifikuar pyjet urbane, por FAO (2016) i grupon ato në pesë kategori/tipa, të cilët analizohen edhe sipas rëndësisë për adresimin e çështjeve specifike në mjediset urbane dhe ato peri-urbane. *Pylltaria urbane dhe periurbane është praktika e menazhimit të pyjeve urbane për të siguruar kontributin e tyre optimal në mirëqenien fiziologjike, sociologjike dhe ekonomike të shoqërive urbane. PUP është një qasje e integruar, ndërdisiplinore, pjesëmarrëse dhe strategjike për planifikimin dhe menazhimin e pyjeve dhe drurëve në dhe rreth qyteteve (FAO, 2016).*

Ai përfshin vlerësimin, planifikimin, mbjelljen, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe monitorimin e pyjeve urbane dhe mund të veprojë në shkallë që variojnë nga drurët e veçuar deri te peizazhet. Në *shkallë komunitare, PUP thekson angazhimin e qytetarëve urbanë në menazhimin e drurëve/pemëve private dhe publike, duke përfshirë*

*edukimin e tyre për vlerën dhe përfitimet e drurëve/pemëve dhe pyjeve dhe mbështetjen e pronësisë dhe përgjegjësisë së tyre të plotë për mjedisin rreth tyre.*

#### **IV.2.2. Kategoritë/tipat kryesorë të pyjeve urbane**

Ka shumë mënyra për të klasifikuar pyjet urbane, por sipas FAO (2016), ato grupohen në mënyrë të thjeshtuar në pesë kategori/tipa kryesorë:

##### *a. Pyjet periferike/periurbane dhe tokat/terrenet me drurë*

Sipas FAO-s (2016) në këtë kategori përfshihen: *Pyjet dhe tokat/terrenet me drurë përreth qyteteve dhe qytezave që mund të ofrojnë mallra dhe shërbime si druri, fibra, fruta, produkte të tjera pyjore jodrusore (PPJD), ujë të pastër, rekreacion dhe turizëm.* Kështu, në këtë kategori të pyjeve urbane mund të përfshihen pyje që janë në afërsi të qyteteve tona dhe që mund të klasifikohen si pyje periurbane, si pyjet e PK të Dajtit që i shërbejnë Tiranës për rekreacion, çlodhje, përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve që i frekuentojnë ato etj.

##### *b. Parqet e qytetit dhe pyjet urbane (>0.5 ha)*

Po sipas FAO-s, në këtë kategori përfshihen: *Parqe të mëdha urbane ose parqe distrikti me një larmi të mbulesës së tokës, dhe së paku pjesërisht të pajisura me objekte për kohën e lirë dhe rekreacion.* Në vendin tonë si shembuj konkretë përmenden: në Tiranë, Parku i Liqenit Artificial, Parku Rinia në Korçë, parku i Elbasanit, parku i Drilonit në Pogradec etj. Këta janë në brendësi të qendrave të banuara. Efektet e tyre janë më të dukshme, gjithmonë në aspektin rekreativ dhe çlodhës. Ndaj ato kanë një frekuentueshmëri tepër të lartë në periudha të ndryshme të vitit.

##### *c. Parqe dhe kopshte të vogla/xhepa me drurë (<0.5 ha)*

Këtu përfshihen - *Parqet e vogla të qytetit, lagjeve/rajonit të pajisura me objekte për rekreacion /kohë të lirë, kopshte private dhe hapësira të gjelbra.* Këtë tip të pylltarisë urbane e takojmë pothuajse në të gjitha

qytete e vendit, ku në çdo lagje apo kompleks banimi nuk mungojnë sipërfaqe me drurë deri në 5 dynymë ose më të vogla. Këto lloje pyjesh urbane janë shumë efektive sepse ato frekuentohen më shumë nga pleqtë dhe fëmijët, të cilët këtu gjejnë vendin ku të pushojnë, luajnë apo të plotësojnë nevojat e tyre rekreative, estetike dhe shëndetësore. Ky tip i pylltarisë urbane është mjaft i zhvilluar në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Rrëshen, Peshkopi.

*d. Drurët në rrugë ose në sheshet publike*

Kjo kategori përfshin: *drurë të vendosur në mënyrë lineare, grupe të vogla drurësh/pemësh, dhe drurë/pemë individuale në sheshe dhe parkingje, në rrugë etj.* Prej kohësh këta drurë janë përfshirë në termin e pylltarisë urbane, të përcaktuar drejt nga FAO. Shumë drurë janë mbjellë te ne përgjatë rrugëve, në trotuare, përreth shesheve, parkingjeve etj. Ky tip pylli urban siguron përfitime të mëdha, po sidomos hijezimin në periudhat e nxehta, ndërsa në dimër përreth tyre është më ngrohtë. Ato pastrojnë ajrin nga pluhuri, ulin zhurmat, janë habitate për jetën e egër dhe më kryesorja thithin gazin karbonik dhe prodhojnë oksigjen. Ky tip i pylltarisë urbane ekziston në të gjitha qytete tona.

*e. Hapësira të tjera të gjelbra me drurë*

Këtu përfshihen sipërfaqe dhe zona si ngastra bujqësore urbane, fusha sportive, toka të lira, lëndina, brigjet e lumenjve, fusha të hapura, varreza apo dhe kopshte botanike (FAO, 2016). Ky tip i pylltarisë urbane gjendet në mbarë botën dhe te ne. Kështu p.sh. sipërfaqe të tilla janë: Kopshti Botanik në Tiranë, Varrezat e Dëshmorëve dhe varrezat publike, tokat e tjera përreth qyteteve dhe brigjet e lumenjve të mbjella me drurë, pyjet e drurët në brigjet e liqenit të Ohrit, Shkodrës etj.

### IV.3. Gjelbërimi dhe pylltaria urbane në Shqipëri – një vështrim mbi qytetin e Tiranës

Në Shqipëri ekzistojnë bimë të ndryshme, habitate natyrore dhe ekosisteme si: shkurre, gjethegjerë, halorë dhe pyje të përziera, kullota, livadhe, shkëmbinj, zona bregdetare, lagunore, detare, liqene, lumenj, zona bujqësore dhe natyrisht urbane. Këtu rriten: rreth 30% e florës europiane, rreth 30 specie endemike dhe 160 specie subendemike. Rreth 36% e sipërfaqes totale të Shqipërisë është e mbuluar nga pyjet dhe sipas funksionit janë: 67 % prodhues, 11 % mbrojtës, 23 % biodiversitet. Ka një vijë bregdetare të gjatë, me plazhe të këndshme ranore dhe shkëmbore. Prej kohësh, por sidomos në periudhën e fundit, është në zhvillim e sipër dhe pylltaria urbane.

Nga zbulimet arkeologjike, por dhe nga jeta reale, mjaft vazo, kapitule kolonash, mozaikë etj., apo në mjaft vizatime të ndryshme ka lloje të ndryshme lulesh, gjethesh si: zambakë, dafina, ullinj, lis, palma etj., që tregojnë përdorimin e bimëve si elemente zbukuruese. Të shek. II janë rozetat dhe gjethet të vizatuara në mozaik (Apoloni) dhe në Antigone në shek. V-VI; palmat e pikturuara në vazo të shek. IV në Shkodër, ndërsa në Durrës dhe Ballsh u zbuluan vizatime gjethesh të Acanthit të gdhendur në gurin e kapituleve të shek. VI; në Berat u gjetën pjata porcelani me vizatime halash pishe, të shek. X-XIII. Gjethet e dafinës, lisit, janë zbuluar në kishën e Tiranës që daton shek. XII-XIV (*Haska, 2021; Haska, 2022*).

Dekadat e fundit në Shqipëri ka një koncept të ri, të ndryshëm nga përkufizimi tradicional për pyjet. Tani, pyjet nuk i quajmë vetëm ato që rriten në forma të “egra”, por edhe ato që rriten në zonat urbane/periferike. Pra ka një koncept të ri për zhvillimin e pyjeve urbane dhe menazhimin e tyre. Më konkretisht, pylltaria urbane shfaqet në Tiranë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Pogradec, Lezhë etj. Pylltaria urbane në Shqipëri ekziston në të

gjitha format; si pyje në zonat urbane, drurë të mbjellë në rrugë, grupe drurësh në zona publike dhe private etj. Janë mbjellë shumë lloje drurësh, duke përfshirë gjethegjërë, halorë, shkurre. Në disa qytete bëhet një inventar i thjeshtë i drurëve. Por, zhvillimi i pylltarisë urbane në Shqipëri ka dhe shumë sfida për të ardhmen. (Haska, 2021; Haska, 2022).



Foto 4: Mbi gjelbërimin urban dhe pylltarinë urbane në qytetin e Tiranës (H. Haska)

## V. Diskutim

Nga sa më sipër del se zhvillimet urbane i kanë domosdoshmëri elementet e gjelbërimit urban dhe të pylltarisë urbane për vendosjen e ekuilibrave natyrorë. Gjelbërimi urban shihet si element i rëndësishëm në mbajtjen pastër të qendrave të banuara, rehabilitimin e zonave të ndotura për të ulur ndikimet negative që vijnë nga aktivitete humane apo natyrore.

■ Një shembull i gjelbërimit dhe pylltarisë urbane është Tirana. Tirana është qyteti më i madh ekonomik, administrativ, politik, industrial, social, medial, akademik dhe kulturor në Shqipëri. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km<sup>2</sup>. Në Tiranë klima është mesdhetare, me temperatura mesatare vjetore rreth 16°C, e korrikut rreth 24°C dhe e janarit rreth 6 °C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297 mm.

■ Gjelbërimi urban ka qenë në Tiranë që nga krijimi i saj si qendër urbane. Si në mbarë Europën, edhe për Tiranën mund të flitet për pylltari urbane rreth viteve '70-'80-'90 të shekullit të kaluar. Disa tregues domethënës që merren në konsideratë në qytetin e Tiranës janë: sipërfaqja totale e gjelbërimit e mbjellë deri në fund të viteve 1990 ishte mbi 4 milionë m<sup>2</sup>, që përfshin zonat periferike; mbi 18 m<sup>2</sup> hapësirë e gjelbër për frymë. Por rritja e shpejtë e popullsisë nga 200,000 në mbi 650,000 dhe shkalla e lartë e dëmtimit të peizazhit të gjelbër uli ndjeshëm sipërfaqen e gjelbër për frymë, deri në rreth 4.2 m<sup>2</sup> (APRMT- 2017). Në vitet e fundit ka një angazhim dhe intensifikim të punës për të rritur numrin e drurëve të mbjellë në Tiranë dhe për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Punë e mirë me pylltarinë urbane vihet re dhe në qytete të tjera: Korçë, Shkodër, Pogradec, Rrëshen, Gramsh etj., Vlora po përdor në masë llojin *Rrap*, i cili emeton BOVC.

■ Vihen re forma të ndryshme të pylltarisë urbane të zhvilluara në Tiranë dhe në qyte të tjera si: parqe urbane, parqe me pyje periferike, grupe drurësh; drurë/shkurre në rrugë; drurë në trotuare, pranë institucioneve, në oborre të shtëpive private, pranë institucioneve fetare, varrezave etj., pra të gjitha tipat e pyjeve urbane, sipas përkufizimeve të FAO-s.

■ Sipas të dhënave të fundit (APRMT 2017), disa nga llojet kryesore të mbjella në Tiranë janë: rreth 46104 drurë dhe 19408 shkurre; sidomos fletorë me rreth 88.5 % e totalit, kurse te shkurret vetëm 5.7 % janë halorë, të tjerët janë fletorë; mbizotërojnë

gjetherënëset. Në foton nr.1 jepen disa pamje të pylltarisë e gjelbërimit urban në Tiranë. Sipas llojeve kryesore nga pamja dallohen: rrap (*Platanus*) 18 %, bli (*Tilia*) 11.6 %, akacie (*Acacia*) 9.3%, dushqe (*Quercus*) 8.1%, pisha (*Pinus*) 5.1%, ekualipte (*Eucaliptus*) 7%, panjë (*Acer*) 5.3 %, gështenjë kali dhe e butë (*Aesculus hippocastanum* L + *Castanea sativa* Mill) 5 %, selvi (*Cupressus sempervirens*) 5.3 %, frashër (*Fraxinus*) 5.3 % etj. Ndërsa nga shkurret: oleandër 26.1 %, trëndafil/*Rosaceae* 8.9 %, *Ligustrum* 10.6 %, dhe dafinë/*Laurus nobilis* L 5.3 % etj. Fatkeqësisht vazhdon të mbillet rrap, pra rreth 18 % e numrit të drurëve në Tiranë janë mbjellë me rrap që emeton *Biogenic Volatile Organic Compounds*, që dëmton e ndot ajrin në temperatura të larta. Vitet e fundit, kjo vihet re në Vlorë.

■ Ekzistojnë mënyra të ndryshme të menazhimit pylltarisë urbane. Legjislacioni për pyjet është përmirësuar vazhdimisht, por, fatkeqësisht, nuk trajtohen specifikisht pyjet urbane. Janë krijuar në Tiranë struktura specifike, si: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, e cila merret dhe me gjelbërimin urban, pyjet dhe drurët në qytet; ndërmarrjet përkatëse që kryejnë shërbimet. Në qytetet e tjera ky organizim dhe këto struktura lënë për të dëshiruar.

*Ekzistojnë probleme dhe sfida, që duhen adresuar dhe zgjidhur në të ardhmen:*

■ Problem kryesor është mosrespektimi si duhet i kritereve të përzgjedhjes së llojeve drusore dhe shkurreve në mbjelljet e pyjeve urbane. Këto lloje janë krejt të ndryshme nga llojet që zgjedhim për mbjelljet në pyjet tradicionale, në pyjet e Bizës, Vermoshit, Gramozit etj. Ndër kriteret specifike të përzgjedhjes së specieve drusore dhe shkurreve për zonat urbane mund të përmendim: përshtatjen klimatike, karakteristikat estetike, potencialin dhe formën e rritjes, rezistencën ndaj sëmundjeve, plasticitetin e madh, cilësinë e rrënjëve, rezistencën ndaj erës dhe thyerjes së degëve,

rezistencën ndaj thatësisirës, tolerancën ndaj ndotjes së ajrit, të mos emetojnë elemente që ndotin ajrin, të tërheqin zogj dhe shpendë të këndshëm. Këta shpendë nuk duhet të sjellin shqetësime në qytet me britmat apo ndotjet e tyre, të mos jenë bartës të sëmundjeve apo dëmtuesve, mundësisht të jenë specie native, vendëse; të bëhet kombinimi i halorëve me fletorë, gjetherënës me gjethembajtës; të mos çelin lule të gjithë në të njëjtën kohë; të krijojnë habitate për jetën e egër, por të pranueshme në ambientet urbane dhe jo të bëhen strehë për zvarranikë, brejtës etj., që mund të na rrezikojnë jetën e njerëzve. Duhet të merren në konsideratë edhe faktorët socialë, pra lagjja, institucioni, vendi ku do mbillen etj. (*Haska, 2021; Haska, 2022*).

■ Kriter tjetër bashkëkohor është që të mos zgjidhen drurë dhe shkurre që emetojnë elemente ndotëse të ajrit. Dihet që drurët dhe shkurret thithin CO<sub>2</sub> dhe shumë ndotës të tjerë të atmosferës. Por studimet e fundit tregojnë se ato emetojnë Biogenic Volatile Organic Compounds (BVOC), ose *komponime organike të paqëndrueshme biogjene* (Calfapietra et al, 2013). Theksojmë se kushtet klimatike dhe përbërja specifike e pyjeve urbane, në veçanti, ndikojnë në thithjen dhe emetimet e gazrave si në aspektin cilësor, ashtu edhe në atë sasior, duke ndikuar përfundimisht në përbërjen e atmosferës dhe në cilësinë e ajrit në mjediset urbane. Gjithashtu, sasia e ndotësve të përthithur ose BVOC-ve të emetuara varet nga speciet dhe kushtet mjedisore. Emetimet prej drurëve të komponimeve organike të paqëndrueshme mund të kontribuojnë në formimin e ozonit dhe të monoksidit të karbonit (*Novak, 2000*). Rekomandohet që druri i blirit (*Tilia*) të futet në masë në gjelbërimin dhe pyllëzimin në qytet, sepse plotëson një seri kriteresh, përfshi edhe mosemetimin e BVOC (*Haska, 2021*).

Problem përbëjnë llojet invazive, madje në disa qytete edhe mbillen. Theksuam se kriter është të zgjidhen lloje native, vendëse. Ne kemi shumë lloje të tilla. Vetëm në raste specifike mund të



futen lloje dekorative që më vonë fitojnë edhe të drejtën e qytetarisë, si manjolja. Por është e pafalshme prania në qytete e llojeve invazive si: Arra e hindit (*Ailanthus altissima*), në mjaft hapësira në Tiranë, Shkodër etj. Po ashtu, mund të flasim edhe për Panjën Amerikane (*Acer Negundo*), një lloj invaziv i cili në Amerikë është kufizuar në maksimum, kurse ajo mbillet në Tiranë, Elbasan, Gramsh etj., *Agaven invazive* në mjaft qytete. U duhet thënë ndal llojeve invazive në qytetet tona.

### **Përfundime**

- Elementet e gjelbërimit urban vërehen qysh në kohët e hershme, në qytetet antike (Butrinti, Apolonia etj), në qytetet mijëvjeçare (Berati, Gjirokastra etj.), në Shkodër në periudhën austro-hungareze, Korçë në periudhën franceze, por dhe në Vlorë dhe veçanërisht në Tiranë.

- Në dekadat e fundit është shumë më i dukshëm zhvillimi i pylltarisë urbane, sidomos në Tiranë.

- Është domosdoshmëri futja e koncepteve të reja për pylltarinë urbane, ndërgjegjësimi për përfitimet që vijnë prej saj etj. Në vendin tonë ende nuk ka njohuri të qëndrueshme për pylltarinë urbane, për parimet dhe elementet kryesore të zhvillimit të saj; janë ende të paktë përfaqësuesit me njohuri të plota për pylltarinë urbane.

- Mungesa e kapaciteteve teknike në qytete për të menazhuar pylltarinë urbane vihet re në gjitha qytetet tona kryesore, përfshi edhe Tiranën.

- Pylltaria urbane nuk mund të zhvillohet pa kapacitete njerëzore dhe burime financiare. Ende në asnjë institucion arsimor nuk ka kurrikul të plotë për përgatitjen e specialistëve të disenjimit dhe zhvillimit të pylltarisë urbane. Nevojiten burime financiare që të zbatohet kjo disiplinë e cila të merret me krijimin, zhvillimin dhe menazhimin e pyjeve urbane në qytetet tona.

- Domosdoshmëri del censusi, inventarizimi i plotë i drurëve dhe shkurreve në qytetet tona. Bazuar në metodologji bashkëkohore të bëhet census-inventarizimi i plotë në pylltarinë urbane për qytetet kryesore. Bazuar në një skedë bashkëkohore, që përfshin treguesit dendrometrikë shëndetësorë etj., të skedohen të gjithë drurët e rritur në qytete dhe të informatizohen në databaza. Për këtë të shfrytëzohet eksperiencia bashkëkohore e Çekisë dhe sidomos eksperiencia e Arboretum Mortum, që ka realizuar censusin 2020 për Çikagon, bashkëpunues me autorin e artikullit.

- Mangësi kryesore është mungesa e legjislacionit kuadër specifik për pylltarinë urbane. Duhet që institucionet përgjegjëse të hartojnë draftligj të veçantë për pylltarinë urbane, i cili të diskutohet me grupet e interesit dhe qeverisjen vendore. Po ashtu, të plotësohet edhe me akte nënligjore: VKM, udhëzime, rregullore etj. Nëpërmjet skemave stimuluese/subvencionime të nxitet zbatimi i politikave qeverisëse në pylltarinë urbane sipas parimeve dhe principeve të saj.

- Mungesa e koherencës në kuadrin ligjor për pylltarinë urbane, ka sjellë dhe mbivendosje të përgjegjësive, roleve dhe të drejtave të pushtetit qendror dhe vendor. Kjo duhet të koordinohet më mirë që secili të marrë përgjegjësitë e tij; të sigurohet pjesëmarrja e komuniteteve dhe e shoqërisë civile, pa të cilat pylltaria urbane nuk mund të kuptohet. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrin ligjor dhe krijimi i strukturave moderne për pylltarinë urbane duhet të realizohet konform eksperiencave europiane dhe më gjerë, dhe zhvillimeve bashkëkohore. Duhet struktura të posaçme që të hartojnë dokumentacionin për pylltarinë urbane, por edhe të menazhojnë pyjet urbane.

- Ka mungesa të disenjatorëve dhe projektuesve posaçërisht për pylltarinë urbane. Kur hartohen projekte për zhvillimin afatgjatë të rajoneve urbane marrin pjesë specialistë, si: arkitektë, inxhinierë ndërtimi, hidrologë, inxhinierë elektrikë, ekonomistë etj., por nuk

ka disenjues ose projektues specifike për pyje urbane. Ndaj duhet të përfshihen patjetër dhe projektues, disenjatorë specialiste të pylltarisë urbane në hartimin e planeve të zhvillimit të qyteteve.

- Në menazhimin e sipërfaqeve me pyje urbane të zbatohen metoda bashkëkohore dhe specifike. Menazhimi strategjik, taktik e operacional janë të lidhur ngushtësisht dhe kanë specifikimet e tyre.

### **Literatura:**

Konijnendijk, C, (2008), "The Forests and the City" The Cultural Landscape of Urban Woodland, Springer.

Konijnendijk, C., et al (2005), "Urban Forests and Trees", 520, Publisher Springer-Verlag, Springer

Novak., J. D., (2000): "Tree species selection, design and management to improve air quality"; Construction Technology, ASLA Annual Meeting PROCEEDINGS.

Calfapietra, C., et al (2013): "Role of Biogenic Volatile Organic Compounds (BVOC) emitted by urban trees on ozone concentration in cities: A review" - Environmental Pollution 183, 71-80., Elsevier.

APRMT 2017, Agency of Parks and Recreation, Municipality of Tirana, given data by e-mail, Neshat Cela, <[neshatcela@hotmail.com](mailto:neshatcela@hotmail.com)> 1 April 1, 2017.

FAO, (2016), *Guidelines on urban and peri-urban forestry*, by F. Salbitano, S. Borelli, M. Conigliaro e al.

Haska, H., (2021), "Urban greening&Urban forestry-Gjelberimi urban&Pylltaria urbane, Tiranë, 2008-2022 (In Press)

Haska, H., (2022), "Silvikultura dhe Pylltaria urbane", Skripte leksionesh, UBT, FSHP, Tiranë.

Novak, J. D., (2016) - Assessing the Sustainability of Agricultural and Urban Forests in the United States, Charter 4- Urban Forests.

Harrison, P., Pearce, F., (2000). AAAS- "Atlas of Population and Environment". American Association for the Advancement of Science, University of California Press, Victoria Dompka Markham, editor, 215 p.

Sala S, Qiriazi P, Nikolli P. Trashëgimia natyrore dhe peizazhet tërheqëse të bashkisë së Tiranës, 2021.

**Prof. dr. Sherif Lushaj<sup>1</sup>**

**Prof. dr. Vezir Muharremaj<sup>2</sup>**

## **HAPËSIRAT E GJELBRA NË FUNKSION TË QËNDRUESHMËRISË SË QYTETEVE**

### **Abstrakt**

Gjelbërimi i qyteteve është kthyer në një sfidë globale në kushtet e rritjes së popullsisë urbane, të ndotjes nga shkarkimet në mjedis, veçanërisht nga transporti në rritje, shtimi i sasisë të mbetjeve urbane dhe si një instrument në qëndrueshmërinë e qyteteve, përmirësimin e cilësisë të ajrit, peizazhit urban dhe cilësisë së jetës së komuniteteve. Rritja e qyteteve të Shqipërisë, urbanizimi i shpejtë dhe informal, kanë bërë që në krahasim me vitin 1990 sipërfaqet e gjelbra për banor të ulen në kufirin kritik, si dhe plotësimi i shërbimeve mjedisore të jetë në nivele të ulëta. Punimi do të fokusohet kryesisht në vlerësimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Tiranës, me popullsi rreth 25 % e popullsisë së përgjithshme të vendit dhe që aktualisht disponon sipërfaqe të gjelbër të ulët për çdo banor, nga 12.5 m<sup>2</sup> në vitin 1990, nga norma prej 7 m<sup>2</sup> e planifikuar vite më parë, ose 9 m<sup>2</sup> në qytetet europiane.

Analiza përfshin të dhëna mbi dinamikën e gjelbërimit dhe shpërndarjen në territorin e qytetit të Tiranës, konceptin e gjelbërimit në reduktimin e ndikimeve në ndotjen e ajrit, në formimin e peizazhit urban, shërbimet mjedisore dhe shëndetin publik si dhe përfshirjen e objektivave të së ardhmes të gjelbërimit të sipërfaqeve të lira. Megjithëse Tirana ka njohur në këto vite të transformimit devijime nga një plan i rregullt zhvillimi dhe ulje drastike të sipërfaqes së gjelbër, përsëri ofron progres në elemente të gjelbërimit, ofron mundësi lidhur me gjelbërimin në hapësirat e lira publike dhe në harmoni me zhvillimin e përgjithshëm të qytetit dhe cilësinë e mjedisit. Gjelbërimi periferik nuk mund ta zëvendësojë gjelbërimin brenda qytetit, mbrojtjen dhe mbarëshkrimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësirave të lira publike në funksion të gjelbërimit, shtrirjen e gjelbërimit në njësitë bashkiake për të arritur normat e gjelbërimit të qytetit.

---

<sup>1</sup> *Universiteti Polis, E-mail: sherif\_lushaj@universitetipolis.edu.al*

<sup>2</sup> *Profesor, Ekspert i pyjeve*

*Fjalë çelës: qëndrueshmëri e qyteteve, gjelbërim, normë gjelbërimi, koncepti i gjelbërimit, sipërfaqe të lira, mjedis.*

### **Abstract**

Urban greenery has become a global challenge, in terms of population growth, air pollution from emissions into the environment, especially from increasing transport, increasing the amount of urban waste, and as an instrument in improving air quality, urban landscape, and quality of life of communities. The growth of Albanian cities, rapid urbanization, and informality have made, compared to 1990, green areas decrease to critical limits as well as the provision of environmental services at low levels. The presentation will focus mainly on the assessment of green areas in the city of Tirana with a population of about 25% of the total population of the country, which has very low / green area per inhabitant, from 12 m<sup>2</sup> in 1990, or the norm of 7 m<sup>2</sup> planned years ago or 9 m<sup>2</sup> in European cities. The analysis will include data on the green area and distribution in the territory of the city of Tirana, the concept of greenery in reducing impacts on air pollution, in the formation of the urban landscape, environmental services, and public health as well as the inclusion of future objectives of greenery of free areas in the General Local Plan of the Municipality of Tirana. Although Tirana has known in these years of transformation deviations from a regular development plan and drastic reduction of the green area. Again, some opportunities will be presented regarding the increase of green areas in free public spaces and harmony with the general development of the city and environmental quality, Suburban greenery cannot replace greenery within the city. This presentation will be brought about a need the legal improvements for the protection of green areas and free areas in the function of greenery, the extension of greenery in municipal units, and the goal to achieve the norms of greenery in the city.

*Keywords: green sustainability of cities, greenery norm, greenery concept, free areas, environment*

## **I. Hyrje**

Gjelbërimi urban, si një tërësi e drurëve të rrugëve të qytetit, parqet, lulishtet, pylli urban, kopshtet e shtëpive, drurë të veçuar, grumbuj drurësh që ndodhen brenda dhe në periferi të qendrave urbane, mbart vlera ekonomike, sociale, mjedisore e shëndetësore dhe përfitime mjedisore e shoqërore për banorët e qytetit. Gjelbërimi urban është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës urbane, me ndikim të theksuar në qëndrueshmërinë e qyteteve dhe përmirësimin e cilësisë të jetës. Është një aspekt i rëndësishëm i planifikimit për shkak të rëndësisë së hapësirave të gjelbra në gjendjen mjedisore dhe mirëqenies së banorëve në zonat urbane.

Gjelbërimi urban është faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm urban, edhe si pjesë e planifikimit urban të qyteteve dhe qendrave të banuara që po zmadhohen me shpejtësi. Sipas OKB-së, në vitin 2050 rreth 68-70% e popullsisë botërore do të jetojë në zonat urbane dhe deri në vitin 2030 parashikohet rritja numerike e qyteteve me popullsi të lartë. Autorët citojnë se:

*“Në vitin 1800 kishte vetëm një qytet me një milion banorë. Deri në vitin 1990, 100 qytetet më të mëdha të botës strehonin 540 milionë njerëz dhe 220 milionë njerëz jetonin në 20 qytetet më të mëdha, me mbi 10 milionë banorë” (Deelstra & Girarde, 2021, f. 43 )*

Afërsia me natyrën është vendimtare për mirëqenien psikologjike njerëzore në qytete dhe zonat e banuara. Sipas literaturës thuhet se: *“Hapësirat e gjelbra urbane, ofrojnë një sërë përfitimesh për shëndetin e njeriut, duke përfshirë jetëgjatësinë, mirëqenien fizike dhe mendore, fuqinë e trurit dhe zhvillimin e fëmijëve, të gjitha të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik” (Jansson, 2014, f.142).*

Në mjediset urbane funksionet e sipërfaqeve të gjelbra janë të orientuara ndaj nevojave të njerëzve si p.sh. hijezim, çlodhje, vlera peizazhike, mbajtje e reshjeve të shiut, mbrojtjen e tokës nga erozioni, pengimin e erës dhe ofrimin e një mjedisi rekreativ. Qytetet në mungesë të gjelbërimit janë më të nxehta. Ndërtesat, asfalti dhe betoni, ku gjatë stinës së verës temperatura e sipërfaqeve shkon deri në 45° C, përthithin rrezatimin diellor dhe më pas e lëshojnë atë si nxehtësi, duke shkaktuar ngritjen e temperaturës së qytetit. Në literaturë theksohet se: *“Sistemet vertikale të gjelbërimit mund të përkufizohen si struktura që lejojnë bimësinë të përhapet mbi një fasadë ndërtese ose mur të brendshëm” (Urrestarazu et al. 2015, f. 66).*

Në Shqipëri, tarracat e gjelbra janë në fillësat e zbatimit. Ndërsa në sipërfaqet e gjelbra temperaturat variojnë në 21-25° C. Studimet tregojnë se bimësia e ul temperaturën e sipërfaqes gjatë verës me

rreth 7° C, gjë e cila ndihmon në pakësimin e përdorimit të ajrit të kondicionuar me rreth 50%. Drurët e shkurret, duke funksionuar si perde izoluese mund të pakësojnë edhe ndotjen akustike.

Zgjerimi dhe rritja e popullsisë urbane në qytetet e mëdha ndeshet me probleme të ndërtimeve informale brenda qyteteve dhe në periferi të tyre dhe kjo shkakton probleme të mprehta mjedisore si ndotjen e mjedisit, shtimin e sasisë dhe efekteve të mbetjeve urbane, shkarkimeve të larta nga transporti në atmosferë, probleme të shëndetit publik, prirje të ndryshimeve klimatike dhe në qëndrueshmërinë e qyteteve, pasoja mbi shëndetin dhe mirëqenien e banorëve. Vlerat e gjelbërimit urban janë shumëdimensionale si në përmirësimin e treguesve mjedisorë të ndotjes së mjedisit, reduktimit të ndotje të ajrit urban, reduktimit të temperaturës së lartë dhe zbutjes të ndryshimeve klimatike. Në Samitin e vitit 1996 në Stamboll, me pjesëmarrjen e 180 vendeve theksohet se:

*“Vendbanimet njerëzore do të planifikohen, zhvillohen dhe përmirësohen në një mënyrë që të marrin plotësisht parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të gjithë përbërësit e tyre, siç përcaktohet në Agjendën 21. ... Ne duhet të respektojmë kapacitetin mbajtës të ekosistemeve dhe ruajtjen e mundësive për brezat e ardhshëm. ... Shkenca dhe teknologjia kanë një rol vendimtar në formimin e vendbanimeve të qëndrueshme njerëzore dhe ruajtjen e ekosistemet nga të cilat ata varen.”* (Deelstra & Girarde, 2021, faqe 45).

Në kushtet e ndryshimeve të treguesve klimatikë, në territorin e Shqipërisë gjelbërimi urban bëhet edhe më i domosdoshëm në koncept, ndërjegjësim, gjithëpërfshirje dhe implementim. Nga monitorimi në 11 stacione meteorologjike të vendit në vitin 2020, temperatura mesatare vjetore rezulton + 2.8 gradë më e lartë dhe reshjet 300 mm më pak, në krahasim me mesataren 30-vjeçare 1961-1990. Gjelbërimi urban kufizon krijimin e *“ishujve të nxehtë urbanë”*, si vatra të nxehta të shkaktuara nga urbanizimi kaotik i

qyteteve, mungesa e korridoreve ekologjike të qarkullimit të rrymave të ajrit dhe të shkarkimit të gazeve serrë në atmosferë. Gjelbërimi urban përmirëson peizazhin urban, rrit vlerën e pronës, vlerat ekonomike dhe treguesit mjedisorë, përmirëson kushtet jetësore dhe shëndetin e popullsisë, krijon shumëllojshmëri të biodiversitetit dhe ruan ujën në tokë. Sipas një studimi: *“Pemët mund t’i sigurojnë një pronari të një shtëpie të vetme një rritje prej 4 deri në 27% në vlerën e pronës dhe një pemë e vetme mund të shtojë deri në 9% në vlerën totale të një prone banimi”* (Grado et al., 2008, f. 8).

Qëndrueshmëria e qyteteve përfshin aspekte ekonomike, mjedisore e sociale dhe vlerësohet me disa tregues. Një qytet i qëndrueshëm është një qendër urbane me ekonomi të zhvilluar, mjedis të qëndrueshëm, kushte jetësore të përshtatshme për komunitetin dhe përfitime të shërbimeve të ekosistemeve në sukestrimin e gazeve serrë, mbrojtje nga erozioni, përfitime në shëndetin publik, zbutje të ndryshimeve klimatike dhe konservim energjie. Qytete drejt ekosistemeve urbane të gjelbra dhe mjedis të qëndrueshëm, hapësira të gjelbra sipas normativave, ndërtesa me energji diellore, kopshte urbane, çati të gjelbra. Qyteti zhvillohet përmes planifikimit dhe menazhimit urban. Qytete me sa më pak makina. Në Kopenhagen, qyteti i parë që synon në 2025-n të jetë me karbon neutër, raporti biçikleta-makina varion në raportin 5:1, ku 50 % e popullsisë lëvizin me biçikleta. Nga monitorimi i temperaturës dhe shkarkimeve në mjedis në disa pika të qytetit të Tiranës (16.9.200), rezulton se në sipërfaqet e betonizuara temperatura rritet 4-8 gradë ndaj vendeve të gjelbëruara dhe gjithashtu rritet shkarkimi i karbonit (Lushaj, Aliaj, 2018, f. 8).

Vendet e BE-së përdorin tregues të ndryshëm të vlerësimit të sipërfaqes të gjelbër për qytetet si: qytete që ofrojnë sipërfaqen e gjelbër për banor, qytete që llogarisin sipërfaqen për 100 mijë banorë, qytete që llogarisin distancën maksimale të hapësirave të gjelbra nga qendrat e banuara midis qyteteve dhe brenda qytetit.




Shkalla e vdekshmërisë si pasojë e sëmundjeve të shkaktuara nga mungesa e hapësirave të gjelbra urbane rritet. Sipas të dhënave të literaturës p.sh. në Paris, ku 86.5 % e banorëve janë vendosur rreth metrove, vdekshmëria është e lartë në saje të mungesës së hapësirave të gjelbra, edhe pse nuk mungojnë parqet, por parqet nuk ofrojnë akses të barabartë për banorët midis zonave të qytetit.

Një situatë e tillë vlerësohet të jetë edhe në qytetin e Tiranës, ku Parku i Madh i Tiranës, mbetet parku i gjelbër më masiv, ndërsa mungojnë sipërfaqet e gjelbra në disa nga njësitë bashkiake të kryeqytetit. Për llogaritjen e hapësirës gjelbër për çdo qytet, studiuesit përdorin indeksin e vegjetacionit të normalizuar, që vjen nga imazhet satelitore brenda një zonë të gjelbër. Në vitin 2019, studiuesit e OBSH-së dhe Universitetit të Kolorados, zbuluan se për çdo 0.1 pikë rritje të indeksit të vegjetacionit të normalizuar brenda 500 ml të zonës banuar, vdekshmëria e parakohshme u ul me 4 %, gjë që lidhet me gjelbërimin e qyteteve, përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe kushteve jetësore, si dhe uljen e ndotjes së ajrit. Cilësia e ajrit në zonat urbane është një nga problemet mjedisore më të rëndësishme për shëndetin publik. Drurët dhe bimësia përbëjnë një filtër për pastrimin e ajrit, pasi kanë aftësinë të ngjitin grimcat e pluhurit PM 10 dhe PM 2,5 mbi sipërfaqen e gjetheve si dhe të thithin dyoksidin e karbonit dhe çlirojnë oksigjenin. Një dru pyjor mund të thithë 12 kg CO<sub>2</sub> në vit, një ha pyll grumbullon deri 32 tonë grimca pluhuri.

Gjelbërimi urban gjithashtu eliminon *“ishujt e nxehtë urbanë”*. Hapësirat e gjelbra në qytetet europiane në rreth 40 % të sipërfaqes përbëhen nga infrastruktura e gjelbër urbane; mesatarisht 18.2 m<sup>2</sup> hapësirë të gjelbër për banor, të aksesueshme nga publiku. Rreth 44% e popullsisë urbane të Europës jeton në distancën deri në 300 metra nga një park i gjelbër publik. Gjelbërimi i qyteteve europiane gjatë 25 viteve të fundit është rritur me 38%, ndërsa në nivel global është rritur me 12% gjatë së njëjtës periudhë. Në zonat

metropolitane të Europës, sipërfaqet e gjelbra të të gjitha kategorive për banor (natyrore, urbane, periferike, pyjore) gjenden në nivele të ndryshme midis vendeve dhe brenda çdo vendi. Në qytetet metropolitane të Spanjës, në vitin 2014, në kategoritë e mësipërme, Barcelona dispononte 8.8 m<sup>2</sup> për banor, ndërsa Zaragoza 46.6 m<sup>2</sup>, Bilbao 210 m<sup>2</sup>, në Kopenhagen 762 m<sup>2</sup>, Tallin (Estonia) 780 m<sup>2</sup>, Berlin 906 m<sup>2</sup>, Dublin 36 m<sup>2</sup>, Athina 3,4 m<sup>2</sup>, Budapesti më shumë se 1000 m<sup>2</sup>. Qytetet metropolitane të SHBA-së dhe Kanadasë disponojnë sipërfaqen më të lartë për banor të gjelbërimit urban natyror e urban.

Qysh në lashtësi, zhvillimi i qyteteve është shoqëruar me gjelbërimin e rrugëve. Kopshtet e varura të Babilonisë në kohën e mbretëreshës Semiramida (800-700 p.e.r) ishin me paraqitje monumentale me drufrutorë e dekorativë dhe skulptura me elemente arkitekturale. Pylli i Londrës me 1470 ha, pishat e Romës, pyjet e Vienës. Qysh në vitin 1552, mbreti Herni II i Francës nxori një urdhër për mbjelljen dhe mirëmbajtjen e drurëve në Paris. Në librin “Qytetet, kopshte të së nesërme” 1902, lindi ideja e qytetit-kopsht, ku një qytet të shtrihej në rrathë koncentrikë me kopshte dhe gjelbërim përpara. Të gjitha vendet e Europës kanë një histori të vjetër të gjelbërimit urban.



Kopshtet e varura të Babilonisë: burimi internet: Lulishtja para Kafes së Madhe. Shkodër, krijuar 1875. Burimi: web Hanging gardens of Babylon -wikipedia.org

## II. Metoda

Vlerësimi i nivelit të gjelbërimit urban fokusohet në qytetin e Tiranës dhe bazohet në studimet e autorëve të këtij artikulli, grumbullimin e informacionit, vëzhgimeve në terren, hapësirat publike, shpërndarja e sipërfaqeve të gjelbra dhe analizën e problemeve dhe mundësive të rritjes së sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Tiranës. Janë studiuar eksperiencat të vendeve të zhvilluara, modele të gjelbërimit urban dhe mundësitë e përshtatjes në kushtet tona dhe PPV i Bashkisë së Tiranës.

### Pak histori:

Në mozaikët e siteve arkeologjike të vendit gjenden të vizatuara bimët zbukuruese. Lulishtja e parë publike njihet ajo para Kafes së Madhe në Shkodër, e krijuar në vitin 1875, gjelbërimi gjatë periudhës 1912 -1944 fokusohet në kopshtet e shtëpive private të qyteteve, gjatë viteve 1914-1916 u krijua lulishtja “Ismail Qemali” në qytetin e Vlorës, në vitin 1922 lulishtja te monumenti i Themistokli Gërmenjit në Korçë, kopshtet e vilave të të pasurve, Parku i qytetit të Burrelit, 1920-1944 parku i Pallatit të Brigadave. Në periudhën 1944-1990 gjelbërimi urban u masivizua në gjelbërimin e qendrës dhe periferisë së Tiranës dhe qyteteve të tjera, rrugëve dhe lagjeve, shumë parqe dhe lulishte, duke filluar nga parku “Rinia”, Parku i Madh i Liqenit, parqe të lojërave për fëmijë, kopshte të shkollave dhe gjelbërim i institucioneve, spitaleve, parqe historike, zona të gjelbra në komplekset e banimit, gjelbërimi i bregut të Lanës etj., të cilat pas 1990 u cenuan rendë.

## III. Rezultatet e arritura

Aktualisht qyteti i Tiranës është kthyer në një metropol me një popullsi rreth 850.000 banorë. Ka progres në ngritjen e strukturave administrative dhe menazhimit të sipërfaqeve të gjelbra si

Administrata e Parkut të Madh dhe Liqenit, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, përmirësime cilësore në sistemimin e lulishteve ekzistuese dhe infrastrukturës së qarkullimit të banorëve në Parkun e Tiranës, zgjerimi i gjelbërimit periferik dhe perspektiva e Parkut Orbital. Një shumëllojshmëri prej 400 llojesh bimore me vlera zbukuruese, mjekësore, të rralla e të rrezikuara gjenden në Parkun e Tiranës. Por një grup problemesh duhet të kthehen në vëmendjen e bashkisë, komuniteteve dhe bashkëpunimit publik-privat. Problemet me gjelbërimin urban në qytetin e Tiranës, pas vitit 1990 dhe gjatë gjithë periudhës së tranzicionit lidhen në radhë të parë me reduktimin e sipërfaqes së gjelbër për banor, në krahasim me vitin 1990, me normat kombëtare dhe ato të BE-së. Në vitin 2014, në qytetin e Tiranës sipërfaqja e gjelbër për banor varionte në 1 m<sup>2</sup> për banor sipërfaqe të gjelbra, synimi ishte të arrijë 3 m<sup>2</sup> për person (norma minimale e sanksionuar në rregulloren e urbanistikës është pranuar 7 m<sup>2</sup>/banor). Në vitin 1990 sipërfaqe për banor në Tiranë 2.5m<sup>2</sup> ose 4 milionë m<sup>2</sup>. Aktualisht, disa herë më e ulët. Për më tepër, llogaritet se përpjesëtimi mes betonit dhe hapësirës së gjelbër është në nivele negative. Sipas literaturës norma orientuese për sipërfaqet e gjelbra në qytete synojnë:

- a. sipërfaqe të gjelbra brenda blloqeve të banimit 2.5 m<sup>2</sup>/banor,
- b. Sipërfaqe të gjelbra masive, parqe e lulishte, brenda blloqeve të banimit 4 m<sup>2</sup>/banor,
- c. Sipërfaqe të gjelbra përgjatë rrugëve, bulevardeve, shesheve, brigjeve ujore 2.5 m<sup>2</sup>/banor,
- d. *Shuma a+b+c 9 m<sup>2</sup>/banorë.* Sipërfaqe të gjelbra të zonës rikrijuese park në periferi 17 m<sup>2</sup>/banor. *Gjithsej zonë e gjelbër 26 m<sup>2</sup>/banor.*

Në fund të vitit 1990, ndërmarrja e ndërtim-gjelbërimit administronte më shumë se 4 milionë m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbër ose mesatarisht 12.5 m<sup>2</sup> për banor, krahas gjelbërimit në territorin e

shkollave, institucioneve dhe të hapësirave publike midis ndërtesave të banimit. Pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik, në periudhën e tranzicionit, rënien e institucioneve, ngjarjet e viteve 1996-1997, shkaktuar nga rënia e firmave piramidale dhe mungesa e stabilitetit politik dhe rendit, urbanizimi informal në qytet, u dëmtuan mbi 33 % e sipërfaqes së gjelbëruar, së pari parqet dhe lulishtet e qendrës së Tiranës, Parku monumental i Namazgjasë, parku “Shqipëria Sot” u përgjysmua sipërfaqja e gjelbëruar rreth Parlamentit, drurët e bulevardit, brigjet e lumit Lana dhe sipërfaqet në zona të tjera u kjoskëzuan. Krahas zgjerimit perëndimor, u reduktua ndjeshëm edhe në vitet më pas sipërfaqja e gjelbëruar në Parkun e Madh të Tiranës, parku rreth varrezave të “Dëshmorëve të Kombit”, Kopshtit Botanik e Zoologjik nëpërmjet ndërtimeve të banesave dhe infrastrukturës. Me ndarjen e Kopshtit Zoologjik, Kopshtit Botanik dhe sipërfaqes së gjelbër rreth varrezave “Dëshmorët e Kombit”, kthimit në troje ndërtimi dhe infrastrukture në Tiranë humbën rreth 69 ha sipërfaqe të gjelbra. Vetëm gjatë periudhës 1990-2006 në zonën Tiranë – Durrës është ndryshuar destinacioni dhe janë dëmtuar gjithsej 845 ha sipërfaqe të gjelbra, përfshirë edhe natyrale, shumë rrugë në qytetin e Tiranës ende nuk kanë drurë dekorativë dhe gjelbërim rrugor. Nga vëzhgimet në terren në qytetin e Tiranës, sikurse dhe në qytete të tjera të vendit, konstatohen këto probleme: shndërrimi i sipërfaqeve të gjelbra në troje ndërtimi, mungon inventarizimi i plotë i drurëve dhe adoptimi i planeve të mbarështimit. Diktohet nevoja e ngritjes së kapaciteteve menazhuese dhe teknike e specialistëve të sektorit të gjelbërimit për një studim të mirëfilltë të balancimit të sipërfaqes të gjelbër në raport me popullsinë e çdo njësie bashkiake, aktualisht me diferenca të thella. Pas viteve '90, në Tiranë dhe gjithë vendin, u shkatërruan fidanishtet e prodhimit të fidanëve të drurëve pyjorë dhe luleve dhe në shumicë u importuan, përfshirë edhe drurë që

nuk përshtaten me tokën dhe klimën. Për më tepër që vazhdon edhe sot kjo praktikë.

Qyteti i Tiranës nuk është më ai i vitit 1990, por me popullsi rreth tri herë më të lartë, ndaj gjelbërimi urban ka rëndësi; për funksionet në aspektin e mënjanimit të stresit, rimarrjen e energjive, shërben si mjedis çlodhës, për uljen e temperaturës, për hapësira mjedisore edukuese, vende takimi për komunitetin, aspekte estetike, reduktimin e ndryshimeve klimatike, zbutjen e zhurmave. Përmirësimi i cilësisë ajrit në saje të thithjes së dyoksidit të karbonit, çlirimin e oksigjenit dhe ngjitjes së grimcave të pluhurit. Sipas autorëve, një pemë e vetme e shëndetshme mund të prodhojë çdo ditë oksigjen të mjaftueshëm për 18 persona. Pemët mund t'i sigurojnë një pronari të një shtëpie të vetme një rritje prej 4 deri në 27% në vlerën e pronës dhe një pemë e vetme mund të shtojë deri në 9% në vlerën totale të një prone banimi.

Për më tepër, sepse ndotja në disa zona të qytetit është në kufij ekstrem mbi normën shqiptare dhe standardin e BE-së, si pasojë e trafikut masiv të automjeteve, densitetit të lartë të popullsisë dhe ndërtesave dhe ndërprerjes së korridoreve ekologjike. Nga monitorimi i kryer në 678 ha në qytetin e Tiranës në tri zona me 16671 drurë pyjorë, tregoi se nga drurët sukestrohen 1640 tonë CO<sub>2</sub> në vit dhe çlirohen 2130 tonë oksigjen. Përqendrimi mesatar i dyoksidit të azotit sa dyfishi i normës së lejuar, mesatarja e dyoksidit të karbonit mbi normën e lejuar dhe në shumicën e stacioneve matëse, vlera e grimcave të PM2.5, është tejkaluar në gjysmën e stacioneve të monitoruara dhe për PM 10 në më pak se gjysma e pikave të monitoruara (*CO-plan, 2018, f. 17,25,102*). Ajri në qytetin e Tiranës vazhdon të jetë i ndotur. Edhe në një raport të viteve më parë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë thuhet se çdo qytetar i Tiranës humb 1 deri në 2 vjet jetë nga niveli i lartë i ndotjes së ajrit. Edhe niveli i zhurmave të matura përbën shqetësim, pasi paraqitet në vlera të larta të cilat lëvizin nga 66 dB

ditën dhe 58 dB natën dhe tejkalojnë vlerat e standardeve (AKM, 2018). Ndër të tjera, edhe për shkak të pakësimit të ndjeshëm të hapësirave të gjelbra në Tiranë. Gjelbërimi urban redukton “ishujt e nxehtë urbanë” që shkaktohen nga valët e nxehta lokale me temperaturë rreth 5 gradë më të lartë se vlerat mesatare maksimale, si pasojë e projektimit të gabuar, humbjes të funksioneve të korridoreve ekologjike nga ndërtime informale dhe shkarkimet në atmosferë. Hapësirat e gjelbra urbane mund të zbusin efektet e ishullit të nxehtë urban, duke ndryshuar bilancin e energjisë sipërfaqësore të sistemit. Sipas qendrës amerikane të klimës, “Ishujt e nxehtësisë urbane zakonisht konsiderohen si ndryshimi i temperaturës midis një qyteti dhe zonave përreth tij, por temperaturat mund të ndryshojnë shumë brenda një qyteti. Disa zona mund të nxehen më shumë se të tjerat për shkak të sasisë së ndërtesave dhe trotuareve që thithin nxehtësinë, ndërsa lagjet e tjera janë më të freskëta për shkak të më shumë pemëve dhe hapësirës së gjelbër. Këto ndryshime të temperaturës krijojnë ishuj më të vegjël të nxehtësisë brenda zonës urbane (climate center 2021, f. 5).

Një studim i kryer nga U-Polis në qytetin e Vlorës, tregoi se temperatura në muajt korrik-gusht 2019, në disa zona të qytetit arriti në 42-43 gradë. Vetëm për 50 ditë, në segmentin nga hyrja e Vlorës- Uji i Ftohtë, kanë qarkulluar rreth 80 mijë makina. Dhe nga llogaritja me metodën e përdorur nga Agjencia Amerikane e Mjedisit, në këtë segment janë shkarkuar 6574-tonë CO<sub>2</sub>. Kapaciteti grumbullues i karbonit nga sipërfaqja e gjelbër e qytetit mund të përballohet në masën 45-50% (Demiraj, Lushaj, 2020, f. 88).



Parku "Rinia". Burimi Internet agefotostock



Liçeni Artificial i Tiranës

#### IV. Përfundime dhe rekomandime

a) Gjelbërimi urban është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës urbane të qyteteve, që përmirëson vlerat: ekonomike, sociale, mjedisore, të pronës, vlerat peizazhike, estetike, shëndetësore, mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e qyteteve. Qyteti i Tiranës në krahasim me vitin 1990 me gjelbërim urban 12.5 m<sup>2</sup>/banor, aktualisht brenda zonës urbane e ka gjelbërimin disa herë më të ulët për banor.

b) Gjelbërimi urban është një aspekt i rëndësishëm i planifikimit urban të qyteteve dhe qendrave të banuara, për shkak të rëndësisë së hapësirave të gjelbra në gjendjen mjedisore, jetën e banorëve dhe qëndrueshmërinë e qyteteve.

c) Aktualisht, në krahasim me vitin 1990 në qytetin e Tiranës, nga qendra në periferi, sipërfaqja e gjelbër publike nga 12.5 m<sup>2</sup>/banor është ulur disa herë në saje të urbanizimit, ndërtimit të infrastrukturës dhe informalitetit. Përpjekjet për shtimin e parqeve periferike nuk mund të zëvendësojnë sipërfaqet e gjelbra dhe drurët në blloqet e banimit brenda qytetit, pasi gjenden në distancë të largët dhe nuk mund të përdoren nga shumica e banorëve në njësitë administrative.



**d)** Rritje e hapësirave të gjelbra/banor, parqeve periferike Farkë, Kashar, Paskuqan, lidhja e korridoreve ekologjike dhe rrugore me Dajtin, Kodrat e Farkës e Bërxullit, Liqenin e Paskuqanit etj., për të rritur në to aksesin e popullsisë së qytetit.

**e)** Edhe pse Tirana nuk është projektuar si një qytet policentrik përsëri tenton të kthehet në një qytet të tillë. Gjelbërimi urban duhet të ndjekë të njëjtën rrugë, nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra në 11 njësitë administrative për plotësimin e kërkesave të popullsisë sipas kësaj ndarjeje.

**f)** Projektimi i hapësirave të gjelbra të qytetit me parimet e qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së infrastrukturës (rrugëve, trotuareve, sistemit të kanalizimeve) nëpërmjet zgjedhjes së drurëve, për evitimin e dëmtimeve nga zgjerimi i rrënjës në thellësi ose në sipërfaqe.

**g)** Në qytetin e Tiranës gjenden hapësira publike të lira në ish-zonat industriale të braktisura, në blloqet e pallateve etj. Sugjerojmë që, deri në një studim të plotë nga bashkia dhe mundësisë së kthimit në sipërfaqe të gjelbra urbane, të ndalohet përdorimi për qëllime të tjera.

**h)** Bujqësia urbane (tokat e lira urbane, kopshtet familjare, tokat e kultivuara me pemëtore dhe ullishte të privatizuara me ligjin nr. 7501) të konsiderohet instrument për vlerat ekonomike, sociale, peizazhike, mjedisore në zonën urbane dhe periferike të Tiranës.

#### **IV.1. Rekomandime**

1. Të rishikohet Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë së Tiranës për gjelbërimin urban të qytetit, me synim së paku dyfishimin e sipërfaqes së gjelbër/banor brenda një periudhe 3-5-vjeçare. Të kryhet inventarizimi i sipërfaqeve sipas kategorive: drurë të rrugës, grumbuj drurësh, lulishte, parqe, gjelbërim periferik dhe krijimi i sistemit të bazës së të dhënave.

2. Qyteti i Tiranës ka potencial të lartë dhe realitet për zhvillimin e bujqësinë urbane, në formën e kopshteve familjare, në tokat urbane, tokat bujqësore të kultivuara me ullinj dhe pemë frutore brenda zonës urbane të përfituar me ligjin nr. 7501 “Për Tokën” si një aktivitet me ndikim në qëndrueshmërinë e qyteteve, vlerave ekonomike, sociale, peizazhike, rekreative, shëndetësore, zbutjen e klimës, thithjen e dyoksidit të karbonit dhe vlera të tjera të gjelbërimit urban në tërësi.

3. Inventarizimi i sipërfaqeve të lira publike, veçanërisht në territoret industriale të braktisura dhe planifikimi i gjelbërimit urban në sipërfaqet e mundshme. Sugjerojmë që deri në kryerjen e studimit të ndalohet tjetërsimi i përdorimit të këtyre sipërfaqeve për qëllime të tjera.

4. Në zgjerimin e gjelbërimit urban të qytetit të Tiranës, përparësi të marrin drurët pyjorë me prodhimin e fidanëve në fidanishtet e vendit që u përshtaten klimës, tokës dhe kursehet valuta kur nuk është e nevojshme.

5. Përmirësimi i vazhdueshëm i hapësirave të gjelbra, shtimi i këndeve rekreative për fëmijë në hapësirat ndërmjet blloqeve të banimit duhet të jetë një nga përparësitë e bashkisë së Tiranës në bashkëpunimin publik-privat.

## **Literatura**

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, (2018) “Raport për gjendjen e mjedisit 2018”, publikuar AKM.

Akinshina, A., Azizov, A., “Monitoring Urban Greenery For Sustainable Urban Management Monitoring Urban Greenery For Sustainable Urban Management”.

Bashkia e Tiranës, (2012), Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë.

Co\_PLAN, Miliuokontakt, (2021), “Mushkri të Gjelbra për qytetet tona”.

Climate Center, (2021), “Hot zones “Urban Heat islands”

Deelstra, T., & Girarde, H., (2021), Urban Agriculture and Sustainable Cities.

Demiraj, B., Lushaj, Sh., (2020) “Urbanizimi dhe ishujt e nxehtë urbanë në qytetin e Vlorës”

Jani, V., Gjelbërimi i qendrave të banuara, Tiranë.

John Wiley & Sons "Forestry Handbook".

Kellert, Stephen and Wilson, Edward, (1993) "Biophilia Hypothesis. Island Press/Shearëater 11. Books, Washington, D.C.

Lirim Selfo et al. (2012), "Vlerësimi strategjik mjedisor i PPV Tiranës, Bashkia e Tiranës".

Lushaj, Sh., (2017) "Biodiversiteti në 360 km<sup>2</sup>" (Shtëpia Botuese Print AL).

Lushaj, Sh., Aliaj, B., (2018) "The role of Green and Landscape Planning in urban policies: the case of Tirana, Polis PRESS –ISBN.

Ramasëami, A., Tong, K., Canadell, C., Jackson, R., (Kellie) Stokes, E., Dhakal, Sh., Finch, M., Jittrapirom, P., Singh N., Yamagata. Y, Yeëdall. E, Yona L. & Seto K., (2021) "Carbon analytics for net-zero emissions sustainable cities" Nature Sustainability, vol 4.

Urrestarazu, L. P., Fernández-Cañero, R., Franco-Salas, A. & Egea, G., (2015) Vertical Greening Systems and Sustainable Cities".

USDA, (2005) "Urban Forestry Manual".

**Prof. dr. Emil Lafe<sup>1</sup>**

## **PËR STANDARDIZIMIN E EMËRTIMEVE TË QENDRAVE TË BANIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

### **Abstrakt**

Emërtimet e qendrave të banimit përdoren rregullisht në veprimtarinë administrative të shtetit, prandaj është e nevojshme që trajta e tyre drejtshkrimore të jetë e kodifikuar dhe e miratuar zyrtarisht. Kjo trajtë të përdoret në dokumentet zyrtare, në vulat dhe në hartat. Në vendin tonë emërtimet e qendrave të banuara janë parë në funksion të ndarjes administrative, pa i kushtuar vëmendjen e duhur formës drejtshkrimore të tyre. Deri në vitin 1990 ishte Presidiumi i Kuvendit Popullor që dekretonte dhe botonte ndarjen administrative të vendit, ku renditeshin sipas rretheve edhe emrat e të gjitha qendrave të banuara. Sot kjo detyrë i ka kaluar Ministrisë së Punëve të Brendshme. Materialet përkatëse dokumentojnë shpërndarjen e qendrave të banuara (qytete e fshatra) sipas qarqeve. Përcaktimi i trajtës drejtshkrimore nuk shihet si kërkesë e domosdoshme në pasqyrat e ndarjeve administrative dhe lista e emërtimeve nuk është vështruar me vëmendje ndonjëherë nga organi përkatës. Në kumtesë shtrohet nevoja për një shqyrtim tërësor të formave drejtshkrimore të emërtimeve të qendrave të banuara, duke përcaktuar më parë kriteret gjuhësore. Për këtë është e nevojshme që pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të ngrihet një komision *ad hoc*, i përbërë prej gjeografësh, gjuhëtarësh dhe specialistësh të pushtetit vendor që e njohin mirë territorin përkatës. Në këtë mënyrë, në bashkëpunim dhe marrëveshje edhe me pushtetin vendor në qarqe, të hartohet lista normative e emërtimeve të qendrave të banuara. Gjatë kësaj pune do të synohet të gjenden zgjidhje të pranueshme në rastet kur forma dialektore e emërtimit duhet të pajtohet me normën e sotme letrare dhe të shikohet mundësia e zëvendësimit të disa emërtimeve të papërshtatshme për arsye të ndryshme.

*Fjalë çelës: qendër e banuar, toponim, kodifikim, drejtshkrim*

### **Abstract**

The names of the residential centers are regularly used in the administrative activity of the state, therefore it is necessary that their orthographic form be codified and officially

---

<sup>1</sup> Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare. E-mail: emilafe1@gmail.com

approved. This form should be used on official documents, stamps and maps. In our country the names of the inhabited centers are seen in function of the administrative division, without paying due attention to their orthographic form. Until 1990, it was the Presidium of the People's Assembly that decreed and published the administrative division of the country, listing the names of all the inhabited centers according to the districts. Today this task has passed to the Ministry of Internal Affairs. Relevant materials document the distribution of inhabited centers (towns and villages) by counties. The determination of the orthographic form is not seen as a necessary requirement in the statements of administrative divisions and the list of designations has never been carefully considered by the relevant body. This paper raises the need for a thorough review of the orthographic forms of the names of the inhabited centers, having previously determined the linguistic criteria. For this it is necessary to set up an ad hoc commission at the Ministry of Internal Affairs, composed of geographers, linguists and local government specialists. In this way, in cooperation and agreement with the local government in the regions, the normative list of names of inhabited centers is to be compiled. This work will aim at finding acceptable solutions in cases when the dialectal form of the name must agree with today's literary norm and to consider the possibility of replacing some inappropriate names for various reasons.

*Key words: residential center, toponym, codification, spelling*

## 01. Shqipja si gjuhë zyrtare

Shteti shqiptar, që kur caktoi gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare (shtator 1913), ka bërë përpjekje për të vendosur një disiplinë gjuhësore, por asnjëherë nuk është arritur që korrektesia e përdorimit të gjuhës të jetë tipar dallues i veprimtarisë shkrimore të shtetit. Mund të dallojmë tri akte zyrtare kryesore për marrëdhëniet e shtetit me gjuhën shqipe:

### 1. Dekreti i vitit 1923:

*Mbi djalektin zyrtar.* Si mbas urdhënit Nr. 148, më 13.I.1923, të Kryeministriës ini të lutun të autorizoni gjithë zyrtarët që në shkrim të akteve të zyrtare gjithmonë të përdoret djalekti i Elbasanit, i cili asht pranue si një djalekt i përbashkët e zyrtar për shtetin t'onë. 14.I.23. n. 763 (*Fletorja zyrtare*, Tiranë, 21 Kallinduer 1923, vjeti II, Nr. 3, f. 1).

2. Vendim Nr. 50, dt. 08.03.1974 "Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe".

3. VKM e datës 07.03.1979 “Për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe” (Propozimin e pati bërë Akademia e Shkencave).

4. Dispozita e Kushtetutës së vitit 1998: *“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: ... mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe”* (neni 59, g). – me propozimin e redaksisë së revistës “Gjuha jonë”, që u mbyll pas reformës së Akademisë (2009).

Dekreti i vitit 1923 mbështetet mbi vendimet që kishte marrë Komisioni Letrare Shqipe e mbledhur në Shkodër (1916–1918) dhe mbi miratimin e tyre nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (gusht 1920). Ai pati një ndikim pozitiv për t’i dhënë gjuhës së veprimtarisë administrative të shtetit një pamje deri diku të njëtrajtshme, por nuk arriti të krijojë një formë gjuhësore me drejtshkrim dhe gramatikë të njësuar, sepse e orientonte zyrtarin e shtetit drejt një dialekti dhe jo drejt një norme letrare të përcaktuar. Brenda këtij dialekti zyrtar në praktikë viheshin re luhatje të shumta deri edhe në përzierje formash nëndialektore të gegërishtes ose të gegërishtes me toskërishten, sipas njohjes që kishte shkruesi për dialektin e Elbasanit. Jashtë sferës së administratës së shtetit, madje edhe në shkollë, vijuan të përdoreshin gjithashtu variantet letrare të mëparshme: toskërishtëja dhe tradita letrare e Shkodrës.

Vendimi i 8 marsit 1974 vuri në vëmendje të shtetit jo vetëm zbatimin e drejtshkrimit, por edhe ngritjen e nivelit të kulturës gjuhësore në përgjithësi. Për fat të keq nuk pati ndikim për të përcaktuar formën normative të emërtimeve të qendrave të banuara.

VKM e vitit 1979 pati një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e përgjithshëm të zbatimit të rregullave gjuhësore dhe ngriti prestigjin e gjuhësisë sonë. Por Akademia e Shkencave mjerisht e

ka braktisur këtë vendim që e ka propozuar vetë, e bashkë me të edhe angazhimin e saj në këtë fushë.

Dispozita e Kushtetutës së vitit 1998 ka mbetur pa u zbërthyer në akte nënligjore, ashtu siç pritej.

## **02. Emërtimet e qendrave të banuara në vëmendjen e shtetit**

Emërtimet e qendrave të banuara, ashtu si edhe emërtimet gjeografike në përgjithësi, i përkasin asaj dege të gjuhësisë që quhet *onomastikë*, dhe brenda saj nëndegës *toponomastikë*. Deri sot nuk ka pasur ndonjë kodifikim shtetëror të formës së shkruar të emërtimeve të qendrave të banuara dhe emërvendeve në përgjithësi, prandaj për një pjesë të tyre vihen re luhatje në shkrim, madje edhe gabime në hartat, në studimet gjeografike, në botimet enciklopedike dhe në shtypin e përditshëm.

Lista e parë e plotë e emërtimeve të qendrave të banuara pas Pavarësisë, me sa di unë, është dhënë në librin e njohur të Teki Selenicës "Shqipëria më 1927". Pas Luftës së Parë Botërore fushatat për ndërrimin e emërvendeve në Greqi e në Jugosllavi për t'i greqizuar e për t'i sllavizuar ato emërvende që nuk ishin të tilla, nxitën edhe në Shqipëri një reagim. Më 1937 u botua "Ligjë mbi ndryshimin e emrave të disa qyteteve, katundeve, lagjeve, lumejve etj." (Fletorja zyrtare, 11 maj 1937, nr. 34, f. 6). Ky ligj autorizonte qeverinë për të zëvendësuar një numër emërtimeesh gjeografike "të imponuara gjatë shkeljeve të huaja" me emërtime nga brumi i gjuhës shqipe. Për këtë do të ndiqeshin dy rrugë:

a) do të hynin në përdorim zyrtar emërtimet shqipe të dikurshme, ose

b) do të propozoheshin emërtime të reja nga brumi i gjuhës shqipe.

Në zbatim të Ligjit të mësipërm qeveria ngriti një komision të posaçëm dhe në "Fletoren zyrtare" të datës 26 gusht 1938 u botua lista e plotë e vendbanimeve (emra të qyteteve, lagjeve fshatrave):

në njëren shtyllë emri i deriatëhershëm, ndërsa në shtyllën tjetër emri i vendosur nga Komisioni në rastet kur propozohet një emër i ri.

Reforma e rishikimit të emërtimeve të qendrave të banuara prekte rreth gjysmën e tyre. Reforma e vitit 1938 u anulua pas pushtimit fashist me një dekret të posaçëm të datës 9 shtator 1939 (botuar në “Fletoren zyrtare” të datës 22 shtator 1939). Pas Çlirimit reforma e anuluar ra krejt në harresë.

### 03. Gjendja pas Çlirimit deri sot

Ndarja administrative pas Çlirimit i kaloi si detyrë Presidiumit të Kuvendit Popullor. Ndarjet administrative kanë synuar gjithnjë të përcaktojnë njësitë territoriale-administrative sipas qarqeve, rretheve, lokaliteteve, fshatrave të bashkuara etj., por nuk janë marrë me formën gjuhësore të emërtimeve. Nuk është botuar ndonjë listë e plotë e vendbanimeve të Republikës së Shqipërisë, por vetëm ndarja sipas qarqeve e rretheve dhe brenda tyre vendbanimet përkatëse. Pra, qëllimi ka qenë thjesht të përcaktohej se me cilën njësi administrative lidhej fshati a vendbanimi përkatës.

Gjatë periudhës së socializmit, për arsye ideologjike e politike, u bënë disa ndryshime në emërtimet e qendrave të banuara p.sh. *Kuçova* u quajt *Qyteti Stalin* (1950–1990); disa qendra banimi morën emra dëshmorësh e figurash historike, si *Arshi Lëngo* e *Asim Zeneli* (Gjirokastër), *Maliq Muço* (Durrës), *Bajram Curri* (ish-Kolgecaj); disa emra me burim fetar u zëvendësuan me emra të rinj, p.sh. *Dervishas* me *Fshati i Ri* (Përmet), *Shehaj* me *Anëvjosë* (Tepelenë), *Shënkollas* me *Bregas* (Lushnjë), *Shënmërtir* me *Çlirim* (Vlorë), *Shijan* me *Blerimas* (Sarandë) etj. U ndërruan disa emërtime të papëlqyeshme, si *Qelbësirë*, *Sëmuraj* (Berat), përkatësisht *Guri i Bardhë* dhe *Pëllumbas*; fshati *Pustec* i krahinës së Prespës (Korçë) u



quajt *Liqenas*<sup>1</sup>, fshati *Vromero*<sup>2</sup> i Sarandës u quajt *Bregas*; u ndërruan disa emërtime që lidheshin me emrat e çifligarëve, si *Hadër Aga, Kalivja e Pashait, Kalivet e Shushit, Kasëmallajbej* (Sarandë), që u quajtën përkatësisht *Lefter Talo, Kodër, Rahullë, Neohor*.

Ndërrimi i emrit të një vendbanimi bëhej zakonisht sipas kërkesës nga administrata vendore dhe miratohej përfundimisht nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Më 1983 u krijua pranë Presidiumit të Kuvendit Popullor një komision i posaçëm studiuesish nga fusha e gjeografisë, historisë, gjuhësisë, kulturës popullore, i cili u ngarkua të merrej me emrat e fshatrave. Komisioni përcaktoi disa kritere pune:

a) të mos përdoreshin më tej si emërtime fshatrash emra abstraktë, si *Afrim, Agim, Çlirim, Përparim* etj., dhe emra vetjakë, si *Andon Poçi, Asim Zeneli, Jah Salih, Lefter Talo* etj.;

b) të mos prekeshin më tej emërtimet me burim fetar për të ruajtur traditën historike;

c) emërtimet e reja të fshatrave të zgjidheshin nga toponimia e zonës (kështu është vepruar në rastin e emrave *Buçimas, Holtas, Ujëmirë, Urakë* – më parë përkatësisht *Starovë, Poroçani i Poshtëm, Dërbaç, Kulla e Pashës*. Por ky komision nuk u angazhua për ndonjë rivështrim të përgjithshëm të emërtimeve të qendrave të banuara e as për rishikimin e emërtimeve të tre tipave të mësipërm.

#### **04. Fjalori i emërtimeve gjeografike të Republikës së Shqipërisë.**

Për të kodifikuar shkrimin e emërtimeve gjeografike të Shqipërisë (qendrat e banuara dhe emërtimet e tjera), me nismën time Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë planifikoi hartimin e një fjalori të emërtimeve gjeografike, që të përcaktonte formën

<sup>1</sup> Sot është rikthyer emri *Pustec*.

<sup>2</sup> Greq. *vromiá* 'fëlliqësi, ndyrësirë'.

normative të tyre sipas kriterëve të pranuar nga komisioni hartues i fjalorit. Më 2002, pas një pune shumëvjeçare, u botua “Fjalori i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë” (Emil Lafe, Nikoleta Cikuli, Mevlan Kabo, Veli Bici). Fjalori është rezultat i një pune kolektive dhe në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor. Emërtimet gjeografike të çdo rrethi janë diskutuar me hollësi me njohës të mirë të terrenit në të 36 rrethet e atëhershme të vendit. Ky fjalor u zbatua te botimet e Akademisë së Shkencave “Historia e popullit shqiptar” (4 vëllime, 2002–2009) dhe te “Fjalori enciklopedik shqiptar” (3 vëllime, 2008–2009), ku janë përmirësuar emërtimet e pasakta të botimeve të mëparshme, p.sh. (në kllapa trajta e drejtë) *Arrën* (*Arn* - Kukës), *Babot* (*Bobot* - Shkodër), *Barçallaja*, *Llogaraja* (*Barçallai*, *Llogorai* – Vlorë), *Bardhazë* (*Bardhëz* - Korçë), *Blezenckë* (*Blezënckë* - Skrapar), *Borakë* (*Borakaj* - Shijak), *Bual* (*Buhal* - Përmet), *Karahaxhë*, *Rumanxajë* (*Karahaxh*, *Rumanxa* - Sarandë), *Tejmollë* (*Tejmallë* - Kukës) etj.

Por “Fjalori i emërtimeve gjeografike” nuk është pasur parasysh në hartimin e “Ndarjes administrative” të sotme (2014), e cila ka trashëguar nga ndarjet administrative të mëparshme shumë emërtime të pasakta. Fjalori nuk është pa të meta, por përfaqëson kodifikimin më të sigurt të emërtimeve gjeografike të vendit tonë deri tani.

### **05. Probleme e detyra të sotme:**

Në listën e emërtimeve të qendrave të banuara, botuar në “Fletoren zyrtare” të vitit 2014, nr. 137, sipas Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, një varg emërtime (kryesisht të fshatrave) janë shkruar në mënyrë të pasaktë. Përveç kësaj nuk është përcaktuar as trajta e shquar e as theksi i fjalës. Le

të përmendim *Fushë-Arrëz* dhe *Fushë-Arrës* – dy emërtime për të njëjtin qytet te po ai ligj, dhe të dy të pasaktë<sup>1</sup>.

Pasaktësitë vihen re më fort te emrat e fshatrave. Po sjellim si shembull qarkun e Beratit, që paraqet më pak probleme se qarqet e tjera në këtë çështje:

Qarku Berat

Është	Duhet
Çilfik	Çiflig
Dyshnik	Dushnik
Feras	Ferras
Gjoroven	Gjeroven
Kakos	Kakoz
Konisbaltë	Konizbaltë
Magjatë	Majëgjatë
Melskë	Melckë
Mëndrak	Mëndrakë
Perisnak	Perisnakë
Sheqës	Sheqëz
Veseshtë	Vëseshtë
Zhapokikë	Zhabokikë

Mungon gjithandej viza lidhëse në shembuj si *Malas-Breg*, *Malas-Gropë* etj.

Por ka edhe disa probleme që kanë mbetur të pazgjidhura, pasi për to duhet të vendosë një autoritet shtetëror.

1. Në qarqet Durrës e Tiranë vërehen luhatje të shumta te emrat që shqiptohen me *-je* në të folmen vendore, por që janë kodifikuar prej kohësh me *-ja*, p.sh. fshatrat e njohur zyrtarisht *Arapaj*

---

<sup>1</sup> Emri i drejtë duhej të ishte *Fushë-Arst* (d.m.th. *Fusha e Arstit*, ashtu si *Fushë-Bulqizë*, *Fushë-Krujë* etj.),

(Durrës) dhe *Lekaj* (Kavajë) shqiptohen nga banorët *Arapje, Lekje*. Shembull tipik është fshati *Mukaj* (kështu zyrtarisht), por gjithandej thuhet *Konferenca e Mukjes* (ndërsa në dokumentet e kohës së konferencës emri i fshatit shkruhet *Mukaj*). Nga ana tjetër njihen zyrtarisht format me *-je* për një varg fshatrash të Tiranës si *Derje, Domje, Kërçukje* etj.

2. Vlen të shqyrtohet edhe forma drejtshkrimore e emërvendeve në zona ku ndodh ndërrimi  $g > gj$ ; p.sh., janë pranuar si forma zyrtare emërtimet *Bulgër, Gur-Lurë, Gurrë-Kalis* etj. të cilat shqiptohen me *gj* nga vendësit (*Bulgjër, Gjur-Lurë, Gjurrë-Kalis* etj.); nga ana tjetër janë pranuar si forma zyrtare *Gjoricë, Lugjei, Zogjaj* etj. Pra nuk është zbatuar i njëjti kriter në të gjitha emërtimet që paraqesin këtë veçori shqiptimore.

3. Për disa toponime me rëndësi vërehet se përdoren në forma gjinie të gabuara, në kundërshtim me formën e përdorur nga vendësit, p.sh. duhet: pika kufitare e *Morinit* dhe jo e *Morinës*<sup>1</sup>; qafa e *Llogorait* dhe jo e *Llogarasë*; Kuvendi i *Barçallait* dhe jo i *Barçallasë*. Emri *Bizë* pasqyron formën e shkrimit në hartat italiane, ndërsa duhet *Bixë*, ashtu si *Bixëllejë*.

4. Janë krejt të papërshtatshme si emërtime qendrash të banuara disa emërtime njësisish ekonomike të ndërmarrjeve të dikurshme bujqësore, si *Frutikulturë* (fshat i Kamzës) ose *Sektor* në emrat e fshatrave *Rrapëz-Sektor, Zhamë-Sektor* (Lushnjë). Po kështu janë të papërshtatshëm emrat e fshatrave *Hidrovor, Rini, Vëllazërim* (Durrës). Për këto fshatra, në bashkëpunim me pushtetin vendor, duhet të gjenden emërtime të tjera sipas mikrotoponimisë vendëse ose formave të relievit.

<sup>1</sup> Fshati *Morin*, pranë të cilit ndodhet pika e kalimit kufitar me Kosovën, i përket Kukësit, kurse *qafa e Morinës* ndodhet në krahinën e Tropojës, pra *Morini* dhe *Morina* janë emërtime të dy vendeve të ndryshme dhe nuk duhen ngatërruar.

## **Përfundim**

Nisur nga kjo gjendje, edhe në emër të Kryesisë së Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare, i sugjeroj konferencës dhe Akademisë së Shkencave t'i propozojnë qeverisë ngritjen e një komisioni *ad hoc* për emërtimet e qendrave të banuara pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Komisioni të përbëhet nga specialistë të asaj Ministrie, gjeografë, hartografë dhe gjuhëtarë. Komisioni, duke marrë edhe mendimin e pushtetit vendor, të hartojë listën normative të emërtimeve të qendrave të banuara të Shqipërisë. Vendimet e këtij komisioni, të miratuara me VKM të posaçme, të bëhen të detyrueshme për zbatim dhe të konsiderohet shkelje ligjore përdorimi i emërvendeve në forma të tjera të ndryshme.

**Dr. Mariglen Sherifaj<sup>1</sup>**  
**Prof. asoc. dr. Valbona Duri<sup>2</sup>**

## **ROLI I ELEMENTEVE TË MJEDISIT NATYROR NË EMËRTIMIN E VENDBANIMEVE NË SHQIPËRI. FENOMENI I “PËRSËRITJES SË TË NJËJTIT EMËRTIM”**

### **Abstrakt**

Krijimi dhe evolucioni i vendbanimeve është një ndër temat më të studiuara dhe debatuar në ditët e sotme. Vendi ynë ka tipare interesante të vendbanimeve, ku luajnë rol kushtet natyrore, zhvillimet historike dhe politike, civilizimi, marrëdhëniet ekonomike, kulturore, etnografike etj. Faktorë të shumtë kanë ndikuar në dinamikën numerike, territoriale, strukturore funksionale, popullative etj. të qendrave të banuara.

Mjedisi natyror ka luajtur një rol thelbësor në krijimin, vendosjen, shtrirjen madje edhe në toponiminë e vendbanimeve. Shqipëria paraqet ndoshta një nga rastet e rralla, ku rreth 1/5 e vendbanimeve kanë huazuar emra të elementeve të mjedisit natyror. Janë jo të pakta vendbanimet tona emrat e të cilave shfaqen si hidronime, oronime, me emra të bimëve, kafshëve, madje ato mbartin cilësi të mjedisit ku janë krijuar.

Punimi ka si objekt kryesor evidentimin e rolit të elementeve të mjedisit fiziko-gjeografik në emërtesën e vendbanimeve në vendin tonë, si dhe studimin e fenomenit të “përsëritjes së të njëjtit emërtim”.

Mbështetja në referenca të rëndësishme të një literature të gjerë gjeografike, historike, gjuhësore etj., sigurimi dhe interpretimi i të dhënave statistikore, analiza nëpërmjet SIG<sup>3</sup> etj. përbëjnë qasjet kryesore metodike të punimit.

*Fjalë çelës: vendbanim (njësi territoriale), toponim, hidronim, oronim, huazim, shpopullim.*

---

<sup>1</sup> Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Sociale, Departamenti Histori-Gjeografi E-mail: mariglens@yahoo.com

<sup>2</sup> Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Sociale, Departamenti Histori-Gjeografi, E-mail: bongjeo@yahoo.com

<sup>3</sup> Sistemet e Informacionit Gjeografik

**Abstract**

The creation and evolution of settlements is one of the most studied and debated topics nowadays. Our country displays interesting features in terms of settlements, where natural conditions, historical and political developments, civilization, economic, cultural, ethnographic relations, etc. play a role. Numerous factors have influenced the numerical, territorial, functional, structural, and population dynamics of inhabited places.

The natural environment has played an essential role in the creation, establishment, and expansion and even in the toponymy of settlements. Albania is probably a rare case, where about 1/5 of the settlements have borrowed names of elements of the natural environment. There are many settlements in our country whose names appear as hydronyms, oronyms, with names of plants, animals, and even carry the quality of the environment where they were created.

The main object of the paper is to identify the role of elements of the physical-geographical environment in the naming of settlements in our country, as well as the study of the phenomenon of "repetition of the same designation".

Relying on important references of a wide geographical, historical, and linguistic literature, obtaining and interpreting statistical data and analyses through GIS<sup>1</sup>, etc constitute the main methodological approaches of the paper.

**Keywords:** *settlement (territorial unit), toponym, hydronym, oronym, borrowing, depopulation.*

**I. Objekti dhe rëndësia e studimit**

Sa herë diskutojmë rreth vendbanimeve, pyetjet më të zakonshme që na vijnë nëpër mend janë: Cili është kuptimi i emrit të vendbanimit? Kur është krijuar ai? Cilat janë kushtet natyrore dhe tiparet e vendit ku ndodhet etj.

Shpjegimi i emërimit të vendbanimeve përbën një ndër temat më të ndërlikuara dhe të debatuar në vendin tonë. Kontributi i studiuesve të fushave të ndryshme si; historia, arkeologjia, antropologjia, gjeografia, gjuhësia etj., është i domosdoshëm për të bërë një analizë të plotë dhe gjithëpërfshirëse në përcaktimin kohor se kur janë krijuar vendbanimet, si kanë evoluar ato, cilët janë faktorët dhe kushtet e përqendrimit të tyre në hapësira të caktuara gjeografike, përbërja sociale e tyre etj.

---

<sup>1</sup> *Geographic Information System*

Ky studim do të fokusohet në emërtimin e vendbanimeve dhe rolin që ka gjeografia në shpjegimin e tyre pa përfshirë interpretim gjuhësor, kulturor, historik etj. Megjithëse një studim i pjesshëm, nëpërmjet tij do të nxjerrim në pah arsyet që kanë ndikuar që vendbanimet të marrin emra të elementeve dhe dukurive të mjedisit natyror si p.sh.: mal, kodër, fushë, burim, lumë, liqen etj. dhe sa i saktë ka qenë botëkuptimi i shoqërisë njerëzore në emërtimin e tyre.

Një aspekt tjetër që do të trajtohet lidhet me faktin se pse shumë vendbanime në Shqipëri kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm dhe a kanë lidhje ato midis tyre apo është një perceptim i veçuar i banorëve që kanë jetuar ose jetojnë në distanca të afërta, ose të largëta midis tyre. Transformimet gjuhësore, dialektore, historike, dokumentare etj. janë pjesë e pashmangshme e emërtimit të vendbanimeve për të cilat duhet thënë se jo të gjitha kanë mbijetuar deri në ditët e sotme.

Emri i vendbanimit mund të mos jetë i së njëjtës moshë me kohën e krijimit të tyre. Disa prej tyre mund të kenë marrë emra të rinj, ndërkohë që mund të jenë më të vjetër. Për arsye të ndryshme emrat e tyre kanë ndryshuar.

Sipas Laansalu (2015) “Për të përcaktuar moshën e vendbanimeve marrim informacion nga censuset e ndryshme, dokumentet e vjetra, hartat etj., megjithëse ato ekzistonin para se t’u dokumentohej emri. Sa më të rinj të jenë vendbanimet, aq më shumë kemi mundësi për të datuar kohën e tyre, emrin që ato kanë pasur dhe si ka evoluar emri i tyre duke marrë në shqyrtim faktorët e ndryshëm dhe e anasjella”.

Meqenëse kjo është një temë pak e trajtuar në vendin tonë, shqyrtimi i saj është motiv i fortë për të ndërmarrë një studim të tillë. Identifikimi i vendbanimeve me emërtime gjeografike, verifikimi i shkaqeve dhe arsyeve që kanë çuar banorët të bëjnë emërtime të tilla, krahasimi i vendbanimeve me emra të njëjtë nëse



kanë lidhje të tjera origjine, historike, kohëformimi, tipare të njëjta mjedisore apo të njëjta me ato që përshkruajnë emrat e tyre janë disa nga pikësnyimet kryesore të këtij studimi. Dhënia e një kontributi teorik në emërtimin e vendbanimeve do të nxitë edhe studiuesit e fushave të tjera të shpjegojnë nga ana gjuhësore, kuptimore, etimologjike, historike, antropologjike etj. se pse vendbanimet kanë marrë emra të tillë, sa rol kanë kushtet mjedisore në diktimin e emrave të vendbanimeve etj. A janë të ngjashme vendbanimet me emra të njëjtë, pavarësisht vendndodhjes së tyre? A tregon kuptimi i emrave të vendbanimeve tipare apo karakteristika të tjera të tyre?

Të kuptuarit se si vepron psikologjia dhe ndërjegjja e shoqërisë njerëzore në emërtimin e vendbanimeve, cilat janë shtysat që i kanë diktuar komuniteteve të ndryshme të njerëzve për t'u vendosur emra të caktuar qendrave të banuara përbën aspektin praktik të studimit. Pra, sa ka ndikuar peizazhi natyror në peizazhin mendor (*Georgelin, 2015*) të shoqërisë njerëzore në emërtimin e vendbanimeve.

Objekti i studimit do të jenë emërtimet e vendbanimeve që rrjedhin nga gjuha shqipe, të cilat nga ana kuptimore shprehin elemente të mjedisit natyror, tipare të tij, qofshin ato me prejardhje nga emra të përgjithshëm apo të përvëçëm, ose nga kombinimi i dy kategorive të sipërpërmendura. Sigurisht, në shumë vendbanime emërtimet nuk shfaqin fjalë identike si emrat e përgjithshëm, pasi shumë prej tyre shfaqen të transformuara si p.sh.: kodër, kodërz, lumë, lumth, ujë, ujmisht, arrë, arrëz, Fushë - Arrëz etj

Megjithatë, emërtimet e disa vendbanimeve mund të kenë një kuptim të paqartë. P.sh. emërtimi "Gorica", e cila në gjuhët sllave do të thotë "mal i vogël", mund të ngatërrohet me fjalën *gorricë* që në shqip do të thotë "dardhë e egër" (*Clayer, 2015*). Për këtë arsye kemi përjashtuar emërtimet e vendbanimeve që nuk tingëllojnë në shqipe pavarësisht se nga burime të tërthorta iu është bërë

përktimi apo shpjegimi i tyre, të cilat shprehin elemente apo tipare të mjedisit.

## II. Metodadat

Studimi i literaturës bashkëkohore me fokus këtë fushë studimi, përdorimi dhe interpretimi i të dhënave statistikore, analiza nëpërmjet SIG, si dhe referencat historike, gjuhësore dhe emërtesat gjeografike do të lehtësojnë punën për shqyrtimin e emërtimit dhe shpërndarjes gjeografike të vendbanimeve.

Kjo do të realizohet nëpërmjet një sërë metodash si: kamerale, grafike, analitike, krahasimit, matematikore etj., kombinimi i të cilave do të sjellë një këndvështrim të ri dhe interesant në shqyrtimin e vendbanimeve.

Një rol të rëndësishëm në realizimin e punimit tonë përbën informacioni i siguruar nga intervistimi i banorëve të vendbanimeve të ndryshme, i cili ofron një qasje të drejtpërdrejtë rreth trashëgimisë kulturore dhe perceptimit të shoqërisë njerëzore rreth emërtimit të vendbanimeve.

Pjesë e aspektit metodik është edhe konsultimi me gjuhëtarë, historianë, arkeologë etj., si dhe autorë që kanë realizuar studime të njëjta ose të ngjashme me këtë temë studimi.

## III. Toponimia e vendbanimeve dhe vendbanimet me emërtesa gjeografike

Toponimia është studimi taksonomik i emrave të vendeve bazuar në informacione etimologjike, historike dhe gjeografike. Toponimia i ndan emrat e vendeve në dy kategori: emrat e vendbanimeve dhe emrat e veçorive. Një emër vendbanimi tregon një lokalitet që është i populluar ose i banuar, si një shtëpi, fshat ose qytet dhe zakonisht daton që nga fillimi i lokalitetit. Emrat e veçorive u referohen veçorive natyrore ose fizike të peizazhit dhe ndahen në hidronime (tipare ujore), oronime (veçori të relievit)

dhe vende të rritjes natyrore të bimësisë (livadhe, lëndina, korije (Britannica).

Sipas Zulbelari (2019): “Toponimet janë një dokument i heshtur. Dëshmi e qartë për historinë, që ndriçojnë pjesëza të errësirës shekullore. Sigurisht, çdo vend ka një emër dhe kuptim domethënës, të krijuar gjithnjë mbi baza bindëse e shpesh i lidhur me ngjarje që kanë ndodhur, emra, pushtimet e një kohe të largët, me pronarë tokash e familjesh, forma e ngjyra të relievit, ndërtime të vjetra etj. Të emërtuara natyrshëm ato u mbajtën mend brez pas brezi, por kanë pësuar edhe ndryshime”.

Sipas Georgelin (2015) “Toponimia është para së gjithash historia e transformimeve të emrit të vendit, evolucioni fonetik, alterimet e natyrave të ndryshme, së fundi zhdukja e tij, në momentin kur një zëvendësues e fshin atë. Toponimia është e lidhur me emigrimet e popujve, pushtimet, kolonizimet, ndryshimet e gjuhës, po aq sa edhe me vlerën që merr toka dhe me etapat e njëpasnjëshme nëpër të cilat kalon qytetërimi”.

Vendbanimet janë elemente mjaft të rëndësishme të hapësirës gjeografike. Ato përfaqësojnë atë pjesë të territorit të rregulluar për të jetuar një numër i caktuar banorësh. Mënyra se si organizohet një vendbanim, pamja që ai merr, funksionet që kryen etj. janë tipare që shprehin edhe shkallën e zhvillimit të një vendi.

Vendbanimet janë klasifikuar në disa kategori sipas origjinës së tyre:

1) Emra të fenomeneve apo elementeve mjedisore ose siç njihen ndryshe nga gjuhësia emra të përgjithshëm gjeografikë (*Lafe, Cikuli, 2002*) Mal, Kodër, Fushë, Grykë, Burim, Lumë, Liqen, Ndërfushas, Gur, Zall, Breg, Grykë, Qafë, Shkozë, Drithas, Vreshtas, Dushk, Arrë etj).

2) Tipare apo cilësi të mjedisit natyror; Gur i kuq, Baribardhë, Guribardhë, Gurazezë, Pusi i thatë

3) Emra të përveçëm të elementëve të mjedisit (Vjosë, Seman,

Gjadër, Fushë-Lurë, Ishëm, Zall Dajt) etj.

4) Emra njerëzish (Dyrrah, Epidamus, Erind, Shkëlzen, Halilaj) etj.

5) Nga mbiemrat e njerëzve, familjeve të mëdha, fiseve (*Laansalu*, 2015) (Bylis, nga bylinët).

6) Emra me origjinë fetare Shën Gjergj, Shën e Premte, Shën Avlash, Shën Mëri) etj.

7) Emra me origjinë ideologjike, politike (Përparim, Kushtrim, Fitore etj).

8) Emra mitologjike, emra perëndish etj. (Gjirokastër, Paleokastër, Apoloni) etj.

Sigurisht që mjedisi natyror ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në lokacionin e qendrave të banuara, në përcaktimin e tipareve morfologjike, në fizionominë e tyre etj. Funkcionet e mjedisit natyror si: ofrues i burimeve natyrore si uji, ushqimi, lënda drusore, toka etj., **mbrojtës** nga fenomenet natyrore, nga pushtimet, luftërat, sëmundjet, strehues (funksion i cili është zbehur me avancimin e teknologjisë) i japin atij një rëndësi tepër të madhe.

Aq i madh ka qenë ndikimi i mjedisit natyror me elementet e tij në jetesën dhe aktivitetin e shoqërisë njerëzore, sa që edhe qendrat e banuara të krijuara kanë marrë emra të huazuar nga elemente apo fenomene natyrore. Pra, ai është skalitur thellë në subkoshiençën e shoqërisë njerëzore, ku shumë emra të objekteve të gjeografisë fizike (*Lafe, etj 2002*), ose elemente dhe tipare të mjedisit natyror u janë vendosur vendbanimeve. Kjo tendencë është tepër e përhapur në vendin tonë.

Vendbanimet që janë emërtuar me emra të elementeve të mjedisit si: mal, fushë, kodër, burim, krua, gurrë, breg, liqen, dushk, shkozë, gështenjë, lis, sheq, dardhë etj. dhe tipare të mjedisit si: shkallë, gur, i bardhë, i kuq, i zi dhe i lehtë etj., janë të

shumta në vendin tonë, 604 vendbanime nga 3036 në total. (shih tab. 1)

Nuk është e rastësishme që këto qendra të banuara janë emërtuar me emrat e bimëve, drurëve janë autoktone në vendin tonë dhe jo aloktone, p.sh. ekualipt, akacie, banane, palma etj. (p.sh. Palma de Mayorca). Shpeshherë vendbanimet në vendin tonë kanë marrë emra apo mbiemra që shprehin attribute të mjedisit natyror. Janë jo të pakta rastet kur një emri të përgjithshëm që shpreh një element të mjedisit natyror i shtohet edhe një mbiemër. P.sh. Gur i bardhë, Gur i kuq, Gur i zi, Gurra e madhe, Gurra e vogël, Anëvjosë, Anëbreg, Dushk i madh etj. Numri i madh i vendbanimeve që kanë mbiemra në përbërjen e tyre tregon të dhëna cilësore, siç ishin të dhënat e mësipërme, por edhe të dhëna sasiore p.sh. i madh, i vogël, i epërm, i sipërm, i poshtëm, i mesëm, si dhe karakteristika moshore i ri, e vjetër. Për këtë të fundit është kompetencë e historianëve dhe arkeologëve që të datojnë dhe të klasifikojnë kronologjikisht nëse vendbanimet që janë më të hershme personifikohen me mbiemrin e vjetër dhe ato që janë më të vona kanë mbiemrin i ri. Mbiemri i madh dhe i vogël shpeshherë tregon se cili vendbanim është më i madh dhe cili është më i vogël. Por ky mbiemër mundet të mos tregojë madhësinë aktuale të vendbanimeve sipas numrit të popullsisë, sepse faktorët pengues apo favorizues mund të kenë bërë që vendbanimi që ka mbiemrin e madh mund të jetë aktualisht më i vogël për numrin e popullsisë dhe e kundërta.

Këto lloje mbiemrash mund të tregojnë se cili vendbanim është më i hershëm dhe më i vonë (duhet vërtetuar, pasi jo gjithmonë një pohim i tillë është i vërtetë).

Emërtimi i vendbanimeve ku është përdorur mbiemri i/e bardhë mund të lidhet me përbërjen litologjike të territorit ku gjendet vendbanimi, pra me shkëmbinj me ngjyrë gri në të bardhë (siç janë shkëmbinj të gëlqerorë, të cilët kanë një përhapje të madhe në

vendin tonë). Kjo mund të jetë me origjinë etnokulturore dhe etnogjuhësore ku fjala e bardhë është bazë e etnosit tonë. Edhe vendbanimet që shoqërohen me mbiemrat i zi, i kuq, etj., mund të shprehin veçori fizike të shkëmbinjve siç është ngjyra, p.sh. Gur i kuq, Gur i zi etj.

Duhet theksuar se për vendbanimet që kanë emra të përgjithshëm gjeografikë si liqenas, kodër, mal, breg, fushë etj. (Lafe, & Cikuli, 2002), njerëzit i kanë huazuar fjalët nga mjedisi (pra këto fjalë janë përdorur për të emërtuar elementet apo fenomenet natyrore dhe më vonë qendrat e banuara), e kundërta ndodh me emërtimin e vendbanimeve që kanë emra të përveçëm me të cilët janë emërtuar elementet e mjedisit. P.sh. Renc, Karavasta, Adriatik, Dajt, Drino, Qukës-Shkumbin, Ishull-Lezhë, Ishëm, Seman, Tejdrin etj.

Në këto vendbanime nuk dihet nëse emrin e përveçëm si p.sh. Adriatik, Ishëm, Seman e kishte qendra e banuar dhe pastaj ajo iu huazua mjedisit natyror dhe elementeve të tij, apo e kishte elementi natyror dhe pastaj iu huazua vendbanimeve. Për këtë nevojitet datimi kohor i krijimit dhe emërtimit të vendbanimeve, shpjegimi etimologjik i kuptimit të emrave të përveçëm me të cilët janë emërtuar elementet e mjedisit dhe vendbanimet, origjina e fjalëformimeve etj., gjë e cila del jashtë objektit të studimit të një gjeografi.

Sipas Felecan O., Felecan N., (2019): “Emrat më të vjetër e më të qëndrueshëm janë emërtimet e vargmaleve dhe lumenjve të gjatë, të cilët, natyrisht, njihen nga të gjithë popujt që banojnë në territoret nëpër të cilat kalojnë lumenjtë. Në rastin e formës identike të hidronimeve dhe emrave të vendbanimeve, dyshojmë se mosha e hidronimit është më e madhe se ajo e metonimit të emrit të vendbanimit, nëse prania origjinale e hidronimit bëhet e mundshme nga homonimet dhe metonimet toponimike: këto mund të përfshijnë emërtimet që i referohen shtratit të ujit,

emërtimet duke përfshirë emrat e bimëve ose kafshëve ujore etj. Ruajtja e emrit të vjetër për rrjedhën e sipërme të një lumi është një shembull i zakonshëm edhe për toponiminë e vendeve. Për të shmangur ndikimin e pushtuesit, popullsia për të ruajtur emrin autokton emërtoi rrjedhën e sipërme të një lumi. Ndërsa pushtuesit shpikën një emër të ri për të njëjtin lumë, i cili përdorej vetëm për rrjedhën e poshtme. Këtu mund të japim si shembull Aos dhe Vjosë, Devoll dhe Seman etj.

Një element tjetër që duhet verifikuar ka të bëjë me shkallën e përputhshmërisë midis emrave të vendbanimeve dhe elementeve të mjedisit natyror që gjenden pranë tyre. Pra, nëse vendbanimet që janë emërtuar me fjalët mal, fushë, luginë, afër lumit, liqenit, detit etj. janë realisht të lokalizuara pikërisht në reliev malor, fushor, kodrinor, afër liqenit, detit, burimit, përroit, në një territor ku mbizotëron një bimë apo një kat bimor, si p.sh. lajthia, arra, sheqi, vreshtat, dushku, shkoza, gjithashtu nëse mbiemrat që janë pjesë e emërimit të vendbanimeve tregojnë tipare të mjedisit, shoqërisë, moshë, madhësi, vendndodhje të vendbanimeve etj.

Tab. 1. Vendbanimet në Shqipëri me emërtime nga elemente të mjedisit ose tipare të tij (përpunuar autorët)						
Kategoria	Emërtimi gjuhësor	Elemente ose tipare të mjedisit	Nr. vendbanimeve Metonime	Nënkategoritë	Nr. i vendbanimeve	
I Elemente të mjedisit 395	Oronime (Britannica)	Relievi	122	mal	27	
				kodër	37	
				fushë	34	
				forma të tjera relievi	24	
		Litologjia etj.	62	shkëmb	48	
				tipar mjedisi	14	
	Hidronim	Hidrografia	69	lumë	36	
					det	3
					burim	6

				përrua ( krua)	12
				liqen, kënetë, lagunë	6
				ujë (pacaktuar)	6
	Floronime <sup>1</sup>	Bimësia	<b>132</b>	bimë natyrale	81
				bimë kultivuar	51
	Zoonime	Fauna	<b>10</b>		10
<b>II</b>  <b>Tipare të vendbani meve 209</b>		Madhësia numerike	<b>108</b>	e madhe	21
				e vogël	26
				pa caktuar	61
	Pozicioni	<b>63</b>	e sipërme	28	
			e poshtme	24	
			pa caktuar	11	
	Moshë	<b>38</b>	e re	20	
			e vjetër	5	
			pa përcaktuar	13	
		<b>Totali</b>	<b>604</b>		

Nga tabela e mësipërme dallohen 2 kategori kryesore të vendbanimeve; 395 vendbanime që kanë emërtime nga elemente të mjedisit, ndërsa 209 prej tyre shprehin tipare apo veçori të mjedisit. Vendbanimet e grupit të dytë mund të jenë thjesht emërtime që janë krijuar nga mbiemrat i/e sipërme, i/e poshtme, i/e madhe, i/e vogël, i ri, e vjetër, të shoqëruar me një emër i cili mund të ketë ose jo kuptim gjeografik. P.sh. Kërçisht i Poshtëm, Kërçisht i Sipërm, Labovë e Poshtme, Labovë e Sipërme, Osmenezë, Osmenezë e re, Qerret i madh, Qerret i vogël etj. Po ashtu, edhe në kategorinë e parë vendbanimet mund të përbëhen nga një fjalë me kuptim gjeografik e cila mund të paraqitet ashtu siç është në origjinal ose e transformuar; p.sh. Burim, Burimas, Buronjë, Kodër, Kodras, Liqen, Liqenas, Gurrë, Gurras, Lajthi, Lajthizë, Fikas, Fikth Sheq, Sheqëz, Sheqishte, Arrë, Arras, Arrëmollë, Arrëvend etj., por ka edhe vendbanime të cilat krahas emrit gjeografik përmbajnë edhe

<sup>1</sup> Këshillim për terminologjinë toponimike: Petrit Nika (studiuues)



fjalë të tjera me kuptim ose jo gjeografik. Këtu mund të përmendim: Ujëmirë, Ujëmisht, Barç Mal, Seman i Ri, Fushë - Prezë, Labinot fushë, Fushë-Muhur, Kodër-Kamëz etj.

Një nënkategori brenda kategorisë së parë janë edhe emërtimet e vendbanimeve me emra të njëjtë si emrat e përveçëm që mbajnë elementet e mjedisit gjeografik. Këtu mund të përmendim qendrat e banuara si Adriatik, Ishëm, Seman, Drino, Karavasta, Vjosë, Qukës-Shkumbin, Valbonë, Kunorë Lurë, Tejdrin, Bistricë etj.

Nënkategoritë që mbajnë peshën më të madhe janë toponimet që lidhen me relievin, 122 vendbanime, bimësia 132, hidrografia 69. Kjo tregon rolin e madh dhe përcaktues që kanë këto elemente të mjedisit gjeografik te shoqëria njerëzore në vendin tonë. Një veçori tjetër që bie në sy te vendbanimet emërtimet e të cilave kanë origjinë nga mjedisi, është se ato janë kryesisht vendbanime rurale. Kjo tregon lidhjen e fortë të varësisë që kanë vendbanimet rurale me mjedisin natyror dhe elementet e tij.

Megjithatë, nga ky rregull i përgjithshëm vihen re përjashtime për vendbanimet urbane si Fier dhe Fushë-Arrëz, Fushë-Krujë, për të cilat nuk është shpjeguar plotësisht nëse përbëhen nga fjalë me origjinë nga mjedisi, si bima e fierit apo kanë kuptime të tjera, për rastin e qytetit të Fierit. Ndërsa për vendbanimin Fushë- Arrëz, i cili megjithëse konsiderohet qytet, ngjan më tepër me një fshat nëse do të marrim parasysh funksionet, popullsinë etj.



Hartë tematike: Vendbanimet hidronime të Shqipërisë, burimi ASIG, punoi në GIS Mariglen Sherifaj

Një kategori tjetër vendbanimesh që për shkaqe të politikave nacionaliste, ideologjike etj., mund t'u ndryshohen emrat, t'u vihen emra të ngjashëm apo të njëjtë me ata ekzistues të cilët mund të jenë me prejardhje nga mjedisi apo elemente mjedisore. Gjatë periudhës së regjimit komunist në vendin tonë toponimet e përbëra që përmbanin fjalë të tilla si "çiflig", "aga", "pasha", "bej", do të ndryshoheshin duke u hequr fjalët e gjykuara si "të padobishme dhe anakronike" (meqenëse lidheshin me hierarkinë sociale të bazuar mbi pronësinë tokësore). Për të bërë dallimin midis fshatrave që mbanin të njëjtin emër, këta emra shoqëroheshin me cilësorët "i epërm" ose "i poshtëm" (Clayer, 2015). P.sh. fshatit Ahmet Bejas (Ahmet beu) në Fier iu ndryshua emri i mëparshëm dhe u emërtua Vjosë për shkak të afërsisë me lumin homonim. Kështu, nga një vendbanim me prejardhje nga një emër njeriu u konvertua me një emërtim që tregon një element mjedisi.

#### **IV. Vendbanimet dhe fenomeni i përsëritjes së të njëjtit emërtim**

Të hedhësh dritë mbi emërtesën e vendbanimeve dhe dukurinë e përsëritjes së të njëjtit emër te vendbanimet në hapësira të ngushta apo të gjera gjeografike, kërkon një punë voluminoze dhe gjithëpërfshirëse nga ekspertë të fushave të ndryshme.

Datimi i vendbanimeve që nga antikiteti deri në ditët e sotme, renditja e tyre sipas kronologjisë së krijimit që nga ato më të lashtat deri te më të vonshmet, përcaktimi i vendndodhjes si dhe emri apo emrat që ka pasur secili vendbanim në periudha të ndryshme historike, do të sillte rezultate të kënaqshme për të kuptuar shpërndarjen gjeografike të qendrave të banuara, për të saktësuar vendbanimet mëma dhe bija, për të kuptuar se cilat vendbanime kanë qenë më të hershme dhe më të vona dhe pse është përsëritur i njëjti emër te vendbanimet në hapësira të ndryshme gjeografike

brenda apo jashtë vendit tonë. Ndihmë në këtë drejtim do të jepte njohja e lëvizjeve migratore sipas të cilave mendohet që janë krijuar vendbanime të reja me të njëjtin emër ose jo, pushtimet, luftërat, rreziqet natyrore etj., faktorë këta që kanë detyruar njerëzit të lëvizin nga njëra hapësirë në tjetrën, qoftë në drejtimin horizontal dhe vertikal.

Në studimin tonë kemi marrë në shqyrtim vendbanimet e periudhës aktuale dhe më konkretisht ato që përmbajnë kuptim të veçorive apo tipareve të mjedisit. Sigurisht që puna e diferencimit të tyre nuk është aq e thjeshtë, pasi edhe në ditët e sotme emrat e vendbanimeve mund të mos jenë në formën e tyre fillestare apo të shprehin fjalë kuptimplota. Kjo dije e mangët na jep të drejtën që të spekulojmë ose të hamendësojmë me informacionin që posedojmë.

Fenomeni i përsëritjes së emrit të vendbanimeve është një dukuri e shpeshtë në vendin tonë. Ai në dukje paraqitet i thjeshtë dhe i parëndësishëm, por aq i vështirë dhe domethënës është.

Vendbanimet me emra të njëjtë janë shfaqur që me shfaqjen e shoqërisë njerëzore dhe krijimin e vendbanimeve të qëndrueshme. Emërtimi i qytetit antik të Apolonisë nga kolonët e ardhur nga Korinthi dhe Korfuzi, duke i dhënë emrin e perëndisë Apolon, nuk është rast unikal. Krahas saj ekzistonin rreth 30 Apoloni gjatë periudhës antike (*Xholi, Vejsiu, 2008*).

Kjo përsëritje e emërtimit të vendbanimeve vihet re në disa forma kryesore.

a) Vendbanimeve me emra identikë, p.sh.: Golem në Lushnjë, Golem në Kavajë, Golëm në Gjirokastër.

b) Emërtime të përafërta të cilat kanë rrënjë të njëjtë, por ka ndryshime ose transformime të fjalës nga janë krijuar. P.sh. Fik, Fikas, Fikth, Liqen, Liqenas, Liqenth, Burim, Burimas, Buronjë, Fushë, Fushas etj.

c) Emërtime që përbëhen nga dy ose më shumë fjalë, ku një fjalë e tyre është e njëjtë. Ngurrëz e madhe, Ngurrëz e Vogël, Barç, Barç mal, Sheq i Madh, Sheq i Vogël, Sheq-Musalala.

d) Emërtime që janë krijuar nga fjalë të përbëra ose të përngjitura p.sh. Fushë-Arrëz, Arrëz, Arrëvend, Arrmollë, Lumë, Lumbardh etj.

Nëse do të shohim hartën e Shqipërisë e cila ka 3036 vendbanime, nga të cilat 2962 fshatra dhe 74 janë qytete, konstatojmë se gati në gjysmën e vendbanimeve në vendin tonë vihet re fenomeni i përsëritjes së emrave të vendbanimeve. Pra në 1600 prej tyre përsëritet i njëjti emër ose i ngjashëm, të paktën një herë deri në disa herë. Në 604 vendbanimet e marra në studim, emrat e përsëritur kanë lidhje me tipare të mjedisit apo elemente të mjedisit natyror. Përsëriten të paktën 1 herë deri në 11 herë ku fjalët që i formojnë ata nuk janë identike, por përafërsisht të njëjta. Disa nga vendbanimet që përsëriten më shpesh janë të krijuara nga fjalët arrë, dardhë, burim, mal, fushë, kodër, breg etj.

<i>Tabela. 2 Vendbanimet me origjinë natyrore me shpeshësinë më të madhe të përsëritjes; burimi: përpunuar autorët</i>			
Nr	Vendbanime me prejardhje nga fjalë të thjeshta	Përsëritja (në herë)	Element i mjedisit
1	arrë+ prapashtesë	11	Flora
2	gurrë+ prapashtese	7	Hidrografia
3	bregas	7	Relievi
4	dardhë+ prapashtese	6	Flora
5	kodras	6	Relievi
6	drizë+ prapashtese	5	Flora
7	bardhaj ( i bardhë)	5	Cilësi
8	lajthizë	4	Flora
9	mollas	4	Flora
10	sheq+ prapashtese	4	Flora
11	shkozë	4	Flora
12	vreshtas	4	Flora

13	shkallë	4	Relievi
14	Adriatik	3	Hidrografia
15	fushë + prapashtese	3	Relievi

Rreth përsëritjes së emërtimit të vendbanimeve na orienton kronologjia e formimit të tyre. Vendbanimet me emër të njëjtë mund të jenë të njëkohshëm apo të krijuar në kohë të ndryshme. Nëse ato janë krijuar në të njëjtën kohë, atëherë ato mund të jenë krijuar nga familje apo fise të cilat për shkaqe të ndryshme janë larguar nga vendbanimi amë për t'u vendosur në hapësira të pabanuara dhe këto hapësira kanë marrë emrin e familjes që ka migruar.

Edhe aktiviteti ekonomik është një faktor që ka ndikuar në krijimin e vendbanimeve të reja apo në shfaqjen e toponimeve që i hasim diku tjetër, pavarësisht se banorët mund të jenë të së njëjtës origjinë ose jo, p.sh. barinjte që çojnë kopenë e bagëtime në vende të ndryshme në verë në mal, ndërsa në dimër në zona të ulëta fushore dhe kodrinore. Barinjtë, mjekët, çirakët, zanatçinjtë (muratorë, drupunues, gurpunues, kovaçë etj.), janë grupe shoqërore të cilat kanë migruar së tepërmi dhe për pasojë shumë toponimeve iu janë vendosur emra të tillë. Në mjaft raste emrat e lagjeve, fshatrave, lagjeve të qyteteve etj., toponimet nuk janë gjë tjetër vetëm se mbiemrat e tyre, apo ato kanë marrë emra të përgjithshëm si sahatçiu, teneqexhiu, nallbani, derveni etj. Nëse vendbanimet me të njëjtin emër nuk janë të njëkohshëm si p.sh. Levan Plak (Tepelenë), Levan Cirua (Berat), Levan Shaban (Fier), atëherë faktorët që kanë ndikuar mund të jenë; migrimi, konflikte shoqërore (hasmëria), zgjerimi i një vendbanimi me shtëpi apo lagje të reja të cilat gradualisht kthehen në fshatra më vete si Çërrile, Çërrilë e Re, Kallm i Madh, Kallm i Vogël, Patos i Vjetër, Patos i Ri (qytet), Patos Fshat etj.

Vendbanime me emërtesa të njëjta, por që gjenden larg njëri-tjetrit është një tjetër aspekt interesant që duhet analizuar dhe duhen nxjerrë në pah shkaqet, faktorët, origjina etj. Këtu mund të përmendim vendbanime të tilla si: Golëm (Gjirokastrë), Golem (Lushnjë), Golem (Durrës), Klos (Mallakastër), Klos (Lezhë), Floq (Fier) Floq (Korçë) etj.

Emërtimi i vendbanimeve me të njëjtin toponim vihet re jo vetëm brenda territorit të Shqipërisë, por në shtetet fqinje me Shqipërinë. P.sh. në Italinë e Jugut, në Greqinë e Jugut (Atikë, Peleponez), vendbanimet e arbëreshëve dhe arvanitëve, të krijuara pas shpërnguljes së një pjese të popullsisë shqiptare si pasojë e pushtimit turk. Vendbanime të tilla janë Varibop (Fier), Varibop (Përmet), Varibop (Athinë), Varibop (Kalabri) (*Stojkov, Kacori, 1966*) e njëjta gjë vihet edhe për fshatrat Floq, Hekal, Drenovë, Fratar etj. Se cili është historiku i krijimit të këtyre vendbanimeve dhe cili prej tyre është vendbanimi amë brenda territorit të Shqipërisë (pasi ato që janë në vendet fqinje janë të mëvonshme si rezultat i lëvizjeve migratore të dokumentuara), kjo është një sfidë që u përket historianëve, arkeologëve, gjuhëtarëve, që të hedhin dritë.

Një tregues që duhet pasur parasysh në shpjegimin e origjinës së vendbanimeve amë dhe bija, është edhe kuptimi dhe shpjegimi i domethënies së toponimeve dhe çfarë lidhjeje kanë ato; me mbiemrat e familjeve, me tiparet e peizazhit, me funksionin që kanë luajtur dhe luajnë, me karakteristikat shoqërore, ekonomike, administrative etj.

Për krijimin e vendbanimeve të reja mund të shërbejë si pikënisje krijimi i një lagjeje të veçuar e një fshati, ku banorët e së cilës fillimisht e quajnë veten banorë të fshatit ndërsa me kalimin e kohës rritja e numrit të banorëve të kësaj lagjeje, zgjerimi i sipërfaqes së saj, identifikimi me një emër tjetër si p.sh. mbiemri i fisit më të madh ose me më shumë reputacion, atëherë ato shpallen si vendbanime më vete. Sipas Ziut, (2009) "Vendbanimet e rendit

të dytë, sipas madhësisë, janë fshatra të veçanta të njohura tradicionalisht si të tilla. Banorët e atij fshati e njohin veten me emrin e atij fshati dhe e dallojnë veten nga banorët e fshatrave përreth”.

Duhet theksuar se jo gjithmonë emërtimi i njëjtë ose i ndryshëm i emërtimeve të vendbanimeve na orienton saktë dhe drejt në të kuptuarit e lidhjeve të tyre ose jo. Shpesh banorët migratorë nga një vendbanim drejt një hapësire tjetër gjeografike, kanë krijuar vendbanime me emra të ndryshëm për arsye të ndryshme si; për t'i shpëtuar persekutimit nga pushtuesit, për të humbur gjurmët e hasmërisë, kanë huazuar për vendbanimin emrat e elementeve të mjedisit, iu kanë vendosur emrat e të parit të fisit apo mbiemrin e familjes më të madhe ose familjes së parë që ka krijuar bërthamën së vendbanimit etj.

Sipas intervistave me banorët e fshatit Buz (Tepelenë) në fillim të shek. XIX një pjesë e stërgjyshërve të tyre migruan si shkak i persekutimit nga pushtuesi turk, u vendosën në fushat kënetore të rrjedhës së poshtme të lumit Seman duke i vendosur vendbanimit të tyre emrin Kallm (kallëmb - bimë ujëdashëse). Sot ky fshat është i ndarë në dy vendbanime, përkatësisht Kallm i Madh dhe Kallm i Vogël dhe në një lagje më vete me emrin Kallm Buxhak.

Iu takon historianëve që të përcaktojnë nëse emri i përsëritur si Kallëmb në rrjedhën e poshtme të Vjosës (tashmë i braktisur si pasojë e përmbytjeve të këtij lumi në vitin 1963), të Semanit apo emërtimet e ngjashme si Kallmet i Madh dhe Kallmet i Vogël (Lezhë), (në një distancë të konsiderueshme nga vendbanimet e mësipërme të krijuar me emrin Kallm), popullsia ka si origjinë fshatin Buz të Tepelenës. Ata duhet të përcaktojnë nëse emrat e tyre janë rastësisht të njëjtë, duke marrë si referencë elemente të mjedisit fiziko-gjeografik apo lidhja dhe origjina e tyre është e njëjtë.



## Përfundime dhe rekomandime

✚ Vendi ynë dallohet për larmi të madhe të emrave të qendrave të banuara, të cilat tregojnë emra të vendeve, elemente dhe tipare të mjedisit, personazhe historike, mbiemra të familjeve të mëdha, emra me origjinë ideologjike, emra me origjinë fetare etj.

✚ Emrat e gati 20% ose 604 vendbanimeve nga 3036 që ka vendi ynë, nënkuptojnë elemente dhe tipare të mjedisit natyror .

✚ Mjedisi natyror dhe elementet e tij kanë luajtur një rol tepër të madh në perceptimin e shoqërisë njerëzore për emërtimin e vendbanimeve. Janë 395 vendbanimeve, emërtimet e të cilave nga ana kuptimore shprehin elemente të mjedisit natyror. Ndërsa 209 vendbanime shprehin tipare dhe veçori të mjedisit natyror.

✚ Perceptimi i shoqërisë njerëzore në emërtimin e qendrave të banuara që shprehin veçori të mjedisit apo tipare të tij, ka qenë më tepër intuitiv sesa i bazuar në koncepte apo përcaktime shkencore gjeografike. Një pjesë e vendbanimeve të emërtuara me emrat fushë, kodër, mal nuk gjenden saktësisht në një reliev malor, fushor apo kodrinor. P.sh. mali i Rencit, mali Kolaj, mali Kakariq, Mali i Robit, Fushë Arrëz, Fushë-Lurë, Fushë Çidhën etj. Kjo lidhet me perceptimin e banorëve për relievin, i cili nuk është gjithmonë i saktë, pasi në territore me lartësi të vogla mbi nivelin e detit, kodra mund të hiperbolizohet si mal, forma pozitive si kodër (pavarësisht se nuk përmbushin kriterin e lartësisë). E njëjta gjë ndodh edhe për konceptin fushë që mund të quhet çdo territor i rrafshët dhe me pjerrësi të vogël, pavarësisht se lartësia mbi nivelin e detit mund të jetë më shumë se 200 m.

✚ Emërtimi i vendbanimeve me fjalën kodër ka qenë më i saktë nga shoqëria njerëzore. Pra shumica e vendbanimeve që janë emërtuar me fjalën kodër gjenden në një reliev kodrinor dhe forma pozitive të relievit. P.sh. Kodras (Korçë), Kodras (Elbasan), Kodër (Tepelenë) etj. Megjithatë në disa raste vendbanimet e emërtuara me fjalën kodër mund të mos jenë në intervalin 200-1000 m mbi

nivelin e detit, që është përcaktuar si reliev kodrinor. Si p.sh. Kodër Vorë (Tiranë), Kodras (Pogradec) etj.

✚ Vendbanimet me emra të tillë si breg, shpat, grykë, qafë etj., rreth 24, janë emërtuar drejt nga shoqëria njerëzore, pasi ato gjenden pranë këtyre formave të relievit.

✚ Ekziston një përputhje gati e plotë midis vendbanimeve, emrat e të cilave përfaqësojnë emra bimësh, emra të elementeve hidrografikë, si: lumë, liqen, burim, gurrë etj. dhe elementeve mjedisore që gjenden pranë tyre. Pra në një territor që ka drurë të tillë si: arra, mollë, dardha, vreshta, shkozë, dushqe, lajthi etj., edhe vendbanimet kanë marrë emra të këtyre përfaqësuesve të florës. E njëjta gjë mund të thuhet për vendbanimet që kanë marrë emra të elementeve të hidrografisë (shih tab. 1).

✚ Fenomeni i përsëritjes së emërtimit të njëjtë te dy ose më shumë vendbanime është mjaft i përhapur në vendin tonë. Kjo dukuri është e përhapur edhe në vendbanimet që kanë emërtime të cilat shprehin elemente dhe tipare të mjedisit natyror (shih tab. 2).

✚ Shpjegimi i kuptimit të fjalëve që janë përdorur për të emërtuar vendbanimet është bërë i pjesshëm, sa shpeshherë gjuhëtarë, historianë, gjeografë etj. janë në dilemë për kuptimin dhe arsyet pse janë vendosur emra të tillë.

➤ Nevojiten studime të thelluara për të analizuar shkaqet, faktorët, kushtet dhe perceptimin e shoqërisë njerëzore në emërtimin e vendbanimeve. Kjo kërkon studime multidisiplinore nga ekspertë të fushave si gjuhësia, historia, antropologjia, gjeografia, arkeologjia etj.

➤ Shpjegimi i emërtimit të vendbanimeve do të nxjerrë në dritë mjaft fakte dhe zbulime që lidhen me toponiminë në vendin tonë dhe evoluimin e saj që është shoqëruar me transformime gjuhësore, kulturore, konceptuale dhe perceptuese të realitetit.

➤ Gjetja e shkaqeve se pse përsëriten emrat e njëjtë në dy ose më shumë vendbanime do të na ndihmojnë të kategorizojmë

vendbanimet sipas kohës së krijimit, origjinës, moshës, ngjashmërive dhe dallimeve që ato kanë etj.

➤ Klasifikimi kronologjik i vendbanimeve kërkon; datimin e kohës së krijimit të tyre, njohjen e lidhjeve që ato kanë pasur dhe kanë midis tyre, të verifikohet nëse dy vendbanime me emër të njëjtë janë krijuar njëkohësisht, nëse kanë lidhje varësie midis tyre, nëse emërtimi i tyre me të njëjtin emër është rastësi apo i një origjine të përbashkët etj.

➤ Shpjegimi i kuptimit të fjalëve që kanë emërtuar vendbanimet, në dukje, nuk paraqet ndonjë vlerë praktike, por nga ana tjetër ai tregon botëkuptimin e shoqërisë njerëzore për vendet, toponimet, objektet, sendet dhe se si ai ka ndryshuar në kohë dhe hapësirë. Kjo sipërmarrje do t'i çojë në një stad të ri shkencat që merren me aktivitetin human dhe marrëdhënien e shoqërisë njerëzore me mjedisin.

➤ Gjeografët me drejtim human duhet të bëjnë më tepër përpjekje për identifikimin dhe analizimin e emërtimit të vendbanimeve duke mos qëndruar vetëm “brenda mureve të kështjellës së gjeografisë”, por të dalin në “terrene të hapura” ku nevojitet ndërveprimi me studiues të fushave të tjera dhe për të bërë studime ndërdisiplinore.

## Literatura

Britannica, E. (n.d.). *Toponymy*. Retrieved 11 20, 2021, from Britannica:<https://www.britannica.com/science/toponymy>

Clayer, N., (2015). *Të emërtosh dhe të klasifikosh në Ballkan*. (A. Puto, Trans.) Tiranë: Guttenberg.

Felecan Oliviu; Felecan Nicolae. (2019). *Toponymic homonymies and metonymies: names of rivers vs names of settlements*. Retrieved 10 18, 2021, from <https://www.raco.cat/index.php/Onomastica/article/download/361863/456466/>:

Georgelin, H., (2015). *Të emërtosh dhe të klasifikosh në Ballkan*. (P. Arben, Trans.) Tiranë: Guttenberg.

<https://geoportal.asig.gov.al/sq/node/235>

Laansalu, T., (2015). *similarities and differences betëeen older snd neëer settelement layers*. Retrieved 10 25, 2021, from [https://www.researchgate.net/publication/301895485Similarities and differences betëeen older and newer settlement name layers](https://www.researchgate.net/publication/301895485Similarities_and_differences_betëeen_older_and_newer_settlement_name_layers)

Lafe, E., Cikuli, N., (2002). *Fjalori i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Shkenca.

Stojkov Rusi, Kacori, Th., (1966). Një regjistër Osmano-Turk i shek XV për shqiptarët e Peleponezit. *Studime Historike Nr.3*, 152.

Xholi, Z., Vejsiu, Y., (2008). *Fjalori enciklopedik shqiptar*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Ziu, T., (2009). *Gjeografia e rregullimit të territorit*. Tiranë: Pegi.

Zulbelari, A., (2019). *Microtoponyms of Xhepcisht and Poroj*. FILOLOGJIA - International Journal of Human Sciences, 12 <http://eprints.unite.edu.mk/250/>

## **PANELI II**

### **ASPEKTE HISTORIKE, URBANIZIMI DHE ORGANIZIMI I VENDBANIMEVE**



**Prof. dr. Skënder Aliu**

## **VENDBANIMET PREHISTORIKE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE**

### **Abstrakt**

Fusha e Korçës, Devollit dhe pllaja e Kolonjës, së bashku me zonën e liqeneve të Prespës e Ohrit, përbëjnë rajonet kryesore të Shqipërisë Juglindore. Kushtet gjeoklimatike, tokat e përshtatshme për prodhime bujqësore (fusha e Korçës, e Devollit dhe pllaja e Kolonjës), Mali i Thatë, mali i Moravës, malet e Gramozit dhe malësitë e Gorës, Oparit, Vithkuqit, Mokrës, malësia e Dangëllisë, Kolonjës e Leskovikut, të pasura me pyje e kullota alpine të përshtatshme për blegtori, kanë favorizuar që herët jetesën njerëzore në epokat prehistorike.

Gërmimet arkeologjike, fillimisht në vitin 1961 e në vazhdim, zbuluan, studiuuan e botuan një numër të madh vendbanimesh shpellore, fushore e kodrinore. Në vështrim të përgjithshëm ato datohen në epokën e neolitit, mijëvjeçari VII- IV p. Kr dhe me vijimësi në epokën e eneolitit 2700- 2200 p. Kr, epokën e bronzit 2200- 1100 p. Kr dhe epokën e hekurit 1100- 650 p.Kr.

Grupin kryesor, ndonëse numerikisht të kufizuar, e zënë vendbanimi shpellor i Trenit, pranë liqenit të Prespës së Vogël; Vendbanimi shpellor i Podës në bashkinë e Kolonjës, në të cilat janë realizuar gërmime arkeologjike ndër vite.

Grupin tjetër, të madh numerikisht, e zënë vendbanimet fushore të zbuluara kryesisht pranë fshatrave Vashtëmi, Podgori, Dunavec, Maliq, Barç, Sovjan etj. në rrethin e Korçës; Vendbanimi "Guri i Nines" Luaras, Shkëmbi i Kamnikut dhe vendbanimi i Robasit, pranë fshatrave Boshanj- Lubonjë në rrethin e Kolonjës.

Grupin e tretë dhe më të madh në numër e zënë vendbanimet kodrinore. Ato janë ndërtuar kryesisht mbi kodra shkëmbore, pranë rrugëkalimeve dhe qafave lehtësisht të kalueshme, përmes së cilave kanë mundësuar lidhjet me krahinat e tjera fqinje e të largëta adriatiko-egjeane. Kalaja "Guri i Nines" Luaras, e Gradecit, Bejkovës, Hollmit, Barmashit etj., në zonën e Kolonjës si dhe Kalaja e Radanjit, Vrëpckës, Malishtë e Madhe, Malishtë e Vogël në zonën e Leskovikut; Kalaja e Symizës, Hija e Korbit, Trenit, Shuecit, Trajanit etj. në bashkinë e Maliqit e Devollit, si dhe Kalaja e Pogradecit dhe e Selcës së Poshtme në bashkinë e Pogradecit.

Në kumtesë prezantohen disa nga vendbanimet kryesore prehistorike, midis të cilave bëjnë pjesë: Vendbanimi palafit i Dunavecit, i datuar në neolitin e mesëm ( mijëvjeçari V p.Kr.), e sidomos vendbanimi palafit i Maliqit, i datuar në epokën eneolitike, fundi i mijëvjeçarit III p.Kr., një nga kryeqendrat e arkeologjisë prehistorike, me vlera panballkanike.

*Fjalë çelës: Fusha e Korçës, Devollit dhe pllaja e Kolonjës; vendbanim shpellor, vendbanimet fushore, vendbanimet kodrinore.*

### **Prehistoric settlements in southeast Albania**

#### **Abstract**

Korça plain, Devolli plain and Kolonja plateau together with the area of Prespa Lake and Ohrid, are the most important regions of Southeast Albania. The geo-climatic conditions, the suitability of lands for agriculture (Korça plain, Devolli plain and Kolonja plateau), Mali i Thatë, Morava Mountain, Gramoz Mountain and the highlands of Gorë, Opar, Vithkuq, Mokër, the highlands of Dangëlli, Kolonjë and Leskovik, rich in forests and cattle pastures and suitable for animal husbandry, favored the development of human life since the prehistoric ages.

Archaeological excavations, from 1961 and onwards have discovered, studied and published a large number of cave and rock shelter sites, as well as settlements situated in field and hilly areas.

Generally, these settlements date in the Neolithic Age, in the 7<sup>th</sup> – 4<sup>th</sup> millennium BC, and continuing to the Eneolithic Age in 2700 – 2200 BC, Bronze Age 2200 – 1100 BC and the Iron Age 1100 – 650 BC.

The main group of settlements, although limited in terms of numbers, is represented by the cave sites of Tren, in the vicinity of Little Prespa Lake; the cave settlement of Podë in the region of Kolonja, both being in the focus of archaeological investigation through years.

The second group, larger in number of sites located in plain areas, is represented by the settlements discovered mainly in the vicinity of the villages Vashtëmi, Podgori, Dunavec, Maliq, Barç, Sovjan, etc. in the region of Korça; the settlement “Guri i Nines” in Luaras, Shkëmbi i Kamnikut and the settlement of Robasi, in the vicinity of villages Boshanj-Lubonjë in the region of Kolonja.

Another third group, the largest in terms of the number of discovered settlements, is represented by sites located in hilly areas. These settlements are constructed mainly in rocky hills, in the vicinity of crosswalks and mountain passes, which provided communication with other neighboring and distant regions of Adriatic and Aegean. This group is represented by the fortifications of “Guri i Nines” Luaras, Gradec, Bejkova, Hollm, Barmash, etc. in the region of Kolonja and the fortifications of Radanji, Vrëpckë, Malishtë e Madhe, Malishtë e Vogël in the region of Leskovik; the fortifications of Symiza, Hija e Korbit, Tren, Shuec, Trajan, etc. in the region of Korça as well as the castle of Pogradec and Selcë e Poshtme in the area of Pogradec.



This paper will describe some of the main prehistoric settlements, such as: the *palafittic* (pile-dwelling) site of Dunavec, dated in Middle Neolithic (5<sup>th</sup> millennium BC) and *palafittic* settlement of Maliq, dated in Eneolithic, end of 3<sup>d</sup> millennium BC, one of the most important sites of prehistoric archeology and of panbalcanic values.

Generally, in this article will introduce the geographic position, the location, and the current situation for each of these settlements, as well as their cultural values in the context of tourism and agro tourism.

**Keywords:** *Korça, Devoll plain and Kolonjë plateau; cave settlements, plain settlements, hilly settlements.*

## Objekti dhe rëndësia, hapësira dhe metoda e studimit

Shqipëria Juglindore në vështrim të përgjithshëm gjeomorfologjik përfshin tri rajone fiziko-gjeografike të ndryshme. Vendin kryesor e përfaqëson fusha e Korçës me sipërfaqe 300 km<sup>2</sup>, me gjatësi 35 km veri-jug dhe 16 km gjerësi, së bashku me fushën e Devollit 21 km e gjatë lindje-perëndim dhe 7 km gjerësi. Ato komunikojnë midis tyre përmes grykës së ngushtë të Cangonjit me gjatësi 3 km. Brenda kufijve të këtij rajoni përfshihen gjithashtu malësia e Gorës, Oparit, Vithkuqit, Voskopojës, të cilat lartësohen në perëndim të fushës së Korçës. Shpatet e malit të Rungajës, me sheshe midis tyre, janë të përshtatshme për skiatorë vendës e të huaj. Ujërat e përrrenjve që zbresin shpatet e Rungajës, së bashku me burimet karstike të cilat dalin pranë fshatit Shtyllë formojnë rrjedhjen e sipërme të lumit Osum, i cili kalon përmes Vithkuqit dhe fushës së Leshnjës.

Në rajonin e dytë të Shqipërisë Juglindore përfshihen zona e liqeneve të Prespës, Ohrit dhe krahinat e Pogradecit.

Këto zona, me kushte fiziko-gjeografike të përshtatshme për jetesë, me ujërat e bollshme të liqeneve, u kanë mundësuar banorëve të këtij rajoni të merren që herët e në vazhdim me blegtori, gjueti e peshkim.

Një vend të rëndësishëm në këtë rajon zënë Gropa e Pogradecit, që përfshin fushën e Buçimasit në jug, atë të liqenit të Pogradecit

me gjatësi 6 km lindje-perëndim dhe 3 km gjerësi. Brenda kësaj grope renditet gjithashtu fusha e Memlishtit, e Gurit të Kuq, e Qafës së Thanës, me dy km gjatësi veri-jug dhe 1 km gjerësi, si dhe fusha e Pojskës, Hudënishtit, Tushemishtit (Driloni antik). Pranë kësaj fushe dalin ujërat të cilat zbresin në rrugë nëntokësore nga Liqeni i Prespës së Madhe me bukuri befasuese, për nxënës, studentë dhe turistë vendës e të huaj.

Vlerat e tjera kanë të bëjnë me ujërat që dalin nga liqeni i Pogradecit, pranë qytetit të Strugës, që shënojnë fillimin e lumit Drini i Zi. Lugina e këtij lumi, me kushte shumë të përshtatshme fiziko-gjeografike, ka shërbyer si rrugë natyrore për marrëdhëniet e banorëve të Shqipërisë Juglindore jo vetëm me krahinat fqinje të Maqedonisë, por edhe me rajonet e largëta të Ballkanit e të pellgut qendror të Danubit, që herët në epokat prehistorike.

Rajoni i tretë shtrihet nga mali i Qarrit në veri deri në brigjet e lumit Vjosa në jug. Vendin qendror e përfaqëson pllaja e Kolonjës me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup>, me përmasa 20 km veri-jug dhe afërsisht deri në 8-10 km lindje-perëndim, që shtrihet përfund maleve të Gramozit, e veshur tërësisht me bar dhe gjithfarë lulesh e bimë medicinale, të dobishme për banorët. Përrenjtë e Kozelit, Shtikës e Selenicës, Starjes, Rehovës e Borovës, që zbresin nga shpatet e Gramozit, marrin në grykat depërtuese formën e kanioneve. Më i rëndësishmi ndër ta është kanioni i “Virkës”, me 900 m gjatësi, 105 m lartësi dhe 5-6 m gjerësi, i cili depërton midis kodrës të kalasë së Bejkovës dhe kodrës shkëmbore të Goricës, që ndodhen afërsisht 3 km në perëndim të qytetit të Ersekës, të cilat vlen të vihen në funksion të turizmit natyror e kulturor (Fig.1).

Malësia e Kolonjë-Leskovikut, me gjatësi 90 km veri-jug dhe 19 km gjerësi, shtrihet nga rrjedhja e sipërme e lumit Osum e deri në Malin e Melesinit e Postenanit në jug. Ajo fillon me pllajën e Rungajës në veri, me burime të shumta ujore që shënojnë rrjedhjen

e sipërme të lumit Osum<sup>1</sup>. Në vazhdim lartësohet Mali i Zi (1689 m), në trajtë konike, me gjelbërim të përhershëm. Në faqet perëndimore të këtij mali ndodhet liqeni akullnajor, i njohur nga vendësit me emrin “Gjoli i Madh” (Fig. 2).



Fig.1, Kanioni i Virkës në Kolonjë



Fig. 2, Liqeni akullnajor në Malin e Zi.

---

<sup>1</sup> KARAISKAJ, ALIU 1984, f. 61.

Në këtë pjesë të kësaj malësie lartësohen njëra pranë tjetrës kodrat e veshura me bar, drurë pyjorë dhe kullota dimërore e verore për blegtori. Midis tyre shtrihet dhe fusha e Boshanj-Lubonjës, me sipërfaqe 9 km<sup>2</sup> dhe përmasa 7,3 me 2 km.

Në pjesën jug-perëndimore të malësisë së Kolonjës bëjnë pjesë fusha e Barmashit me përmasa 2 x 1 km, pllaja e Shalësit, Sanjollasit, Kamnikut dhe e Podës. Ujërat e përrrenjve të Shalësit, Barmashit, Kamnikut dhe Piskalit, përfund fshatit Shijan, formojnë lumin Langaricë, i cili bashkohet me lumin Vjosa pranë fshatit Petran të Përmetit<sup>1</sup>.

Malësia e Leskovikut shtrihet midis lumit Lengaricë në veri dhe përfundon në brigjet veriore të lumit Vjosa në jug. Brenda kufijve të kësaj malësie përfshihet mali i Radanjit, fusha e “Hasit” dhe kodrat e Shelegurit, të veshura me drurë të dendur halorë, pishë e bredh, që krijojnë një peizazh nga më të bukurit e vendit tonë. Në shpatet veriore pranë fshatit Postenan, ku ndodhen rrënojat e shtëpive të rilindësit të shquar Jani Vreto, dalin rryma të ngrohta gazrash sulfurore, që kanë befasuar etnografen Edith Burden gjatë vizitës në këtë fshat të bukur malor<sup>2</sup>. Vlera kurative kanë pasur dhe kanë gjithashtu ujërat të cilat dalin përfund grykës së “Vromonerit”, pranë një kodre shkëmbore në bregun e djathtë të lumit Sarandoporos, burimet e të cilit fillojnë në shpatet lindore të malit Gramoz. Lugina e këtij lumi me 7 km gjatësi, nga hyrja pranë “Vromonerit”, shërben si kufi ndarës me Greqinë dhe bashkohet me lumin Vjosa pranë fshatit Mesare.

Rajonet e Shqipërisë Juglindore kanë pasur kushte klimaterike të përshtatshme për jetesën njerëzore, të provuar arkeologjikisht fillimisht në epokën e paleolitit (guri i ri), të mesëm e të vonë, nëpërmjet një grupi veglash stralli të zbuluara mbi sipërfaqen e një

<sup>1</sup> Gjeografia 2, 1991, f. 261, 324, 332.

<sup>2</sup> BURDEN 1905, f. 214-244.

kodre pranë fshatit Kamenicë, e njohur me emrin “Izraishtë” (Fig. 3). Të gjitha këto kategori gjetjesh prej stralli janë datuar pa asnjë lloj dyshimi nga specialistët e fushës përkatëse, vendës e të huaj, 35000 vjet më parë<sup>1</sup>.



Fig.3, Kodra e Izraishtës, stacion i paleolitit të mesëm.

Vargmalet e Shqipërisë Juglindore me drejtim veri-jug, të veshur me pyje e kullota të bollshme, me një rrjet të dendur përrenjsh e lumenjsh, së bashku me fusha e gropa, me toka të përshtatshme për kultivimin e drithërave thekër, grurë etj., janë përmendur edhe nga autorët antikë. Klima kontinentale me dimër të ftohtë dhe verë të freskët, me florë e faunë shumë të pasur dhe prania e mineralit të bakrit në Rehovë; Vithkuq e Luaras; të hekurit në Bitinckë<sup>2</sup>, kanë favorizuar njerëzit që nga shëtitës të vendosen në vendbanime të përhershme, në fillim të epokës së neolitit, gurit të ri, rreth 7000 vjet p.e.s., duke u marrë me bujqësi, blegtori dhe

<sup>1</sup> ALIU 2020, f. 326.

<sup>2</sup> SELENICA 1982, f. 11.

prodhimin e veglave prej guri të brimuar. Janë arritjet epokale arsyet që kjo epokë është quajtur nga arkeologët *epoka e qytetërimit prehistorik*. Të gjitha të dhënat e këtyre vendbanime shpellore, fushore apo kodrinore, të cilat toka i ka ruajtur si një arkiv i vërtetë në natyrë, kanë qenë të panjohura në Shqipërinë Juglindore, deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, 1945 ( Fig. 4).



Fig. 4, Harta arkeologjike e Shqipërisë Juglindore.

## Gjetje dhe diskutime

Gjetjet e para në historinë e kërkimeve arkeologjike për të gjitha krahinat e Shqipërisë Juglindore, u zbuluan gjatë punimeve për tharjen e kënetës së Maliqit në vitin 1948. Draga e traktorëve nxori në sipërfaqe me dhjetëra fragmente qeramike dhe vegla pune prej briri, kocke etj. Tërësia e këtyre objekteve që dolën 800 m larg nga ura e sotme e qytetit të Maliqit, u mblodhën nga arkeologu i mirënjohur Hasan Ceka dhe ing. Jovan Adami, të cilët i trajtuan ato dhe botuan të parin artikull me përmbajtje arkeologjike<sup>1</sup>.

Gërmimet e para sistematike për të zbuluar këtë vendbanim mbiujor, me vlera të rralla kulturore brenda e jashtë vendit, filluan në gusht-shtator 1961 të drejtuara nga arkeologu F. Prendi dhe me pjesëmarrjen e arkeologëve A. Mano, Dh. Budina, B. Dautaj, të cilat vazhduan me fushata gjatë viteve 1961-1966<sup>2</sup>. Në vijim u gërmua vendbanimi shpellor i Trenit në Devoll<sup>3</sup>. Kalaja ilire e Hollmit, si dhe vendbanimi prehistorik i Kamnikut në Kolonjë<sup>4</sup>.

Gjatë këtyre 60 vjetëve të fundit përmes gërmimeve sistematike dhe vëzhgimeve në terren, janë zbuluar shumë vendbanime e vendvarrime me përkatësi kohore fillimisht në epokën e neolitit, mijëvjeçari VII-IV p.Kr., në vijim në epokën e eneolitit 2700-2200 p. Kr., bronzit, 2200-1100 p. Kr., dhe në epokën e hekurit 1100-650 p. Kr.

Grupin e parë e zënë vendbanimet shpellore. Nëpërmjet vëzhgimeve ndër vite janë lokalizuar një numër i konsiderueshëm shpellash natyrore të përdorura si vendbanime. Vendin kryesor midis tyre e zënë Shpella e Trenit dhe ajo e Podës, me vlera të rralla natyrore e kulturore jo vetëm për Shqipërinë Juglindore, por

<sup>1</sup> CEKA, ADAMI 1949, 2, f. 94.

<sup>2</sup> PRENDI 1966, f. 255.

<sup>3</sup> KORKUTI 1971, f. 31.

<sup>4</sup> ALIU 1969, f. 159.

edhe për vendin tonë e më gjerë, ndaj dhe janë ndërmarrë gërmime arkeologjike.

**Shpella e Trenit.** Ndodhet buzë liqenit të Prespës së Vogël, e njohur me emrin shpella në “Grykën e Ujkut”, përfund kodrës shkëmbore, 706 m mbi nivelin e detit. Ajo ka një hyrje kryesore me 5 m gjerësi, 4 m lartësi dhe sipër saj një dritare natyrale që çon dritë brenda shpellës (Fig. 5). Shpella përbëhet nga pesë salla me përmasa të ndryshme. Salla e parë me përmasa 21 x 20 m, salla e dytë 32 x 22 m, salla e tretë, 21 x 6 m, salla e katërt 10 x 6,4 m dhe salla e pestë 10, 4 x 4 m. Këto salla lidhen me galeri të gjera midis tyre<sup>1</sup>.

Gërmimet sistematike të viteve 1966-1967 u përqendruan në sallën e parë, me sipërfaqe 360 m<sup>2</sup>. Gjatë këtyre fushatave u gërmuan 280 m<sup>2</sup>, që provuan se kjo shpellë është përdorur për banim që në fillim të epokës së neolitit të hershëm dhe me vijimësi gjatë epokës së eneolitit, bronzit, hekurit e deri në mesjetë<sup>2</sup>.

Nga gjetjet e rastit është një pitos, hambar drithi, në grykën e të cilit është vizatuar me grisje figura e një parmende druri me plor hekuri. Ky pitos që ka qenë i ekspozuar në muzeun e qytetit të Korçës, i datuar në shek. III-II p. Kr., është i vetmi i këtij lloji në grupin e madh të pitosave të zbuluar me shumicë në Shqipërinë Juglindore, që përfaqëson territoret e banuara nga fiset ilire të Dasaretisë antike<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> QIRIAZI ETJ., 2007, f. 2.

<sup>2</sup> KORKUTI 1971, f. 33.

<sup>3</sup> ANAMALI 1980, f. 20.





Fig. 5, Hyrja në shpellën e Trenit dhe stalaktitet brenda një salle.

Në anën perëndimore të kodrës të kësaj shpelle lartësohet një kodër tjetër shkëmbore, që u përdor për vite si gurore. Gjatë këtyre punimeve u zbulua një sallë e re që lidhet nëpërmjet një galerie të nëndheshme me sallën e madhe nr. 2, brenda së cilës ka stalaktite e stalagmite. Gjatë vëzhgimeve në vitin 2009, ne gjetëm në tabanin e sallës një gropë të hapur nga klandestinët me përmasa 1 m të thellë dhe diametër 1 m. Në përfundim të kontrollit të dherave të kësaj grope u zbuluan rreth 60 copë fragmente qeramike, tipike për qeramikën e neolitit të hershëm, fillimi i mijëvjeçarit të VII p. Kr. Së bashku me këto, u zbuluan dhe vegla kocke, briri etj., si dhe një kafkë e ruajtur mjaft mirë që i mungon vetëm nofulla e poshtme (Fig 6).



Fig. 6, Eshtra njerëzore të zbuluara në një nga sallat e shpellës së Trenit.

Vlerat e tjera kanë të bëjnë me praninë në shpellën e Trenit të 28 llojeve të ndryshme të lakuriqëve të natës, që sipas specialistëve të fushës përkatëse gjuajnë insekte të cilët janë vdekjeprurëse për njerëzit. Shpella e Trenit po shkon drejt degradimit sepse, në mungesën e një porte hekuri, është shndërruar në një stallë bagëtish. Së dyti, klandestinët vendës e të huaj vazhdojnë ta dëmtojnë vazhdimisht dhe së fundi, mjedisi përreth është shndërruar në një vend hedhurinash, ndaj duhet të merren masat e nevojshme nga organet e administratës lokale apo institucionet përkatëse që administrojnë monumentet e kulturës, për ta vënë atë në funksion të edukimit për nxënës e studentë dhe turistë vendës e të huaj<sup>1</sup>.

**Shpella e Podës.** Shpella e Podës e njohur me emrin “Guvë” ndodhet në njërën nga dy kodrat shkëmbore që lartësohen mbi fshatin Podë. Hyrja e shpellës ka formën e një strehe me përmasa 6 x 4 m dhe 4 m lartësi, që të çon në një sallë me përmasa 20 x 10 m dhe 4 m lartësi. Kjo shpellë është bërë e njohur fillimisht në vitin 1973. Në përfundim të vërtetimit tona rezultoi se salla e parë e emërtuar me nr. 1, pasohet dhe nga katër salla të tjera të lidhura midis tyre me korridore të ngushta, jo shumë të gjata (Fig.7).




Fig. 7, Shpella e Podës dhe çezmat.

<sup>1</sup> ALIU 2018, f. 363.

Të gjitha këto salla janë plot me stalaktite e stalagmite me vlera të rralla natyrore. Gjatë kontrolleve ndër vite janë zbuluar brenda këtyre sallave shumë fragmente qeramike me përkatësi kohore nga periudha e bronzit të vonë, shek. XIII-XII p. Kr., dhe me vijimësi të pandërprerë gjatë epokës së hekurit, shek. XI - 650 p. Kr., si dhe një grup fragmentesh vorbash kuzhine, të datuara në mesjetën e hershme e të zhvilluar në shek. VII-VIII dhe IX-XI m. Kr. Vlerat e tjera kanë të bëjnë me praninë e rrënojave të shtëpive të Zylyftar Podës, një nga udhëheqësit e shquar të luftës kundër ushtrive turke e të rezistencës në malin e Melesinit në vitit 1830.

Gjithashtu, përfund fshatit Podë ruhen muret e dy kishave, njëra e përdorur si qimitir për të vendosur eshtrat e njerëzve më të dëgjuar dhe pranë tyre tetë çezma të gdhendura në shkëmb, të cilat duhen restauruar nga institucionet përkatëse, në funksion të edukimit e turizmit. Ky mendim përforcohet edhe me praninë e drurëve pyjorë e sidomos frutorë, kryesisht ara, lajthi, mollë, dardha etj., që përbëjnë së bashku një atraksion turistik<sup>1</sup>.

Grupin e dytë e zënë vendbanimet fushore me vlera të rëndësishme historiko-kulturore. Ato janë zbuluar pranë fshatrave Maliq, Vashhtëmi, Podgori, Dunavec, Sovjan, Barç e Dërsnik në fushën e Korçës dhe sheshi i Gurit Luaras, shkëmbi i Kamnikut dhe vendbanimi i Robasit, midis fshatrave Boshanj-Lubonjë në rrethin e Kolonjës. Vendin më të rëndësishëm në këtë grup e zënë vendbanimet lakustër ose mbiujore, Maliq, Dunavec dhe Sovjan.

Vendbanimi mbiujor i Dunavecit është ndërtuar buzë lumit Dunavec, 400 m larg, ku ai bashkohet me lumin Devoll. Gjatë gërmimeve janë zbuluar 87 hunj që janë përdorur si pilota për ngritjen e platformës për ndërtimin e banesave, të punuara me sëpata guri. Kategoritë e ndryshme të gjetjeve arkeologjike e datojnë këtë vendbanim në neolitin e mesëm, mijëvjeçari V p. Kr.,

---

<sup>1</sup> ALIU 2020, f. 73.

që vazhdon të jetë sot për sot i pari dhe i vetmi jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan e më gjerë<sup>1</sup>.

Vendbanimi mbiujor i Maliqit është ndërtuar në bregun e liqenit ose kënetës së dikurshme. Gjatë gjurmëve shumëvjeçare janë zbuluar rreth 1000 hunj, pilota prej drurësh dushku, plepi, shelgu e thane, të punuara me sëpata bakri, si dhe gjurmët e pareteve të banesave të thurura me kallama (Fig. 8).



Fig. 8, Palafiti i Maliqit dhe maketi i palafitit të Maliqit.

Grupet e ndryshme të gjetjeve prej qeramike, së bashku me veglat prej guri, kocke, briri dhe bakri, kanë provuar se vendbanimi i Maliqit është banuar fillimisht në neolitin e vonë, fundi i mijëvjeçarit IV p. Kr., dhe me vijimësi gjatë gjithë epokës së bakrit, bronzit, hekurit e deri në vitet 650 p. Kr. Për rrjedhojë ai është vendbanimi më i madh jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe me gjerë në Ballkan e Europën Juglindore<sup>2</sup>. Lidhur me vlerat që mbart në fushën e qytetërimit neolitik dhe tipareve kryesore të

<sup>1</sup> KORKUTI 2010, f. 108.

<sup>2</sup> PRENDI 1966, f. 255.

kulturës ilire, duhet domosdoshmërisht të ndërtohet një vendbanim artificial, për ta vënë këtë vendbanim mbiujor në funksion të edukimit dhe turizmit vendës e të huaj.

Grupin e tretë më të madh numerikisht e përfaqësojnë vendbanimet kodrinore (kalatë). Ato janë ndërtuar kryesisht pranë brigjeve të lumenjve Devoll e Osum, të cilët bashkohen pranë Beratit dhe formojnë lumin e Semanit, që derdhet në detin Adriatik. Kalatë e tjera janë ndërtuar pranë brigjeve të lumenjve Lengaricë, Pagomen dhe Sarandoporos, ujërat e të cilëve bashkohen me lumin Vjosë që derdhet në detin Jon. Luginat e këtyre lumenjve kanë shërbyer si rrugë natyrore, për lidhjet e krahinave të Shqipërisë Juglindore me brigjet bregdetare si dhe me krahinat e Maqedonisë Perëndimore nëpërmjet lumit të Bisticës (Haliakmonit antik) me Thesalinë dhe brigjet e detit Egje. Një rol favorizues kanë pasur grykat e qafat lehtësisht të kalueshme. Në hartën arkeologjike të Shqipërisë Juglindore janë përfshirë të gjitha kalatë e njohura përmes vëzhgimeve ose gërmimeve arkeologjike, Korçë, Kolonjë, Pogradec e Devoll. Vendin kryesor e përfaqësojnë fortifikimet e ndërtuara në brigjet e liqenit të Prespës së Vogël, pranë “Grykës së Ujku”, në rajonin e Devollit<sup>1</sup>. Fortifikimi më i madh në këtë grup është kalaja e Trajanit (1200 m mbi nivelin e detit), me sipërfaqe 23 ha, brenda tri radhëve me mure guri me karakter mbrojtës. Materialet arkeologjike të përfituara nga vëzhgimet sipërfaqësore e datojnë këtë kala në bronzin e vonë shek. XII-XI p. Kr. Sigurisht kjo kala ka pasur funksion jo vetëm mbrojtës, por edhe bujqësor e blegtoral. Në kodrën pranë Trajanit ruhen muret e një kalaje tjetër, e njohur nga vendësit “Kalaja e Mokut”. Ajo rrethon majën e një kodre gjysmësferike me dy rreshta gurësh me përmasa të mëdha, të ngjashme me kalatë e njohura të bronzit të vonë në vendin tonë, shek. XIV-XII p. Kr. Në

---

<sup>1</sup> KARAIKAI, LERA 1974, f. 263.

anën tjetër të “Grykës së Ujikut”, aty ku binjakëzohet rruga që ka lidhur që herët në prehistori fushën e Devollit e të Korçës (Dasaretia antike), me krahinat në lindje të tyre (Lynkestidës antike), ndodhet kalaja e “Ventrokut”. Banorët e kësaj kalaje, ndryshe nga ato të Trajanit, janë marrë që herët në prehistori me bujqësi e peshkim. Kalaja e “Ventrokut” është një tjetër vendbanim i fortifikuar rreth 3 km larg nga “Gryka e Ujikut”, mbi një kodër shkëmbore në bregun e liqenit të Prespës. Ndryshe nga të gjitha kalatë e tjera të Shqipërisë ajo është ndërtuar me ledhe dheu të përzier me gurë të thyer e me zhavorr në formën e një trapezi. Ajo ka shërbyer si pikë vrojtimi për kontrollin e rrugës që shkonte drejt qytetit të Follorinës, Selanikut dhe brigjeve egjeane. Fortifikimi mbi shpellën e Trenit është rrethuar me hark muresh 90 m të gjatë dhe 3.5 m gjerësi. Gjatë gërmimeve arkeologjike janë zbuluar shumë materiale të datuara në epokën e eneolitit, bronzit të vonë dhe epokën e hekurit<sup>1</sup>. Të gjitha vendbanimet e fortifikuara të pellgut të Korçës janë ndërtuar mbi kodra shkëmbore, pranë rrugëkalimeve dhe qafave për t’u mbrojtur nga shqetësimet sociale dhe nga dyndjet e të huajve. Si të tilla janë, kalaja e Bellovodës, Gjonmadhit, Hija e Korbit, Gradishta e Symizës etj. Të njëjtat funksione kanë pasur edhe kalatë e rajonit të Pogradecit, ndër të cilat bëjnë pjesë kalaja e Bllacës, Tushemishtit, Pogradecit, Gradishta e Selcës së Poshtme etj<sup>2</sup>. Vendbanimet e fortifikuara në rajonin e Kolonjës janë ndërtuar në tri zona kryesore. Grupi i parë gjendet në rrjedhjen e sipërme të lumit Osum dhe të përrenjve që kanë shërbyer si arterie rrugore për t’u lidhur me krahinat bregdetare, Maqedoninë Perëndimore, duke kaluar nëpër pllajën e Kolonjës, Grykën e Kazanit, drejt qytetit të Kosturit (Celentrumit antik). Në këtë zonë malore të përshtatshme për blegtori ndodhen

---

<sup>1</sup> KORKUTI 1971, f. 33.

<sup>2</sup> ANAMALI 1978; CEKA 1985, f. 7.

kalaja “Bregu i Velikos”, “Kalaja e Qezarit” pranë fshatit Qesarakë, ajo e Boshanjit dhe ajo e Luarasit. Kalaja e njohur nga banorët vendës me emrin “Guri i Madh” rrethon një ambient të sheshtë, mbështetur në shpatet e pakalueshme të kodrës shkëmbore. Muret rrethuese janë ndërtuar me gurë krejtësisht të papunuar, 320 m gjatësi, 2.5 m gjerësi dhe lartësia e ruajtur është 2 m. Ajo përfaqëson një tip origjinal, e datuar në bronzin e vonë, shek. XIV-XII p. Kr.<sup>1</sup>



Fig. 9, Kalaja e Hollmit dhe kodra e Thesarit me monedha të Eginës.

Grupi i dytë i fortifikimeve është ndërtuar nëpër kodrat shkëmbore përrreth pllajës së Kolonjës. Ato fillojnë me Kalanë e Hollmit në veri (Fig. 9), Kalanë “Gradeci i Bejkovës”, Kalanë e Bejkovës në perëndim dhe vazhdojnë me kalanë “Çuka e Borovës”, “Gradishta e Barmashit”, “Liqenet e Novoselës” në perëndim, të datuara përgjithësisht në bronzin e vonë dhe epokën e hekurit, shek. XIII-XII e XI-VII p. Kr.

Grupi tjetër është ndërtuar në malësinë e Leskovikut. Kalatë “Malishtë e Madhe” e “Malishtë e Vogël” ndodhen mbi dy kodra shkëmbore, përfund të cilave kalonte rruga për t’u lidhur me

<sup>1</sup> KARAISKAJ, ALIU 1984, f. 61.

qytetin e Janinës. Kalaja tjetër e njohur me emrin “Gradeci i Vrëpckës” ndodhet në një kodër shkëmbore në rrjedhjen e sipërme të lumit Pagomen, ujërat e të cilit bashkohen pranë fshatit Çarçovë me lumin Vjosa, i cili ka shërbyer e shërben si rruga kryesore për t’u lidhur me krahinat bregdetare të detit Jon. Kalaja “Hasi i Radanjit” rrethon me mure një sipërfaqe 25 ha, midis dy kodrave “Çuka e Madhe” dhe “Çuka e Vogël” (Fig.10.) Muret e kësaj kalaje rrethojnë një sipërfaqe prej 25 ha. Muret janë ndërtuar me gurë me përmasa të mëdha. Brenda mureve rrethuese ruhen ende mbi sipërfaqe ndërtesat e banimit me një deri në katër ambiente. Kjo kala ndodhet rreth 500 m në të majtë të rrugës nacionale Ersekë-Leskovic, shumë pranë kodrave të bukura të Shelegurit, që ofrojnë së bashku një atraksion të përshtatshëm për turizëm.



Fig. 10. Kalaja e Radanjit dhe pyjet e Shelegurit.

Materialet që paraqitëm më sipër provojnë se kushtet e përshtatshme fiziko-geografike që karakterizojnë Shqipërinë Juglindore kanë favorizuar që herët në prehistori banorët e këtyre rajoneve për të ndërtuar vendbanimet e para të qëndrueshme. Vendin kryesor në këto vendbanime e zënë vendbanimet mbiujore (Lakustër) të zbuluara përmes gërmimeve shumëvjeçare në Fushën e Korçës, të cilat kanë marrë vlera të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare. Vendbanimet e tjera fushore e kodrinore shquhen



për pozicionin gjeografik të vendndodhjes, kryesisht pranë brigjeve të lumenjve që kanë shërbyer si arterie rrugore për t'u lidhur me krahinat fqinje e të largëta adriatiko-egjeane dhe me pellgun qendror të Danubit. Në vështrim të përgjithshëm të shkallëzuar në kohë, kultura materiale e Shqipërisë Juglindore përbën grupin që ka luajtur rolin kryesor në formimin e kulturës materiale e shpirtërore ilire në përgjithësi, të emërtuar nga arkeologët grupi iliro-jugor ose "devollit". Sipas burimeve të shkruara greko-romake, këto krahina përfshiheshin në Dasaretinë antike, në të cilën u krijua i pari shtet i ilirëve me kryeqendër Pelionin. Këto të dhëna kanë gjetur mbështetje me zbulimet e varreve monumentale mbretërore, kalanë e Selcës së Poshtme në Pogradec, që kanë marrë vlera jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë në Ballkan. Në mbyllje duhet thënë se kulturë nuk krijohet vetëm në rajonet bregdetare, por edhe në ato kodrinore-malore.

### Literatura

ALIU, S., (1969), Zbulime të reja të kulturës ilire në rrethin e Kolonjës, *Studime Historike* 1, f. 159-163.

ALIU, S., (2002), Les rapports entre L'Albanie du Sud-est et L'Europe Centrale pendant la transition de L'age du bronze à L'âge du fer à la Lumière des découvertes de Kolonjë. *L'Albanie dans L'Europe Préhistorique*, BCH 42, 2002, *Actes du Colloque de Lorient, Athènes*, f. 217-229.

ALIU, S., (2004), *Tuma e Luarasit*, Tiranë

ALIU, S., (2005), Les bijoux du L'époque du Bronze Recent et L'époque du Fer Ancien a Kolonja, *Betëen the Aegean and Baltic Seas: Prehistory Across Borders*, University of Zagreb.

ALIU, S., (2011), ALIU, Vlerat arkeologjike të Shqipërisë Juglindore, *Buletini Shkencor, Seria e Shkencave shoqërore*, nr. 21, Universiteti "F. S. Noli", Korçë, f. 141-164.

ALIU, S., (2012), S. ALIU, *Tuma e Rehovës*, Korçë.

ALIU, S., (2017), The Late Bronze Age and Iron Age Jewellery from Kolonja region, *Archaeological Discoveries in the Albanian Regions I*, International Conference, Tiranë, *Botimet Albanologjike*, Vol. I, f. 253-273.

ALIU, S., (2018), Natural and Archaeological Values of Treni Cave, *Vjetori shkencor 5/1 II FEF*, Botim i veçantë i buletinit shkencor të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, f. 363-377.

ANAMALI, S., 1979-1980, Kështjella e Pogradecit, *Iliria IX-X*, f. 211-237.

ANAMALI, S., (1980), Arkeologjia dhe Bujqësia, Tiranë.

CEKA (1985), *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*.

CEKA, H., ADAMI, J., (1949), *Raport mbi zbulimet prehistorike në Maliq*, Tiranë.

KARAIKAJ, GJ., ALIU, S., (1984), Fortifikimet e periudhës së parë të Hekurit, *Kuvendi i I i Studimeve Ilire*, V. II, f. 263-290.

KARAIKAJ, GJ. LERA, P., (1974), Fortifikimet e periudhës së parë të Hekurit, *Kuvendi i I i Studimeve Ilire*, V. II, f. 263-290.

KORKUTI, M., (1971), Vendbanimi prehistorik i Trenit, *Iliria I*, f. 31-48.

KORKUTI, M., (2010), *Qytetërimi Neolitik dhe Eneolitik në Shqipëri*, Tiranë.

PRENDI, F., (1966), La civilization prehistorique de Maliq, *Živa Antika 1*, f. 255-280.

**Prof. dr. Irakli Koçollari<sup>1</sup>**

## **PROGRESI URBAN DHE MJESHTËRIT E NDËRTIMEVE NË PASHALLËKUN E ALI PASHËS**

Ali Pasha qëndroi në pushtet si zot i pashallëkut të Janinës për rreth 40 mote, nga viti 1788 gjer në vitin 1822. Krahas arritjeve në fushat e ekonomisë, politikën e brendshme, politikën e jashtme, konsolidimin e strukturave shtetërore, ushtarake dhe ato policore, arsim, kulturë, ai punoi intensivisht dhe arriti të ngrrejë një infrastrukturë nga më modernet e kohës, në tërë dimensionet e pashallëkut të tij. Nën përkujdesjet dhe vizionet personale të tij, u ngritën vepra dhe objekte të rëndësishme në fushën e ndërtimitarisë, infrastrukturës etj., duke e kthyer pashallëkun në një nga qendrat urbane më të avancuara në Ballkan për kohën.

Ishin një pasion i njohur personal i Ali Pashës gjatë tërë jetës së tij ndërtimet e të gjitha natyrave, por me pretendimin që ato të ishin përherë me një arkitekturë të veçantë dhe sa më të bukur. Me këtë pasion dhe nevojë për t'i hapur rrugë zhvillimit, ai mbështeti dhe financoi personalisht ndërtimin e objekteve të shumta me karakter social sikundër: pallate, bibliotekë, hane, akademi ushtarake, shkolla, medrese etj.; Ndërtime me karakter religjioz, skundër: kisha, xhami, teqe, hamame, manastire pa demonstruar kurrfarë diferencimi religjioz; ndërtoi gjer në zonat më të thella

---

<sup>1</sup> E-mail: kocollariir@yahoo.it

vepra arti, sikundër: ura, rrugë, akuadukte, drenazhime; ngriti objekte me karakter ushtarak, sikundër: shkollë kavalerie, shtëpi të oficerëve, fortifikime, kështjella, kulla vrojtimi apo kontrolli, stacione policie, trashe etj.

Shumë shpejt, ngritja e rrjetit të shumëfishtë urban i dha impulse të mëdha transportit rrugor, qarkullimit të njerëzve, mallrave, produkteve dhe këmbimit të madh artizanal, industrial dhe lëndëve të para të prodhimeve vendëse, për t'u dërguar jo vetëm brenda tregut dhe territorit të pashallëkut, por dhe në tregjet e vendeve të largëta të Ballkanit, madje edhe më gjerë se kaq, nëpër Europë, si: Venedik, Trieste, Ankona, Vjenë, dhe gjer në Dresdenin e largët, Bukuresht, Sofje, Stamboll e gjetiu.

Ishin pikërisht politikat e tij vizionare në këto fusha që e kthyen këtë pashallëk një nga qendrat urbane më të zhvilluara në Ballkan, dhe Janinën “metropolin e helenizmit modern”. Gjatë viteve të dominimit të tij, pashallëku pësoi transformime të rëndësishme, sigurisht edhe vetë Janina nga një qytet me 9 000 banorë në fundin e dominimit të tij arriti në 60 000 banorë (aq sa kishin edhe kryeqytetet e tjera të Ballkanit). Nga 38 dyqane në fillimet e sundimit të tij, Janina do të kthehej një nga qendrat më të mëdha tregtare, me 1180 dyqane. Në kohën e tij u hapën shkollat e para me karakter laik dhe medresetë e para, ku filluan të predikoheshin veç lëndëve me karakter religjioz edhe shkencat natyrore, sociale etj.

### **Petro Korçari - Kryearkitekti i Ali Pashës dhe origjina e tij**

Të gjithë këtë infrastrukturë urbane, këto objekte me karakter social, ekonomik, kulturor, religjioz dhe ushtarak, që mbeten edhe sot e kësaj dite një fond i pasur i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe Greqisë, i ngritën mjeshtër të njohur të inxhinierisë, arkitektë, xhenierë, hidroteknikë, të udhëhequr nga një inxhinier

dhe arkitekt kryemjeshtër shqiptar. Ai ishte kryearkitekti i Ali Pashës me emrin Petro.

Koloneli britanik Lik në veprën e tij “Udhëtim në Greqinë Veriore dhe në Shqipëri.” na bën me dije se “kryearkitekti i Ali Pashait është “Zoti Petro” nga Korca”. Liku sqaron gjithashtu se kryearkitekti ishte inxhinier dhe arkitekt (“chief architect and engineer”) (*Leak, William Martin 1835*).

Lik-u e përmend dy herë kryearkitektin Petro. Për herë të parë ai shkruan më 2 janar të vitit 1805, kur britaniku mbërrinte në Tepelenë. Në ato ditë të ftohta janari, Lik-u ende nuk e kishte njohur personalisht atë, por të pranishmit i kishin treguar se mjeshtri ishte duke ndërtuar urën mbi lumin e Vjosës në Tepelenë. Hera e dytë ishte pak muaj më vonë, brenda të njëjtit vit, më 1805 (1 korrik 1805), kur koloneli Lik ishte takuar personalisht me kryearkitektin Petro dhe në shoqërinë e tij ai informohej prej tij si ndërtues i kësaj ure dhe për një numër objektesh të tjera të ngritura nëpër pashallëk. (*Leak, William Martin 1835*). Duke folur për veprat e projektuara dhe ndërtuara prej tij, Lik-u shkruan: “... chief architect named Peter of Koritza who constructed bridges and sarai ....” – “...kryearkitekti me emrin Petro nga Korça që ndërtoi ura dhe pallate...” Ndërsa në një pasazh të mëvonshëm, po ky autor shkruan: “... his property and family are at Koritza....” pra “.. pasuria dhe familja e tij janë në Korçë” (*Leak, William Martin, 1835, f. 254.*)

Një tjetër burim që na flet për këtë mjeshtrë është konsulli francez, Fransua Pukëvili (Francois Charles Hugues Laurent Pouqueville, 1770-1838). Duke iu referuar kryearkitektit të Pashait të Janinës, ai na ofron një të dhënë për vendin e origjinës dhe vendlindjen e Petros. Ai shkruan se “Arkitekti Petro është një shqiptar nga Përmeti”. Por, sigurisht për origjinën e tij ai është i pasaktë (*Pouqueville, 1824*).

Për origjinën e kryemjeshtrit shkruan edhe një tjetër ushtarak francez. Ai është koloneli Frederic Francois Guillaume de Voudancourt, xhener dhe ndërtues, që shërbeu në pashallëkun e Janinës gjatë viteve 1807-1810. Ushtaraku francez na bën me dije në librin e kujtimeve të tij se ishte takuar dhe kishte bashkëpunuar në ndërtime fortifikuese të Ali Pashës me Petron, duke na dhënë sqarimin se *“fortifikimet e Aliut zakonisht drejtohen ... nga një shqiptar me emrin Petro...”* dhe pak më tej ai identifikon se mjeshtri Petro ishte një *“inxhinier nga Korça”* (Vaudoncourt, 1816, f. 287)

Të njëjtin vlerësim ofron edhe studiuesi ynë i nderuar Shuteriqi, pa pasur asnjë mëdyshje se Petro Korçari ishte shqiptar, madje duke nënvizuar se ai ishte nga qyteti i Korçës (Shuteriqi, 1978 f. 14, 52.)

Nisur nga këto dhe dëshmi të lëna në dritaret e shënimeve apo botimet e mëvona të diplomatëve, udhëtarëve apo ushtarakëve të huaj, Shuteriqi ka konkluduar: *“Ky qytet i lindjes kush mund të jetë tjetër veçse Korça, prej të cilit Petroja ka marrë emrin?... Petroja është pra edhe familjarisht banues i qytetit të Korçës.”* (Shuteriqi, 1978, f. 14).

\* \* \*

Por një dokument fare i thjeshtë i vitit 1804, që gjendet kohët e fundit brenda radhës së materialeve të Arkivit të Ali Pashës, flet për “master Petro maimarin”. Pra, sipas përkthimit të saktë në shqip, mësojmë se opinioni, banorët e Janinës, e thërrisnin këtë njeri “mastor Petro maimarin” (maimar = arkitekt, turqisht), pra “Mjeshtër Petro Arkitekti” (Panajotopulos, 2007, f.395-8).

Një tjetër dokument që mban datën 1 gusht 1809, bën fjalë për *“përfundimin e punimeve fortifikuese ushtarake, ndërtimin e kullave mbrojtëse të kryera në Qafën e Rehovës - Berat, të drejtuar nga “Usta Themeli...”*. Dokumenti pasqyron shumë që kanë marrë punëtorët për punimet e kryera. (Panajotopulos, 2007, f. 91-3).

Duke shkuar më tej, në një dokument të muajit gusht të vitit 1809, na bëhet me dije se arkitekti i Pashait porsa ka përfunduar

punimet ndërtuese dhe meremetime në sarajet (=pallatet, turq.) e Ali Pashës në Tepelenë, punime të cilat kanë zgjatur rreth një vit. Dokumenti në thelb është një përshkrim i punimeve të kryera dhe liston pagat sipas ditëve të punës së punëtorëve. Në fund mjeshtri arkitekt që ka drejtuar këto punime prezantohet me mbiemrin e tij Themeli.

Pra, tanimë përmes dokumentit të deklaruar dhe firmosur nga vetë mjeshtri, mësojmë edhe mbiemrin e tij. Ai quhet mjeshtri Petro Themeli. (Panajotopoulos, 2007, f. 98).

Nga një tjetër dokument të vitit 1813, ne arrijmë të mësojmë me saktësi origjinën e mjeshtrit Petro. Është fjala për një urdhër të lëshuar nga Ali Pasha për shpërblimin e “Mjeshtrit Themeli”, përmes administratorit të tij Tito Baltador, për punët ndërtimore të kryera në Gjirokastrë. Në të shkruhet:

*“Tito Baltadorit, - Janinë.*

*Jepi mjeshtrit Themeli, që punon në Gjirokastrë groshë 500, (pesëqind grosh) dhe mbaje 231ate llogaritë e bëj diferencën, asgjë më shumë.”*

*Dora vetë Ali Pasha*

*Preveza, 17 shkurt 1813*

Poshtë këtyre fjalëve, mbi të njëjtin dokument është bërë shënimi i njerëzve që kanë tërhequr shumën e parave të urdhëruara nga Ali Pasha. Në të thuhet (Panajotopoulos, 2007, f. 324):

*“Sipas urdhrit të Zotit 231ate, unë Dhimitri dhe Zafiri nga Marjani muarrëm nga Tito Baltadori grosh pesqind, pra 500.”-*

*Unë, Dhimitri djali i Mjeshtrës Themelit dhe nipi i tij, Zafiri, muarrëm këtë shumë.*

*Sot më 231ate 20 Shkurt 1813”*

Pra, dokumenti na tregon gjithashtu se kryearkitekti i Ali Pashës, Petro Themeli ka pasur një djalë të quajtur Dhimitër, i cili pasi kishte përfunduar tërë punimet dhe restaurimet e plota të kalasë së Gjirokastrës, ka tërhequr pagesën për punën e bërë. Madje në këtë nënshkrim ai ka identifikuar edhe vendin e origjinës

së familjes të mjeshtrit Petro Themeli. Pra familja e tyre vjen nga fshati Marjan i krahinës së Oparit të Korçës.

Ndërsa nga një dokument i datës 22 korrik 1818, që bën fjalë për një ankesë të banorëve të qytezës së Vithkuqit, del në dritë vendi ku gjendej konkretisht shtëpia e arkitektit. Është një “ankesë nga populli”, drejtuar Ali Pashës, për abuzimin e dy policëve me detyrën e tyre. Në të thuhet:

*“... Ata (policët) u lëshuan mbi bagëti dhe qengja dhe ç'u pëlqente, i rrëmbenin dhe nuk paguanin asgjë ... kështu ata ... dhunuan një mëhallë të tërë. .... Në radhët e shtëpive që ata hynë me forcë dhe i përdhosën, e para ishte shtëpia e Mjeshtrit Petro dhe mbas saj të njëjtin fat pësuan tërë shtëpitë e mëhallës. Me një paudhësi të shfrenuar ata nuk nguruan të vënë dorë edhe mbi gratë që kundërshtonin aktet e tyre, aq më keq ata dhunuan pa pikë turpi edhe vajzën, e cila ndodhej brenda në shtëpinë e Mjeshtrit tënd të ndërtimeve, Petros....”*

22 Korrik 1818

*Të gjithë ne Vithkuqarët të vegjël, të mëdhenj, burra e gra,....mbetemi me shpresë....” (Panajotopoulos, 2007, f. 124-125)*

Pa dashur të bëjmë komente të gjata për këtë dokument, duket qartë përmes pohimeve të banorëve të Vithkuqit se të paktën njërën shtëpi (në mos njëra prej...) kryearkitekti i Ali Pashës, Petro Themeli e ka pasur në Vithkuq, në kryeqendrën e krahinës ku ndodhej fshati i tij, Marjani.

Sikurse dihet, fshatrat e krahinës së Oparit, Marjani, Treska, Trebicka, Panariti etj., si në të kaluarën edhe sot janë njohur në gjithë qarkun e Korçës dhe më gjerë për nxjerrjen e mjeshtërve në ndërtimtari, gurgdhendës, punues të drurit, tavanxhinj etj.

### **Veprat dhe objektet e ndërtuara nga Petro Themeli**

Në inventarin e gjatë të objekteve të projektuara, punuara dhe realizuara nga “Mjeshtri”, sikundër e thërriste Ali Pasha kryearkitektin Petro Themeli, renditen veprat më të rëndësishme me karakter social, religjioz, hidroteknik, urban dhe ushtarak në



Pashallëkun e Janinës. Nëpër tërë hapësirat e sotme të shtetit grek dhe në tokën shqiptare, ato i gjejmë ende të tilla, si objektet apo veprat me të rëndësishme të trashëgimisë historike dhe kulturore të dy popujve. Disa nga ato figurojnë në listat e trashëgimisë së UNESCO-s dhe vlerësohen si monumentet më të rëndësishme kulturore në këto anë të Ballkanit.

Mes dokumentacionit arkivor të huaj dhe atij të Ali Pashës, gjenden fonde dhe material që flasin për këto objekte, arritje dhe zgjidhje arkitektonike, ndërtime që mbështeten mbi traditën dhe pasurojnë inventarin e arkitekturës shqiptare, vepra arti me karakter ushtarak, fetar, urban etj. Në aradhën e fondeve arkivore renditen; emrat e ustallarëve që i zbatuan këto projekte, gjendja e punimeve të kryera në vepra të ndryshme inxhinierike, numri i fuqisë punëtore të përdorur në këto punime, kohëzgjatja e punimeve, ditët e punës për çdo punëtor e mjeshtër, drejtuesit e projekteve, supervizorët dhe pagat për punët e bëra. Ka lista nominale të mjeshtërve të përfshira në punime, sipas profileve gurgdhendës, kafsharë, sharrëxhinj, karpentierë, tavanxhinj, shkruhet gjer për punëtorët e furrave të gëlqeres etj.

Në pjesën qendrore të punimeve të kryera evidentohet puna e këtij "Mjeshtri", kryearkitektit Petro Themeli, jo vetëm si hartues i projekteve, por edhe si ndjekës i realizimit të punimeve, për projekte të hartuara nga ai vetë apo edhe nga inxhinierë të huaj.

Mes veprave që mbajnë autorësinë e këtij mjeshtri mund të rendisim: - Pallatet e reja (sarajet) të Ali Pashës në kalanë e Janinës (1808); Ndërtimi i kalasë së Tepelenës; Pallatet e Ali Pashës në kalanë e Tepelenës, (të shkatërruara më pas); Zgjerimi dhe restaurimi i plotë i Kalasë së Gjirokastrës në gjendjen që e shohim sot; akuadukti i Gjirokastrës (i rrënuar); akuadukti i Bëncës që ruhet ende; ndërtimi i kullave në Janinë; pallatet (sarajet e pashait) në kalanë e Prezës; sarajet e djemve të Ali Pashës, Myftarit dhe Veliut; fortifikimi i Litharicës (1807); muret dhe kullat fortifikuese

të kalasë së Prevezës (1798), zgjerimi dhe fuqizimi i tyre më (1807); ura e Vjosës në Tepelenë (1805); ndërtimet brenda kalasë së Tepelenës, hanet, stallat e kuajve, shatërvani dhe hamamet të shkatërruara më 1923; ndërtime fortifikuese të kalasë së Janinës, ndërtimi i Kjoskut (sallat e pritjes mbretërore; (1801) dhe shatërvanët brenda sallave të pritjes në pallatet e Aliut në Janinë; një numër urash mbi lumin e Vjosës dhe Drinosit, apo të tjera në degëzime të lumenjve dhe përrenjve në zona të thella urbane të pashallëkut; fortesa dhe kullat e Litharicës; fortifikime dhe kulla në rrethimin e Sulit (tetor 1803), etj.

\* \* \*

### **Inxhinierë të huaj në Pashallëkun e Janinës**

Por, nën politikat e tij stimuluese për zhvillimin, fuqizimin dhe urbanizmin e vazhdueshëm të pashallëkut të tij, Ali Pasha ftoi dhe mirëpriti në oborrin e tij edhe një numër të madh inxhinierësh, arkitektësh, xhenierësh ushtarakë dhe ndërtuesish të huaj, të ofronin kontributin dhe mjeshtërinë e tyre në ngritjen e veprave të ndryshme për interesat e pashallëkut.

Pjesa më e madhe e punimeve të kryera nga këta inxhinierë dhe arkitektë të huaj u krye nën kontrata të rregullta ligjore, mes dy subjekteve-palë në këto kontrata, të huajve dhe administratorëve të krahinave të pashallëkut. Kuptohet që të gjitha punimet ishin të centralizuara dhe shpërblimet e tyre bëheshin me urdhër të veçantë të vetë tepelenasit.

Mes arkitektëve të huaj që dhanë kontributin e tyre në ndërtime me karakter urban apo ushtarak, si kulla, fortifikime, fortesa etj., ishte britaniku Charles Robert Cockerell. Ai bëri disa projekte dhe skica për objekte të ndryshme të realizuara në pashallëkun e Janinës. Bashkë me to, Cockerell i kërkoi Ali Pashës t'i pozonte për një tablo me ngjyra vaji. Me atë rast britaniku e 'punoit' vezirin në ambientet e sallorit të tij të pritjes, në një tablo që është mjaft e njohur dhe sot. Të gjitha skicat e punimeve të këtij arkitekti në

vitin 1818 u ekspozuan në Sallën e Ekspozitave të Arkitekturës në “Somerset-House”, në Londër. Aty rreth vitit 1812 Kokerel së bashku me ndihmësit e tij projektoi rrugën që lidhte qytetin e Artës me Salahorën dhe Gjirin e Ambakisë, territore këto të pashallëkut të Janinës.

Në vitin 1806 dhe disa kohë më vonë, evidentohet fakti se në qytetin e Përmetit dhe në kalanë e tij vazhdonin punimet për përfundimin e plotë të objekteve. Brenda rrethimit të mureve të kësaj kalaje u realizua edhe një saraj (= pallat) i Ali Pashës. Drejtuesi dhe përgjegjësi për punimet dhe ndërtim e këtyre dy objekteve, deri në përfundimet e tyre, ishte një inxhinier katolik italian, i cili ishte konvertuar në mysliman dhe kishte marrë emrin Molla Sulejmani.

Një ndër inxhinierët e huaj që dha kontributin e tij në ndërtimin e disa objekteve me karakter ushtarak ishte edhe koloneli francez Guillaume de Vaudoncourt. Sikundër njofton historiani grek, Sp. Aravantino si dhe ai francez Remerand, ushtaraku, inxhinieri dhe xhenieri Vaudoncourt, me porosi të Ali Pashës projektoi dhe drejtoi punimet në rrethimin e dytë të kalasë së Prevezës, si dhe punime të tjera fortifikuese në kalanë e Janinës. Në vitin 1807 po ky inxhinier, projektoi dhe drejtoi punimet për ndërtimin e hendekëve rrethues të kalasë së Janinës dhe të kalasë në Litharica.

Një tjetër punim që mban firmën e Guillaume de Vaudoncourt është fortesa e Pandokratit, e cila në përfundim kishte të gjitha parametrat e fortifikimeve moderne, për të përballuar çdo lloj goditjeje, edhe ato të artilerisë me kalibrin më të madh të kohës. Në përfundim të punimeve, Ali Pasha për të ruajtur sekretin e objekteve me karakter ushtarak, të ndërtuar nga ky inxhinier i huaj, i kishte marrë atij të gjitha projektet e objekteve që ai kishte realizuar në pashallëkun e tij. Fortesa pesëkëndore e Pandokratorit, që ndodhet në perëndim të qytetit të Prevezës,

ruhet edhe sot në një gjendje mjaft të mirë, si një objekt mjaft atraktiv (*Vaudencourt, 1815*)

Në fundin e dekadës së parë të shekullit XIX shfaqet në territoret e pashallëkut të Janinës edhe (1809-1812) arkitekti gjerman B. B. Picheman, i cili kishte shërbyer si ushtarak në forcat franceze dhe ato ruse. Edhe ky arkitekt u thirr për shërbime të ndryshme inxhinierike dhe ndërtimi në pashallëk nga Ali Pasha. (*Baggaly, 1938*).

Në vitin 1810, gjatë kohës që territoret kontinentale të Greqisë ishin në zotërimet e Ali Pashës, anglezët dërguan në pashallëkun e Janinës një grup inxhinierësh për të studiuar mundësinë e hapjes së rripit bashkues që lidhte Peloponezin me pjesën kontinentale greke. Ky ishte misioni i parë i dërguar në këto anë nga europianët për të parë mundësinë e hapjes së kanalit të Korinthit, i cili u bë realitet dekada më vonë.

Në vitin 1810, Ali Pasha mobilizoi disa mjeshtër dhe inxhinierë të pashallëkut për të studiuar dhe filluar punimet për bonifikimin e kënetës së “Shtrivinës”, në fushën e Artës. Vetë Pukëvili, i cili i kishte parë nga afër këto punime, i kishte konsideruar ato një ndërmarrje të paralizueshme, gati-gati një aventurë. Në fakt bonifikimi i kënetës në fushën e Artës u krye me sukses. Madje ajo konsiderohet një nga veprat me vlera shumëdimensionale që i dha impulse zhvillimit bujqësor në këto anë dhe ngriti në mënyrë të ndjeshme produktin e kulturave bujqësore. Edhe sot operacionet e bonifikimit dhe drenazhimit të punuara ato kohë, vazhdojnë të funksionojnë normalisht. Inxhinieri zbatues i projekteve në këtë ndërmarrje të madhe inxhinierike i realizoi, (*Pouqueville, Vol. II, , 270-271, 1820*)

Në fund të dekadës së parë të shekullit XIX, vjen dhe vendoset në Janinë për të qëndruar për një kohë të gjatë arkitekti i njohur austriak me emrin Freywald, zyrat e të cilit ishin në Vienë. Ai mbërriti në pashallëk mbas kërkesës të dërguar nga vetë Ali Pasha.

Dokumentet flasin për shpërblimet në të holla që ai ka marrë në Janinë gjatë viteve 1816-1820 për punët e kryera, por ne nuk arrijmë të mësojmë se çfarë punimesh ka kryer ky arkitekt i njohur në këto anë. Vallë, Ali Pasha i kishte besuar punë të tilla për të cilat duhej të ruhej konfidencialiteti për vetë karakterin e tyre? Këtë gjë hëpërhë nuk e dimë. (*Aravantino*)

Në vitin 1814 vjen në Janinë një tjetër arkitekt. Është fjala për inxhinierin e ndërtimit, italianin Don Santo di Montleone, nga Palermo e Sicilisë. Pikërisht këtë vit inxhinierit italian i besohet ndërtimi i një fortese të vogël në afërsi të fshatit Aja, pranë Pargës, në Çamëri. Në zbatimin e projektit të këtij fortifikimi dukej se ishin bërë gabime, pasi nga një dokument i vitit 1816 mësojmë se objekti rrezikohej të prishej. (*Arvantino & Ibrahim Manzur Efendi*).

Aty rreth vitit 1815, dokumentet flasin për një tjetër inxhinier ndërtimi italian në qytetin e Janinës. Është fjala për Caretton. Ai prezantohet shpesh nga dëshmitarët e atyre viteve si një italian, napolitan, por në fakt të parët e inxhinierit ishin me origjinë nga Bretanja e Francës. Këto vite ai punoi në disa objekte në qytetin e Përmetit, pallatet e Ali Pashës, banesa fisnikësh, dhe ndërtime fortifikuese. Aty nga viti 1816, Kareco u kap në marrëdhënie me një vajzë të re të fesë myslimane me emrin Gjylsum. Për një akt të tillë ligji osman Sherihati i dënonte me vdekje autorët e këtij akti – “krimi”. Por, ndërsa e reja u ekzekutua, Kareco me urdhrin e Ali Pashës u dënua me burg. Pas pak ai u lirua dhe u rikthye në krye të punëve ndërtimore në pashallëk, por edhe si mjeshtër i artilerisë dhe i fortifikimeve mbrojtëse nga artileria.

Mbas vdekjes së kryearkitektit Petro Themeli, veziri i Janinës caktoi në vendin e tij inxhinierin francez Ibrahim Manzur efendiun. Emri i vërtetë i tij ishte Samson Cerfbeer de Medelsheim, një hebre i konvertuar në mysliman, që kishte shërbyer si komandant në repartet e husarëve, në ushtrinë franceze. Ai qëndroi për gati tetë vite në pashallëkun e Janinës. Ndër veprat e

tij inxhinierike njohim ndërtimin e fortesave bregdetare të Rio-Antirios në ngushticën e Patrës-Greqi, të cilat qëndrojnë edhe sot si monumente të trashëgimisë me karakter ushtarak. Mbas përfundimit të punimeve të dy fortesave, ai dorëzoi tek Ali Pasha projektet e veprave të realizuara, së bashku me harta topografike të territoreve ku ishin vendosur fortifikimit. Në vitin 1819, Ibrahim Manzuri u largua përfundimisht nga pashallëku, por ende për të nuk ka ndonjë studim hulumtues që do të na tregonte se çfarë objekte të tjera u realizuan në drejtimin e këtij inxhinieri.

*Charles James Napier* ishte një inxhinier ndërtimi britanik që kryente detyrën e xhenierit pranë trupave të ushtrinë britanike në Korfuz. Mbasi e kishte verifikuar me kujdes figurën e tij, Ali Pasha e ftoi atë në Janinë për të kryer disa punë ndërtimore të një karakteri mjaft konfidencial. Mbasi dëgjoi me kujdes vizionet dhe idetë e Ali Pashës për llojet e punimeve që ai kërkonte të kryente, Napier i dorëzoi Pashait në fund të vitit 1819 një grup projektesh të cilat lidheshin me punime të një natyre sekrete, që do t'i shërbenin Ali Pashës si mjete dhe masa për të shpëtuar në rast rreziku. Ndër këto objekte ishin fortifikime të reja në kështjellën e Janinës, në territorin e IçKalsë, disa dalje të fshehta etj. Aliu i pa projektet e punuara nga Napier-i, por i vlerësoi ato si mjaft të kushtueshme dhe u tërhoq nga realizimi i tyre. Në korrik të vitit 1820 Napier u largua nga Pashallëku. Disa muaj më vonë, ndërsa Ali Pasha ishte i rrethuar prej ushtrive osmane në kalanë e Janinës dhe vlerësoi kërcënimet dhe rreziqet në terrenin e luftimeve, i dërgoi Napier-it të vinte pranë tij për të realizuar punimet aq të nevojshme, duke i dërguar edhe një sasi prej 600 lirash floriri.

Napier-i, që kishte analizuar dhe vlerësuar tanimë pa rrugëdalje rrethimin dhe situatën e pashait të Janinës, i ktheu 600 lirat dhe me keqardhje e njoftoi se “e kishte të pamundur të ndërmernte operacionin e realizimit të objekteve...” (*Petronotis, 1994*).

Muaj më vonë, më 24 janar të viti 1922, forcat osmane që mbanin të rrethuar kështjellën e Janinës, Ali Pashën arritën ta vrasin në ishullin e Janinës dhe të shuajnë rezistencën shqiptare kundër perandorisë turke.

### **Literatura**

Aravantino, Spiro: "Istoria Ali Pasa tou Tepelenli", Pirro, 1895.

Ibrahim Manzur Effendi: "Kujtime për Ali Pashën..." 1827.

Leak, William Martin (1835): "Travel in Northern Greece...", vol.1.

Panajotopoulos, V.: "Arhio Ali Pasa" – Genadio Vivliothiki – Tomos A, Instituto Neolenikon Erevnon, Athina 2007, nr. 205, f.395-8.

Panajotopoulos, V. (2007): "Arhio Ali Pasa" – Genadio Vivliothiki – Tomos B, Instituto Neolenikon Erevnon, Athina, f. 91-3, 324.

Petronotis, A. (1994): "Arqitektoneq qe mihaniqi stin iperesia tu Ali Pasa.", Figos, Joanina.

Pouqueville, F. C. H. L. (1824): "Histoire de la regeneration de la Grece..." Paris.

Pouqueville, F. C. H. L.: "Travels in Epirus, Albania, Macedonia, and Thessaly", Vol. II, 1820.

Shuteriqi, Dh. S. (1978): "Petro Korçari – Kryearkitekt i Ali Pashë Tepelenës.", Tiranë, 8 Nëntori.

Vaudencourt, Guillian de (1816): "Memories of the Ionian Islands, Albania...", London

**Prof. as. dr. Zhuljeta Kadilli<sup>1</sup>**

**Prof. as. dr. Majlinda Peza<sup>2</sup>**

## **BANESA ME HAJAT (ELBASANASE) PAS NDRYSHIMEVE EKONOMIKO-POLITIKE TË VITEVE 1990 NË ZONËN E ELBASANIT**

### **Abstrakt**

Banesa me hajat është ndërtuar në Shqipërinë e Mesme dhe veçanërisht në qytetin e Elbasanit. Këtë tip banese e gjejmë gjatë mesjetës së vonë. Por, megjithatë ajo ka vazhduar të ndërtohet edhe në periudhat e mëvonshme. Faktorët që ndikojnë përhapjen e kësaj banese lidhen me relievin, kushtet natyrore dhe ato ekonomike. Kjo banesë gjeti kushtet më optimale në Elbasan, pasi territori ishte i gjerë, fushor dhe ndihmonte si në zhvillimin e zejtarisë dhe në atë të bujqësisë. Banesa me hajat është ekonomike, kërkon pak shpenzime në raport me tipat e tjerë të banesave. Hajati që përbën qendrën e kompozimit të kësaj banese ndërlidh në mënyrë të përsosur ambientet e mbyllura me oborrin dhe natyrën. Funkcionet janë të ndryshme. Me kalimin e kohës tipat e banesave filluan të ndryshojnë. Kjo lidhet edhe me sistemin politik të vendosur në vendin tonë pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe pas vitit 1990 vihet re rënie e ndërtimit të këtij tipi banese dhe ndërtimi i banesave të mëdha, me dy apo tri kate, individuale apo kolektive. Për të shkruar artikullin jemi mbështetur në literaturën historike, dokumentet e zyrës urbanistike dhe vëzhgimet në disa fshatra rreth qytetit të Elbasanit. Nga studimi rezulton se ka pak banesa me hajat në Elbasan e zonat përreth. Arsyeja e mosndërtimit të kësaj banese, sipas mendimit tonë, lidhet me emigrimin e të rinjve dhe dërgimin e remitancave, sidomos nga zonat rurale, si edhe dëshira për të investuar në banesa, e cila kishte qenë problem në të kaluarën. Gjithashtu ndërtimi i banesave të mëdha

---

<sup>1</sup> E-mail: zhkadilli@yahoo.com

<sup>2</sup> E-mail: majapeza@yahoo.com



për familje me disa breza mund të jetë një tjetër arsye. Duhet të pranojmë se këto banesa në shumicën e rasteve nuk shfrytëzohen, pasi një pjesë e madhe e të rinjve janë në emigrim. Një pjesë kanë ikur në qytete dhe nuk kanë interes për bujqësinë. Ky problem kërkon një studim të thelluar në shumë plane.

*Fjalë çelës: banesa me hajat, Elbasan, emigrim, rendi ekonomik-shoqëror*

### **Abstract**

The house with porch was initially built in Central Albania and especially in the city of Elbasan. This type of house was most prevalent during the Late Middle Ages. However, it continued to be built even later. The factors that influence the spread of this dwelling are relief, natural, and economic conditions. Elbasan offered the most optimal conditions since it contained vast land, flat and the porches helped in the development of handicrafts and agriculture. This type of house requires little expense compared to other types of houses. The porch is the center of the house and perfectly connects closed environments with the yard and nature. The functions are different. Over time the types of houses started to change. This change was the result of political system established in our country after the Second World War. Even after the 1990ies, there was a decline in the construction of this type of house. In the 90ies, the construction of large houses, with two or three floors began.

To write the article we researched historical, technical literature and observed several villages around the city of Elbasan. From the study, it turns out that there are few houses with porches in Elbasan and the surrounding areas. In our opinion, the reason for not building this type of house, is related to the emigration of young people and who sent remittances to Albania, especially in rural areas, and the desire to invest in big houses, which had been a problem in the past. The big houses in most part now, are not fully used because young people in the family have emigrated and do not live in Albania. Some young people have moved to cities and have no interest in agriculture.

*Keywords: house with porch, Elbasan, emigration, socio-economic order.*

### **I. Hyrje**

Në pranverën e vitit 1466, Sulltan Mehmeti II, për të forcuar pozitat sunduese në Shqipërinë e Mesme dhe për ta vazhduar me lehtësi pushtimin e krahinave veriore, ndërtoi kalanë e Elbasanit, ku, përveç banorëve të krahinave dhe qyteteve përreth, vendosi edhe administratën e rregullt, të siguruar nga një garnizon i

fuqishëm ushtarak (*Shkodra, 1973, f.25*). Me themelimin e këtij qyteti, siç do të shohim, do të zhvillohet me shpejtësi, madje do të formohet edhe një njësi e re administrative e njohur me emrin sanxhaku i Elbasanit që kishte nën vartësi krahinën e Shpatit, Krrabën, si dhe zonat përreth. Administrata e re osmane e ndryshoi tërësisht fizionominë e organizimit të jetës qytetare. Me pushtimin e vendit, qytetet u shndërruan në pika mbështetjeje të sundimit osman, në garnizone ushtarake, në qendra administrative dhe në vatra të fuqishme të kulturës dhe fesë islame (*Shkodra, 1973, f.26*).

Gjatë shekullit XVI qyteti i Elbasanit fillon e merr veten ekonomikisht duke u kthyer në një nga qendrat kryesore të Shqipërisë. Ndryshime të dukshme pati edhe në aspektin urban, kjo falë rritjes së popullsisë, qoftë nga rritja natyrore apo edhe nga zhvendosjet fshat qytet. Kështu u themeluan edhe lagjet e para të qyteteve.

Nga pikëpamja e arkitekturës qyteti përbëhej nga dy pjesë kryesore: nga kalaja e rrethuar me mure të larta, ku zakonisht përveç popullsisë civile, ishin vendosur garnizonet ushtarake dhe administrata qeveritare turke, dhe nga lagjet e jashtme (Varoshi, Borgu) të banuara nga zejtarët, tregtarët, fshatarët etj., dhe ku ndodhej tregu i qytetit. Pushtimi osman solli ndryshime të rëndësishme në konceptimin urbanistik të qytetit, duke e ndërprerë rrjedhën e arritjeve të qytetit shqiptar të mesjetës së vonë (*Shkodra, 1973, f.21*). Ky qytet, në vazhden e trashëgimisë më të hershme në përgjithësi ishte i lidhur me tiparet e qyteteve europiane. Tradita ku jeta shoqërore ishte mjaft aktive, siç tregojnë ndërtimet e shumta shoqërore në qytetet ilire, të cilat zinin një vend të dorës së parë në konceptimin urbanistik, pëson një ndryshim thelbësor. Jeta private merr një rëndësi të dorës së parë, ndërsa jeta shoqërore varfërohet ndjeshëm. Ndërtimet e kultit dhe banjat publike janë të vetmet mjedise në të cilat zhvillohet

veprimtaria shoqërore e qytetit. Këto rrethana kanë rëndësi parësore për tiparet dhe karakterin e qytetit shqiptar të mesjetës së vonë. Krijimtaria në fushën urbanistike të qyteteve e cila, siç kemi përmendur, merr një zhvillim të ndjeshëm gjatë shekujve XVI-XVIII. Megjithatë në kuptimin rigoroz të termit, zhvillimi urbanistik qe një vepër spontane, pra, e paplanifikuar.

Në dallim nga ndërtimet e veçanta private, pra kryesisht të banesave, krahas mjeshtrit në zgjidhjet konkrete kanë ndikuar edhe faktorë të llojeve dhe shtytësve të tjerë. Edhe në krijimtarinë urbanistike të periudhës në shqyrtim, ende projektuesi dhe zbatuesi bashkohen në një figurë të vetme. Brenda këtyre parimeve të përgjithshme u zhvillua dhe u ndërtua edhe qyteti i Elbasanit në këtë kohë. Janë të shumtë shembujt e zhvillimit urbanistik që e tregojnë këtë. Krijimi i tregut rreth kalasë, i zonës së banuar me distancë jo shumë të largët nga kalaja, krijimi i dy akseve kryesore rrugore, të cilat janë edhe sot, flasin për veprime të studiuara në fushën e urbanistikës. Edhe banesa përshtatet më mirë me mjedisin natyror dhe zhvillimin ekonomik e shoqëror. Banesa e tipit dollmallie dhe me hajat janë të pranishme në qytetin e Elbasanit. Ajo parakupton lidhjen e banesës me natyrën dhe ekonominë bujqësore, si dhe mbrojtjen nga vërshimet e Zaranikës.

## **II. Hapësira e studimit**

Hapësira e studimit përfshin qarkun e Elbasanit, por është përqendruar në qytetin e Elbasanit dhe në disa fshatra ku është më i dukshëm ndërtimi i banesave individuale. Fshati Shirgjan, fshati Hajdaran, fshati Katjel në rrethin e Librazhdit janë hapësira kryesore e studimit. Gjithashtu janë parë edhe disa fshatra të tjera në rrugën nacionale Elbasan-Belsh, Elbasan-Përrenjas apo Elbasan-Tiranë, të cilat nuk janë objekt studimi, por na ndihmojnë me shembuj të ndërtimeve në studimin tonë.

### III. Metoda

Për të realizuar artikullin kemi studiuar fillimisht literaturën e shkruar për këtë problem. Autorët kryesorë mbi të cilët jemi mbështetur janë: Emin Riza, Zija Shkodra, Ferit Duka etj. Studimi i dokumenteve të zyrës urbanistike të bashkisë së qytetit të Elbasanit janë një tjetër element i rëndësishëm i studimit. Gjithashtu janë realizuar vizita në terren për të vëzhguar llojet e ndërtimeve. Gjatë daljeve në terren janë realizuar disa intervista me banorë të fshatrave. Analiza e gjetjeve në literaturë dhe terren është pjesë përbërëse e studimit, madje më kryesorja.

### IV. Gjetje dhe diskutime

#### 4.1. Banesa me hajat, karakteristika të përgjithshme

Banesa me hajat është karakteristike për Shqipërinë e Mesme dhe veçanërisht Elbasanin në periudhën e mesjetës. Në jo pak raste ajo njihet si banesë elbasanase. Cilat janë karakteristikat kryesore të kësaj banese?

Në banesat e hapura me hajat dhe çardak, tremat zënë një vend të rëndësishëm funksional dhe kompozicional në banesë. Si të tilla, ato përbëjnë elementin bazë në konceptimin e banesës, duke qenë qendra e kompozimit dhe duke përmbushur funksione të rëndësishme jetësore, veçanërisht në stinët e ngrohta të vitit.

Banesa me hajat dallohet për kompozimin e shtrirë horizontal, për lidhjen e ngushtë me oborrin dhe natyrën në përgjithësi.

Edhe në periudhën midis shekujve XIX-XX vërejmë se kemi këtë tip banese, por gjithashtu dhe evoluim në teknologjinë dhe tipologjinë e saj. Megjithatë, edhe në këtë periudhë, në Elbasan dominon banesa me hajat, por jo rrallë edhe ajo me çardak. Hajati (në dokumentet osmane të kohës quhej edhe “dehliz”) ishte një mjedis i mbuluar që ndërlidhte oborrin me banesën (Duka 2009, f. 363). Parapëlqimi i kësaj banese në Elbasan duhet lidhur me karakterin e ekonomisë, ku ekonomia qytetare ishte e pashkëputur

nga prodhimi bujqësor. Sipërfaqet e gjera që kufizonin muret rrethuese të banesave, përbënin një faktor të rëndësishëm në ekonominë familjare (*Riza 1991, f. 112*). Madje edhe zhvillimi i ekonomisë feudale që arriti shkallën më të lartë me esnafët, e bënte banesën me hajat mjaft të përshtatshme dhe komode. Këtë banesë njëkohësisht e favorizonte edhe prania e trojeve të mëdha të ndërtimit, të cilat kjo banesë i parapëlqente, si dhe numri i vogël i popullsisë. Ky tip banese është përdorur që në lashtësi, madje për shekuj me radhë (*Riza, 1991, f.112*). Në literaturën e këshilluar pretendohet se kjo banesë është ndërtuar deri në fillimin e gjysmës së dytë të shekullit XIX (*Riza 1991, f. 112*). Këtë banesë në Elbasan e më gjerë ne e gjejmë edhe në shekullin XX.

#### **4.2. Banesa me hajat në fillim të shekullit XX**

Gjatë shekullit të 20-të në zhvillimin urban të Elbasanit kemi dy momente të rëndësishme të cilat patën ndikim në të. Nuk pati ndryshime të dukshme në zhvillimin urban gjatë viteve 1912-1924, menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë. Periudha e parë e rëndësishme fillon gjatë viteve 1924–1939, me ndryshime të mëdha politike dhe ndryshime, si krijimi i Republikës së Shqipërisë në 1925 dhe krijimi i Mbretërisë Shqiptare më 1928. Marrëdhëniet politike dhe ekonomike me Italinë u forcuan. Këto lidhje të ngushta u pasqyruan në marrëveshjet e partneritetit të nënshkruara mes Tiranës dhe Romës. Në atë periudhë, familjet e tregtarëve dhe bejlerëve në Elbasan filluan të investonin për kushte më të mira jetese. Veç kësaj, në periudhën e viteve 1939- 1990 vihen re ndryshime të dukshme në zhvillimet urbane dhe tipologjinë e banesës.

Banesat e këtyre familjeve të pasura u ndërtuan në stilin evropian. Shembuj janë banesa e familjes *Biçaku* në lagjen *Karaveli* afër murit të kalasë, e Lef Nosit brenda në kala, e familjes *Plangarica*, në lagjen *Beqire* (sot quhet lagja *Qemal Stafa*), e familjes

Hastopalli në lagjen “Bobolle”, e familjes Vërlaci etj. Këto banesa ndiqnin stilin europian jo vetëm në pamjen e jashtme por edhe në arredimin e brendshëm. Karakteristikë e ndërtimeve të tilla në këtë periudhë është se, dy faqet e banesës dalin në rrugë dhe kjo ndodh kur sipërfaqja e ndërtimit është e vogël (*Lughod, 1987, f.147*). Pavarësisht këtyre ndërtimeve të stilit europian, edhe banesa me hajat i qëndroi kohës. Në mënyrë të veçantë familjet me të ardhura të pakta ndërtonin këtë tip banese.

Kriteri kompozicional është i tillë: hajati në ballë, kthinat e banimit në qendër dhe në pjesën fundore kthinat ndihmëse (*Riza, 1991, f.113*). Në Elbasan ka qenë ndërtuar një tip banese që dallonte nga banesa e zakonshme me hajat në pasi ishte e ngritur nga trualli rreth 40-100 cm. Pikërisht ky tipar lokal i ka dhënë emërtimin karakteristik “dollmallije”, d.m.th. e mbushur. Kjo mënyrë ndërtimi, mund të jetë diktuar nga përmbytjet që vërshonin në qytet nga disa përrenj stinorë, megjithëkëtë, kjo zgjidhje tregon për një kulturë të mirë banimi (*Riza, 1991, f.113*). Sipas të dhënave hajat kishin edhe shtëpitë përdhese (*Duka, 2009, f.363*).

Një gjetje e tillë, mendojmë, është nga më të përkryerat për të lidhur kthinat e banimit me hajatn dhe natyrën. Hajati kishte funksione të ndryshme, që nga përpunimi i produkteve bujqësore deri te shfrytëzimi për banim gjatë periudhës së verës. Hajati ka qenë i shtruar me baltë të ngjeshur dhe të rrahur (*Demiri, 2006, f.47*). Një element shumë i rëndësishëm në banesën me hajat në Elbasan ka qenë sofaja. Sofaja ishte një podium i ngritur një ose dy shkallë nga hajati, e vendosur në anë të tij, është i sheshtë, d.m.th. i shtruar me baltë të rrahur ose dysheme dërrase. Ajo ishte e rrethuar me parmakë druri. Në mjaft raste kjo sofa ishte kthyer në dhomë me dërrasa. Në mur shpesh herë kishte dollapë, gjë që tregon se gjatë verës sofaja mund të përdorej edhe si ambient banimi (*Riza, 1991, f.114*). Jo rrallë ndërtohej edhe një sofa e dytë, e cila ishte më e ngritur se e para dhe e rrethuar me parmakë druri.

Kjo sofa ngrihej, mund të ngrihej ose jo, në vazhdimin horizontal të hajatit, ose mund të formonte kënd të drejtë në pjesët fundore të tij. Poshtë kësaj sofaje ose qoshku siç quhej ndryshe, të mbuluar me çati, ngrihej një kthinë ndihmëse (Riza, 1991, f.118). Por sofatë mund të ishin në të dyja anët e hajatit simetrike me njëra-tjetrën.

Në këtë periudhë kemi ndërtimin e një tipi banese e cila në pikëpamje kompozicionale u përmbahet kriterëve të njohura tipologjike, atyre të banesës me hajat. Vazhdon ngritja nga trualli me rreth 85 cm, poshtë së cilës ngrihet një kthinë ndihmëse. Kjo banesë ndryshe është quajtur “dollmallije”, dhe mori aq shumë përhapje në Elbasan saqë filloi të quhet banesa “elbasanase”. Si ishte ndërtuar kjo banesë? Në qendër është *shtëpia e zjarrit*, që është ambienti kryesor i shtëpisë. Funkzioni kryesor i këtij mjedisi ishte gatimi dhe përgatitja e ushqimeve, por ajo është përdorur edhe si vend qëndrimi për pjesëtarët e familjes. Nuk dimë nëse në atë kohë ky mjedis ishte pajisur apo jo me oxhak për tërheqjen e tymit, porse, duke gjykuar nga dëshmitë e mëvonshme, del se vatra me oxhak ishte një dukuri mbisunduese në këtë mjedis të banesës qytetare (Duka, 2009, f.363).

Në të dyja anët e hajatit kemi dy sofa. Banesa me hajat në foto është tipike me praninë e sofasë në anën e majtë. Oda e miqve paraqitet një zgjidhje origjinale, ku mbizotërojnë zbukurimet e ndryshme, në tavane sidomos, apo edhe te dollapët në mure. Kompleksi musëndër-trapazan (ndarje me dërrasë) paraqitet i zhvilluar në këtë kthinë. Tavani me daltime është i llojit me kazan, pra me një thellim në formë sferike në qendër, si dhe oxhak dekorativ (Riza1991, f.114). Ambientet kryesore sipas profesor Shyqyri Demirit, ishin: Soba e madhe, akçihania dhe soba e vogël (Demiri, 2006, f.47). Sobat kanë pasur brenda tyre parvane dhe dollapë, shpeshherë të skalitur, që paraqisnin lule të stilizuara, por jo figura njerëzish pasi nuk i lejonte feja myslimane (Demiri, 2006, f.47). Para se të hyje në këto ambiente duhej të kaloje nëpër hajat, i

cili në tri anë mbështetej në mur, kurse nga ana e përparme mbështetej në shtylla druri (Demiri 2006, f.47). Edhe në këtë periudhë kjo banesë ndërtohej pasi ishte mjaft ekonomike dhe hajati përdorej për përpunimin e produkteve bujqësore në fshat. Edhe në qytet e gjejmë këtë banesë pasi ishte ekonomike edhe në ndërtim.



Fig.1. Banesa me hajat dhe sofa e familjes Çausi. Sot nuk ekziston më si banesë.  
Foto: Zhuljeta Kadilli.

### 4.3. Banesa me hajat në vitet 1944-1990

Pas çlirimit të vendit në vitin 1944, Partia Komuniste e drejtoi Shqipërinë drejt një ekonomie të centralizuar. Për sa i takon zhvillimit urban, ai u zhvillua sipas orientimeve sovjetike që kishin të bënin me ndërtimin e banesave kolektive. Ky orientim vazhdoi deri në fillim të viteve 1960, që shënoi ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik. Teoritë



marksiste ishin orientimi kryesor i zhvillimit të vendit. Enver Hoxha, diktatori komunist që udhëhoqi vendin për 40 vjet, urdhëroi shpronësimin e pronarëve pa shpërblim dhe vendosi pronësinë kolektive. Në shumë raste ky shpronësim është bërë në mënyrë të dhunshme (*Smirnova, 2004, f. 377*).

Planet e kësaj periudhe u hartuan pa marrë parasysh nevojat e popullsisë. Edhe në fushën e zhvillimit urban Partia Komuniste shkatërroi gjithçka që i përkiste së shkuarës. Gjatë viteve të para pas Luftës së Dytë Botërore, plani i qytetit u kërkuar të bazohej në parimet e ekonomisë socialiste, duke ndjekur kështu përvojën sovjetike. U krijua një komision publik ndërtimi që përfshinte specialistë shqiptarë dhe të Bashkimit Sovjetik (*AQSH, Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Viti 1951, Fondi 487*). Stili i ri në zhvillimin urban të kësaj periudhe përfshinte ndërtimin e banesave kolektive 29-50 metra katrorë dhe ndalimin e ndërtimit të banesave individuale (*AQSH, Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Viti 1951, Fondi 487*)



Fig.2. Banesa kolektive ndërtuar në vitet e para të çlirimit. Foto: Zhuljeta Kadilli

Në vitin 1960, Instituti Shqiptar i Zhvillimit Urban paraqiti planin e parë urbanistik për Elbasanin, i cili duhej të zbatohet brenda 20 viteve. Ky plan ishte pjesë e planit rregullues për të gjithë Shqipërinë. Plani synonte të linte pas të shkuarën dhe të rindërtonte dy rrugët: “28 Nëntori” dhe “Qemal Stafa”. Përgjatë këtyre dy rrugëve, objektet private u shpronësuan dhe më pas u prishën. Në vend të tyre, numri i madh i ndërtesave të banimit që u ndërtuan në të dyja anët e rrugëve i dhanë një pamje të re qytetit, në të cilin mbizotëronte uniformiteti dhe stili kolektiv i jetesës. Stili italian i katrorit u zëvendësua nga dy rrugë paralele (*Giusti, 2006, f. 27*). Sot këto ndërtesa të periudhës 1960-1970 ekzistojnë ende dhe janë simbol i regjimit komunist në vendin tonë.

Për sa i takon tipit të banesës, në këtë periudhë gjejmë edhe banesën kolektive, edhe atë individuale, të ndërtuar në toka në pronësi private. Kur ndërtoheshin banesa kolektive në truall privat, bëhej shpronësimi pa kompensim, sipas ligjeve të shtetit komunist. Shteti, në fakt, nuk ishte në gjendje të plotësonte të gjitha kërkesat e popullsisë për strehim. Pas çlirimit filloi të rritet popullsia dhe nevoja për banesa u bë e domosdoshme. Shteti e gjeti zgjidhjen për të plotësuar kërkesat në dhënien e lejeve të ndërtimit për banesa individuale, sidomos kur kërkuesit kishin truallin. Banesa me hajat është tipi i banesës që gjeti përhapjen më të gjerë. Shkaku duhet kërkuar në faktin se ndërtimi kërkonte pak të holla, në raport me banesat e tjera. Aty ku kjo banesë ndërtohej kishte edhe kopsht rreth e qark, i cili përdorej për kultivimin e perimeve apo drurëve frutorë. Në këtë mënyrë hajati përdorej pikërisht për vendosjen e këtyre produkteve bujqësor. Ai gjithashtu përdorej, sidomos gjatë verës edhe për të ndenjtur. Nga vlerësimi i tipave të banesave në qytet, rezulton se numri më i madh i banesave private i përkisnin pikërisht tipit të banesës me hajat. Vetëm në një rrugicë të lagjes “Çlirimi” nga 1945 deri në 1990 kanë qenë rreth 50 banesa, nga të cilat vetëm dy kanë qenë

dykatëshe, të tjerat kanë qenë njëkatëshe dhe me hajat. Parapëlqimi i kësaj banese në Elbasan duhet lidhur edhe me karakterin e ekonomisë. Ekonomia qytetare ishte e pashkëputur nga prodhimi bujqësor.



Fig. 3. Banesa me hajat në ballë dhe shtrije për gjatë saj, para viteve 1990.

Foto: Zhuljeta Kadilli

#### 4.4. Banesa me hajat pas viteve 1990

Çdo sistem ekonomik dhe politik në Shqipëri pati një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin urban të Elbasanit. Pas viteve '90, në Elbasan pati shumë ndryshime urbane për shkak të zhvillimit të lirë demografik në vend. Lëvizja e parregulluar dhe e çorientuar e popullsisë nga zonat rurale drejt qyteteve, si dhe ndërtimet pa leje sollën sfida të reja në përshtatjen e planit rregullues urban ekzistues të vitit 1983. Një pjesë e madhe e qytetit, e cila ishte planifikuar për sipërfaqe të gjelbëruara, e ruajti funksionin. Por pas viteve 1990 kjo u bë e pamundur, pasi kjo sipërfaqe po kthehej në

sipërfaqe ndërtimi. Në këto rrethana, zbatimi i planit rregullues urban të vitit 1983 ishte i pamundur.

Në vitin 2005, zyra urbanistike në bashkinë e Elbasanit në bashkëpunim me një studio italiane projektimi prezantoi planin e ri rregullues urban. Ky plan i ri mori në konsideratë zonat territoriale përreth qytetit, klimën, burimet ujore dhe burimet e industrisë së ndërtimit. Një element i rëndësishëm i këtij plani ishte mundësia e zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së elementeve kryesore të trashëgimisë historike të qytetit. Rritja e popullsisë është një tjetër element që duhet marrë në konsideratë në planin urbanistik. Ai synon legalizimin e zonave informale, krijimin e kantierëve të reja dhe vendosjen e rregullave të ndërtimit brenda kufijve të qytetit. Rregulla të tilla respektojnë mbrojtjen e të drejtave individuale si dhe ruajtjen e trashëgimisë historike. Ajo që duhet theksuar në zhvillimin urban të Elbasanit dhe zonave përreth është ndërtimi i banesave individuale, krahas atyre kolektive. Banesat kolektive janë shumëkatëshe kurse ato individuale janë 2-3 katëshe. Banesa me hajat thuajse është në rënie.

#### **4.6. Gjetjet në terren të banesës me hajat**

Gjatë kërkimit në terren kemi vërejtur se pas vitit 1990, së bashku me ndryshimet politike kanë ndodhur edhe ndryshime në fusha të tjera. Midis këtyre ndryshimeve, më të dukshmet janë ato në zhvillimin urban. Shpeshherë ky zhvillim ka qenë kaotik, për shkak të mungesës së legjislacionit të ri urban që rregullonte zhvillimin urban. Të dhënat për studimin tonë i kemi marrë në disa fshatra, kjo për faktin se aty gjen përshtatjen më të madhe banesa me hajat. Kjo banesë bën më së miri lidhjen me zhvillimin e bujqësisë.

Bashkia e Elbasanit vepron sipas detyrimit të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), VKM

nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar), VKM nr. 626, datë 15.7.2015, “Për miratimin e normativave të projektimit të banesave”, VKM nr. 686 datë 22.11.2017, “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan të miratuar me vendim të KKT nr.1 datë 29.12.2016.

Sipas vlerësimit të dokumentacionit të zyrës urbanistike të bashkisë së Elbasanit kemi të dhënat e mëposhtme.

Vlerësimi për aplikimet për leje për objektet nën 250 metra katrorë, janë marrë të dhënat që disponojnë Arkiva teknike e DPZHT për vitin 2018, si edhe nga sistemi elektronik “e-leje” për periudhën 2019-2021.

Viti 2018 (Këto të dhëna janë marrë nga zyra urbanistike e bashkisë së Elbasanit)

Miratuar 11 (njëmbëdhjetë) leje ndërtimi për llojin “Leje ndërtimi deri në 250 metra katrorë”, arkivuar pranë arkivës teknike të drejtorisë, bashkia e Elbasanit, nga të cilat: 6 në qytet, 2 në Vidhas, 1 në Gjergjan dhe 1 në Gjinar.

Viti 2019

Miratuar 19 (nëntëmbëdhjetë) leje ndërtimi për llojin “Leje ndërtimi deri në 250 metra katrorë”, arkivuar pranë arkivës teknike të drejtorisë, bashkia e Elbasanit, nga të cilat: 9 në qytet, 2 në Kuqan, 2 në Kusarth, 1 në Bradashesh, 1 në Jagodinë, 1 në Vidhas, 1 në Gjonëm, 1 në Gjinar, një në Labinot Fushë.

Viti 2020

Miratuar 42 (dyzet e dy) leje ndërtimi për llojin “Leje ndërtimi deri në 250 metra katrorë”, arkivuar pranë arkivës teknike të drejtorisë, bashkia e Elbasanit.

Viti 2021

Deri në tremujorin e tretë, konkretisht deri në shtator 2021, janë miratuar 34 (tridhjetë e katër) leje ndërtimi, për llojin “Leje ndërtimi deri në 250 metra katrorë”, sipas sistemit “e-leje”.

Këto të dhëna janë për lejet e ndërtimit deri në 250 metra katrorë. Në pjesën më të madhe këto banesa janë 2-3 katëshe. Gjithsesi të dhëna analitike mbi gjendjen e banesës me hajat kemi për këto tre njësi banimi.

Shirgjan, nga rreth 400 banesa (shtëpi banimi), 250 janë njëkatëshe dhe 150 2-3 katëshe.

Hajdaran, nga rreth 500 banesa (shtëpi banimi), 150 njëkatëshe dhe 350 2-3 katëshe.

Katjel, (Katjeli bën pjesë në bashkinë Prrenjas, Prefektura Elbasan), nga rreth 600 banesa (shtëpi banimi) 350 njëkatëshe dhe 250 2-3 katëshe<sup>1</sup>. Edhe nga vështrimi në terren, sidomos në rrugën Elbasan- Belsh, Elbasan-Tiranë, Elbasan-Pogradec, vihen re ndërtime të shumta 2 dhe 3 katëshe. Në mjaft raste janë në mes të arave, por edhe buzë rrugëve nacionale. Kjo gjë vërehet edhe me sy të lirë. Nga biseda e bërë me banorë të fshatrave Katjel, Shirgjan dhe Hajdaran, Artur Zito, Besim Muça dhe Xhevit Duraku, rezulton gjithashtu se banorët nga dëshira për shtëpi, ngaqë nuk kanë pasur në të kaluarën, ndërtuan shtëpi të mëdha. Një pjesë e tyre ishin në emigrim në Greqi, fituan lekë dhe i investuan për të ndërtuar shtëpi. Shumë prej tyre janë bërë pishman, por iku ajo punë. Kanë ndërtuar vend e pa vend. Investime në bujqësi kanë bërë pak. Shumë të rinj kanë ikur nga fshatrat apo edhe duan të ikin. Nuk e shohin me interes bujqësinë. Edhe shteti duhet të bëjë më shumë për të investuar në bujqësi<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Shënim: Të dhënat për fshatrat e Prefekturës së Elbasanit janë marrë nga studentët e Masterit Profesional për Mësuesi në Edukatë, Histori, Eriseld Zito, Artjola Duraku, Anisa Muça.

<sup>2</sup> Nga biseda e bërë me banorët, Artur Zito, Besim Muça dhe Xhevit Duraku.



Fig.4., Banesa me hajat në Shirgjan, Artjola Duraku, Fig. 5. Banesa dykatëshe ne Hajdaran, Anisa Muça

## V. Analiza e gjetjeve

Duke analizuar këto gjetje, vërejmë se pas viteve 1990 ka tendencë të rritet numri i banesave individuale 2 dhe 3 katëshe. Edhe pse në dy fshatra ka më shumë banesa njëkatëshe, numri i banesave 2 dhe 3 katëshe po vjen duke u rritur. Pse po ndodh ky fenomen? Për mendimin tonë, ky fenomen është pasojë e problemeve të strehimit që kanë qenë para viteve 1990. Edhe kushtet ekonomike e vështirësonin ndërtimin e banesave. Në shumë raste banorët nuk kishin mundësi financiare për të ndërtuar. Kjo bënte që të jetonin në vështirësi, madje pse jo edhe dy apo tri kurorë në një banesë. Dhënia e lejeve të ndërtimit gjithashtu ishte e vështirë, kjo për shkak edhe të centralizimit të veprimeve të zyrave të urbanistikës. Një tjetër problem që hasej gjatë procesit të ndërtimit ishte edhe kreditimi nga banka, të cilat kërkonin garanci nga kredimarrësit.

Në këtë kontekst, pas viteve 1990, njerëzit të etur për banesë filluan të ndërtojnë, pse jo jashtë çdo kriteri urbanistik. Këto ndërtime kaotike i nxitën edhe të ardhurat e siguruar nga puna në emigracion. Në këtë mënyrë vërshoi ndërtimi i banesave individuale, por edhe kolektive. Mungesa e Planeve Urbane të qyteteve dhe fshatrave, liberalizimi i lejeve të ndërtimit, lëvizjet

kaotike të popullsisë, mungesa e kontrollit nga organet kompetente bëri që të ndërtohej vend e pa vend pa asnjë kriter, madje banesa të mëdha 2-3 katëshe.

Ne mendojmë se një pjesë e këtyre banesave individuale janë bërë pa asnjë lloj studimi për tokën ku janë ndërtuar dhe madhësinë e tyre. Pse? Ato janë ndërtuar në toka arë, duke zvogëluar sipërfaqen aq të domosdoshme për bujqësinë. Njëkohësisht kanë shpenzuar të holla për ndërtimin e banesave të mëdha, në një kohë që mund të mos jenë aq të domosdoshme. Ajo që konstatohet gjithashtu, është se një pjesë e banorëve që kanë këto banesa të mëdha janë në emigracion, pra thjesht kanë investuar të ardhurat e tyre nga puna në emigrim. Duke bërë një studim më të thelluar për kostot dhe përfitimet e ndërtimit të një banese individuale më të vogël, më ekonomike, do të kishin mundësi të investonin në zhvillimin e bujqësisë dhe sigurimin e të ardhurave. Gjithashtu është edhe një variant i diskutueshëm, që për të mbrojtur tokën bujqësore mund të ndërtohej një banesë kolektive, me disa familje në fshat, që edhe toka ruhej, edhe shpenzimet janë më të vogla. E rëndësishme është që çdo gjë duhet të bëhet mbi bazën e studimeve të mirëfillta ekonomike. Vetëm kështu zgjidhen problemet sociale dhe ekonomike.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Në studimin e bërë rezulton se banesa me hajat ka qenë mbizotëruese në tipin e banesave individuale në qarkun e Elbasanit, sidomos në fshat, në periudhën deri në vitin 1990. Në ndërtimin e kësaj banese kanë ndikuar në radhë të parë aspekti ekonomik në ndërtim dhe lidhja e saj me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Pas viteve 1990 kjo banesë e humbi përhapjen e dikurshme. Kjo për faktin se largimi në emigrim i popullsisë krijoi të ardhura që mundësuan ndërtimin e banesave individuale dy apo trikatëshe.



Largimi gjithnjë e më shumë nga puna në bujqësi e banorëve, bëri që të heqin dorë nga ky tip banese.

Ne rekomandojmë që të ndërtohen banesa sa më ekonomike dhe pjesa tjetër e të ardhurave të investohen në zhvillimin e bujqësisë.

Të kthejnë vëmendjen nga zhvillimi i bujqësisë si një sektor prioritar në vendin tonë në aspektin e zhvillimit ekonomik.

Përpara se të bëjnë investimin në ndërtimin e banesave, është e domosdoshme të bëjnë studimin në aspektin ekonomik dhe social, qoftë kjo edhe në marrëdhënie me banorë të tjerë.

### Literatura

AQSH, (1967), Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës, Fondi 315.

AQSH, (1951), Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Fondi 487.

AQSH, (1951), Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Fondi 87.

Demiri, Sh., (2006). Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Shtëpia Botuese "Egnatia".

Duka, F., (2009). Shekujt Osmanë në hapësirën shqiptare, UET Press, Tiranë.

Giusti, M.A., (2006). Albania, Architettura e Citta (1925-1943), Firenze.

Lughod, J.A., (1987). The Islamic City, Historic Myth, Islamic Essence and Contemporary Relevance.

Riza, E., (1991). Qyteti dhe banesa Shqiptare e Mesjetës së Vonë, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë.

Smirnova, N., (2004). Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, Botime "IDEART".

Shkodra, Z., (1973). Esnafet Shqiptare (shek. XV-XX). Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë.

Zyra e Urbanistikës në Bashkinë Elbasan.

**Dr. Dorian Koçi<sup>1</sup>**

## **RINDËRTIMI I KUJTESËS URBANE TË QENDRËS HISTORIKE TË TEPELENËS**

### **Abstrakt**

Tepelena, vendlindja e Ali pashë Tepelenës, nuk ka zënë ende vëmendjen e duhur në studimet e trashëgimisë kulturore për identifikimin e vendeve që reflektojnë memorien historike për sa u përket lidhjeve të veçanta që kishte kjo figurë historike me vendlindjen e vet. Kjo mosvëmendje ka ardhur më së tepërmi për arsye se Janina si kryeqendra e pushtetit të tij administrativ ka qenë më tepër në qendër të vëmendjes së udhëtarëve të huaj, pavarësisht faktit që vetë Ali Pasha e përmendte gjithnjë vendlindjen e vet dhe madje i ftonte ta vizitonin vendlindjen e tij. Jashtë murit të fortesës, nga ana e Gjirokastrës gjendej një gur i rrafshuar në formën e një froni. Gojëdhëna thotë se mbi këtë gur rrinte Ali Pasha kur vinte në Tepelenë. Atje shkante ca minuta të orës afër perëndimit. Sot ky shkëmb i gdhendur në formë froni nuk ekziston. Në zgjerimet që iu bënë sheshit në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar, në momentin kur u ndërtua dhe rruga që shkante poshtë kalasë, ka të ngjarë që të jetë zhvendosur pa e ditur se po hiqnin gjurmët e një trashëgimie të rëndësishme të Ali Pashës në vendlindjen e tij. Riemërimi dhe shpallja si monument natyror i vendit, ku sipas fotografisë që gjendet në Arkivin e Muzeut Britanik, shkrimit të Edith Durham dhe Mit'hat Frashërit për shkëmbin froni do të ridimensionojë më mirë panoramën e trashëgimisë kulturore të Ali pashë Tepelenës në vendlindjen e tij.

*Fjalë çelës: Tepelena, Ali pashë Tepelena, trashëgimia kulturore, memoria historike*

### **Abstract**

Tepelena, the birthplace of Ali Pasha Tepelena has not yet received the right attention in cultural heritage studies to identify places that reflect the historical

---

<sup>1</sup> Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, E-mail: dorian.koci@gmail.com

memory in terms of special connections that this historical figure had with his birthplace. This inattention has come mostly because Ioannina as the center of his administrative power has been more in the spotlight of foreign travelers despite the fact that Ali Pasha himself always mentioned his hometown and even invited them to visit his hometown. Outside the walls of the fortress, on the side of Gjrokastra, there was a flattened stone in the shape of a throne. The legend says that Ali Pasha was standing on this stone when he came to Tepelena. He went there a few minutes near sunset. Today this throne-carved rock does not exist. In the extensions made to the square in the late 60s of the last century at the time it was built and the road that went down to the castle is likely to have been moved without knowing that they were removing traces of an important legacy of the Pasha in his birthplace. Renaming and proclaiming the place as a natural monument where according to the photo found in the Archive of the British Museum, the writing of Edith Durham and Mit'hat Frashwri for the throne rock will better resize the panorama of the cultural heritage of Ali Pasha Tepelena in his hometown.

*Keywords: Tepelena, Ali Pasha Tepelena, cultural heritage, historical memory*

## I. Hyrje

Në 21 tetor të vitit 1809 kur Bajroni dhe Hobhouse vizituan Tepelenën, lanë disa përshtypje për sarajet e Ali Pashës, gjurmë të së cilave nuk gjenden sot. ...Të nesërmen shkruan Bajroni në letërën e tij dërguar së ëmës nga Preveza në 12 nëntor 1809, më shpunë tek Ali Pasha. Isha veshur me uniformë të plotë shtabi, me shpatë madhështore etj. Veziri më priti në një odë të madhe të shtruar me mermer; një shatërvan vijonte ujët në mes të saj, oda e shtruar rreth e rrotull me otomane të kuqërremtë.<sup>1</sup> Sarajet e Ali pashë Tepelenës nga brenda reflektonin stilin otoman me shatërvan, mermer dhe sofa të kuqërremtë që vite më vonë do të shtrihej dhe në Europë me sallonet të mobiluara sipas këtij stili dekorimi. Rreth 40 vjet më vonë, kur Edward Lear do vizitonte Tepelenën në 31 tetor 1847,

---

<sup>1</sup>Shënim: Letra e Bajronit dërguar së ëmës, zonjës Katerina Gordon Bajron. Zonjës Katerina Gordon Bajron Prevezë, 12 nëntor 1809. Përkthyer nga Skënder Luarasi. Citohet sipas librit të profesor Afrim Karagjozit "Miti Shqiptar për Bajronin".

nuk do të gjente gjurmë të sarajeve madhështore, por disa rrënoja që pasqyronin lavdinë e së shkuarës. Lear botoi ditarin e vet “Journal of a Landscape Painter in Albania” më 1851. Ditari është pasqyrim i mbresave dhe shënimeve të udhëtimit që Lear ndërmori në Shqipëri më 24 shtator – 4 nëntor 1848, ku përmendet dhe udhëtimi i tij nga Vlora drejt Tepelenës. Nga kodrat e veshura me ullishta sipër Vlorës mora rrugën për në vendin e lindjes së të mahnitshmit Ali Pasha. .... na u desh të kalonim një luginë të gjatë, të ngushtë e gjarpëruese, pastaj një përrua, pastaj një kodër të pafund nga maja e së cilës shihej Vjosa e gjerë që turrej drejt detit mes kodrash të mbjella, në faqet e të cilave xixëllonin fshatra të shumta si Gradishta, Karbunara etj., ndërsa sipër të gjitha këtyre lartohej Tomori gjigant. ...Vjosa rrjedh nëpër një grykë të ngushtë mes shkëmbinjve rrzë malit të Kudhësit, kurse mbi grykën e errët ngrihen malet e bukura dhe të ndara të Trebeshinës dhe Hormovës. Në këmbët e spektatorit, deri sa të sheh syri, shtrihet shtrati i gjerë shkëmbor në të cilin Vjosa, tashmë e çliruar nga kufijtë e ngushtë, rrjedh gjerësisht e shpenguar e në shumë degëzime, për në det. Ujërat e saj të errëta vezullojnë si mijëra fije gjarpëruese në një tokë të bardhë që të merr sytë . Ai bën disa skicime e peizazhe gjatë rrugës derisa arrin në Tepelenë në 31 tetor. Ishte gati ora tre e pasdites kur gjarpërimet e fundit të lodhshme të luginës na nxorën përpara malin e madh të Trebeshinës dhe fqinjën e tij, malin e Hormovës, që tani dukeshin qartë nga rrëza deri në majë. Të dy lartoheshin qetësisht me nuanca vjollcë të ndezur nën majat e mbuluara nga dëborat vezulluese. Në ta bashkimi i dy lumenjve të Vjosës dhe Bënçës krijon kepin e Tepelenës, ku pallati me muret e rrënuara e xhamia me tone të argjendta i japin skenës (një nga sublimet e më të thjeshtat në Shqipëri dhe, pa dyshim, e ngarkuar me lidhje historike të lashta e të reja), një aureolë të çuditshme romantizmi ëndërrimtar (*Lear, 2009*).

## II. Fusha dhe metoda e studimit

Artikulli “Rindërtimi i kujtesës urbane të qendrës historike të Tepelenës” është fokusuar në këto pika kryesore: Tepelena, vendlindja e Ali pashë Tepelenës, nuk ka zënë ende vëmendjen e duhur në studimet e trashëgimisë kulturore për identifikimin e vendeve që reflektojnë memorien historike për sa u përket lidhjeve të veçanta që kishte kjo figurë historike me vendlindjen e vet. Kjo mosvëmendje ka ardhur më së tepërmi për arsye se Janina si kryeqendra e pushtetit të tij administrativ ka qenë më tepër në qendër të vëmendjes së udhëtarëve të huaj, pavarësisht faktit që vetë Ali Pasha e përmendte gjithnjë vendlindjen e vet dhe madje i ftonte ta vizitonin vendlindjen e tij. Metodologjia e punimit është gjithëpërfshirëse, analitike dhe krahasuese. Për shtjellimin e temës janë zbatuar katër metoda kërkimi: përshkruese, hulumtuese, krahasuese dhe parashikuese. Këto katër metoda ndërthuren, duke respektuar kronologjinë e ngjarjeve.

## III. Gjetje dhe diskutime

### Vizita e Edith Durham në Tepelenë në 1904

Edhe Edith Durham do t’i vizitojë atë çka mbetur nga sarajet e Ali pashë Tepelenës duke lënë edhe një skicë. Në pasazhet e udhëtimit për në Tepelenë Edith Durham gjen pothuajse të gjitha karakteristikat e pushtetit otoman, të cilat hasnin pothuajse gjithë udhëtarët europianë: papërgjegjshmërinë, qeverisjen despotike, anarkinë ekonomike dhe intolerancën fetare (*Jelavich, 1955*). Por në të njëjtën kohë, edhe përqasja e Durham në shkrimet e saj ndaj popullsisë të Ballkanit do të ishte njëlloj si edhe e udhëtarëve të tjerë, e bazuar në perceptimin dhe njohjen e Ballkanit në Europë, i analizuar nën spektrin e “Ballkanizmit”, i cili ka huazuar nga diskursi i orientalizmit eksplorimin e mënyrave sesi kolonializmi

ishte më tepër një mendësi perceptimi kulturor sesa një dominim politik dhe ekonomik i Perëndimit ndaj Ballkanit (*Fleming, 2000*).

Durham shkruan se tani konaku i Aliut është një pìrg i madh gërmadhash dhe brenda mbeturinave të tij tani banojnë një grumbull jevgjish të zes<sup>1</sup> të një tipi zuzarësh shumë të ulët. Këta tani përbëjnë një pjesë të popullsisë të këtij qyteti. Njëqind shtëpi jevgjish, shtatëdhjetë shtëpi myslimanësh shqiptarë dhe tridhjetë të krishterësh shqiptarë përbëjnë popullatën e këtij qyteti. Këta banojnë nëpër muret e Aliut. Tokat jashtë dhe shtëpitë brenda tokave janë prona të teqesë së vendit e cila mbahet si shumë e pasur. Bodrumet janë të forta dhe të ndërтуara mirë me gurë të gdhendur. Aliu kishte ndër mend që ta bënte Tepelenën një qytet me rëndësi, gjë që ka mundësi të bëhet dikur edhe në të ardhmen sepse lugina e Vjosës është e vetmja rrugë e moçme brenda mureve të Aliut (*Durham, 2009*). Një informacion tjetër i vlefshëm është gjendja në të cilën ndodhet ura e famshme mbi Vjosë, nën kala, e ndërтуar nga Petro Korçari, kryearkitekti i Ali pashë Tepelenës. Për të ka dëshmi të shumta në harkun kohor 1805- 1812 nga Leake, Hobhause, Dr Holland. Dr Holland në librin e vet *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, &c., during the years*

---

<sup>1</sup>Shënim: Tekstet e Durham si dhe udhëtarëve të tjerë të huaj janë të ndikuar nga diskursi i orientalizmit që përcaktoi për herë të parë studiuesi Edward Said në veprën e vet “Orientalism” (1978). “Orientalizmi” thekson Edward Said, “është një shpërndarje e shqetësimit gjeopolitik në tekste estetike, shkollore, ekonomike, sociologjike, historike dhe filologjike”. Edward Said. “Orientalism” Penguin, 1995, faqe 12. Në këtë kontekst, këto tekste janë dhe pasqyrim i paragjytimeve të ndryshme mbi popullsitë përfshi dhe komunitetin me origjinë egjiptiane në Tepelenë, të cilët e identifikojnë veten si shqiptarë. Çështja e identitetit, etno-kulturës dhe historisë të egjiptianëve të Ballkanit është një nga problemet më të vështira shkencore. Duke e kujtuar se historia nuk është çështje e së kaluarës, por është përgjigje e nevojave të jetës moderne, është gjithashtu e rëndësishme të gjendet mënyra se si një kontekst historik ose tradicional përdoret në procesin aktual të krijimit të realitetit.

1812 and 1813 botuar në 1813 shkruan për Tepelenën, sarajet e Ali pashë Tepelenës dhe urën mbi Vjosë poshtë sarajeve.

Tepelena, qyteti i lindjes së Ali Pashës, ndodhet në bregun perëndimor ose në të majtë të lumit, mbi një lartësi gadishullore të formuar nga bashkimi i Bënçës me Vjosën. Saraji madhështor i Vezirit, pothuajse i njëjtë me përmasat me atë të Janinës, qëndron në buzë të shkëmbit, mbi ujërat e Vjosës. Pranë tij ndodhet një xhami e madhe dhe diku poshtë gjenden rrënojat e një ure të shkatërruar nga prurjet e Vjosës në dimër. Ura është shembur dy ose tri herë, pavarësisht përpjekjeve të shumta të Vezirit për ta ndërtuar më të qëndrueshme. Hera e fundit kur u shemb nga përmbytja ka qenë në vitin 1812 dhe që atëherë nuk janë bërë të tjera përpjekje për ta ndërtuar. Kur u ktheva në Janinë, Ali Pasha kërkoi mendimin tim për këtë urë. Në përgjithësi i thashë Vezirit, që shumë ndërtime ai i kryente shumë më shpejt se ç' duhej dhe në të njëjtën kohë i propozova një urë me varka, që në përgjithësi është më e përshtatshme në atë vend. Ai tha se një sugjerim i tillë i ishte bërë edhe më përpara, por ai dëshironte të ngrinte një objekt më të qëndrueshëm në vendin e tij të lindjes (*Holland, 2008*). Sot ekziston vetëm këmba e urës mbi lumin Vjosa.

Pothuajse një shekull më vonë, Durham përshkruan situatën në të cilën ndodhet në Tepelenë me sarkazëm dhe diskursi i saj është i ngritur mbi kontrastin e dy botëve: perëndimore që ajo përfaqëson dhe orientale me të cilën po ndeshet. Pas një orë udhëtimi, shkruan Durham, mbërritëm në Vjosë, me Tepelenën madhështore në anën tjetër, të fortifikuar me mure guri të mëdhenj, me bodrume dhe bedena të ndërtuara nga Ali Pasha, por i papërfunduar për shkak të vdekjes së tij. Pata mjaft kohë për ta soditur. Lumi gjarpëronjës dhe rrotullonjës në gjire vështronte i turbulluar duke shkumëzuar rreth tetë bedenave të urës së prishur. Në kodër, përtej shiheshin njerëz që bërtisnin dhe thërrisnin. Një nga suvaritë e mi vuri dorën në gojë e thirri. Thirrjes iu përgjigj një zë. Lumi kishte filluar të

binte dhe ndoshta pas tri orësh do të mundnim të kalonim, por tani për tani lundra nuk mund të hidhej në asnjë mënyrë. Shkarkuam plaçkat dhe kuajt i lëshuam për të kullotur. Disa vendës që jetonin aty thoshin se mund të krijoheshin mundësi që mua mund të më hidhnin më shpejtë përtej dhe shpresonin se mund të përfitonin dhe ata nga ai rast. Në këtë bisedë dëgjova dhe historinë e urës. Ajo që rrëzuar gjashtë vjet më parë nga një stuhi e madhe dhe qysh prej asaj kohe qyteti vuante shumë. Fushat e tij më të shumta shtriheshin përtej lumit dhe ky nuk është i kalueshëm, në pjesën më të madhe të vitit. Toka për këtë arsye mbetet e pambjellë dhe e papunuar. Njëri nga suvaritë e mi kishte një copë toke të mirë këtu që përballonte jetesën mirë, por që nga koha që nga koha që rrëzuar ura, ai u shtrëngua që të regjistrohej në polici. Pastaj vazhdoi të thotë për prapambetjen e rrogave. Të gjithë të pranishmit m'u lutën t'i ndihmoja.

“Po të duash të marrësh masa”, tha njëri prej tyre, “do të shpëtosh qindra njerëz të këtij vendi.”

Mora vesh se shumë njerëz kishin shprehur dëshirën për të kontribuar për rindërtimin e urës dhe kishin dërguar shumë herë lutje në Stamboll, por kot. Dyzet deri në pesëdhjetë veta në vit mbyteshin në kohën që binte lumi duke u përpjekur që të evitonin shpenzimet e lundrës. Këta ishin përpjekur që ta ndërtonin urën në mënyrë provizore duke hedhur trarë mbi këmbët ekzistuese, por autoritetet nuk i kishin lejuar duke u thënë se ndërtimi i urave i përkiste shtetit. Ata ishin me të vërtetë në hall me këtë çështje. Një mysliman më tha që unë t'i shkruaja Sulltanit që ai të më jepte leje ta ndërtoja unë me shpenzimet e mia. Unë iu përgjigja se s'kisha të holla për të ndërtuar ura.

“Do të të kushtojë vetëm një pullë post”, tha ai. “Ti duhet t'i shkruash dhe t'i thuash që pamja e mjerueshme e nënshtetasve të tij myslimanë të detyroi ty një grua, për më tepër e krishtere, t'i ndihmosh. Një grua, një e krishtere! Do të jetë një goditje e



shëndoshë për padishahun tonë kur të marrë vesh ndihmën që kërkon të japi një grua kaure, prandaj ai në çast ka për të dhënë urdhër për ndërtimin e urës! Por duhet ta shkruash kur të vesh në Angli. Ai i merr letrat që i drejtohen nga të huajt, kurse lutjet tona ai nuk i sheh kurrë". Sulltani shtoi një tjetër kishte frikë nga anglezët. Ai i lë ata të bëjnë si të duan; "Nuk shihni se ç'kanë bërë ata në Maqedoni! Ti mund të na ndihmosh po të duash!"

Hipa mbi gërmadhën thatanike të urës së prishur dhe pashë malet e egra, të vetmuara të këtij vendi të përmallshëm. Dhe po mendoja. Unë, një femër "kaurkë", të turpëroj Padishanë e madh me një nga nënshtetasit e tij myslimanë. Ironia e gjërave rrallë mund të shkonte më gjatë. Besimi i tyre këmbëngulës në fuqitë e mia do të më kishte shtytur të besoja që unë isha Perandoria Britanike sikur të mos ishte dhëmbja djegëse dhe bluajtëse e kofshës që të më kujtonte se unë isha vetëm unë, e pafuqishme për të duruar peshën e "barrës së njeriut të bardhë"<sup>1</sup>, që kudo populli

---

<sup>1</sup>Shënim: Barra e Njeriut të Bardhë: Shtetet e Bashkuara dhe Ishujt Filipine" (1899), nga Rudyard Kipling, është një poezi rreth Luftës Filipino - Amerikane (1899-1902), e cila nxiti Shtetet e Bashkuara të marrin kontrollin kolonial të ishujve filipinas. Fillimisht e shkruar për të festuar Jubileun e diamantë të Mbretëreshës Victoria (22 qershor 1897, 60-vjetori i kurorëzimit të saj), poema jingoiste u zëvendësua me një poemë më të zhurmshe "Recessional" (1897), gjithashtu një poezi Kipling për perandorinë. Në poemën "Barra e Njeriut të Bardhë", Kipling inkurajoi kolonizimin amerikan dhe aneksimin e Ishujve Filipine, të pushtuar në Luftën tre-mujore Spanjollo-Amerikane (1898). Si një poet i imperializmit, Kipling inkurajon lexuesin dhe dëgjuesin amerikan të marrë ndërmarrjen e perandorisë, megjithatë paralajmëron për kostot personale me të cilat përballen, durojnë dhe paguhen për ndërtimin e një perandorie; barra e njeriut të bardhë "për të justifikuar pushtimin perandorak si një mision të civilizimit që lidhet ideologjikisht me filozofinë e zgjerimit kontinental të fatit të dukshëm të fillimit të shekullit të 19-të. Durham dukshëm e influencuar nga kjo poemë e përmend si referencë duke pasur parasysh misionin qytetërues që duhet të mbante Perandoria Britanike në lidhje me kombet dhe popujt e tjerë. Ky koncept është kritikuar nga studiuesi i njohur Edward Said në veprën e vet "Orientalism" (1978).

përpiqej të më ngarkonte. Dhe kjo ngjante në vendin e lindjes së Ali Pashës, të Aliut Kryezotit të Shqipërisë së Jugut, Luani i Janinës, madhështor, ngadhënjimtar, i egër, gjakatar; Aliu i pamposhturi, sundimi i të cilit arriti deri në Ohër dhe që u shfuqizua dhe u ther vetëm atëherë kur arriti moshën tetëdhjetëvjeçare. Ku je tani, o Ali Pasha? Populli po kërkon ndihmë nga një farë kaurkë!

Më andej, udhëtarja Edith Durham në veprën e vet “Bregna e Ballkanit” (1914) përshkruan një detaj interesant nga vizita e saj në Tepelenë në 1904. Ajo takon aty kajmekamin dhe zëvendësin e tij të prej këtij të parit, na jep informacionin që dëshmon vendin në të cilin ulej Ali pashë Tepelena për të soditur perëndimin e diellit dhe pronat e tij matanë lumit. Tepelena është një vend i çuditshëm, zemra e egër e një vendi të egër...E rrethuar me mure dhe pajada e vendosur në një shesh të lartë, rreth së cilës qëndrojnë male me dëborë. Pak më sipër qytetit vërshon në Vjosë lumi i rrëmbyeshëm i Drinos, i cili përhapet midis brigjesh zallishtore. Pezule të pjerrëta të shkretuara prej tij. Sheshi përfundon në një majë shkëmbi të gërmuar në formë shtrese e cila komandon një pamje të gjerë. Në këtë vend rrinte Aliu dhe shikonte pronat e tij, kurse mbi një shkëmb tjetër rrinte Arapi i tij besnik, i cili ruante se mos i bëhej ndonjë mësymje e befasishme nga prapa nga ndonjë armik<sup>1</sup>. Kurrkush nuk guxonte të mësynte drejt për drejt, sepse sytë e tij shkëlqenin si zjarri dhe ngallte tmerr në të gjithë ata që e shikonin. Pikërisht te ky shkëmb ka një foto të kajmekamit dhe komisarit të policisë që sot ndodhet në koleksionin e Edith Durham në Muzeun

---

<sup>1</sup>Shënim: Bëhet fjalë për Jusuf Arapin, lalën e Ali pashë Tepelenës, vëllait të tij me një nënë tjetër etiopiane që ishte në të njëjtën kohë dhe njeriu më besnik i Vezirit. Dr Henri Holland në librin e vet *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, &c., during the years 1812 and 1813* botuar në 1813 thotë se Jusuf Arapi mund të ishte 90 vjeç.

Britanik.<sup>1</sup> Foto nuk është shkrepur nga Edith Durham, por është pjesë e disa fotove që i dhuroi kajmekami. Këtë e dëshmon ajo vetë kur shkruan se Kajmekami dhe komisari i policisë ishin, besoj, shumë të kënaqur që të shihnin një njeri cilido nga bota e jashtme, prandaj më pritën me përzemërsi. Unë isha e vetmja europiankë që isha parë prej shumë vitesh në këto vise. Ai caktoi orën shtatë të mëngjesit si më të përshtatshmen për të më pritur në konak. Më pyeti nëse dëshiroja që të pritesha në mënyrë zyrtare apo miqësore dhe unë iu përgjigja si të dëshironte ai. Ata deshën në mënyrë miqësore. Dhoma e Kajmekamit ishte e parfumuar rëndë me myshk dhe tërësisht e mbuluar me qilima qumësht të bardhë të thurura në afërsitë e qytetit dhe me mindere të mëdhenj të butë, ku mund të rrija në rehati të madhe dhe muret e ngarkuara me fotografi sepse Kajmekami ishte një fotograf i pasionuar... Ai më tregoi të gjithë filmat e fotografive dhe m'u lut që të merrja prej tyre ato që do të më pëlqenin, sepse nuk duhej të largohesha nga Tepelena pa një koleksion të mirë, megjithëse i mungonin kopje të shtypura. Pranova katër copë të cilat mund t'i marr në shalë të kalit dhe t'i sos të pathyera deri në Angli (*Durham, 2009*). Sheshi për të cilin bëhet fjalë që është i gërryer dhe përfundon me një shkëmb është sheshi i sotëm i ish-agjencisë, para monumentit të Ali pashës në Tepelenë, i njohur me emërtimin buzat nga vendësit. Për këtë shesh dhe shkëmb na jep informacion dhe Mithat Frashëri në faqet e Revistës *Dituria* kur boton kujtimet e veta rreth udhëtimit të tij në Janinë në janar-mars 1913. Ja muret e kalasë madhështore dhe rrënojat e pallatit të Ali pashë Tepelenës shkruan Mithat Frashëri që u dogj kur ishte gjallë Aliu. Pranë pallatit-zyrat e qeverisë shqiptare ku valon një flamur i kuq me shkabën dykrenore në mes. Jashtë murit të fortesës, nga an' e Gjrokastrës

---

<sup>1</sup>Shënim: Kjo foto u paraqit për herë të parë në Shqipëri nga Robert Elsie më 17 maj 2016, në sallën Unesco të Muzeut Historik Kombëtar, kur paraqiti koleksionin prej 450 fotosh të Edith Durham që gjendet në Muzeun Britanik.

më rrëfejnë një gur të rrafshuar në formën e një froni. Gojëdhëna thotë se mbi këtë gur rrinte Ali Pasha kur vinte në Tepelenë. Atje shkonte ca minuta të orës afër perëndimit (Butka, 2006)

### Rekomandim

Sot ky shkëmb i gdhendur në formë froni, nuk ekziston. Në zgjerimet që iu bënë sheshit në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar, në momentin kur u ndërtua dhe rruga që shkonte poshtë kalasë, ka të ngjarë që të jetë zhvendosur pa e ditur se po hiqnin gjurmët e një trashëgimie të rëndësishme të Ali Pashës në vendlindjen e tij. Riemërimi dhe shpallja si monument natyror i vendit ku sipas fotografisë që gjendet në Arkivin e Muzeut Britanik, shkrimit të Edith Durham dhe Mit'hat Frashërit për shkëmbin fron do të ridimensionojë më mirë panoramën e trashëgimisë kulturore të Ali pashë Tepelenës në vendlindjen e tij.

### Literatura

- Arkivi i Muzeut Historik Kombëtar.  
 Butka, U., (2006), *Gjeniu i Kombit*, Drier, Tiranë, f. 65-66  
 Durham, E., (2009), *Brenga e Ballkanit*, Argeta-LMG, Tiranë.  
 Edëard Lear në Shqipëri. Plejad, Tiranë, 2009.  
 Fleming, E. K., (2000). *Orientalism, the Balkans, and Balkan Historiography*.  
 The American Frashëri, M., Përshtypje udhëtimi, 1912-1913.  
 Historical Review, Vol.105. No.4  
 Holland, H., (2008), *Mjek tek Ali Pasha*, Migjeni, Tiranë.,  
 Jelavich. B., (1955) *The British Traveller in the Balkans: The Abuses of Ottoman Administration in the Slavonic Provinces*. The Slavonic and East European Review. Vol.33, No.81  
 Letra e Bajronit dërguar së ëmës, zonjës Katerina Gordon Bajron. Zonjës Katerina Gordon Bajron Prevezë, 12 nëntor 1809. Përkthyer nga Skënder Luarasi. Citohet sipas librit të profesor Afrim Karagjozit "Miti shqiptar për Bajronin".  
 Said, E., (1995). *Orientalism*, Penguin.

**Prof. asoc. dr. Rudina Mita<sup>1</sup>**

## **ORGANIZIMI ADMINISTRATIV NË PREFEKTURËN E ELBASANIT NË VITET 1925-1939 DHE NDIKIMI I SAJ NË ZHVILLIMIN E QENDRAVE TË BANUARA**

### **Abstrakt**

Reformat administrative të viteve 1925-1939 evidentuan përpjekjet e Ahmet Zogut në drejtim të centralizimit të vendit, nëpërmjet ndryshimeve në administratë. Riorganizimi i administratës synonte futjen e frymës perëndimore në funksionim të administratës lokale dhe qendrore, si dhe vënien e tyre nën kontrollin sistematik të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Hierarkia shtetërore e krijuar për organet dhe funksionarët shtetërorë si pjesë e tyre; e ligjeve e qarkoreve të nxjerra nga qeveria shqiptare; padyshim që drejtohej nga Ahmet Zogu dhe prej hallkave të mekanizmit ligjvënës shtetëror të caktuara prej tij. Pavarësisht se legjislacioni ishte i vendeve të përparuara të kohës, ai u adaptua prej A. Zogut me qëllim jo thellimin e demokracisë, por forcimin dhe konsolidimin e pushtetit të tij. Nën këtë pasqyrë të përgjithshme të situatës, qëllimeve dhe rezultateve të këtij procesi, punimi synon të paraqesë sadopak elemente të reja dhe të hollësishme në lidhje me organizimin administrativ-territorial në Shqipëri gjatë viteve 1925-1939, si dhe më konkretisht të japë detaje lidhur me ndryshimet e kryera nën efektin e kësaj reforme në prefekturën e Elbasanit. Mbështetur në dokumentet arkivore, fletoret zyrtare, shtypin e kohës si dhe literaturën historiografike, janë paraqitur të dhëna me interes, lidhur me njësitë territoriale, numrin e shtëpive, numrin e banorëve dhe problematikat e shfaqura në prefekturë e nënprefekturat e saj, krahinaritë, komunat, katundet,

---

<sup>1</sup>*Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". E-mail: rudinamita@hotmail.com*

qytetet, lagjet e Elbasanit, pasqyrë e implementimeve që solli gjatë këtyre viteve zbatimi i reformave administrative. Reforma nga pikëpamja teorike dhe ligjore ishte e plotë, por mënyra se si u implementua në vend ishte mjaft e vështirë, për shumë faktorë që vështirësuan zbatimin e saj. Nga ana tjetër, në punim kërkohet të pasqyrohet dhe ndikimi që solli zbatimi i reformës administrative-territoriale në vend dhe në prefekturën e Elbasanit. Metodologjia e përdorur është ajo e kërkim-hulumtimit, analitike dhe narrative.

***Fjalë çelës:** Ligji i Bashkive, reforma administrative-territoriale, komuna, prefektura, nënprefektura, administratë.*

### **Abstract**

The administrative reforms of 1925-1939 highlighted the efforts of Ahmet Zogu, towards the centralization of the country, through changes in the administration. The reorganization of the administration aimed at introducing the western spirit in the form and functioning of the local and central administration, as well as putting them under the systematic control of the Ministry of Internal Affairs. State hierarchy created for state bodies and officials as part of them; of the Laws and Circulars issued by the Albanian government; it was obviously headed by Ahmet Zogu and by the links of the state legislative mechanism appointed by him. Despite the fact that the legislation belonged to the advanced countries of the time, it was adapted by A. Zogu, in order not to deepen democracy, but to strengthen and consolidate the power of the unit. Under this general overview of the situation, goals and results of this process, the paper aims to present some new and detailed elements related to the administrative-territorial organization in Albania during the years 1925-1939, as well as to provide more details regarding changes made under the effect of this reform in the Prefecture of Elbasan. Based on archival documents, official notebooks, the press of the time and historiographical literature, data of interest were presented, related to territorial units, number of houses, number of inhabitants and problems expressed in the prefecture and its sub-prefectures, provinces, communes, villages, cities, neighborhoods of Elbasan, an overview of the implementations brought during these years by the implementation of administrative reforms. The reform from the theoretical and legal point of view was complete, but the way it was implemented in the country was quite difficult, for many factors or actors, who were in charge of its implementation. On the other hand, the paper seeks to reflect the impact brought by the implementation of administrative-territorial reform in the country and in the

Prefecture of Elbasan. The methodology used is that of research-research, analytical and narrative.

**Keywords:** *Law of Municipalities, administrative-territorial reform, communes, prefectures, sub-prefectures, administration.*

## I. Hyrje

Shqipëria nga viti 1923 deri në vitin 1925 kur nisi periudha e parë e qeverisjes së Republikës Shqiptare ndahej në 9 prefektura, 31 nënprefektura, 80 krahina, 2538 katunde. Prefektura e Elbasanit ishte një ndër prefekturat në vend që nga pikëpamja fiziko-geografike pozicionohej si territor në Shqipërinë e Mesme, gjë që përcaktonte dhe rëndësinë strategjike të kësaj treve në shumë aspekte. Nga pikëpamja administrative prefektura shtrihej në një sipërfaqe prej 2954.90 km<sup>2</sup> dhe në përbërje kishte: 3 nënprefektura: *Elbasani (Rrethi i Qendrës)* bashkë me 3 krahinat përbëhej nga 169 katunde, 7770 shtëpi me një popullsi 49 843. Popullsia myslimane përllogaritej në 44 056 banorë, dhe popullsia ortodokse 5787 banorë; *Gramshi* përbëhej nga 2 krahina, 69 katunde, 2626 shtëpi. Popullsia e kësaj nënprefekturë përllogaritej në 11230 banorë të ndarë në dy besime: myslimanë 10834 banorë dhe ortodoksë 396 banorë; *Librazhdi* përbëhej nga 1 krahinë, 35 katunde, 2234 shtëpi. Në këtë nënprefekturë mbizotëronte vetëm popullsi e besimit mysliman, pra gjithsej 13697 banorë; *Peqini* përbëhej nga 1 krahinë, 65 katunde, 2026 shtëpi. Popullsia përbëhej prej 8857 banorësh të besimit mysliman, gjithsej në shkallë prefekturë ishin 7 krahina, 338 katunde, 14586 shtëpi dhe 83.627 banorë. Sipas përkatësisë fetare popullsia ndahej në: myslimanë 77 444 banorë dhe 6183 ortodoksë, gjithsej 83.627 banorë me dendësi 28 banorë për km<sup>2</sup>. Autoriteti më i lartë në prefektura ishte i prefektit dhe në nënprefektura i nënprefektit.

## II. Metoda

Metodologjia e përdorur është hulumtuese dhe kërkimore-shkencore. Për disa çështje apo aspekte të trajtuara në këtë punim është përdorur dhe metodologjia krahasuese lidhur me ndryshimet administrative që kanë ndodhur në periudha të caktuara gjatë viteve 1925-1939, në shkallë vendi dhe më konkretisht në prefekturën e Elbasanit. Metodologjia e përdorur për disa aspekte të reformave administrative është dhe narrative, përshkruese apo pasqyruese.

## III. Gjetje dhe diskutime

Gjetjet në temën e trajtuar janë të dhënat e detajuara në lidhje me katundet, krahinaritë, komunat, nënprefekturat pjesë përbërëse të prefekturës së Elbasanit; ndryshimet në lidhje me emërtimet; kategorizimi i bashkive sipas klasit, ndryshimet e organizimeve dhe riorganizimeve administrative. Krijimi apo rikrijimi i njësisë përbërëse në komuna, katundari, krahinari, krijimi i qendrave të tyre etj. Në lidhje me diskutimet duhet theksuar se gjatë punës kërkimore shkencore në lidhje me hartimin e këtij punimi, hasa në dokumente të shumta arkivore dhe në burime informimi të shumta shtetërore si rasti i *Fletoreve Zyrtare*, prandaj gjykoj se kjo tematikë duhet të zgjerohet pasi paraqet mjaft interes për studiuesit, historianët e gjeografët për ndërmarrjen e një projekti dhe hartimin e një punimi enciklopedik në shkallë shtetërore, pra për të gjithë territorin shqiptar.

### 1. Organizimi administrativ i prefekturës së Elbasanit në vitet 1925-1928

Prefektura e Elbasanit përbëhej nga dy qytete: Elbasani me 13 lagje, 2041 shtëpi, 8475 banorë myslimanë, 1924 banorë ortodoksë pra gjithsej 10.408 banorë si dhe Peqini me 390 shtëpi e 1905 banorë të besimit mysliman. Problemet e organizimit administrativ të



prefekturës së Elbasanit ishin të shumta dhe në këtë proces u shfaqën të meta e vështirësi. Përveç të dhënave mjaft të rëndësishme të Teki Selenicës në botimet: “Shqipëria më 1923” dhe “Shqipëria më 1927”, ajo që vërehet është fakti se në aspektin e verifikimeve të të dhënave në organizimin administrativ u kryen dhe shtesa apo plotësime. Synimi i verifikimit dhe plotësimi i të dhënave u krye për të saktësuar plotësisht përbërjen në detaje të çdo elementi të organizimit administrativ të kësaj prefekturë. Gjatë hulumtimeve në AQSH më ra në dorë një dokument, i cili evidentonte një përpjekje të tillë realizuar në vitin 1926 dhe që vazhdoi deri në vitin 1927. Në të paraqitej lista (AQSH., F. 271, D. 12, 1927: 6-7) që përmbante shpjegimet e duhura mbi disa katunde të rrethit Elbasan, bashkangjitur listës së Ministrisë nga prefektura e Elbasanit më datë 03.09.1927. Gabimet e evidentuara pas verifikimit nuk ishin të pakta.

## 2. Bashkia e Elbasanit gjatë viteve 1925-1928

Gjatë viteve `20 të shek. XX në vend ekzistonin bashkitë si organe të pushtetit lokal e vendor. Krahas bashkisë u krijuan edhe Këshillat Bashkiakë në përbërje të të cilëve sipas organikës ishin 4-12 anëtarë të përzgjedhur nga popullsia lokale me mandat ushtrimi aktiviteti e veprimi për një periudhë trevjeçare sipas kriterëve të përcaktuara në ligj. Deri në vitin 1925 nuk pati ndryshime ligjore në lidhje me bashkitë. Në vitin 1926 u krye procesi i Klasifikimit të Bashkive (*Fletorja Zyrtare*, 8 qershor 1926), të cilat ndaheshin në tri kategori sipas klasit ku Elbasani bënte pjesë në klasin II ndërsa në klasin III: Gramshi, Peqini (*Gazeta Zyrtare*, 8 qershor 1926). Gjatë vitit 1927 u propozua dhe projektligji, i cili plotësonte Art. 7 të ligjit të Bashkive mbi vendosjen e taksave, të ardhurave dhe nevojave që ato kishin, si dhe disa rregullime mbi klasifikimin e disa bashkive. Diskutimet dhe debatet zunë vend dhe në parlament edhe mes deputetëve duke iu mëshuar faktit se

në klasifikim nuk ishin marrë aspak në konsideratë mendimet dhe nevojat e tyre. Nga shpërfillja, pasojat që u krijuan shkaktuan pakënaqësi. Diferenca mes bashkive të klasit I dhe II ishte 50.000 franga ari. Duke marrë në konsideratë gjendjen e vështirë ekzistuese të pjesës më të madhe të bashkive në vend, si dhe nevojave që ato paraqitnin për të kapërcyer ato dhe për të bërë hapa zhvillimi më tej, mbi bazën e buxhetit të akorduar sipas klasit pjesë e të cilit ishin, bëhej e pamundur. Elbasani, Berati e Gjirokastra ishin tri qytete që paraqitnin nevoja të mëdha për përmirësim, ndërtim e zhvillim. Plotësimi i propozimit mori formë të plotë në Art.1, sipas të cilit bashkitë e qyteteve Elbasan, Berat e Gjirokastër të klasifikuar në nenin 7, në klasin e dytë, të klasifikoheshin tashmë në klasin e parë. Fondet e akorduara do ishin më të mëdha, dhe nëse përdoreshin me efikasitet mund të përmirësonin situatën në bashkinë e Elbasanit, ku dhe nevojat ishin të shumta. Duhet theksuar se mbështetje të madhe Elbasanit i dha dhe vullneti politik dhe angazhimi dëshirëplotë i përfaqësuesve të kësaj treve në parlament. Angazhim, i cili mund të konsiderohet të ishte i duhuri në këto momente.

### **3. Shqipëria ndahet në katër departamente**

Në vitin 1926 me anën e një shkrese të MPB-së u krye organizimi i ri i xhandarmërisë, që përfshinte njësi administrative. Organizimi iu komunikua të gjithë prefekturave nëpërmjet një qarkoreje me anë të së cilës informohej se Shqipëria ndahet në këta departamente: Departamenti i Veriut me qendër Shkodrën, Departamenti i Lindjes me qendër Peshkopinë, Departamenti i Qendrës me qendër Tiranën, Departamenti i Jugut me qendër Sarandën (*Fletorja Zyrtare, 15 qershor 1926*). Në Departamentin e Qendrës përfshihej dhe: Prefektura e Elbasanit, nënprefekturat e Peqinit e Gramshit. Prefektura e Elbasanit, nënprefekturat dhe krahinat e saj mbi bazën e ndarjes administrative përfshiheshin në

Aneksin B. Nëpërmjet një qarkoreje të MPB-së për prefekturat në vend, qartësoheshin ndryshimet dhe lidhjet e varësisë që kishin mes tyre prefekturat apo nënprefekturat. Nënprefekturat nuk varehin prej prefekturave, por të dyja hynin në marrëdhënie varësie me MPB-në. Krahinat, nga ana e tyre, varehin prej prefekturave e nënprefekturave në të cilat bënin pjesë. MPB-ja e vinte theksin në tregimin e kujdesit të duhur e vullnetit të mirë në zbatim të udhëzimeve apo urdhrave që transmetoheshin përmes qarkoreve për zbatim (*Fletorja Zyrtare, 15 qershor 1926*). Në qarkore, Ministria theksonte dhe të drejtat dhe detyrat e prefektëve si dhe kufizimet e pushtetit të tyre e mosndërhyrjet në funksionet e nënprefektëve (Ibid). Sipas qarkores, në qendrën e çdo departamenti vendosej një inspektor me detyrë vendosjen e kontrollit në të gjitha zyrat e Republikës dhe qëllimi i tij ishte jo vetëm vëzhgimi dhe kontrolli për zbatimin me rigorozitet të vendimeve qeveritare në zonën ku vepronte, por ai duhet të ishte syri dhe veshi i qeverisë në to. Një funksion i tillë sipas ministrisë mund dhe duhet të zhdukte burokratizmin në zyrat qeveritare si dhe në ato të pushtetit vendor (Ibid). Reformimi i organizimit administrativ në vend synonte centralizimin e pushtetit dhe në këtë drejtim u hasën vështirësi të dukshme e të prekshme në drejtim të praktikitetit të zbatimit, që krijuan probleme të shumta. Probleme paraqiste prefektura e Elbasanit lidhur me disa ndryshime që përfshinin fshatrat kufitare midis kësaj prefekturë dhe nënprefekturës së Lushnjës. Prefektura shqetësimin ia paraqiti më 4 janar 1927 MPB-së për shqyrtim, mbështetur në vendimin e Këshillit Administrativ të Elbasanit. Vendimi kërkonte shkëputjen e pesë fshatrave; Rrasë, Çirragë, Dragot, Kajan dhe Haxhi Aliani nga nënprefektura e Lushnjës dhe kalimin e tyre në prefekturën e Elbasanit. Katundi Çirragë përmblihte dhe lagjen *Biçakaj* dhe Dragoti lagjen *Trubull* (*AQSH., F. 271, D. 51, 1926:3*). Në lidhje me katundin Biçakaj me vendimin e Këshillit Administrativ të

Prefekturës së Elbasanit u vendos që katundi, i cili ishte i lidhur me katundin Çirragë duhej të shkëputej jo vetëm nga pikëpamja territoriale me nënprefekturën e Lushnjës, por edhe nga ana financiare duke iu aneksuar qarkut të Elbasanit (AQSH., F. 271, D. 51, 1926:3). Vendimi i Këshillit Administrativ të Elbasanit dhe i Ministrisë ishte që 5 katundet i shkëputeshin nënprefekturës së Lushnjës dhe kalonin nën juridiksionin e prefekturës së Elbasanit (AQSH., F. 271, D. 147, 1927:4). Në vitin 1927 u pa e domosdoshme ndërmarrja e ndryshimeve të reja në organizimin administrativ për të vënë sërish në veprim formën e vjetër të administratës (Gazeta “Telegraf, 31 mars 1927). Sipas ndryshimit të ri, prefekturat ndaheshin në dy klasë. Elbasani ishte prefekturë e klasit II dhe kishte në përbërje të saj nënprefekturat: Peqin e Gramshi, 5 krahina, 312 katunde, 14 825 shtëpi, 81.228 banorë dhe një sipërfaqe 2954.90 km<sup>2</sup> (*Selenica, 1928*): XXXV). Gjatë vitit 1927 e në vazhdim në rrethin e Qendrës Elbasan dhe në dy nënprefekturat ekzistonte: një zyrë bashkiake dhe një këshill me mandat 4-vjeçar (*Selenica, 1928*:250). Në mars të vitit 1927 u ndien dhe lëvizjet e para në drejtim të ndryshimeve në organizimin administrative të kësaj prefekturë. Bazuar në një vendim të Këshillit Administrativ të prefekturës së Elbasanit mbështetur në urdhrin e MPB-së, rreth 40 shtëpi të lagjeve *Pervin Aga* dhe *Qejvan Bej* u shkëputën prej tyre dhe iu bashkëngjiten lagjes *Shinkoll* të qytetit (AQSH., F. 271, D.12, 1927: 16). Vendimi i Këshillit Administrativ i datës 23.04.1928 vendosi aneksimin e katundit Seltë të krahinës Shpat I në komunën e Qendrës Gjinar, pasi gabimisht ishte lënë jashtë kësaj komune (AQSH., F. 271, D. 12, 1928: 23).

#### **4. Ndarja e re administrative e Republikës shqiptare, ligji i 23 majit 1928**

Qeveria shqiptare më 23 maj 1928 miratoi *ligjin* për ndarjen e re administrative të vendit në 10 prefektura, 29 nënprefektura, 63

krahina (komuna) me tre klasë dhe në 2361 katunde. Në përbërje të prefekturave kishte dy a më shumë nënprefektura, të cilat përfshinin disa krahinari apo komuna. Prefektët ishin përfaqësuesit e pushtetit përmbarues në qarqe dhe drejtues të administratës civile. Në prefektura ekzistonin *Këshillat Administrativë*, në përbërje të të cilëve ishin prefektët, nënprefektët, kryesekretari i prefekturës, drejtori i financave, nëpunësi i Botores, Arsimit e Bujqësisë dhe 4 përfaqësues të zgjedhur nga populli si anëtarë të këshillit. Pjesë e organizimit ishin dhe *Këshillat e Krahinave e të Katundeve* që zgjidheshin me votim të fshehtë nga *Këshilli i Pleqësisë* të katundeve të krahinës dhe përbëheshin nga 4 individë, që pas zgjedhjes emëroheshin nga prefekti me dekret të posaçëm. Çdo katund kishte një Këshill të Pleqësisë, përbërë nga *Kryeplaku* dhe 4 a më shumë anëtarë që zgjidheshin çdo vit në fillim të tij me votim të fshehtë ose të hapur (*Selenica, 1928*): XXXVII). Në ligjin e 23 majit 1928, prefektura e Elbasanit ishte e klasit të parë, ndërsa nënprefekturat Gramsh, Librazhdit e Peqinit të klasit të dytë.

## 5. Organizimi administrativ në vitet e Monarkisë Shqiptare 1928-1939

Ndryshimi i formës së regjimit në vend nga Republikë në Monarki dhe hartimi i Statusit të Monarkisë Shqiptare në 1 dhjetor 1928, kushtëzuan si domosdoshmëri ndërmarrjen e një reforme të re administrative, sipas së cilës Shqipëria ndahej në 9 prefektura dhe 39 nënprefektura. Statusi i Monarkisë përcaktonte dhe të drejtat, detyrat dhe varësitë institucionale të njëjësive përbërëse të kësaj ndarjeje, për të cilën nisën të bashkërendoheshin veprimet midis prefekturave, nënprefekturave dhe këshillave administrativë mbi raportimin mbi distancat e afërta dhe të largëta të katundeve përbërëse të krahinarive. Pjesa më e madhe e këshillave vendosën që katundet me distancë të largëta të mos ishin pjesë e krahinarive

ekzistuese, por të krijonin njësi më vete sipas distancës me qendrën e këtyre krahinarive. Në komunën e Rrethit të Qendrës së Peqinit ishin përfshirë katunde, të cilat kishin një distancë më shumë se 3 orë nga qendra rreth 20 katunde dhe 39 që ishin jo më shumë se 3 orë larg. 26 katunde formuan *krahinarinë e Shpatit*. 27 katunde kishin distancë më pak se 3 orë nga *krahinaria e Qendrës së prefekturës së Elbasanit*, 12 katunde formuan *krahinarinë e Zaranikës* me qendër në Brenesh, *krahinaria e Qendrës së NP Gramsh* me 11 katunde, *krahinaria e Kukurit* 21 katunde, *krahinaria Dragot* 21 katunde, *krahinaria e Darsisë* 20 katunde etj. Në këto kushte, kërkohet nga ana e këshillit si dhe nga lutjet e banorëve që katundet me distancë të largët duhet të formojnë krahinë më vete. Më 1 prill 1929 hyri në fuqi Kodi i ri Civil, i cili paraqiste një adaptim të legjislacionit modern të shteteve të zhvilluara me gjendjen në të cilën ndodhej vendi ynë. Mbi bazën e këtij adaptimi, në vend të krahinarive, si pjesë më e vogël e njësive administrative u krijuan *njësi administrative komunale*, numri i të cilëve ishte 192. Krijimi i komunave në Mbretërinë Shqiptare, ashtu siç shprehej dhe shtypi që trumbetonte propagandën e kohës, u pa si një reformë me rëndësi për faktin se katundari tashmë do të ishte i kushtëzuar të punonte për rimëkëmbjen e një jete urbane të vendit, të kryente punë fakultative për zhvillimin e vendit ku ai banonte. Sipas ndarjes së re administrative, prefektura e Elbasanit përbëhej nga 2 nënprefektura, 18 komuna dhe 308 katunde (AQSH., F. 271, D. 20, 1929:31). Kodi Civil i përcaktonte qartë detyrat e komunave. Një nga detyrat e komunave, e detyruar për zbatim, ishte dhe realizimi i martesave mbi bazën e ceremonisë së celebrimit. Komuna e Kushovës, si komunë e nënprefekturës së Gramshit, në këtë periudhë drejtohej nga komunari i saj Mysret Struga. Veprimtarinë e parë e nisi më 7 maj 1929 me aktin e shpalljes së një martese. Mbas dhjetë ditësh, më 17 maj, çifti i ri bëri prezantimin përpara kryetarit të komunës duke realizuar celebrimin (“Gazeta e

*Re*", Tiranë, 19 maj 1929). Pjesë e personelit të komunave ishte dhe inspektori i komunave. Për Elbasanin në një post të tillë ishte Ilija Qirko, që filloi nga detyra në vitin 1929 (*"Gazeta e Re"*, Tiranë, 26 maj 1929). Në qershor të vitit 1929 kishte shumë ankesa dhe lutje drejtuar prefekturës së Elbasanit nga disa katunde mbi mënyrën e grupimit të katundeve, që sipas tyre nuk ishte realizuar drejt. Ankesat konsistonin në faktin se katundet ishin shumë të shpërndara dhe katundaritë shumë të kufizuara. Nisur nga ky qëllim kërkohesh ndryshim i qendrave të katundarive në mënyrë që të përshtatej shtrirja e katundeve me qendrën drejtuese të tyre. Prefektura e Elbasanit për të qetësuar banorët e katundeve shprehej se do të merrte në konsideratë ankimet e tyre që mbështeteshin në baza vërtetësie (*Gazeta "Shekulli i Ri"*, Durrës, 6 qershor 1929). Këshilli Administrativ i prefekturës pasi shqyrtoi në mënyrë serioze dhe me kompetencë profesionale listat e paraqitura mbi formimin e komunave të rrethit të Elbasanit vendosi që komuna e Qukësit të mos ndahej në dy komuna. Pavarësisht se kërkesat e kryera dhe të adresuara prefekturës ishin për ndarje, Këshilli Administrativ nuk e aprovoi një kërkesë të tillë (*AQSH., F. 271, D. 223, 1929: 2*). Këshilli vendosi që komunës së Martaneshit t'i bashkoheshin dy katunde, Prevall e Lunik, që ishin më afër me qendrën e komunës Zdrashë sesa me Martaneshin. Ishte domosdoshmëri të formohej një komunë në Martanesh me qendër në Martanesh, pasi numëronte në atë kohë një popullsi prej 2000 banorësh dhe për të rritur numrin e banorëve u bë dhe përfshirja në këtë komunë e dy katundeve. Këshilli vendosi që edhe komuna e Librazhdit të mos ndahej në dy komuna, pasi të gjitha katundet që e formonin këtë komunë ndodheshin pranë qendrës. Katundi Labinot i Poshtëm u vendos të lidhej me qendrën e komunës së Zaranikës (*AQSH., F. 271, D. 223, 1929:2*). Pavarësisht nga ankesat dhe sugjerimet e kryera nga katundet apo nga komunat, Këshilli Administrativ në prefekturën e Elbasanit nuk mori asnjë vendim

që të çonte në formimin e ndonjë komune të re apo edhe suprimimin e ndonjë komune ekzistuese. Ndër ndryshimet e kryera ishte vetëm lidhja e katundit Grigjan i komunës së Zaranikës me qendrën. Katundi Xibrakë shkëputej nga komuna Zaranikë dhe i bashkohej komunës Librazhd (AQSH., F. 271, D. 223, 1929:3). Gjatë vitit 1930 Këshilli Administrativ i prefekturës aprovoi dhe vendimin e marrë nga katundaria e Shpatit II mbi lidhjen e katundit Gjyral të katundarisë së Dumresë me katundarinë në fjalë, si dhe shkëputjen e katundeve Trepsenisht, Tudan të varur prej saj me katundarinë e Qendrës (Elbasan) (AQSH., F. 271, D. 227, 1929:3). Rrethi i Qendrës Elbasan përfshinte në vetvete 10 komuna në krye të drejtuara nga kryepletë, të cilët merrnin pjesë në zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Administrativ të prefekturës së Elbasanit (AQSH., F. 271, D.274, 1932:1). Në dhjetor të vitit 1930 Inspektoria e Komunave i drejtohej prefekturës së Elbasanit mbi disa sugjerime që kjo e fundit kishte bërë mbi mundësitë e disa ndryshimeve mbi ndarjen në komuna dhe katundet që mund të përfshiheshin në të, mbështetur në kritere dhe argumente si largësia apo afria, dhe shkrirja e komunave që gjykohej se mund të përfaqësonin një njësi të vetme komune. Kërkesa për bashkimin e komunës së Qendrës së Çermenikës I me Çermenikën II u aprovua nga Inspektoria, duke sugjeruar që komuna të marrë emrin Çermenikë me katundin Orenj. Gjithashtu u sugjerua nga Inspektoria që komuna e Shpatit I të bashkohej me atë të Shpatit II me emrin komuna e Shpatit dhe qendër të ishte katundi Gjinar. Në nënprefekturën e Peqinit, Inspektoria vendosi që të mos suprimohen komunat e Qendrës (AQSH., F. 271, D. 24, 1930: 8). Në këtë nënprefekturë, sipas udhëzimeve, mund të bashkohej vetëm komuna e Mlikës me atë të Vrapit duke u emërtuar komuna e Vrapit me qendër katundin Rrostenj. Në nënprefekturën e Gramshit nuk parashikoheshin ndryshime, pasi komunat kishin në varësi rajone të gjera në hapësira dhe mundësia



e shkrirjes së dy komunave në një ishte e pamundur. Në lidhje me vështirësitë ekonomike që paraqiteshin në komunën e Qendrës, për përballim të shpenzimeve duhej suprimuar sekretaria dhe komuna të mbetej dhe të luante rolin e bashkisë nën drejtimin e kryetarit të komunës. Në lidhje me shkëputjen e disa katundeve të rajonit të komunave dhe bashkimit të tyre me një komunë tjetër, udhëzohej nga ana e Inspektorisë të respektoheshin dhe të merreshin në konsideratë vendimet e komunave përkatëse. Duheshin parë mundësitë që bashkimi apo ndarja e tyre të kryhej mbështetur në nevojat e secilës komunë. Vendim tjetër ishte dhe ai i datës 30.12.1929 mbi pagëzimin e Çermenikës I me emrin Martanesh, si dhe vendimi i datës 11.2.1930 mbi bashkimin e katundarive Vrap e Mlik të nënprefekturës së Peqinit. Nënprefektura e Gramshit i kërkoi prefekturës së Elbasanit që qendra e komunës Dragot të transferohej në katundin Mollas, shkak paraqitej largësia që kishin katundet e saj nga qendra e mëparshme. Nënprefektura sqaronte se katundi Zgjubë mbështetej prej komunës së Qendrës dhe katundi Sultë prej komunës së Kushovës. Kjo e fundit të transferonte qendrën në katundin Tunjë (AQSH., F. 271, D. 24, 1930: 21). Kërkesa të tjera të kësaj nënprefekturë ishin: bashkimi i katundeve Shëmbërdhej i Poshtëm dhe Shëmbërdhej i Sipërm, si dhe katundi i Nartës me komunën e Qendrës, për shkak të largësisë më të afërt me të. Prefektura e Elbasanit mbështetur në udhëzimet e Inspektorisë dhe propozimet e nënprefekturave, vendimin e saj ia përcolli MPB-së në të cilën pasqyrohej dhe skepticizmi në lidhje me bashkimin e komunave të Çermenikës I me atë të Çermenikës II me emrin Çermenikë dhe qendër katundin Orej. Qëndrimi i saj u mbështet në faktin se në përbërje të tyre ato përfshinin një popullsi prej 10.000 banorësh, por edhe distanca e largët e disa prej katundeve shkaktonte vështirësi për kryerjen e veprimeve administrative dhe për vendosjen e rregullit e qetësisë për shkak të zonës kufitare në të

cilën ato shtriheshin. Katundi Martanesh për shkak të madhësisë që kishte, si dhe mundësive për zhvillime shoqërore në të ardhmen, ishte sipas prefekturës përcaktues për ekzistencën e komunës së Martaneshit, sesa për suprimimin e saj apo përfitimin ekonomik që mund të sigurohej nga ky suprimim. Prefektura propozonte më tej rrugën që duhej ndjekur, mbështetur në idenë e bashkimit të dy komunave të Çermenikës. Komunitat Shpati I e II përbënin një popullsi prej 9000 banorësh me 39 katunde në distancë të largët nga njëra-tjetra, ndaj po të bashkoheshin me qendrën në katundin Gjinar do të shfaqnin vështirësi të natyrave të ndryshme. Në nënprefekturën e Peqinit ndryshimet dhe propozimet e kryera nga inspektorët e komunave, shiheshin të arsyeshme dhe përkraheshin nga prefektura e Elbasanit. Sipas saj, bashkimi i komunës Mlik me atë të Vrapit me qendër katundin Rrostenj ishte mjaft i dobishëm pasi popullsia e tyre ishte 3000 banorë, dhe afria me katundin Rrostenj krijonte të gjitha lehtësitat e duhura për veprimet administrative. Dakordësi paraqiti prefektura e Elbasanit edhe për ndarjen administrative të nënprefekturës së Gramshit (AQSH., F. 271, D.24, 1930: 21), pasi kjo ishte e lidhur dhe me vendosjen e Post-Komandave të Xhandarmërisë (AQSH., F. 271, D.24, 1930:24). Ndryshimet gjatë vitit 1930 kishin për bazë nevojat dhe domosdoshmëritë që paraqiste çdo katund në lidhje me katundarinë pjesë e së cilës kërkonte të ishte. Kjo, pasi më mirë se kushdo tjetër atij që i rëndonte më shumë në shpinë në çdo aspekt ishte katundari dhe ishte pikërisht ai që i ndiente i pari pasojat e ndryshimeve institucionale apo administrative të marra nga MPB-ja apo qeveria. Më 30 prill 1934 u ndërмор ligji për disa ndryshime në organizimin komunal, të paraqitura nga ana qeveritare për arsye kursimi dhe prej 192 komunave që gjendeshin më parë në Mbretërinë Shqiptare u suprimuam 52 komuna dhe mbetën 140 (Fletorja Zyrtare, Tiranë, 22 qershtor 1934). Ligji i Komunave i

miratuar në Parlament (*Albumi, 10 vjet Mbretëri 1928-1938, 1938:236*) u evidentua, dhe në komunat e qarkut të prefekturës së Elbasanit kishin nisur të realizoheshin dhe suprimimet, ndryshimet e emrave të qendrave e katundeve: Kryetari i komunës së Qendrës suprimohet dhe detyra e tij, atributet dhe kompetencat iu ngarkuan kryetarit të bashkisë. Kryetari i komunës së Qendrës Gramsh u suprimua dhe detyra e tij iu ngarkua nënprefektit (*AQSH., F.271, D. 2, 1934:12*). Mbështetur në ligjin e datës 19 maj 1934, sidomos në Aneksin A të tij, pasqyroheshin komunat që suprimoheshin si dhe bashkimi i katundeve brenda tyre me komunat e tjera fqinje (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 19 maj 1934*). Gjatë vitit 1936, nga ana e qeverisë shqiptare doli në pah domosdoshmëria e rikrijimit të komunave nëpër qendrat e nënprefekturave apo dhe krijimit të komunave të reja, për shkak të nevojave dhe problemeve që evidentoheshin në to, të cilat ishin të suprimuara nga vendimet e mëparshme të MPB-së për nevoja kursimi. Shtypi i kohës shprehej se suprimimi ishte kryer pa kritere të qarta si: largësia e fshatrave nga njëri-tjetri, largësia e tyre me qendrën e komunës, kriteri topografik, vështirësitë natyrore, mungesa e komunikacionit dhe gjendja administrative (*Gazeta "Besa", Tiranë, 4 korrik 1936*). Në dhjetor 1936, MPB-ja i drejtohej prefekturës së Elbasanit më anë të një shkrese duke e informuar se në lidhje me shkresën e dërguar prej saj për disa ndryshime mbi ndarjen administrative në të cilën theksohej se: "Tue marrë parasysh randësinë që ka marrja e një inisiativë të tillë për efektet politike, ekonomike e shoqërore të Mbretnis, ...e shef të nevojshme që pasqyrat të merren edhe një herë në studim t' imët nga Këshilli Administrativ i asaj Prefekturë" (*AQSH., F. 271, D. 21, 1937:2*). Afati përfundimtar që Ministria i linte në dispozicion prefekturës për shqyrtim e studim ishte 20 janari 1937. Në Aneksin A për prefekturën e Elbasanit paraqiteshin shkëputjet e disa katundeve prej një komune dhe lidhja e tyre me një komunë tjetër. Në

Aneksin C po për këtë prefekturë paraqiteshin komunat që krijoheshin bashkë me katundet që përfshinin (AQSH., F. 271, D. 21, 1937:48). Në shqyrtimin e propozimeve të Ministrisë rolin kryesor e luajti Këshilli Administrativ, i cili me vendimin e datës 5.01.1937 u vendosi që: -Katundet Grekan, e Prenjas të komunës së Mollasit t'i aneksoheshin komunës së Tunjës;-lagja Zdravë e katundit Selitë të Mollasit për arsye të shtrirjes anës lumit Devoll dhe në pamundësi komunikimi e lidhjeje me Qendrën Mollas duhet t'i aneksohej komunës së Dumresë që ndodhej më afër me qendrën e komunës Belshin. Kjo lagje do të ishte pjesë e katundit Dëshiran të Belshit;-Katundet Lazarej e Pajovë të komunës Krrabës duhej t'i aneksoheshin komunës së Qendrës së Peqinit për shkak të afërsisë më të madhe me të sesa me Cacabezën. Katundet Gjormë, Krrabë e Vogël, e Shingjin të Krrabës duhet t'i aneksoheshin Komunës së Zaranikës. Këto katunde me qendrën e Zaranikës ndodheshin më afër sesa me Cacabezën;-Katundet Dushkan, Sharqinas e Shpat të komunës Krrabë, të cilat ndodheshin më tepër se tre orë larg qendrës së kësaj komune, duhet t'i aneksoheshin komunës së Petrelës (Tiranë) për shkak të distancës më të shkurtër me të (AQSH., F. 271, D. 21, 1937: 48). Mbështetur në urdhrin e dhënë nga MPB-ja të datës 01.06.1937, nënprefektura e Peqinit mbas një studimi të hollësishëm evidentonte se me përjashtim të komunës së Qendrës që ishte propozuar të krijohet, ishte përcaktuar dhe organizimi i saj administrativ. Nënprefektura ishte e ndarë në tri komuna (AQSH. F. 271, D.21, 1937: 27), me një popullsi 12.500 frymësh dhe 70 katunde e lagje. Në ndryshimet administrative të nënprefekturës Peqin përfshiheshin: shkëputja e katundeve Lazarenjë Pajovë nga komuna e Krrabës, si dhe katundeve Çikallesh, Mëlikë dhe Pojan nga komuna e Garunjës së Madhe. Dy të parat i lidheshin komunës së Qendrës dhe tri të dytat komunës Rrogozhinë. Katundi Ballashenj i komunës Garunjë e Madhe, propozohet t'i lidhet komunës së Rrogozhinës nëse do

ishte e mundur, pasi përbënte një lehtësim për popullsinë e atij katundi, për shkak të largësisë së madhe që kishte me qendrën e komunës Garunjë. Katundi Gjyshaj i rrethit të nënprefekturës së Lushnjës kishte një distancë prej 20 minutash me qendrën e komunës Darsie, kur largësia me nënprefekturën e Lushnjës ishte 2 orë dhe synohej përfshirja e këtij katundi dhe rregullimi më pas i kufirit të kësaj nënprefekturë. Pas propozimeve apo kërkesave që prefektura e Elbasanit i kishte paraqitur Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi organizimin administrativ të saj, si dhe reagimeve në shenjë aprovimi apo jo prej saj, Këshilli Administrativ i Elbasanit vendosi të shpallë vendimet përfundimtare më datë 10.08.1937:-Katundi Ballashej i varur juridikisht nga komuna e Garunjës së Madhe i aneksohej komunës së Rogozhinës;-Katundi Lazarej e Pajovë të komunës së Krrabës duhej t`u aneksoheshin komunës së Peqinit;-Katundi Çikallesh, Mlikë e Pojan shkëputen nga komuna e Garunjës dhe i lidheshin komunës së Rogozhinës;-Katundi Gjyshaj i nënprefekturës së Lushnjës shihej e nevojshme t`i aneksohej komunës së Darsisë. Për rrethin e Gramshit: katundi Shëmërdhenj i Sipërm e i Poshtëm dhe Narta t`i shkëputeshin komunës së Tunjës e t`i aneksoheshin komunës së Qendrës së Gramshit; Katundet Poroçan i Sipërm, Kobash e Kamiçan të komunës së Kukrrit t`i aneksoheshin komunës së Qendrës së Gramshit; Lagja Zdravaj e katundit Selitë e juridiksionit Mollas t`i lidhej katundit Dëshiran të komunës së Belshit; Katundi Prrenjas i komunës së Mollasit t`i aneksohej komunës së Tunjës. Për katundet e rrethit të Qendrës të Prefekturës: Katundet Gjormë, Krrabë, Vogël, e Shingjini të shkëputen nga komuna e Krrabës dhe t`i lidheshin komunës së Zaranikës (*AQSH., F. 271, D. 21, 1937:36*); Katundi Dushkan Sharqinas, Shpat të komunave të Krrabës për shkak të largësisë t`i lidheshin komunës së Petrelës; Katundi Tudan në juridiksion të Shpatit II t`i lidhej komunës së Qendrës Elbasan; Katundi i Series, Prapanik e Labinot të komunës së

Zaranikës t'i lidheshin komunës së Qendrës Elbasan. Klasifikimi i komunave të nënprefekturës së Peqinit: Komuna e Rrogozhinës klasifikohet në klasin II; Komuna e Darsisë dhe e Garunjës së Madhe mbeteshin në klasin III. Klasifikimi i komunave në rrethin e Gramshit: Komuna e Kukurit, Tunjës dhe ajo e Mollasit të mbeteshin në klasin III; Komuna e Belshit, si vend historik të ishte e klasit II; Komunit Gjinari, Shtëpaj, Prapanik, Zdrajshë, Martanesh, Qukës e Qendër të mbeteshin në klasin III (AQSH. F. 271, D. 21, 1937:37). Gjatë viteve 1928-1934 e në vazhdim krahas përpjekjeve të Ahmet Zogut në drejtim të centralizimit e vendit, ndryshime u ndërmorën dhe në administratë. Përmes riorganizimit të administratës synohej jo vetëm futja e një fryme të re perëndimore në formën e funksionimit të saj në rrafshet lokale dhe qendrore, por gjithashtu edhe vënia nën kontroll sistematik të tyre. Pjesa më e madhe e drejtuesve të organeve shtetërore e vendore gjatë organizimeve të reja administrative të zbatuara në vend rritnin varësinë e tyre ndaj MPB-së, e cila kontrollonte, udhëzonte e detyronte zbatimin e ligjeve, udhëzimeve e politikave shtetërore nëpërmjet zyrtarëve të komanduar prej saj.

#### **IV. Organizimi bashkiak me aprovimin e Dekretligjit për Bashkitë**

“Një rol me rëndësi në jetën dhe administrimin e qyteteve e luanin Bashkitë” (*Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2007), Historia e Popullit Shqiptar, 291*). Dekretligji i ri për Bashkitë në thelbin e vet si pjesë e rëndësishme e reformës administrative synonte të zëvendësonte kryetarët me komiserë. Në vitin 1934 (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 10 maj 1934*), u konkretizua edhe ligji i 30 prillit që caktonte në mënyrë përfundimtare dhe me një legjislacion thuajse modern, organizimin e institucioneve bashkiake të Mbretërisë. Sipas tij, në qytetet e qendrave të prefekturave dhe nënprefekturave ku popullsia i kalonte të 2 500 banorët, bëhej i

detyrueshëm organizimi bashkiak. Mbi bazën e këtij kriteri rritej dhe numri i bashkive në vend në 28 dhe kategorizoheshin sipas rëndësisë në pesë nivele klasi. Përjashtim bënte bashkia e kryeqytetit, që përfshihej në një kategori të posaçme (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 10 maj 1934*). Ligji i Bashkive u votua nga Parlamenti shqiptar më 24 prill 1934 dhe u dekretua nga mbreti Ahmet Zogu më 30 prill 1934. Pasqyra e institucioneve dhe kuadrove të bashkisë së Elbasanit në përputhje me ndryshimet që parashikonte ky ligj përbëhej nga: Administrata në krye të së cilës ishte kryetari i bashkisë së Elbasanit, një sekretar, një protokollist-arshivist, kopist; Zyra e Inspektorisë kishte në përbërje një inspektor dhe gjashtë policë; Zyra e Financës një llogaritar, një arkëtar, dy tagrambledhës; Zyra Teknike në të cilën ushtronin funksionin e tyre një inxhinier ose arkitekt, një konduktor; Zyra e Shëndetësisë ku në strukturë kishte dy mjekë dhe dy mami; Zyra e Gjendjes Civile pjesë e së cilës ishte një nëpunës dhe një ndihmësnëpunës. Pasqyra e Kuadrit e bashkisë Peqin përbëhej nga Administrata e Financa në përbërje të së cilës ishte një kryetar, një sekretar llogaritar, një arkëtar, një polic me detyrë tagrambledhësi; Zyra e Shëndetësisë nuk kishte personel; Zyra e Gjendjes Civile kishte në organikën e saj një nëpunës. Kufijtë e bashkisë së Elbasanit që ishin përcaktuar me vendim të Këshillit Ministror që në datë 15.06.1935, ishin: nisur që nga Shën Thanasi, vazhdojnë në Urën e Manasderës, Mullirin Sollak, Urën e Shkumbinit, Tyrbja Fusha Mbret, Ura e Zaranikës, Zaranikë Tre –mullinjtë (*AQSH. F. 252:1*). Gjatë vitit 1937 u aprovua dhe u caktua për zbatim edhe ligji mbi ndryshimin e emrave të disa qyteteve, katundeve, lagjeve, lumenjve me qëllim thellimin e karakterit kombëtar të toponimisë së njësive territoriale, lumenjve, lagjeve, nënprefekturave, bashkive e komunave etj. Një pjesë e madhe e emërtimeve në vend ishin me origjinë sllave, osmane etj. dhe për këtë qëllim nisma e ndërmarrë ishte vërtet më rëndësi kombëtare, mjaft e mirë dhe u përkrah në

vend. Puna për realizimin e ndryshimeve të emërtimeve iu ngarkua specialistëve e personaliteteve të njohura të gjuhës e arsimit shqip në vend (*Fletorja Zyrtare, Tiranë 11 maj 1937*). Prefektura e Elbasanit dhe nënprefekturat e Peqinit e Gramshit (*Fletorja Zyrtare, Tiranë Gusht 1938*) bënë ndryshimin e emërtimeve të emrave të lagjeve të qytetit të Elbasanit, të lumenjve, të përrrenjve dhe fshatrave (*Gazeta "Drita", Tiranë, 23 shtator 1938*).

#### **V. Ndarja e re administrative e vitit 1938 (Komunat e qendrave)**

Gjatë vitit 1938, Ministria pas një studimi të hollësishëm ndërmoi ndryshime që synonin krijimin e një ndarjeje të re administrative në Mbretërinë shqiptare...U miratua Ligji mbi krijimin e disa nënprefekturave, suprimimin e disa bashkive, krijimin e disa komunave, si dhe ndryshimin e disa juridiksioneve administrative të reja (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 17 qershor 1938, 46*). Sipas ligjit të majit 1938, vendi ndahej në: 10 prefektura, 30 nënprefektura, 181 komuna dhe 2584 katunde dhe 23 bashki (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 14 qershor 1938*). Prefektura e Elbasanit përbëhej nga 2 nënprefektura: Gramshi dhe Peqini; 18 komuna e 310 katunde (*Fletorja Zyrtare, Tiranë, 17 qershor 1938, 46*). Më 6 qershor 1938 një ligj tjetër rikrijoi sërish nënprefekturat e shkriera. Në thelb të tij sanksionohej krijimi i nënprefekturës së Gramshit me qendër Gramshin, bashkia e Peqinit suprimohet dhe qyteti në fjalë i aneksohet komunës së Qendrës që rikrijohet sipas nenit 5 të këtij ligji, Qendër Peqin. Komunat e klasit të parë në prefekturën e Elbasanit ishin: Librazhd, Qendër Gramsh dhe Qendër Peqin; Komunat e klasit të dytë në Prefekturën e Elbasanit ishin: Dumre, Krrabë, Martanesh, Qendër Elbasan, Rrogozhinë dhe Shpat II; Komunat e klasit III në Prefekturën e Elbasanit ishin: Çermenikë, Darsi, Kukur, Mollas, Qukës, Shpati I, Tunjë, Vrap e Zaranikë;



## Përfundime

Gjatë periudhës së sundimit të Ahmet Zogut, në dy periudhat shtetërore qeverisëse, ai u përpoq për t'i dhënë Shqipërisë formën e një shteti ligjor i cili duhej të funksiononte mbi bazën e institucioneve shtetërore, vendit t'i obligonte qeverisjen e re mbi bazën e ndarjeve administrative dhe vënies në jetë të një politike aktive e të bërit funksionale të hallkave të ndërmjetme me pushtetin qendror, për të krijuar lidhje të konsoliduara midis tyre. Pavarësisht përpjekjeve të bëra, në Shqipëri struktura e hallkave dhe organeve shtetërore paraqiste probleme të mëdha në funksionim dhe shkak për këtë ishte mungesa e përvojës dhe paaftësia e nëpunësve në këto dikastere. Rëndësia e ndërmarrjes së reformave administrative gjatë qeverisjes së Ahmet Zogut qëndron në faktin se, për herë të parë, një lider u përpoq të unifikonte dhe bashkonte shqiptarët nga përkatësia territoriale mbi bazën e ligjeve të shtetit. Sipas historianit Edvin Jacque, "...veç lehtësimit të procesit të centralizimit të vendit, mund të ndihmonin edhe në paqtimin e mëtejshëm dhe zvogëlimin e numrit të gjakmarrjeve. Nëpunësit e komunave kishin për detyrë të kryenin hetime të menjëhershme rreth grindjeve të ndryshme dhe merrnin masat e nevojshme, duke mos i lënë ato të zhvilloheshin më tej..." (*Fischer, 1996, Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri, 184*). Nëpërmjet reformës administrative, Zogu mendonte se mund të siguronte unifikimin territorial, qetësinë dhe kontrollin e popullsisë në këto njësi. Një politikë e tillë u evidentua dhe në prefekturën e Elbasanit, në ndryshimet administrative që ajo pësoi kohë mbas kohe gjatë këtyre viteve. Shpeshherë ndryshimet cenonin interesat e popullsisë së kësaj prefektуре, e cila për të rregulluar marrëdhëniet mes tyre dhe institucioneve të MPB-së merrte vendime e iniciativa në mbështetje të tyre. Ndryshimet e kryera, mbi të gjitha, nuk është se rregulluan sadopak situatën ekonomike në të cilën gjendeshin banorët e saj, pavarësisht se në

shpinë të tyre ndien dhe ngarkesën e vënë për mbajtje të shpenzimeve të komunës nga puna e tyre vullnetare për shkak të kursimit qeveritar e mungesës së fondeve.

### Literatura

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2007), *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi III, Tiranë: Toena.

Albumi, (1938), 10 vjet Mbretëri 1928-1938, Tiranë.

AQSH., F.271-Prefektura Elbasan, D. 12, 1927; F. 271, D. 20, 1929; F. 271, D. 51, 1926; F. 271, D. 147, 1927; F. 271, D. 223, 1929; F. 271, D. 12, 1928; F. 271, D. 227, 1929; F. 271, D.274, 1932; F. 271, D. 24, 1930; F.271, D. 2, 1934; F. 271, D. 21, 1937;

Dervishi, K., (2006), *Historia e Shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: "55".

Fischer, B., (1996), *Mbreti Zog dhe përpyekjet për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej.

*Fletorja zyrtare*, Tiranë, 8 qershuer 1926; 15 qershuar 1926; 22 qershuer 1934; 15 qershor 1934; 19 maj 1934

Gazeta "Besa", Tiranë, 4 korrik 1936; 3 korrik 1936;

Gazeta "Drita", Tiranë, datë 23 shtator 1938

Gazeta "Shekulli i Ri", Durrës, e enjte 6 qershor 1929; e enjte, 6 dhjetor 1928

Gazeta "Telegraf", Tiranë, e enjte, 31 mars 1927; e enjte 10 maj 1934; 11 maj 1937; 14 qershor 1938; 17 qershor 1938, Nr. 46; Gusht 1938

Gazeta e Re, Tiranë, e djelë, 19 maj 1929; e djelë, 26 maj 1929.

Selenica, T., (1923), *Shqipëria më 1923*, Tiranë.

Selenica, T., (1928), *Shqipëria më 1927*, Tiranë.

Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, (1965), *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë.

**Dr. Artan Lila<sup>1</sup>**

## **HISTORIA E VENDBANIMEVE DHE TIPARET E POPULLIMIT NË ZONËN E GOLLOBORDËS SOT**

### **Abstrakt**

Golloborda përfaqëson një zonë me histori të vjetër të popullimit, ku ndërthuren elemente historike, natyrore dhe ekonomike në krijimin dhe zhvillimin e vendbanimeve. Treva është e pasur me elemente historike e kulturore, duke filluar nga periudha ilire kur popullohej nga Penestët. Rrënojat e vendbanimeve ilire të gjetura nga gërmimet arkeologjike të quajtura “qyteza” si ajo e Borovës apo vendbanimet dhe fortifikimet si Gurshkameni i Borovës, Gradishta e Trebishtit apo ajo e Kojavecit e dëshmojnë më së miri këtë fakt. Ato u përkasin periudhave midis shek. IV dhe VI të e.s. Elementi më dallues i arkitektonikës së ndërtimit përfaqësohet nga punimet e gurit, për të cilën mjeshtrit e zonës dalloheshin në të gjithë Ballkanin deri në Stambollin e sotëm. Vendbanimet në aspektin organizativ arkitektonik i lidhnin lagjet e tyre me kalldrëm, e me mure prej guri. Këto tipare vazhdojnë deri në ditët e sotme. Organizimi hapësinor i vendbanimeve sot karakterizohet nga vendosja e lagjeve në bazë fisi, kryesisht sipas pronësisë së trojeve. Në periudhën moniste u vunë re disa elemente të reja, si ndërtimi i qendrave të fshatrave kryesisht me qëllim “funksional”, si qendra e kooperativave bujqësore apo vatrave të kulturës. Por në tërësinë e tyre, këto vendbanime kanë ruajtur me pak ndryshime fizionominë e tyre shumëshekullore. Popullsia e trevës, ndonëse e hershme, në ditët e sotme karakterizohet nga disa dukuri midis të cilave veçojmë: braktisjen e vendbanimeve të tyre dhe zhvendosjen kryesisht drejt rajoneve fushore, ku oferta për tokë bujqësore është më e madhe. Drejt qendrave të mëdha urbane si Tirana, Durrësi apo Elbasani, por me mundësi më të mëdha punësimi. Dhe së fundmi, drejt emigrimit, më i shprehur kjo te grupmoshat e reja. Po të

---

<sup>1</sup>Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan; Fakulteti i Shkencave Humane; Departmenti Histori-Gjeografi; E-mail: tani\_lila@yahoo.com

krahasojmë të dhënat midis vitit 2011 dhe atij 2020 rezulton një rënie prej 3.9% të grupmoshave të reja të zonës. Ndërkohë që lëvizja më e madhe ka ndodhur në periudhën '95-'98, kur ka një pakësim me 57% të popullsisë krahasuar me vitin 1989. Pasojat: shpopullim i zonës, rritja e përqindjes së grupmoshës së tretë, mungesa e fuqisë punëtore dhe ulja e ndjeshme e lindjeve dhe grupmoshës 0-14 vjeç.

***Fjalë çelës:** Migrim, vendbanim, popullsi, fortifikim, strukturë e popullsisë, urbanizim*

### **Abstract**

Golloborda represents an area with an ancient history of population, where historical, natural and economic elements intertwine in the creation and development of settlements. The area is rich with historical and cultural element starting from the Illyrian period and was populated by Penestwt. Ruins of Illyrian settlements found by archeological excavations called "City" like that of Borova or settlements and fortifications like the stone quarry of Borova, Gradishta e Trebisht or Kojavec best prove this fact. They belong to the periods between IV and VI century AD. The most distinctive element of building architecture is represented by the stone works, for which the masters of the area were distinguished throughout Balkans up to Istanbul.

The settlements in the organizational architectural aspect connected their neighborhoods with cobblestones, and with stone walls. These features continue to be present to these days. Spatial organization of settlements today, it is characterized by the settlement of neighborhoods on a tribal basis, mainly according to land ownership. During the monistic period some new additional elements were noticed, such as the construction of village centers mainly with "functional" purpose as the center of the agricultural cooperatives or cultural centers. However, in the entirety these settlements have been preserved with a few changes in their very centuries-old physiognomy. The population of the area, although created early in the days, nowadays is characterized by several characteristics among which we want to emphasize: abandonment of their settlements and relocation to the plain regions, mainly where the supply for agricultural land is greater. Reallocation towards large urban centers such as Tirana, Durrës or Elbasan for greater employment opportunities as well as recently, towards emigration expressed more in the young age group. If we compare the data between 2011 and 2020 that would result in a decrease of 3.9% young age group. However, the largest movement occurred during 95-'98'period 'where we had a decrease of 57%of the population compared to 1989. Consequences: depopulation of the area, increase of the elderly group

percentage, lack of labor force and significant reduction in births and age group 0-14 years.

*Keywords:* Migration, settlement, population, outwork, population structure, urbanization

## I. Metoda

Punimi “Historia e vendbanimeve dhe tiparet e sotme të popullimit në Gollobordë” ka për synim të evidentojë fakte dhe të dhëna shkencore mbi popullimin e hershëm të zonës. Metodologjia e përdorur konsiston në dy aspekte të rëndësishme. Së pari, në aspektin kohor dhe së dyti në atë hapësinor. Kjo për të pasqyruar sa më drejt e në mënyrë shkencore fillesat e qendrave urbane në Gollobordë, si dhe ndryshimet e tyre në periudha të ndryshme kohore, në varësi të faktorëve ndikues. Këto ndryshime janë parë dhe në aspektin hapësinor. Kjo, duke pasur për qëllim evoluimin që pësuan vendbanimet me zgjerimin e tyre në veçanti në periudhën e viteve 1960-1989. Për të nxjerrë më në pah këto ndryshime jemi mbështetur në metodën e hulumtimit historik me të dhënat e mbledhura në Arkivin e Shtetit, atë të qarkut Dibër e Elbasan si dhe nga burime të tjera. Pra nëpërmjet kësaj metode jepen fakte bindëse mbi historinë e hershme të krijimit të këtyre vendbanimeve në zonë. Në kontekstin kohor, ndryshimet që ka pësuar popullsia e zonës si në aspektin sasior, por dhe në atë cilësor, duke u bazuar në të dhëna statistikore dhe shoqëruar me grafikë dhe tabelat përkatëse. Përdorimi i metodës statistikore me ato krahasuese dhe grafike na mundësojnë të japim konkluzione të sakta mbi popullsinë sot dhe prognozën e saj. Për sa parashtriam më lart përdorimi i këtyre metodave të ndërlydhura me njëra-tjetrën, na japin mundësi për të dhënë një analizë shumëdimensionale dhe njëherazi të parashtrojmë rrugët e zhvillimit dhe integritimit të saj jo vetëm me zonat më të zhvilluara në vend, por dhe më gjerë.

## II. Vendndodhja dhe roli i saj në urbanizimin dhe zhvillimin e zonës

Zona e Gollobordës shtrihet në pjesën lindore të territorit të vendit tonë. Ajo bën pjesë në malësinë me të njëjtën emër. Pikërisht në kufijtë administrativë të tri ish-komunave: Ostren, Klenjë dhe Steblevë. Sot këto njësi administrative karakterizohen nga tipare të njëjta ose gati të përafërta ekonomike, sociale, kulturore dhe shpirtërore. Kjo e bën atë të dallueshme nga e gjithë malësia në fjalë. Pra, vetë banorët vendës e njohin si Gollobordë. Zona, nga pikëpamja administrative, bën pjesë në dy qarqe: pjesa më e madhe e saj, 181,7 km<sup>2</sup> ndodhet në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesa tjetër në qarkun e Elbasanit, pra shtrihet në zonat rurale të rretheve Bulqizë dhe Librazhd. Përfshin njësinë administrative Stërblevë, e cila ndodhet nën administrimin territorial të bashkisë së Librazhdit. Dy njësitë e tjera, Ostren dhe Klenjë, që janë nën administrimin e bashkisë së Bulqizës. Pozita gjeografike dhe roli i saj është i lidhur me shumë faktorë, ndër të cilët vlerë të veçantë kanë zhvillimet social-politike të brendshme, por dhe ato rajonale e më gjerë. Pavarësisht nga periudhat historike dhe veçoritë e tyre, zona e Gollobordës ka pasur rolin e një ure lidhëse midis territorit të vendit tonë dhe viseve të tjera shqiptare jashtë saj dhe më gjerë. Në antikitet ka funksionuar *rruga Durrës – fusha e Tiranës – Dibër*, e cila lidhte bregdetin me brendësinë e trevave ilire dhe, më pas, me pjesën tjetër lindore të perandorisë romake. Në periudhën e mesjetës së hershme dhe të mesme, shndërrohet ndër rrugët më të rëndësishme në të gjithë Ballkanin, sepse lidhte territorin shqiptar dhe brigjet e Adriatikut me luginën e Pollogut. Pas vitit 1913 mbeti jashtë saj qendra më e madhe urbane dhe social-ekonomike, Dibra e Madhe. E gjithë kjo hapësirë rurale mbeti pa qendrën urbane. Pasojat e kësaj ndarjeje janë të mëdha, pasi qendra urbane cilësohet si motori i zhvillimit social dhe ekonomik.

### III. Historia e popullimit dhe veçoritë e urbanizimit

Zbulimet arkeologjike dhe të dhënat historike tregojnë qartazi se Golloborda përbën një trevë të trungut iliro-arbëresho-shqiptar. Kjo trevë ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike që zë fill që në periudhat më të hershme, pikërisht në ato të qytetërimit ilir të saj. Në periudhën e antikitetit ajo banohej nga fisi ilir i Penestëve (*Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, 2002, f. 40*). Dëshmi të shumta dhe mjaft të qarta të kulturës ilire në këtë zonë paraqiten me rrënojat e vendbanimeve ilire “urbane” të kohës; rrënojat “e qytezave” apo atyre të quajtura “fortifikime”. Të gjitha faktet e mësipërme janë tregues të urbanizimit e qytetërimit të hershëm të zonës. Golloborda në tërësi përfaqëson një trevë me histori të lashtë të popullimit, ku ndërthuren elemente historike, natyrore dhe ekonomike në krijimin dhe zhvillimin e vendbanimeve të saj. Këto vendbanime dhe fortifikime dallohen për arkitekturën e veçantë. Ato janë ndërtuar në sektorët më strategjikë të zonës, kryesisht në pikat dominuese të saj për t’u mbrojtur nga pushtuesit e huaj. Midis tyre interes të veçantë kanë: qyteza dhe Gushkameni i Borovës, Gradishta e Trebishtit dhe ajo e Kojavecit. Një objekt me një rëndësi të veçantë është kalaja e Ladomiricës, e cila ndodhet pranë fshatit homonim. Kalaja ka vazhduar të funksionojë deri në mesjetë, kur bënte pjesë në vargun e fortesave të shumta në trungun lindor të Ilirisë. Vendbanimi i hershëm ilir i zbuluar në zonë, e cila njihet si “qyteza e Borovës” dëshmon për qytetërimin e hershëm të zonës. Ajo i përket periudhës shek. IV para Krishtit deri në shek. VI. Këto ndërtime me karakter mbrojtës të shekullit VI, të cilat emërtohen “qyteza”, kanë pamjen e gërmadhave të një kështjelle. Varrezat e vjetra dhe shumë sende qeramike, të zbuluara nga arkeologët shqiptarë midis fshatrave Borovë dhe Zabzun flasin për vazhdimësi të kulturës ilire tek ajo arbëreshe. Kjo kështjellë vazhdon të quhet “qyteza e Borovës”, e banuar kryesisht nga arbëreshët në shekullin VI. Banorët e zonës janë

dalluar historikisht si mjeshër të talentuar ndërtimi. Kjo ka qenë një traditë që u trashëgua nga lashtësia deri në ditët tona. Gjurmët e punës së tyre gjenden të skalitura në ndërtimin e shumë objekteve të hershëm të Perandorisë Osmane: në Stamboll, Bullgari, Greqi dhe deri në Egjiptin e largët.



Fig 1 Harta e pozitës gjeografike të Gollubordës.  
Burimi, Harta e punuar nga autori. Tiranë 2015.

Arkitektura e përdorur në ndërtimin e banesave dallohet për ndërthurjen e punimit prej druri me atë të gurit, ku gjen shprehjen e vet te ballkonet e gjata dhe të ngushta të quajtura “telise”. Çatitë me maja të mprehta me dërrasë ose rrasa guri dhe dritare të vogla në formë frëngjie u japin atyre karakter unik krahasuar me ndërtimet në zonat e tjera në vend. Mënyra e vendosjes së fshatrave, e përshtatur me arkitekturën e vendosjes së shtëpive



është tejet e veçantë vetëm për zonën. Të bie në sy fakti se ato lidhen me njëra-tjetrën me rrugica me kalldrëm të ngushtë dhe në shumicën e rasteve me mure guri. Shtëpi tipike të tilla apo dhe fshatra të tërë të këtij lloji mund të përmendim, Stëblevën, Zabzunin, Ostrenin, Borovën etj.

#### **IV. Organizimi hapësinor i qendrave të banuara**

Përgjithësisht, vendbanimet në zonë janë ato të tipit të fshatrave. Ato më tepër ndodhen të vendosura në lartësinë nga 850-1000 m mbi nivelin e detit. Kryesisht janë të tipit malor, ku sipërfaqja bujqësore paraqitet tejet e kufizuar. Disa fshatra të tilla si Pasinkë, Trebaç dhe Cerenec janë të vendosura në lartësinë nga 600-650 m mbi nivelin e detit, duke përfaqësuar dhe fshatrat me lartësinë më të ulët dhe pikërisht këtu ndodhen dhe sipërfaqet më të mëdha të sipërfaqes bujqësore në zonë. Duke u nisur nga lartësitë në të cilat janë vendosur qendra të banuara, dallohen disa nivele hipsometrikë të vendosjes së tyre. Fshatra me lartësi nga 600 – 850 m ku përfshihen Pasinka, Trebaçi, Sebishti dhe Cereneci. Ato përbëjnë 22,8 % të të gjithë qendrave të banuara të zonës.

Fshatra me lartësi nga 851 – 1000 m në të cilat përfshihen Radovesh, Ostren i Vogël, Orzhanova, Borovë, Lejçan, Orshenjë, Ladomicë dhe Vërnice. Ato përbëjnë 40,9 % e të gjithë qendrave të banuara në zonë. Fshatra me lartësi nga 1001–1360 m, ku futen Llangë, Celebi, Zabzun, Studën, Trebisht, Steblevë, Klenjë dhe Gjinavec. Ato përbëjnë 36,3 % e të gjithë qendrave të banuara të zonës (Lila, 2006).




Fig. 2 Grafiku i vendosjes së qendrave të banuara sipas lartësisë, zona Gollabordë. (2021)

*Burimi: Harta topografike e Gollabordës 1:25000.*

Disa fshatra gjenden të vendosura në gropa, të rrethuara nga shpate malesh. Vendosja e tyre në to është bërë për të shfrytëzuar mundësitë më të mëdha që këto gropa ofrojnë për toka të punueshme, për ujë dhe t'u mbrojtur nga erërat e ftohta. Në këtë kategori përfshihen fshatrat Steblevë, Borovë dhe Fushë Studën. Disa të tjera janë të vendosura përgjatë luginave të lumenjve e përrrenjve të zonës. Kjo lidhet me mundësinë e sigurimit të ujit për vaditjen e tokave bujqësore. Si të tilla mund të përmendim fshatrat Borovë, Sebishtë në njësinë administrative Steblevë; fshatrat Ostren i Vogël e Tuçep si dhe Ladimirica. Numri më i madh i qendrave të banuara paraqiten të përqendruara më së shumti në njësinë administrative Trebisht dhe Steblevë. E përbashkëta e këtyre qendrave të banuara, në ditët e sotme, qëndron në faktin se ato janë të përqendruara pranë qendrave të njësive administrative apo buzë rrugës nacionale, në udhëkryqet që bashkojnë fshatrat midis tyre. Përgjithësisht fshatrat në brendësi të tyre janë të organizuara në lagje me bazë fisi, si në rastet e fshatrave Steblevë, Trebisht, Borovë, Gjinavec etj. Pas viteve '90 kanë ndodhur ndryshime të

dukshme në arkitekturën e ndërtimitarisë së shtëpive në zonë. Rikthimi i ndërtimeve të reja sipas trojeve të trashëguara, me elemente të reja funksionale në ndërtim, veranda, kangjella hekuri etj., përbëjnë specifika të cilat nuk kanë ekzistuar më parë. Sot vërehet gjithnjë e më tepër ndërtimi i objekteve të shërbimit turistik duke afruar rreth tyre dhe ndërtimet e banesave të reja në funksion të turizmit malor dhe atij familjar, si në Steblevë, Studën apo Borovë. Kjo lidhet me resurset e mëdha për turizëm malor dhe ekoturizëm që ofron zona.

### **V. Tipare të sotme të popullimit në zonë**

Ndonëse zona ka qenë e populluar prej shekujsh, sot qendrat e banuara të saj paraqesin disa tipare të reja. Karakteri tejet malor i saj, disi i izoluar nga pjesët e tjera të vendit, si dhe infrastruktura rrugore shumë e amortizuar me investimet e pakta, ka bërë që ato të shpopullohen. Kjo lëvizje migruese ka pasur dhe vazhdon të ketë dy drejtime kryesore. Së pari, zhvendosjen e tyre brenda vendit kryesisht në drejtim të Ultësirës Perëndimore dhe në veçanti drejt qendrave urbane të tilla si Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Përgjithësisht janë vendosur në periferi të tyre duke krijuar “komunitetet” e tyre në këto lagje.

Së dyti, largimi i tyre dhe kryesisht i grupmoshave të reja 18-30 vjeç jashtë vendit në drejtim të vendeve të Europës Perëndimore si Gjermani, Angli, Francë etj. Intensiteti i kësaj lëvizjeje u rrit ndjeshëm sidomos pas vitit 2012 dhe në vazhdim. Kjo lidhet më së shumti me lehtësimin e lëvizjes së lirë në drejtim të vendeve europiane dhe së dyti, nga marrja e nënshtetësisë bullgare dhe njohja si minoritet i tyre. Një lëvizje e tillë e kësaj popullsie ka ndikuar në disa dukuri negative demografike dhe social-ekonomike. Për pasojë po vërehet një rënie e theksuar e numrit të përgjithshëm të popullsisë duke çuar deri në shpopullimin e disa fshatrave si në rastin e fshatit Steblevë. Krahasuar me vitin 2011, në

ditët e sotme kemi një ulje me 18 deri 20% të popullsisë referuar INSTAT-it dhe pushtetit vendor në zonë. Pasojë e këtij largimi të popullsisë është ulja e ndjeshme e grupmohave të reja. Kjo ka ndikuar në mungesën e fuqisë punëtore dhe rritjen jonatyrare të peshës së grupmohës së tretë. Në disa fshatra të mëdha si Ostren e Trebisht vërehet ulja e grupmohës së re deri në 14 vjeç në vitin 2020 nga 2.2-3.9 % krahasuar me 2011. Kjo është shoqëruar me një rritje të lehtë të grupmohës së tretë nga 1.7% në 3.4% në vitin 2020 në Steblevë, Klenjë e Gjinavec. Pa dyshim që ky largim ka ndikuar dhe në strukturën gjinore të popullsisë në këto qendra të banuara. Vërehet një rritje e peshës së femrave në grupmoshat 18-35 vjeç me 11-14% krahasuar me regjistrimin e vitit 2011 (*Instat, 2011*).

## **VI. Mundësitë për zhvillim dhe rikthim të popullsisë në Gollobordë**

Me gjithë kushtet e vështira fizike si dhe ekonominë e dobët që e karakterizon zonën, ekzistojnë mundësi reale për zhvillim. Ato lidhen para së gjithash me: -Hartimin e planeve zhvillimore dhe mbështetjen financiare në dy sektorët bazë të zonës, turizmin malor dhe ekonominë blegtorale. Sipërfaqet e mëdha pyjore, shtrirja e një pjese të saj në Parkun Kombëtar më të madh në vend, atë të Shebenik-Jabllanicës, krijon mundësi të mëdha për shndërrimin e saj në një destinacion të rëndësishëm turistik. Nga ana tjetër, sipërfaqet e mëdha të kullotave natyrore në Kallkan, Dragan, Kusar dhe malin e Letmit mundësojnë mbarështimin e një numri të konsiderueshëm të blegtorisë së imët, e cila është traditë në Gollobordë. Përfundimi i rikonstruksionit të aksit kombëtar Librazhd-Peshkopi i lënë përgjysmë prej 8 vitesh, do të mundësonte një lidhjes më të shpejtë të zonës me qendra të mëdha urbane si Elbasani apo Tirana. Për rrjedhojë do të ndihmonte popullsinë e zonës për të dalë në treg në një kohë të shpejtë me prodhimet e tyre dhe ardhjen e turistëve. Hartimi i politikave të

përbashkëta me qeverinë e Maqedonisë, me synim nxitjen e investimeve për integrimin e rajonit ndërkufitar Strugë-Gollobordë do të përbënte një mundësi reale për zhvillim, e për pasojë do të nxiste rikthim të popullsisë dhe investime në zonë. Hapja e pikës së kalimit kufitar të Steblevës do të nxiste qarkullimin më të madh të mallrave dhe njerëzve në të dyja anët e rajonit ndërkufitar. Kjo do të krijonte mundësi të mëdha edhe për shkak të afërsisë me aeroportin e Strugës, e cila nga fshati Steblevë nuk ndodhet më larg se 45 km. Nxitja e turizmit familjar, atij malor dhe ekoturizmit nëpërmjet mbështetjes financiare me grante apo kredi me kushte lehtësuese do të rriste mundësinë e punësimit dhe të zvogëlonte largimin e popullsisë. Përfshirja e zonës në hartat turistike të vendit do të mundësonte njohjen e bukurive natyrore të Gollobordës, duke iu bashkëngjitur zinxhirit turistik ndërkufitar Prespë-Galicicë-Ohër-Strugë-Gollobordë.

### **Rekomandime**

Nga analiza e mësipërme mbi zonën e Gollobordës në aspektin e shpopullimit, mendojmë se zgjidhja do të vinte nëpërmjet: Kritisjes së investimeve direkte në ekonomitë familjare për të nxitur prodhimin vendës. Hartimin e strategjive për zhvillim, duke përcaktuar si prioritetë zhvillimin më të madh të ekonomisë blegtorale e në veçanti turizmin malor. Përfundimi i projektit të lënë në mes, ai i rrugës nacionale Librazhd-Peshkopi, si e vetmja një lidhëse midis saj dhe qarqeve Dibër dhe Elbasan. Bashkërendimi i politikave zhvillimore midis qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Maqedonisë për integrimin e rajonit ndërkufitar Gollobordë-Strugë. Mundësi për zhvillim në zonë do të krijonte rihapja e pikës së kalimit kufitar të Steblevës, duke nxitur lëvizjen e mallrave njerëzve në të dyja anët e tij.

### **Literatura**

Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë,(2002), “Historia e Popullit Shqiptar”, Vol I, f. 40, 45, 50, etj. Tiranë

Akademia e Shkencave. Instituti i Historisë, (2002), Historia e Popullit Shqiptar, Vol I.Tiranë.

Hofrat Dr.Karl Patsch “Ilirët”,Botim i vitit 1923.

Hoxha, R., (2003), Stebleva – Histori dhe Figura, f. 34, Tiranë

INSTAT, (2001), Popullsia e Shqipërisë, prefektura Dibër dhe Elbasan,rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe banesave, Tiranë 2003.

INSTAT, (2011), Popullsia e Shqipërisë, prefektura Dibër dhe Elbasan,rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe banesave.

Lila, A.,(2010), “Golloborda, studim gjeografik” Tiranë f. 82-83

Muzeu Historik i Dibrës, (1987), Gjetjet arkeologjike në fshatrat Borovë dhe Moglicë,.

Pushteti vendor Bulqizë dhe Librazhd 2021.

**Dr. Flora Gjoni<sup>1</sup>**

**Dr. Bresena Kopliku<sup>2</sup>**

**Prof. as. dr. Nevila Dibra<sup>3</sup>**

## **TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE NË BASHKINË E SHKODRËS, NDRYSHIMET QË KANË PËSUAR GJATË TRANZICIONIT, POTENCIALET PËR ZHVILLIM TË TYRE**

### **Abstrakt**

Tipologjia është një aspekt i rëndësishëm i studimit të vendbanimeve në vendin tonë. Ajo është një metodë që na çon në analiza të rëndësishme në lidhje me vendbanimet. Në vendin tonë tipologjia ka pësuar ndryshime të mëdha, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit, ku kriteret e tipizimit të vendbanimeve kanë pasur një variabilitet më të madh si në aspekt kombëtar, ashtu edhe atë rajonal. Veçoritë gjeografike-natyrore, si dhe ato të aspektit human, mbeten kriteret kryesore të tipologjisë së tyre. Ato të karakterit human kanë pasur një dinamizëm ndryshimesh më të mëdha, të reflektuara edhe në tipologjinë e vendbanimeve rurale dhe urbane. Në këto të fundit tranzicioni demografik dhe ekonomik evidentoi edhe krijimin e vendbanimeve të reja joformale, gjë e cila ndikoi në morfologjinë e qyteteve dhe ndryshimet funksionale të tyre. Realisht vendbanimet duhet të mishërojnë në tipologjinë e tyre historinë, tiparet e zhvillimit social-ekonomik, si dhe përshtatshmërinë sipas veçorive të relievit, që

---

<sup>1</sup> *University of Shkodra "Luigj Gurakuqi", Faculty of Social Sciences, Department of Geography; E-mail: flora.gjoni@unishk.edu.al;*

<sup>2</sup> *University of Shkodra "Luigj Gurakuqi", Faculty of Social Sciences, Department of Geography; E-mail: bresena.kopliku@unishk.edu.al;*

<sup>3</sup> *University of Shkodra "Luigj Gurakuqi", Faculty of Social Sciences, Department of Geography; E-mail: nevila.dibra@unishk.edu.al*

reflektohet edhe në morfologjinë e tyre. Nisur nga këto kritere, por edhe faktori politik (ndarjet administrative), vendbanimet në rajonin e Shkodrës kanë sot një tipologji komplekse, parë këto në sfond kohor e hapësinor. Pikërisht këtë synojmë të evidentojmë në këtë punim shkencor, si dhe të japim disa sugjerime mbi prognozën e zhvillimit të vendbanimeve rurale e urbane të rajonit në të ardhmen.

*Fjalë çelës: vendbanim rural, tipologji vendbanimi, ndryshim funksional, peisazh rural, peisazh urban.*

### **Abstract**

The typology of the settlement is one of the main aspects we should consider when studying the different population settlements. The topology helps us analyze the different factors that influence the decision of people to settle in a certain place. Albanian settlements have changed drastically during the transition from a planning economy to a free market one. We see these changes in different spatial scales, from the national to the regional one. In addition to the natural geographical factors, human ones have had their undisputable role as well. Recently the human factors have changed in a very dynamic way influencing also the typology of urban and rural settlements. From the human factors we consider as more important the demographic and economic transition which affected the creation of new informal settlements and the changes in the morphology and functions of the cities. In addition to the above-mentioned factors, settlements reflect also the morphological features of the relief, historical events, social and political changes. In this article we analyze the spatial and time changes in Shkodra region by studying in-depth some of the main natural and human factors. Relying on the nowadays settlements' typologies we also give some suggestions on the configuration urban and rural settlements may take in the future.

*Keywords: rural settlements, settlements typology, functional change, rural landscape, urban landscape.*

## **I. Hyrje**

Pjesë e rëndësishme e gjeohapësirës dhe kompleksitetit të dukurive që përmbledh urbanizimi në vendin tonë, me transformime shumëpërmasore, janë edhe vendbanimet. Këto ndryshime kanë qenë historike, të reflektuara si në formë, madhësi dhe funksionalisht. Qëllimi i këtij punimi studimor është



hulumtimi i tipologjisë së vendbanimeve në bashkinë e Shkodrës, parë në sfond historik dhe me fokus kryesisht prezantimin e situatës aktuale të tyre. Gjetjet në funksion të këtij qëllimi janë përpunuar prej nesh dhe mund të përdoren për qëllime njohjeje, projektimi dhe planifikimi (*Vit, 2014, f. 4*), në mënyrë që vendbanimet të transformohen dhe shndërrohen në zona tërheqëse dhe funksionale për popullsinë. Tipizimi i vendbanimeve mbetet një aspekt shumë i rëndësishëm i studimeve humane, për shkak se në sfondin kohor kriteret për realizimin e tij ndryshuan, të lidhura kryesisht me proceset evolutive të faktorëve humanë. Këto janë të reflektuara sot në ndryshimet funksionale të vendbanimeve. Prandaj e bën domosdoshmëri analizën e tyre tipologjike në këtë aspekt. Rezultatet e kësaj analize mund të shfrytëzohen nga politikëbërësit për shfrytëzimin dhe përdorimin sa më racional të tokës urbane e rurale, duke i konsideruar vendbanimet si indikator të zhvillimit ekonomik. Dallimi tradicional midis zonave urbane dhe rurale është në shumë aspekte: morfologjike, funksionale dhe mënyra e jetesës etj. Në këtë të fundit, sipas INSTAT-it (2014), vendbanimet urbane sigurojnë një mënyrë të ndryshme dhe me një standard më të lartë jetese sesa ato rurale. Kjo vlen kryesisht për vendet në zhvillim, ku dallueshmëria midis këtyre dy tipave të vendbanimit është më e dukshme.

## **II. Metoda e studimit**

Qëllimi i studimit të punimit imponoi përdorimin e një larmie metodash gjatë hulumtimit të kryer. Analiza tipologjike e rajonit të marrë në studim është mbështetur në kriteret e klasifikimit tipologjik të vendbanimeve në vendin tonë, duke përzgjedhur ato që kanë ndikuar në tipologjinë aktuale të vendbanimeve të kësaj hapësire gjeografike. Për këtë qëllim është përdorur metoda deduktive. Analiza ka konsistuar në përpunimin e të dhënave të marra nga organet e qeverisjes lokale mbi numrin e vendbanimeve

(*Të dhënat nga Bashkia Shkodër*). Gjithashtu për të realizuar tipizimin e vendbanimeve në këtë hapësirë janë shfrytëzuar edhe përvojat botërore, mbështetur në një literaturë të gjerë në lidhje me tipologjinë e vendbanimeve, sidomos tipologjitë e vendeve të rajonit. Në punim është përdorur gjerësisht metoda statistikore, me anë të së cilës kemi realizuar klasifikimin e vendbanimeve sipas kriterëve tipologjike të përcaktuara, me qëllim identifikimin e llojeve të ndryshme të vendbanimeve rurale e urbane të zonës në studim. Qasjet e aplikuara në hulumtimet e analizuara në vende të ndryshme të botës dhe veçanërisht të rajonit, na kanë ndihmuar që të realizojmë një tipizim të vendbanimeve në bashkinë e Shkodrës sipas disa kriterëve: relievit, madhësisë demografike, funksionit, ndryshimeve morfologjike të tyre.

Rezultatet e marra dhe përdorimi i metodës së sintezës tregoi se hapësira e marrë në studim për sa i përket tipologjisë aktuale ka një diversitet të madh të vendbanimeve, kushtëzuar nga marrëdhëniet ndërvepruese të faktorëve natyrorë e humanë. Natyrisht që për realizimin e këtij studimi janë përdorur edhe metoda të tjera: metoda historike, që konsiston në analizën historike të vendbanimeve në këtë hapësirë në sfond kohor, duke u reflektuar në ndryshimet funksionale të tyre; metoda grafike, për të pasqyruar ndryshimet strukturore ekonomike e ato të popullsisë; metoda e përpilimit dhe përdorimit të hartave etj.

### **III. Diskutime dhe gjetjet**

Tipologjia e vendbanimeve rurale e urbane në bashkinë e Shkodrës aktualisht është komplekse dhe në variabilitet të vazhdueshëm, kushtëzuar kryesisht nga faktorët humanë. Prandaj gjetjet kryesore në këtë analizë tipologjike të vendbanimeve rurale për hapësirën e marrë në studim, treguan për praninë e një numri të madh fshatrash me numër e dendësi të ulët të popullsisë. Gjithashtu, funksionalisht ato kanë pësuar ndryshime, reflektuar te

krijimi i një numri më të madh fshatrash me veprimtari të përzier në të tria nivelet hipsometrike, pasojë e dinamizmit të zhvillimit ekonomik të tyre gjatë tranzicionit. Ky dinamizëm është reflektuar edhe në ndryshimet shumëpërmasore të vendbanimit urban në këtë bashki.

Hulumtimi tipologjik i vendbanimeve rurale e urbane në zonën e marrë në studim është trajtuar në dy periudha kohore: nga antikiteti e deri në vitet 1990, dhe fokusi kryesor ka qenë prezantimi i situatës aktuale, që lidhet me periudhën e tranzicionit.

### **3.1 Historiku i ndryshimeve tipologjike të vendbanimeve në rajonin e Shkodrës**

Krijimi i vendbanimeve të qëndrueshme daton nga periudhat e hershme, ku faktori vend ka përcaktuar lokalizimin e tyre me përqendrim kryesisht në vendet mbrojtëse. Të lidhura me këtë faktor janë edhe disponueshmëria e ujit, tokës, strehimit dhe aspekti që lidhet me topografinë e zonës (*Ibrahim, Ayoob, 2011*). Morfologjikisht dhe funksionalisht vendbanimet në Shqipëri kanë ndryshuar në epoka të ndryshme të historisë së popullit tonë. Çdo epokë historike ka lënë gjurmët e veta, derisa sot, edhe në nivel lokal, kemi një rrjet vendbanimesh me tipologji komplekse dhe fizionomi specifike.

Në gjeohapësirën e marrë në studim, kriteri gjeografik-natyror me elementet e tij ishte i pari që përcaktoi tipologjinë e vendbanimeve. Kjo bëri që vendbanimet e para të krijoheshin dhe pozicionoheshin kryesisht rrëzë maleve e buzë lumenjve, aty ku njerëzit e kishin më të lehtë jetesën dhe ushtrimin e veprimtarive të tyre. Popullsia në rajonin e Shkodrës nga prehistoria dhe më pas, ka pasur rritje demografike si rezultat i shtimit natyror dhe proceseve migruese. Ardhjet e popullsisë drejt rajonit të Shkodrës favorizoheshin nga kushtet fiziko-gjeografike të tij, një territor me një morfografi të shumëllojtë dhe për rrjedhojë përshtatshmëri për

banim. Më vonë me shfaqjen e vendbanimeve të para urbane evidentohet karakteri mbrojtës i tyre. Këtë e vërteton analiza arkitektonike dhe prania e mureve rrethuese, të cilat e shprehin qartë këtë funksion. Në fushën e studimit të vendbanimeve të fortifikuara pre dhe protohistorike, një interes të veçantë paraqesin sistemet e tyre mbrojtëse (Koço, 1977-78). Këto kanë ekzistuar edhe në territorin e rajonit të Shkodrës, të evidentuara nga kërkimet arkeologjike në vendbanimin e Gajtanit. Gërmimet sistematike në këtë rajon kanë treguar se aty nga fundi i bronzit dhe fillimi i epokës së hekurit i ka fillimet edhe qyteza e Marshejt dhe vetë Shkodra (Koço, 1977-1978). Më vonë, gjatë periudhës së hekurit, urbanizimi në Iliri ishte mjaft i shprehur në shumë hapësira të saj dhe për rrjedhojë edhe në atë të Shkodrës. Vendbanimet e fortifikuara të krijuara në këtë fazë do të shërbenin si qendra të lulëzimit të qyteteve të ardhshme në këtë rajon. Gjurmët e këtyre periudhave shihen edhe në figurat (1, 2 dhe 3):



Fig 1. Muri i rrethimit Gajtan-Shkodër



Fig 2, 3. Muri i Hendekut të thatë dhe kalaja e Shkodrës  
Burimi: (Koço, 1977-1978)

Në thelb, Shkodra është e personifikuar me Kalanë e Rozafës, e cila me fortifikimin e saj ushtronte funksione ushtarake dhe mbrojtëse njëkohësisht. Në mesjetë dhe pas pushtimit osman do ruante këto funksione dhe me lulëzimin e Pazarit të Vjetër (*Bushati, 1998*) do të kishte kryesisht funksione tregtare.

**Në periudhën e Zogut** qytetet shqiptare dhe për rrjedhojë edhe Shkodra, në përgjithësi ruajtën elementet orientale otomane në arkitekturë e tipologji funksionale. Në disa qytete shfaqen edhe elemente moderne të arkitekturës italiane e austriake, ndikimi i të

cilave për Shkodrën ka qenë i madh, për shkak të lidhjeve të hershme tregtare me to. Funkzioni kryesor edhe në këtë periudhë mbeti ai tregtar. Vetëm në vitin 1937 qyteti dhe periferia e tij numëronin rreth 1305 njësi ekonomike (industriale, zejtare dhe tregtare), prej të cilave funksiononin 1225 njësi tregtare dhe artizanati (*Fishta, 2001*).

Gjatë periudhës së zbatimit të modelit të ekonomisë së planifikuar dhe në vazhdim, Shkodra ishte një nga qendrat më të rëndësishme të vendit tonë, konsideruar edhe si kryeqendra e Veriut të Shqipërisë (*Bashkia Shkodër, 2017*). Ajo funksiononte si pjesë e zinxhirit të të gjithë qendrave ekonomike në vend. Zona urbane, e përfaqësuar në rastin konkret nga qyteti i Shkodrës, u shndërrua në një hapësirë të rëndësishme ekonomike, duke marrë funksionet e një qendre ekonomike me zhvillim kompleks, proces ky që pushtoi gjithë jetën ekonomike të vendit (*Laçi, 2015*). Në këtë periudhë kemi ndryshime të tipologjisë funksionale edhe për sa u përket vendbanimeve rurale, të lidhura këto me ndryshimin e marrëdhënieve në prodhim dhe të konceptit mbi pronën. E gjithë hapësira rurale gjatë kësaj kohe u vu në dispozicion të bujqësisë, si në zonat fushore, kodrinore e malore të saj. Këto ndryshime ishin në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të sektorit primar, ku përparësi iu dha degës së bujqësisë. Në vitin 1990 Shkodra kishte 2 qytete (Shkodra e Kopliku), 29 fshatra të bashkuara dhe 190 fshatra. (*Vjetari Statistikor i Shqipërisë, 1991*). Po në këtë vit, popullsia banuese në qytete ishte 34.9% dhe popullsi rurale 65.1% (*Vjetari Statistikor i Shqipërisë 1991*).

Rrjeti i vendbanimeve rurale në rrethin e Shkodrës në këtë periudhë, si në të gjithë Shqipërinë, u zgjerua nëpërmjet këtyre rrugëve:

- Bonifikimit të tokave dhe sistemit të lumenjve në këtë hapësirë gjeografike. Lumenjtë malorë të Alpeve Perëndimore, Drini e Gjadri deri në vitin 1944 vërshonin në Ultësirën e Shkodrës

dhe përmbytnin sipërfaqe të mëdha toke. Prandaj një ndër masat e para të kësaj periudhe në aspekt të zhvillimeve infrastrukturore të bujqësisë shqiptare ishte bonifikimi dhe sistemimi i lumenjve, dhe në rastin konkret Drinit, Bunës, Gjadrit (*ASH, Qendra e Studimeve Gjeografike, 1991*), të cilët sollën si pasojë përqendrimin e vendbanimeve në këtë rajon rrëzë kodrave ose shpateve të tyre.

- Në rajonin e Shkodrës u krijuan edhe qendra të reja fshatare pas tërmetit të vitit 1979, lëkundjet e të cilit u ndjenë sidomos në zonën e rrjedhës së poshtme të lumit Buna. Vendbanimet rurale të Anës së Malit dhe të gjitha fshatrat nga Ura e “Bahçallëkut” e deri në Velipojë ishin ato që pësuan më tepër dëme nga kjo fatkeqësi natyrore.

### **3.2. Situata aktuale tipologjike e vendbanimeve në bashkinë e Shkodrës**

Qasjet bashkëkohore për studimin e kriterëve të tipizimit të vendbanimeve rurale dhe urbane janë bazuar në përdorimin e kriterëve të spektrit gjeografik-natyror e human. Ndërkohë përvoja botërore ka treguar se tipologjia më kuptimplote e klasifikimit të vendbanimeve është ajo e funksionit (*Petar, 2002*), përcaktuar kryesisht nga struktura ekonomike e tij, ku dominanca e një dege i jep funksionalitetin dhe fizionominë vendbanimit (*Laçi, 2005*). Vendbanimet urbane, duke qenë zonat kryesore të përqendrimeve të popullsisë, në përgjithësi kryejnë funksione thelbësore për një numër të madh popullsie, të lidhura me aktivitetet dytësore e terciare.

*Si paraqitet tipologjia aktuale e vendbanimeve në bashkinë e Shkodrës?*

Bazamenti historik ka pasur ndikim të fuqishëm në tipizimin funksional të vendbanimeve në rajonin e Shkodrës dhe ka lënë gjurmët e veta sot në shumë aspekte, pavarësisht ndryshimeve demografike dhe politikave të ndarjeve administrative në vite. Kjo hapësirë ka pasur një dinamikë zhvillimi dhe evolucion shumë


interesant, kushtëzuar jo vetëm nga veçoritë natyrore-geografike (relievi), por edhe ndryshimet demografike e funksionale në kohë e hapësirë. Ndryshimet tipologjike të dekadës së fundit janë të lidhura edhe me faktorin politik (*reformat e ndarjes administrative e territoriale*). Me reformën e ndarjes së re territoriale të vitit 2014, bashkia e Shkodrës pësoi ndryshime numerike të popullsisë dhe të vendbanimeve. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës, në masën rreth 55% të saj (*Bashkia Shkodër, 2017*). Sipas kësaj ndarjeje administrative, Shkodra ka 1 vendbanim urban dhe 92 vendbanime rurale (*Vendim i Kuvendi i RSh. 2014*).

### **Vendbanimet rurale**

Zonat rurale në përgjithësi mbulojnë një mori peizazhesh, aktiviteteve dhe funksionesh natyrore dhe kulturore, duke përfshirë jo vetëm fshatrat me zonat bujqësore, por edhe pyjet, parqe të ndryshme, si dhe shërbime të ndryshme (*Dorrell, 2019*). Ato përgjithësisht karakterizohen nga përdorimi i gjerë i tokës në favor të sektorit primar, dendësia e ulët e popullsisë, përdorimi i mjeteve të ngadalta dhe të vjetra të transportit dhe komunikimit, zhvillimi i dobët i sektorëve sekondarë e terciarë, mënyra tradicionale e jetesës, një frymë më e madhe e bashkëpunimit dhe mjedis më pak i ndotur (*Laçi, 2005*). Mbështetur në disa kritere të përcaktuara për të gjithë vendin tonë (*Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987*), do të realizojmë edhe tipologjinë e vendbanimeve në rajonin e Shkodrës:



## 1. Harta fizike e bashkisë së Shkodrës



a. Kriteri i parë i marrë në konsideratë për tipizimin e vendbanimeve rurale është ai i relievit, pra shpërndarja e vendbanimeve sipas niveleve hipsometrike (Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987). Kështu sipas këtij kriteri, bazuar te mozaiku i prezantimit morfografik të këtij komponenti natyror, dhe siç shihet edhe nga harta nr. 1 e relievit të kësaj bashkie, vendbanimet rurale në këtë njësi vendore i klasifikojmë:

*Burimi: Profili i bashkisë së Shkodrës, 2017*

### Vendbanime rurale në reliev fushor

Ky tip në përgjithësi karakterizohet nga dendësi e lartë e popullsisë dhe distancë e shkurtër midis tyre, që për gjithë vendin varion nga 2.7 km deri në 2.9 km (Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987). Gjeografikisht në rajonin e Shkodrës këto lloje fshatrash gjenden në Ultësirën e Nënshkodrës në lartësitë 0-100 m mbi nivelin e detit dhe pjesën më jugore të Ultësirës së Mbishkodrës (pjesa fushore e Nj/A Postribë). Sipas përlllogaritjeve, këtij niveli hipsometrik i

përkasin pjesa më e madhe e vendbanimeve rurale, në rreth **64.2%**<sup>1</sup> e totalit të përgjithshëm të tyre. Në këto vendbanime është përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë rurale, e lidhur me shtimin natyror të kësaj popullsie dhe veçanërisht me ardhjet masive nga eksodet rurale (specifikisht këtu, njësitë administrative në kufi me qytetin e Shkodrës).

### **Vendbanimet rurale në relief kodrinor**

Edhe këto vendbanime kanë popullsi të vogël në numër dhe distancë të shkurtër ndërmjet tyre. Gjeografikisht ato shtrihen në periferinë më lindore të Ultësirës së Nënshkodrës, ku janë prezent relievet kodrinore në lartësitë 100-300 m, përgjatë luginave lumore të Drinit, Kirit. Ky tip fshatrash në këto nivele hipsometrike përbën vetëm **7.6 %** (*Gjoni F. 2021*) të totalit të përgjithshëm të vendbanimeve rurale në këtë Bashki.

### **Vendbanimet rurale në relief malor**

Ky tip fshatrash përfshin një numër më të paktë vendbanimesh, gjeografikisht të shtrira në zonat malore të kësaj bashkie dhe që zënë rreth **28.2 %** të numrit të përgjithshëm të vendbanimeve rurale (*Gjoni, 2021*). Gjeografikisht ato shtrihen në relievet më të ulëta të shpateve të njësive malore të Alpeve Perëndimore, në rrjedhjet e mesme e të sipërme të Kirit, Shalës. Këto vendbanime karakterizohen nga një popullsi e vogël në numër, si rezultat i përfshirjes së popullatave të këtyre zonave në eksodet rurale, ardhur drejt zonave më të ulëta të rajonit të Shkodrës. Zonat malore në këtë bashki kanë pësuar deformime demografike në kah të kundërt, por jo shpopullime totale. Shpërndarjen e vendbanimeve rurale në zonat malore sipas niveleve hipsometrike

---

<sup>1</sup> Gjoni F. 2021. Përlllogaritja sipas niveleve hipsometrike të vendbanimeve në zonën e studimit

në këtë pjesë të njësisë vendore në studim e tregon edhe tabela nr. 1, si më poshtë vijon:

*Tabela 1: Shpërndarja e vendbanimeve sipas niveleve hipsometrike në relievet malore.*

Vendbanimet rurale malore sipas lartësisë	300-600 m	600-1000 m	Mbi 1000 m
26	15 fshatra	10 fshatra	1 fshat
<b>Në përqindje</b>	<b>57.6%</b>	<b>38.4 %</b>	<b>4%</b>

Burimi: (Gjoni F. 2021) Matje në hartë e hipsometrisë së vendbanimeve në NJ/A malore

**b.** Sipas kriterit të **veprimtarisë ekonomike**, vendbanimet rurale në bashkinë e Shkodrës i klasifikojmë në:


### **Vendbanime rurale me veprimtari bujqësore**

Këto vendbanime shtrihen në zonën fushore të kësaj bashkie dhe zënë vetëm 1/3 të tyre. Vitet e fundit vendbanimet e mirëfillta bujqësore janë pakësuar për shkak të zvogëlimit të sipërfaqes bujqësore dhe shndërrimit të saj në troje ndërtimi, si dhe lënia djerrë nga përfshirja e popullsisë së tyre në eksodet rurale apo migrimin e jashtëm. Ky tip vendbanimi në zonën e studimit ushtron aktivitet primar, krahas disa të tjerëve me peshë më të vogël. Toka pjellore e Nënshkodrës është aset natyror shumë i rëndësishme në favor të kultivimit të të gjitha kulturave bujqësore të hershme dhe të vonshme. Në këtë tip vendbanimi përfshihen fshatrat e NJ/A të *Ana Malit, Bërdicës, Dajcit, Gur i Zi, Postribës (pjesa fushore)*, të cilat zënë rreth **29.3%** të vendbanimeve rurale (Gjoni, 2021), me funksion kryesor bujqësor e blegtoral. Bujqësia në këto njësi dallohet për produktivitet të lartë dhe janë hapësirat që kanë pasur qëndrueshmëri zhvillimi gjatë gjithë tranzicionit, si në

aspekt demografik dhe ekonomik, tregues këta mjaft premtues edhe për të ardhmen.

## Vendbanime rurale me veprimtari të përzier

### 2. Harta e sistemeve territoriale




Në vazhdim të analizës mbi funksionalitetin e vendbanimeve të rajonit në studim, dhe bazuar në të dhënat e bashkisë së Shkodrës në lidhje me veprimtarinë e tyre ekonomike (*Profili i Bashkisë Shkodër, 2017*), në këtë tip aktualisht përfshihet pjesa më e madhe e vendbanimeve rurale. Ky tip fshatrash përfaqëson tipin kryesor të dy dekadave të fundit për vendin tonë në përgjithësi dhe rajonit në veçanti (Laçi, 2005). Në shumicën dërrmuese të

vendbanimeve rurale të bashkisë së Shkodrës, krahas funksioneve primare, ushtrohen edhe të tjera si: agroturizmi, funksioni mjedisor, industrial, turistik etj. Gjeografikisht ky tip fshatrash shtrihet në të tria nivelet hipsometrike (fushorë, kodrinor dhe malor) dhe përbën rreth **70.7%** të totalit të përgjithshëm të vendbanimeve rurale (Gjoni, 2021).


*Burimi: Bashkia Shkodër, 2017*

Në konkluzion të të gjithë kësaj analizë tipologjike funksionale rajonale të vendbanimeve rurale rezulton se: pjesët fushore e kësaj bashkie (Nj/A Dajç, Bërdicë, Ana e Malit, Guri i Zi), kanë kryesisht vartësi bujqësore; zonat rurale pranë qytetit të Shkodrës, e cila korrespondon me zonën periurbane, janë shumëfunksionale, fshatrat e (Nj/A Postrinë e Rrethina, Velipojë); vendbanimet rurale malore (Nj/A Pult, Shosh, Shalë) mbështeten te turizmi malor, krahas disa degëve të tjera tradicionale, pra veprimtari të përziera.

c. Vendbanimet rurale mund t'i tipizojmë edhe sipas **madhësisë demografike**. Eksodet rurale prekën fuqishëm edhe rajonin e Shkodrës, sidomos nga Alpet Perëndimore drejt pjesës fushore të tij, dhe nga zonat rurale drejt qytetit (Laçi, 2005). Pasojat demografike të lëvizjeve migratore të brendshme janë reflektuar te ndryshimet numerike në kah të kundërt te vendbanimet rurale, sidomos në fshatrat malore. Situata demografike sipas numrit dhe dendësisë së popullsisë bujqësore të njësive administrative të kësaj bashkie paraqiten në hartën nr.3 dhe nr.4, si më poshtë vijojnë:



Harta 3: Nr. i banorëve për Nj/A



Harta 4: Dendësia e popullsisë bujqësore sipas Nj/A<sup>1</sup>

Nga analiza e hartave respektive për numrin e banorëve dhe ajo e dendësisë së popullsisë bujqësore (hartat nr.1 dhe nr.2), konstatojmë që zonat rurale në periferi të qytetit të Shkodrës (Rrethina, Postriba), të cilat klasifikohen si periurbane (Laci, 2005), janë më të dendurat në aspekt demografik dhe nën ndikimin e fuqishëm të qendrës urbane, ndërkohë që njësitë malore (Pult, Shosh e Shalë) kanë dendësi të vogël të popullsisë bujqësore e numër të paktë të saj. Ky i fundit nuk është vetëm fenomen shqiptar, por një dukuri e përgjithshme mbarëbotërore, ku në përgjithësi vendbanimet rurale malore kanë pasur ndryshime në dimensionin demografik të tyre në vite (Darlaczi, 2014).

c. Duke pasur parasysh edhe përvojën botërore në klasifikimin e vendbanimeve rurale mund të bëjmë edhe një klasifikim tjetër, duke përdorur si kriter klasifikimi **formën, strukturën e brendshme dhe shtrirjen e tyre**. Nisur nga ky kriter, vendbanimet rurale mund të klasifikohen në katër tipa: *të grumbulluara, lineare dhe të shpërndara*. (Dorrell, ...., & Sullanami, 2019).

<sup>1</sup> Punuar nga as.prof. dr Medjon Hysenaj, Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Fotot janë marrë nga Google earth.



### Vendbanime rurale të grumbulluara

Ky tip vendbanimesh rurale përbën rreth 75% të numrit të përgjithshëm të vendbanimeve të zonës në studim (*Gjoni, 2021*), të cilat kanë pothuajse të njëjtën fizionomi organizimi dhe shtrirje

në formë dhe strukturë me qendrën e fshatit (në rastin shqiptar përputhet me qendrën e ish-kooperativës bujqësore), dhe rreth saj ndërtesat për banim e sipërfaqet e tokës në shërbim të bujqësisë. Në pjesën qendrore të vendbanimit janë të përqendruara disa ndërtesa publike, kryesisht me natyrë tregtare apo shërbime të tjera, shkolla dhe objektet e kultit. Gjeografikisht, në këtë bashki, këto vendbanime me këtë fizionomi shtrirjeje, janë në zonën e mirëfilltë fushore, në brigjet lumore dhe më pak në depresionet kodrinore-malore të kësaj hapësire (qendrat e njësjive administrative).

### Vendbanime rurale lineare



Forma lineare e tyre është e lidhur me shtrirjen e ndërtesave përgjatë një rruge, lumi, dige ose bregu detar. Me këtë fizionomi shtrirjeje na vijmë një pjesë e vendbanimeve rurale të kësaj bashkie në të tria nivelet hipsometrike (fushore,

kodrinore e malore). Në këtë tip futen një pjesë e madhe e fshatrave që janë edhe në tipin e grumbulluar, edhe atë të shpërndarë, sepse janë buzë një rruge apo lumi. Analiza e vendbanimeve të këtij tipi kërkon studime më të detajuara, me shpresën që në botime të tjera ne të japim kontributin tonë.

## Vendbanime rurale të shpërndara



Ky tip vendbanimesh rurale është në kontrast të plotë me vendbanimet e grumbulluara apo lineare dhe zënë rreth 25% të totalit të përgjithshëm të vendbanimeve në rajonin e Shkodrës. Gjeografikisht ato shtrihen në relievet malore dhe zënë numrin më të madh të fshatrave në këto nivele hipsometrike. Popullsia në to ruan në shumë aspekte tiparet tradicionale në ndërtimin e banesave, veshje, tradita dhe zakone. Këtu gjejmë tipin e banesës kullë, në përshtatje këto me kushtet fiziko-natyrore dhe rrethanat historiko-shoqërore të zonës. (Laçi, 2006). Përmirësimet infrastrukturore, sidomos ato rrugore, kanë ndikuar vitet e fundit në ruajtjen momentale të treguesve demografikë dhe ka stimuluar zhvillimin të atyre degëve për të cilët ata kanë traditë historike (blegtori e sot turizëm malor të gjelbër). Shembuj konkretë i gjejmë sot në fshatrat e njësisë vendore të Shalës, në të cilën ndërtimi i rrugës që lidh Shkodrën me Thethin i ka dhënë rezultatet e veta në shumë aspekte të zhvillimit ekonomik të tyre, sidomos të degës së turizmit, por edhe demografik me rikthimin e popullatave drejt tyre.

## Vendbanime të izoluar rurale sezonale



Këto vendbanime janë të pakta në rajonin e Shkodrës, me shtrirje gjeografike në lartësitë e mëdha malore, aty ky bjeshkëzimi si aktivitet është ushtruar




tradicionalisht dhe dega e blegtorisë është dominante. Ka ardhur koha që edhe për vendin tonë vendbanimet stinore blegtorale (stanet) (Laçi, 2006) të konsiderohen si tip më vete. E theksoj këtë, nisur nga vëmendja që po i jepet sot aplikimit të fenomenit të transhumancës (bjeshkëzimit) në zonat malore të vendit tonë. Ky tip vendbanimesh mund të rritet në të ardhmen, pasi hapësira në studim ka kushte natyrore dhe humane të përshtatshme për ushtrimin e këtij transhumancës.

*Po tipologjia e qytetit të Shkodrës si paraqitet?*

Qytetet evoluojnë në simbiozë me zhvillimet infrastrukturore, lëvizjet e popullsisë dhe ndryshimet funksionale të tyre. Vendbanimet urbane në vendin tonë janë më të pakta në numër, por më të rëndësishmet në aspektin ekonomik dhe atë të përqendrimeve të popullsisë. Tipizimi i tyre në vendin tonë është bërë duke pasur në konsideratë disa kritere: kohën e ndërtimit, gjeografik-natyror (relievin) dhe ato funksionale (*Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987*). Bashkia e Shkodrës me ndarjen e re administrative, përbëhet vetëm nga një vendbanim urban, qyteti i Shkodrës.

Ndryshimet e qytetit të Shkodrës gjatë tranzicionit janë në shumë aspekte: strukturore të popullsisë me trende pozitive të zhvillimit demografik; funksionale, bazuar te pesha e tre sektorëve në ekonominë e saj; në aspekt morfologjik, lidhur me zgjerimin që ka pësuar qyteti në këto tri dekada të tranzicionit. Këto ndryshime shumëpërmasore të të gjithë tranzicionit demografik e ekonomik, synojnë të japin edhe grafikët (1 dhe 2, aspekti funksional), (3 dhe 4, struktura e popullsisë sipas vendbanimit) dhe (harta nr. 5, aspekti morfologjik), si më poshtë vijojnë:

Grafiku 1. 2: Ndryshimet **funksionale** në vite



Burimi: Gjoni F. (2014)

Grafiku 3 dhe 4: Ndryshimet **strukture** të popullsisë (popullsia sipas vendbanimit)



Burimi: Profili i Bashkisë Shkodër (2017)

Harta 5. Ndryshime **morfologjike të qytetit** (shtrirja jashtë vijës së verdhë)  
Burimi: Bashkia e Shkodrës (2017)



Harta tregon dinamizmin e shtrirjes në vite të qytetit të Shkodrës dhe në mënyrë të veçantë të periudhës së tranzicionit, ku qytetit i janë shtuar vendbanimet joformale në pjesën e jashtme të tij, duke pësuar zgjerim në aspekt morfologjik (ngjyra rozë e lehtë). Këto pjesë të qytetit janë tokat më pak të dëshirueshme, ku është e përqendruar kryesisht popullsia e shpërngulur nga eksodet rurale, por njëherësh dhe më me shumë problematika.

Duke pasur parasysh kriteret e tipizimit të vendbanimeve urbane, qytetin e Shkodrës e klasifikojmë në këta tipa:

➤ Sipas **kohës së ndërtimit** Shkodra klasifikohet (*Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987*):

- a. *Qytet antik (Scutari);*
- b. *Qytet kështjellë (Kalaja e Rozafës);*

c. *Qytet tregtar në Mesjetë.*

➤ Sipas **shtrirjes gjeografike**, me shtrirje buzë liqenit dhe në një terren të sheshtë, klasifikohet (*Misja, Vejsiu, Bërxfholi, 1987*) si:

a. *Qytet fushor*

➤ Sipas **funksionit** Shkodra klasifikohet si qytet **shumë-funksional** (*qendër administrative, industriale, bujqësore, kulturore, arsimore, shëndetësore, turistike, etj.*) (*Misja, Vejsiu, Bërxfholi 1987*).

Tipologjia shumëfunktionale e qytetit të Shkodrës ndikon në shndërrimin e saj në qendër policentrike në lidhje me hapësirat rurale përreth, duke qenë kështu premisë për zhvillim e qëndrueshëm të tij edhe në të ardhmen. Shkodra, me pozicionimin gjeografik të saj, ka një rol të rëndësishëm edhe në bashkëpunimet ndërkuftare, sidomos me trevat shqiptare në Mal të Zi, ku lidhjet komunikative midis tyre kanë qenë e janë historike. Intensifikimi i këtyre bashkëpunimeve në disa aspekte specifike, do të ndikojë në evoluimin e tipologjisë funksionale dhe zhvillimin shumëpërmasor të Shkodrës, me kontribute jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe atë rajonal.

### **Përfundime e rekomandime**

Analiza historike e tipologjisë së vendbanimeve në rajonin e Shkodrës evidenton ndryshime të mëdha, kryesisht të karakterit funksional, ku çdo epokë historike ka lënë gjurmët e veta në këtë proces dhe ka krijuar një fizionomi tipologjie specifike. Tipologjia e vendbanimeve në zonën e marrë në studim ka pasur evolucionin e saj, krijuar mbi një origjinë shumë të hershme të popullimit dhe të krijimit të vendbanimeve të para, sidomos jo për qytetin.

Tranzicioni demografik dhe ekonomik me dinamizmin e tij në këto tri dekadat e fundit ka lënë gjurmë të mëdha në tipizimin e vendbanimeve në përgjithësi në rajon, duke krijuar një tipologji komplekse të tyre. Ky kompleksitet tipologjik është i lidhur me veçoritë gjeografike-natyrore të bashkisë së Shkodrës, lëvizjet

migratore të brendshme (eksodet rurale), ndryshimet në strukturën ekonomike të rajonit dhe ndarjet administrative të tranzicionit, të cilat kanë shërbyer edhe si kritere për tipizimin e vendbanimeve rurale e urbane.

Struktura ekonomike ka përcaktuar llojin funksional të vendbanimeve. Tipologjia funksionale e vendbanimeve rurale aktualisht tregon për dominimin e tipit të vendbanimeve me veprimtari të përziera, ku krahas aktiviteteve primare janë edhe ato industriale, turistike e agroturistike etj. Ky tip, që korrespondon kryesisht me zonën periurbane (hapësirat përreth qytetit, Rrethina, Postriba, Guri i Zi), do të ketë trend rritës në rajonin e Shkodrës edhe në të ardhmen, me premisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e demografik të tyre.

Analizat dhe studimet e aspektit tipologjik në nivel rajonal, na ndihmojnë në arritjen e konkluzioneve të rëndësishme për zhvillimet e ardhshme të vendbanimeve. Gjithashtu ato tregojnë për trendin e rritjes së popullsisë të njërive vendore të këtij rajoni, ku qartësisht shihet që pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në qytet, tregues i qartë i një niveli urbanizimi në rritje në këtë njësi vendore. Kjo rritje urbane ka çuar në shtimin e qytetit dhe krijimin e zonave suburbane të tipave të ndryshëm.

Një tipologji e bazuar në kritere të caktuara dhe në tregues konkret, mund të shërbejë si bazë edhe për hartimin e politikave specifike hapësinore, bazuar në marrëdhëniet funksionale midis vendbanimeve urbane e atyre rurale dhe anasjelltas. Analiza të tilla i ndihmojnë politikëbërësit në planifikimet infrastrukurore, investimeve, përdorimit sa më racional të tokës urbane e rurale dhe një planifikimi mjedisor të tyre.

## Literatura

Akademia e Shkencave të RSH, (1991), "Gjeografia Fizike e Shqipërisë," *Qendra e Studimeve Gjeografike, Pjesa e II, f. 474.*

Bashkia Shkodër, (2017) Plani i zhvillimit të territorit 2340. Pdf, Harta e ndarjes në zona dhe njësi 2338. pdf. f. 125  
<https://bashkiashkoder.gov.al/web/sistemmet/1944.pdf>

Bushati, H., (1998) "Shkodra dhe motet" Traditë, Ngjarje, Njerëz.

Dorrell, D., Henderson, J., Lindley, T., Connor, G., Parson, C., & Sullanami, A., (2019). "Introduction to Human Geography" (2nd Edition) *University sistem of Geografia*. f. 237-257. <https://oer.galileo.usg.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1002&context=geo-textbooks>

Darlagzi, T., (2014). "The typology of settlements in Bargau district (Romania)". *Geographic Timisiensis, Vol, XXIII, nr.2, f. 65*.  
<https://www.academia.edu/65308292/>

Gjoni, F., (2014), Doktoratura me titull "Roli i sektorit terciar në ekonominë e rrethit të Shkodrës", *Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë*, f. 106.

Human Settlements. (2007), "Fundamentals of Human Geography". *Textbook for Class 12. National Council of Educational Research and Training Në Delhi, NCERT*. f. 92. [https://www.chahalacademy.com/admin\\_theme/book\\_file/Fundamentals%20of%20Human%20Geography-Class-XII.pdf](https://www.chahalacademy.com/admin_theme/book_file/Fundamentals%20of%20Human%20Geography-Class-XII.pdf)

Ibrahim, N., Ayoob, I., (2011) "Spatial Distribution Pattern of Rural Settlement in Shaqlaëa District Kurdistan Region", *Paper Reference No: Pn-21, Theme: Empowering National thought Geospatial* f. 7.  
<https://www.academia.edu/551285/>

Iljaz, F., Shkurt (2001) "Historia e Dhomës së Tregtisë e Industrisë Shkodër". f. 50

INSTAT, (2014). "Një klasifikim urban -rural i popullsisë së shqiptare, Tipologjia gjeografike e BE-së e bazuar në të dhënat e rrejtësive të qelizave" pdf. f. 11 [http://www.instat.gov.al/media/2817/nj\\_klasifikim\\_i\\_ri\\_rural-urban\\_i\\_popullsis\\_shqiptare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/2817/nj_klasifikim_i_ri_rural-urban_i_popullsis_shqiptare.pdf)

Koço, Zh., (1977 -1978) "Mbi tipologjinë e vendbanimeve të fortifikuara paraurbane ilire në territorin e Shqipërisë", *Nr. 7-8 Iliria.*, f. 13, 114, 120.  
[https://www.persee.fr/doc/iliri\\_1727-2548\\_1977\\_num\\_7\\_1\\_1277](https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1977_num_7_1_1277)

Laçi, S., Tiranë (2005), "Gjeografia Rurale", *Shtëpia botuese "Progres"*, f. 22, 26, 27, 290

Laçi, S., Tiranë (2006), "Gjeografia e Kosovës dhe trevave shqiptare jashtë RSH". *Shtëpia botuese "Progres" ISBN:99943-824-4-6*, f. 101-102

Laçi, S., Tiranë (2015), "Gjeografia Humane e Shqipërisë", *Shtëpia botuese "Lilo"*, ISBN: 978-9928-149-27-5, f. 104

Kuvendi i RSh. (2014), Ligj 115 pdf, faqe 24. <https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018>

Misja, Vejsiu, Bërxfholi (1987), "Popullsia e Shqipërisë" *Studim demografik, Universiteti i Tiranës*, f. 154-164

Profili i bashkisë 2703. (2017). pdf, f. 5. [https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/profili\\_i\\_bashkise\\_2703.pdf](https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/profili_i_bashkise_2703.pdf)

Petar, M., Ljiljana, V., Ivana, B., Milena, D., (2002) "Functional and size tipology of the village settlement in the city of Niš territory" *Facta Universitatis Series: AArchitecture and Civil Engineering Vol. 2, No 4, 200*, f. 232. <https://www.researchgate.net/publication/47393659>

Vjetari statistikor i Shqipërisë, Tiranë 1991. f. 12

Vít Rýpar, (2014). "Rurality- Character of rural settlements", *University in Prague*. f. 4 <https://www.researchgate.net/publication/282974995>

**Dr. Ermiona Braholli<sup>1</sup>**

## **KUSHTET NATYRORE DHE HISTORIA E KRIJIMIT TË VENDBANIMEVE RURALE NË PELLGUN MË TË SIPËRM UJËMBLEDHËS TË DEVOLLIT**

### **Abstrakt**

Pellgu më i sipërm ujëmbledhës i Devollit përfaqëson një hapësirë gjeografike tërësisht malore. Pozicionohet në juglindje të Shqipërisë, në jug të bashkisë së Bilishtit, përgjatë kufirit me shtetin grek. Zona është e pasur me burime ujore, me materiale ndërtimi dhe me shumëllojshmëri të bimëve dhe kafshëve. Në zonë gjenden pesë vendbanime rurale (fshatra) me histori të gjatë krijimi, e shprehur në arkitekturën e ndërtimeve popullore dhe kulinari. Në kushtet e sotme të ndryshimeve të shpejta ekonomike, sociale dhe kulturore është e domosdoshme të studiohen dhe analizohen drejtimet e zhvillimit në hapësirat rurale malore. Fshatrat Dardhë, Arrëz, Nikolicë, Sinicë dhe Qytezë karakterizohen nga emigrimet e popullsisë, nga shtesa natyrore e ulët, nga mbizotërimi i sektorit të parë të ekonomisë dhe nivelet e ulëta të të ardhurave. Në studim do të përdoret analiza SËOT dhe TOËS. Analiza SËOT mundëson evidentimin e pikave të forta, të dobëta, të mundësive dhe kërcënimeve që kanë vendbanimet rurale. Rezultatet e SËOT-it do të përfshihen në analizën strategjike dhe analitike TOËS, e cila ndihmon në identifikimin e marrëdhënieve midis faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Studimi nxjerr në pah rëndësinë e resurseve natyrore në zhvillimin e blegtorisë, turizmit dhe kulinarisë, si aktivitetet më me perspektivë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

***Fjalë çelës:** vendbanime rurale, kushte natyrore, popullim, analiza SËOT, analiza TOËS.*

---

<sup>1</sup> Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Histori-Gjeografisë, E-mail: ermiona.braholli@yahoo.com



### Abstract

The source of Devolli River is a mountain area. It is located on the southeast of Albania, in the south of Bilisht Municipality, on the border with Greece. The territory is full of springs and rich biodiversity. In the area are located five rural settlements with a long human history, expressed on the traditional buildings and gastronomy. The study of rural settlements is a necessity in the conditions of today's economic, social and environmental development. The village of Dardha, Arrëza, Nikolica, Sinica and Qyteza are characterized by population emigration, low natural increase, the predominance of the first sector of the economy and low-income levels. SWOT and TOWS analysis will be used in the study. The SWOT analysis enables the identification of strengths, weaknesses, opportunities and threats that rural settlements have. The SWOT results will be included in the strategic and analytical analysis (TOWS analysis), which helps to identify the relationships between external and internal factors. The study highlights the importance of natural resources in the development of livestock, tourism and culinary, as the most promising activities in the sustainable development of the area.

*Keywords:* rural settlement, natural conditions, historical development, population.

### I. Hyrja

Vendbanimet rurale janë hapësira gjeografike me dendësi të vogël banesash dhe popullsie, me zhvillim të dobët infrastrukturor dhe me dominim të aktiviteteve bujqësore, blegtorale, pylltarisë, bletarisë etj. Shqipëria është një vend i vogël, por me mbi 3 000 vendbanime rurale (fshatra). Në vazhdimësi janë bërë përpjekje për t'i kategorizuar vendbanimet rurale sipas lartësisë hipsometrike, shtrirjes hapësinore, mënyrës së organizimit dhe menazhimit të tyre (Laçi et al. 2014). Në terminologjinë shkencore shqiptare njihen fshatrat fushorë, kodrinorë dhe malorë; fshatrat e grumbulluar e të shpërndarë; me shtrirje gjatësore, rrethore apo të çrregullt; të menazhuar nga njësitë administrative dhe bashkitë e reja (Ligji 115/2014).

Ndryshimet politike në vitet '90 sollën ndryshime të mënyrës së organizimit, menazhimit dhe përdorimit të vendbanimeve rurale. Ligji 7501 i privatizimit të tokës (Vendime, 1991) dhe lejimi i lëvizjes

hapësinore të popullsisë ndikuan në ndryshimet demografike, në aktivitetet ekonomike dhe peizazhin e zonave rurale. Shpopullimi, plakja e popullsisë, mbyllja e shkollave, shpyllëzimi, bujqësia ekstensive, infrastruktura e dobët, braktisja institucionale etj., janë fenomene që shoqërojnë fshatrat malore në Shqipëri.

Në kuadër të problematikave të mësipërme, ky studim është përqendruar në vendbanimet rurale në pellgun më të sipërm ujëmbledhës të lumit Devoll. Nëpërmjet programit kompjuterik ArcGIS 10.1 janë krijuar harta në të cilat evidentohen veçoritë natyrore që kanë ndikuar në krijimin, organizimin dhe vazhdimësinë e vendbanimeve. Në studim do të analizohet pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, hidrografia, tokat dhe bimësia, si elemente të rëndësishme të morfologjisë dhe strukturimit të fshatrave të zonës. Nëpërmjet analizës SËOT dhe TOËS do të evidentohen lidhjet e varësisë midis pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve që kanë fshatrat Dardhë, Arrëz, Nikolicë, Qytezë dhe Sinicë.


## II. Hapësira e studimit

Pellgu më i sipërm ujëmbledhës i Devollit gjendet në shpatin juglindor të vargut malor të Moravës (*Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1990*). Gjeografikisht pozicionohet në lindje të Krahinës Juglindore të Shqipërisë, në kufi me shtetin grek. Zona përfaqëson një unitet natyror të shprehur në peizazhin rural të saj. Tektonikisht, relievi malor është krijuar mbi depozitimet e zonës së Mirditës dhe të Ultësirës Albano-Thesaliane (*Xhomo et al., 2002; Pashko, 2018*). Nga studimi i hartës gjeologjike 1:200 000 evidentohet se fshati Dardhë dhe Nikolicë janë të vendosur mbi depozitime të oligocenit të mesëm (Pg<sup>32</sup>), ndërsa fshatrat Arrëz, Sinicë dhe Qytezë janë vendosur mbi depozitime të burdiganianit (N<sup>1b</sup>) (Harta 1).

Dominojnë shkëmbinjtë sedimentarë, kryesisht copëzorë të çimentuar, shkëmbinjtë gëlqerorë dhe më pak prezentë shkëmbinjtë magmatikë. Gurët gëlqerorë dhe magmatikë janë përdorur nga banorët e fshatrave për të krijuar banesat fshatare (në mure dhe në çati), në ndërtimin e urave të gurta dhe në shtrimin e rrugëve brenda fshatrave (kalldrëmet).

Duke qenë se hapësira e studimit shtrihet nga lartësia 1050 m në 2041.9 m (maja e Badaroshës), fshatrat konsiderohen malore. Fshati Dardhë shtrihet në lartësinë 1300 m, fshati Nikolicë në lartësinë 1230 m, fshati Arrëz në lartësinë 1120 m, fshati Sinicë në lartësinë 1060 m dhe fshati Qytezë në lartësinë 1060 m (*bazuar në hartat topografike 1:25 000*) (harta 2). Vija ujëndarëse e pellgut më të sipërm ujëmbledhës të lumit Devoll kalon në kreshtat e malit të Prokoniatit, Malit të Gropës, Malit të Bigllës, Malit të Kuq, malit të Badaroshës, Gurit të Sulejmanit dhe Malit të Djegur (harta 2). Malet e mësipërme ndahen nga njëri-tjetri nga përrenj, degë të majta dhe të djathta të lumit Devoll, të cilët kontribuojnë në formimin e rrjedhjes kryesore të lumit.

## 2. Harta 1. Harta gjeologjike e pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit




Burimi: Referuar Hartës gjeologjike të Shqipërisë të shkallës 1:200 000, e vitit 2002, Punoi: Ermiona Braholli, ArcGIS 10.1, 2021.

Kjo pjesë e pellgut ujëmbledhës të Devollit është e pasur me burime ujore, përrenj, ujëvara dhe liqene akullnajore. Lumi Devoll buron në një cirk akullnajor në rrëzë të malit të Badaroshës (*Qiriazi, 2001; Qiriazi, 2011*). Pasi kalon nga gryka e Përroit të Madh bashkohet me degë të majta (përroi i Thatë, i Grykës, i Telës, i Valës, i Dardhës dhe i Konacit) dhe me degë të djathta (përroi i Sulit, i Fiçishtit, i Zakës, i Izvorit, i Gollomboçit dhe i Qilarit), për të formuar pranë fshatit Miras luginën e mirëfilltë të Devollit.

Përgjatë shtratit të rrjedhjes së përroit të Dardhës gjenden dy ujëvara (Vala e Madhe dhe Vala e Vogël) me vlera kulturore, estetike dhe shpirtërore për popullsinë lokale dhe rajonale (*Braholli, et al. 2021*). Në Malin e Kuq (mali i Llofkës) gjendet 1 liqen

akullnajor dhe gjurmët e dy liqeneve të tjera akullnajore. Burimi ujor i Devollit, Uji i Qelbur dhe Çezma me Gozhdë kanë vlera ekonomike, shëndetësore dhe gjeoturistike për zonën. Ujërat e burimit të Kiço Telës janë përdorur si lëndë e parë për prodhimin industrial të pijeve energjetike (Dardha Water) me treg rajonal dhe kombëtar. Në rrjedhjen kryesore të Devollit janë ndërtuar dy hidrocentrale të vogla (hidrocentrali i Nikolicës dhe i Qytezës), që janë përfshirë në rrjetin kryesor energjetik të Shqipërisë.

Harta 2. Harta fizike e pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit



Burimi: Referuar hartave topografike 1:25 000, K-34-126-B-c; K-34-126-B-d; K-34-126-D-a; K-34-126-D-b; Punoi: Ermiona Braholli, ArcGIS 10.1, 2021.

Në rrjedhjen më të sipërme të lumit të Devollit mbizotëron klima mesdhetare malore, me temperaturë mesatare vjetore 9-10°C (IGJEU, 2020). Në përgjithësi dimri është i ftohtë e i gjatë dhe

vera e shkurtër, e freskët. Mesatarisht ka rreth 40 ditë/ vit borë, të përqendruara në periudhën e ftohtë të vitit. Reshjet e shumta të borës në ditë të veçanta bllokojnë rrugët e fshatrave, ndërpresin aktivitetin bujqësor, por nxisin lëvizjet turistike në zonë.

Mbizotëruese janë tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore (*Gjoka, 2012*). Tokat e mësipërme janë të mbuluara nga bimësi të katit të dushqeve, ahut dhe bimësitë barishtore të kullotave alpine. Nuk mungojnë bimët mjekësore dhe aromatike si: çaji i malit, dredhëzat, rigoni, salepi, trëndafili i egër, dardha e egër etj. Tokat aluvionale janë të përqendruara gjatë rrjedhjes kryesore të lumit Devoll, të cilat kanë përdorim ekstensiv bujqësor. Zona ka një botë shtazore të shumëllojtë, të përfaqësuar nga ujku, dhelpra, lepuri i egër, derri i egër, ketri etj.

Pjesë të biodiversitetit janë përfshirë në kategoritë e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë. Në fshatin Dardhë ndodhet Bredhi i Vishnjës, me moshë mbi 100-vjeçare, i cili është pjesë e biomonumenteve të Shqipërisë (*Qiriazhi & Sala, 2006*). Dushkaja e Dobërgorës në fshatin Arrëz është një pyll dushku i mbrojtur për vlerat shkencore, ekologjike dhe shpirtërore. Fshati Nikolicë e pyjet përreth janë përfshirë në *kategorinë V* të Zonave të Mbrojtura (*Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave, 1997; Qiriazhi, 2020*). Litologjia, relievi malor, pasuria ujore, tokat dhe biodiversiteti kanë mundësuar krijimin e vendbanimeve të hershme dhe vazhdimësinë e tyre deri në ditët e sotme.

### **III. Historiku i vendbanimeve rurale në rrjedhën më të sipërme të Devollit**

Vendbanimet rurale të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit janë Nikolica, Dardha, Arrëza, Sinica dhe Qyteza. Me ndarjen e re administrative-territoriale fshati Dardhë bën pjesë në njësinë administrative të Drenovës (bashkia Korçë), ndërsa Nikolica, Arrëza, Sinica dhe Qyteza janë pjesë e njësisë

administrative Miras (*bashkia Bilisht; Fletore Zyrtare, 2014*). Largësia nga qyteti i Korçës dhe i Bilishtit shkon deri në 20 km. Fshatrat janë pothuajse të baraslarguar, me një distancë 4-5 km, dhe konsiderohen si fshatrat më të sipërme të bashkisë Devoll dhe kjo lidhet me rrjedhjen më të sipërme të lumit homonim. Fshatrat lidhen midis tyre me rrugë automobilistike të paasfaltuara dhe me rrugë këmbësore. Banorët e fshatrave kanë lidhje fisnore, martesore dhe shoqërore me njëri-tjetrin.

Lidhjet dhe komunikimet midis fshatrave dhe qendrave urbane kanë qenë të pandërprera. Zona njihet për popullimin e hershëm, e dëshmuar kjo nga gjetjet spontane të objekteve arkeologjike. Një nga fshatrat me dëshmi më të hershme është Sinica. Sipas arkeologut Skënder Aliu, në Senishtë janë gjendur disa objekte zbukurimi për gra që i përkasin shekullit VII-VI p.e.s. Fshati Sinicë shtrihet në dy anët e rrjedhjes së mesme të përroit të Dardhës. Sinica ka ndërtime tradicionale 2-3 katëshe, të mbuluara me rrasa guri (plloça). Mbas vitit 1990 popullsia ka pasur tendencë të largohet në fshatrat fushore të Korçës, në Ultësirën Perëndimore ose të emigrojë ndërkombëtarisht. Aktualisht, në fshatin Sinicë jetojnë rreth 81 banorë (*Zyra e Gjendjes Civile, 2017*) të angazhuar në bujqësi dhe blegtori.

Fshati me numrin më të madh të popullsisë është Arrëza, me 677 banorë në vitin 2017. Dëshmitë e para për fshatin Arrëz vijnë nga shekulli XVI (*Seferi, 2017*). Pushtimi i trojeve shqiptare nga Perandoria Osmane imponoi ndryshimin e besimit fetar për një pjesë të popullsisë. Banorët që nuk pranuan shndërrimin në myslimanë u detyruan të largoheshin dhe u vendosën në një territor më të pyllëzuar (në shpatin lindor të malit të Moravës), duke krijuar vendbanimin e ri të Dardhës. Fshati Dardhë u zgjerua nga të ardhurit e fshatrave Drenovë, Hoçisht etj., që vazhdonin të ruanin besimin ortodoks. Në vitin 2017, Dardha rezultoi me rreth

124 banorë, nga të cilët vetëm 1/5 jetojnë në fshat gjatë të gjithë vitit kalendarik.

Fshati Arrëz numrin më të lartë të popullsisë e pati gjatë fundit të regjimit komunist, si efekt i zbatimit të politikave pronataliste dhe ndalimit të lëvizjeve hapësinore të popullsisë. Fshati është i shtrirë në të dyja anët e rrjedhjes kryesore të Devollit, aty ku lumi merr një zgjerim (*Qiriazhi, 1982*). Fshati është i ndarë në lagje (fise) me lidhje farefisnore midis tyre. Pjesa më e madhe e banorëve që jetojnë në fshat merren me blegtori, bujqësi, bletari dhe pylltari. Arrëza është fshati i vetëm në zonë me shkollën 9-vjeçare “Selami Kodra”. Ndryshe nga Arrëza, fshati Dardhë ka numëruar numrin më të lartë të popullsisë rreth fillimit të shekullit XX. Rënia e numrit të popullsisë lidhet me emigrimet drejt Amerikës së shumë dardharëve, të cilët ishin të arsimuar dhe të kulturuar. Në dekadat e fundit, Dardha është kthyer në një fshat pritës për turistët kombëtare dhe ndërkombëtarë. Shërbimi në hotele, në shtëpi pritëse dhe në restorante është aktiviteti kryesor i banorëve të fshatit.

Fshati Nikolicë është vendbanimi rural më i thellë në zonë me rreth 26 banorë (*Zyra e Gjendjes Civile, 2017*). Dëshmitë e para për vendbanimin vijnë që nga shekulli X, ku Nikolica njihej si qendër episkopale. Në shekullin XV ishte një qytetërim me rëndësi tregtare. Udha e Karvanëve lidhte Voskopojën me Kosturin (Greqi). Fshati është pothuajse i braktisur, me 2-3 familje të përhershme që kryejnë punë bujqësore dhe blegtorale. Banesat e gurta janë njëkatëshe, me çati dhe me oborre të përparme.

Të dhënat historike për Qytezën janë të pakta. Qyteza njihet për rëndësinë e madhe në edukimin e popullsisë, ku në vitin 1889 është hapur shkolla e parë në Devoll (*Larti, 1999*). Fshati i gurtë shtrihet përgjatë përroit të Gollomboçit, me banesa të ruajtura mirë. Në vitin 2017 fshati Qytezë numëronte 72 banorë. Ndër vite



ka pasur rënie të numrit të popullsisë dhe kjo lidhet me numrin e lartë të emigrimeve brenda dhe jashtë vendit.

Të pesta fshatrat e pellgut më të sipërm ujëmbledhës të lumit Devoll janë përfshirë nga fenomeni i plakjes së popullsisë si rezultat i emigrimeve, rënies së numrit të lindjeve dhe rritjes së numrit të vdekjeve. Duke veçuar fshatin Arrëz, në të gjitha fshatrat e tjera dominon mosha e tretë e popullsisë, e cila vazhdon të merret me blegtori, bujqësi, bletari dhe pylltari. Si rezultat i rënies së numrit të lindjeve dhe për rrjedhojë i numrit të fëmijëve, janë mbyllur shkollat në fshatrat Nikolicë, Qytezë, Sinicë dhe Dardhë, por rrezikohet mbyllja edhe në fshatin Arrëz. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga infermierët në fshatrat Arrëz dhe Dardhë.

Fshatrat Arrëz, Dardhë dhe Nikolicë janë përfshirë në projektin e “100 fshatrave” turistikë. Prej disa vitesh janë duke u zbatuar projektet e asfaltimit të rrugëve rurale, krijimit të rrjetit të ujërave të përdorura dhe përmirësimit të shërbimit në energji elektrike. Zona ka potenciale për zhvillimin e turizmit të bardhë dhe sportit të skijimit.



Foto: A-fshati Dardhë, B-fshati Nikolicë, C-fshati Arrëz dhe D-fshati Qytezë.  
Burimi: Ermiona Braholli, 2021

#### IV. Metoda

Studimet zonale janë qasje induktive që çojnë në përgjithësimin e fenomenit. Nëpërmjet vizitave në terren, bisedave me banorët e zonës, shfletimit të literaturës shkencore, përdorimit të programit ArcGIS 10.1 janë realizuar interpretime shkencore rreth zonës. Rezultatet më reale në studim do të vijnë nga analiza e pikave më të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të vendbanimeve rurale në pellgun më të sipërm ujëmbledhës të Devollit. Rezultatet e analizës SËOT do të përfshihen në analizën strategjike dhe analitike (analiza TOËS), e cila ndihmon në identifikimin e marrëdhënieve midis pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe

kërcënimeve. Sipas Božac (2008), TOËS-i është një variacion i analizës SWOT që identifikon një sërë faktorësh dhe i sjell ata të ndërlydhur me njëri-tjetrin. Analiza TOËS përbëhet nga katër strategji kryesore:

1. Maxi-maxi (SO)-një kombinim i pikave të forta me mundësitë, ku shpjegohet se si pikat e forta mund të përdoren për të arritur mundësitë;
2. Maxi-mini (ST)-një kombinim i pikave të forta me dobësitë, sipas së cilës pikat e forta përdoren për të minimizuar dobësitë;
3. Mini-maxi (WO)-një kombinim i dobësive me mundësitë, ku është e rëndësishme të kalohen dobësitë për të arritur mundësitë;
4. Mini-mini (WT)-një kombinim i pikave të dobëta me kërcënimet, ku qëllimi është të minimizohen dobësitë dhe të anashkalohen kërcënimet.

Analiza SWOT dhe TOWS do të ndihmojë në menazhimin strategjik në fshatin Dardhë, Arrëz, Nikolicë, Sinicë e Qytezë, duke identifikuar dhe përdorur potencialet natyrore dhe humane në kuadër të zhvillimit ekonomik, social dhe mbrojtjes mjedisore të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit.

## V. Rezultatet dhe diskutimet

Kushtet natyrore mundësojnë krijimin e fizionomisë dhe morfologjisë së vendbanimeve rurale. Vendbanimet janë të përhershme, të grumbulluara rreth qendrës së fshatit. Tiparet fiziko-gjeografike të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit kanë krijuar tiparet e veçanta të fshatrave Arrëz, Dardhë, Nikolicë, Qytezë dhe Sinicë. Zona njihet për burime të mëdha natyrore, të cilat janë përdorur në vazhdimësi si resurse natyrore. Ndër pikat më të forta që ka zona është shumëllojshmëria gjeologjike dhe biologjike, e përdorur në ndërtimin e vendbanimeve, mbijetesën dhe jetesën e popullsisë dhe në krijimin e kulturës lokale. Produktet e pakta të prodhuara janë të cilësisë së lartë, të

konkurrueshme në tregun shqiptar dhe ndërkombëtar. Në vendbanimet rurale të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit ka mundësi të mira të prodhimit të sasive më të mëdha të produkteve blegtorale dhe bujqësore.

Peizazhi natyror dhe kulturor ofron mundësi për rritjen e lëvizjeve turistike në zonë, në rastet e krijimit të një plani zhvillimor lokal. Pikat e dobëta që ka zona janë largësia kohore dhe kilometrike nga qendrat urbane të qarkut Korçë, si dhe shërbimi i ulët arsimor, shëndetësor dhe kulturor. Në vitet e fundit nuk është respektuar arkitektura tradicionale e ndërtimit, pasi po përdoret lëndë industriale prej alumini apo plastike. Sipërfaqet bujqësore janë të vogla, përdorimi i tyre është ekstensiv dhe për rrjedhojë prodhimet shkojnë më tepër për konsum familjar. Në zonë kultivohen foragjeret, perimet dhe frutat (mollët, dardhat, kumbullat e egra, ftonjtë, arrat, thanat etj.). Zona njihet për prodhimin e rakisë së kumbullës, oshafeve (tharja e frutave) dhe kompostove.

Sipërfaqet e tjera të tokave janë të zëna me kullota dhe pyje. Sipërfaqet pyjore janë përdorur për sigurimin e drurit për ngrohje dhe gatim në banesa, si dhe për tregtimin e lëndës drusore. Pyjet më të mbrojtura janë ato të Zonave të Mbrojtura (Peizazhi i Mbrojtur i Nikolicës, Dushkaja e Dobërgorës), ndërsa sipërfaqet e tjera pyjore janë dëmtuar nga shpyllëzimi dhe djegia natyrale. Nënkat i pyjeve ofron fruta pylli, bimë medicinale dhe farmaceutike. Mali i Badaroshës është i njohur për cilësinë e lartë të çajit të malit, i cili mbledhet dhe tregtohet nga banorët e zonës.

Kërcënimet më të mëdha vijnë nga largimi i popullsisë, e cila nuk gjen shërbimet e nevojshme arsimore, shëndetësore dhe kulturore në zonë. Shpyllëzimet dhe lënia djerrë e tokave ka bërë që sipërfaqet e erozionit sipërfaqësor të rriten në vazhdimësi. Në tabelën e mëposhtme jepen pikat më të forta, pikat më të dobëta,

mundësitë dhe kërcënimet që kanë vendbanimet rurale të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit.

Tabela 1. Analiza SWOT për vendbanimet rurale të pellgut më të sipërm ujëmbledhës të Devollit

<p><b>Pikat e forta</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Natyrë e bukur, e ruajtur me gjeodiversitet dhe biodiversitet (gjeo/biotrashëgimi);</li> <li>2. Prani e lëndëve të para për ndërtimin e banesave tradicionale (guri dhe druri);</li> <li>3. Sasi dhe cilësi e ujit në përdorim familjar, në bujqësi dhe industrinë energjetike;</li> <li>4. Shumëllojshmëri të botës bimore me përdorim në ndërtimtari, kulinari dhe mjekësinë popullore;</li> <li>5. Vendbanime me arkitekturë të veçantë ndërtimi (guri dhe druri);</li> <li>6. Investime në rindërtimin e banesave (veçanërisht në Dardhë);</li> <li>7. Produkte lokale (perime, fruta, mjaltë, raki, produkte të qumështit etj);</li> <li>8. Njohja kombëtare dhe ndërkombëtare e fshatit turistik të Dardhës;</li> <li>9. Përfshirja e fshatit Dardhë, Arrëz dhe Nikolicë, në programin e “100 fshatrave” turistike.</li> <li>10. Koshienca regjionale dhe sociale e zhvilluar.</li> </ol>	<p><b>Pikat e dobëta</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mungesa e një plani zhvillimor të qëndrueshëm për zonën;</li> <li>2. Vendbanime malore (vështirësi/kosto në komunikim me qendrat rurale);</li> <li>3. Bllokimi i zonës nga reshjet e borës gjatë periudhës së ftohtë të vitit;</li> <li>4. Probleme me infrastrukturën audiovizive dhe të fibrave optike (internetit);</li> <li>5. Emigrimet e mëdha të popullsisë brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>6. Braktisje e vazhdueshme e banesave dhe lënia djerrë e tokave bujqësore;</li> <li>7. Investime të vogla në rindërtimin e banesave dhe në aktivitete ekonomike;</li> <li>8. Mungesë të shërbimeve cilësore shëndetësore, arsimore dhe kulturore;</li> <li>9. Nivel i ulët arsimor, mungesë të profesionistëve;</li> <li>10. Dëmtime të peizazhit rural nga prerja e pyjeve dhe ndryshimit të arkitekturës të ndërtimit.</li> </ol>
<p><b>Mundësitë</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zona ka mundësi të mira të zgjerimit të aktivitetit blektoral dhe bletarisë;</li> <li>2. Zona ka mundësi të mira në</li> </ol>	<p><b>Kërcënimet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emigrimet e vazhdueshme të popullsisë po zvogëlojnë popullsinë e fshatrave duke çuar në braktisjen</li> </ol>

<p>prodhimin dhe tregtimin e produkteve cilësore të qumështit;</p> <p>3. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të integronte më mirë zonën në qytetin e Korçës dhe Bilishtit;</p> <p>4. Rritja e investimeve në fshatrat e përfshirë në programin e “100 fshatrave” turistikë;</p> <p>5. Zona ka mundësi të përfshihet në destinacione turistike rurale të Shqipërisë;</p> <p>6. Zgjerimi i shërbimeve turistike në fshatrat Arrëz, Nikolicë, Qytezë dhe Sinicë;</p> <p>7. Mundësitë e zhvillimit të turizmit (turizmi natyror, i bardhë) dhe ndërtimi i pistës së skive në Nikolicë.</p>	<p>totale të tyre;</p> <p>2. Zvogëlim i fuqisë punëtore të re dhe plakja e popullsisë do të zvogëlojë sasinë e produkteve blegtorale dhe bujqësore;</p> <p>3. Rritja e sipërfaqeve të shpyllëzuara do të nxisë veprimtaritë erozionale përgjatë luginës së Devollit;</p> <p>4. Ulja e nivelit të edukimit mjedisor dhe kulturor të popullsisë si rezultat i nivelit të ulët të shërbimit arsimor ;</p> <p>5. Niveli i lartë i ndotjeve në rrjedhjen më të poshtme të lumit Devoll nga mbetjet organike dhe plastike.</p>
--	--

Për të minimizuar pikat e dobëta dhe për të mënjeluar kërcënimet, ka rëndësi krijimi i një strategjie afatgjatë ku të përdoren pikat e forta dhe të arrihen mundësitë. Në tabelën 2 janë krijuar katër strategji bazuar në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Tabela 2. Analiza TOWS në pellgun më të sipërm ujëmbledhës të Devollit.

		Faktorët e brendshëm	
		Pikat e forta	Pikat e dobëta
Faktorët e jashtëm	Mundësitë	<p><b>Strategjia SO-u: maxi-maxi</b></p> <p>1. Njohja e gjeodiversiteti dhe biodiversiteti do të nxisë zgjerimin e lëvizjeve turistike dhe investimeve turistike në të gjithë fshatrat e zonës;</p> <p>2. Prania e lëndës së parë do të mundësojë rindërtimin e shtëpive, duke ruajtur arkitekturën tradicionale të banesave.</p> <p>3. Topografia e përshtatshme e relievit dhe reshjet e dëborës do të mundësojnë krijimin e pistës së skive në fshatin Nikolicë dhe hapjen e vendeve të reja të punës.</p> <p>4. Shumëllojshmëria bimore dhe shtazore (natyrore dhe e kultivuar) do të mundësojë krijimin e “markave” lokale në tregun kombëtar.</p>	<p><b>Strategjia WO-u: mini- maxi</b></p> <p>1. Pavarësisht se është zonë malore e me reshje bore, përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të afronte fshatrat me qendrat më të mëdha urbane të qarkut Korçë;</p> <p>2. Përfshirja e Arrëzës, Dardhës dhe Nikolicës në projektin “100 fshatrat” turistike do të mundësorë hartimin e në plani zhvillimor më të gjerë;</p> <p>3. Mundësia e zhvillimit të aktivitetit turistik do të ndërpriste emigrimet e vazhdueshme të të rinjve;</p> <p>4. Përfshirja e popullsisë në aktivitete blegtorale, bletari dhe turizëm do të zvogëlojë shfrytëzimin e madh të pyjeve.</p>
	Kërcënimet	<p><b>Strategjia ST: maxi-mini</b></p> <p>1. Cilësia e ajrit dhe ujit mund të jetë një arsye për të nxitur imigrimet e popullsisë;</p> <p>2. Vlerësimi i trashëgimisë natyrore do të nxiste iniciativat mbrojtëse të natyrës;</p> <p>3. Rritja e ndërgjegjes rajonale si rezultat i koshiençës sociale të fortë.</p>	<p><b>Strategjia WT: mini-mini</b></p> <p>1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, energjetike dhe të fibrave optikë do të mundësojë lëvizje të përkohshme dhe jo të përhershme të popullsisë;</p> <p>2. Qëndrimi i popullsisë lokale në fshatra do të rrisë sasinë e produkteve blegtorale dhe bujqësore, të përshtatshme për tregun rajonal.</p>

### Përfundimet dhe rekomandimet

Pellgu më i sipërm ujëmbledhës i Devollit karakterizohet nga vendbanime rurale malore, të grumbulluara e me kulturë tradicionale. Pavarësisht largimeve të mëdha të popullsisë, potenciali natyror ofron mundësi zhvillimi ekonomik dhe social në

secilin fshat. Orientimi i popullsisë drejt zgjerimit të aktiviteteve blegtorale dhe turistike do të zvogëlojë ndikimin negativ mbi sipërfaqet pyjore dhe do të përmirësojë të ardhurat financiare. Produktet bujqësore, blegtorale dhe gatimet tradicionale kërkojnë krijimin e “markave” lokale, si vlerë e kulturës së punës dhe ndërgjegjes regionale. Blegtorja, bletaria dhe turizmi janë aktivitete ekonomike me perspektivë për zhvillimin ekonomik-social të zonës. Lëvizja turistike duhet të bazohet në gjeodiversitet, biodiversitet dhe trashëgiminë kulturore. Përdorimi i materialeve të ndërtimit të zonës do të mundësojë ruajtjen e traditës ndërtimore popullore. Hartimi i planeve afatgjata të menazhimit të territorit do të mundësojë një perspektivë më të mirë zhvillimi. Diversiteti natyror, potenciali human vendës dhe investimi financiar i popullsisë së përfshirë në emigrim janë pikat më të forta në zhvillimin e qëndrueshëm të fshatrave Arrëz, Dardhë, Nikolicë, Qytezë dhe Sinicë.

### Literatura

Antić, A., Tomić, N. (2017). Geoheritage and geotourism potential of the Homole area (eastern Serbia). *Acta Geoturistica*, vol 8, nr.2, 67-78. DOI: 10.11515/agta-2017-0007.

Božac, M.G., (2008). Swot analysis and toës matrix-similarities and differences. *Economic research*, vol. 21. nr.1, 1-10.

Braholli, E., Ndreko, Dh., Menkshi, E., Damo, R. ( 2021). A preliminary evaluation of geotourism potential at the local level (The upper stream of Devolli River, Albania). *Building connection for Global Geoconservation*, Segovia, Spain, 173-174.

Gjoka, F., (2012). *Pedogjeografia*. Tiranë: Geer.

Kullotave, I. i., Biologjike, I. i., & Natyrore, M. i. (1997). *Pyjet e Virgjëra të Shqipërisë (vëzhgim ekologjik)*. Tiranë: Banka Botërore.

Laçi, S., Xhafa, S., Kola, E. ( 2014). *Gjeografia rurale*. Lilo, Tiranë.

Larti, I., (1999). *Të njohim Devollin (Vështrim i shkurtër gjeografiko-historik e social)*. Gama Class, Korçë

IGJEUM, (2020). *Buletini Mujor Klimatik*. Nr.37-48. Departamenti i Klimës dhe Mjedisit, ISBN: 2521-831X.



Pano, N., (2008). *Pasuritë ujore të Shqipërisë*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Pashko, P. L., (2018). Morava Mt Oligocene-Middle Miocene succession of Albanian-Thessalian Basin, Albania. *Bulletin of the Geological Society of Greece*, 1-46.

Qiriazhi, P., (1982). Disa veçori gjeomorfologjike të maleve të Moravës. *Buletini i Shkencave Gjeologjike*, 71-88.

Qiriazhi, P., (1985). *Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore dhe e maleve përreth tyre*. Tiranë: Universiteti i Tiranës.

Qiriazhi, P., (2001). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë.

Qiriazhi, P., (2011). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*. Tiranë: Mediaprint.

Qiriazhi, P., (2019). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë: Mediaprint.

Qiriazhi, P., (2020). *Trashëgimia natyrore e Shqipërisë (Vlerat, rreziqet dhe menaxhimi)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Qiriazhi, P., Sala, S., (2006). *Monumentet e natyrës të Shqipërisë*. Tiranë: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Seferi, G., (2017). *Shekulli i Vlerave Arzare*. Promo Print, Korçë.

Shqipërisë, A. e. (1990). *Gjeografia Fizike e Shqipërisë, vol II*. Tiranë: Qendra e Studimeve Gjeografike.

Shqipërisë, K. i. (2014). *Ligji nr. 115/2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*. Tiranë: Fletore Zyrtare. [https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligji\\_115-2014\\_31.07.2014.pdf](https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligji_115-2014_31.07.2014.pdf).

Vendime, (1991). *Ligji nr. 7501, Datë 19.07.1991. Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë*. <https://www.vendime.al/ep-content/uploads/2015/08/Ligj7501-dt.-19.07.1991-fl.5.pdf>

Xhomo, A., Kodra, A., Xhafa, Z., Shallo, M., (2002). *Gjeologjia e Shqipërisë (Tekst shpjegues i Hartës Gjeologjike 1:200 000 të vitit 2002)*. Tiranë.

Zyra e Gjendjes Civile, B. (2017). *Numri i përgjithshëm i popullsisë*. Bilisht: Bashkia Bilisht.

**Dr. Florinka Gjevori<sup>1</sup>**

## **NDIKIMI I ORGANIZIMIT EKONOMIK E SOCIAL NË TIPARET E QENDRAVE TË BANUARA TË PREFEKTURËS SË ELBASANIT NË VITET 1925 – 1939**

### **Abstrakt**

Në periudhën e Republikës Shqiptare, prefektura e Elbasanit përfaqësonte një nga 10 prefekturat e vendit dhe përbëhej nga 2 nënprefektura: Peqini dhe Gramshi. Secila prej nënprefekturave ndahej në komuna, të cilat nga ana e tyre përfshinin një numër të konsiderueshëm fshatrash. Pjesa më e madhe e popullsisë banonte në fshat dhe ishte e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Popullsia qytetare përbënte rreth 12.5% të popullsisë së gjithë prefekturës dhe ishte e vendosur kryesisht në qytetin e Elbasanit, që ishte edhe qendra e prefekturës. Një organizim i ri administrativ i vendit në periudhën e Monarkisë, do ta gjejë Elbasanin sërish prefekturë, por tanimë me disa ndryshime për sa u takon qendrave urbane e rurale të përfshira brenda tij. Madje në vitet e fundit të monarkisë, gjejmë mjaft arritje të shënuara në këtë prefekturë si edhe një sërë zhvillimesh në fushën ekonomike, sociale e kulturore, të cilat sjellin shfaqjen e tipareve të reja të qendrave të banuara.

Pozita e përshtatshme gjeografike dhe kushtet natyrore të volitshme të kësaj prefekturë kishin mundësuar zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, që në fakt përbënin degët bazë të ekonomisë dhe jepnin të ardhurat më të mëdha. Zhvillimi ekonomik i rajonit mbështetej edhe te zëjtaria e tregtia, të cilat kishin krijuar kushte për forcimin e lidhjeve jo vetëm midis fshatit dhe qytetit, por edhe për lidhjet e rajonit të Elbasanit me qytetet e tjera apo vendet e huaja. Për sa i përket strukturës sociale të prefekturës, ajo shfaqet tepër e larmishme dhe interesante në organizimin e saj, në këtë hark kohor.

---

<sup>1</sup> Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, E-mail. [florinkagjevori@yahoo.com](mailto:florinkagjevori@yahoo.com)

Ajo që duam të evidentojmë në këtë punim, nëpërmjet konsultimit me një seri burimesh bibliografike dhe arkivore, është se në këtë periudhë kohore nën drejtimin e mbretit Zog ishin shënuar vërtet një sërë ndryshimesh pozitive dhe mjaft të reja të tjera, por që nga ana tjetër dëshmonin se kishte ende për të bërë në drejtim të ndryshimeve cilësore në fushën ekonomike dhe sociale.

***Fjalë çelës:** qendra urbane, qendra rurale, organizim ekonomik, zhvillim social, prefekturë, komunë etj*

### **Abstract**

In the period of the Republic of Albania, the prefecture of Elbasan represented one of the 10 prefectures of the country and consisted of 2 sub-prefectures: Peqini and Gramshi. Each of the sub-prefectures was divided into municipalities and each municipality included a considerable number of villages. Most of the population lived in the village and was unevenly distributed. The urban population made up about 12.5% of the population of the entire prefecture and was located mainly in the city of Elbasan, which was also the center of the prefecture. According to a new administrative organization of the country in the period of the Monarchy, Elbasan will be a prefecture again, but now with some new changes in terms of urban and rural centers included within it, as well as the internal organization of provinces and municipalities in each sub-prefecture. Even in the last years of the Monarchy, we find many significant achievements in this prefecture as well as a series of developments in the economic, social and cultural field.

The convenient geographical position and favorable natural conditions of this prefecture had favored the cultivation of a variety of agricultural crops and had enabled the development of agriculture and livestock, which in fact constituted the basic branches of the economy and provided the greatest income. The economic development of the region was also based on handicrafts and trade, which had created conditions for strengthening the ties not only between the village and the city but also for the connections of the Elbasan region with other cities or foreign countries. Regarding the social structure of the prefecture, it appears very diverse and interesting in its organization in this time frame.

What we want to highlight in this paper, through consultation with a series of bibliographic and archival sources, is that in this period of time were marked such of positive changes and many other new ones, but on the other hand proved that there was still for it made in terms of qualitative changes.

***Keywords:** urban center, rural center, economic organization, social development, prefecture, municipality, etc*

## I. Hyrje

Në vitet '20 të shekullit XX në Shqipërinë Qendrore, krahas Tiranës, një tjetër qendër e rëndësishme urbane ishte edhe Elbasani. Elbasani gjendej në kryqëzimin e rrugëve tregtare mes prefekturave të Beratit, Vlorës, Durrësit, Tiranës, Korçës dhe deri Gjirokastrës, Shkodrës e Dibrës. Prefektura e Elbasanit në fillim të shekullit XX për nga sipërfaqja përfshinte gati 4 rrethe të sotme (Elbasani, Gramshi, Librazhdi, Peqini), pa futur aty pjesët e vogla në rrethet fqinje. Kjo prefekturë, duke zënë pra gati 1/6 e sipërfaqes së tërë Shqipërisë, me një popullsi të konsiderueshme, përbën një trevë të rëndësishme studimi të zhvillimit ekonomik jo vetëm në planin lokal, por edhe në atë kombëtar.

Nga pikëpamja fiziko – gjeografike prefektura e Elbasanit karakterizohej nga një reliev kodrinor–malor, kurse fushat janë të pakta. Gati 70% e zënë malet. Në nënprefekturën e Elbasanit ngrenë krye malet e Sopotit, Bukanikut, Kërrabës, Guri i Pikës, Shebeniku, Kaptina e Martaneshit, Morava etj. Në nënprefekturën e Gramshit ndodhen Grabova, Kamja, Shënepremtja. Terrenet kodrinore–malore shtrihen në perëndim si dhe në të dyja anët e lumit Shkumbin e Devoll që e përshkojnë në jug e qendër këtë prefekturë. Në jugperëndim është zona karstike e Dumresë me dhjetëra liqene që i japin asaj vlera të mëdha turistike. Elbasani dhe Peqini përshkohen nga lumi Shkumbin, ndërsa Gramshi nga lumi Devoll. Ka edhe një numër të madh përrenjsh që e përshkojnë Elbasanin, Peqinin, Gramshin, si Kusha, Zaranika, Manazderja, Cërrunja, Holta, Tomorrica etj. Pasuritë e saj nëntokësore e mbitokësore janë të shumta, si p.sh. bakër, plumb, squfur, vajguri, qymyrguri, serë, hekur-nikel në zonën e Përrenjasit e metale të tjera (*Selenica*, 1928). Sipërfaqja e prefekturës së Elbasanit, sipas të dhënave të vitit 1925, ishte 2954,90 km<sup>2</sup>, popullsia numëronte rreth 83627 banorë dhe dendësia ishte 28 banorë për km<sup>2</sup>. Kjo prefekturë

kufizohej me prefekturën e Tiranës e të Dibrës në veri, si kufi verilindor kishte Jugosllavinë, në juglindje me prefekturën e Korçës, ndërsa në jug me prefekturën e Beratit dhe në perëndim me prefekturën e Kavajës (*Selenica, 1928*). Vendosja e tij në mesin e rrugëve kontinentale që bashkonin Adriatikun me Maqedoninë, ndihmoi në zhvillimin e shpejtë të qytetit. Ai figuron si një qendër e rëndësishme tregtare, ekonomike dhe politike qysh pas shekullit XVIII e në vazhdim. Që nga shpallja e Pavarësisë, kjo qendër urbane përcaktohej njëherazi si një nga prefekturat më të mëdha dhe më të rëndësishme të vendit. Ajo përbëhej nga 2 nënprefekturat: Peqini dhe Gramshi, ndërsa Elbasani quhej Qendër. (*Duka, 2002*)

Secila prej nënprefekturave ndahej në komuna, ose siç quheshin ndryshe krahinari, gjithsej 5, që përfshinin një numër fshatrash, gjithsej 312. Më konkretisht, sipas regjistrimit të vitit 1926 qendra e prefekturës së Elbasanit kishte 3 krahina, atë të Qukësit, Librazhdit dhe Çermenikës, si edhe rrethin e qendrës me afërsisht 7837 shtëpi dhe popullsia e tij llogaritej në 29 029 frymë, ndërsa si qendër ai kishte 174 katunde, 11624 shtëpi dhe 55708 banorë gjithsej. Peqini, një qytet tjetër i prefekturës me rrethin e qendrës, pa asnjë krahinari, numëronte 1976 shtëpi dhe 9668 frymë, ndërsa Gramshi ishte një qendër administrative e nënprefekturës dhe nuk kishte tiparet e një qyteti. Ai kishte rrethin e tij të qendrës, dy krahinari, 2626 shtëpi dhe 15852 banorë. (*Selenica, 1928*)

Pjesa më e madhe e popullsisë banonte në fshat, rreth 73 219 banorë dhe përbënte gati 87.5 % të popullsisë, që ishte e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Nga kjo popullsi e fshatit, shumica ishte e përqendruar në viset malore, për shkak të relievit që mbizotëronte si dhe të faktorëve historikë që kishin vepruar në rrjedhën e shekujve. Popullsia qytetare përbënte rreth 12.5% të popullsisë së gjithë prefekturës (*Selenica, 1928*).

## **II. Hapësira e studimit**

Hapësira e studimit përfshin prefekturën e Elbasanit në harkun kohor të viteve 1925 - 1939

## **III. Metoda**

Studimi është realizuar mbështetur në konsultimin dhe analizën e një sërë burimesh historike, arkivore, një literature të gjerë të autorëve vendës e të huaj, si edhe disa raporteve të shtypit periodik për rajonin e prefekturës së Elbasanit.

## **IV. Gjetje dhe diskutime**

### **4.1 Tregues të zhvillimit ekonomik: zejtaria, tregtia dhe industria**

Në fillim të viteve '20 të shekullit XX, Shqipëria paraqitej me një gjendje të prapambetur ekonomike- shoqërore si dhe nivel të ulët të zhvillimit të forcave prodhuese. Industria ishte në fazën e foshnjërisë dhe pothuaj në stadin artizanal, ndërsa rrjeti rrugor dhe mjetet e transportit ishin të pakta dhe në një gjendje të keqe, gjë që ishte bërë pengesë për zhvillimin e forcave prodhuese. Tregtia e jashtme dhe bilanci i pagesave paraqiteshin në deficit kronik, kurse financat e shtetit ndodheshin në krizë të vazhdueshme. Bazën ekonomike të qyteteve e përbënte prodhimi i vogël zejtar, ku prodhuesi përgjithësisht merrej edhe me shitjen e produkteve të tij e mjaft prej tyre nuk ishin shkëputur ende nga prodhimi bujqësor. Çdo prodhues i vogël ushtronte një zeje të caktuar dhe këto zeje ishin të organizuara në formën e esnafëve, dhe në to ishte e përfshirë një pjesë e konsiderueshme e popullsisë myslimane apo ortodokse. Esnafet përbënin grupe të organizuara, të cilat kishin në bazë mjeshtrin, kallfën dhe çirakun, kurse mbi ta ishin drejtuesit dhe përgjegjësit, si shehlerët, nakibët, duaxhitë, çaušet etj., të cilët ndihmoheshin në punën e tyre nga këshilli i pleqve. Baza e prodhimit ishte puna e dorës dhe rregulli e disiplina

mbështeteshin në parime fetare e morale. (*Daja, 2014*) Në fakt sistemi i esnafit kish filluar të shthurej, por gjithsesi, esnafet e punishtet e zejtarëve përbenin bazën ekonomike të qytetit. Nga ana tjetër, qyteti i Elbasanit i ruante pothuajse të pandryshuara tiparet otomane ballkanike, të formuara gjatë sundimit osman, në aspektet e jetës ekonomike e sociale. Rolin kryesor në jetën ekonomike të qytetit, e luante pazari me njësitë e tij të prodhimit dhe të shkëmbimit (*Duka, 2002*).

Qytetarët elbasanas kishin dyqanet e tyre në disa vende të posaçme apo sheshe, të cilat janë pasqyruar edhe në regjistrat e kadiut të qytetit qysh në periudhën e fundit të shekullit XIX. Këto sheshe ishin: Bezistani, Qoshja, Sheshi i Tabakëve, Porta e Kalasë, Pazari i Zahireve, Pazari i Vjetërsirave dhe Pazari i Zarzavateve në të cilët ishte përqendruar tregtia e qytetit në përgjithësi. Në këto sheshe, krahas dyqaneve ku shiteshin mallrat e prodhuara nga esnafët, në përgjithësi kryhej edhe shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale, apo atyre të artizanatit shtëpiak të fshatit. Sipas regjistrave, në këto sheshe ishin rreth 340 dyqane, por po të llogarisim këtu edhe numrin e esnafëve të cilat ishin të vendosura në rrugë të ndryshme të tregut, mendohet se ky numër mund të ketë qenë edhe më i madh. (*Daja, 2014*)

Nga Elbasani, prodhime të tilla si vaji, duhani, lëkurët e deleve apo dhive, ndonëse prodhoheshin me mjete primitive, dërgoheshin në sasi të mëdha në tregjet e Dibrës, Strugës, Ohrit, Manastirit, Shkupit dhe Selanikut si edhe atë të Durrësit prej nga merrnin rrugën për t'u eksportuar me anë të detit për në tregjet e Venedikut dhe të Triestes. Në tregun e Elbasanit përveç produkteve vendëse dominonin mallra që vinin nga Triestja si sheqer, pambuk, lëkurë, por edhe produkte që vinin nga Anglia, Stambolli, Selaniku etj. (*Daja, 2014*) Lidhja ekonomike e Elbasanit me Gjirokastrën, me Dibrën, Voskopojën e qytete të tjera tregon jo vetëm pamundësinë për të përballuar nevojat e popullsisë me

produkte dhe mallra, por edhe lidhjen e ndërsjellë të krahinave me njëra-tjetrën si edhe fuqizimin ekonomik të një pjese të tregtarëve elbasanas, të cilët do t'i gjejmë si pjesëmarrës në organizime të ndryshme panairesh gjatë kësaj periudhe kohore. Pra, edhe vetë Elbasani si një nga viset e pasura bujqësore dhe blegtorale të vendit, do të njohë tregtinë periodike të panairove. Ndërsa, për sa i përket veprimtarisë tregtare me botën e jashtme, e cila do të kishte ndikim tepër pozitiv në mjaft drejtime, ishte kjo shtresë tregtare, apo borgjezia tregtare, e cila u bë një faktor me rëndësi në tregtinë tranzite dhe atë të panairove ballkanike (*Shkodra, 1973*).

Së fundmi, për të kuptuar situatën e tregtisë në qytetet e prefekturës së Elbasanit gjatë kësaj periudhe, na vjen në ndihmë një shkresë që shoqëronte listën e zejtarëve në tregun e Elbasanit, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, në të cilën gjendja e tregut përshkruhej tepër e vështirë, duke e krahasuar në mënyrë metaforike si një treg ku mbretëronte “një babiloni”. Dhe kjo kuptohej po të gjykoje thjesht nisur nga emërtimet, p.sh. tregtari që shet kafe, sheqer etj. merr emrin bakall, por një bakall shiste edhe misër, sulfate e aspirinë. Po kështu, një tregtar që shiste pemë quhej pemëshitës, por disa nga këta tregtarë shisnin bashkë me pemët edhe qeleshe, penj sheqer e shumë të tjera, pra dukej qartë se çdo dyqan ishte një pazar i madh, ose siç i quanin në ato vite një “gran-Pazar”. Nga ana tjetër, kishte ankesa të shumta pothuaj nga të gjithë këta tregtarë. Një herë ankoheshin qelesheshitësit, pastaj ankoheshin këpucarët e kështu të tjerë me radhë, për arsyen kryesore që po u bëhej konkurrencë sa nga jashtë, aq edhe nga qytetet e tjera të mbretërisë. Drejtuesi i Odës Ekonomike shprehte mendimin e tij se, që t'i pritej udha këtij spekulimi, duhej të ndaloheshin dyqanxhinjtë që të merreshin me çdo lloj gjëje, por të caktohej mjeshtëria e tyre e kështu të kufizoheshin vetëm në mjeshtërinë dhe zejtarinë që ata ushtronin (*AQSH, F 171, Dosje III 205, 1932*).



Për sa i përket gjendjes së zejtarisë, i vetmi dokument që pasqyron situatën është një relacion që Oda e Tregtisë Elbasan i dërgonte Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare në vitin 1937, edhe pse në fakt vetë Oda deklaronte se një statistikë e saktë ishte e vështirë të përcaktohej. Relacioni pasqyronte gjendjen e zejtarëve të rrethit që nga shpallja e Pavarësisë e deri në vitin 1937, ndërsa numri i tyre i referohej gjendjes aktuale në vitin 1937. Shifrat e përcaktuara sipas zejeve, ishin afërsisht si më poshtë: (AQSH, 1937)

*Bakej* rreth 60-70 persona, *bakërpunues* 10-12, *briskpunues* 5, *benzinëshitës* 4, *berberë* 20-25, *drithrashitës* 10-15, *duhanshitës* 10 deri 12 (por theksohej se përpara se të vihej taksa e duhanit, numri i personave në këtë zeje kishte qenë shumë i madh, pothuaj i kalonte 60 persona); *Restorante e ëmbëltore* 25-30 (më përpara kjo zeje kishte qenë në numër më të vogël dhe ëmbëltore gati nuk kishte pasur fare); *furrxhi* 30-35; (por edhe ky numër më parë kishte qenë fare i vogël); *farmaci*, sikurse edhe më parë edhe në këtë periudhë kohore ky numër ishte fare i vogël, 1 deri 2; *hotele* të vërteta nuk kishte, por kishte pasur disa *hane* të vogla antihigjienike, por aktualisht ishin 7 hotele dhe njëri ishte shumë i mirë dhe me mjete krejt moderne. Numri i haneve ishte pakësuar pak, por megjithatë ishin më shumë se 15 hane.

*Hekurpunuesit*, dhe kjo zeje ishte duke u pakësuar, pasi këta nuk mundeshin të bënin ndonjë përparim në mjeshtërinë e tyre, kështu që shumë sende të hekurta vinin nga jashtë, si për shembull vegla bujqësore.

*Këpucëbërësit*, numri i tyre dikur kishte qenë shumë i vogël dhe tashmë arrinte rreth 30 persona dhe këta deri diku kishin mundur të bënin disa përparime në zejen e tyre.

---

*Kafexhinjtë* kishin ardhur duke u shumuar gjithnjë, edhe pse kohë më përpara numri i tyre kishte qenë shumë i vogël. Ata

arrinin në 30 persona, porse lokalet që përdoreshin për këtë qëllim ishin shumë të dobëta.

*Kasapët*, edhe këta ishin në gjendjen e mëparshme pa më të voglin përparim të bërë, numri i tyre arrinte në 25 persona.

*Landëshitësit* numëroheshin në 10 persona dhe po kaq arrinte edhe numri i *lëkurëpunuesve*.

*Marangozët* më parë nuk kishin qenë aspak numër i konsiderueshëm, por sidomos këto vitet e fundit ishin duke u përmirësuar dhe shtuar në zejen e tyre dhe numëroheshin si të tillë rreth 15 persona. Duhet të thuhet se përpara Shpalljes së Pavarësisë, kjo zeje kishte qenë në gjendje primitiviteti dhe vetëm në vitet '30 kishte arritur të zhvillohej shumë.

*Mekanikë* ishin rreth 15 persona, por edhe kjo zeje kishte qenë e panjohur më parë.

*Manifakturat* edhe këto më parë kishin qenë shumë pak dhe tani numri i tyre arrinte në rreth 50 persona.

*Opingarët* kapnin numrin 20, ndërsa më parë kishin qenë pak më shumë.

*Pemëshitësit*, edhe këta kishin qenë shumë të pakët dikur, kurse në atë kohë kapnin numrin më shumë se 20 persona.

*Pijeshitësit* kapnin numrin 25, por për më pare, nuk dihej sa kishin qenë kështu që, nuk gjykohej dot në ishin shtuar apo pakësuar.

*Qeleshepunuesit* dikur kanë qenë në numër më të madh, kurse në vitin 1937 kishin mbetur në numër 6-7 persona dhe gati ishin duke u zhdukur.

*Rrobaqepës* më përpara kishin qenë fare pak, por në këtë kohë kishin arritur në numrin 25 persona. Shtesa e numrit të kësaj zejeje i detyrohej ndryshimit të veshjes së popullatës.

*Sipërmarrës e përfaqësues* kishin qenë shumë pak, e sidomos përfaqësues të shtëpive tregtare, por tanimë ky numër ishte shtuar e bashkërisht kishin arritur në shifrën 35.

*Eksportuesit*, këta kishin arritur në numrin e 10 personave dhe me shumë zor mundeshin të bënin punë, pasi shumica nuk kishin fare dijeni mbi shkencat tregtare.

*Argjendarët*, themi se kjo zeje më përpara kishte qenë shumë e përhapur dhe e përmirësuar në Elbasan, por tashmë pak nga pak ishte duke u kufizuar e aktualisht gjendeshin vetëm 7 persona që merreshin me punimin e argjendit.

Si përfundim, duke përfshirë edhe komunat, numri i zejtarëve, tregtarëve dhe industrialistëve në total, arrinte afërsisht 1200 persona (*AQSH, F 284, Dosje 11, 1937*).

Po kështu, del se në qytet ka pasur të regjistruar 1 fotograf, 1 hotel-han, 1 kafe-restorant, 1 fabrikë alkooli, 1 agjent i shoqërisë "Stambles", 1 fabrikë cigare dhe 1 koncesionar elektrik.

Për sa i takon gjendjes së industrisë në trevën e Elbasanit në vitet e Republikës Shqiptare, ajo paraqitej e njëjtë si në shkallë kombëtare. Nuk mund të flasim në kuptimin e mirëfilltë të këtij koncepti, por themi se mbizotëron prodhimi i vogël zejtar i cili përfaqësohej nga artizanati e manufakturat. Punishtet e vogla të përbëra nga 2-5 veta, ishin përhapur në mbarë qytetet shqiptare e sipas llojit të mjeshtërisë në këtë kohë llogariteshin të vepronin në vend 26 këpucarë, 18 rrobaqepës, 10 argjendarë, 160 manifaktura, 2 bojaxhinj, 336 mullinj etj. (*Selenica, 1928*). Rreth industrive të vogla, themi se në këtë qark si të tilla cilësoheshin *makinat që bënin çorape*, por këto nuk kishin instalime të veçanta dhe ishin më tepër si industri të vogla shtëpiake, gjithashtu bënin edhe punimin e qelesheve në formë dhe cilësi fare të thjeshtë. Sa për punimin e pëlhurave të vendit, kjo zeje ishte e ushtruar fare pak për shkak të çmimeve të lira me të cilat vinin nga jashtë mallrat e ndryshme dhe po konkurronin në çmime e cilësi prodhimet tradicionale vendëse.

Në vitet '30 të shek. XX, ka një rritje të interesit që shfaqin të huajt mbi firmat prodhuese e tregtare të vendit tonë, gjë që duket në një sërë kërkesash që mbërrinin nëpërmjet Ministrisë së Punëve

të Jashtme apo konsullatave mbretërore të Shqipërisë nga vende të ndryshme të rajonit e botës, në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare e pas kësaj drejt Odave Ekonomike të rretheve. Kërkesa të tilla kishin si qëllim për të hyrë në marrëveshje të ndryshme shkëmbimi apo tregtie me ata persona, të cilët ishin në gjendje të transportonin apo thjesht mbulonin kërkesat e të interesuarve, lidhur me prodhimet tona vendëse. Edhe drejt Odës Ekonomike Elbasan, gjejmë të kenë mbërritur në këto vite një sërë kërkesash të drejtuara nga institucione të tilla. Në vitin 1931, kur edhe në këtë qark sikurse mbarë vendin tonë, kishte filluar të ndihej era e krizës ekonomike, në fushën e zejtarisë vihej re shtimi i numrit të të papunëve dhe kjo për shkak të depërtimit të mallrave të importit, të cilat hynin me një taksë të ulët doganore. Mendimi i Odës ishte se ngritja e një takse të tillë për mallrat e importit do të mund të rimëkëmbte jo vetëm zejtarët vendës, por edhe ekonominë kombëtare. Madje ajo nuk ngurronte të përcaktonte edhe rrugën konkrete sipas saj për ndryshimin e kësaj situatë, që ishte ajo e ngritjes së tarifave doganore për çdo send të jashtëm (*Ekonomisti Shqiptar*, 1932).

#### 4.2 Transporti rrugor

Të gjitha prefekturat e Shqipërisë lidheshin me njëra-tjetrën dhe në rrethin e Elbasanit kalonin një sërë rrugësh nga veriu, jugu, lindja e perëndimi. Por nga rrugët kombëtare, komunale dhe provinciale të kësaj periudhe, prefekturës së Elbasanit i përkasin këto rrugë konkretisht: (*Selenica*, 1928)

*Rrugë kombëtare:*

- Rrogozhinë - Elbasan, 46 km e gjatë, rrugë në ndërtim në fund të vitit 1926

- Elbasan – Librazhd - Qafë e Thanës, 76.5 km, rrugë në ndërtim në fund të vitit 1926

- Rrogozhina – Shkumbini, 15 km, rrugë në ndërtim në vitin 1926.

- Elbasan - Qafë e Kërrabës – (Tiranë) 21 km e gjatë. Duhet theksuar që ky ishte vetëm segmenti i rrugës që i përkiste kësaj prefektуре, sepse e gjithë gjatësia e rrugës ishte 117 km.

*Rrugë provinciale:*

- Elbasan-Kukjan-Xibrakë, 14 km e gjatë

*Rrugë komunale:*

- Xhyrë – Qukës – Ura e Qukës, 8 km e gjatë, rrugë në veprim në fund të vitit 1926

- Kukjan – Llixhë, 5.5 km e gjatë, rrugë në veprim në fund të vitit 1926.

Deri në vitin 1926, në prefekturën e Elbasanit përmenden edhe një sërë urash në lumin Shkumbin e në përrenjtë e Kushës dhe Zaranikës. Shumica e tyre ishin sistemuar me mure betoni, por kalimi i njerëzve, kafshëve apo mallrave shpesh bëhej edhe nëpërmjet lundrave.

Domosdoshmëria për zgjerimin e rrjetit rrugor vinte jo vetëm nga kërkesat e ekonomisë së vendit, por edhe nga depërtimi i kapitalit të huaj dhe i Fuqive të Mëdha, sidomos Italisë. Marrëveshja për huan SVEA shërbeu pothuaj tërësisht për ndërtim rrugësh e pallatesh, por vazhdonte edhe ndërtimi i rrugëve me punën angari të fshatarëve, e cila për hir të së vërtetës shpesh herë rezultonte e dobët dhe kjo shfaqej në një gjendje të keqe të rrugëve (*Histori e popullit shqiptar, 2007*). Kostoja e shpenzimeve të transportit paraqitej tepër e lartë në Shqipërinë e viteve '30. Në prill të vitit 1932 Oda Ekonomike Elbasan, në mënyrë që t'i priste rrugën spekulimeve lidhur me vërtetësinë e dëftesave të rrugëve, vendosi në një mbledhje të posaçme të këshillit të odës çmimet e rrugëve. Nga ky dokument njëherësh na dëshmohet edhe ekzistenca e rrugëve kryesore automobilistike me të cilat Elbasani lidhej me krahinat dhe rajonet përreth në këtë periudhë kohore.

Kështu, Elbasani lidhej me rrugë të tilla me pothuaj të gjithë qytetet dhe rajonet kryesore të vendit, si p.sh. me Tiranën, Durrësin, Peqinin, Kavajën, Shijakun, Fierin, Vlorën, Beratit, Tepelenën, Sarandën, Gjirokastrën, Përmetin, Leskovikun, Korçën, Pogradecin, Dibërën, Krujën, Lezhën dhe Shkodrën. Bileta për një person që udhëtonte me mjetin automobil me gaz, varionte nga 5-10 fr.ari për distancat më të afërta, si Peqin, Kavajë, Durrës e Shijak, si edhe deri në 30 – 40 fr.ari për distanca si Saranda, Gjirokastra, Leskoviku, Tepelena etj. Kjo me sa duket, si një vlerë e tillë lidhej jo vetëm me distancën, por edhe vështirësinë dhe shkallën e rrezikshmërisë së rrugës. Drejt veriut rruga dukej se ishte më pak e kushtueshme, p.sh. drejt Lezhës, Shkodrës, Dibërë bileta kushtonte rreth 20 fr.ari, ndërsa rruga për në Korçë, Pogradec pothuaj sa rruga drejt Vlorës e Beratit rreth 15 fr.ari. (AQSH, F 171, Dosje III-205, 1932).

Mjetet e transportit deri në vitin 1926 në Elbasan ishin karrocet që kryenin transportin e njerëzve dhe mallrave jo vetëm brenda qytetit, por edhe në rrethinat e tij. Mjetet e mekanizuara të transportit do të shfaqeshin në këtë qytet vetëm pas vitit 1926 e më shumë pas viteve '30. Ekzistonin 11 pronarë që i zotëronin këto mjete, që më konkretisht po i rendisim: (Vogli, 1988)

➤ Rrap Lloshi kishte sjellë një kamion të markës “Shevrolet” me tonazh 15 kv.

➤ Hysen Cani kishte sjellë një veturë të markës “Plimuth” me të cilën bënte rrugën Elbasan – Llixhë. Po kështu edhe Hasan Garibolli, Mustafa Turku e Qamil Graceni zotëronin secili nga një veturë “Plimuth”

➤ Ymer Graceni zotëronte një autobus të vogël “Shevrolet” me kapacitet 10 – 15 vende dhe bënte rrugën Elbasan – Tiranë.

➤ Ali Kumi zotëronte tre kamionë të markave “Shevrolet”, “Opel” dhe “OM”.

- Hasan Garunja kishte dy kamionë, ndërsa Baftjar Struga dhe i vëllai Halim zotëronin një kamion.
- Shefqet Graceni zotëronte një veturë “Opel”
- Xhaferr Arapi kishte një veturë “Fiat”

### 4.3 Punët Botore

Sistemi rrugor përbën një element të rëndësishëm në tërësinë e infrastrukturës së qytetit, apo skemës urbanistike të tij. Rrugët brenda apo jashtë qytetit krijonin mundësi për lidhjen me tregjet dhe vendet e tjera. Megjithatë, deri në periudhën monarkike përgjithësisht flasim për një zhvillim të paplanifikuar të sistemit rrugor në rrethin e Elbasanit, gjë që sillte dendësim të trafikut dhe pamundësi të klasifikimit të tyre mbi bazën e kësaj ngarkese. Edhe pse deri në fillim të shekullit XX nuk përmendet ekzistenca e ndonjë plani rregullues të qytetit, vetë prania e lagjeve, shesheve, rrugëve, pazarit apo edhe sistemimi i qytetit, pa diskutim flasin për ekzistencën e një lloji planifikimi sipas parametrave të kohës, duke dëshmuar madje nëpërmjet këtij sistemimi dhe zgjerimi të qytetit drejt periferisë, edhe për një rritje demografike dhe zhvillim ekonomik në këtë periudhë kohore. (*Daja, 2014*)

Si në mbarë vendin edhe në rajonin e Elbasanit, hapat e parë për ndërtimin e një rrjeti rrugor u hodhën gjatë Luftës së Parë Botërore, ku italianët, austriakët e francezët për nevojat e tyre kishin ndërtuar një sërë rrugësh të improvizuara (rreth 1000 km). Rrugët e ndërtuara nga austriakët lidhnin disa nga qytetet e Shqipërisë së Mesme e Veriore, si Shkodra me Tiranën, me Durrësin, Elbasanin e Lushnjën. Pas vitit 1920, kur u bë rimëkëmbja e aparatit shtetëror shqiptar, nevoja e rrugëve dhe mjeteve të komunikacionit u ndje jo vetëm nga qeveria shqiptare, por edhe vetë tregtarët. Ndërtimi e meremetimi i rrugëve u bë me punë angari, që mbështetur në ligjin e posaçëm përfshinte të gjithë meshkujt e moshës 18 deri 58 vjeç, caktohej 10 ditë në vit, por mund të shlyhej edhe me të holla ose

me bedel (zëvendësues) (*Shqipërisë, Histori e popullit shqiptar, 2007*). Edhe në shkrimet e autorëve të huaj për këtë situatë të transportit do të gjesh të njëjtat përcaktime. Ja si e përshkruanin J. Swire dhe R. Austin situatën e Shqipërisë në vitin 1922: "... Shqipëria ndodhej akoma në të njëjtën gjendje si edhe disa vende të tjera të Ballkanit, menjëherë pas çlirimit nga sundimi turk. Nuk ekzistonte në fakt asnjë sistem transporti, kishte më pak se 200 kilometra rrugë të shtruar, asnjë port modern... nuk kishte trafik të motorizuar dhe i gjithë inventari i mjeteve në 1920 përbëhej nga tre makina Ford të lëna nga një mision ndihme i SHBA-së (*Austin, 2003*).

Që prej mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kishte filluar zgjerimi i qyteteve dhe bashkë me to shtimi i ndërtimit të banesave. Kjo kishte sjellë tashmë edhe rritjen e nevojës për materiale ndërtimi. Tashmë edhe fusha e ndërtimit, ishte bërë një tjetër fushë veprimi, ku kishte filloi të investohej kapitali vendës. Në fakt kishte mjaft të dhëna që dëshmonin që qysh nga koha e sundimit turk kishte pasur sipërmarrës të tillë në vend, por numri dhe aktiviteti i tyre ishte shtuar mjaft pas Luftës së Parë Botërore. Në Elbasan në vitet 1922-1923, Grigor Nosi kishte marrë në sipërmarrje ndërtimin e urave të vogla në rrugën Elbasan-Durrës. Aktiviteti i tij në këtë fushë na dëshmohet edhe në vitin 1925, kur ai kishte ndërtuar të gjitha urat, ndër të cilat përmendet edhe ura e Dervenit të Madh me gjatësi 300 metra (*Mishta, 1976*). Rrjeti i rrugëve konsiderohej i dobët, i pamjaftueshëm, në gjendje të keqe e mbi të gjitha nuk bënte lidhjen e të gjitha qendrave të prefekturave të vendit. Urat mungonin pothuaj kudo e mbi lumenjtë e mëdhenj kalimi bëhej vetëm me lundra (*Histori e popullit shqiptar, 2007*).

Në vitin 1932 ishte krijuar pranë Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, Seksioni i Ujërave, me dy degët e tij: dega hidrografike dhe dega e bonifikimeve. Dega hidrografike kishte ngritur një sërë stacionesh meteorologjike ndarë në kategoritë pluviometrike, termo-pluviometrike dhe stacione të klasit I. Në Elbasan ishte



ngritur një stacion i klasit I, sikurse edhe në mjaft rrethe të tjera si Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Korçë etj. Në vitin 1933 u rikrijua Drejtoria e Ujërave, duke vlerësuar tepër të nevojshme qenien e shërbimit të ujërave në vendin tonë, qëllimi i së cilës ishte vetëm veprimtaria bonifikuese, të cilat do të sillnin një përmirësim mbi bujqësinë, blegtorinë dhe mbi shëndetin publik. Në Elbasan veprimtaria e kësaj drejtorie kishte konsistuar në hapjen e dy kanaleve vaditëse, njëri në Komunën e Qukësit – Kanali i Skroskës dhe tjetri në katundet Direz – Gjizavesh – Librazhd. Kanali i parë kishte një gjatësi deri në 12 780 metra dhe konfiguracioni i tij ishte  $\frac{1}{2}$  në mal dhe  $\frac{1}{2}$  në rrafshinë. Ai do të shërbente për të vaditur 220 hektarë tokë. Ndërsa kanali i dytë kishte një gjatësi deri në 14 747 metra dhe konfiguracioni i tij ishte më i vështirë, pasi  $\frac{3}{4}$  e tij ishin në shkëmb dhe  $\frac{1}{4}$  ishte në kodrinë e rrafshinë. Për realizimin e këtyre punimeve kjo drejtori kishte vënë në dispozicion personelin teknik, veglat e punimit, dinamitin dhe kishte përdorur punëtorët komunalë (*Ekonomia kombetare, 1938*).

#### 4.4 Banka dhe financat

Bankat e para të ngritura në vendin tonë ishin: Banka e Perandorisë Otomane, si bankë emisioni e Perandorisë Turke me filialet e saj në Shkodër, Shkup, Manastir e Janinë, e ngritur në vitin 1863, si edhe Banka Agrare Turke e ngritur në vitin 1888, mbi bazën e “Arkave krahinore” dhe “Arkave të interesit” me filialet e saj si degë, agjenci dhe arka në disa rajone të vendit, ndër të cilat edhe në Elbasan. Në Elbasan, kjo është dega e parë bankare që na përmendet në rajon (*Ekonomia kombëtare, 1938*). Kjo Bankë zhvilloi për disa vite veprimtari të gjerë në vilajetet shqiptare të perandorisë dhe deri në vitin 1912 kjo bankë kishte dhënë në këto vilajete një kredi 6.7 milionë groshë ar, pjesën më të madhe të të cilave me afat të gjatë shlyerjeje. Interes përbën fakti që në rritjen e fitimeve të kësaj banke ndikoi edhe norma e interesit prej 1%, që

mblidhej nga të gjithë fermerët mbi bazën e prodhimeve të tyre (*Zarshati, 2011*). Gjatë periudhës së viteve 1924-1939, ishin bërë një sërë përpjekjesh për ngritjen e sistemit bankar në Shqipëri. Por, industrialistët dhe tregtarët shqiptarë megjithëse kishin bërë një sërë hapash në rrugën e zhvillimit, ende nuk kishin akoma as përvojën e duhur dhe as fuqinë e mjaftueshme për ngritjen e institucioneve financiare.

Kur në pushtet erdhi qeveria e Ahmet Zogut, konkurrenca për marrjen e koncesioneve ekonomike, sikurse edhe për koncesionin e Bankës, mori zhvillime të reja. Në shtator 1925 u bë konstituimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e cila krijohet si bankë emisioni dhe aktiviteti i saj rregullohet prej statutit, në përputhje me ligjin organik për bankën. Deri në vitin 1926, filialet e Bankës Kombëtare të Shqipërisë ishin hapur në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër e Korçë. Po kështu, edhe në qytetin e Elbasanit u hap një filial i kësaj Banke, e cila e shtriu veprimtarinë e saj në fushën e dhënies së kredive për personat e interesuar dhe që njëkohësisht plotësonin kushtet për përfitimin e saj. Vetëm në fund të muajit korrik të vitit 1938 ishin vendosur në qytetin e Elbasanit themelet e godinës së Bankës Kombëtare, e cila pritej të mbaronte shumë shpejt (*Drita, 1938*). Godina e parë e personalizuar si bankë në qytetin e Elbasanit, sikurse edhe në qytetet e tjera kryesore të vendit ishte konceptuar dhe u realizua me një arkitekturë të spikatur dhe me një pozicion të saktë urban në qendër të qytetit, sa edhe sot mbetet një nga veprat më të arrira në fushën e arkitekturës dhe të ndërtimit administrativ. Pa dyshim, ky organizim dhe zhvillim i administratës shtetërore kishte qenë pjesë e rikonceptimit urban të qyteteve sipas modeleve më të zhvilluar të Europës Perëndimore, që u shfaq në vendin tonë në vitet '20-'30 me konsolidimin e shtetit shqiptar (*Zarshati, Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare. Lindja dhe puna e një banke konkurruese, 2011*).

#### 4.5 Pronësia tokësore

Në vitin 1927, nga 2 954 km<sup>2</sup> sipërfaqe e përgjithshme e tokës së prefekturës së Elbasanit ose 295 400 ha, punohej vetëm një pjesë e vogël prej 64 988 ha ose 22% e sipërfaqes. Një sipërfaqe prej 277 240 ha ishte pyllishte dhe tokë e zhveshur, 8 862 ha, ose 3% ishte livadh, kullotë, shkëmbinj, përrrenj, shtrat lumi e zallishte (*Selenica, 1928*). Nga pikëpamja e pronësisë 6.90% e sipërfaqes së tokës ndodhej në pronësi të shtetit dhe vakëfeve dhe 93.05% e tokës ndodhej në pronësi private, prej të cilëve 16.13 % të kësaj sipërfaqe e zotëronin 3 familje të mëdha latifondiste të qytetit të Elbasanit, 29.5 % të saj e zotëronin 23 familje të pasura të këtij qyteti t dhe 47.40 % të saj e zotëronin 352 familje pronarësh të mesëm (*Kongoli, Disertacion shkencor*). Në prefekturën e Elbasanit ekzistonte një copëzim i madh i pronësisë mbi tokën bujqësore, që nuk paraqitej unik për të gjithë prefekturën, si edhe një polarizim i theksuar i cili shfaqet, nga njëra anë, në përqindjen e lartë të numrit të pronarëve të vegjël e të mesëm të tokave në krahasim me përqindjen e ulët të sipërfaqeve të tokave që ky grup zotëronte dhe nga ana tjetër, në përqindjen e ulët të numrit të pronarëve të mëdhenj në krahasim me përqindjen e lartë të sipërfaqes së tokës që kjo shtresë kishte në zotërim. Tri familjet latifondiste të Elbasanit zotëronin pasuri tokësore, së bashku me rrënjë ullinjsh, përkatësisht 1 357 ha tokë dhe 6 225 rrënjë ullinj, 23 familjet e pasura të qytetit 1 530 ha tokë dhe 134 000 rrënjë ullinj dhe 352 familjet e pronarëve të mesëm zotëronin 3 991 ha tokë dhe 108 000 rrënjë ullinj (*Kongoli, Disertacion Shkencor*).

Situata ekonomike, sidomos bujqësia, gjatë periudhës 1920-1924 paraqitej relativisht e mirë. Në vitin 1927, nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës së prefekturës së Elbasanit 2 954 km<sup>2</sup>, punohej vetëm një pjesë e vogël, prej 94932.2 ha (tokë private dhe shtetërore). Një sipërfaqe prej 35663.2 ha ishte pyllishtë dhe tokë e

zhveshur dhe 26757 ha ishte livadh e kullotë, si dhe 3300 ha shkëmbinj moçale e kënetë (*Selenica, 1928*).

Toka e punuar mbillej me kultura të ndryshme bujqësore si grurë, misër, elb, tërshërë, thekër, oriz, duhan etj. Ndër lëvrimet bujqësore të drithërave, ai që kishte rëndësinë më të madhe ishte misri, meqenëse ai formonte ushqimin kryesor të bujkut dhe deri diku edhe të qytetarëve. Ndërsa, sipas të dhënave të vitit 1933, po të krahasojmë shifrat e disa prodhimeve bujqësore me prodhimin kombëtar të përgjithshëm rezulton se Elbasani zë këto vende:

*Për prodhimin e orizit dhe të tepës zë vendin e parë dhe totali për secilin prej tyre përkatësisht paraqitet: për orizin sipërfaqja totale në Shqipëri 1 905 ha dhe prodhimi i përgjithshëm kombëtar, ose PPK 4 090 kv, ndërsa Elbasani jepte 73% të këtij prodhimi; për tepën sipërfaqja totale ishte 1 819 ha dhe PPK 14 028 kv, ndërsa Elbasani jepte 54% të këtij prodhimi.*

*Për elbin Elbasani zinte vendin e dytë pas Korçës, prodhimi i këtij të fundit ishte 2.5 herë më i madh, kur PPK (Prodhimi i Përgjithshëm Kombëtar) ishte 89 935 kv dhe sipërfaqja totale 6 100 ha, ndërsa Elbasani jepte 16 % të këtij prodhimi.*

*Elbasani zë vendin e tretë për prodhimin e tërshërës si dhe të ullishtave.*

*Për misrin Elbasani radhitej i katërti, pas Beratit, Durrësit, Korçës, kur PPK ishte 1 093 225 kv dhe sipërfaqja 77 295 ha, ndërsa Elbasani jepte 12 % të këtij prodhimi.*

*Vendin e gjashtë për prodhimin e grurit, duke u renditur pas prefekturës së Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Durrësit. Ndërkohë që Prodhimi i Përgjithshëm Kombëtar ishte 650 832 kv dhe sipërfaqja e përgjithshme e kultivuar 43 329 ha, Elbasani jepte 8% të këtij prodhimi (*AQSH, F271, Dosje152*).*

Në Elbasan në vitet '20-'30, funksiononte Zyra e Bujqësisë. Veprimtaria dhe fusha e aktivitetit e kësaj zyre, por edhe e zyrave të tjera në përgjithësi deri në vitin 1925 ka qenë e ngushtë dhe e

kufizuar thjesht në dhënie këshillash e propagandë për të ngjallur në shpirtin e bujkut ndjenjën e veprimeve të duhura në zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë. Kjo ndodhte për disa arsye, por ndër më kryesoret kanë qenë se nuk ka pasur një organizim komunal, nuk disponoheshin plotësisht as ligjet e duhura nga Ministria e Ekonomisë Kombëtare. Veprimtaria e kësaj zyre intensifikohet edhe në drejtim të rritjes dhe mbarështimit të kafshëve, duke u kujdesur me këshilla e orientime për ta ndërgjegjësuar bujkun që edhe blegtorisë t'i kushtonte vëmendjen e duhur. Për të ruajtur shëndetin e bagëtive dhe për të luftuar sëmundje të ndryshme të gjësë së gjallë merreshin masa për t'i bërë të ditur bujkut rreziqet e mundshme, nëse nuk njoftoheshin ngushtësisht autoritetet e vendit, apo për të vepruar me masa preventive dhe kurative (AQSH, F271, Dosje IV-10).

#### 4.6 Pasuritë pyjore

Në prefekturën e rajonit të Elbasanit ishte organizuar Inspektoriati i Shërbimit Pyjor në vitin 1927, vit ky që shënonte edhe fillimin e trajtimit ligjor të pasurisë pyjore në shtetin shqiptar. Në varësi të kësaj prefekturë ishin vendosur edhe dy zyrat e pyjeve në Qukës të Librazhdit dhe në Martanesh (*Grup autorësh, 2003*). Ndërsa sipas regjistrimeve të bëra në vitin 1945, pasuritë pyjore në prefekturën e Elbasanit llogariten me një sipërfaqe rreth 150 000 ha ose 15% të gjithë sipërfaqes pyjore të Shqipërisë. Sipërfaqet pyjore më të mëdha ndodheshin në nënprefekturën e Qendrës dhe asaj të Peqinit. Më poshtë po paraqesim një listë të pyjeve më të rëndësishme që gjenden në këtë prefekturë, ndarë sipas nënprefekturave. Po të llogarisim fuqinë lëndore të pyjeve, në prefekturën e Elbasanit rezulton se materiali drusor, matur në  $m^3$  këmbë, që gjendet në pyjet e kësaj prefekturë është 10 635 000  $m^3$ , nga 79 000 000  $m^3$  këmbë material drusor që gjendet në pyjet e Shqipërisë. Pra, në këtë prefekturë gjendet rreth 13.46 % e

materialit drusor të pyjeve, në shkallë vendi. Për sa i përket fuqisë prodhuese dhe materialit të shfrytëzuar prej tyre, në këtë prefekturë kemi 217 100 m<sup>3</sup> material të shfrytëzuar në vit, nga 1 500 000 m<sup>3</sup> në vit që është prodhimi i përvitshëm i pyjeve të gjithë Shqipërisë (AQSH, Fond 494, Dosje 492, 1945).

### **Përfundime**

Zhvillimi ekonomik në periudhën e Monarkisë ndikoi në tiparet e qendrave të banuara. Në aspektin e strukturës ekonomike në trevën e Elbasanit, ashtu si në të gjithë vendin, në vitet '20 – '30 të shek. XX peshën kryesore e kishte bujqësia. Për shkak të pranisë së luginave e fushave pjellore, klimës shumë të favorshme dhe faktorëve të tjerë, prefektura e Elbasanit dallohej për prodhimet e saj bujqësore dhe përhapje të aktivitetit agrar, kryesisht në zonat fushore të Peqinit dhe të Elbasanit. Situata e prodhimit bujqësor të këtyre viteve është e lidhur me faktorët klimaterikë dhe atmosferikë, si p.sh. mungesë apo rënie e theksuar e reshjeve të shiut, thatësi e tejkjatur etj., por edhe me rolin dhe politikën e shtetit ndaj kujdesit për bujqësinë apo fshatarësinë. Rënia e prodhimeve bujqësore, sidomos në vitet 1933-1935, është e lidhur edhe me krizën ekonomike të kësaj periudhe.

Zejtaria e artizanati ishin veprimtaritë kryesore të qytetit, bashkë edhe me tregtinë, të cilat u përfshinë në vorbullën e krizës ekonomike botërore, por treguesit e tyre ishin të ndryshëm në fusha të ndryshme. Konkretisht tregtia shfaqti pakësim të produkteve bujqësore, por edhe pakësim të të ardhurave. Eksporti kishte pësuar rënie të ndjeshme, që shprehej me mungesë të tregut të jashtëm për produktet e vendit e njëkohësisht edhe ulje të çmimeve deri përgjysmime të tyre, sidomos për lëkurat. Artizanati, veprimtari kjo me anën e të cilës mbaheshin me qindra familje, e ndjeu pa dyshim më thellë këtë krizë. Shumë prej artizanëve mbetën të papunë, ose gjendeshin në prag të falimentimit, gjendje

kjo e pasqyruar edhe në ankesat e protestat që zejtareë nga të katër anët e vendit u drejtonin organeve qeveritare. Zejtaret e profesioneve të ndryshme po shkonin drejt rrënimit për shkak të konkurrencës së prodhimeve të huaja. Ishte krijuar një gjendje e tillë sikurse e përmendin dokumentet e kohës që deri edhe qeleshet, prodhimi i të cilave kishte traditë shekullore në vendin tonë, po importoheshin nga vende të tjera.

Ajo që duhet evidentuar është fakti që në kushte të tilla, konkurrenca dhe anarkia morën përhapje të madhe. U shfaqën mjaft raste kur në emër të forcimit të pozitive personale apo të përfitimit nga kjo situatë, në kuadër të sigurimit të fitimeve më të mëdha e duke mposhtur e asgjësuar konkurrentë të tjerë, të hapen veprimtari të reja industriale në një sërë qytetesh të vendit, sikurse edhe në Elbasan, por fakt është që kjo nuk dëshmonte aspak nxjerrjen e vendit nga kriza, madje nga ana tjetër nuk mungonin rastet kur këto veprimtari të reja u gjendën në vështirësi ekonomike-financiare, ose shkuan shpejt drejt mbylljes.

---

## Literatura

- AQSH. (1931). F 171, Dosje III-139. 150. Tiranë.  
 AQSH. (1932). F 171, Dosje III-205. 46. Tiranë.  
 AQSH. (1937). Fond 284, dosje 11. Tiranë.  
 AQSH. (1945). Fond 494, Dosje 492. 9-11.  
 AQSH. (n.d.). F 271, D 152. 7-9.  
 AQSH. (n.d.). Fond 271, Dosje IV-10. 4-6. Tiranë.  
 Austin, R. (2003). Shtegu i pashkelur i Fan Nolit. Tiranë.  
 Daja, Z. (2014). Elbasani në vitet 1892-1908, sipas regjistrave osmane. Tiranë.  
 Drita. (1938, August 9).  
 Duka, V. (2002). Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912 - 1924. Tiranë.  
 Ekonomia kombëtare, (1938). f. 9, 23-26.  
 Ekonomisti Shqiptar, (1932). 2, f. 43.  
 Fishta, I., Toci, V., (1983). Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1924-1944. Prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat. Tiranë.  
 Grup autoresh. (2003). Elbasani Enciklopedi. Elbasan.

Iliaz Fishta, Venemin Toci. (1983). Gjendja ekonomike e Shqipërisë 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat. Tiranë.

Kongoli, S. (n.d.). Zhvillimi ekonomik i prefekturës së Elbasanit në vitet 1912-1939. Tiranë.

Mishta, K. (1976). Lëvizja punëtore në Shqipëri. Tiranë.

Selenica, T. (1928). Shqipëria në vitin 1927. Tiranë.

Shkencave, A. e. (2007). Histori e popullit shqiptar (Vol. III). Tiranë: Toena.

Shkodra, Z. (1973). Esnafet shqiptare (shek XV-XIX). Tiranë.

Shqipërisë, A. e. (2007). Histori e popullit shqiptar (Vol. III). Tiranë: Toena.

Vogli, H., Elbasani nga vitet 1800-1944. Tiranë: Ngjyrat e kohës.

Zarshati, O., (2011). Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare. Lindja dhe puna e një banke konkurruese. Tiranë.

---



**Dr. Manjola Xhaferri<sup>1</sup>**

**Dr. Mirela Tase<sup>2</sup>**

## **ARKITEKTURA E BANESËS NË RRETHINAT E TIRANËS DHE TRANSFORMIMET E REJA PAS VITEVE '50 TË SHEK. XX**

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah disa elemente të rëndësishme në lidhje me ndryshimin e banesës tiranase gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Ky proces ndryshimi e përfshin shoqërinë e këtij rrethi në veçanti, por dhe gjithë shoqërinë shqiptare në tërësi në një rrugë modernizimi në aspektin arkitekturor, por edhe jetësor. Duke u ndalur te tipi i banesës tradicionale në rrethinat e Tiranës duhet thënë se karakteristikë bazë e kësaj krahine është tipi i banesës me shtëpi zjarri në qendër përgjatë dy kateve, e cila është emërtuar edhe si banesa tiranase për shkak të përhapjes së madhe që ka marrë. Po t'u referohemi ndryshimeve pas viteve '50 të shek. XX, shikojmë që kemi një transformim tërësisht të banesës, që nga arkitektura e ndërtimit, pozicionimi dhe mobilimi i saj. Nëse në periudhat para çlirimit fshatarët e këtij rrethi përpiqeshin të siguronin materiale rrethanore për ndërtimin e banesave dhe nuk kishin një organizim të qartë në pozicionimin e ndërtimit dhe shtrirjes së tyre, pas çlirimit shikojmë që ndërtimet bëheshin me një vendosje më të qartë, me një shtrirje të përcaktuar, por ajo që është më e rëndësishme lidhet me praktikitetin dhe modernitetin e ndërtimit dhe mobilimit. Transformime rrënjësore arkitektura e banesës tiranase pësoi kryesisht pas viteve '90, si në: tipin dhe modelimin e saj, materialet e përdorura, mobilimi dhe orenditë etj. Në këtë punim do përpiqemi

---

<sup>1</sup>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Departamenti i Shkencave Politike, E-mail: mxhaferri@yahoo.com

<sup>2</sup>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Turizmit, E-mail: mirelatase@hotmail.com

të japim disa veçori të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me transformimet që i janë bërë banesës tiranase, sidomos të zonave fshatare. Do ndalemi kryesisht te:

- a. Pozicionimi i banesave dhe ngushtimi i hapësirave të gjera.
- b. Arkitektura e përdorur dhe praktikiteti i tyre në aspektin jetësor.
- c. Sigurimi i materialeve të ndërtimit në mënyrë rrethimore.
- d. Mobilimi dhe dalja në skenë e pajisjeve të reja që e bëjnë banesën tiranase më moderne dhe më bashkëkohore. Të gjitha çështjet e sipërpërmendura do të japin një vështrim më të gjerë rreth konceptimit të ri të arkitekturës së banesës në rrethinat e Tiranës.

*Fjalë çelës: Transformim, arkitekturë, banesë, rrethinë, Tiranë*

### **Abstract**

The purpose of this paper is to highlight some important elements related to the change of the Tirana apartment, during the second half of the twentieth century. This process of change includes the society of this district in particular but also the entire Albanian society as a whole in a way of modernization in terms of architecture but also life. Referring to the type of traditional dwelling in the suburbs of Tirana, it should be said that the basic characteristic of this province is the type of dwelling with a firehouse in the center along with the two floors, which is also named as Tirana dwelling due to the large spread that has received. If we refer to the changes after the 50s of the XX century, we see that we have a complete transformation of the apartment, from the construction architecture, its positioning, and furnishing.

If in the periods before the liberation the villagers of this district tried to provide circumstantial materials for the construction of dwellings and did not have a clear organization in the positioning of their construction and layout, after the liberation we see that the constructions were done with a clearer placement, with an extension defined, but what is most important, is that, it relates to the practicality and modernity of construction and furnishing. The architecture of the Tirana apartment underwent radical transformations mainly after the 1990s, such as its type and modeling, the materials used, the furniture and furnishings, etc. In this paper, we will try to give some features which are directly related to the transformations that have been made to the Tirana apartment, especially in rural areas. We will focus mainly on:

- a. Positioning of dwellings and narrowing of large spaces
- b. The architecture used and their practicality in the vital aspect
- c. Providing construction material circumstantially.

d. Furnishing and launching new equipment that makes the Tirana apartment more modern and contemporary.

All the above issues will provide a broader framework for the new conception of the architecture of the apartment on the outskirts of Tirana.

*Keywords: Transformation, Architecture, Dwellings, Surroundings, Tirana*

## I. Hyrje

Ky punim synon të paraqesë disa aspekte të rëndësishme të arkitekturës së banesës në rrethinat e Tiranës (fshatrat: Prezë, Pezë, Petrelë, Dajt, Shëngjergj, Domje, Paskuqan, Qerret etj.), kryesisht gjatë shek. XX dhe dekadën e parë të shek. XXI. Në procesin e studimit përfshihen elemente të cilat kanë qenë të pranishme gjatë gjithë periudhave historike dhe vazhdojnë të jenë edhe sot në mënyrën e ndërtimit të banesës, transformimet që ka pësuar në mënyrë graduale kryesisht pas viteve '50 të shek. XX. Këto elemente janë të tipit tradicional dhe modern, të cilat kanë pësuar një gërshetim të fortë gjatë viteve të fundit të shek. XX dhe fillimit të shek. XXI.

Pjesë e këtij punimi do të jenë shumë çështje të cilat kanë për qëllim të tregojnë zhvillimin dhe ecurinë e arkitekturës së banesës dhe ndryshimet e para që kanë pësuar sidomos në gjysmën e parë të shekullit XX. Vend i posaçëm do t'i kushtohet edhe ndërtimit të banesave tradicionale tiranase, si dhe pajisjes së tyre me të gjitha orëditë, qoftë brenda ambientit të shtëpisë, ashtu edhe në aksesoret e oborrit. Vëmendje e veçantë u është kushtuar edhe ndryshimeve të ndodhura në strukturën e re të ndërtimit të banesave, koncepteve të reja të shfaqura lidhur me mënyrën e jetesës, në kushtet e ekonomisë së tregut dhe mendësive të reja aktuale social-ekonomike në këtë zonë. Në këtë punim do pasqyrojmë edhe fragmente përshtatëse të tradicionales me modernen, që e shndërron mënyrën e jetesës në një formacion krejt të ndryshëm nga e kaluara.

Ky punim në tërësi synon të paraqesë ato vlera tradicionale që banorët e fshatrave të ndryshme të Tiranës kanë kultivuar për shekuj me radhë, por njëkohësisht edhe për të treguar se këto vlera tradicionale të mënyrës së të jetuarit sa vijnë dhe bëhen të padukshme.

Për të qenë korrektë me lexuesin na duhet të sqarojmë se pjesa kushtuar arkitekturës tradicionale dhe ndryshimeve të reja që ka pësuar banesa tiranase është tërësisht material i siguruar në terren duke përfshirë një pjesë të mirë të fshatrave të Tiranës, që dikur cilësoheshin si qendra të rëndësishme komunikimi dhe ekonomike. Trajtimet në këtë punim janë pjesë e një pune kërkimore në zhvillim e sipër, në kuadër të një monografie për banesën tiranase në shekuj.

## II. Metoda

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur disa metoda konkrete të kërkimeve etnografike.

*Së pari*, materiali kryesor për hartimin e këtij punimi do të jenë të dhënat gojore, të siguruara gjatë kërkimeve në terren, rreth ndërtimit të banesave në fshatra të ndryshme të Tiranës, pajisjeve të tyre, si dhe transformimet që kanë pësuar në periudha të ndryshme kohore, kryesisht pas viteve '90, ku transformimet ishin rrënjësore. Janë realizuar 25 intervista, të ndara në grupmosha të ndryshme, ku shumica prej tyre, rreth 70% janë mbi moshën 60 vjeç.

*Së dyti*, është shfrytëzuar literatura e botuar dhe ajo që ndodhet në arkivin e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit (IAKSA), në lidhje me pasqyrimin e arkitekturës së banesës në rrethinat e Tiranës.

Veç këtyre janë shfrytëzuar edhe burime të ndryshme si: revista e shkrime të tjera të shtypit të periudhave të ndryshme, të cilat japin informacione rreth zhvillimit të arkitekturës së banesës dhe

transformimeve që ka pësuar në rrethin e Tiranës, të marra nga Biblioteka Kombëtare. Përgjithësisht këto botime përdoren si burime informacioni për të ndjekur ecurinë e ndërtimit dhe arsyet që kanë ndikuar në transformimin e tyre apo në shfaqjen e dukurive të reja.

Për të ilustruar disa aspekte të rëndësishme të transformimit të banesës, janë shfrytëzuar edhe burime të tjera si: fotografi të realizuara në terren dhe ato të mbledhura në familje të ndryshme.

*Së treti*, kemi realizuar anketime dhe pyetësorë për probleme të ndryshme, kryesisht për transformimet e mënyrës së jetesës në ditët e sotme, si tipi i banesave, aksesorët e saj të jashtëm dhe të brendshëm etj. Janë marrë si kampion 600 anketa. Janë përzgjedhur mosha nga 18 vjeç deri në 65 vjeç. 50% e të anketuarve janë me arsim nëntëvjeçar dhe të mesëm, 30% me arsim të lartë dhe 20% me arsim pasuniversitar.

### III. Gjetjet dhe rezultatet

Në bazë të gjetjeve në terren tregohet se transformimet e banesave kanë ardhur si rezultat i disa faktorëve të rëndësishëm. Do përmendim faktorët e brendshëm rrethanorë, që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me transformime brenda kontureve krahinore, pa u ndikuar nga pjesa e jashtme, dhe faktorët e jashtëm që lidhen me transformime kombëtare ardhur si nevojë e detyrimit nga sistemi komunist, si dhe transformime rrënjësore për t'iu përshtatur nevojës që impononte koha e tranzicionit pas viteve '90. Si fillim, përmenden transformimet në tipat e banesave; transformime bazike në përdorimin e materialeve të ndërtimit; transformime në organizimin e oborrit dhe aksesorët e saj; transformime që ka pësuar arkitektura e banesës në arredimin e brendshëm të saj. Në bazë të anketave, rezulton se 70 % e përgjigjeve flasin për transformim total të modelit të banesave ku nuk u kursyen edhe pjesët shoqëruese të saj, si arredimi i brendshëm dhe oborri. Ajo që

vihet re nga gjetjet është se 30 % mendojnë se në fshatra të ndryshme është ruajtur pozicionimi dhe disa elemente tradicionale të banesës tiranase. Gjithashtu nga gjetjet, rezulton se 40% e të anketuarve të moshave 40-65 vjeç kanë nostalgji dhe insistojnë në ruajtjen deri diku të banesës tradicionale tiranase, ndërsa 60% e të anketuarve të moshave 20-40 vjeç janë për transformim total të saj.

### **1. Pozicionimi i banesave dhe ngushtimi i hapësirave të gjera**

Në traditën e vjetër popullore shqiptare faktori themelor i krijimit dhe qëndrueshmërisë së familjes ka qenë banesa. Për këtë arsye bashkësia familjare është identifikuar me banesën si një ndër elementet bazë të shoqërisë sonë. Karakteristikë bazë në fshatra të ndryshme të Tiranës është tipi i banesës me «shtëpi zjarri», për këtë arsye quhet banesa tiranase për shkak të përhapjes së madhe që ka marrë kryesisht në këtë zonë. Shtëpia e zjarrit është mjedisi i parë dhe shpesh i vetëm jo vetëm në banesat e fshatrave të Tiranës, por në të gjithë Shqipërinë dhe luan një rol të rëndësishëm në jetën e familjes. Shtëpia e zjarrit ose dhoma e zjarrit dhoma e ndenjes sot,<sup>1</sup> ruajnë në të gjitha variantet vendin qendror në kompozimin e banesës. Në gjendjen e sotme, numri i shtëpive të zjarrit të ruajtura në formën origjinale ose me pak ndryshime, është mjaft i vogël, megjithatë ato që ruhen mundësojnë karakterizimin e plotë të këtij ambienti. Ecuria e këtij tipi, nga më të thjeshtët e deri tek ato më të zhvilluarat, paraqitet e larmishme dhe mjaft interesante. Larmia vihet re dukshëm, sidomos kur kalohet nga pjesa fushore e kodrinore e Tiranës në atë malore. Nëse në malësi banesa në fjalë paraqitet e tipit të mbyllur, në pjesën e ulët dhe kodrinore mbizotëron karakteri i hapur i saj, me përdorimin e gjerë të hajateve dhe çardakëve. Megjithatë, duke i studiuar dhe duke i

---

<sup>1</sup> Shtëpia e zjarrit ka marrë disa emërtime në periudha të ndryshme kohore dhe është trajtuar si: dhoma e zjarrit, dhoma e ndenjes, dhoma e gatimit etj.

parë me kujdes, rezulton se koncepti themelor kompozicional është i njëjtë (*Muka, 2001*).

Shtëpia e zjarrit ndodhet në qendër, ndërsa përreth saj shtohen ambiente të tjera nga dy deri në tri kate. Duke qenë se faktori themelor i banesës është familja, kjo e bën atë që të paraqitet si kategori historike me të kaluarën e saj, të tashmen dhe të ardhmen. Format e zhvilluara të banesës tiranase pasqyrojnë ekzistencën e familjes së madhe dhe të kamur. Për aq kohë sa kjo familje ka qenë e pranishme, tipi i banesës që përmendëm e ka pasqyruar këtë dukuri në kompozimin e vet planimetriko-volumor. Shtëpia e zjarrit mbetet gjithnjë qendër e jetës së përditshme të familjes dhe njëherazi edhe si qendër kompozimi, duke u rrethuar me ambiente të tjera. Të gjitha nevojat kryesore për banim të familjes së madhe, fillimisht janë zgjidhur brenda një hapësire të vetme. Por njëkohësisht kjo nuk përjashton edhe praninë e aksesorëve dhe ndërtimeve të tjera në oborr, por me funksione të tjera ekonomike e shërbimi. Shkalla e përhapjes së kësaj banese në përgjithësi dhe e formave të zhvilluara të saj në veçanti, tregojnë se familja e madhe në këtë zonë ka qenë e pranishme për një periudhë të gjatë dhe pothuajse në çdo fshat dhe krahinë të Tiranës.

## **2. Arkitektura e përdorur dhe prakticiteti i saj në aspektin jetësor**

Gjurmimet dhe të dhënat e marra në terren krahas literaturës (*Muka, 1982*), tregojnë se familja e madhe këtu i ka zgjidhur nevojat për banim edhe nëpërmjet rrugëve të tjera. Është fjala pikërisht për komplekse banimi, të ndërtuara në qendra të ndryshme, si dukuri e rëndësishme për këtë zonë. Të tilla janë ato ndërtime ku brenda oborreve të rrethuara tërësisht ose pjesërisht, vendosen njësi të përgatitura ose ndërtesa të veçanta me funksione të caktuara banimi. Ato, të marra së bashku, plotësonin kërkesat e familjes në etapa të caktuara kohore. Duke u ndalur tek analizimi i banesës

tiranase duhet thënë se pozicioni gjeografik dhe veçoritë natyrore (relievi, klima, hidrografia, tokat e bimësia etj), dëshmojnë qartë mundësitë dhe rezervat që i ka ofruar natyra banorit të kësaj zone. Mundësitë potenciale kanë luajtur rol edhe në veprimtarinë ndërtimore, e cila pasqyrohet qysh në zgjedhjen e trojeve për banim e në vendosjen e fshatrave. Në varësi të pozicionit të vendbanimeve, janë shfrytëzuar edhe materiale të ndryshme rrethano-re.



Fig.1. Banesë e gjurmuar në fshatin Prezë 150-vjeçare  
Foto : M. Xhaferri, korrik 2020



Fig. 2. Banesë e gjurmuar në fshatin Petrelë 100-vjeçare  
Foto : M.Xhaferri, korrik 2020



Kështu në ndërtimin e mureve të banesave në zonat malore mbizotëron guri; në zonat e ulëta vendin e tij e kanë zënë druri dhe qerpiçi, ose kombinimet gur-qerpiç. Në mbulimin e çatave në zonat e larta, është përdorur rrasa e gurit, ndërsa në të ulëtat tjegulla e lugët ose ky material i kombinuar me rrasa guri. Natyrisht kjo nuk përjashton përdorimin e ndonjë materiali tjetër rrethanor, më pak të kushtueshëm si p.sh., kashta për mbulimin e çatave, gardhi me purteka për ndarjen e pareteve të murit të lyer me qerpiç etj. Edhe klima dhe larmia e saj kanë lënë "vulën" e vet në karakterin e mbyllur ose të hapur të banesave. Duke parë ecurinë e ndërtimeve dhe sidomos duke u mbështetur edhe në pohimet e banorëve të ndryshëm të intervistuar, vihet re që kjo trevë ka ofruar kushte të mira jetese në çdo kohë. Tipi i banesës me shtëpinë e zjarrit në qendër, nuk ka qenë i lidhur vetëm me zonat fushore, por edhe me ato malore, sigurisht me ndryshime të vogla në përshtatje me relievin dhe kushtet klimatike. Ajo që vihet re është se ekziston një lidhje dhe ndërvarësi ndërmjet fshatrave të konsideruar si kryeqendër dhe fshatrave të tjera që përfshihen nën juridiksionin e tyre. Dukuri të tilla vihen re sidomos në zonat kodrinore dhe fushore. Gjatë anketimeve të disa banorëve të rrethinave të Tiranës, ajo që bie në sy është fakti se, kur i pyet nga janë, ata priren të thonë emrin e ndonjërit nga këto fshatra mjaft të njohura edhe sot, siç janë: Petrela, Preza (sot sipas ndarjes së re administrative i përket bashkisë Vorë), Ndroqi, Peza, Shupali, Shëngjergji etj., të cilat kanë qenë qendra të zhvilluara para pushtimit turk. Dihet se qyteti filloi të dalë në skenë si qendër e madhe banimi relativisht vonë. Kujtojmë që në shek. XVI, Tirana nuk njihet si kryeqendër e rrethinave të saj. Përkundrazi më të njohura dhe më të rëndësishme në këtë kohë ishin : Petrela, Preza, Shëngjergji etj. Po kështu në kujtesën e banorëve, sidomos të malësisë së Tiranës, qëndron ende sot ndarja e saj në dy nahije si: Benda dhe Tomadheja, që ishin pjesë e Kazasë së Akhisarit (Krujë)

(Frashëri, 2004). Të dyja këto njësi, ndonëse formojnë së bashku malësinë e Tiranës, ruhen në kujtesën e të moshuarve si qendra të rëndësishme banimi dhe ekonomike, shumë të njohura për kohën.



Fig. 3. Mur ndarës me purteka dhe lyster me qerpiç  
Foto: M.Xhaferri, dhjetor 2020



Fig. 4. Pamje e brendshme e ndërtimit të murit qendror  
Foto: M.Xhaferri, dhjetor 2020

### 3. Transformimet e arkitekturës së banesës dhe mobilimit pas viteve '60 të shek. XX

Në bazë të anketave rezulton se në 80% e të anketuarve, theksojnë se pati ndryshime të dukshme në mënyrën e jetesës në disa fshatra si Petrela, Peza, Dajti, Preza etj., të cilat kanë filluar në vitet '60-'70 të shek. XX, por më të dukshme këto ndryshime u shfaqën në periudhën pas viteve '90, kur ndodhën transformime të thella në të gjithë jetën e shoqërisë shqiptare. Ndryshimet e para filluan me ndërtimin e banesave të reja, pastaj ndryshime pësoi mënyra e të veshurit dhe ushqyerit si dhe gjithë jeta shoqërore në fshatrat e Tiranës. Këto ndryshime erdhën si rezultat i standardeve që u ofruan ndërmarrjet bujqësore shtetërore punonjësve, ku paga e tyre në këto ndërmarrje ishte relativisht më e lartë se ajo e kooperativave të zakonshme, gjë që u shpreh në rritjen e standardit të jetesës. Kjo u shoqërua edhe në ndryshime të thella në mentalitetin e jetesës, si p.sh. në shpërbërjen e familjes së madhe patriarkale etj. Filluan të ndërtoheshin shtëpi me materiale të siguruara nga ndërmarrjet shtetërore. Tashmë vendin e përdorimit të gurit dhe qerpiçit filluan ta zinin tullat e kuqe, të cilat siguroheshin në fabrikat e tullave. Krahas tyre filluan të përdoren edhe tullat e bardha silikate si material ndërtimi.

Nga fundi i viteve '50 filloi ndërtimi i tavaneve në shtëpitë e fshatrave të Tiranës (Petrelë, Pezë, Dajt, Shëngjergj, Baldushk, Bërxullë, Domje etj.). Krahas me këtë u ngritën edhe grupet e para të ustallarëve vendës. Filloi edhe ndërtimi i soletave dhe i përdorimit të letrës katrama për izolim nga shiu. Në vitet '70 për shtrimin e dyshemeve të shtëpive filluan të përdoshin **pllakat** që prodhoheshin nga Kombinati "Josif Pashko"-Tiranë, të cilat ishin me përbërje çimentoje. Sipas pohimit të të intervistuarve dhe rezultateve të anketave, në vitet '70-'80, fshatarët tiranas nuk kishin nevojë të shkonin në pyll për të siguruar lëndën drusore për ndërtimin e çative, sepse filluan të përdoshin kapriatat prej

dërrase të trasha. Edhe shtëpitë e vjetra prej guri fshatarët filluan t'i suvatojnë nga brenda (disa edhe nga jashtë). Modelet e shtëpive filluan të ndryshojnë. Më shumë pëlqej modelin e shtëpisë "elbasance" (Muka, 1976). Ky model përfaqësohej nga shtëpia njëkatëshe e cila u bë bazë kryesore e ndërtesave në rrethin e Tiranës gjatë viteve '70-'80. Shtëpitë njëkatëshe filluan të zëvendësonin kullat dykatëshe prej guri. Sot këto shtëpi nuk janë të pakta, zënë rreth 25% të banesave në fshatra si: Bërxullë, Prezë, Baldushk etj.



Fig.5 Shtëpi njëkatëshe e ndërtuar në 1960 në Prezë  
Foto: M.Xhaferri, prill 2021



Fig.6. Shtëpi 100-vjeçare e modifikuar në Dajt pas 1970  
Foto: M.Xhaferri, prill 2021

Dhomat e mëdha të zjarrit ku dikur përdorej vatra, tani filluan të ktheheshin në kuzhina me përmasa më të vogla dhe me kushte më të mira higjienike (*Muka, 1984*). Gatimi tashmë bëhet me stufa (soba) gize që prodhoheshin në uzinat mekanike të vendit. Këto soba lyheshin me varak të bardhë për t'i dhënë pamje estetike. Tubat ishin prej teneqeje, po ashtu, lyheshin me varak. Pak nga pak filluan të hiqeshin hasrat (rrogozat) meqenëse dhomat shtroheshin me çimento ose me pllaka. Në disa fshatra, në bazë të anketave, 70% e familjeve mbi dyshemenë prej çimentoje shtronin *qylyma* leckash (qilima të punuar në vegjë me rripa të hollë leckash nga gratë e familjes), ndërsa 30% e tyre shtronin qilima të punuara në Ndërmarrjen Artistike të Krujës (*Onuzi, 1982*), që tregtoheshin në pazarin e Krujës. Vendin e sofrës pas viteve '60 e zuri tavolina. Për ndenje filluan të ndërtonin mindere që luanin rolin e divaneve të sotëm. Ndërtimi i mindereve ishte i thjeshtë dhe pa shpenzime, sepse përdoreshin vetëm dërrasa dhe binarë. Sipër u shtronin çilte (shilte) fillimisht mbushur me bar dhe më vonë me pambuk ose lesh deleje. Mbulesa preferohej prej damasku (copë e trashë që përdoret për veshjen e divaneve sot). Si mbështetëse përdoreshin jastëkët që viheshin mbi mindere dhe mbështeteshin në mur. Këllëfët prej pëlhure të jastëkëve punoheshin në vegjë. Vendin e hambarëve, të përdorur dikur në dhomat e zjarrit, e zunë raftet e bukës me dy kapakë, pjesërisht të bërë me rrjetë teli (site). Aty vendosnin pjatat, lugët, pirunët, tasat prej alumini ose plastike, gotat e madhësive të ndryshme qoftë prej alumini apo prej qelqi. Sirtarëve të raftit u shtronin gazeta që i zbukuronin duke i prerë me gërshërë në forma të ndryshme. U zhdukën sergjenët, ku dikur vendoseshin orenditë për gatim e ngrënie (tepsitë, tenxheret, pjatat etj.). Familjet me gjendje më të mirë ekonomike filluan të përdornin bufetë e vogla që zëvendësuan raftet me dy kanate. Pas viteve '60 të shek. XX nëpër sallone (korridore të brendshme), apo

dhomat e gatimit nuk shikoje më gjyma e enë të tjera të mbushura me ujë dhe të mbuluara me peshqirë të gjatë pëlhure, t'endur në vegjë. Kjo ndodhi, sepse në të gjitha fshatrat e rrethit të Tiranës, në pjesën më të madhe, uji u fut në oborre dhe në disa raste edhe në lavamanët, të instaluar në kuzhina. Enët e mëparshme (gjymat prej bakri ose prej teneqeje,) u zhvendosën jashtë shtëpive, në mjediset e jashtme ose rrëzë fasadave të shtëpive.

Dhoma e miqve filloi të quhej “dhoma e pritjes”. Përgjithësisht vendin e oxhakut filluan ta zënë sobat e ngrohjes që ishin thjesht prej teneqeje. Mbi dyshe-menë prej dërrase ose çimentoje shtroheshin qilima prej leshi që tregtoheshin kudo. Pëlqeheshin më shumë qilimat e punuar në Ndërmarrjen Artistike të Krujës. Zakonisht bëheshin me përmasa 3x4 m, me ornamente e ngjyra të ndryshme dhe kushtonin gati sa tri rroga të një nëpunësi. Jastëkët e mindereve visheshin me këllëfë, të zbukuruar me qëndisje e dantella të punuara me grep. Minderet ndërtoheshin me rripa gomash që luanin rolin e sustave për të krijuar një butësi në krahasim me dërrasat. Rripat bëheshin me kamerdaret e makinave. Në fund të viteve '70, filluan të përdoren divanet me susta (*Onuzi, 1982*).

Pas prillit të vitit 1967 kur u bë elektrifikimi i gjithë Shqipërisë, ashtu si në të gjithë fshatrat e Shqipërisë edhe në fshatrat e Tiranës vendin e kandilave dhe llambave me vajguri e zunë llambat elektrike. U blenë radiot e para që nxirreshin nëpër sallone jashtë dhe volumi i tyre ngrihej lart që ta dëgjonin edhe komshinjtë dhe një pjesë e lagjes, meqenëse radiot ishin të rralla (rrëfime nga banorë të fshatra Pezë, Petrelë, Shëngjergj, Dajt, Baldushk). Vetëm 20% e familjeve në fshatrat Pezë (fshat sot i përfshirë në bashkinë e Vorës, mbi bazën e ndarjes së re administrative), Pezë, Petrelë, Dajt, Shëngjergj, kishin mundësinë ekonomike të blinin një radio, ndërsa pjesa tjetër në pamundësi për ta blerë, dëgjonin emisionet nga komshinjtë ose të afërmit e tyre. Në dhomat e pritjes në

fshatrat e ndryshme u futën edhe bufetë e mëdha, ku vendosnin qelqurinat. Raftet e bufesë i zbukuronin me dantella të punuara me grep nga gratë dhe vajzat e familjes. Vetëm pak familje kishin mundësinë ekonomike të blinin bufe, rreth 15% të tyre, kryesisht familje me nëpunës shtetërorë që punonin si: inxhinierë, mësues, apo mjekë, ndërsa punonjësit e kooperativave nuk e përballonin dot me pagat që kishin. Edhe dritaret e dhomave filluan t'i zbukurojnë me perde të vogla të punuara me grep. Më vonë filluan të përdorshin perdet e gjata deri në dysheme, të bëra prej cope basme ose puplini me ngjyra, të zbukuruara me qëndisje.

Pas viteve 1970, pothuajse në të gjitha fshatrat e rrethit të Tiranës u futën edhe frigoriferët e parë (të cilët jepeshin me autorizim), (*rrëfim i A. Demirxhiut, banor në fshatin Prezë*). Por për çudi ato nuk vendoseshin në dhomën e ndenjjes ku familjarë kalonin gjithë kohën, por në dhomat e pritjes duke i trajtuar si objekt zbukurimi, duke ngjallur/ shkaktuar një ndjenjë zilie te vizitorët e miqtë e familjes.

Rreth vitit 1972, u futën edhe televizorët e parë, bardh e zi, që montoheshin në Durrës, po që ishin shumë të rrallë dhe ndaj jepeshin me autorizim. Domosdo që edhe vendi i televizorit ishte në dhomën e pritjes për të njëjtën arsye, si dhe të numrit të madh të miqve apo komshinjve që vinin për të parë programet disaorëshe televizive të RTSH-së. Në muret e banesave në fshatrat e Prezës, Dajtit, Petrelës etj., përveç stendave me fotografi familjare, filluan të vendosen edhe piktura (kryesisht nga piktorë provincialë) dhe banda muri të qëndisura nga gratë e familjes.



Fig.7. Raft një kanat ku mbahej buka dhe enë kuzhine  
Foto: M.Xhaferri, shtator 2021



Fig. 8. Objekte si radio, televizor dhe enë të ndryshme  
Foto: M. Xhaferri, shtator 2021

#### 4. Dukuri të reja në arkitekturën e banesës pas viteve '90 të shek. XX

Pas viteve '90 të shek. XX për ndërtimin e shtëpive filluan të përdreshin **blloqet** prej çimentoje, sidomos nga familjet me të ardhura të pakta financiare. Nga anketimet rezulton se 45% e familjeve fshatare përdornin bllokun si material ndërtimi. Kjo për faktin se blloqet kushtonin më lirë krahasuar me tullat dhe afati i



ndërtimit të shtëpisë ishte më i shkurtër. Gjithashtu përveç tjegullave tradicionale pas viteve '90, filluan të përdoren edhe tjegullat e importit, që ishin më cilësore dhe me ngjyra të ndryshme. Ndërtesat 3-4 katëshe pas viteve '90 u bënë nga më të preferuarat dhe u ndërtuan më shumë nga familjarët që kishin fëmijët e tyre emigrantë në vendet e Europës, kryesisht në Itali, Greqi, Angli etj. Shumë modele vilash u sollën nga vendet ku banojnë këta emigrantë, të cilët janë përpjekur të sjellin stile banesash tepër moderne për jetën e banorëve. U shtuan gjithashtu edhe garazhet e makinave personale (familjare), të cilat më parë nuk njiheshin fare. Nga gjurmimet në fshatrat e Tiranës si: Petrelë, Dajt, Shëngjergj, Domje etj., vërehet se 80% e familjeve kanë pësuar një transformim të thellë në ndërtimin e banesave, ku shihen vilat e bukura të ndërtuara me dy, tri, por dhe katër kate, me oborre të sistemuara mirë dhe me një shumëllojshmëri lulësh, pemësh dhe sipërfaqe të gjelbëruara. Mund të thuhet se, sot, në peizazhin e fshatrave të Tiranës si në Dajt, Prezë, Petrelë etj., mbizotërojnë shtëpitë dhe vilat moderne me mjedise përreth shumë të rregulluara. Pas viteve '90 dhomat e pritjes pësuan ndryshime të thella. U hoqën bufetë, për t'u lënë hapësirë divaneve-kënde apo completeve të divaneve dhe tavolinës së mesit. Për perde të dritareve filloi të përdorej tyli me ngjyra të ndryshme, që më vonë u kombinua me perde të trasha. Vit pas viti ndryshoi zbukurimi, duke veshur me tyl gjithë faqen e murit ku ishte dritarja (vendosur në shina). Përsëri iu kthyen mbajtësve të drurit, perdeve dopjo etj., dhe në familje të veçanta me nivel të mirë ekonomik u vendosën minibaret (*Xhafferri, Tase, 2012*). Filluan të përdoshin parketet prej dërrase kryesisht në dhomat e pritjes dhe njëkohësisht filluan të shtroheshin tapetë të përmasave dhe ngjyrave të ndryshme, të cilat ishin mallra importi nga vendet e Lindjes, si Turqi, Kinë etj. Nëse deri në fillim të shek. XX dhomat e miqve përdoshin kryesisht për fjetje, në vitet '90 të këtij shekulli, ato funksiononin vetëm për

pritjen e miqve. Duhet thënë se për pajisjen e dhomave të pritjes tregohet e njëjta vëmendje dhe i njëjti kujdes, si në periudhat e mëparshme.

Ndryshime të mëdha pësuan edhe odat e fjetjes. Në periudhat e kaluara, odave të fjetjes nuk u kushtohej shumë vëmendje dhe orenditë e saj ishin shumë të pakta, dollapë të vendosur në brendësi të murit (musëndra), futeshin rrobat e fjetjes, ose në ndonjë rast mund të gjeje ndonjë sënduk, me përmasa të ndryshme. Pas viteve '60-'70 odat e fjetjes filluan të ndryshonin ashtu si odat e tjera. Pas vitit 1965, hynë për herë të parë mobilie druri, të cilat punoheshin në ndërmarrjet e punimit të drurit. Pas viteve '90, filluan të porositeshin mobilie importi, por njëkohësisht filluan të prodhoheshin edhe në Shqipëri nga firma private të cilat merreshin me punimin e mobilieve. Do të përmendja këtu, kryesisht zonën e Niklës, zonën e Dajtit, zonën e Baldushkut etj., të cilat vazhdojnë të punojnë intensivisht për të plotësuar nevojat vendëse dhe më gjerë.



Fig.9. Banesë e tipit vilë e gjurmuar në Prezë  
Foto: M.Xhaferri, prill 2018



Fig.10. Banesë e tipit vilë e gjurmuar në Dajt  
Foto: M.Xhaferri, prill 2018

Ndryshime mori dhe struktura dhe përmbajtja e oborrit. Ndryshimet e para filluan pas viteve '60, por pas viteve '90 transformimet ishin tepër të mëdha. Në organizimin e oborrit pas gjysmës së dytë të shek. XX luajti rol kolektivizimi i bujqësisë, përfshirë edhe tufëzimi i bagëtive. Kjo gjë e ndryshoi strukturën e oborrit, mbasi u pakësua numri i bagëtive, ose u ndalua fare mbajtja e tyre. Kësisoj, oborri u pastrua nga kasollet e bagëtive, por edhe nga veglat bujqësore. Kështu ndodhi ndryshimi i parë në oborr, ku familjet filluan t'i kushtonin rëndësi edhe rrethimit të tyre me avlli guri e tulle dhe më vonë edhe me blloqe. Nëse përpara viteve '50 të shek. XX në shumë fshatra oborret ishin të parrethuara, sidomos ato të zonës së malësisë së Tiranës, në vitet '70, rreth 90% në familjet e fshatrave malore, kodrinore dhe fushore, filluan të ndërtonin mure rrethuese dhe ndarëse që krijuan një farë privatësie (intimiteti). Në vitet '80 filloi rrethimi me pllaka të mëdha betoni, të cilat kufizoheshin dhe futeshin në kolona prej betoni (Muka, 1986). Ndryshime të tjera u shfaqën edhe në oborret e banesës, pasi filluan të ndërtoheshin mure dekorative

të veshura me pllaka mermeri ose argjile, sidomos tek ato familje të cilat kishin ndërtuar vila të bukura, sipas stileve perëndimore të ndërtimit. Kjo realizohej te të gjitha ato familje që kishin fëmijët në emigracion dhe të ardhurat ishin shumë herë më të bollshme. Përveç rrethimit të oborreve, vëmendje iu kushtua edhe zbukurimit të ambienteve në oborr, duke vendosur lule e gjelbërim. Përveç këtyre mbilleshin edhe agrume (portokaj, limonë, mandarina), të cilat kishin munguar në këto zona. Edhe hardhitë në pjergulla filluan të përhapen gjerësisht. Shumë familjarë ngritën edhe skelete metalike me tuba dhe hekura, mbi të cilat shpërndanin hardhitë nga porta deri te dera e shtëpisë, duke krijuar një “tunel” që shërbente edhe për hije në stinën e pranverës dhe të verës (*Muka, 1991*).

Me ndërtimin e shtëpive të reja, pas viteve '90, sidomos pas fillimit të shek. XXI, emigrantët sollën frymën e transformimeve të dukshme në mjediset e oborreve. Bari zbukurues, drurët dekorativë, vazot e ndryshme për mbjelljen e luleve të ndryshme, që dikur nuk njiheshin në këtë zonë, ndriçimet dekorative etj., janë dëshmi të këtyre ndryshimeve kolosale që ndodhen edhe po ndodhin në fshatrat e gjithë Shqipërisë. Jo vetëm kaq, në oborret e disa shtëpive, rreth 30% e familjeve në fshatra si: Dajti, Shëngjergji, Petrela, Peza, Preza u vendosën edhe kënde lojërash për fëmijët, të cilët e shndërruan oborrin në një ambient argëtues për fëmijët, por edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes. Sipas gjurmimeve të bëra në terren (në Petrelë, Pezë, Dajt, Shëngjergj, Baldushk, Bërxullë etj.), mund të themi me plot bindjen se banorët e rrethit Tiranë, pas viteve '90, kanë një standard jetese shumë herë më të lartë se para viteve '50 të shek. XX.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Arkitektura e banesës tiranase fillon nga fazat më të hershme të ndërtimit të saj me vatër zjarri përgjatë kateve, në banesa të tipit

"elbasançe" dhe pas viteve '90 banesa të tipit "vilë". Transformimet e banesës tradicionale filluan në vitet '50 të shek XX, me një model shumë ndryshe nga tipi i mëparshëm. Ky model përfaqësohej nga shtëpia njëkatëshe e cila u bë bazë kryesore e ndërtesave në fshatrat e Tiranës pas viteve '70. Shtëpitë njëkatëshe filluan të zëvendësonin kullat dykatëshe prej guri. Sot këto shtëpi nuk janë të pakta në fshatra të ndryshme të Tiranës. Pas viteve '90 transformimet në arkitekturë të banesës janë rrënjësore, u bënë të preferueshme vilat 3-4 katëshe. Ndryshime të dukshme u vunë re sidomos në aspektin e mobilimit të këtyre banesave. Kemi një transformim total duke filluar, qysh nga dhoma e ndenjjes dhe duke përfunduar te dhoma e miqve. Banesa tiranase u bë një model banese bashkëkohore, tepër moderne, që ngritën jo vetëm standardin e jetesës, por u ofronin komfortin dhe komoditetin banorëve të fshatrave të Tiranës. Disa rekomandime që sugjerojmë në këtë punim janë:

1. Ndërgjegjësimi i banorëve të fshatrave të Tiranës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e banesave tradicionale ekzistuese, si pjesë e trashëgimisë kulturore.
2. Gjenerimi i fondeve të veçanta nga pushteti lokal për restaurimin e banesave të vjetra tiranase dhe promovimi i tyre në site të ndryshme turistike, për ngjalljen e interesit nga vizitorët e huaj, por dhe ato vendës, për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Literatura**

Frashëri, K., (2004), " Historia e Tiranës " vëll. I Shtëpia Botuese " TOENA" Tiranë.

Muka, A., (2001) "Banesa fshatare dhe familja e madhe", Botim i "Akademisë së Shkencave", Tiranë.

Muka, A., (1982), Një kompleks banimi në fshatin Brar (Tiranë) në revistën."Etnografia Shqiptare" nr. 12, Tiranë, f. 191-199.

Muka, A., (1976), Banosat fshatare në Malësinë e Tiranës gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, "Etnografia Shqiptare" Vëll, IX Tiranë, f. 209-312.

Muka, A., (1984), Vendi i zjarrit në banesën fshatare të Shqipërisë së Mesme (vatra dhe oxhaku), "Kultura Popullore" nr. 2, Tiranë, f. 29-54.

Muka, A., (1986), Ndërtime ndihmëse dhe ekonomike të familjes fshatare, "Kultura Popullore" nr. 2, Tiranë, f. 62-79.

Muka, A., (1990), Themelet e banesës në mendësinë popullore, "Kultura Popullore" nr. 1, Tiranë, f. 107-123.

Muka, A., (1991), Oborri i banesës fshatare (Pellgu i Shqipërisë së Mesme), "Kultura Popullore", nr. 1, Tiranë, f. 134-148 .

Muka, A., (1988), Ndërtimet fshatare në luginën e Shkumbinit, "Etnografia Shqiptare" nr. 16, Tiranë, f. 133-169.

Onuzi, A., (1982), Ndryshime në mënyrën e jetesës së klasës punëtore në NB, Kamzë, "Etnografia Shqiptare" nr. 12, Tiranë, f. 63-77.

Xhaferri, M, Tase, M., (2012), Environment in Tirana and its pollution as a result of urban development after 90 years, Journal of, "Environmental Science and Engineering" (USA), 8(1), T T, f. 85-91.

## **PANELI III**

# **FUNKSIONET, ZHVILLIMI DHE TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE NË RAJONE TË SHQIPËRISË**





**Prof. asoc. dr. Valbona Duri<sup>1</sup>**

**Dr. Fatlinda Shkurti<sup>2</sup>**

**Prof. dr. Niko Rogo<sup>3</sup>**

## **RRJETI I QENDRAVE TË BANUARA, SHTRIRJA DHE SHPËRNDARJA HIPSOMETRIKE E TYRE NË QARKUN E GJIROKASTRËS (1989-2009)**

### **Abstrakt**

Rrjeti i qendrave të banuara në territorin në studim është krijuar gjatë një procesi të gjatë historik, që nën efektin e kushtëzuesve ekonomiko-shoqërorë, ka marrë tipare të përcaktuara tipologjiko-funksionale. Në këtë proces një rol i rëndësishëm u atribuohet kushteve fiziko-gjeografike (gjeomorfologjike, klimatike, hidrologjike, pedologjike etj). Tipologjia e tyre është e larmishme në varësi të: shtrirjes, gjenezës, formës, madhësisë, aktivitetit ekonomik, mënyrës së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës etj. Shpërndarja e vendbanimeve sipas hipsometrisë paraqet interes të veçantë, pasi nëpërmjet saj shihet dhe evidentohet shkalla e popullimit të vendbanimeve në këtë aspekt. Sipas hipsometrisë (tipave të relievit), rreth 45.8 % e qendrave të banuara është përqendruar në relievin kodrinor, veçanërisht në atë të ulët kodrinor 301-600 m dhe 1.5% në lartësitë mbi 1000 m. Ndërsa numri i qendrave të banuara reduktohet me rritjen e hipsometrisë, treguesi i largësisë mesatare midis

---

<sup>1</sup>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti Histori-Gjeografi. E-mail: bongjeo@yahoo.com

<sup>2</sup>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Edukimit. E-mail: fshkurti@yahoo.com

<sup>3</sup>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti Histori-Gjeografi. E-mail: nrogo@yahoo.com

vendbanimeve vjen në rritje (në relacion të drejtë me rritjen e lartësisë). Ky tregues merr vlerën prej 2.6 km (22.0% më e vogël se mesatarja e qarkut), në relievin kodrinor, ndërsa rezulton 9.7 km në relievin malor. Përqendrimi më i madh i vendbanimeve në relievin kodrinor i dedikohet sidomos ndikimit të faktorëve gjeografikë si: përshtatshmëria e relievit në këto lartësi (për ndërtime), ekzistenca e ujit të pijshëm etj. Vendosija e pjesës më të madhe të vendbanimeve në lartësitë mbi 300 m (shkak kënetëzimi i fushave prej kaosit hidrologjik në të kaluarën). Ndërsa më pas, vendosja në këto lartësi (301-600 m), ka pasur si qëllim (nga popullsia), lënien e terreneve fushore për shfrytëzim.

*Fjalë çelës:* rrjeti i qendrave të banuara, largësi mesatare midis qendrave të banuara, shpopullim, tipologji, shpërndarje sipas hipsometrisë.

### **Abstract**

The network of inhabited centers in the territory under study has been created during a long historical process, and under the effect of socio-economic factors, has acquired defined typological-functional features. In this process an important role is attributed to physical-geographical conditions (geomorphologic, climatic, hydrologic, geologic, etc.) The distribution of settlements according to hypsometry is of special interest, as through it is seen and evidenced the rate of population of settlements in this aspect. According to hypsometry (types of relief), about 45.8% of inhabited centers are concentrated in hilly relief, especially in the low hilly 301-600m and 1.5% at altitudes above 1000m. While the number of inhabited centers decreases with the increase of hypsometry, the indicator of the average distance between settlements increases (in direct relation with the increase of height). This indicator takes the value of 2.6km (22.0% less than the average of the region), in the hilly relief, while it results in 9.7 km in the mountainous relief. The largest concentration of settlements in the hilly relief is especially dedicated to the influence of geographical factors such as: the suitability of the relief at these heights (for construction), the existence of drinking water, etc.

**Keywords:** network of inhabited centers, average distance between inhabited centers, depopulation, typology, distribution according to hypsometry.

### **I. Hyrje**

Në hapësirën në studim, gjatë periudhës së tranzicionit (pas viteve 1990), një nga rezultatet e zhvillimeve të reja demografike ka

qenë thellimi i ndryshimeve në shkallën e popullimit midis niveleve hipsometrike.

Në ndryshim me politikën demografike para viteve '90, që synonte një popullim të njëtrajtshëm të gjithë vendit në planin global, rajonal e më ngushtë pas viteve '90 në Shqipëri, konstituimi i lëvizjes së lirë të njerëzve, shënon një kthesë në këtë aspekt. Prezenca tashmë e një klime aprovuese për lëvizje të lirë stimuloi dukshëm migrimin, për më tepër atë brenda vendit. Prirja e përgjithshme ka qenë ajo tradicionale, largimi nga fshati dhe zonat malore drejt qytetit dhe fushave. Nga evidentimi i shpërndarjes së popullsisë sipas hipsometrisë, vihet se ka ndryshime në numrin dhe përqendrimin e saj, ndryshime këto që reflektojnë drejtpërdrejt ndikimin e kushteve jo të njëjta klimatiko-tokësore, veçoritë e riprodhimit, lëvizjeve hapësinore, treguesve të zhvillimit ekonomik-shoqëror etj.

## II. Metoda

Përdorimi i një metodologjie komplekse studimi ka përbërë domosdoshmëri, me qëllim evidentimin e ndryshimeve të ndodhura nëpërmjet grumbullimit, vëzhgimit të të dhënave në terren, analizës nëpërmjet përlllogaritjes së treguesve statistikorë sasiorë dhe cilësorë, krahasimit, intervistimit, hartografimit etj.

## III. Gjetje dhe diskutime

### 1. Shpërndarja e vendbanimeve dhe popullsisë sipas lartësisë

Rrjeti i qendrave të banimit në hapësirën në studim ka pësuar transformime të cilat përfshijnë si aspektin hapësinor, funksional, tipologjik etj. Ndikimi i faktorëve ekonomik-shoqërorë, gjeografikë, historikë etj., ka ndikuar në rrjetin e qendrave të banuara në numrin, madhësinë, veçoritë e shtrirjes dhe ndërtimit etj. (*Bërxfholi, 1987*). Shpërndarja e vendbanimeve në qark në

aspektin horizontal paraqitet: rreth 35.6 % e numrit të përgjithshëm të vendbanimeve të qarkut janë vendosur në rrethin e Gjirokastrës<sup>1</sup> që zë 39.4% të sipërfaqes së përgjithshme. Ndërkohë po 35.6% e vendbanime rezultojnë të vendosur në rrethin e Përmetit që zë 32.2% të sipërfaqes së qarkut dhe 28.8% e tyre është vendosur në 28.4% të sipërfaqes në rrethin e Tepelenës. Kjo shpërndarje është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kushteve gjeografike, historike etj. Treguesi i dendësisë së vendbanimeve për njësi të sipërfaqes rezulton 9.5 vendbanime për 100 km<sup>2</sup>. Në qark vërehet se dendësinë më të madhe të rrjetit të vendbanimeve e ka Përmeti me 10.0% më të lartë se mesatarja e qarkut. Ndërsa rrethet Gjirokastër dhe Tepelenë kanë tregues nën mesataren e qarkut.

Tabela 1. Numri i qendrave të banuara për 100 km<sup>2</sup> në Qarkun Gjirokastër

Njësitë	Vitet			
	1945	1979	1989	2009
<b>Qarku</b>	<b>8.8</b>	<b>9.6</b>	<b>9.6</b>	<b>9.5</b>
Qytet	2.5	5.0	5.0	5.0
Fshat	9.1	9.8	9.8	9.7
Gjirokastër	7.7	8.5	8.5	8.6
Fshat	7.9	8.6	8.6	8.7
Përmet	11.3	11.5	10.8	10.5
Fshat	12.3	12.4	11.6	11.4
Tepelenë	7.7	8.2	9.4	9.4
Fshat	7.6	8.0	9.4	9.4

Burimi: Vjetarët statistikorë 1945, 1979 dhe 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të qarkut Gjirokastër për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

<sup>1</sup> Sipas ligjit Nr.8653, dt.31.07.2000” Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, Qarku Gjirokastër me kryeqendër Gjirokastrën përfshinte 3 rrethe: Gjirokastër, Përmet dhe Tepelenë.

Përqendrimi më i madh i vendbanimeve në relievin kodrinor i dedikohet sidomos ndikimit të faktorëve gjeografikë si: përshtatshmëria e relievit në këto lartësi (për ndërtime), ekzistenca e ujit të pijshëm etj. Vendosja e pjesës më të madhe të vendbanimeve në lartësitë mbi 300 m ka pasur si shkak gjithashtu edhe kënetëzimin e fushave prej kaosit hidrologjik në të kaluarën. Më pas vendosja në këto lartësi (301-600 m) ka pasur si qëllim (nga popullsia) lënien e terreneve fushore për shfrytëzim. (*Evolucioni i proceseve gjeopopullative pas vitit 1990 në Qarkun Gjirokastrë, punim doktore, Duri, 2009*).

Krahasimisht me vitin 1989, rritja e këtij treguesi vërehet vetëm në lartësitë deri në 300 m, rrjedhojë e përqendrimit më të madh këtu të qendrave të reja të banimit, krahasuar me nivelet e tjera hipsometrike.

Tabela 2. Shpërndarja e vendbanimeve në qarkun e Gjirokastrës sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009 (në %)

Nivelet hipsometrikë	÷ 300		301-600		601-1000		+ 1000	
	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Vitet	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Nr.përgjithshëm i vendbanimeve	53	54	126	126	93	91	4	4
Pesha specifike (%)	19.2	19.6	45.7	46.0	33.7	33.1	1.4	1.3
Sipërfaqja e Përgjithshme (%)	14.8		13.8		31.0		30.4	

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Shpërndarja e popullsisë sipas hipsometrisë në qark tregon se numri më i madh i popullsisë është vendosur në lartësitë deri në 300 m mbi nivelin e detit (rreth 46.0 %, ku shtrihen dhe vendbanimet urbane me përjashtim të Libohovës 301-600 m), dhe

numri më i vogël në lartësitë mbi 1000 m (1.5%). Nëse kjo shpërndarje e popullsisë shihet sipas tipave të relievit, vihet re se:

- Në relievin fushor ( $\div$  300 m) që zë më pak se 15% (14.8%) të sipërfaqes së qarkut është përqendruar 55.3% e popullsisë së përgjithshme;
- Në relievin e ulët kodrinor (301-600 m), që zë 24.2% të sipërfaqes rezulton e vendosur 31.1% e popullsisë totale të qarkut.
- Në relievin e lartë kodrinor (601-1000 m), që zë pjesën më të madhe të sipërfaqes 31.0%, gjendet e vendosur më pak se 13% e popullsisë së qarkut.
- Në relievin malor (mbi 1000 m), që përbën 30% të sipërfaqes së përgjithshme gjendet e vendosur më pak se 2.0 % e popullsisë së qarkut.

Këtë situatë sipas hipsometrisë prezanton dhe numri mesatar i popullsisë për një qendër banimi. Me rritjen e lartësisë mbi nivelin e detit ky tregues shënon rënie.

Tabela 3. Ndryshimi i numrit mesatar të popullsisë / qendër banimi në qarkun e Gjirokastrës sipas hipsometrisë (1989-2009)

Nivelet hipsometrikë	$\div$ 300	301-600	601-1000	+ 1000
Nr.mes.pop./ vendbanim	24.2	- 5.7	- 28.7	- 43. 3
Nr.mes.pop./ vend.rural	13.5	- 7.1	- 28.7	- 43. 3

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Niveli më i lartë i këtij treguesi evidentohet në lartësitë deri në 300 m dhe më i ulët në lartësitë mbi 1000 m. Përkundrajt vitit 1989,

ky tregues evidenton rritje vetëm në territoret deri në 300 m lartësi (24.2%), ndërsa ka pësuar rënie në të gjithë nivelet e tjera. Rënia më e madhe e këtij treguesi evidentohet në lartësitë mbi 1000 m 43.3%, kur në lartësitë 601-1000 m dhe 301-600 m rënia ka qenë më e paktë, përkatësisht me rreth 29.0% dhe rreth 6.0% krahasimisht me vitin 1989. Zbritjet e popullsisë, nga nivelet e larta hipsometrike drejt terreneve të ulëta fushore, brenda dhe jashtë qarkut e bëjnë të qartë shpjegimin e situatës së mësipërme (*Evolucioni i proceseve gjeopopullative pas vitit 1990 në Qarkun Gjirokastrë, punim doktore, Duri V, 2009*).

## 2. Shpërndarja e vendbanimeve dhe popullsisë sipas njësive administrativo -territoriale

Sipas njësive administrativo-territoriale, në rrethin e Gjirokastrës vihet re se 50.0% e numrit të përgjithshëm të qendrave të banuara gjendet në lartësitë 301-600 m që zënë 21.0% të sipërfaqes së përgjithshme<sup>1</sup>.

Tabela 4. Shpërndarja e vendbanimeve në rrethin e Gjirokastrës sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009 (në %)

Nivelet hipsometrike	÷ 300		301-600		601-1000		+ 1000	
	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Vitet	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Nr.përgjithshëm i vendbanimeve	22	23	49	49	25	25	1	1
Pesha specifike (%)	22.7	23.5	50.5	50.0	25.8	25.5	1.0	1.0
Sipërfaqja e Përgjithshme (%)	15.9		21.0		29.6		33.6	

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

<sup>1</sup> Shënim. Në artikull për analizën e vendbanimeve gjatë periudhës 1989-2009, operohet në rrethe, sipas ligjit Nr.8653, datë 31.07. 2000 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", vendi ka qenë i ndarë në 12 qarqe dhe përbëhej nga 36 rrethe, 65 bashki dhe 309 komuna.

Numri më i madh i popullsisë për një qendër të banuar evidentohet në lartësitë deri në 300 m. Më i ulët ky tregues rezulton në lartësitë 601-1000 m.

Tabela 5. Ndryshimi i numrit mesatar të popullsisë për vendbanim në rrethin e Gjirokastrës sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009 (në %)

Nivelet hipsometrike	÷ 300	301-600	601-1000	+ 1000
Nr.mes.pop./vendbanim	26.8	5.9	3.6	- 54. 8
Nr.mes.pop./vendb.rural	24.7	4.0	3.6	- 54. 8

Burimi: Vjetari statistikor 1989 (RSSH) & arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Në rrethin e Përmetit, numri më i madh i qendrave të banuara evidentohet në lartësitë 301-600 m dhe 601-1000 m, përkatësisht 43.0% dhe rreth 42.0% të numrit të përgjithshëm të vendbanimeve të vendosura në 23.4% dhe 35.4% të sipërfaqes së rrethit.

Tabela 6 . Shpërndarja e vendbanimeve në rrethine e Përmetit sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009(në %)

Nivelet hipsometrike	÷ 300		301-600		601-1000		+ 1000	
	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Vitet								
Nr.përgjithshëm i vendbanimeve	11	11	43	43	43	41	3	3
Pesha specifike %	11.0	11.2	43.0	43.0	43.0	41.8	3.0	3.0
Sipërfaqja e Përgjithshme %	10.1		23.4		35.4		31.3	

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.



Numrin mesatar më të madh të popullsisë e kanë vendbanimet rurale në lartësitë deri në 300 m, rreth 1700 banorë që përkundrejt vitit 1989 është rritur me 32.5%. Prirja që evidentohet në këtë aspekt është se numri mesatar i banorëve për qendër banimi në të gjitha nivelet e tjera, pas 1990 shënon rënie, ndonëse e diferencuar sipas niveleve hipsometrike.

Tabela 7. Ndryshimi i numrit mesatar të popullsisë për vendbanim në rrethin e Përmetit sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009 (në %).

Nivelet hipsometrike	÷ 300	301-600	601-1000	+ 1000
Nr.mes.pop./ Vendbanim	32.5	-12.1	-36.5	-34.6
Nr.mes.pop./ Vend.rural	-5.4	-12.1	-36.5	-34.6

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Në rrethin e Tepelenës, 43.0% e numrit të përgjithshëm të vendbanimeve është përqendruar në lartësitë 301-600 m që zënë 28.2% të sipërfaqes së rrethit. Në vendin e dytë renditen lartësitë 601-1000 m me rreth 32.0% të vendbanimeve të vendosura në rreth 28.0% të sipërfaqes.

Tabela 8 Shpërndarja e vendbanimeve në rrethin e Tepelenës sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009(në %)

Nivelet hipsometrike	÷ 300		301-600		601-1000		+ 1000	
	1989	2009	1989	2009	1989	2009	1989	2009
Nr.përgjithshëm i vendbanimeve	20	20	34	34	25	25	-	-
Pesha specifike (%)	25.3	25.3	43.0	43.0	31.7	31.7	3.0	3.0
Sipërfaqja e Përgjithshme (%)	18.6		28.2		27.9		25.3	

**Burimi:** Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Shpërndarja e *numrit mesatar të banorëve për qendër banimi*, sipas hipsometrisë, ka ndjekur shpërndarjen e vendbanimeve në këtë aspekt (verikal). Fshatrat e vendosura në territoret e ulëta deri në 300 m dallohen për popullsi më të madhe. Në vendin e dytë vijnë lartësitë 301-600 m dhe në fund lartësitë 601-1000 m. Vendbanimet në këto lartësi janë shumë larg rrugëve të komunikacionit dhe qendrave rurale dhe urbane, shërbimet janë të varfra, popullsia jeton kryesisht në saje të blegtorisë ekstensive. Në këto rrethana, këto vendbanime po vuajnë shpopullimin (Meçaj N. 2007).

Tabela 9. Ndryshimi i numrit mesatar të popullsisë për vendbanim në rrethin e Tepelenës sipas hipsometrisë, gjatë periudhës 1989-2009 (në %).

Nivelet hipsometrike	÷ 300	301-600	601-1000	+ 1000
Nr.mes.pop ./ Vendbanim	12.3	-13.7	-38.1	-
Nr.mes.pop ./ Vend.rural	5.0	-13.7	-38.1	-

Burimi: Vjetari statistikor i vitit 1989 (RSSH) & Arkivi i Gjendjes Civile të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2009, përpunuar nga autorët.

Përkundrajt vitit 1989, ky tregues rritje ka pasur në lartësitë deri në 300 m me 12.3%, ndërkohë që është pakësuar në nivelet e tjerë përkatësisht me rreth 14.0% (301-600 m) dhe 38.1% (601-1000 m).

### 3. Largësia mesatare e qendrave të banimit

Ndryshimet në numrin e vendbanimeve sipas rretheve kanë sjellë ndryshime dhe në *distancën mesatare midis qendrave të banuara*.

Largësia mesatare midis qendrave të banuara të hapësirës në studim, deri në fund të viteve 1970 ka qenë 3.3 km. Të dhënat për vitin 2009 tregojnë se largësia mesatare midis qendrave të banuara në qark rezulton **3.2 km**, pra e ulur me 3.0% kundrejt vitit 1979, e cila ka pasur si shkak rritjen e numrit të qendrave të banuara (*Evolucioni i proceseve gjeopopullative pas vitit 1990 në Qarkun Gjirokastrë, punim doktore, Duri V, 2009*). Sipas rretheve, distanca mesatare midis qendrave të banuara rezulton: 3.4 km në Gjirokastrë (mbi mesataren e qarkut), 3.2 në Tepelenë dhe 3.1 km në Përmet. Numri më i madh i qendrave të banuara në rrethin e Përmetit shpjegon qartë pse distanca midis vendbanimeve është e vogël. Përgjithësisht këto qendra të banuara dallohen për popullsi të vogël dhe vendosje afër njëri-tjetrit. Sipas niveleve hipsometrike, distanca më e shkurtër mesatare midis vendbanimeve evidentohet në nivelin 301-600 m (21.8% më e vogël se mesatarja e përgjithshme e qarkut), dhe më e madhe vërehet në relievin malor 9.7 km (3 herë më e madhe se mesatarja e qarkut për këtë tregues). Sipas rretheve, ky tregues për çdo nivel hipsometrik paraqitet në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 10. Distanca mesatare e vendbanimeve në qarkun e Gjirokastrës (1989-2009)*

Nivelet hipsometrike	÷ 300		301-600		601-1000		1000-1500	
	'89	'09	'89	'09	'89	'09	'89	'09
Vitet								
Distanca mes. vendb. Qarku	3.0	3.0	2.5	2.5	3.3	3.4	9.7	9.7
Distanca mes. vendb. Hapësira rurale	2.8	2.7	2.5	2.5	3.3	3.4	9.7	9.7
Dëndësia e vendb/km <sup>2</sup>	12.4	12.6	18.3	18.3	10.4	10.2	0.5	0.5

Distanca mes.vendb. <b>Rr.Gjirok</b>	3.0	3.0	2.4	2.4	3.9	3.9	9.9	9.9
Distanca mes.vendb. Hapësira rurale	2.9	2.9	2.3	2.4	3.9	3.9	9.9	9.9
Dendësia vendb/km <sup>2</sup>	12.2	12.7	20.5	20.5	7.4	7.4	0.3	0.3
Distanca mes.vendb. <b>Rr.Përmet</b>	3.1	3.1	2.4	2.4	3.0	3.0	6.7	6.7
Distanca mes.vendb. Hapësira rurale	3.5	3.5	2.4	2.4	3.0	3.0	10.5	10.5
Dendësia vendb/km <sup>2</sup>	11.7	11.7	19.7	19.7	13.1	12.4	2.1	2.1
Distanca mes.vendb. <b>Rr.Tepelenë</b>	2.9	2.9	2.8	2.8	3.2	3.2	-	-
Distanca mes.vendb. Hapësira rurale	3.1	3.1	2.8	2.8	3.2	3.2	-	-
Dendësia vendb/km <sup>2</sup>	13.1	13.1	14.7	14.7	11.0	11.0	-	-

Burimi: Evolucion i proceseve gjeopopullative pas vitit 1990 në qarkun e Gjirokastrës, punim doktorature (Duri, 2009).

Dukuria që evidentohet në rrethet e qarkut është se lartësitë deri në 300 m kanë distancën më të vogël të vendbanimeve. Ky tregues mbart diferencime midis rretheve. Distanca më e vogël në lartësitë deri në 330 m evidentohet në rrethin e Tepelenës (2.9 km) dhe më e madhja në rrethin e Përmetit (3.1 km). Në lartësitë 301-600 m, distanca më e shkurtër midis vendbanimeve vërehet në rrethet Gjirokastrë dhe Përmet. Ky i fundit evidentohet për largësinë mesatare më të ulët në lartësitë 601-1000 m dhe mbi 1000 m. Sipas tipave të relievit, vihet re se relievi kodrinor në përgjithësi, dhe ai i ulët kodrinor në veçanti, kanë largësinë më të vogël midis qendrave të banimit, ndërsa relievi malor më të madhe.

## Përfundime dhe rekomandime

Vendbanimet në zonat e ulëta kodrinore karakterizohen nga një popullsi mesatare më e vogël se mesatarja e qarkut dhe distancë më të shkurtër midis tyre (nën 3 km), ndërsa në zonat malore evidentohet dukuria e kundërt. Popullsia mesatare për qendër banimi është më e vogël se mesatarja e qarkut (6 herë), ndërsa distanca midis tyre e madhe (mbi 10 km).

Sipas hipsometrisë largësia mesatare midis vendbanimeve, më e ulët rezulton në relievin e ulët kodrinor, më pak se 3 km (2,6 km) dhe shumë më e lartë në relievin e lartë malor 1001-1500 m, me rreth 10 km. Sipas tipave të relievit, vihet re se relievi kodrinor në përgjithësi dhe ai i ulët kodrinor në veçanti, kanë largësinë më të vogël midis qendrave të banimit, ndërsa relievi malor më të madhe.

Referuar relacionit ndërmjet shpërndarjes së vendbanimeve sipas hipsometrisë dhe shkallës së popullimit në këtë kontekst, paraqitet si domosdoshmëri mbajtja e populluar e territoreve në lartësi. Kjo kërkon angazhimin qeverisës për zhvillimin në këto territore të sektorëve ekonomikë që mbështeten në potencialin e tyre natyror (blegtorisë, apikultutës, pyjetarisë, agroturizmit etj).

Diferencimet në këtë aspekt reflektojnë ngushtësisht dallimet e këtyre gjeohapësirave në të gjithë treguesit dhe variablat gjeodemo-ekonomikë. Popullimi i vendbanimeve të vendosura në lartësitë e mëdha, apelon për më shumë angazhim rajonal, lokal e më gjerë, me qëllim që të mos thellohet dizekuilibri i vërejtur popullsi - zhvillim. Pasi burimet njerëzore në procesin e zhvillimit, përbëjnë elementin bazë të progresit dhe zhvillimit.

### **Literatura**

Arkivi i Gjendjes Civile, Qarku Gjirokastrë.

Bërxfholi, A., (1987) Ndryshime në gjeografinë e popullsisë në rajonin Vjosë  
Deti Jon.

Duri, V., (2009), Evolucioni i proceseve gjeopopullative pas vitit 1990 në  
Qarkun Gjirokastrë, punim doktorature.

Meçaj, N., (2007), Enciklopedia e Tepelenës, f. 222-223.

Ndarja administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në  
Republikën e Shqipërisë, ligji Nr.8653, dt.31.07.2000

Vjetarët statistikor të viteve 1945, 1969, 1979 dhe 1989 (RSSH).

**Prof. asoc. dr. Jaho Cana<sup>1</sup>**  
**Prof. asoc. dr. Kozeta Sala<sup>2</sup>**

## VENDBANIMET KRYESORE TË KRAHINËS SË LABËRISË

### Abstrakt

Krahina e Labërisë është një nga krahinat më të mëdha etnologjike të vendit tonë. Ajo zë pjesën më të madhe të Shqipërisë JP. Kufijtë e saj etnografikë janë: në lindje ajo kufizohet me luginën e lumit Vjosa, në perëndim kufizohet me brigjet e detit Jon dhe pjesërisht me brigjet e detit Adriatik, në veri kufijtë e saj shkojnë deri në Urën e Drashovicës, kurse në jug kufizohet me lumin Kalasë. Brenda këtyre kufijve gjenden një sërë vendbanimesh të rëndësishme si të tipit urban, ashtu edhe vendbanime të tipit rural. Nga vendbanimet e tipit urban mund të përmendim një sërë qytetesh si Vlora, Himara, Tepelena, Gjirokastra, Delvina si dhe ndonjë qytezë tjetër më e vogël. Ndërsa vendbanimet fshatare janë të shumta. Sot në të gjithë Krahinën e Labërisë numërohen rreth 150 fshatra. Të ndara në disa nën krahina si: Kurveleshi i Sipërm dhe i Poshtëm, Smokthina, lumi i Vlorës, Gryka e Dukatit, Bregu i Sipërm dhe ai i Poshtëm, Lopësi, Rrëza e Delvinës etj.

Përgjithësisht popullsia e kësaj krahine është një popullsi kompakte dhe është pak e përfshirë nga lëvizjet mekanike të popullsisë, në kuptimin që, në këtë krahinë të ardhurit nga krahina të tjera etnografike janë gati të papërfillshëm. Këtu bëjnë përjashtim qytet e saj si Vlora, Tepelena, Gjirokastra dhe Delvina, në të cilat si rezultat i ndikimit të një sërë faktorëve me karakter ekonomik, historik dhe social ka vendosje më të madhe të banorëve të ardhur nga krahina të tjera etnografike.

***Fjalë çelës:** labëri, krahinë, popullsi, vendbanim, qytet*

### Abstract

---

<sup>1</sup>Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, E-mail: jaho.cana@yahoo.com

<sup>2</sup>Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, E-mail: salakozeta@yahoo.com

Labëri is one of the largest and ethnological regions in our country. It is roughly situated in south western Albania. The ethnographic borders compose: in the east it is bordered by the Vjosa valley, in the west by the Coast of Jon Sea, partially by Adriatic coast. In the north the border reaches the bridge of Drashovica, whereas in the south the river of Kalasë. Within these borders there are several very important settlements, urban as well as rural types. Regarding the settlements of urban type we could mention several towns like Vlora, Himara, Tepelena, Gjirokastra, Delvina, also other smaller towns. Rural settlements are numerous and currently, in the region of Labwri there are nearly 150 villages. They are divided into sub regions such as: Kurveleshi i Sipërm and i Poshtëm, Smokthina, river of Vlora, Gryka e Dukatit, Bregu i Sipërm and i Poshtëm, Lopësi, Rrëza e Delvinës etc.

Overall, the population of this region is compact and fairly involved in the mechanical move to the sense that the newcomers from other ethnographic areas are almost insignificant. Vlora, Tepelena, Gjirokastra and Delvina are an exception and as a result of the influence of economic, historical and social factors, there is a great amount of population coming from other ethnographic regions.

*Keywords: labëri, region, population, settlement, towns.*

## **I. Hyrje dhe hapësira e studimit**

Krahina e Labërisë është një nga krahinat më të mëdha etnografike të vendit tonë. Ajo është e pozicionuar në JP të vendit dhe ka këta kufij etnografikë: në lindje ajo kufizohet nga rrjedhja e mesme e luginës së lumit Vjosa, në perëndim ajo kufizohet nga brigjet e detit Jon dhe pjesërisht nga brigjet e detit Adriatik, në jug kufijtë e saj zbresin deri te lugina e lumit Kalasë dhe në veri shkon deri tek Ura e Drashovicës.

Me këtë shtrirje të gjerë gjeografike, kjo krahinë dallohet nga një sërë veçorish etnografike krahasuar me krahinat e tjera etnografike të vendit tonë. Por mbi të gjitha ajo veçohet për popullsinë që jeton aty. Përgjithësisht popullsia e kësaj treve është tepër kompakte dhe autoktone. Zanafilla e popullimit të kësaj krahine është shumë e hershme. Sipas të dhënave arkeologjike mendohet se kjo krahinë ka qenë e populluar që në periudhën e bronzit, madje edhe më



herët. Por ajo që është më e rëndësishmja është fakti se në këtë krahinë nuk kemi shkëputje apo ndërprerje të jetës urbane deri në ditët e sotme. Por të dhënat dokumentare për këtë periudhë historike janë shumë të pakta.

Megjithatë, mungesa e të dhënave dokumentare kompensohet nga të dhëna e tjera si ato arkeologjike, etnografike etj. Të dhëna këto që na mundësojnë të arrijmë në konkluzionin se kjo krahinë ka qenë një nga krahinat më të populluara të vendit tonë. Të dhënat dokumentare për këtë krahinë sa vijnë e shtohen me kalimin e kohës. Dhe më të qarta këto të dhëna bëhen gjatë periudhës së antikitetit. Ndërsa më të organizuara dhe të shpeshta ato i përkasin periudhës së mesjetës së hershme dhe mandej të mesjetës së vonë.

## II. Metoda

Për realizimin me sukses të këtij punimi, nga ana jonë janë përdorur një mori metodash shkencore siç janë metoda hipotetike, e analizës, metoda krahasuese, e statistikës etj. Në fakt përdorimi i këtyre metodave ka ardhur si rezultat edhe i natyrës së këtij punimi. Duke qenë se ky punim në thelb është parë në këndvështrimin historik, u pa e arsyeshme që për arritjen e qëllimit dhe për të realizuar objektivat e kërkuar të bazoheshim pikërisht te këto metoda.

Nga ana tjetër, përdorimi dhe alternimi në mënyrë efikase i të gjitha këtyre metodave ka bërë të mundur që punimi të jetë solid dhe shtrija e materialit të ruajë kohezionin logjik dhe atë kronologjik të problemit. Përdorimi i këtyre metodave ka ardhur në mënyrë të natyrshme, për arsye sepse edhe bibliografia e konsultuar nga ana jonë, në një farë mënyre, të diktonte përdorimin e tyre.

### III. Gjetje dhe diskutime

Sipas të dhënave që disponohen, në fund të shek. të XVIII dhe fillim të shek. XIX, pjesë të veçanta të Labërisë u karakterizuan nga një rritje në përmasa të dukshme e numrit të popullsisë, veçanërisht e qendrave urbane. Kjo ishte rrjedhojë kryesisht e rritjes ekonomike që pësoi kjo trevë në periudhën e zhvillimit të ekonomisë së tregut. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë rurale të Labërisë u zhvendos dhe u vendos përfundimisht në qendrat qytetare, kryesisht të kësaj krahine.

Në këtë periudhë filloi dhe emigracioni jashtë shtetit. Fillimisht përfshiu pjesët periferike të Labërisë, veçanërisht trevën e Himarës. Falë pozitës së favorshme gjeografike (e vendosur në brigjet e detit Jon), himarjotët filluan të emigronin shumë më herët, duke u bërë promotorë e emigracionit për mbarë Labërinë. Sipas dëshmimeve, emigrimet e para ishin në drejtim të Greqisë. Kohë pas kohe fenomeni i emigrimit u zgjerua. Deri në fund të shek. XIX u zhvillua në drejtim të Turqisë kryesisht në Stamboll, në Bursë etj. (*Memushaj, 2007*), por edhe në vende të tjera si në Bullgari, në Rumani dhe në Egjipt. Në fillim të shek. XX, emigrimi përfshiu dhe mjaft vende perëndimore si Francën, Italinë, SHBA-në, Argjentinën etj.

Midis qendrave urbane që pësuan rritje të vlerësueshme demografike veçohen Gjirokastra, Delvina dhe mandej Vlora. Gjatë harkut kohor të shek. XIX, popullsia e qytetit të Gjirokastrës u luhet nga 7000-12 000 banorë (*Shkodra, 1984*). Tërheq vëmendjen qyteti i Delvinës, i cili në këtë kohë u shndërrua në një qendër të rëndësishme tranziti. Sipas anglezit Lik, ishin të panumërt karvanët që përshkonin akset Delvinë - Janinë - Gjirokastrë dhe Delvinë - Skërficë dhe pazari i Delvinës ishte tejet i mbingarkuar për nga numri i popullsisë, por edhe për nga numri i kafshëve të ngarkuara me mallra (*Pango, 2002:84*). Në gjysmën e parë të shek. XIX, Delvina kishte rreth 7500 banorë dhe në vitin 1852 numëronte

rreth 450 shtëpi, ndërsa në disa fshatra të dokumentuara (Tatzat, Senicë, Palavli) banesat luhaten nga 57-80 (*Pango, 2002: 85, 333, 365, 383*). Ndërsa popullsia e qytetit të Vlorës gjatë shekullit në fjalë u luhat në shifrat 4-5 000 banorë (*Pango, 2002:86*).

Në harkun kohor të shek. XIX, dy qytetet e tjera të rëndësishme të Labërisë, Gjirokastra dhe Vlora, kishin përkatësisht nga 7-12 000 banorë dhe 4-5 000 banorë (*Shkodra, 1984:26*).

Të dhënat dokumentare sjellin informacione edhe për popullsinë rurale të Labërisë. Në një dokument të vitit 1879, që na jep të dhëna mbi popullsinë e vilajetit të Janinës, përmendet se në Kurvelesh banojnë 12 mijë banorë (*Shkodra, 1984:26*).

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme vërehet se gati pas katër shekujve popullsia e kësaj zone është rritur rreth katër herë. Kjo rritje, për shtrirjen e gjatë kohore, rezulton e vogël. Shkaqet konsistojnë kryesisht te: prapambetja ekonomike e krahinës, jetëgjatësia e ulët, vdekshmëria e lartë (veçanërisht te foshnjat) etj.

Faktor i rëndësishëm kanë qenë edhe lëvizjet emigruese të popullsisë së kësaj treve. Kontingjente të saj, në kushtet e një klime të ashpër, relievit të thyer dhe tepër malor, ekzistencës së një sipërfaqeje të kufizuar të tokës bujqësore (*Selenica, 1928*), detyroheshin të lëvizin në drejtim të zonave të tjera. Por për këtë zhvendosje të popullsisë nga brenda jashtë Labërisë, të dhënat e dokumentuara janë të pakta. Disa të dhëna sporadike dhe të tërthorta, si prania e emrave të disa vendbanimeve tek arbëreshët dhe arvanitasit apo dhe në treva të ndryshme të Shqipërisë, hedhin dritë mbi origjinën labe të këtyre ngulimeve.

Gjatë shek. XX për Labërinë, sipas burimeve, lexohet një pamje demografike e cila krahasuar me shek. XIX prezantohet me ndryshesa deri dhe të dukshme në elementet përbërëse të saj.

Për sa i përket numrit të popullsisë sipas qendrave të banuara, urbane dhe rurale, vërehet fenomeni i uljes apo i rritjes së popullsisë. Oscilacionet vërehen edhe në periudha relativisht të

shkurtra. Në rastin e Kurveleshit (epiqendra e Labërisë), popullsia në vitin 1922, ishte 10 858 banorë, ndërsa dy vjet më vonë (1924) 10 414 banorë (*AQ i RSH, 1922 f. 49, 1924 f.59*). Sipas këtyre shifrave nuk justifikohet shtesa natyrore e popullsisë së kësaj treve. Kjo shpjegohet si me ndonjë ndryshim të pjesshëm të strukturës administrative, ashtu dhe me zhvillimin e fenomenit të lëvizjes të një kontingjenti popullate, kryesisht drejt qendrave urbane.

Fenomeni i rrudhosjes apo i bumit demografik vihet re qartazi edhe në qendrat urbane të Labërisë. Veçohet qyteti i Delvinës, i cili në vitin 1923 kishte 2545 banorë (*Mema, Shahu, 2001:29*), ndërsa në vitet 1926 dhe 1937 kishte përkatësisht 3010 (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2008:435*) dhe 3500 banorë (*Pango, 2002, f. 86*). Popullsia e këtij qyteti, në gjysmën e parë të shek. XX, gati është mbi përgjysmuar krahasuar me atë të rreth një shekulli më parë. Kjo shpjegohet kryesisht me rritjen e rolit të Sarandës si qendër e fuqishme tregtare, e cila thithi edhe një pjesë të konsiderueshme të popullatës së Delvinës. Por, pas Luftës së Dytë Botërore zhvillohet procesi i rritjes së ndjeshme të popullsisë së qytetit të Delvinës. Ajo në vitin 1989 arrin në 7600 banorë dhe në vitin 2001 në rreth 13 000 banorë (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2008:435*), gati e dyfishuar me shek XIX.

Fenomeni oscilacional i zhvilluar në rastin e qytetit të Delvinës nuk vërehet në qytetin e Gjirokastrës, i cili në vitin 1923 numëron 12 406 banorë (*Mema, Shahu, 2001:30*), ndërsa në vitin 1985 arrin në 22 000 banorë (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2008:345*). Interpretimi i këtyre shifrave tregon se ky qytet gjatë shek. XX ka pasur një rritje graduale dhe jo të ndjeshme të numrit të popullsisë. Si duket, raportet futje-dalje të popullatës kanë ruajtur gati raporte balancuese dhe si rrjedhojë ka qenë shtesa natyrore treguesi kryesor i shtimit të popullatës.

Ndërsa qyteti i Vlorës veçohet për një shtim të madh të popullsisë në gjysmën e dytë të shek. XX. Në vitin 1985 ajo arrin në

62 200 banorë, gjë që ishte rrjedhojë e shndërrimit të këtij qyteti në një qendër të rëndësishme ekonomike e administrative. Popullsia e këtij qytetit, si dhe e shumë qyteteve të tjera shqiptare të kësaj periudhe, u karakterizua nga një strukturë shoqërore heterogjene. Krahas popullatës që u zhvendos nga zonat rurale të Labërisë dhe u instalua në Vlorë, pati edhe kontingjente të tjera popullatash të zhvendosura nga qytete apo fshatra të tjera të vendit, kryesisht nga Shqipëria Jugore.

Duke u nisur nga fakti që qendra të ndryshme urbane, në kohë të ndryshme, karakterizohen nga oscilacione në pikëpamje të popullimit, nuk është vështirë të arrish në përfundimin se përqendrimi i popullsisë urbane ka kaluar nga një qendër në tjetrën, në përshtatje me rrethanat favorizuese që ka pasur gjithsecila në kohë të ndryshme.

Për sa i përket popullsisë rurale të Labërisë gjatë shek. XX, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të tij, karakterizohet nga një popullim gjithëpërfshirës, gjë që rridhte prej politikave të regjimit komunist për të populluar gjithë hapësirën e vendit.

Gjatë viteve të regjimit komunist popullsia e Labërisë u rrit ndjeshëm. Qytetet si Vlora, Gjirokastra, Saranda, Delvina, Tepelena etj., u mbipopulluan shumë, krahasuar me periudhën para Luftës së Parë Botërore. Ky popullim u shoqërua dhe me specifika, ku duhet veçuar prishja e kompaktësisë ekzistuese në rrafshin etnologjik. Kjo, sepse një pjesë e konsiderueshme e banorëve të rinj vinin nga treva jashtë Labërisë. Kjo ka vështirësuar identifikimin e numrit të popullsisë së mirëfilltë labe.

Pavarësisht prej kësaj specifike, numri i popullsisë labe pësoi rritje të konsiderueshme. Kjo ishte rrjedhojë e përmirësimit në mënyrë të ndjeshme dhe gjithnjë e në rritje të kushteve të jetesës, gjë që çoi në rritjen e jetëgjatësisë, në uljen e vdekshmërisë (veçanërisht foshnjore).

Në vitet 1945-1960, nga krahina e Labërisë pati shpërngulje masive të popullsisë nëpër qytete, por edhe në zona të tjera, kryesisht fushore. Vala e parë dhe më e madhja e shpërnguljes ndodhi gjatë procesit të zbatimit të Reformës Agrare (1946). Fakti që krahina e Labërisë kishte sipërfaqe të pamjaftueshme toke bujqësore, e detyroi qeverinë e hershme të regjimit komunist të merrte vendime të posaçme për pajisje me tokë të tërësisë së banorëve të saj. Sipas këtyre vendimeve me qindra familje labe u vendosën në zonat fushore, pjesa dërmuese jashtë trevës së Labërisë. Gjatë këtij procesi u krijuan edhe vendbanime të reja. Në këtë kategori vendbanimesh përfshihen fshatrat *Asim Zeneli*, i *Valaresë*, i *Arshi Lëngos*, të instaluara në rrethin e Gjirokastrës, në krahun e djathtë të lumit Drino, në kontakt me krahinën etnologjike të Lunxhërisë. Popullsia e këtyre vendbanimeve vinte kryesisht nga Labëria, veçanërisht nga Progonati dhe Golemi, ndërsa pjesa tjetër nga zona të tjera rurale fqinje me Labërinë.

Një pjesë e mirë e labëve, të zhvendosur krijuan qendra të reja banimi shumë larg krahinës së Labërisë. Në këtë kategori përfshihen disa ngulime në zonën e Myzeqesë, si në Levan, në Frakull etj.

Vala e dytë e madhe e largimeve masive të banorëve të Labërisë është ajo e viteve 1950-1960. Gjatë këtyre viteve, si rezultat i zhvillimit të vrullshëm të industrisë, u ndie uri për forca pune në këta sektorë të ekonomisë. Në këto vite, kontingjente të rinjsh nga Labëria (si nga mbarë vendi), u larguan nga fshatrat e tyre dhe shtuan radhët e punëtorëve me mëditje pranë qendrave të mëdha industriale. Largimet bëheshin edhe në bazë familjeje. Një kontingjent tjetër të rinjsh dhe të rejash iu përkushtuan gjithnjë e më masivisht rrugës së arsimimit, duke e mos u kthyer më nëpër fshatrat e tyre.

Gjatë viteve 1945-1990 nuk gjeje cep të Shqipërisë ku të mos kishte intelektualë me orgjinë nga kjo krahinë. Falë inteligjencës,

aftësive menazhuese në ekonomi dhe në sektorë të tjerë të jetës, prania dhe kontributi i intelektualëve me orgjinë labe ndihej gati në pjesën dërmuese të vendit. Një pjesë e tyre arritën deri në kupolën e lartë partiake dhe shtetërore. Kontributi i tyre vazhdon të jetë i dukshëm dhe në ditët e sotme në mjaft fusha.

Mbas viteve 1960, me përfundimin e kolektivizimit të bujqësisë, shpërnguljet e popullsisë u minimizuan në ekstrem. Aplikimi i kësaj politike ishte faktori kryesor që çoi në rritjen e numrit të popullsisë në Labëri. Por ndërprerja e emigrimit, me forma shtrënguese, me kalimin e kohës krijoi shqetësime. Aplikimi i kësaj politike jo vetëm shkeli një nga të drejtat më elementare të njeriut, atë për të jetuar dhe banuar atje ku ai e quan të arsyeshme, por ajo çoi në mbipopullimin e Labërisë. Terreni i kufizuar në toka joproductive nuk mundësonte një mirëqenie normale për banorët e saj, aq më shumë kur partia-shtet kërkonte me insistim si sigurimin e bukës në vend, ashtu edhe dorëzimin e detyruar të tepricave bujqësore e blegtorale për furnizimin e qytetit. Kjo politikë e mbrapshtë ekonomike krijoi premisat që ekonomia kooperativiste e këtyre trevave të mbërthehej në një krizë të thellë. Pasojat e saj u ndien në furnizimin e pamjaftueshëm të popullit me nënprodukte, deri dhe ato të natyrës bujqësore e blegtorale. Ishte paradoksale që krahina e Labërisë, më e njohura në rang vendi për sasinë dhe cilësinë e produkteve blegtorale, të përfshihej nga kriza edhe në këtë sektor. Të dhënat zyrtare të kohës tregojnë se banorët e zonave të Labërisë kishin mungesa të theksuara të furnizimit me mish, qumësht, djathë dhe produkte të tjera bujqësore e blegtorale.

Si rezultat, viti 1990 e gjeti këtë krahinë në një gjendje gati të mjerueshme. Varfëria gati e paimagjinueshme ishte e pranishme ngado. Ishte kjo situatë që ndikoi në reagimin e ashpër të banorëve, të cilët pas shpërbërjes së sistemit u ngritën dhe dëmtuan në pjesën dërmuese të asaj që quhej “pronë socialiste”.

Në kuadrin e kësaj vale nuk u kursyen edhe vlera që me aq mund e sakrifica ishin krijuar gjatë viteve të regjimit komunist.

Mbas viteve '90, varfëria e banorëve të Labërisë u shndërrua në një plagë të thellë sociale. Ishte kjo arsyeja që ata u përfshinë nga një valë e re emigracioni, qysh në fillim të viteve. Me eksodin drejt ambasadave të huaja, me dhjetëra të rinj dhe të reja nga kjo krahinë u larguan për tu instaluar në vendet Perëndimore. Në rrjedhën e viteve '90 emigracioni përfshiu mbarë krahinën. Procesi i emigrimit fillimisht përfshiu moshat aktive të punës, por gradualisht ai u shndërrua në emigrim familjar, duke lënë në mëshirë të fatit gjithçka që kishin. Duke përfituar nga afërsia me kufirin shtetëror me Greqinë dhe duke shfrytëzuar kryesisht portin e Vlorës dhe atë të Sarandës dhe pika të tjera të vendit, me mijëra veta u larguan përkohësisht, por edhe përfundimisht nga vendlindja e tyre drejt Greqisë, Italisë, por dhe në vendet e Europës Perëndimore, SHBA, Kanada etj.

Në periudhën postkomuniste, krahas emigrimit të jashtëm, krahina e Labërisë u përfshi edhe nga procesi i emigrimit të brendshëm, i cili është ende aktiv. Shkaqet e këtij lloji emigrimi burojnë po nga kushtet e vështira. Mungesa e infrastrukturës rrugore apo degradimi i saj, mungesa e shërbimit shëndetësor, mundësitë e pakta që ka në këtë trevë për tu arsimuar etj. janë faktorë që favorizojnë emigrimin.

Eksodi, i jashtëm apo i brendshëm, preku ndjeshëm edhe qendra urbane, më i ndjeshëm ky është për qendrat e vogla si Tepelena, Himara, Memaliaj etj., në të cilat numri i banorëve pas vitit 1990 ka rënë ndjeshëm.

Banorët e Labërisë gjatë procesit të emigrimit të brendshëm kanë parapëlqyer që të vendosen kryesisht në qendra të rëndësishme urbane, brenda apo jashtë trevës së Labërisë, si në Tiranë, Vlorë, Fier, Sarandë etj. Kontingjentet labe të emigruara janë karakterizuar nga përpjekje intensive për t'u integruar në jetën



urbane. Një pjesë e tyre janë faktorë zhvillimi dhe përparimi në këto qendra.

Pasoja kryesore e emigrimit është shpopullimi masiv i krahinës, gjë që u shoqërua me efekte të ndjeshme në zhvillimin e saj. Pasojat u ndien më shumë në zonat e thella malore, veçanërisht treva e Kurveleshit, por dhe në fshatra të tjera të Labërisë. Në ditët e sotme, si rezultat i këtyre lëvizjeve masive dhe të pakontrolluara, ka fshatra të cilët nuk ekzistojnë më si qendra banimi. Në këtë kategori përfshihen fshatrat Këtlaz, Sopot, Vërmik etj. Një kategori tjetër fshatrash janë në prag shpopullimi tërësor. Në pjesën dërmuese të fshatrave numri i banorëve është përgjysmuar dhe në një pjesë të tyre vazhdon procesi i shpopullimit.

Në vitet 2000-2010 janë bërë përmirësime në rritje të infrastrukturës, veçanërisht asaj rrugore, dhe në trevën rurale të Labërisë. Këto zhvillime kanë tërhequr vëmendjen e banorëve, banues në Labëri apo të shpërngulur prej andej (brenda ose jashtë vendit). Si rrjedhojë ka filluar dhe po zhvillohet gjithnjë e më shumë një fenomen i ri, ai rindërtimit të shtëpive të tyre të braktisura apo i ndërtimit të banesave të reja të tipit “vila”. Mjaft të tjerë që kanë mundur të ngrenë biznese të fuqishme (dhe nuk janë të paktë), kanë filluar që të investojnë pranë fshatrave të tyre të origjinës me qëllim që të ndikojnë sadopak në rigjallërimin e jetës ekonomike të këtyre fshatrave. Si rrjedhojë e zhvillimeve po vërehet tendenca e rikthimit të shumë banorëve të larguar në vendbanimet e tyre në Labëri.

Në ditët e sotme popullsia e Labërisë i përket besimit fetar mysliman dhe ortodoks. Por duhet theksuar se në të kaluarën jo shumë të largët, e gjithë popullsia e saj ishte e krishtere. Besimi fetar kristian ka gjurmë shumë të hershme në krahinën e Labërisë. Ky besim u pranua nga popullsia iliro-epiriote shumë kohë më parë se ajo të shndërrohej në besim fetar zyrtar për Perandorinë Romake. Fenë kristiane në vendin tonë nuk e përhapën misionarë

grekë apo latinë. Atë e përhapën vetë dishepujt e Jezu Krishtit. Shën Pali, që ka jetuar në shekullin e parë të erës së re, shkeli vetë pothuajse në të gjithë hapësirën që dikur e zinte Iliria dhe Epiri. Madje, mendohet se ai qëndroi për pak kohë edhe në Nikopol, atëherë kryeqendër e Epirit. Gjatë kësaj kohe ai shpërndau predikimet e fesë së krishtere dhe po kështu predikoi Ungjillin. Gojëdhënat popullore flasin se ai në malin e Nemërçkës ktheu një tempull pagan në kishë (*Memushaj, 2007:121*).

Plutarku na jep një dëshmi të gjallë që na tregon se në Kaoni, krishterimi është përhapur që në shekullin e parë. Ai tregon se kur një anije romake po lundronte afër brigjeve të liqenit të Butrintit, asaj iu afrua një anije vendëse e mbushur me njerëz, prej së cilës u dëgjua një zë që tha: “Kur të arrini pranë liqenit Pelode, lajmëroni se Pani i Madh ka vdekur”. Dhe kur anija romake, iu afrua liqenit, ata lajmëruan për Panin e Madh që kishte vdekur. Mbas kësaj u dëgjuan vajtime të banorëve dhe jo vajtimi i një njeriu, por i disa njerëzve që vajtonin së bashku. Sipas Moikim Zeqos vajtimi për Panin e Madh, hyjin e kopeve, me kultin e tij të vjetër të përhapur te molosët, kaonët etj., që vajtimi për një epokë të tërë të historisë njerëzore që po merrte fund. Pra, ky vajtim ishte si të thuash një lloj vajtimi që njerëzit po i bënin fesë politeiste, e cila tashmë po dilte gradualisht nga skena historike dhe po ia linte vendin një feje të re, fesë monoteiste të krishterimit. Prandaj, me të drejtë, mund të themi se duke u nisur vetëm nga këto të dhëna, feja kristiane duke filluar nga shekulli i parë po bëhej pronë e masave.

### **Përfundime**

Labëria është një nga krahinat më të mëdha etnografike të vendit tonë dhe si e tillë ajo zë një pjesë të rëndësishme të territorit të Shqipërisë JP, dhe ka një pozitë gjeografike tepër të favorshme.

Krahina e Labërisë është e populluar shumë herët, zbulimet arkeologjike na tregojnë se kjo krahinë është e banuar qysh në

periudhën e bronzit, por gjurmët e qytetërimit për këtë krahinë sa vijnë e shtohen gjatë periudhës së antikitetit dhe sidomos në mesjetë, pikërisht për këtë periudhë gjenden dhe dokumentet e para për banorët e kësaj krahine.

Qendrat kryesore të banimit në Labëri dallohen për popullsinë e tyre autoktone. Pjesët e brendshme të kësaj krahine si zona e Kurveleshit të Sipërm, Kurveleshit të Poshtëm, Lopësi, Smokthina, Lumi i Vlorës, Gryka e Dukatit etj., janë edhe zonat të cilat e kanë ruajtur më qartë fizionominë e tyre në këtë aspekt.

Pas viteve nëntëdhjetë të shekullit që sapo lamë pas, krahina e Labërisë është kapur nga lëvizje të shumta të popullsisë. Kjo ka bërë që mjaft fshatra të saj ta humbasin fizionominë e tyre të dikurshme. Në shumë raste, në pjesët e brendshme të kësaj krahine shpërpullimi është masiv, madje në disa raste edhe alarmante.

Shkaqet e këtyre shpërnguljeve janë të ndryshme. Por më kryesori është faktori ekonomik, por këtu kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë si ata kulturorë, arsimor, shëndetësor etj. Pavarësisht se kohët e fundit janë marrë disa masa nga ana e shtetit për të përmirësuar situatën e krijuar, duhet thënë se ato janë të pamjaftueshme, dhe në disa raste edhe shumë të vonuara. Megjithatë hartimi i një plani strategjik dhe shumëplanësh do të ndikonte pozitivisht në reduktimin e këtij fenomeni negativ.

### Literatura

- AQ i RSH, F. 252, viti 1922, dos. 201, f. 49. po aty, viti 1924, dos. 626, f. 59  
 Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vol. I, Tiranë: 2008, f. 435, 345.  
 Mema, B., Shahu, A., (2001), *Prefektura e Gjirokastrës 1920-1924*, Berat: Jonalda, f. 29, 30  
 Memushaj, R., (2007), *Histori e Kurveleshit*, Toena, f. 33, 121  
 Selenica, T., (1928), *Shqipëria më 1927*, Tiranë, f. 43  
 Shkodra, Z., (1984), *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, f. 26  
 Pango, A., (2002), *Enciklopedia e Sarandës dhe Delvinës*, Tiranë, f. 84, 85, 86, 333, 365, 383

**Prof. asoc. Nehat Collaku<sup>1</sup>**

**Dr. Selman Meziu<sup>2</sup>**

## **LËVIZJET DEMOGRAFIKE NË QENDRAT E BANUARA DHE NDRYSHIMET NË PËRDORIMIN E TERRITORIT NË KRAHINAT E SLOVËS DHE MUHURRIT TË QARKUT DIBËR**

### **Abstrakt**

Me këtë artikull synojmë të analizojmë lëvizjet demografike në qendrat e banuara dhe ndryshimet në përdorimin e territorit në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit të qarkut të Dibrës, si dhe identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në këto lëvizje. Metodika e ndjekur konsiston në analizimin e lëvizjeve demografike të fshatrave të krahinave të marra në studim bazuar në dokumentet arkivore, statistikat, botimet e ndryshme si dhe në vrojtimitet tona. Për vlerësimin e dinamikës së lëvizjeve demografike në qendrat e banuara jemi bazuar në vitet e regjistrimeve të popullsisë kur kemi siguruar informacion, në vitet 1467, 1583, 1923, 1992, 2005 si dhe censusin e fundit në vitin 2011. Ndërkohë që për grumbullimin e të dhënave mbi përdorimin e territorit janë përdorur burimet e të dhënave nga INSTAT-i, studime të ndryshme që ekzistojnë etj. Gjetjet kryesore të studimit tregojnë se pakësimi më i madh popullsisë në fshatrat e krahinave të marra në studim ka ndodhur pas vitit 1990, me ndryshimin e lëvizjeve demokratike. Shkaqet kryesore të lëvizjeve demografike konsistojnë në ndryshimin e menjëhershëm të sistemit social - ekonomik, si dhe kushtet me të cilat u përballën popullsia që jetonte në fshatrat e krahinave të marra në studim në periudhën pas vitit 1990. Lëvizjet kryesore demografike rezultojnë me një migrim të popullsisë nga fshatrat e zonës në

---

<sup>1</sup> E-mail: [nehatcollaku@ubt.edu.al](mailto:nehatcollaku@ubt.edu.al);

<sup>2</sup> E-mail: [smeziu@yahoo.it](mailto:smeziu@yahoo.it)

studim drejt zonave urbane si Tiranë, Durrës, Fushë – Krujë, Lushnjë, për një mundësi jetese më të mirë. Lëvizjet demografike kushtëzohen nga burimet natyrore, ndryshimet në përdorimin e territorit. Në disa raste lëvizjet demografike janë të konsiderueshme dhe kanë shkaktuar një braktisje të madhe të zonave të banuara në krahinën e Sllovës krahasuar me krahinën e Muhurrit, ndërkohë që fshati me pakësimin më të theksuar të lëvizjeve demografike rezulton fshati Palaman në krahinën e Sllovës dhe fshati Shqath i krahinës së Muhurrit.

***Fjalë çelës:** lëvizje demografike, krahina, përdorim, territor, braktisje, migrim.*

### **Abstract**

Through this paper we aim to analyze the demographic movements in the inhabited areas and the changes in the land use in the provinces of Sllova and Muhurr in the Dibra region as well as the identification of the factors that have influenced these movements. The methodology followed consists in analyzing the demographic movements of the villages of the provinces taken in the study based on archival documents, statistics, various publications as well as our observations. For the assessment of the dynamics of demographic movements in the inhabited areas we are based on the years of the population census when we provided information in the years 1467, 1583, 1923, 1992, 2005 as well as the last census in 2011. While for the collection of data on the land use are used data sources from INSTAT, various studies that exist, etc. The main findings of the study show that the largest decrease in population in the villages of the provinces surveyed occurred after 1990, with the change of democratic movements. The main causes of demographic movements consist in the immediate change of the socio-economic system, as well as the conditions faced by the population living in the villages of the studied provinces in the period after 1990. The main demographic movements result in a population migration from the villages of the study area to urban areas such as Tirana, Durrës, Fushë-Krujë, Lushnjë, for a better living opportunity. In some cases, demographic movements are significant and have caused a large abandonment of inhabited areas in the province of Sllova compared to the province of Muhurri, while the village with the most significant decrease in demographic movements in the village of Palaman in the province of Sllova and in the village of Shqath of the province of Muhurr.

***Keywords:** demographic movement, province, use, territory, abandonment, migration.*

## I. Hyrje

Lëvizjet e popullsisë nga zonat e banuara janë nxitur nga arsye të ndryshme si ekonomike, social-kulturore, por edhe natyrore. Sipas Lacit (1998), lëvizjet e popullsisë nga vendbanimet rurale drejt qyteteve është pasojë e mbipopullimit të fshatrave dhe e situatës ekonomike të vështirë në to. Për të analizuar lëvizjet e popullsisë nga zonat e banuara duhet t'u referohemi statistikave dhe regjistrimeve të popullsisë të kryera në periudha të ndryshme. Statistikat e para zyrtare të regjistrimit të popullsisë për Shqipërinë ishin regjistrimi i vitit 1923, kur vendi ynë kishte 823,000 banorë gjithsej (Wikipedia: [https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia\\_e\\_Shqip](https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Shqip)). Ndërkohë, që para regjistrimit zyrtar të vitit 1923 janë bërë disa regjistrime të tjera të popullsisë nga Perandoria Osmane. Regjistrimi i popullsisë i kryer nga Perandoria Osmane kishte për qëllim njohjen e numrit të popullsisë për vjeljen e taksave, rekrutimin e ushtarëve për shërbim ushtarak etj. Gjatë periudhës së regjimit komunist, lëvizjet e popullsisë kanë qenë shumë më të kontrolluara, për vetë natyrën e vetë sistemit. Pamundësia e popullsisë që jetonte në zonat rurale për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për jetesë është shoqëruar me ndryshime të mëdha në përdorimin e territorit, si mbishfrytëzim të pyjeve dhe kullotave, ndryshim të destinacionit të përdorimit të territorit dhe degradim të burimeve natyrore. Ndërkohë që pas vitit 1990 kanë ndodhur ndryshimet më të mëdha të lëvizjeve të popullsisë.

Shkaqet kryesore të lëvizjeve demografike të ndodhura në vitet 1990 konsistojnë në ndryshimin e menjëhershëm të sistemit social - ekonomik, si dhe kushtet me të cilat përballej popullsia që jetonte kryesisht në zonat rurale. Lëvizjet kryesore demografike rezultojnë me një migrim të popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane, por në të njëjtën kohë edhe me emigrimin e një pjesë të popullsisë në vende të ndryshme. Myers dhe Kent (1995) përcaktuan edhe një

kategori të quajtur *migrantë mjedisorë*, si “persona të cilët nuk ishin në gjendje të sigurojnë jetesën në vendbanimet e tyre tradicionale, për arsye të faktorëve mjedisorë të kufizuar”. Ndër flukset më të mëdha të migrimit të popullsisë janë ato që lëvizin nga zonat rurale drejt zonave urbane, fenomen i nxitur nga një sërë faktorësh me natyra të ndryshme dhe që çojnë në largimin e popullsisë nga vendbanimet e tyre, për arsye të kushteve aktuale të vështira apo të pamundura për jetesë dhe përpjekjeve për një jetë më të mirë (Collaku, 2005). Pas viteve 1990, popullsia tregoi një rënie mesatare prej rreth 0.3 për qind në vit, shkaktuar nga emigrimi. Në regjistrimin e vitit 2001, popullsia u zvogëluar në 3.023.000 nga afërsisht 3.3 milionë në vitin 1990 (Wikipedia: [https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia\\_e\\_Shqip](https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Shqip)).

Laci (1998) përshkruan se zonat rurale me aktivitetet në rënie përfaqësojnë territore me relief të thyer dhe kushte klimatike të papërshtatshme për jetesë e veprimtari bujqësore, të izoluara, me infrastrukturë të mangët, me vendbanime të rralla (të tipit të shpërndarë) dhe eksod bujqësor e rural masiv. Tipike është zona malore verilindore, e cila dallohet me prapambetjen e theksuar ekonomike, sociale dhe kulturore: ekonomi të rrënuar, dendësi shumë të madhe popullore për njësi të sipërfaqes së punuar, gjendje të mjeruar të infrastrukturës dhe një rrjet të rrallë shkollash e qendrash shëndetësore, nivel jetese shumë të ulët, izolim gati total në pikëpamje të informacionit dhe të veprimtarive kulturore etj. (Laci, 1998).

## II. Hapësira e studimit

Hapësira e studimit shtrihet në krahinat (njësitë administrative) e Sllovës dhe Muhurrit të qarkut të Dibrës. Treva e Dibrës është një nga zonat më të thella të Shqipërisë së brendshme malore (Frashëri, 2012). Qarku i Dibrës përbën një ndër dy qarqet me nivelin më të lartë të varfërisë, pas qarkut të Kukësit që rezulton si qarku më i

varfër në vendin tonë. Bazuar në studimin “Profili i varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri” të realizuar nga Banka Botërore dhe INSTAT-i (2016), si dhe bazuar në Censusin e vitit 2011 si dhe *Anketën e matjes së nivelit të jetesës*, kryer në vitin 2016, rezultoi se niveli më i lartë i varfërisë në Dibër ishte në komunën e Sllovës, me 29.4 %.



Figura nr.1: Shtirja gjeografike e hapësirës së studimit

Krahina e Sllovës shtrihet në verilindje të qytetit të Peshkopisë, me distancën më të afërt 12 km dhe më të largët 30 km nga qyteti, duke formuar pjesët e sipërme të shpateve lindore të luginës së Drinit të Zi. Sllova (ose siç njihet ndryshe edhe si Ujë e m’Uja) është ndër krahinat me shtirje më të madhe në rrethin e Dibrës, që ka një sipërfaqe prej 78 km<sup>2</sup>, e cila shtrihet në të djathtë të Luginës së Drinit të Zi nga 500 m deri 1050 m mbi nivelin e detit (Daci, 2021). Daci (2021) përshkruan se kufijtë e Sllovës nisin nga bregu i Drinit të Zi dhe ngjiten deri në malin e Korabit dhe të Deshatit, nisin te Përroi i Kapcit e përfundojnë te Përroi i Veleshicës. Në krahinën e Sllovës gjendet Korabi, mali më i lartë i vendit, ndërkohë që në anë të tij ndodhen bjeshkët e bukura të Shehut dhe të Abazit. Rrjeti hidrologjik është mjaft i dendur, që përbëhet nga dy përrenj të mëdhenj, siç është ai i Gramës dhe i Veleshicës. Përroi



i Gramës mbledh ujërat e pjesës lindore e jugore të malit të Korabit, si dhe ujërat e bjeshkëve të Gramës dhe të Pelpenikut. Mbetet një faktor mjaft i vazhdueshëm rrezikimi për fshatrat që ndodhen në rrjedhën e poshtme të tij, në pjesën ku ai bashkohet me Drinin, duke shkaktuar përmbytje të vazhdueshme e mbathje të tokave të bukës, si dhe rrezikim të shtëpive.

Krahina e Sllovës ka jo vetëm sipërfaqe mjaft të madhe, por në të njëjtën kohë ka edhe një territor mjaft të larmishëm, me shumë toka bujqësore, livadhe, kullota e pyje. Në territorin e krahinës së Sllovës ekzistojnë burime natyrore të shumta, si dhe një florë dhe faunë mjaft të pasur (Havene shpk 2008).

Tufa (2008) nënvizon se për të kuptuar pozicionin gjeografik të krahinës së Sllovës e Muhurrit do të mbështetemi së pari tek atdhetari H. Luis, i cili përshkruan: “Në lindje shtrihet kreshta e Korabit... shpate të pjerrëta bien në thellësi, ato përfundojnë në më shumë se 200 m mbi rrafshin e truallit. Në këto relieve shtriheshin që në vitin 1467 fshatrat e krahinës së Sllovës, ku sipas (*Gjoni et al, 2011*), përbëhej nga Shumbati dhe Shumbati Fushë që kishin përkatësisht me 26 shtëpi dhe 182 banorë dhe 3 shtëpi e 21 banorë, fshati Sllatinë me shtatë shtëpi dhe 42 banorë, Sllova me 4 shtëpi dhe 24 banorë, fshati Trojak me 5 shtëpi dhe 35 banorë, fshati Venisht jetonin vetëm 5 familje me 35 banorë, Vlesha me 15 familje dhe 108 banorë, si dhe Dypjaka me 9 shtëpi me një popullsi 63 banorë.

Krahina e Muhurrit: Në lindje të Muhurrit rrjedh lumi Drin, në perëndim kanë kreshtat e maleve që e ndajnë atë nga Mati, dhe Selishtën nga Luznia, Muhurrin dhe Cidhnën (*Tufa, 2008*). Komuna Muhurr vendoset në pjesën perëndimore të rrethit të Dibrës. Lartësia mbi nivelin e detit ka një amplitudë të theksuar, nga 387 m mbi nivelin ku bashkohet Murra me Drinin, lartësia mesatare është 790 m. Relievi është tërësisht malor, ku përmendim fshatrat Bulac, Shqath, Hurdh Muhurr. Fenomeni i erozionit është intensiv në

tokat që janë djerrina, ish-toka bujqësore tani të braktisura (Korabi sh.p.k. 2007). Krahina e Muhurrit rezulton e populluar të paktën që më 1467, ku (Gjoni, et al, 2011) e përshkruan se Muhurri përbëhej nga fshati Bulaç ku jetonin 5 familje me 35 banorë, Shën Vasili me 5 familje me 35 banorë, Gardh me 7 familje me 49 banorë, Griçanme me 4 familje dhe 28 banorë dhe Muhurri me 19 familje me 133 banorë.

### III. Metoda

Metodologjia e përdorur konsiston në: analizimin e lëvizjeve demografike të fshatrave të krahinave të marra në studim. Burimet e të dhënave: bazuar në dokumentet arkivore, statistikat, botimet e ndryshme si dhe në vrojtimit tona. Për vlerësimin e dinamikës së lëvizjeve demografike në qendrat e banuara jemi bazuar në vitet e regjistrimeve të popullsisë kur kemi siguruar informacion në vitet 1467, 1583, 1923, 1992, 2005 si dhe censusin e fundit në vitin 2011. Ndërkohë, që për grumbullimin e të dhënave mbi përdorimin e territorit janë përdorur burimet e të dhënave nga INSTAT-i, studime të ndryshme që ekzistojnë si hartimi i Planit të Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave të komunës Muhurr, si dhe Plani i Menazhimit të Mikrobasenit të komunës Slllovë etj., si dhe vrojtimit e bëra në terren. Gjithashtu, nëpërmjet këtij studimi synojmë të analizojmë se cili është ndikimi i lëvizjeve të popullsisë në ndryshimet e përdorimit të territorit. Duke qenë se grumbullimi i të dhënave mbi ndryshimet e territorit të shkaktuara në periudha të ndryshme (periudhat kur kemi siguruar të dhëna të regjistrimit të popullsisë), analizimin e ndikimit të lëvizjeve në ndryshimet e territorit e kemi bërë vetëm për periudhën pas viteve '90 kur ne kemi pasur mundësi të sigurojmë informacion mbi ndryshimin e territorit.

#### IV. Rezultate dhe diskutime

Analizimi i lëvizjeve të popullsisë për krahinat e Sllovës dhe Muhurrit është kryer për periudhat kur ne kemi pasur mundësi të sigurojmë të dhëna, të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

##### **4.1 Lëvizjet e popullsisë në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit në vitin 1467**

a) Burimi më i hershëm mbi vendbanimet e dy krahinave të marra në studim është regjistrimi i Perandorisë Turke të vitit 1467.

b) Për krahinën e Sllovës në regjistrimin e vitit 1467: Shumbati dhe Shumbati Fushë rezultojnë me të populluarit që ngriheshin në një rrafshnaltë mbi shtratin e Drinit të Zi me lartësi 715 m dhe kishin përkatësisht 26 shtëpi me 182 banorë dhe 3 shtëpi me 21 (3) të tillë; si dhe fshati Vleshë rezulton i populluar me 15 familje dhe 108 banorë.

c) Për krahinën e Muhurrit në regjistrimin e vitit 1467: Fshati Hurdhë–Muhuri më i populluari i vendosur në fundin e shpateve të vargmalit të Runjës, me lartësi 830 m, ku kishin banimet e tyre 19 familje me 133 banorë.

##### **4.2 Lëvizjet e popullsisë në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit në vitin 1583**

Duke analizuar lëvizjet e popullsisë në vitin 1583, sipas Gjoni et al (2011) rezulton se pas 116 vjetësh kemi rritje popullsie për krahinën e Sllovës, dhe përkatësisht kemi:

✓ Shumbati Fushë është kthyer në djerrina, për kullotje blegtorie;

✓ Sllatina ka një rritje popullsie më shumë se shtatëfishin e regjistrimit të vitit 1467, pra nga 42 banorë në 305;

✓ Dypjaka fatkeqësisht është zhdukur plotësisht;

✓ së fundi, Vlesha ka një rritje popullsie pothuajse tri herë, prej 200 banorësh.

Gjithashtu, po sipas Gjoni et al (2011 rezultojnë se pas 116 vjetësh kemi rritje popullore për krahinën e Muhurrit për vitin 1583, dhe përkatësisht kemi:

- ✓ Fshati Bulaç ka një rritje popullore prej 116 veta, me një rritje pesëfish, pra nga 35 banorë në 175 të tillë;
- ✓ Fshati Gardhi ka një shtesë popullore më shumë se tri herë e gjysmë, pra në 175 frymë;
- ✓ Griçani ka një rritje të banorëve tri herë, pra në 90 të tillë;
- ✓ Muhur (Hurdhë – Muhuri) ka shtesë popullore më shumë se 4 herë, pra nga 133 banorë në 560 banorë.

#### **4.3 Lëvizjet e popullsisë në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit në vitin 1923**

Duke analizuar lëvizjet e popullsisë në vitin 1923, pra pas rreth 440 vjetësh, nga viti 1583 rezultojnë se për krahinën e Sllovës dhe Muhurrit kemi këtë situatë:

- ✓ Ripopullimin e Dypjakës me 25 shtëpi me 155 veta,
- ✓ formimin e dy fshatrave të reja, Kalla dhe Lugje, përkatësisht me 30 shtëpi dhe 178 banorë dhe 46 shtëpi me 332 banorë.
- ✓ Si përfundim, sipas viteve të sipërpërmendura, rezultojnë se krahina e Sllovës nga 80 shtëpi me 553 banorë në vitin 1467, në vitin 1583 kemi 133 shtëpi me 940 banorë, ndërkohë që në vitin 1923 kemi 7978 shtëpi dhe 23152 banorë.
- ✓ Banorët e krahinës së Sllovës e kishin lidhur jetën e tyre me bujqësinë, blegtorinë, pyllin, livadhin, tokën bujqësore, kopshtjet, drurët frutorë.

#### 4.4 Lëvizjet e popullsisë në krahinat e Sllovës dhe Muhurrit në periudhën post '90

Tabela 1: Lulatja e lëvizjes së popullsisë në harkun kohor 1996 – 2001 në njësitë administrative të rrethit Dibër.

Nr.	Komuna/ Bashkia	Viti		Diferenca në %
		1996	2001	
1	Arras	5.838	5.778	- 1.0
2	Fushë Cidhën	4.425	4.716	+ 6.5
3	Kala e Dodës	5.713	4.662	- 18.0
4	Kastriot	9.665	10.011	+ 3.6
5	Lurë	3.568	2.065	- 42.0
6	Maqellarë	14.226	13.730	- 3.5
7	Melan	7.593	5.800	- 23.6
8	Muhurr	5.063	4.370	-13.7
9	Peshkopi	18.360	19.386	+ 5.5
10	Qendër Tomin	12.542	10.461	- 16.5
11	Selishtë	4.373	4.054	- 7.3
12	<b>Sllovë</b>	<b>6.471</b>	<b>4.294</b>	<b>- 33.6</b>
13	Zall Dardhë	4.152	3.555	- 14.3
14	Zall Rec	3.897	2.662	- 31.7
15	Luzni	4.970	4.776	- 3.9

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile e rrethit (2002)

Nga analizimi i të dhënave të tabelës nr.1 rezulton:

✓ Lulatja të dukshme në komunën e Sllovës me 33.6 %, të justifikuar këto me faktin e vendndodhjes së tyre tepër larg nga qyteti;

✓ mungesën e aksesit me tregun, kryesisht për produktet blegtorale dhe bujqësore;

✓ sasinë e paktë të tokës bujqësore / frymë;

✓ relievin tepër të thyer të terrenit;

✓ degradimin e një pjese të resurseve pyjore, të cilat janë konsideruar si një ndër burimet e mundshme të jetesës së tyre, etj;

Tabela 2: Të dhëna për popullsinë banuese dhe ndërtesat sipas Censurit 2011

Komunat/ Qarku	Popullsia banuese	Ndërtesat	Banesa gjithsej	Banesa të zakonshme jo të banuara	Banesa të zakonshme të banuara
Muhurr	2780	672	737	191*	545
Slllovë	2405	650	715	256*	457
<b>Gjithsej qarku</b>	<b>137047</b>	<b>29524</b>	<b>39782</b>	<b>10835</b>	<b>28716</b>

Burimi: Census 2011

Nga analizimi i të dhënave të tabelës nr.2 rezulton se kemi:


✓ Numri i madh banesave jo të banuara, ku në krahinën e Slllovës rezultojnë me 256 banesa jo të banuara.

✓ dhe më pak se 191 banesa jo të banuara në krahinën e Muhurrit

Tabela 3: Popullsia dhe sipërfaqja e tokës arë për familje në fshatrat e krahinës së Slllovës

Nr	Fshatrat	Popullsia banorë		Diferenca e popullsisë në %	Sipërfaqja tokë arë dynam/familje në viti 1992
		Viti 1992	Viti 2005		
1	Kallë	448	240	46	8.9
2	Slllovë	729	392	46	10
3	Vleshë	659	351	47	2.5
4	Dypjakë	384	250	34	5
5	Palaman	560	187	67	7
6	Sllatinë	617	404	34	13
7	Shumbat	1454	985	32	13
8	Venisht	518	242	54	6.2
9	Trojak	613	304	50	5
Totali		5982	3355		7.84

Burimi: Daci (2006) Enciklopedia e Dibrës



Nga analizimi i të dhënave të mësipërme rezulton se:

✓ Fshati Vleshë rezulton me më pak tokë për familje, pra shohim se në fshatin Palaman megjithëse ka mesatarisht 7 dynmë tokë arë për familje, rezulton se ka lëvizjet më të mëdha të popullsisë me 67 %. Mendojmë se një ndër arsyt kryesore që lidhet me lëvizjet e mëdha të popullsisë në këtë rast ka të bëjë me mungesën e ujit për vaditje.

✓ Braktisja e banesave është një tregues tjetër i lëvizjeve të mëdha të popullsisë.

✓ Braktisja e tokave bujqësore në zona të pjerrëta, përshpejtim i fenomeneve të erozionit.

Tabela 4: Dinamika e lëvizjes së popullsisë nga viti 1467 deri në vitin 2012 në fshatrat e krahinës Sllovë

Nr	Fshati	Shtëpi në vitin 1467	Shtëpi në vitin 1931	Shtëpi në vitin 1976	Popullsia e banesa në 31.12.1991		Popullsia e banesa në vitin 2012		Pakësimi i popullsisë	
					shtëpi	frymë	shtëpi	frymë	%	frymë
1	Sllovë	4	91	88	139	753	80	320	57.5	433
2	Kallë	-	35	42	82	441	61	252	42.8	189
3	Vleshë	15	-	86	125	662	91	377	43	285
4	Zall-Kalis	-	-	-	116	633	64	268	62.4	395
5	Sllatinë	7	-	92	149	832	100	435	47.7	397
6	Trojak	5	30	72	117	593	52	276	53.4	317
7	Shumbat	26	135	104	268	1438	195	857	40.4	581
8	Palaman	6	30	66	91	552	23	140	74.6	412
9	Dypjakë	9	-	38	59	377	44	222	41.1	155
10	Venisht	6	-	56	89	499	54	191	61.7	308
11	Lugjej	8	60	98	151	923	79	288	68.8	635
Gjithsej		86	381	742	1386	7703	854	3626		4077




Nga analizimi i dinamikës së lëvizjeve të popullsisë në krahinën e Sllovës në periudhën 1991 dhe 2012, bazuar në të dhënat e shifrave të tabelës së mësipërme, duke krahasuar të dhënat e vitit 2012 me të dhënat e vitit 1991, pa marrë parasysh shtesën natyrale të popullsisë rezulton se në Sllovë në vitin 2012 jetojnë 532 familje dhe 4077 frymë më pak.



Tabela 5: Popullsia dhe sipërfaqja e tokës arë për familje ne fshatrat e krahinës së Muhurrit

Nr	Fshatrat	Popullsia banorë		Diferenca e popullsisë në % ndërmjet viteve 1992 dhe 2005	Sipërfaqe tokë arë dynym/familje në vitin 1992
		Viti 1992	Viti 2005		
1	Bulac	507	308	39	8.6
2	Fushë-Muhurr	900	809	13	12
3	Hurdhë-Muhurr	378	261	31	5.9
4	Shqath	523	301	42	3.7
5	Vajmdhej	636	627	1	9.5
6	Rreth Kale	782	542	31	11
Totali		3726	2848		8.45

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile (2005) dhe Zyra e Bujqësisë (2005)



## Përfundime

○ Gjetjet kryesore të studimit tregojnë se pakësimi më i madh i popullsisë në fshatrat e krahinave të marra në studim ka ndodhur pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik e lëvizjeve demokratike.

○ Shkaqet kryesore të lëvizjeve demografike konsistojnë në ndryshimin e menjëhershëm të sistemit social - ekonomik, si dhe kushtet me të cilat u përballen popullsia që jetonte në fshatrat e krahinave të marra në studim në periudhën pas vitit 1990.

- Lëvizjet kryesore demografike rezultojnë me një migrim të popullsisë nga fshatrat e zonës në studim drejt zonave urbane si Tiranë, Durrës, Fushë – Krujë, Lushnjë, për një mundësi jetese më të mirë.

- Lëvizjet demografike kushtëzohen nga burimet natyrore, por kanë çuar edhe në ndryshimet në përdorimin e territorit.

- Në disa raste, lëvizjet demografike janë të konsiderueshme dhe kanë shkaktuar një braktisje të madhe të zonave të banuara, ku fshati me pakësimin më të theksuar të lëvizjeve demografike rezulton fshati Palaman në krahinën e Sllovës dhe fshati Shqath i krahinës së Muhurrit.

- Braktisje e tokave bujqësore në terrenet e pjerrëta kodrinore-malore, duke i ekspozuar ato ndaj fenomenit të erozionit dhe degradimit;

- Dëmtimin, prerjet e pakontrolluara dhe deri braktisje graduale të plantacioneve ekzistuese me pemë frutore (mollë, kumbulla, etj.), siç ishte pemëtorja e Sllovës.

- Prania e një lloji të ri peizazhi, tashmë i quajtur ndryshe “peizazhi i braktisur”, tepër i përhapur edhe në zonat rurale të zonës së marrë në studim në krahinën e Sllovës dhe të Muhurrit, veçanërisht në fshatrat e vendosura në shpate të pjerrëta, tokë të paktë bujqësore, mungesë infrastrukture etj.

- Në krahinën e Muhurrit rezulton se në fshatin Shqath për vitin 2021, megjithëse në gjendjen civile janë të regjistruar rreth 100 banorë, de fakto nuk ka asnjë banor, pra kemi një braktisje totale të territorit.

- Në fshatin Bulac jetojnë vetëm 8 familje me 30 banorë.

## Literatura

Banka Botërore. et al (2016), “Profili i Varfërisë dhe Pabarazisë në Shqipëri”, f. 18.

Collaku, N., (2005), Studimi i aspekteve social-ekonomike në fokusin e një mbarështimi të qëndrueshëm të pyjeve në rrethet Kukës, Dibër, Bulqizë dhe Librazhd, f. 23-27.

Daci. F., (2006), Enciklopedia e Dibrës, f. 104 – 110.

Daci. F; (2021), “Historia e Ujë e m’Ujës, f. 3-5.

Frashëri. K., (2012), Historia e Dibrës – që nga lashtësia deri në mars 1939, f. 11-12.

Gjoni. Z., Përnezha. H., (2011), Dibra në defterët osmanë (1467, 1583) - Regjistrimet e Perandorisë Turke të vitit 1467. Vol. I, f. 368-369.

Havene shpk (2008), Plani i Menaxhimit të Mikrobasenit të Komunës Slllovë, f. 13 -19.

INSTAT (2011), Censusi i popullsisë në vitin 2011.

Korabi shpk (2007), Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të Komunës Muhurr, f 11-18.

Laci. S., (1998), Gjeografia rurale f. 18-31;

Myers. N, Kent. J., (1995), Environmental Exodus: An Emergent Crisis in the Global Arena. Climate Institute, Washington, DC. f. 18.

Tufa. A., (2008), Dibra në sytë e të huajve. f. 96; f.261.

Wikipedia: [https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia\\_e\\_Shqip](https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Shqip)).

**Dr. Florian Fusha<sup>1</sup>**

## **POPULLSIA DHE VENDBANIMET NË HAPËSIRËN GJEOGRAFIKE DHE ETNOGRAFIKE TË DUKAGJINIT**

### **Abstrakt**

Krahina e Dukagjinit, për pozicionin e saj strategjik, e vendosur në zemër të Alpeve Shqiptare ka qenë historikisht e banuar. Alpet Shqiptare kanë shërbyer si kështjellë natyrore për mbrojtjen e popullsisë.

Vendbanimet e krahinës së Dukagjinit, të vendosura në 2 luginat (Shalës e Kirit), në shpatet në dy anët e luginave deri në lartësitë afër 1000 m mbi nivelin e detit.

Copëtimi i madh i relievit të Alpeve ka qenë një faktor përcaktues në vendosjen e vendbanimeve, tiparet e tyre dhe në mënyrën e jetesës. Ky copëtim i madh i relievit, me male mbi 2000 m, me qafa në 1500 – 1800 m, me shpate të pjerrëta dhe lugina me shtrat kryesisht nga 300 -700 m mbi nivelin e detit, ka krijuar kushte të mira mbrojtëse dhe mbijetese, por nuk ka lejuar një zhvillim social-ekonomik të mirëqenë.

Ka kushtëzuar toka të pakta dhe jo të përshtatshme bujqësore, komunikim e shkëmbime shumë të vështira.

Kjo ka qenë një nga arsyet kryesore që me rënien e rolit mbrojtës dhe me lejimin e lëvizjes së lirë të popullsisë, sidomos pas viteve '90 të shek. XX u shoqërua me një braktisje masive të Dukagjinit, me një largim të rreth 75-80% të popullsisë.

Por me ndryshimet e viteve të fundit dhe me zhvillimin gjithnjë e në rritje që po merr turizmi, me të drejtë shtrohen pyetjet:

- A do jenë këto male burim për një të ardhme me mirëqenie për popullsinë e këtij rajoni?

---

<sup>1</sup>Doktor magjstral në studime gjeografike dhe antropologjike

- A do të ndalohet braktisja e këtyre vendbanimeve?

Prandaj, ky referim ka vendosur në fokusin e tij një analizë të rolit të Alpeve në vendosjen dhe funksionimin e vendbanimeve në Dukagjin deri në ditët e sotme dhe njëkohësisht do të japë përgjigje për pyetjet e mësipërme.

*Fjalë çelës: Dukagjin, Alpet, turizëm,, agroturizëm, alpinizëm .*

### **Abstract**

The Dukagjini region, for its strategic position, located in the heart of the Albanian Alps has been historically inhabited. The Albanian Alps have served as natural fortresses for the protection of the old population, but also of the new populations, which as a result of the constant wars that have taken place in Albanian lands, have moved towards these mountains to survive. The settlements of the Dukagjini region, located in the 2 valleys of the region (Shala e Kiri), are located on the slopes, on both sides of the valleys up to altitudes close to 1000m above sea level. The great fragmentation of the relief of the Alps has been a determining factor in the placement of settlements, their features and in the way of life. This large fragmentation of the relief, with mountains over 2000m, with necks at 1500 - 1800m, with steep slopes and valleys with floors mainly from 300 -700m above sea level, has created good conditions for protection and survival but has not allowed a welfare socio-economic development. It has conditioned scarce and unsuitable agricultural lands and poor and very difficult communications and trade. And this was one of the main reasons that with the decline of the protective role and the allowing free movement of people, especially after the 90s of the century. XX was accompanied by a mass abandonment of Dukagjini, with approximately 75-80% of the population departing. But with the changes in recent years and the growing development of tourism, the questions are rightly asked:

a- Will these mountains be a source for a prosperous future for the population of this region?

b- Will the abandonment of these settlements be stopped?

Therefore, this reference has focused on an analysis of the role of the Alps in the establishment and functioning of the settlements in Dukagjini up to the present day and at the same time, it will provide answers to the above questions.

*Keywords: Dukagjin, Alps, tourism, agritourism, mountaineering*

## I. Metoda

Metoda e punës e përdorur për realizimi e këtij referimi është një ndërthurje dhe analizë e ekspeditave në terren, kërkime bibliotekare dhe arkivore, si dhe intervista dhe diskutime me ekspertë të fushave të ndryshme dhe banorë të zonës.

## II. Diskutime

Referimi ka si objektivi: evolucionin historik të popullsisë së Dukagjinit, veçoritë aktuale hapësinore dhe cilësore të popullsisë, potencialet ekonomike në raport me kushtet që ofrojnë Alpet Shqiptare dhe disa sugjerime për investime strategjike për krijimin e kushteve për zhvillimin e zonës.

## III. Hyrje e shkurtër gjeografike

Dukagjini, një krahinë gjeografike dhe etnografike e Shqipërisë, shtrihet në pjesën qendrore të Alpeve Shqiptare, në pjesën veriore të bashkisë së Shkodrës, ndërmjet bashkive të Malësisë së Madhe në perëndim, bashkisë së Tropojës në lindje dhe bashkisë së Vaut të Dejës në jug. Ndodhet midis koordinatave gjeografike:  $42^{\circ} 11'$  dhe  $42^{\circ} 29'$  gjerësia gjeografike veriore,  $19^{\circ} 38'$  dhe  $19^{\circ} 52'$  gjatësia gjeografike lindore. Nga ana administrative bën pjesë në qarkun e Shkodrës, në bashkinë e Shkodrës dhe një pjesë shumë e vogël në bashkinë e Vaut të Dejës. Krahina përbëhet nga njësitë administrative të Shalës, Shoshit dhe Pultit në bashkinë e Shkodrës dhe zona e



Toplanës në njësinë administrative Temal, bashkia Vau i Dejës. Dukagjini ka një sipërfaqe prej rreth 500 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 3800 banorësh, me 25 fshatra dhe me fshatin e Breglumit si qendër kulturore.

### **1-Mjedisi gjeografik**

Dukagjini ka një mjedis gjeografik me një pasuri mjedisore shumë të pasur, me forma relievesh, kushte klimatike, hidrologjike, florë e faunë që ofrojnë potenciale shumë të larta për zhvillimin e zonës nëpërmjet turizmit malor. Mjedisi gjeografik ka një vlerë shumë të madhe ekologjike, e cila lidhet me shumëllojshmërinë e ekosistemeve dhe habitateve natyrore si ekosistemi malor, lumor, pyjor, livadhor, kullotave alpine, karstik, akullnajor etj.

### **IV. Popullimi i Dukagjinit**

Për evolucionin e popullimit të kësaj zone nga antikiteti e deri më fitoren e Pavarësisë më 1912, ashtu si për të gjithë Shqipërinë, nuk ka të dhëna të sakta. Megjithatë, mund të jepet një informacion për evolucionin e kësaj popullsie në bazë të të dhënave historike dhe arkeologjike.

Një ndihmesë shumë të madhe në këtë rast na japin relacionet që priftërinjtë katolikë të zonës i dërgonin Vatikanit dhe defterët turq të regjistrimit të popullsisë për efektin e taksave. Por këta defterë janë të shoqëruar nga një numër i madh pasaktësish dhe gabimesh për zonat si Dukagjini, ku nëpunësit turq e kishin të pamundur të shkonin për të kryer regjistrimin.

Në antikitet ishte pjesë përbërëse e fisit ilir të labeatëve, dhe pjesë e Mbretërisë Ilire. Në mesjetën e hershme popullsia u rrit si pasojë e ardhjes së shqiptarëve nga zona e Bosnjës, por për këtë popullsi nuk ka asnjë të dhënë se sa ishin në numër apo ndonjë të dhënë tjetër demografike. Informacionet për ngulitjen e kësaj

popullsie vijnë nga tradita popullore.

Në shek. XIV dhe XV zona kaloi në dorë të principatës së Spanëve. Në këtë periudhë, zona ka një rritje ekonomike, politike dhe ushtarake, që sot shprehet me rrënojat e disa qyteteve të njohura të asaj kohe: Qyteza e Dakajve ose Mavriqi në Nënmaçriq, Shalë, qyteza e Pepsuamajve në Shosh. Një fakt tjetër që tregon rëndësinë e kësaj zone është edhe vizita e Skënderbeut në qytetin e Dakajve për të siguruar aleancë me Spanët. Në këtë periudhë kemi dhe ardhjen e fiseve të Shalës dhe Shoshit dhe vendosjen e tyre në zonën e Dukagjinit, 1430-1450.

Më 1485, në defterin turk të regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës (*Pulaha, 1975*) jepet një informacion për nahijen e Petishpanit (siç e quanin zonën turqit). Sipas këtij defteri kishte rreth 170 shtëpi, me rreth 1300 banorë. Shumë fshatra janë shpopulluar plotësisht. Defteri turk i vitit 1582 nuk jep asnjë të dhënë pasi ishte një zonë në luftëra të vazhdueshme me ushtrinë turke. Më 1671, në relacionin e tij Stefan Gaspari kishte 299 familje me rreth 1868 banorë (*Gaspari, 1930*). Kjo dëshmon se për një periudhë pothuajse dyshekullore (1485-1671) popullsia e Dukagjinit është rritur shumë pak, me vetëm 130 familje, pra ka kaluar nga 170 familje më 1485, në 299 familje në 1671, edhe si numër banorësh rritja ka qenë shumë e vogël (rreth 570 banorë), duke kaluar nga 1300 banorë më 1485, në 1868 banorë më 1671. Kjo ka ardhur si pasojë e luftërave që bënë dukagjinastit më ushtritë turke dhe me zonat përreth.

Në shekullin e 17-të ka një rritje të popullsisë si pasojë e ardhjes së fisit të Gimajve, të cilët, duke gjykuar nga numri i tyre sot, mund të flitet se kur erdhën ishin disa qindra njerëz.

Fiset e Shalës dhe të Shoshit, të cilët janë në rritje demografike fillojnë të zgjerohen dhe të ndahen në fshatra të reja. Lindin fshatrat e reja të Thethit, Nënmaçriqit etj., por kjo solli edhe largimin e fiseve të vjetra si Mavriqi, Lopçi pjesërisht etj.



Një shekull më vonë, Dukagjini (viti 1772) kishte rreth 510 shtëpi me rreth 3500-4000 banorë (Shala 150 shtëpi, Shoshi 138 shtëpi, Kiri 72 shtëpi, Xhani 95 shtëpi dhe Toplana 57 shtëpi).

Më 1897-1902 konsulli austriak në Shkodër Theodor Ippen (*Ippen 2002*) bëri disa ekspedita studimore në Shqipërinë Veriore, ku mes të tjerave, studioi edhe Dukagjinin. Sipas këtij studiuesi, më 1902 zona e Dukagjinit kishte rreth 9700 banorë. Një numër të përafërt jep edhe A. Baldacci në studimin e tij “Note statistiche sul vilajet di Scutari” (*Baldacci 1901*), i botuar më 1901, ku zona e Dukagjinit jepet me 1330 shtëpi, me 8850 banorë.

Më 1918 trupat pushtuese austro-hungareze bënë regjistrimin e popullsisë së zonave të pushtuara në Shqipëri, ku hynte edhe Dukagjini. Sipas këtij regjistrimi zona futej në njësinë ushtarake (Kreis) të Kirit e kishte 1167 shtëpi, 129 familje dhe 6386 banorë, të gjithë katolikë (*Seiner, 1922*).

Regjistrimi i parë i popullsisë së zonës nga shteti shqiptar u bë më 1923, sipas të cilit, zona e Dukagjinit ishte pjesë përbërëse e nënprefekturës së Dukagjinit dhe kishte 4 krahina, 46 katunde, 1107 shtëpi dhe 6831 banorë, të gjithë katolikë.

Në regjistrimin e vitit 1927 (*Seleniza, 1928*), zona ka 19 katunde me 1083 shtëpi dhe me 6820 banorë. Për kushtet e Dukagjinit në atë kohë (kryengritja e Dukagjinit e 1926-s etj.), për regjistrimin e vitit 1927 janë bazuar në regjistrimin e vitit 1923 dhe kanë bërë ndryshimet në Tiranë.

Pas Çlirimit (1944), si për gjithë Shqipërinë edhe Dukagjini, si pasojë e politikave pronataliste që ndoqi shteti ynë, pati në rritje të shpejtë të popullsisë. Në vitin 1955 zona kishte 8378 banorë, më 1960 kishte 9014 banorë, më 1970 kishte 10957 banorë, më 1973 kishte 11689 banorë, më 1980 kishte 12842 banorë, më 1983 kishte 13000 banorë dhe më 1990, në prag të rënies së sistemit socialist, kishte 3598 familje me 12062 banorë.

Ndryshimi i sistemit u shoqërua me një sërë ndryshimesh, si në

ndryshimin e politikës nga pronataliste në proplanifikimit familjar, lëvizja e lirë e njerëzve etj. Këto u shoqëruan me një largim masiv të popullsisë nga zona. Por vjetari statistikor i rrethit Shkodër i vitit 1999 na jep për zonën një numër shumë të madh banorësh, ku zona e Dukagjinit del me 3545 familje me 11763 banorë (kjo ndodh për arsye së vjetarët statistikorë të rretheve bazohen në të dhënat e marra nga gjendjet civile, por në gjendjet civile të zonave malore, ndonëse popullsia largohet, ajo nuk bën çregjistrimin, prandaj zyrtarisht ajo vazhdon të jetë banore e zonës, edhe pse ka vite që është larguar. Për këtë mund të marrim si shembull fshatin Ndërlisë, komuna Shalë, në të cilin më 31.7.2003, zyrtarisht nga gjendja civile e Breglumit jepej se ky fshat ka 136 familje, me 437 banorë, por në një analizë në terren doli se në fshat ishin 4 familje më 18 banorë. Pasaktësinë e këtij vjetari e tregoi edhe regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe i vendbanimeve i prillit të vitit 2001 (*Instat 2001*), sipas të cilit zona e Dukagjinit kishte 1410 familje me 7110 banorë. Me një rënie prej rreth 50% në raport me vitin 1990 (me rënien e sistemit).


Regjistrimi i popullsisë dhe banesave i vitit 2011 (*Instat 2011*) tregoi përmasat reale të eksodit të popullsisë së Dukagjinit. Sipas tij, zona kishte 852 familje me 3798 banorë, me një rënie prej pothuajse 50 % nga regjistrimi i vitit 2001 dhe me një rënie drastike prej 75% në krahasim me vitin 1990. Në pritje të regjistrimit të ri të popullsisë dhe banesave të vitit 2021, për të certifikuar situatën e re demografike të zonës së Dukagjinit, siç jepet edhe nga tabela dhe grafiku nr.1, për evolucionin numerik të popullsisë, mund të themi se eksodi ka vazhduar për shkak të vështirësive ekonomike të zonës, e cila është lënë në harresë, bën përjashtim vetëm zona e Thethit (Theth e Ndërlisa), ku si pasojë e interesimit gjerman (GTZ, GIZ etj.), ka pasur një zhvillim gjithnjë e në rritje të turizmit malor dhe ardhjes së mijëra turistëve gjatë vitit. Zhvillim që ka sjellë jo vetëm ndaljen e eksodit, por edhe një rikthim të popullsisë.

Tab. 1 . Evolucioni numerik i popullsi së Dukagjinit.

Nr.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
Viti	1485	1671	1772	1902	1918	1923	1927	1955	1960	1970	1973	1980	1983	1990	1999	2001	2011
Popullsia	1357	1868	3700	9300	6386	6831	6820	8378	9014	10957	11689	12847	13000	12062	11763	7110	3798

Burimi: Pulaha 1975, Gaspari 1930, Shoqata 1968, Ippen 2002, Seiner 1922, Selenica 1928, Vjetari 1983, 1999, Instat 2001, 2011.

Grafiku nr. 1 .Evolucioni numerik i popullsisë të Dukagjinit në periudhën 1485 – 2011.



Burimi: Pulaha 1975, Gaspari 1930, Shoqata 1968, Ippen 2002, Seiner 1922, Selenica 1928, Vjetari 1983, 1999, Instat 2001, 2011.

#### IV.1. Etapat e popullimit të Dukagjinit

Pasi kemi bërë një analizë të plotë të evolucionit numerik të popullsisë së zonës përgjatë gjithë historisë, arrijmë në konkluzion se këtë evolucion mund ta ndajmë në katër etapa:

**IV.1.1. - Etapa e parë, nga mesjeta deri më 1912,** në të cilën kemi një rritje të ngadaltë të popullsisë, e cila ka ardhur si pasojë e lindjeve të shumta dhe e ardhjeve të banorëve nga zonat e tjera për t'i shpëtuar regjimit turk nga njëra anë, por edhe vdekjet dhe largimet e popullsisë për në fushën e Shkodrës dhe në rrafshin e Dukagjinit. Mortaliteti i madh që ka zona vinte për tri arsye: luftërat me turqit dhe zonat përreth, mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe fenomeni i gjakmarrjes.

**IV.1.2. - Etapa e dytë, nga fitorja e Pavarësisë më 1912 e deri më 1945,** në këtë periudhë popullsia e zonës ka një stacionim, madje

dhe një rënie të popullsisë, e cila ka ardhur për katër arsye: ra roli mbrojtës që zona ofronte para Pavarësisë, humbja e tregjeve kryesore të saj, Plava dhe Gucia, kjo shkaktoi mungesën e drithërave dhe si pasojë, zona përjetoi periudhën e zisë së bukës në vitet 1913-1923, gjë që i detyroi banorët e zonës të largohen dhe të vendosen në zona të tjera të Shqipërisë si në Shkodër, Pejë etj. Pas asaj që ka hyrë në histori me emrin “Kryengritja e Dukagjinit”, 20.11.1926, një pjesë e popullsisë së zonës u detyrua të shpërngulej për në ish-Jugosllavi, për t’u shpëtuar reprezaljeve të xhandarëve dhe mercenarëve myslimanë të qeverisë së Zogut. Epidemitë e shumta që binin në zonë si: kolera, e cila mbyti më 1918 rreth 1500 vetë.

**IV.1.3. - Etapa e tretë, nga Çlirimi i vendit (1945) e deri në rënien e sistemit socialist (1990)**, gjatë kësaj periudhe kemi një rritje të madhe dhe të shpejtë të popullsisë së zonës (dyfishim të popullsisë), e cila ka ardhur për shkak të rritjes së numrit të lindjeve dhe rënies së numrit të vdekjeve si pasojë e përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore, ndërprerjes së luftërave dhe të gjakmarrjes. Edhe në këtë kohë vërehet një largim i banorëve nga zona, por në ndryshim nga herët e tjera, tashmë ishte vetëm në zonat e tjera të Shqipërisë (në raste të rralla jashtë Shqipërisë, në mënyrë klandestine) dhe i organizuar nga shteti, sidomos në periudhën 1945-1960, kur me banorët e larguar nga zona u formuan disa fshatra në vende të ndryshme si fshati Dukagjin i Ri në Mamurras.

**IV.1.4. - Etapa e katërt, nga rënia e sistemit socialist (1990) e deri sot**, gjatë kësaj periudhe vërehet një rënie drastike e numrit të popullsisë së zonës, e cila ka ardhur si pasojë e kufizimit të lindjeve, emigracionit të jashtëm dhe sidomos eksodit masiv rural, dhe siç vërehet nga të dhënat e mësipërme, më 2011, popullsia e zonës ishte pothuajse sa numri i popullsisë së vitit 1772 dhe vetëm 25% e popullsisë së vitit 1990. Shkaqet e këtij eksodi masiv rural të

popullsisë pas viteve '90 janë nga më të ndryshmet, por më kryesoret kanë qenë: kushtet e vështira social-ekonomike të zonës, shkatërrimi i infrastrukturës së zonës pas viteve '90, dëshira e njerëzve për të lëvizur etj.

Ky eksod masiv i popullsisë ka pasur anë pozitive dhe negative.

**Anët pozitive:** rënie e mbipopullimit të zonës, e cila për kushtet e sotme të zhvillimit ekonomik e ka të pamundur mbajtjen e tyre; zvogëlimi i presionit human ndaj mjedisit; ruajtja më e mirë e peizazhit human, sidomos e parkut të Thethit.

**Anët negative:** braktisja e tokave bujqësore, të cilat janë kryesisht të hapura në shpate. Sipas regjistrimit të ekonomive bujqësore të 1998, në zonën e Dukagjinit ishin braktisur 58 ha tokë, kjo shkakton një nxitje të erozionit dhe formimin e bedlendeve.

## V. Veçoritë e shpërndarjes gjeografike të popullsisë

Shpërndarja gjeografike e popullsisë është një dukuri e rëndësishme, dhe me treguesit e saj ndikon në shumë probleme të tjera të zhvillimit ekonomik-shoqëror të një vendi apo një zone.

**V.1.** Treguesi kryesor që shpreh shpërndarjen gjeografike të popullsisë është *dendësia e popullsisë* për njësinë e sipërfaqes, pra banorë /km<sup>2</sup>. Sot në zonën e Dukagjinit dendësia e popullsisë në bazë të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe vendbanimeve të 2011 është 7.6 b/km<sup>2</sup>.

### V.2. Tregues të tjerë të shpërndarjes së popullsisë.

**V.2.1.** Dendësia e popullsisë fshatare për njësinë e sipërfaqes së punueshme, pra b/ha, e cila më 1990 ishte 7.5 banorë/ha, kurse më 2011 ishte 7.6 banorë/ha. Pra edhe pse ka ndodhur një eksod masiv pas viteve '90, zona nuk ka pasur një rënie të densitetit të popullsisë për njësinë e punueshme dhe kjo ka ardhur si pasojë e rënies së sipërfaqes së tokës bujqësore nga 1614 ha më 1990, në 500 ha më 1998 (*të dhënat e Instat-it*).

**V.2.2.** Dendësia e qendrave të banuara për 100 km<sup>2</sup>, është rreth 5

vendbanime për 100 km<sup>2</sup>.

**V.2.3.** Distanca e vendbanimeve nga njëri-tjetri është rreth 4.1 km.

## VI. Lëvizja e përgjithshme e popullsisë

Në zhvillimin demografik të një vendi apo zone, rol të rëndësishëm luan lëvizja e përgjithshme e popullsisë, me të cilën kuptojmë të gjitha ndryshimet që ndodhin në numrin e popullsisë, strukturën e saj sipas grupmoshave, gjinisë, vendbanimeve etj. Lëvizja e përgjithshme e popullsisë shprehet në dy forma: lëvizje natyrore e popullsisë dhe lëvizje hapësinore e saj.

### VI.1. - Lëvizja natyrore e popullsisë

Me lëvizje natyrore të popullsisë kuptojmë të gjitha ndryshimet që ndodhin në zhvillimin e popullsisë si rezultat i ndikimit të faktorëve të brendshëm, ku përcaktues janë ata biologjikë, por ndikojnë edhe faktorë kulturorë, shoqërorë, ekonomikë etj. Elementët e lëvizjes natyrore të popullsisë janë: lindjet, vdekjet, martesat dhe divorcet. Ndërsa treguesi kryesor i lëvizjes natyrore të popullsisë është shtesa natyrore, e cila jepet nga diferenca e numrit të lindjeve me numrin e vdekjeve për çdo 1000 banorë. Për të analizuar lëvizjen natyrore të popullsisë, në studim janë marrë tri vite, të cilat përfaqësojnë tri periudhat e zhvillimit demografik të zonës për shekullin e 20-të (viti 1927 për periudhën 1912-1945, viti 1983 për periudhën 1945-1990 dhe viti 1999 për periudhën pas viteve '90 ) dhe paraqiten si më poshtë:

Tab.2 Shtesa natyrore e popullsisë.

Viti	Lindje		Vdekje		Shtesa natyrore
	Numër	Për mijë	Numër	Për mijë	Numër
1927	131	19.2	116	17.0	15
1983	382	29.4	118	9.1	264
1999	224	19.1	70	6.0	154

Burimi: Selenica 1928 , Vjetari 1983 dhe 1999

Siç jepet nga tab. 2, më 1927 zona ka pasur një lindshmëri mesatare, e shkaktuar nga largimi i një pjese të popullsisë pas kryengritjes së nëntorit 1926, dhe ka pasur një vdekshmëri shumë të lartë, e cila ka ardhur si pasojë e kushteve të papërshtatshme të jetesës, kryengritjes së nëntorit të vitit 1926, sëmundjeve epidemike etj. Si pasojë e gjitha këtyre ka pasur një shtesë natyrore shumë të vogël (2.2 për mijë), kjo ka sjellë një shtesë shumë të vogël të popullsisë, e cila nuk ka qenë në gjendje që të kompensojë largimet e popullsisë nga zona, prandaj kemi një rënie të vogël të popullsisë në krahasim me vitin 1923.

Viti 1983 i korrespondon edhe vitit në të cilin zona ka pasur maksimumin absolut të popullsisë, dhe njëkohësisht paraqet edhe rezultatin e politikave pronataliste të ndjekura nga shteti shqiptar në periudhën 1945-1990. Nga tabela del se në këtë periudhë zona ka një rritje të lindshmërisë dhe një rënie të nivelit të vdekshmërisë (si pasojë e përmirësimit të kushteve të jetesës, ndërprerjes së gjakmarrjes etj.) dhe kjo ka sjellë edhe një rritje të shpejtë natyrore të popullsisë.

Viti 1999, ashtu si për të gjithë Shqipërinë, tregon se ka një stabilizim të lindshmërisë dhe një rënie të mëtejshme të vdekshmërisë, të cilat kanë shkaktuar një rënie të shtesës natyrore të popullsisë.

VI.1.1. Jetëgjatësia mesatare e popullsisë është një tjetër element i rëndësishëm që lidhet me lëvizjen natyrore të popullsisë, e cila sot është rreth 75 vjeç.

VI.1.2. Mosha mesatare e popullsisë është një element tjetër që lidhet direkt ose indirekt me lëvizjen natyrore të popullsisë dhe sot është rreth 28-30 vjeç. Kjo premon për një vazhdim të shtimit të lartë natyror të popullsisë edhe në të ardhmen, nëse nuk ndikojnë faktorë të tjerë.

## VI.2. Lëvizja hapësinore e popullsisë

Pjesë përbërëse e lëvizjes së përgjithshme të popullsisë është lëvizja e saj hapësinore, e cila ka si rrjedhojë shpërndarjen dhe rishpërndarjen e popullsisë. Treguesi që shpreh këtë lëvizje quhet *saldo migruese*, e cila shpreh diferencën midis të larguarve dhe të ardhurve të një vendi apo zone. Dhe kjo mund të jetë pozitive kur dominojnë të ardhurit dhe negative kur dominojnë të larguarit. Siç kemi theksuar edhe në evolucionin e popullsisë, gjatë gjithë historisë zona është karakterizuar nga ardhje dhe largime të popullsisë. Ardhja ka qenë nga zonat në të cilat bëheshin luftime, kurse largimet ishin kryesisht për në fushën e Shkodrës e Kosovës. Në periudhën 1945-1990 lëvizja hapësinore e popullsisë së zonës u kufizua në dy forma: në zhvendosje të përcaktuar nga shteti, nga zona për në qytete dhe brenda zonës (fshat-fshat), si krijimi i një lagjeje në fshatin Breglumi me njerëz të ardhur nga fshatrat e tjera të zonës. Pas viteve '90 lëvizja hapësinore e popullsisë karakterizohet nga një zhvendosje masive e popullsisë në dy drejtime: zhvendosja e popullsisë në drejtim të qyteteve dhe zonave të tjera të Shqipërisë, kryesisht në Shkodër, dhe zhvendosja e popullsisë për në shtetet e botës (emigracion i jashtëm), kryesisht të rinjtë.

Sa u takon të ardhurve, ka qenë një dukuri e rrallë dhe kanë qenë kryesisht vajza që martohen në zonë nga zonat e tjera. Pasojat e lëvizjes hapësinore të popullsisë janë të shumta, pozitive dhe negative, por këtu do të përmendim dy pasoja të rëndësishme të saj që njëkohësisht janë edhe më negative: **largimi i trurit**, pasi të parët që largohen janë intelektualët dhe **largimi i rinisë**, pra largimi i fuqisë punëtore. Largimi i këtyre dy grupeve sjell ndërprerjen e zhvillimit ekonomik dhe ndalimin e rritjes numerike të popullsisë.



## VII. Struktura cilësore e popullsisë

Struktura cilësore e popullsisë është një element i rëndësishëm i studimit të një vendi dhe njëkohësisht dhe i së ardhmes së atij vendi në pikëpamjen e zhvillimit dhe të mirëqenies. Me strukturë cilësore të popullsisë së zonës, kuptojmë strukturën e saj sipas grupmohave, gjinisë, strukturën sociale dhe strukturën sipas vendbanimit.

**VII.1 - Struktura moshore e popullsisë së zonës** tregon numrin sipas grupmohave të veçanta. Për nxjerrjen e kësaj strukture për problemin e aftësisë së popullsisë për punë, është bërë ndarja e popullsisë në tri grupmosha, tabela 3: grupmosha nën moshën e punës (0-15 vjeç), grupmosha e moshës së punës (15-60 e 65 vjeç) dhe grupmosha mbi moshën e punës (mbi 60 e 65 vjeç).

Tab.3. Struktura moshore e popullsisë.

Grupmosha	% viti 2001	% viti 2011
0-15 vjeç	37	26
15-60 e 65 vjeç	54	64
Mbi 60 e 65 vjeç	9	10

Burimi: Instat, Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe i banesave prill 2001 dhe 2011

Zona ka një popullsi me moshë të re, e cila është bazë për shtimin e popullsisë në të ardhmen (në Dukagjin apo jashtë tij). Në strukturën moshore dominojnë moshat e reja, e kjo ka ardhur si pasojë e lindjeve relativisht të larta dhe rënies së numrit të vdekjeve, por gradualisht popullsia po plaket.

**VII.2 - Struktura gjinore e popullsisë**, tregon raportin mes femrave dhe meshkujve në kuadër të gjithë popullsisë. Për këtë strukturë bëhet ndarja e popullsisë në dy grupet e saj gjinore *meshkuj* dhe *femra*, dhe janë 2025 meshkuj dhe 1773 femra. Dominon elementi mashkull.

**VII.3 - Struktura sociale e popullsisë**, përcaktohet nga shumë

faktorë, politikë, ekonomikë, shoqërorë, dhe më së shumti ka në themel elementin e pronësisë. Në zonë mbizotëron grupi social i fermerëve privatë (të cilët kanë një sipërfaqe bujqësore shumë të vogël dhe nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre e jo më të dalin në treg), por ka dhe grup social të intelektualëve, të tregtarëve etj.

#### **VII.4. - Struktura e popullsisë sipas vendbanimeve**

Dukagjini karakterizohet si një zonë totalisht fshatare (100 %), pasi mungojnë qytetet. Fshatrat e zonës shtrihen nga lartësitë 200-1000 m. Fshatrat janë të vjetër, të formuar në mesjetën e hershme si: Kiri, Toplana, Pogu etj., në mesjetën e vonë si Pecaj, Nicaj-Shalë, në shekujt XVII – XVIII si Thethi, Gimaj etj. dhe fshatra të reja të formuara me dekrete qeveritare në 50 vitet e fundi si: Breglumi, Nderlysa etj. Për nga ana e funksionit, fshatrat e Dukagjinit janë kryesisht agrare dhe ndonjë i përzier si: Thethi (përzierje e bujqësisë me turizmin), Breglumi (përzierje e bujqësisë me administratën). Meqenëse të gjitha fshatrat e Dukagjinit janë shtrira në Alpet e Shqipërisë, pavarësisht nga lartësia ku ndodhen, ato janë fshatra malore.

Në regjistrimin e popullsisë dhe të banesave të vitit 2011, zona e Dukagjinit kishte 852 familje dhe 3798 banorë, dhe të ndara sipas njësive administrative janë si më poshtë:

**Njësia administrative e Shalës** ka 11 fshatra me 415 familje dhe 1804 banorë, njëkohësisht struktura gjinore e popullsisë është 964 meshkuj dhe 840 femra. Qendra është fshati Breglumi.

**Njësia administrative e Shoshit** ka 5 fshatra me 68 familje dhe 304 banorë, njëkohësisht struktura gjinore e popullsisë është 171 meshkuj dhe 133 femra. Qendra është fshati Ndreaj.

**Njësia administrative e Pultit** ka 7 fshatra me 333 familje dhe 1529 banorë, njëkohësisht struktura gjinore e popullsisë është 799 meshkuj dhe 733 femra. Qendra është fshati Pogu.

Edhe dy fshatrat e Njësisë administrative Shllak, por që janë

pjesë e zonës së Dukagjinit: Toplana me 27 familje dhe 121 banorë dhe Serma me 7 familje dhe 40 banorë.

### **VIII. Zhvillimi ekonomik dhe perspektiva**

Zona e Dukagjinit, duke qenë një zonë e lartë dhe e izoluar malore, në kushtet e sotme ka një zhvillim të dobët ekonomik dhe është një nga zonat më të varfra të Shqipërisë. Me fitoren e Pavarësisë, Alpet Shqiptare e humbën rolin mbrojtës si fortesë natyrore dhe për shkak të mungesës së projekteve të drejta ekonomike, infrastrukture dhe të mosinvestimeve nga shteti shqiptar, Alpet u kthyen në një pengesë shumë të madhe për zhvillimin ekonomik të zonës. Aktiviteti kryesor i popullsisë është ekonomia bujqësore, por duhet theksuar se zona e Dukagjinit si pasojë e relievit dhe e klimës së ashpër nuk ka kushte të mira për zhvillimin e këtij aktiviteti ekonomik. Pavarësisht nga këto, dukagjinast kanë arritur t'i "grabisin" natyrës ndonjë pëllëmbë tokë dhe ta bëjnë tokë bujqësore. Infrastruktura dhe rrjeti i shërbimeve është i një niveli shumë të ulët.

Dukagjini duke qenë një zonë malore e vendosur në qendër të Alpeve Shqiptare ka një larmi mundësish për tërheqjen e turistit shqiptar dhe atij të huaj, dhe ndër më kryesoret janë:

**VIII.1.- Agroturizmi.** Turisti gjen natyrën e pastër, traditën dhe zakonet e pasura. Bujqësia e blegtoria rritet me ushqime biologjikisht të pastra dhe natyrore dhe jo me kimikate. Ka ujin dhe ajrin të një cilësie shumë të lartë. Dhe shumë monumente të natyrës siç janë: kanioni i Grunasit, shpella e Zhylës etj. dhe objekte të kulturës popullore si: kulla e ngujimit në Theth, si dhe një sërë objektivash të tjera të prodhimeve artizanale dhe të kulturës materialo-shpirtërore .

**VIII.2.- Alpinizmi.** Zona ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e alpinizmit amator dhe sidomos atij profesionist, pasi e gjithë zona rrethohet nga maja mbi 2000 m dhe të ndërtuara në

gëlqerorë që krijojnë rrëpira fantastike prej 400-500 m të larta. Vendet më të përshtatshme për alpinizëm janë blloku i Jezercës, vargmali Kaki-Ndërmanjë, Biga e Gimajve etj.

**VIII.3.- Speleologjia.** Ndërtimi kryesisht nga gëlqerorë, ku janë formuar shpella të shumta, ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e speleologjisë. Shpellat më interesante janë: shpella e Majës së Alisë në Theth, shpellë më shumë kate dhe me tre sifonë, shpella e Zhylës në Prekal, etj. Por nuk ka një studim të plotë për numrin e shpellave të zonës, pasi ato janë shumë më tepër.

**VIII.4.- Sporti i skive.** Për shkak të kushteve të përshtatshme topografike (shpate të pjerrëta) dhe atyre klimatike (ditët e shumta me dëborë), zona ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e këtij sporti.

**VIII.5.- Ekskursionet në natyrë.** Zona ofron kushte shumë të mira për ekskursionet kolektive dhe familjare në zona piktoreske etj. Mund të zhvillohen ekskursionet në fshatin e Thethit, në lugun e Runicës, në qafën e Tërthores, në qafën e Valbonës, në kullotat alpine në fshatin Pecaj etj.

**VIII.6. – Kanotazhi.** Duke qenë një zonë alpine, ofron kushte shumë të mira si në 2 lumenjtë dhe në përrenjtë për shkak se kanë ujëra të rrëmbyeshme dhe prurje relativisht të shumta.

**VIII.7.- Veprimtaria artistike.** Gjatë pushimeve mund të organizohen shumë veprimtari artistiko-kulturore siç janë: lojëra të ndryshme popullore, festivale me këngë e valle popullore etj.

**VIII.8.- Ekskursionet kulturore.** Në kullat tipike dukagjinase, ku një pjesë janë shpallur monumente kulture, me traditat, gojëdhënat, mitologjitë, kishat e krahinës etj.

## Përfundime

Alpet kanë qenë një faktor përcaktues në zhvillimet historike dhe hapësinore të popullsisë së Dukagjinit dhe njëkohësisht do të jenë faktor dominues edhe në zhvillimin e ardhshëm të kësaj

krahine. Duke parë gjithë këto mundësi që ofrojnë Alpet, mund të themi me plot bindje se mundësia më e mirë për zhvillimin social-ekonomik që ka Dukagjini është zhvillimi i turizmit, i cili sjell zhvillim social-ekonomik dhe ndalon eksodin e popullsisë.

### **Rekomandime**

Situata aktuale është në kushte dëshpëruese dhe popullsia mendon vetëm të largohet. Një largim i detyruar dhe me pikëllim. Gjithnjë me shpresën së një ditë dikush do vërë dorë e do të rikthehen në trojet e tyre. Sot, për të nxjerrë Dukagjinin nga kjo situatë prapambetjeje dhe varfërie dhe për të ndaluar shpopullimin e plotë duhet të bëhen një sërë investimesh në sektorët strategjikë, të tillë si:

**1.- Rrjeti i komunikacionit**, rrugët ekzistuese janë të një kategorie të ulët (kategori e 4-5) bën përjashtim vetëm rruga për Theth e saporestauruar dhe asfaltuar, prandaj duhet të bëhet aksi i shumëpremtuar i Dukagjinit, rruga Prekal–Shosh–Breglumi, si dhe rrugët dytësore të asfaltohen.

**2.- Uji i pijshëm**, furnizimi i vendbanimeve nuk është një problem, pasi zona ka burime të shumta, por duhet ngritur një sistem për rrjetin e ujit nëpër shtëpi 24 orë pa ndërprerje.

**3.- Energjia elektrike**, dy hidrocentralet e zonës arrijnë të përballojnë nevojat e zonës edhe me zhvillimin e turizmit, por këta të dy duhet të lidhen në sistem me njëri-tjetrin dhe të mirëmbahen. Zona ka, gjithashtu, potenciale të shumta hidrike për plotësimin e nevojave të zonës dhe për eksport. Por sot si pasojë e mirëmbajtjes jo të mirë zona furnizohet 24 orë me energji elektrike, por kjo energji elektrike nuk është me tension të plotë dhe vjen me 150-180 volt, gjithashtu duhet bërë investime në rrjetin e amortizuar të shpërndarjes së energjisë.

**4.- Shërbimi telefonik** në zonën e Dukagjinit është i një niveli shumë të ulët, duhet të bëhet lidhja me rrjetin e telefonisë fikse dhe

përforcimi i antenave të telefonisë celulare.

**5.- Superstruktura - struktura akomoduese turistike**, si ish-kampi i pushimit edhe shtëpitë e zonës, të cilat lëshohen me qira duhet të bëjnë rikonstruktim të brendshëm të ndërtesave, të bëjnë pajisjen e tyre sipas standardeve europiane, ku modeli i Thethit shërben si shembull shumë i mirë.

**6.- Ngritja dhe mirëmbajtja e një sistemi kulturor**, duke filluar nga Muzeu Etnografik i Dukagjinit në Theth, kullat monument kulture. Krijimi i ekomuzeve, siç mund të ishte ekomuzeu i staneve.

### Literatura

Baldacci, A., (1901), "Note statistiche sul «Vilayet» di Scutari e la legge della montagna albanese", "Rivista geografica italiana", Firenze, f. 420-421

Dibra, A., (2000). "Zhvillimi i turizmit në rajonin e Shkodrës", Shkodër

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, (2003) "Trashëgimia Kulturore", Tiranë.

Gaspari, P. S., (1930), "Relazione della diocesi di Pullati" Nji dorshkrim i vjetër 1671 mbi Shqyperi, Hylli i Dritës, Shkodër, f. 492– 498

Ghiglione, P., (1941), "Montagne d'Albania" Tiranë, f. 38-54

Grup autorësh, (1998), "Panoramë sociale e prefekturës së Shkodrës", Shkodër.

Instat, Popullsia e Shqipërisë", Tiranë, 2001, 2011

Ippen, Th., (2002), "Shqipëria e vjetër", Tiranë, f. 35-47

Komiteti Ekzekutiv, (1984), "Vjetari statistikor i vitit 1983, rrethi Shkodër", Shkodër, f. 41-51

Ministria e Turizmit, (2004), "Strategjia kombëtare e zhvillimit të turizmit", Tiranë.

Pulaha, P., (1975) "Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485", Tiranë, f. 145-152

Rrethi i Shkodrës, (2000), "Vjetari statistikor i vitit 1999, rrethi Shkodër", Shkodër.

Seiner, F., (1922), "Ergebnisse der Volkszählung in Albanien 1916-1918", Eien, f. 25-26.

Selenica, T., (1928). "Shqipëria me 1927", Tiranë, f. 367 – 410; 489 - 558

Shoqata e mësuesve të rrethit Shkodër, (1968), "Dukagjini", Shkodër.

Tirta, M., (1999), " Migrimet e shqiptarëve", Etnografia Shqiptare nr. 18, Tiranë

**Dr. Fatlinda Shkurti<sup>1</sup>**

**Prof. asoc. dr. Albina Sinani<sup>2</sup>**

## **QENDRAT URBANE TË QARKUT TË VLORËS - PRIRJET E SOTME TË ZHVILLIMIT**

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është historia e krijimit, shtrirja gjeografike dhe karakteristikat e sotme të zhvillimit të qendrave urbane në qarkun e Vlorës, trajtimi dhe analiza e origjinës dhe e krijimit si qendra urbane, ecuria e tyre në kohë dhe hapësirë e përcaktuar nga faktorët fiziko-gjeografikë, historiko-tradicionalë, social-ekonomikë dhe politikë shtetërore lidhur me zhvillimin dhe funksionimin e qendrave urbane. Pas vitit 1945, qendrat urbane në qarkun e Vlorës kanë pësuar ndryshime në aspektin territorial, funksional, tipologjik etj. Në politikën ekonomike të ndjekur në vend, industrializimi u cilësua si hallka kryesore e zhvillimit. Rivlerësimi i pasurive të mjedisit, në interes të zhvillimit u shoqërua me ngritjen e katër qendrave të reja urbane, përkatësisht: Selenicë, Orikum, Himarë, Konispol, si qendra të industrisë nxjerrëse, të industrisë së lehtë dhe ushqimore. Pas vitit 1990 një nga momentet më të rëndësishme është: Reforma administrative – territoriale e vitit 1992. Nga reforma, vendbanimi i Delvinës merr statusin e rrethit dhe qarku i Vlorës nga dy bëhet me tri rrethe (Vlorë, Sarandë, Delvinë). Ndryshimet që kanë ndodhur në fushën sociale, ekonomike në dy dekadat e fundit kërkonin një përmirësim të funksionimit të qeverisjes vendore dhe një konfigurim të ri të ndarjes administrativo-territoriale. Qeveria e Republikës së Shqipërisë në vitin 2014 ndërmori reformën e organizimit të ri administrativ të vendit. Nga ndarja e re administrativo-territoriale qarku i Vlorës ka në përbërje bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol. Prirje ka qenë shtimi i shpejtë i popullsisë banuese në qytete nëpërmjet ardhjes së popullsisë kryesisht nga zonat fshatare apo lëvizjes së popullsisë drejt qendrave të mëdha qytetare. Zgjerimi i qyteteve dhe rritja e numrit të banorëve nxjerr në pah fenomene mjaft të mprehta sociale dhe mjedisore. Transformimet

---

<sup>1</sup> Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Edukimit. E-mail: fshkurti@yahoo.com,

<sup>2</sup> Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti Histori-Gjeografi. E-mail: sinanialbina@yahoo.com

social-ekonomike, lëvizjet demografike dhe organizimi administrativo - territorial kërkojnë vizion afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrave urbane.

*Fjalë çelës: qendra urbane, reformë administrative-territoriale, bashki, lëvizje demografike, zhvillim i qëndrueshëm*

### **Abstract**

The purpose of this study is to present the history of creation, geographical distribution and recent characteristics of the development of urban centres in Vlore district. It will also offer a description and analysis of their origin and creation as urban centres, the progress in time and area determined from physical-geographical, historical-traditional, social-economic factors and also state politics related to the development and function of these urban centres. After 1945, the urbane centres in the district of Vlore changed according to their territorial, functional and typological aspect. In the economic politics of the country, industrialization was qualified as the main link of development. The revaluation of the environment assets in the interest of development was accompanied with the development of four new urban centres respectively those of Selenice, Orikum, Himare and Konispol, as centres of extraction industry, light and food industry. After 1990's one of the most important moments is the administrative - territorial reform of 1992. According to this industry the town of Delvine becomes a city and the district of Vlore includes three cities instead of two (Vlore, Sarande, Delvine). The social and economic changes that have happened during the last two decades required an improvement of local government function and a new configuration of the administrative -territorial division. The government of the Republic of Albania in 2014 undertook an organization administrative reform of the country. The new administrative-territorial division the district of Vlore includes the municipalities of Vlore, Selenice, Himare, Delvine, Sarande, Finiq and Konispol. The actual trend is the fast increase of residing population through the migration of people from the villages toward the big urbane centres. The expansion of the cities and the increase of residents highlights important social and environmental phenomena. The social and economic transformation, demographic migration and administrative-territorial organization require a long-term vision for the sustainable development of urbane centres.

*Keywords: urbane centres, administrative-territorial reform, municipality, demographic migration, sustainable development*

## **I. Hyrje**

Qarku i Vlorës, si një nga 12 njësitë administrative rajonale me shtrirje jugore dhe dalje të gjerë në bregdetin, kryesisht, jonian, me potenciale të mëdha natyrore e humane, ka pasur zhvillime gjeohistorike dinamike me ndikim kombëtar e më gjerë. Sot në këtë hapësirë gjeografike ka shtatë qendra urbane (Vlora, Saranda,



Delvina, Selenica, Orikumi, Himara dhe Konispoli). Pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik, tiparet e relievit, të klimës, pasuritë hidrike me vlera të mëdha ekonomike, bota bimore dhe shtazore e pasur kanë përcaktuar përshtatshmërinë e këtij mjedisi për jetesë dhe zhvillim, dhe si i tillë popullohet që në kohët prehistorike. Qendrat urbane të kësaj gjeohapësire kanë ndryshuar në numër, shtrirje, popullim, funksione, arkitekturë dhe infrastrukturë. Duhet theksuar që krahas zhvillimit të potencialeve humane dhe shfrytëzimit të pasurive natyrore, hasen dhe shumë problematika të organizimit territorial, probleme sociale dhe mjedisore.

## **II. Metoda e studimit**

Për realizimin e këtij punimi dhe rezultatet e studimit jemi mbështetur në një literaturë të pasur nga fusha e gjeografisë, historisë, arkeologjisë, statistikës përshkruese, por jo vetëm, në studimet dhe artikujt shkencorë të botuar, guidat turistike për qendrat urbane, ekspeditat në terren, takimet dhe workshopet për strategjinë e zhvillimit të tyre. Materiali i grumbulluar nga burime të shumta është përpunuar, analizuar dhe sintetizuar në funksion të arritjes së objektivave të punimit. Ky punim për tematikën e gjerë të tij nuk mund të trajtohej pa një sërë metodash kërkimore: metoda e konsultimit të dokumentacionit dhe studimeve ekzistuese, e vëzhgimit dhe ekspeditave në terren, e anketimit, historiko-krahasuese, duke mundësuar një analizë të hollësishme në funksion të objektit të studimit.

## **III. Gjetje dhe diskutime**

### **1. Vështrim historik i qendrave urbane në gjeohapësirën e qarkut të Vlorës**

Qendrat urbane në hapësirën gjeografike të qarkut të Vlorës kanë ndryshuar gjatë historisë (shekujve dhe mijëvjeçarëve).

Ndikuar nga faktorë natyrorë, historikë, socialë-ekonomikë, faktorë të brendshëm e të jashtëm, duke pasur ulje-ngritjet e tyre në rrugën e ekzistencës dhe zhvillimit të mëtejshëm.



Figura 1. Harta administrative territoriale e bashkive të Shqipërisë



Figura 2. Harta administrative territoriale e Qarkut Vlorë.

*Burimi:* Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.137, Datë.11/09/2014; Ligj Nr.115/2014 “Përndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

### 1.1. Popullimi i hershëm

Historia e trevës së Vlorës është e lashtë dhe e pasur. Ajo daton që me mijëvjeçarin e tretë p.l.k. përgjatë periudhës së hershme të epokës së bronzit (*Ceka, Korkuti, 1998*), shfaqet me vendbanimin e Vajzës. Në parahistori (epokat neolit-enolit) në territorin në studim, ndeshen fillesat e qytetërimit (*Korkuti et al., 1996*). Treguesi më i qartë është kalimi nga jeta nomade në atë sedentare (vendbanimet e qëndrueshme). Materiali i pasur arkeologjik si vegla pune, gjetja e farërave të karbonizuara të grurit dhe rrushit të butë në shpellën e Konispolit, tregojnë se banorët prehistorikë aplikonin bujqësinë që në neolitin e hershëm dhe vreshtarinë gjatë epokës së bronzit. Gjetja e fosileve të të imtave dhen e dhi, tregojnë

për fillimet e blegtorisë në këtë zonë nga fundi i epokës së paleolitit e fillimi i neolitit (*Korkuti et al., 1996*). Gjetjet më të hershme i takonin neolitit të mesëm, mandej vijnë me radhë neoliti i vonë, eneoliti, shtresa e bronzit, e hekurit, e periudhës qytetare dhe të mesjetës (*Ceka, 1982*). Këto vendbanime ngrihen në pika strategjike, majë kodrave, pranë rrugëve natyrore dhe fortifikohen me mure të cilat ndjekin formën e terrenit. Përgjatë bregdetit të Jonit janë zbuluar tetë vendbanime prehistorike të fortifikuara me mure (Vendbanimi i Gjipesë, i Gjyvlashit, i Pirgut, i Karosit, i Sopotit (Borshit), i Badhrës, i Gjashnjarit dhe i Kalivosë në skajin jugor), (*ASHRSH, 2004*). Në shekujt V-I pr.K. në këtë territor (si në gjithë Ilirinë) ishte karakteristikë instalimi me intensitet i procesit të urbanizimit. Shekulli V p.K. i marrë si kufiri i fundit për fazën paraurbane, ka vlerë, kryesisht, për Kaoninë dhe pellgun e Vjosës (*Trushaj, 2007*). Qyteti i Vlorës në lashtësi quhej Aulon (*ASHSH, 1965*). Fitoi rëndësi nga rrugët detare që e përshkonin, sidomos pas dekadencës së qyteteve antike: Apolonisë dhe Orikos. Aulona ka qenë vendbanim me rëndësi. Këtë e mbështet edhe zbulimi i viteve të fundit, i traktatit të murit rrethues mbrojtës, fortifikues në qendër të qytetit të sotëm të Vlorës (pranë monumentit të Pavarësisë) si dhe zbulimi i disa dëshmimeve të reja për ekzistencën e molit të vjetër, në afërsi të stacionit të trenit (*Krutaj et al., 2001*). Pseudo-Skylaksi, një gjeograf grek që transmeton të dhënat e kësaj periudhe, krahas ngulimeve helene të Dyrrahut, të Apolonisë dhe të Orikut përmend vetëm një qytet ilir, Amantien, duke e cilësuar atë me termin grek polis-qytet (*Ceka, Korkuti, 1998*). Qyteti më i vjetër i ngritur në territorin kaon, është Butrinti, qendër e fisit kaon të prasaibëve, që zë skajin juglindor të gadishullit të Ksamilit (*Karaiskaj, 1984*). Një tjetër qytet që del në burimet e shkruara, është edhe Onhezmi. I pari që i vizitoi rrënojat e tij ishte Martin Lik, ai e identifikoi atë me Sarandën (*Trushaj, 2007*).

## 1.2. Urbanizmi antik dhe mesjetar

Vendbanimet qytetare antike, kryesisht, në pjesët dominuese dhe në shpatet e kodrave rrethoheshin me mure të fortifikuara. Kjo vendosje paraqiste vështirësi për sheshe ndërtimesh shoqërore. Vendbanimet e fortifikuara me mure guri kanë filluar të ngrihen në vendin tonë që në periudhën e vonë të bronzit. Tipik për këtë periudhë është ai i Badhrës në rrethin e Sarandës. Por ato u bënë karakteristike dhe u përhapën gjerësisht gjatë shek. XI–V p.e.s (*Ceka, Korkuti, 1998*). Prania e shumë qendrave urbane, rrjeti i pasur rrugor, zhvillimi intensiv i këmbimeve, janë faktorë që tregojnë se territori në studim ka qenë dendësisht i populluar që në antikitet. Depërtimi dhe instalimi i ushtrive të huaja (romake, maqedonase etj.), dhe luftërat e gjata të zhvilluara u shoqëruan me shkatërrimin apo braktisjen e mjaft qendrave qytetare. Si rrjedhojë, u përjetua një periudhë kohore, që u karakterizua nga ruralizimi i jetës (*Ceka, Korkuti, 1998*).

Në shek. V-VI, krahas rindërtimit të fortifikimeve të vjetra flitet edhe për ndërtimin e kështjellave të reja. Me këtë periudhë ndërtimesh lidhet edhe ndërtimi i kalasë së Sarandës dhe një fortifikim të ri ndeshim në Foinike, ku fortifikohet vetëm akropoli i qytetit antik (*Ceka, Korkuti, 1998*). Gërmimet e fundit në Kaninë dhe Himarë kanë dhënë dëshmitë e tjera për kulturën ilire të antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme, për autoktoninë dhe vazhdimësinë iliro-arbërore dhe mesjetare shqiptare (*Krutaj et al., 2001*). Duke ndjekur të dhënat për këtë periudhë (shek. IV-VI e. sonë) mund të vihet re mjaft qartë se nuk ka dëshmi të ndërprerjes së jetës, por ka një vazhdimësi kulturore. Disa nga provat që e mbështesin këtë vazhdimësi janë vetë qytetet, qytezat e kështjellat ilire, që vazhduan të ekzistonin e të banoheshin pa ndërprerje (Kanina, Onhezmi, Buthroti), (*Korkuti, 2003*). Gjatë mesjetës u zhvilluan një sërë procesesh dhe fenomenesh, të cilat ndikuan në tkurrjen e qendrave urbane. Midis faktorëve kryesorë ndikues

duhen veçuar: zhvillimi i luftërave të shpeshta, kënetëzimi dhe moçalizimi i zonave të ulëta fushore përgjatë lumenjve, dalja e blegtorisë si dega bazë e ekonomisë etj., (Korkuti, 2003). Në shekullin VII-XI sundoi ekonomia e mbyllur natyrore (Shkurti, 2019). Si një qendër e zhvilluar dhe e kulturuar shfaqet edhe në Mbretërinë e Arbërisë më 1272, ku kronikat e kohës shënojnë lulëzimin e zejtarisë, tregtisë, blegtorisë dhe pemëtarisë, të përfshirë si despotat më vete. Vlora u pushtua nga osmanët në vitin 1417, së bashku me Kaninën dhe Beratit (Krutaj et al., 2001). Periudha letargjike e ekonomisë së mbyllur u pasua me rilindjen e qyteteve dhe lulëzimin e qytetërimit feudal shqiptar, në shekujt XII-XVIII. Në mesjetën e vonë e gjithë Labëria e Poshtme deri në Tepelenë, e përtej Vjosës bashkë me Bregdetin, përfshihen në njësinë administrative të Himarës, rreth 50 fshatra. Në skelën e Vlorës ishin ndërtuar depo të mëdha për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të fshatarësisë, ku përfshiheshin zonat e Beratit, Gjirokastrës dhe Myzeqesë (Krutaj et al., 2001). Ali Pashai e mbajti Vlorën deri në vdekje të tij në vitin 1822, pas së cilës qyteti iu kthye sërish kontrollit qendror osman dhe ra ekonomikisht (Pettifer, Pettifer, 2007). Hapësira që sot përfshihet në qarkun e Vlorës, në shek. XVIII dhe deri në shpalljen e Pavarësisë ka qenë pjesë administrative e vilajetit të Janinës. Kazaja e Vlorës, pjesë e sanxhakut të Beratit, kazaja e Himarës dhe Delvinës në sanxhakun e Gjirokastrës. Qendra më e madhe dhe më e zhvilluar ka qenë Vlora dhe Delvina (ASHSH, 2002).

### 1.3. Tregues të popullsisë para vitit 1945

Burimet materiale arkivore, arkeologjike dhe historike flasin qartë për popullim të hershëm dhe vazhdueshmërinë e procesit të popullimit në hapësirën e qarkut të Vlorës. Statistikat për numrin e popullsisë dhe disa tregues të tjerë të saj deri në mesjetën e hershme janë të pjesshme, fragmentare e jo shumë të sakta. Të

ndërtosh një tablo të plotë mbi ecurinë e numrit të popullsisë që nga lashtësia, është e vështirë për mungesë të dhënash. Por, kur ka të tilla, ato janë tepër të thjeshta, spontane dhe sporadike, që e bën të vështirë besueshmërinë e tyre (*Shkurti, 2019*). Për periudhën para pushtimit osman, të dhëna të vlefshme dhe mjaft të pasura sjellin defterët e regjistrimeve të hollësishme kadastrale, të kryera nga sunduesit turq para pushtimit të vendit e vendosjes së regjimit të tyre feudalo-ushtarak. Të dhënat e para të mirëfillta statistikore, që dëshmojnë mbi ecurinë e numrit të popullsisë në trevat shqiptare, i përkasin periudhës së pushtimit osman në “Regjistrimi i tokave të Sanxhakut të Shqipërisë – 1431-1432” (*Kaso et al., 2006*). Brenda kufijve të sanxhakut të Shqipërisë, nga pikëpamja territoriale përfshihet edhe rrethi i Vlorës, Sarandës dhe Delvinës (hapësira gjeografike e sotme e qarkut të Vlorës). Fillimi i shek. XVI e rendit qytetin e Vlorës me një zhvillim të shpejtë ekonomik shoqëror, një rritje të dukshme demografike. Kështu në regjistrin e vitit 1520 numëroheshin 1367 shtëpi, rreth 605 më shumë se në vitin 1506, ku numëroheshin 762 shtëpi (*Duka, 2009*). Megjithëse kriteret e ndarjes administrative u ndryshuan, shohim se gjatë një periudhe 150-vjeçare, që nga regjistrimi i parë osman, pati një shtim të ndjeshëm të vendbanimeve dhe të shtëpive, rrjedhimisht dhe të popullsisë. Për sanxhakun e Vlorës gjendja paraqitej e tillë: numri i vendbanimeve 711, numri i shtëpive 38838, ndërsa numri mesatar i shtëpive për një vendbanim ishte 54,6 shtëpi. Për sanxhakun e Delvinës: numri i vendbanimeve 89, numri i shtëpive 6710 dhe numri mesatar i shtëpive për një vendbanim 75,4 shtëpi (*Misja et al., 1987*). Shpallja e Pavarësisë e gjeti Shqipërinë me një popullsi të vogël, që është shtuar me ritëm të ngadalshëm, e vendosur në pjesën dërrmuese në fshat (*Mitro, 2006*). Pas shpalljes së Pavarësisë, regjistrimi i parë i përgjithshëm i popullsisë është realizuar në shtator të vitit 1923. Po t’u besojmë këtyre të dhënave, prefektura e Vlorës, me sipërfaqe 1360.2 km<sup>2</sup>, e cila përshinte

nënprefekurën e Himarës dhe krahinën e Mesaplikut, në regjistrimin e vitit 1923 kishte 45429 banorë. Gjatë periudhës 1923 – 1945, vëmë re dy prirje: rritje e shpejtë e qyteteve, si dhe lëvizje e pakontrolluar e popullsisë, një zhvendosje e fuqishme drejt qyteteve (Mitro, 2006).

Tabela 1. Popullsia e përgjithshme, në vitin 1938 (përpunuar nga autorët).

Nr.	Rrethet	Popullsi Gjithsej	Nga kjo		Përqindja e pop.qytetare	Dendësia për 1 km <sup>2</sup>
			Q	F		
1	Vlora	56700	9900	46800	17.5 %	35.2
2	Saranda	44600	5300	39300	11.9 %	40.6
3	Qarku	101300	15200	86100	14.7 %	38.9

Burimi: (Vjetari Statistikor, Vlorë, 1972, f. 45., Sarandë, 1972, f. 40)


Në vitin 1923, në qytete banonte një numër më i paktë i popullsisë së përgjithshme në krahasim me vitin 1938. Peshën më të madhe kjo popullsi e kishte në rrethin e Vlorës (17.5%) dhe më të ulët në rrethin e Sarandës (11.9%). Për rrethin e Vlorës treguesi i numrit të popullsisë qytetare për vitin 1923 është 5942 banorë. Pjesa më e madhe e kësaj popullsie ishte e zënë me punë në bujqësi dhe shumë pak në industri (Vjetari Statistikor, Vlorë, 1972). Të punësuarit në këtë sektor i përkisnin industrisë së lehtë e përfaqësuar nga ajo ushqimore si dhe e regjjes së lëkurëve. Ky sektor dallohej për karakterin e theksuar artizanal. Duke marrë për bazë sipërfaqen e rretheve Vlorë, Sarandë e Delvinë prej 2706 km<sup>2</sup> (sipas ndarjes administrative të vitit 1972), dendësia mesatare e popullimit në të gjithë territorin për vitin 1923 ka qenë rreth 30.9 b/km<sup>2</sup> dhe rreth 38.9 b/km<sup>2</sup> në vitin 1938. Në vitin 1945, dendësia mesatare e popullsisë për rrethin e Vlorës është 37.9 b/km<sup>2</sup> (Vjetar Statistikor i Vlorës, 1972) dhe për rrethin e Sarandës në vitin 1950 është 34.1 b/km<sup>2</sup> (Vjetar Statistikor i Sarandës, 1972), kur mesatarja për gjithë vendin në vitin 1945 ka qenë rreth 39 b/km<sup>2</sup>.



## 2. Qendrat urbane prej vitit 1946 – 1990, karakteristikat e zhvillimit

Kjo periudhë ka qenë një nga etapat më të rëndësishme në zhvillimin demografik të vendit dhe shënoi një kthesë që la gjurmë në lëvizjen e mëvonshme të popullsisë (Kaso et al., 2006). Tipari kryesor që konkretizon tablonë e zhvillimit demografik gjatë kësaj periudhe për qarkun e Vlorës është shtimi i popullsisë me ritme të shpejta, që është rezultat i ruajtjes së niveleve të larta të lindshmërisë dhe rënies sistematike të vdekshmërisë (Mitro, 2006). Si bazë referimi shërbejnë të dhënat statistikore të tërhequra prej regjistrimeve të popullsisë, deri në regjistrimin e vitit 1989, sipas të cilit në hapësirën e qarkut të Vlorës jetonte një popullsi prej 264.448 banorësh nga 98.400 banorë në vitin 1945. Siç vihet re, popullsia ka ardhur në rritje si në rrethin e Vlorës, ashtu edhe për rrethin e Sarandës, por rritja më e madhe i takon rrethit të Vlorës (Fig. 3.)

Figura 3. Popullsia urbane/rurale në vite (autorët)



Shënim: a) Në vend të vitit 1945, rrethi i Sarandës ka vitin 1950.

b) Nga viti 1970 Konispoli përfshihet në popullsinë qytetare.

Treguesi për rrethin e Vlorës për vitin 1989 (Mitro, 2006) dhe treguesi për rrethin e Vlorës dhe Sarandës për vitin 1985, është e dhënë e popullsisë mesatare vjetore (Misja et al., 1987). Popullsia e rrethit të Vlorës është rritur me ritëm mesatar vjetor prej 4.31% (1945-1989), kurse popullsia e Sarandës me ritëm mesatar vjetor prej 3.055% (1945-1989). Numri i përgjithshëm i qyteteve në

hapësirën në studim ka ardhur duke u rritur. Nga tri qytete në vitin 1945 (Vlora, Saranda, Delvina) në shtatë qytete në vitin 1970 e në vazhdim (Vlora, Saranda, Delvina, Selenica, Orikumi, Konispoli, Himara). Përgjithësisht, qytetet janë qytete të vogla me përjashtim të Vlorës që përfshihet në qytetet e mëdha dhe Sarandës që përfshihet në grupin e qyteteve mesatare. Gjatë viteve 1970 kemi ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të shumë objekteve të industrisë ushqimore (ndërmarrjet ushqimore në Vlorë, Sarandë, Delvinë), industrisë së lehtë, të industrisë energjetike (hidrocentrali mbi lumin Bistrica), të industrisë minerale (miniera e kripës në Dhrovjan të Sarandës) etj., të cilat ndryshuan strukturën dhe shtrirjen hapësinore të prodhimit industrial (*Bërzholi, 1987*). Vlora është qytet antik dhe një nga portet kryesore të Shqipërisë, qendër e qarkut me të njëjtin emër. Vlora shtrihet në jugperëndim të vendit, buzë Adriatikut, në gjirin e Vlorës (*Profili i Qarkut Vlorë, 2003*). Në vitet 1945-1990, nën frymën e kolektivizimit u zhvillua bujqësia, industria dhe blegtoaria, një rrjet i gjerë shkollash dhe qendrash shëndetësore, lëvizje teatrore, sportive dhe kulturore (*Guida e Vlorës, 2010*). Saranda përmendet për herë të parë si port me emrin antik Onhezmi në shek. I p.e.r., shërbente si liman për kalimin nga Epiri në Gadishullin Italik dhe si skelë e Foinikës (Finiqit). Gjatë mesjetës nuk përmendet më në burimet e shkruara. (*Profili i Qarkut Vlorë, 2003*). Emri “Sarandë” hyri në përdorim të gjerë në fillim të shekullit tonë. Deri në fund të vitit 1920 Saranda ishte ende një skelë e vogël me shumë pak ndërtesa, kryesisht baraka (*Profili i Qarkut Vlorë, 2003*). Delvina përmendet si qendër e banuar në shek. XI-XII, kur në kodrën e Xhermëhallës (JP) ndërtohej një kala, rreth së cilës u ngrit qyteti i ardhshëm, i cili i kapërceu muret e kështjellës dhe u shtri atje ku është sot (*Profili i Qarkut Vlorë, 2003*). Vendbanimi i Delvinës merr statusin e rrethit nga ndarja administrative e vitit 1992, më parë ishte vendbanim në rrethin e Sarandës. Numrit të përgjithshëm të qyteteve në qark, në

vitin 1955 i shtohet edhe qyteti i Selenicës. Dëshmohej si vendbanim i lashtë me emrin Nymfeum, i përmendur për zjarret e përhershme. Miniera e bitumit është shfrytëzuar që në antikitet. Me emrin e sotëm dëshmohej në vitin 1870 (Mitro, 2006). Rivlerësimi i pasurive të mjedisit u shoqërua me futjen e shumë burimeve natyrore në qarkullimin ekonomik e së bashku me to u ngritën edhe disa qendra të reja banimi qytetare (ndërmjet tyre Selenica), si qendra të mirëfillta industriale, të industrisë nxjerrëse, përpunuese e të industrisë së lehtë (Misja et al., 1987). Vendbanimi i Orikumit u krijua në afërsi të qytetit të lashtë. Filloi të popullohej qysh në vitin 1949. Në vitin 1961 u shpall qytet dhe u zgjerua më pas, sidomos me hapjen e brezareve të Jonufrës. Si njësi administrative ka në përbërjen e saj katër fshatra: Radhimë, Tragjas, Dukat i Ri dhe Dukat i Vjetër (FSHZH, 2009). Qyteti kishte një popullsi prej 2832 banorësh në vitin 1989 (Mitro, 2006). Himara ka lindur si një vendbanim i madh fshatar dhe u shpall qytet në vitin 1965. Qyteti numëronte një popullsi prej 4601 banorësh në vitin 1989. Popullsia merrej kryesisht me bujqësi, por në të njëjtën kohë edhe me aktivitet industrial, në drejtim të përpunimit të prodhimeve bujqësore, (Mitro, 2006) si dhe veprimtari të shërbimeve artizanale (punimi artizanal i qilimave, sixhadeve, punime qëndistarie, punimet e baltës dhe avlëmendit, vazhdojnë të kënaqin dhe mahnitin turistët me bukuritë e tyre (Vlora Guidë, 2008-2009). Konispoli shtrihet në skajin më jugor të Republikës së Shqipërisë, i vendosur në një “ballkon natyror” në shpatin jugperëndimor të malit të Saraqinit, nga ku dominon një hapësirë të gjerë të detit Jon, kodrat e Stillosit, Çukën e Ajojt, Vrinën e Butrintin (Sheme, 2008). Lindi si qendër qytetare pas vitit 1960, nga një vendbanim fshatar i cili erdhi duke u zgjeruar në shtrirje.

Tabela 2. Numri i qyteteve dhe popullsisë qytetare në vite (përpunuar nga autorët)

Njësitë	Vitet							
	1950		1960		1970		1990	
	Nr. 1	Pop.	Nr. 2	Pop.	Nr.3	Pop.	Nr. 4	Pop.
Qarku	3	24851	4	61166	7	77190	7	148586
Vlorë	1	18200	1	41400	1	50200	1	82000
Himarë	-	-	-	3070	1	3200	1	4601 (1989)
Selenicë	-	-	1	4100	1	5400	1	7430
Orikum	-	-	-	1100	1	1600	1	2832 (1989)
Sarandë	1	3444	1	6043	1	8710	1	29768
Konispol	-	-	-	-	1	2123	1	2685
Delvinë	1	3207	1	5453	1	5957	1	11122

*Shënim: Treguesi i popullsisë për qytetet Sarandë e Delvinë në vitin 1950, i takojnë vitit 1955 Të dhënat për qytetin e Sarandës, Vjetari Statistikor i Vitit 1974, f. 49*

*Të dhënat për Vlorën dhe qytetet e saj (vitet 1960 & 1970), (Krutaj et al., 2001)*

*Të dhënat e vitit 1990 të pasqyruara në tabelë janë marrë nga Zyrat e Gjendjes Civile, grumbulluar në vitin 2010.*

Në këtë periudhë është vërejtur një përqendrim më i madh i popullsisë në zonat dhe qendrat ku u ndërtuan objektet e shumta industriale, apo ku u përfituan toka të reja bujqësore (Doka, 2015). Përgjithësisht, prirja që vihet re është rritja e shpejtë e popullsisë në qendrat e mëdha urbane krahasimisht me ato të vogla urbane, të cilat para viteve 1990 (si qendra të reja industriale prodhimi) njohën rritje të shpejtë demografike. Në këtë situatë kanë ndikuar faktorët ekonomikë, zhvillimi i degëve të ndryshme të industrisë të cilat kërkonin krahë pune. Faktorët ekonomikë dhe ata demografikë, sidomos lëvizjet mekanike (ardhjet nga fshati për të plotësuar nevojat e industrisë me fuqi punëtore), në minierën e Selenicës, në nxjerrjen e naftës, uzinën e Sodë - PVC, uzinën mekanike, fabrikën e miellit, e llambave elektrike, portin e Vlorës dhe Sarandës etj., si dhe rritja e lartë natyrore (origjina rurale e saj), shpjegojnë rritjen e shpejtë të popullsisë qytetare. Qyteti i Vlorës ka treguesit më të lartë të numrit të popullsisë në vite. Nga tabela më

sipër vihet re që qyteti i Vlorës nga viti 1950-1970 ka rritje të popullsisë 2.7 herë, qyteti i Sarandës me rritje 2.5 herë. Krahasuar viti 1950 me vitin 1990 treguesi për qytetin e Sarandës është 8.6 herë, për qytetin e Vlorës rritja është 4.5 herë, për qytetin e Delvinës 3.4 herë. Deri në 1990, rritja e popullsisë ka qenë rezultat vetëm i shtimit natyror.

### 3. Qendrat urbane pas vitit 1990, karakteristikat e tyre të zhvillimit

Kthesa e rëndësishme në jetën politike, ekonomike e sociale pas vitit 1990, shënon fillimin e një epoke të re në ecurinë e proceseve demografike, e cila mund të konsiderohet si fillimi i fazës së tretë dhe të fundit të procesit të tranzicionit demografik në Shqipëri. Fillimet e kësaj periudhe të veçantë të tranzicionit demografik, njëkohësisht përkon me zgjatjen e pasojave të tranzicionit social-ekonomik, duke nisur me valën masive dhe të egër të emigracionit si dhe të lëvizjeve të brendshme të urbanizimit kaotik fshat-qytet (Sheri, 2001). Në ndryshim nga politika demografike deri në vitin 1990, pas vitit 1990 u lejua edhe në Shqipëri lëvizja e lirë e njerëzve. Prirja e përgjithshme ka qenë largimi i popullsisë nga rajonet malore të vendit dhe vendosja në zonat fushore e në qytetet kryesore (Doka, 2015).

Tabela 3. Popullsia e qyteteve pas vitit 1990 ( përpunuar nga autorët)

Njësitë	Vitet							
	1990		2010		2011 (Instat)		2021	
	Nr. 1	Pop.	Nr. 2	Pop.	Nr. 3	Pop.	Nr. 4	Pop
Qarku	7	148586	7	224827	7	115183	7	264860
Vlorë	1	82000	1	135291	1	79513	1	164398
Himarë	1	9605	1	13381	1	2822	1	13677
Selenicë	1	7430	1	7004	1	2235	1	6640
Orikum	1	8661	1	11373	1	5503	1	11976

Sarandë	1	27083	1	40405	1	17233	1	47461
Konispol	1	2685	1	3067	1	2123	1	3073
Delvinë	1	11122	1	14306	1	5754	1	17635

*Burimi: Vitet 1990, 2010, 2021, Zyrat e Gjendjeve Civile të qyteteve përkatëse Viti 2011, Censusi Vlorë 2011, Instat f. 84*

Ky fluks i madh i lëvizjes së njerëzve drejt qyteteve ka bërë që shumica e qyteteve të Shqipërisë të rrisin ndjeshëm popullsinë e tyre këto vitet e fundit (*Doka, 2005*). Duke analizuar të dhënat (Tab. 3.), vihet re ndryshimi i madh i numrit të popullsisë të qendrave urbane të qarkut, viti 1990 me vitin 2011, viti 2011 me vitin 2021. Nëse shohim regjistrimin e popullsisë nga Instat në vitin 2011 në të gjitha qytetet e qarkut ka rënie të numrit të popullsisë. Të dhënat e vitit 2021 me tregues të lartë të popullsisë janë regjistrime të lindurve jashtë vendit dhe nuk pasqyrojnë realisht popullsinë banuese në këto qytete. Ndërrimi i sistemit ekonomik dhe politik i hapi rrugë lëvizjes së lirë. Pas kësaj, emigrimi ka vijuar në mënyrë të vazhdueshme deri në ditët e sotme (*Urban Research Institute, Unicef, 2009*). Në vitin 1992, ndryshimet politike, ekonomike, sociale dhe juridike në Shqipëri shtruan nevojën për një organizim të ri administrativ. Me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 269, datë 25.06.1992, Shqipëria u organizua në 36 rrethe, 313 komuna dhe 44 bashki, por nevoja për reformimin e pushtetit vendor bëri që në shtator të vitit 1992 vendi të organizohej edhe në 12 prefektura (*Laçi, 2015*). Ndryshimet, më së shumti përfshijnë aspektin e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor se atë territorial. Nga kjo reformë qarku i Vlorës përbëhej nga tri rrethe, 19 komuna dhe 7 bashki: Vlorë, Selenicë, Orikum dhe Himarë (në Rrethin e Vlorës), Sarandë dhe Konispol (në Rrethin Sarandë) dhe Delvinë (në Rrethin Delvinë). Prirja që vërehet në shtrirjen apo zgjerimin e hapësirës urbane në qark, paraqet specifika dhe modalitete jo të njëjta në qytetet e qarkut. Zgjerimet më të

dukshme hapësinore vërehen në qendrat e mëdha urbane sidomos në qytetin e Vlorës, Sarandës, Orikumit dhe Himarës, kryesisht, për banesa (rezultat i kërkesave të mëdha për strehim), shërbime, biznese informale me shtrirje gjeografike në të gjithë zonën urbane dhe ndërtime për struktura turistike. Shtimi i madh dhe i shpejtë i popullsisë në qytet nuk u shoqërua njëkohësisht me hapjen e vendeve të reja të punës, veçanërisht me zhvillimin dhe punësimin në sektorin e dytë, në industri. Ndarjet e reja administrative dhe territoriale të vendit pas ndryshimeve politike të vitit 1990 kanë qenë të paqarta dhe shpesh problematike. Rezultat i kësaj është fakti se ato nuk iu përshtatën dot zhvillimeve dhe ndryshimeve të shpejta që ka pësuar vendi (*Doka, 2015*). Duhej një përmirësim i funksionimit të qeverisjes vendore e cila kërkonte edhe një konfigurim të ri të ndarjes administrativo-territoriale. Mbi këtë bazë, në vitin 2014 qeveria e Republikës së Shqipërisë, ndërmoi reformën e organizimit të ri administrativ të vendit. Rezultat i kësaj reforme do të ishte kufizimi i numrit të njësive administrative të nivelit të parë (komuna e bashki), duke eliminuar kështu komunën. Ndërkohë që mbetet qarku si njësi më e madhe e organizimit administrativo-territoriale të vendit (*Doka, 2015*). Arritja e objektivave në drejtim të zhvillimit urban kërkon ndërmarrjen dhe realizimin e një sërë reformash të harmonizuara institucionale dhe ligjore përfshi: forcimin e qeverisjes bashkiake në përputhje me reformën e decentralizimit; forcimin e enteve rregullatore (këshillat e rregullimit të territorit, policia ndërtimore etj.); krijimin e hapësirave të përshtatshme për veprimin komunitar; plotësimin e rregullave mbi të drejtat dhe detyrimet në akses të tilla, si: në infrastrukturë, shërbime publike urbane, në të drejtën për ndërtime; forcimin e kapaciteteve për monitorimin e zhvillimit urban etj. (*UNDP, 2005*).

### 3.1. Struktura funksionale e qendrave urbane

Në qarkun e Vlorës numërohen 7 vendbanime urbane. Nga qytetet që janë cilësuar të tilla, katër kanë qenë vendbanime fshatare dhe si rezultat i zhvillimit kaluan në rang qyteti (Himara, Orikumi, Selenica dhe Konispoli). Në vendin tonë, për të deklaruar qytet një qendër të banuar kanë qenë marrë parasysh disa kritere. Qendra e banuar të ketë mbi 2000 banorë. Dendësia e popullsisë së qendrës së banuar brenda vijës kufitare të jetë mbi 80 banorë për ha. Konsiderohen tradita, fizionomia e ndërtimit, perspektiva e qendrës së banuar, si dhe në raste të veçanta si qytet historik, afër kufirit etj., (*Dumani, Stringa, 1997*). Vihet re fare qartë ndryshueshmëria dhe evolucioni i vendbanimeve nëpërmjet krahasimeve që realizohen ndërmjet pamjeve të vjetra të qyteteve, apo siç quhen në vende të ndryshme të botës, qendra historike, me pamjet e reja të tyre (*Axhemi, 2007*), (Foto 1, 2).




Foto 1. Rruga Muze - Vlorë



Foto 2. Pamje e qytetit të Vlorës (autorët)

Sipas strukturës funksionale kemi qytete me funksione komplekse: administrative, ekonomike, kulturore, arsimore, tregtare etj. Të tilla janë: Vlora, Saranda, Delvina. Në strukturën ekonomike të pas viteve 1990, aktiviteti industrial pësoi dëmtime e shkatërrime të mëdha. Një pjesë e ndërmarrjeve industriale janë në konservim, një pjesë u privatizuan dhe një pjesë tjetër iu përshtat prioriteteve dhe nevojave të ekonomisë së tregut. Në qark



ushtrojnë veprimtarinë e tyre rreth 3000 ndërmarrje (*Qarku i Vlorës, 2011*).



Foto 3. Pamje nga Selenica, viti 2020



Foto 4. Pamje nga Saranda, 2018 (autorët)

Nga të dhënat e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Vlorë, kemi këto shifra të sektorëve në përqindje: ndërtim 16 %, tregti 43 %, prodhim (këtu edhe me mall të porositësit) 19.6%, shërbime (duke përfshirë edhe turizmin dhe transportin) 21.4 % (*Qarku i Vlorës, 2011*). Duke marrë në analizë strukturën e aktivitetit industrial, rezulton se industria e përpunimit të qumështit zë vendin e parë (43 njësi) me burim lëndësh të para lokale dhe të vendit dhe me treg të mallit vendës, dhe vetëm një subjekt për tregun e eksportit. Në vendin e dytë qëndron industria e materialeve të ndërtimit (31 njësi), e cila burim të lëndës së parë përdor më tepër mallin vendës dhe më pak mall importi (3 njësi) (*Qarku i Vlorës, 2002*). Në Vlorë ushtrojnë aktivitetin e tyre një sërë firmash prodhuese e tregtuese, si Fabrika e Bojërave, Fabrika e Vajit, Fabrika e Kolës, Tregtimi i Gazit të Lëngshëm, Magazina e Birrës *Norga*, Magazina e Vezës *Vlora* etj. Dy vepra të rëndësishme janë ndërtuar në Vlorë më 2008-2010: TECI-I me fuqi prodhuese 97 megawat dhe terminali i gazit dhe naftës “Petrolifera Italo-Shqiptare”. Një port i madh kontenerësh në plazhin e Zvërnecit dhe një park energjetik me turbina ere mbi kreshtën e Karaburunit pritet të nisnin nga puna ndërtuese (*Qarku i Vlorës, 2011*). Në vitin

2003 përfundoi ndërtimi i autostradës Vlorë-Fier me gjatësi 35 km, me degëzim në Levan dhe kalim me rrugë të shkurtuar për në Gjirokastrë e më tej në Kakavijë. Porti Detar i Vlorës, rreth 90 km në jug të portit të Durrësit, është i dyti në Shqipëri për nga rëndësia dhe porta e dytë hyrëse në Korridorin VIII. Në këtë port kryhet përpunimi i trageteve të pasagjerëve dhe i anijeve me mallra, duke mbuluar 10% të eksport-importit. Porti është në procesin e zhvillimit të infrastrukturës mbi bazën e Master Planit. Qeveria italiane do të financojë me rreth 15.3 milionë euro (në tri faza) ndërtimin e kalatave për mallrat dhe asaj të trageteve (Laçi, 2015).

Tabela 4. Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe veprimtarisë ekonomike (përpunuar nga autorët)

Veprimtari ekonomike	Ndërmarrje		
	Të vogla	Të mesme	Të mëdha
Industri	77	11	12
Ndërtim	43	34	23
Transport e telekom	98	1	1
Tregti	98	1	1
Shërbime	93	4	3
Gjithsej	409	51	40

Burimi: Qarku i Vlorës, UNOPS, "Masterplan i veprimtarive turistike të Qarkut të Vlorës",  
Fast Edit di Acquaviva Picena, Italy 2002, f. 47

Porti i Sarandës ka kapacitet të vogël (anije deri në 2000 ton), por me karakteristika të shkëlqyera për mjete turistike. Sot ekzistojnë linja të shërbimit të pasagjerëve (tri) dhe shërbime me jahte që arrijnë deri në Himarë (*Profili i Qarkut Vlorë, 2003*), por edhe një linjë e rregullt ditore Sarandë-Korfuz. Edhe pse një port i vogël, përpunohen rreth 63874-tonë mallra/vit, ka katër tragete me flamur shqiptar dhe numri i udhëtarëve që nisen dhe mbërrijnë në vit në këtë port është përkatësisht 39382 dhe 39177, ndërsa numri i mjeteve të nisura dhe të mbërritura është mesatarisht 329 dhe 218 (*Qarku i Vlorës, 2012*). Porti i vogël i Himarës luan një rol të

rëndësishëm për komunitetin e zonës duke komunikuar me fqinjin jugor me linjën Himarë-Igumenicë dhe mund të hyjnë anije deri në 500 t, që në pjesën më të madhe bëjnë transportin e materialeve të ndërtimit në linjën Himarë-Korfuz. Në territorin e bashkisë, midis Himarës qytet dhe Qeparoit ndodhet porti i vogël i Porto Palermos, ndërtuar për qëllime ushtarake dhe që sot shërben për ankorimin e peshkarexhave. Kohët e fundit është parë mundësia e shndërrimit në port turistik (Qarku i Vlorës, 2002). Pas vitit 1990 shumë biznese të vogla u shndërruan në shoqëri tregtare. Bizneset e vogla e të mesme janë një promotor i rëndësishëm zhvillimi. Një numër i konsiderueshëm shoqëri tregtare me qendër në Vlorë dhe Sarandë janë bërë furnizuese të tregut të brendshëm. Vendndodhja e favorshme gjeografike dhe strategjike, në qendër të Europës, si urë lidhëse e Mesdheut Lindor, është një faktor që mund të ndihmojë një zhvillim të shpejtë të turizmit (Profili i Qarkut Vlorë, 2003). Shumë faktorë mund të ndihmojnë në zhvillimin e një sistemi turistik të integruar në zonën e dy deteve: trashëgimia e pasur kulturore, që dallon të dy brigjet dhe funddetet bregdetare, ekosistemi mesdhetar me veçoritë adriatike, popullsitë dhe kulturat popullore, pasuria enogastronomike (Qarku Vlorë, 2004). Për bregdetin e qarkut të Vlorës si pjesë e Mesdheut, por edhe rajone të tjera të tij, ky tip turizmi ka zënë vendin kryesor në zhvillimin turistik (Doka & Draçi, 2002). Bregdetit të kësaj hapësire këtë privilegj ia jep funksioni i rëndësishëm turistik i tyre, i cili ka ardhur në rritje në dy dekadat e fundit. Ky tip turizmi është më masiv, më shpejt i arritshëm dhe me më pak kosto. Karakteristikë tjetër dalluese e turizmit të banjave detare është edhe përqendrimi sezonal i turistëve, kryesisht në stinën e verës. Kohëzgjatja e qëndrimit të turistëve është relativisht e gjatë dhe klientela mjaft heterogjene (Koja & Gorica, 2004). Shfrytëzimi i hapësirës detare të këtij rajoni, dikton dhe prodhimtarinë iktiologjike në lagunën e Nartës, gjirin e Vlorës,

lagunën e Butrintit, kultivarët e peshqve të së cilave i japin shtysë zhvillimit të turizmit gastronomik. Peshku i kënetës (lavraku, koca) ka një cilësi të veçantë organoleptike po të krahasohet me ato të detit (Mitro, 2002). Qyteti i Selenicës është i specializuar në industrinë nxjerrëse dhe eksportuese të bitumit dhe serës, pasi nuk ka kushte për rafinim. Sot është dega kryesore e të ardhurave të ekonomisë dhe operon me anë të dy kompanive kontraktuese, me 307 punonjës. Duhet përmendur edhe përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale (15 baxho, 9 fabrika vaji dhe 2 fabrika mielli) me shpërndarje në Selenicë dhe fshatrat e bashkisë (*Spektori i Statistikës, Bashkia e Selenicës, 2021*). Në qytetin e Orikumit gjenden një llojshmëri subjektsh biznesi, të cilat arrijnë në rreth 280 të tilla, ku 40 prej tyre konsiderohen biznese të mëdha. Shumica janë të përqendruara në Orikum, Dukat e Radhimë. Profili i bizneseve të mëdha janë kompani ndërtimi, hotele dhe bar-restorante. Në Dukat drejtimi kryesor ekonomik është rritja e bagëtive të imta, por edhe vreshtaria (FSHZH, 2009).

## Përfundime

Historia e popullimit në trevën e Vlorës është e lashtë dhe e pasur. Popullimi ka qenë i pandërprerë gjatë historisë, duke bërë të mundur vazhdimësinë iliro-arbërore-shqiptare.

Qytetet në hapësirën e qarkut të Vlorës kanë pasur historinë e tyre të lindjes si qendra qytetare, zhvillimin dhe konsolidimin e tyre. Nga tri qytete në vitin 1945 (Vlora, Saranda, Delvina), në shtatë qytete në vitin 1970 e në vazhdim (Vlora, Saranda, Delvina, Selenica, Orikumi, Konispoli, Himara). Në aspektin hapësinor qyteti dallon për rritjen e potencialit human me 36% (-14% sipas INSTAT) kundrejt vitit '89. Ritmet e rritjes së kësaj popullsie kanë qenë 5 herë më të larta se rritja e popullsisë së përgjithshme. Përqendrimi i popullsisë në llogari të qytetit ka çuar në

ndryshimin e peshës së popullsisë qytetare nga 33.9% në vitin 1989 në 41.3% në 2000, në 55.3% në 2013. Në aspektin ekonomik vendbanimet urbane të qarkut pas vitit 1990 patën mbyllje të aktiviteteve industriale, privatizim të objekteve dhe dhënien prioritet ekonomisë së tregut. Sot degë të tilla si: shërbimet, tregtia, ndërtimtaria, artizanati, turizmi, përpunimi i produkteve bujqësore e industriale kanë rritur prodhimin dhe të ardhurat.

### **Rekomandime**

Qendrat qytetare të qarkut të mirë menazhohen për të ruajtur traditën, historinë pa mohuar edhe elementet e reja të fizionomisë, shtrirjes, infrastrukturës. Të kthehen plotësisht në vlera të shfrytëzimit të potencialeve të tyre natyrore e kulturore. Koordinim i politikave të pushtetit qendror me atë vendor për të zbutur problemet sociale dhe për ruajtjen e hapësirave mjedisore nga ndërtimet dhe ndërhyrjet në infrastrukturë.

### **Literatura**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2002). "Historia e Popullit Shqiptar Vol. II", Toena, f. 42

Akademia e Shkencave të RSH, (1965). "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë", f. 318

Akademia e Shkencave, (2004). "Himara në shekuj", Toena, f. 26

Axhemi, S., (2007) "Gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve", "ALSA" Graphics, f. 205

Bërxfholi, A., (1987). "Ndryshime në Gjeografinë e Popullsisë në zonën Vjosë-Deti Jon", Tiranë, f. 29

Ceka, N., & Korkuti, M., (1998). "Arkeologjia", SHBLU, f. 240, 264, 414, 52, 67

Ceka, N., (1982). "Vendbanimet protourbane në Kaoni", Almanak-Saranda 2, f. 21

Doka, Dh., (2015). "Gjeografia e Shqipërisë"-Popullsia dhe ekonomia, ASD Studio, f. 21, 23, 33, 34

Doka, Dh., (2005). "Zhvillime socio-ekon. dhe rajonale të Shqipërisë pas vitit 1990", Potsdam, f.51

- Doka, Dh., B, Draçi., (2002) “Gjeografia e turizmit”, SHBLU Tiranë, f. 71
- Duka, F., (2009). “Shekujt Osman në Hapësirën Shqiptare”, UET Press, f. 95, 190
- Dumani, B., Stringa, A., (1997). “Elemente të demografisë (Popullsia dhe zhvillimi)”, Tiranë, f. 85
- FSHZH, 2009. “Plani i Zhvillimit Lokal – Bashkia Orikum”, Grant Print, f. 7, 16, 17
- Guida e Vlorës, (2010), “Vlora-qyteti me dy dete” albPaper, f.8
- Karaiskaj, Gj., (1984)., “Butrinti dhe fortifikimet e tij”, Tiranë, f. 20
- Kaso, M., Duri, V., Ruspi, G., Shkurti F., (2006). “Gjeografia”, Shblu, f. 108, 111
- Këshilli i Qarkut të Vlorës, (2003). “Profili i Qarkut Vlorë”, Toena, f. 55, 114, 115
- Koja, V., Gorica, K., (2004). “Bazat e turizmit”, SHBLU, f. 217
- Korkuti, M., (2003). “Parailirët, ilirët, arbërit”, Histori e shkurtër, Toena, f. 57
- Korkuti, M., Petruso, K., Bejk, L., Ellwoo, B., Hansen, J., Harold, F., Rusell, N., Botema, S., (1996) “Shpella e Konispolit, raport paraprak 1992-1994”, Iliria 1996, 1-2, f. 193-194 “Shpella e Konispolit, raport paraprak 1992-1994”, Iliria, 1-2, f. 193-194
- Krutaj, F., Gaçe, B., Abazi, H., (2001). “Vlora porti jugor i Adriatikut”, Toena, f. 8, 9,10,41, 65
- Laçi, S., (2015). “Gjeografia Humane e Shqipërisë”, SHB “Lilo”, f. 96-97, 287
- Misja, V., Vejsiu, Y., Bërxfholi, A., (1987). “Popullsia e Shqipërisë”, Tiranë, f. 151, 163
- Mitro, I., (2006). “Struktura demografike e rrethit të Vlorës”, Europrint f. 17, 18, 25, 43
- Mitro, I., (2002) “Turizmi mesdhetar”, Botimet Toena, f. 37
- Pettifer, J & Pettifer, Xh., (2007). “Butrinti – rrethinat e tij dhe bregdeti jugor i Shqipërisë”, Toena
- Qarku i Vlorës, (2011). “Strategjia dhe plani i veprimit për fëmijët” 2011-2013, Vlorë, f.14, 15
- Qarku i Vlorës, UNOPS, (2002). “Masterplan i veprimtarive turistike të Qarkut të Vlorës”, Fast Edit di Acquaviva Picena, Italy, f. 47, 79
- Qarku i Vlorës, (2012). “Guida e Trashëgimisë Natyrore-Kulturore të Qarkut”, Vlorë, f. 43

Qarku Vlorë, UNOPS-PASARP, Cooperazione Italiana, Unioncamere e Markeve, (2004). "Itenerare, shërbime, plazhe, male, shpella, histori të panjohura, njerëz, receta gatimi", Ancona – Italia, f. 5

Sektori i Statistikës, Bashkia e Selenicës, 2021

Sheme, S., (2008). "Monumentet natyrore dhe kulturore të Çamërisë", Ideart, f. 62

Sheri, F., (2001). "Evolucioni i popullsisë i parë në rrjedhat e tranzicionit të dyfishtë në Shqipëri", Revista Demografia, Viti V, Nr. 1, f. 13

Shkurti, F., (2019). "Evolucioni i proceseve gjeopopullative në Qarkun e Vlorës", Studio Sai, f. 95, 100

Trushaj, A., (2007). "Kaonia dhe kaonët në prehistori dhe antikitet", Europrint, f. 89, 117

Urban Research Institute & UNICEF, (2009). "Migracioni shqiptar pas viteve 1990 dhe ndikimi i tij në jetën ekonomike dhe sociale të fëmijëve të lënë pas", f. 23

UNDP, (2005). "Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë", f. 26

Vjetar Statistikor, Sarandë 1972, f. 40

Vjetar Statistikor, Vlorë 1972, f. 45, 47

Vjetari Statistikor i Vitit 1974, f. 49

Vlora Guidë, 2008-2009, f. 41

**Dr. sc. Sami Behrami<sup>1</sup>**

**Msc. Fadil Bajraktari<sup>2</sup>**

## **SHPËRNDARJA E POPULLSISË DHE VENDBANIMEVE NË REGJIONIN VERIOR TË KOSOVËS - ROLI I RELIEVIT DHE PASURIVE NATYRORE**

### **Abstrakt**

Shpërndarja e pabarabartë hapësinore e popullsisë dhe vendbanimeve në Regjionin Verior të Kosovës është kushtëzuar nga një varg faktorësh natyrorë-geografikë dhe socio-ekonomikë. Ndonëse kushtet natyrore kanë favorizuar një përqendrim më të madh të popullsisë, rrethanat historike- politike kanë qenë mjaft të ndërlikuara dhe jo të përshtatshme për një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX, të cilat janë përcjellë me pasoja të rënda në zhvillimin e popullsisë dhe vendbanimeve, si në gjithë Kosovën, edhe në Regjionin Verior.

Regjioni Verior për nga numri i banorëve është më i vogli; me dendësinë më të ulët; më heterogjen në aspektin etnik dhe në të njëjtën kohë është regjion ku janë evidente shumë ekstreme të treguesve demografikë dhe të zhvillimit të vendbanimeve. Përqindja që zë popullsia e këtij regjioni në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës duke filluar nga viti 1960 është zvogëluar vazhdimisht, si pasojë e uljes së shtimit natyror, emigrimit dhe shkallës së lartë të ndotjes së mjedisit, me pasoja në shëndetin e popullsisë.

---

<sup>1</sup> Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Rr. Luan Haradinaj (ish-Pallati i Mediave) kati 14, 10000 Prishtinë, KOSOVË, samibehrami@gmail.com, fadil.bajraktari@rks-gov.net

<sup>2</sup> Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Rr. Luan Haradinaj (ish- Pallati i Mediave) kati 14, 10000 Prishtinë, KOSOVË, samibehrami@gmail.com, fadil.bajraktari@rks-gov.net



Faktorët natyrorë dhe zhvillimet demografike në shumë pjesë (sidomos zonat kodrinore-malore) do të jenë përcaktues edhe në të ardhmen në procesin e depopullimit, moshimit demografik dhe strukturave të tjera, duke penguar dhe pamundësuar rivitalizimin ekonomik e demografik, duke krijuar hapësira me popullsi të moshuar e cila nuk mund ta ripërtërijë veten e jetën ekonomike dhe duke pamundësuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Minimizimi i pasojave negative që sjellin këto zhvillime arrihet me politika të mirëfillta demografike, me politika zhvillimore, që nënkuptojnë: zhvillim të ekuilibruar socio-ekonomik rajonal dhe shmangieje nga zhvillimi monocentrik drejt atij policentrik të vendbanimeve e sidomos atyre urbane.

Në këtë punim, roli i faktorëve natyrorë në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve në Regjionin Verior të Kosovës trajtohet përmes analizës së ndikimit të relievit (lëvizjeve vertikale të popullsisë) dhe kushteve mjedisore, të cilat në Regjionin Verior kishin dhe kanë ndikim të veçantë.

*Fjalë çelës: relievi, pasurit natyrore, popullsia, vendbanimet, regjioni verior etj.*

### **Abstract**

The unequal spatial distribution of population and settlements in the northern region of Kosovo is conditioned by a number of natural-geographical and socio-economic factors. Although natural conditions have favored a larger concentration of population, historical-political circumstances have been quite complex and unsuitable for a higher degree of economic development, especially in the last decade of the twentieth century which have been accompanied by severe consequences for population development and settlements also in the northern region.

The Northern Region in terms of number of inhabitants, it is the smallest region, with the lowest density, the most ethnically heterogeneous and at the same time it is a region where very extreme demographic indicators and settlement development are evident. Participation within the total population of Kosovo, since '60 has been steadily declining, due to reduced natural increase, emigration and high level of environmental pollution.

Natural factors and demographic developments in many parts (especially in hilly-mountainous areas) will be determinants in the future for the process of depopulation, demographic aging and other structures, preventing and disabling economic and demographic revitalization, creating spaces with older populations which can not renew itself and economic life and disable sustainable development.

Minimization of the negative phenomena brought by these developments is achieved with genuine population policies, development policies that mean: balanced regional socio-economic development and avoidance of monocentric to polycentric development of settlements, especially urban ones.

In this paper the role of natural factors in the distribution of population and settlements in the northern region of Kosovo will be addressed through the impact of relief (vertical movements of population) and environmental conditions which in the northern region had and have a special impact.

*Keywords:* relief, natural resources, population, settlements, northern region, etc.

## I. Hyrje

Regjioni Verior (RV) zë pjesën veriore të Kosovës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2050 km<sup>2</sup>, brenda të cilit përfshihen komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan me 335 vendbanime ku, sipas regjistrimit të vitit 2011, jetonin 233303 banorë, me dendësi banimi 114 b/km<sup>2</sup>. Për nga numri i banorëve është regjioni<sup>1</sup> më i vogël dhe në të njëjtën kohë regjioni me dendësinë më të vogël të banimit në Kosovë. Përqindja që zë popullsia e këtij regjioni në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, duke filluar nga viti 1960 është zvogëluar vazhdimisht, si pasojë e uljes së shtimit natyror, emigrimit dhe shkallës së lartë të ndotjes së mjedisit, me pasoja shëndetësore.

---

<sup>1</sup> Ne bazë të rregullimit territorial të Kosovës me 5 regjione: Verior ose i Mitrovicës, Qëndror ose i Prishtinës, Lindor ose i Gjilanit, Jugor ose i Prizrenit dhe Perëndimor ose i Pejës.



Harta 1. Pozita gjeografike e Regjionit Verior në Kosovë  
(punoi autori i parë i punimit)

RV karakterizohet me specifika të veçanta në të gjitha segmentet e dinamikës së popullsisë, për tipare dalluese të strukturave të popullsisë dhe vendbanimeve, prandaj, si njësi administrative, diferencohet në raport me regjionet e tjera të Kosovës. Objekt i këtij punimi është: analiza e ndikimit të relievit dhe rolit të pasurive natyrore/kushteve mjedisore në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve në Regjionin Verior të Kosovës. Këta faktorë kishin dhe kanë ndikim të veçantë.

## II. Metoda

Meqenëse punimi i takon tipit të kërkimeve fundamentale dhe observues për arritjen e rezultateve në punim janë përdorur metodat: statistikore, krahasuese, analizës, sintezës, hartografike etj. Për analizat e dukurive gjeografike jemi bazuar në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë dhe statistikave të tjera relevante, duke

përfshirë edhe ato në nivel të vendbanimeve dhe komunave, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe institucionet e botime tjera relevante.

### III. Rezultatet dhe diskutimet

#### 1. Relievi dhe roli i tij në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve në RV

Relievi i RV përbëhet nga disa njësi: fushore, kodrinore dhe malore. Relievi kodrinor-malor përbën fizionominë kryesore, me rreth 60% të sipërfaqes së përgjithshme (*Osmani, 2003*). Ky reliev përshkohet nga luginat e lumenjve Ibër, Sitnicë, Lushtë, Klinë dhe të rrjedhave të tjera më të vogla dhe shtrihen në të dyja anët e lumit Ibër.

Relievi i ulët ka shtrirje më të kufizuar përgjatë luginave të lumenjve. Shtrirjen më të madhe e ka në luginat e lumit Sitnica dhe Klina dhe shumë më të kufizuar përgjatë luginave të Ibrit e Lushtës.

Në anën e djathtë të Ibrit shtrihet masivi malor i Kopaunikut, i cili është vazhdim tektonik dhe orografik i Rodopeve, të rrudhosur në paleozoik dhe të modeluar për një kohë shumë të gjatë nga proceset e jashtme (denudimi etj), ndërsa në kuaternar u modeluan nga akullnajat. Pjesë e maleve të Kopaunikut në lindje të Mitrovicës është dhe Shala e Bajgores, që është njësi gjeografike dhe etnografike.

Në pjesën veriore të rrjedhës së sipërme dhe pjesën perëndimore të rrjedhës së mesme të Ibrit shtrihet mali i Rogoznës, i cili e mbyll RV-në prej atij të Novi Pazarit (Serbi). Ky mal i takon sistemit të maleve të formuara nga orogjeneza alpine. Dallohet për shtrirjen relativisht të madhe të formacioneve gëlqerore, që ka ndikuar në zhvillimin e formave të ndryshme të erozionit karstik. Ndërtim të njëjtë dhe periudhë të njëjtë të formimit me malet e

Rogoznës kanë edhe malet e Moknës dhe Mali i Thatë të cilat shtrihen në pjesën jugore të lumit Ibër.



Harta 2. Relievi i Regjionit Verior të Kosovës. Burimi: autorët

Zona më e ulët e RV-së është fusha në rrafshin aluvial të Sitnicës, Ibrit, Lushtës dhe Klinës. Fusha aluviale në të dyja anët e Sitnicës me një brez relativisht të gjerë, janë tarraca liqenore të pliocenit. Rrafshet aluviale të Ibrit e Lushtës janë shumë më të ngushta krahasuar me tarracat aluviale të Sitnicës dhe Klinës.

Në përgjithësi në kuadër të morfologjisë së RV-së, relievi kodrinoro-malor përfshin rreth 1200 km<sup>2</sup> ose 58.5 %, kurse zona e

ulët fushore (nën 700 m) zë rreth 850 km<sup>2</sup> ose 41.5 % të sipërfaqes së përgjithshme të RV-së.

Relievi dhe popullsia janë në lidhshmëri dhe ndërvarësi mes tyre. Kjo shihet më mirë nëse hartën e relievit e krahasojmë me hartën e shpërndarjes së popullsisë. Me përmasa planetare pjesa më e madhe e njerëzimit jetojnë në viset e ulëta, më pak në viset kodrinore, edhe më pak në viset malore. Kështu, shpërndarja e popullsisë në tokë është e kundërt me lartësinë mbidetare (lartësia më e madhe numri më i vogël i popullsisë). Një rregull i tillë mund të konstatohet edhe në RV.

### **1.1. Lëvizja vertikale si tregues i ndikimit të relievit në shpërndarjen e popullsisë**

Migrimi vertikal i popullsisë lidhet me zhvendosjen e saj nga vendbanimet më të larta (kodrinore - malore) drejt vendbanimeve më të ulëta.

Në kuadër të RV-së lëvizjet vertikale të popullsisë u zhvilluan gjatë gjithë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, por më intensive ishin pas viteve 1960, kur edhe zhvillimi ekonomik ishte më i madh. Këto lëvizje ishin intensive sidomos nga lartësitë mbi 700 m, që u përcollën me rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë dhe dendësisë në territoret nën 700 m mbi nivelin e detit.

Tabela 1. Shpërndarja e popullsisë dhe vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në RV

		Mitrovicë	Vushtrri	Skendera j	Leposavi ç	Z. Potok	Zveqa n	R.Verior
Nën	% e sipërfaqes.	17	70.5	66.2	32	15.2	37	41.4
700 m	% e vendbanimeve	46.9	82.1	70.0	40.8	15.9	62.8	51.9
	% e pop. 1961	73.5	90.4	73.3	53.3	22.8	79.3	75.1
	% e pop. 1991	83.8	95.4	76.7	73.9	45.2	85.3	84.1
	% e pop. 2011	92	98.7	76.9	88.5	82.8	92.3	90.3
Mbi	% e sipërfaqes.	82	29.5	33.8	68	84.8	63	58.9
700 m	% e vendbanimeve	53.1	17.9	30.0	59.2	84.1	37.1	48.1
	% e pop. 1961	26.5	9.6	26.7	46.7	77.2	20.7	24.9
	% e pop. 1991	16.2	4.6	23.3	26.0	54.8	14.7	15.9
	% e pop. 2011	8	1.3	23.1	11.5	17.2	7.7	9.8

Burimi: Regjistrimi i popullsisë 1961,1991 dhe 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat i përpunoi autori

Në viset e ulëta fushore të RV-së (deri 700 m), që zënë 41.4 % të sipërfaqes, jetojnë 90.3 % e popullsisë, kurse në viset kodrinore-malore, që zënë rreth 58.9 % të sipërfaqes, jetojnë 9.8 % e popullsisë së RV-së (2011), nga 15.9% (1991) dhe 24.9% (1961) .

Përqendrimi i lartë i popullsisë në viset e ulëta shprehet edhe me dendësinë e banimit, e cila në viset e ulëta është 247 b/km<sup>2</sup>, krahasuar me 20 b/km<sup>2</sup> në zonën kodrinore-malore, ndërsa dendësia mesatare e RV-së është 114 b/km<sup>2</sup>.

Përqendrimi i numrit të përgjithshëm dhe dendësia e popullsisë në RV e vërteton konkluzionin se relievi është element i rëndësishëm në shpërndarjen e popullsisë.

Kushte më të favorshme për ndërtimin e vendbanimeve ofrojnë zonat fushore. Në RV këto zona janë më të populluara dhe në to ndodhen vendbanimet më të mëdha të regjionit (urbane dhe rurale).


Relievi gjithashtu ndikon edhe në formën e vendbanimeve, kështu viset e ulëta janë zona të vendbanimeve të mëdha dhe të dendura, kurse vendbanimet e zonave kodrinore-malore janë të vogla dhe të tipit të shpërndarë.

Tabela 2. Shpërndarja e sipërfaqeve, popullsisë dhe vendbanimeve sipas tërësive relievoze në RV 2011

	% e sip.	% e vendb.	% e pop. 2011	Dend. e pop. 2011	Madh. mesa. e vendb.
Zona fushore	41.8	56.2	90.3	247.3	1118
Zona kodrinore	37.1	32.6	8.4	25.8	179
Zona malore	21.3	11.1	1.4	7.4	86.3

Burimi: Regjistrimit të popullsisë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat i përpunoi autori

Nga të dhënat e prezantuara mund të konstatohet se në RV, viset e ulëta janë të ‘ngarkuara’ kurse viset kodrinore-malore “drejt zbrazjes”, edhe pse këto zona ofrojnë kushte për zhvillimin e shumë veprimtarive ekonomike (blegtori, pylltari, turizëm, bletari etj.).



Grafiku 1. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe popullsisë sipas lartësisë mbidetare në RV 1961- 2011



Nga grafiku shihet se pjesa më e madhe e popullsisë së RV-së është përqendruar mes 500-600 m mbidetare, ku në 17% të sipërfaqes jeton rreth gjysma e popullsisë. Përqendrimi kaq i madh i popullsisë në lartësitë 500-600 m lidhet me numrin e madh të vendbanimeve (33.8%) të përqendruara në këtë lartësi, sidomos të vendbanimeve të mëdha urbane si: Mitrovica, Vushtria, Zveçani etj., dhe rrethinat e tyre.


Në komunat ekonomkisht më të pazhvilluara të RV-së ka përputhje më të madhe midis sipërfaqeve, vendbanimeve dhe popullsisë, si dhe lëvizje më e vogël vertikale e popullsisë, si rasti i Skënderajt.

Polarizimi më i madh sa i përket lëvizjes vertikale të popullsisë është konstatuar në Mitrovicë dhe Zubin Potok ku në 5 % të sipërfaqes jetojnë afër 90 % respektivisht dhe 65.4% e popullsisë të komunave gjegjëse.

*Dukuria e përqendrimit të popullsisë në “zonat e ulëta”, “qendrore” e “aktive” në njërën anë dhe “boshatisja e zonave të larta”, “periferike” e “pasive” në anën tjetër, ka shkaktuar çrregullime në strukturën ekonomike, sociale, demografike e territoriale. Minimizimi i dukurive negative që sjellin këto zhvillime arrihet me politika të mirëfillta zhvillimore që nënkuptojnë: zhvillim të ekuilibruar socio-ekonomik regjional dhe shmangieje nga zhvillimi monocentrik i vendbanimeve e sidomos atyre urbane me orientim në zhvillim policentrik.*

Numri i popullsisë së një vendbanimi më së shpeshti merret si indikator për përcaktimin e madhësisë së tij në hierarkinë e zhvillimit të vendbanimit.

Zvogëlimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë (1961-2011), përjashto këtu vendbanimet në mes 500-600 m lartësitë mbidetare, tregon për depopullimin dhe imtësimin e vendbanimeve, ku më të goditurat janë vendbanimet me lartësi të madhe mbidetare (*bazuar në klasifikimin ndërkombëtar të vendbanimeve sipas madhësisë populatave të udhëzimit të EUROSTAT-it*).



Me këtë rast duhet theksuar se, përveç rritjes shumë të shpejtë të vendbanimeve shumë të vogla, janë shtuar edhe vendbanimet e braktisura, të cilat kanë mbetur vetëm si nocione gjeografike, që janë dyfishuar nga 6 (1961) në 13 (2011).

Në literaturën demografike, vendbanime potencialisht në shuarje konsiderohen të gjitha vendbanimet me numër më të vogël se 100 banorë, që do të thotë se nga procesi i depopullimit në vitin 2011 janë të rrezikuara mbi 35% e vendbanimeve të RV-së, nga 15% që ishin në vitin 1961.

Në rastin e RV-së (bazuar në grafikun 1) mund të konstatohet se në proces depopullimi intensiv janë të gjitha vendbanimet deri me 500 banorë, të cilat përbëjnë rreth 70% të numrit të përgjithshëm të vendbanimeve.

Vendbanimet e braktisura dhe ato potencialisht në shuarje u takojnë zonave kodrinore- malore të regjionit.

## 1.2. Pasuritë natyrore - roli në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve në RV

*Edit Durham: Mitrovica do të jetë eshka që do t'i japë flakë fuçisë së barutit të Ballkanit.*

*New York Times ( korrik 1998)“.....lufta në Kosovë bëhet për Mitrovicën”*

Hapësira e RV-së është e begatshme me rezerva të pasurive natyrore, të cilat deri në ditët e sotme kanë qenë të shfrytëzuara me intensitet të ndryshëm, në vartësi të rrethanave ekonomike dhe politike në të cilat kalonte RV-ja dhe Kosova në përgjithësi.

Në ndërtimin gjeologjik dhe tektonik të këtij territori, karakteristikë themelore është prezenca e shkëmbinjve të vjetër të paleozoikut, por edhe të mezozoikut dhe kenozoikut. Ndërtimi i komplikuar gjeologjik ka kushtëzuar vendburime të pasura minerare metalike, prej të cilave veçohen xehe të plumbit, zinkut, manganit, arit, argjendit, kadmiumit, bismutit, FeS<sub>2</sub> etj. Vlerësohet se afër 60% e rezervave minerale dhe 70 % e rezervave të plumbit dhe zinkut të Kosovës janë përqendruar në Regionin Verior të Kosovës.

Tabela 3. Rezervat minerare në RV sipas vendburimeve

Vendburimi	Xeherore (t)	Pb %	Zn %	Ag ( g/t)
Fusha xeherore e Trepçës-Stantërg	35,081,000	3.85	3.85	65
Fusha xeherore e Kopaunikut	7,544,227	6.85	5.07	96.1
Gjithsej	42,625,227	4.46	4.28	75.8

Burimi: Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë 2012, fq. 23. [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia\\_Minerare\\_e\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2012-2025.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf)

Zonat më të njohura me xehe të plumbit dhe zinkut ndodhen në pjesën lindore të Mitrovicës: fusha xeherore e Trepçës, e cila ka

disa vendburime të mëdha (Stan Tërgu, Zijaqa, Melenica e Mazhiqi, me rezerva të cilat vlerësohen në 35.1 milionë tonë) dhe fusha xeherore e Kopaonikut-Leposaviq, me vendburimet: Belo Bërdë, Crnac etj. me rezerva rreth 7.54 milionë tonë.

## **2.1. Prishja e baraspeshës ekologjike nga shfrytëzimi i pasurive natyrore në RV**

Shfrytëzimi i pasurive natyrore në RV ishte joracional, i bazuar në konceptin maksimal e jo në shfrytëzim të qëndrueshëm, i cili ndikoi që RV-ja zhvillimin e vet ekonomik, socio-demografik dhe mjedisor e kishte larg parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Shkaktarët kryesorë të një zhvillimi të paqëndrueshëm janë:

- Shfrytëzimi maksimal i pasurive minerare i bazuar në konceptin “shfrytëzim maksimal” e jo në konceptin “shfrytëzim i qëndrueshëm”.
- Përpunimi joracional i tyre: pasuri të shumta me koncentrim të ulët të metalit janë hedhur si mbeturina, kështu që me përdorimin e teknologjive të reja në të ardhmen të njëjtat mund të shfrytëzohen si miniera;
- Teknologjia e vjetruar me të cilën shfrytëzoheshin pasuritë minerare kontribuonte në shkallën e lartë të ndotjes dhe shfrytëzimin joefikas të pasurive minerare;
- Lokacioni joadekuat i objekteve industriale brenda zonës urbane me koncentrim të lartë të popullsisë;

Nga shfrytëzimi joracional i pasurive natyrore problemet kryesore ekologjike, të cilat rrezikojnë ekzistencën e gjeneratave të tashme dhe të ardhme janë: ndotja e lartë e të gjitha elementeve ekologjike të mjedisit jetësor (ajri, toka dhe uji).

Matjet gjatë viteve 1979-’89 kanë treguar se në 70% të rasteve koncentrimi i plumbit ka qenë më i lartë sesa VML dhe se tejkalimet kanë lëvizur nga 80.2 herë (zona urbane) deri 24.2 herë

(rrethina), kurse ato maksimale kanë qenë 184.8 herë mbi VML të lejuara. Në vitin 2000 matjet e bëra nga UNMIK-u në Zveçan kanë konstatuar prezencën e plumbit në atmosferë 200 herë më të lartë sesa lejojnë standardet nga OBSH-ja, prandaj këtë vit shkrijtorja mbyllet si “një burim i papranueshëm i ndotjes së ajrit” (*Behrami, Bajraktari & Zogaj, 2010*).

Në vitin 2002 monitorimi i ndotjes me plumb nga KFOR-i francez tregoi se tejkjalimet e VML kanë qenë: te shkrijtorja e plumbit në 60.6% të rasteve, te spitali maroken (fabrika e akumulatorëve- Mitrovicë) në 57.2% të rasteve, spitali i qytetit 20.1%, komanda e KFOR-it (hotel Adriatiku- Mitrovicë) 21.3%, batalioni danez (Zhabar) 13.2% dhe te batalioni belg (Albanik) 7.8% , kurse në vitin 2004 nga 6 vendmatje, 5 kanë rezultuar me prezencë më të lartë të plumbit se VML, me tejkjalime deri 1.3 herë etj.

Prezenca e lartë e plumbit është vërtetuar edhe në rezultatet e mostrave të dheut të marra në 308 vendmostrime në nëntor - dhjetor 2002, me tejkjalime të VML: për plumb 95.1 % e rasteve, zink 91.5 % e rasteve.

Në periudhën pas vitit 2000, edhe pse ka pasur tejkjalime të VML të plumbit në RV ato kanë qenë më të ulëta se në periudhën 1979-2000 si pasojë e mosaktivizimit të reparteve të Kombinatit “Trepça”.

## **2.2. Pasojat për popullsinë nga prishja e baraspeshës ekologjike në RV**

Pasuritë natyrore në zona të veçanta kanë bërë të mundur lindjen e qyteteve të para xehetarie, kurse zhvillimi i mëtejshëm i tyre ka qenë i lidhur ngushtë në mënyrë të domosdoshme me zhvillimin e vet këtyre zonave (*Axhemi, 2007*). Në këto zona pasuritë natyrore ishin faktorë kryesorë në përqendrimin e

popullsisë dhe zhvillimin e vendbanimeve. Raste të tilla në RV janë të shumta, pasi pasuritë natyrore janë element i rëndësishëm dhe i përhapur. Përqendrimi i popullsisë në vendbanimet e pasurive natyrore, e veçmas në qendrat e përpunimit të tyre, tregon më së miri rëndësinë e tyre. Raste të tilla në RV janë: Stan Tergu në të cilin popullsia në periudhën 1948-1991 tregon rritje për 203.1 %, Bello Bërda 6.8 % (edhe përkundër faktit se vendbanimet përreth pothuajse janë boshatisur nga popullsia), Tuneli i Parë 142.1 %, ose edhe qendrat e përpunimit siç është rasti me: Mitrovicën 278.7%, Zveçanin 232.3% etj. Lindja dhe zhvillimi i këtyre vendbanimeve është i lidhur ngushtë me pasuritë natyrore të plumbit, zinkut, argjendit etj. Pas luftës së vitit 1999, si pasojë e mosaktivizimit të minierave të “Trepçës” dhe reparteve përpunuese, shumë nga këto vendbanime kanë shënuar trend negativ sa i përket numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Si pasojë e shkallës së lartë të ndotjes së ajrit me metale të rënda në RV (sidomos zonat afër burimit të ndotjes), është e rrezikuar e tërë popullsia (të gjitha grupmoshat) e veçanërisht fëmijët, gratë shtatzëna dhe të moshuarit.

Kërkimet gjatë vitit 1980 kanë treguar përqendrim të plumbit në gjak prej 50-60 mg/dl në 35% të fëmijëve, prej të cilëve 12% kanë pasur përqendrim prej 70 mg/dl e më tepër që konsiderohet shkallë e lartë e helmimit. Për të vërtetuar pasojat e rënda të ndikimit të plumbit, nga maji 1985 deri në janar të vitit 1987 është punuar projekti special me gratë shtatzëna nga Mitrovica (602) dhe Prishtina (900), duke përcjellë zhvillimin e frytit në pjesën e dytë të shtatzënisë. Përqendrimi mesatar i plumbit te shtatzënat e Mitrovicës ishte për 3.4 herë më i lartë se te shtatzënat nga Prishtina.

Studimet e viteve '90 kanë treguar se në Mitrovicë përqendrimi i plumbit në gjak te të porsalindurit ka qenë 20.8 mg/dl ose dy herë më i lartë se VML prej 10 mg/dl.

Në këtë periudhë është konstatuar se 70% e popullsisë nën 15 vjet karakterizohen me prezencë të plumbit mbi 30 mg/dl, që paraqet përqendrim shumë të lartë.

Studimi i viti 1992, i realizuar te gratë shtatzëna dhe fëmijët e moshës deri dy vjet në Mitrovicë dhe Prishtinë, ka konstatuar se prania e plumbit: te gratë shtatzëna ishte 3.55 herë më e lartë në Mitrovicë sesa në Prishtinë, te të porsalindurit 4.24 herë, kurse te fëmijët dyvjeçarë prezenca e plumbit ishte 4.16 herë më e lartë në Mitrovicë sesa në Prishtinë.

Hulumtimet për shkallën e plumbit në gjak në qytetin e Mitrovicës, të udhëhequra nga OBSH-ja, pas luftës së vitit 1999, kanë treguar rezultate shumë të ngjashme me ato të viteve '80 dhe '90 të shek. të kaluar.

Në korrik të vitit 2004, OBSH-ja realizoi një studim për nivelin e përqendrimit të plumbit në gjak në Mitrovicë dhe Zveçan. Nga mostrat e marra është konstatuar se në 58.6% të rasteve përqendrimi i plumbit ka qenë mbi VML, kurse në vitin 2006 nga 203 mostra të marra, 76.4% të rasteve ishin mbi këtë vlerë. Në 31.5% të rasteve vlera është tejkaluar me 2 herë, në 23.6% me 3 herë, në 12.3% me 4 herë, kurse në 8.9% të rasteve mbi 5 herë. Gjithashtu vlen të theksohet se 66.4% e mostrave janë marrë nga fëmijët e moshës nën 6 vjet (Komuna e Mitrovicës, 2004). Si pasojë e një niveli kaq të lartë të përqendrimit të plumbit në gjak, por edhe në ajrin e Mitrovicës, disa ekspertë të OBSH-së kishin rekomanduar evakuimin e të gjithë banorëve të Mitrovicës nga zona urbane (*Svjetska Zdravstvena Organizacija*, 2005).

Në vitin 2006 nga 203 mostra të marra, 76.4% të rasteve ishin mbi këtë vlerë. Në 31.5% të rasteve vlera është tejkaluar me 2 herë, në 23.6% me 3 herë, në 12.3% 4 herë, kurse në 8.9% të rasteve mbi 5 herë. Vlen të theksohet se 66.4% e mostrave janë marrë nga fëmijët e moshës nën 6 vjet.

Për efektet negative të përqendrimit të plumbit në RV tregon edhe rekomandimi i KFOR-it për pjesëtarët e tij, sipas të cilës të gjitha femrave që shërbejnë në kuadër të KFOR-it në Mitrovicë dhe Zveçan u rekomandohet që 2 vite pas përfundimit të misionit të tyre në Kosovë të mos mbesin shtatzëna, sepse nëna e ekspozuar më parë ndaj plumbit mund të ketë plumbin në organizëm, i cili mund të bartet dhe të shkaktojë pasoja për zhvillimin e frytit. Masa të njëjta u këshillohen edhe meshkujve, por në periudhë dukshëm më të shkurtër kohore - pas 6 muajve (*Behrami, 2008*).

Nga ndotja e mjedisit, më të rrezikuarit dhe më të ndjeshmit janë fëmijët, kështu që përqindja e vdekjeve të tyre në numrin e përgjithshëm të mortalitetit gjithashtu tregon për gjendjen e mjedisit në të cilin ata jetojnë.

Në vitin 2002, sipas Entit të Statistikave të Kosovës 2004 dhe 2005, në Mitrovicë (qendër e industrisë së rëndë) mortaliteti postnatal përbënte 5.9% (2002) dhe 6.4% (2004) të numrit të përgjithshëm të vdekjeve, kurse në Pejë (qendër pa industri ndotëse) 4.9% (2002) dhe 2.7% (2004). Gjithashtu në Mitrovicë grupmoshat deri 9 vjet përbënin 8.7% (2002) dhe 7,6% (2004) të të gjithë të vdekurve, kurse në Pejë grupmoshat e njëjta përbënin 5.9% (2002) dhe 3.4% (2004) të të gjithë të vdekurve. S'ka dyshim se një gjendje e tillë është pasojë e shkallës më të lartë të ndotjes, pasi sa i përket kujdesit shëndetësor Mitrovica ndodhej në pozitë më të favorshme sesa Peja<sup>1</sup>.

Edhe shumë sëmundje të tjera të cilat janë të lidhura me ndotjen e mjedisit janë shumë të përhapura në RV. Kështu, tumoret që janë sëmundjet më përfaqësuese të ndotjes së mjedisit, janë shumë të përhapura. Gati çdo i dyti banor i sëmurë nga tumori në Kosovë

---

<sup>1</sup> Shënim: Në këtë periudhë në komunën e Mitrovicës mesatarisht një mjek vinte në 722 banorë, kurse në Pejë, 821 banorë. Krahasimi mes Mitrovicës dhe Pejës është marrë për faktin se kishin numër pothajse të njëjtë të popullsisë, por industri shumë të ndryshme.



vjen nga RV-ja (43.8%); më tepër se  $\frac{1}{4}$  (26.0%) e problemeve që lidhen me shtatzënësinë, lindjen dhe abortin në Kosovë vijnë nga RV-ja; çdo i dyti abort i realizuar në Kosovë është nga RV (49.7%), kurse sa u përket lindjeve të komplikuar 89.7% të këtyre lindjeve në Kosovë janë nga RV-ja. Këto të dhëna i referohen gjendjes së gjashtëmujorit të vitit 2003 kur RV-ja përbënte 12.9 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Gjithashtu edhe sëmundjet e tjera që kanë lidhje me ndotjen në RV kanë frekuentim të lartë siç janë: sëmundjet e veshkave 24.3 %, sëmundjet ngjitëse 19.8%, sëmundjet e organeve të frymëmarrjes 14.2%, sëmundjet e brendshme 18.7% etj. (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, 2003).

Siç u theksua edhe më lart, në periudhën pas vitit 2000, edhe pse ka pasur tejkalime të VML të plumbit në RV, ato kanë qenë më të ulëta se në periudhën 1979-2000, si pasojë e mosaktivizimit të reparteve të Kombinatit "Trepça", ndaj edhe pasojat për popullsinë janë më të vogla.

### 3.3. Ndotja e mjedisit dhe migrimet e popullsisë në RV

RV-ja ishte dhe mbeti në vazhdimësi territor tipik emigrues si pasojë edhe e ndotjes së mjedisit. Dinamika migruese e popullsisë, e shprehur përmes saldos migruese, tregon për thellim të saldos negative, e cila në periudhën 1971-1981 dyfishohet në krahasim me periudhën 1961-1971. Komuna e Mitrovicës (njësia më e rëndësishme e RV-së), për këtë arsye, njihet edhe si Regjioni i Mitrovicës, i cili, krahas qendrave të tjera regjionale, në vitet '70, përveç ndotjes së ambientit, humbi edhe hapin e zhvillimit ekonomik. Kjo ndikoi në shpërnguljen e popullsisë në drejtim të qendrave të tjera (sidomos drejt Prishtinës, jashtë regjionit dhe Vushtrrisë, brenda regjionit). Prandaj, në periudhën 1971-1980 dallohet për saldo negative më të lartën edhe në nivel të Kosovës, që vazhdon edhe në dhjetëvjetëshin 1981- 1991.

Fatkeqësisht emigrimet e popullsisë nga RV-ja vazhduan edhe pas luftës së vitit 1999 me intensitet të pazvogëluar. Kështu sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në RV në periudhën 2000-2020 nga emigrimet janë përfshirë 30-35% e popullsisë së përgjithshme të regjionit.

Ndërsa emigrimet e periudhës 1961-1981 ishin të shkaktuara në radhë të parë nga problemet mjedisore, në periudhën 1981-1990 emigrimet janë të karakterit mjedisor dhe ekonomik, 1991-1999 të karakterit politik, sigurisht dhe ekonomik, ndërsa në periudhën 2000-2020 emigrimet janë të karakterit ekonomik.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Shpërndarja e popullsisë dhe vendbanimeve në një hapësirë të caktuar është e kushtëzuar nga një numër i madh faktorësh, faktorët natyrorë kanë ndikim dominant.

Për shmangien e pasojave negative të ndikimit të faktorëve natyrorë, sidomos i relievit nevojitet: strategji dhe politika të suksesshme zhvillimore regjionale: zhvillim të qëndrueshëm; zhvillim të ekuilibruar socio-ekonomik brenda komunave dhe regjionit, që nënkupton shmangie nga zhvillimi monocentrik dhe orientimi kah ai policentrik; krijimin e lehtësirave për jetë më të mirë në këto zona përmes infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë, shërbime arsimore, shëndetësore etj.; krijimin e përfitimeve të tjera materiale dhe shfrytëzimin e fondeve të BE-së për rivitalizimin dhe shfrytëzimin e praktikave të suksesshme nga vendet e tjera me problematika të përafërta etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor nënkupton ndërmarrjen e masave që do të ndikonin në: zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe minimizimin ose ndalimin e atyre veprimtarive ekonomike që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisit; përmirësimi i cilësisë së jetës, dihet se pa një zhvillim ekonomik nuk mund të ketë as përkujdesje të duhur për

mjedisin sepse mbrojtja e tij ka çmimin e vet; përdorimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore, duke u orientuar në resurset ekzistuese në dispozicion dhe ato që mund të ripërtërihen dhe integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët që veprojnë në mjedis ose që kanë të bëjnë me të, duke mundësuar që mbrojtja e mjedisit të jetë pjesë e politikave, planeve dhe programeve sektoriale zhvillimore. (Behrami, Bajraktari & Hajdari, 2013).

Nëse masat nuk janë të menjëhershme, problemet në RV do të thellohen edhe më tepër dhe do të përcillen me pasoja të shumta të natyrës demografike, në radhë të parë me moshimin e popullsisë, që do të pamundësonte: 1) rivitalizimin demografik dhe ekonomik të zonës; 2) do të krijonte zona të cilat nuk mund ta ripërtërijnë veten (popullsia) dhe jetën ekonomike dhe 3) do të pamundësonte zhvillimin e qëndrueshëm demografik, i cili do të përcillej me paqëndrueshmëri edhe në sferat e tjera.

### Literatura

Axhemi, S., (2007). "Gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve", ALSA. Tiranë,

Behrami, S., Bajraktari F., Zogaj N., 2010. "Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor, ekonomik dhe demografik i Mitrovicës". *International Geo-Science Conference- "GeoAlb 2011"*., Mitrovicë,

Behrami, S., (2008). "Problemet ekologjike në Mitrovicë, pasojat për popullsinë". *Kërkime Gjeografike 14*. Shoqata e Gjeografëve të Kosovës. Prishtinë,

Behrami, S., Bajraktari, F., Hajdari, R., (2013), "Environmental, Economic and Demographic Challenges for Sustainable Development in Mitrovica". *Volume B- Facing Demographic Challenges, Information Society – IS 2013*- Ljubljana, Slovenia,

Osmani J. (2003), Vendbanimet e Kosovës: Mitrovica, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku, Prishtinë. Rezultatet e përpunuara të raporteve periodike mbi kuadrin, aktivitetin dhe morbiditetin ambulator të regjistruar në institucionet shëndetësore publike në Kosovë për janar- qershor 2003, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Prishtinë, 2003,

Statistikat vitale të Kosovë 2002-2003, Enti i Statistikave të Kosovës, Prishtinë, 2004,

Statistikat vitale të Kosovë 2004, Enti i Statistikave të Kosovës, Prishtinë 2005,  
Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Ministria e Zhvillimit  
Ekonomik, Prishtinë 2012, f. 23. [https://kryeministri.rks-gov.net/wpcontent/uploads/docs/StrategjiaMinerareeRepublikes se Kosoves 2012-2025.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wpcontent/uploads/docs/StrategjiaMinerareeRepublikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf)

SZO, Kosovu preti olovo, Radio B92. 27 maj 2005,

Shënime të marra në KK të Mitrovicës- Sektori për mbrojtje të mjedisit dhe  
OBSh - zyra në Mitrovicë.

**Dr. Adriatik Balla<sup>1</sup>**

## **NDIKIMI I RRUGËS SË ARBRIT NË RIORGANIZIMIN GJEOGRAFIK TË LUGINËS SË BULQIZËS**

### **Abstrakt**

Rruga e Arbrit është arteria më e re e rrjetit rrugor shqiptar, një investim i rëndësishëm i qeverisë shqiptare që mundëson lidhjen e zonës lindore të vendit me kryeqytetin, Tiranën, por njëherësh një rrugë me efekt strategjik rajonal, pasi mundëson lidhjen më të shkurtër të Durrësit dhe sidomos Tiranës me Maqedoninë e Veriut. Rruga e re shkurton me afro 100 km distancën e Tiranës me Bulqizën dhe qendrat e tjera urbane e rurale të qarkut të Dibrës. Gjithçka lidhet me efektet e transportit, i cili eviton kostot e qarkullimit, shkurton kohën (nga 3-4 orë në më pak se 1 orë) dhe rrit premiset për një lulëzim ekonomik. Vendbanimet kryesore ku spikasin ndërtimet arkitektonike të tipit “kullë” dhe numri më i madh i tyre shtrihet drejtpërdrejt në luginë, në lartësitë 550-850 m. Mbi këtë lartësi, vendbanimet dhe dendësia e popullsisë pakësohet dhe rrjeti i tyre është më i dobët. Në tri dekadat e fundit zona ka pësuar një tronditje të thellë demografike, pasi kanë emigruar 30% e popullsisë së saj, e në disa fshatra malore deri në 75%, por me hapjen e rrugës së Arbrit pritet një riorganizim i hapësirës që sot i përket bashkisë së Bulqizës.

*Fjalë çelës:* Bulqizë, rruga e Arbrit, luginë, Dibër, riorganizim gjeografik, vendburim minerar.

### **Abstract**

Arbri Road is the newest artery of the Albanian Road network, an important investment of the Albanian government that enables the connection of the eastern part of the country with the capital Tirana, but also a road with strategic regional effect, as it enables the shortest connection of Durrës and especially

---

<sup>1</sup> Doktor i Shkencave Gjeografike

Tirana with Northern Macedonia. The new road shortens by about 100 km the distance of Tirana with Bulqiza and other urban and rural centers of Dibra district. It all has to do with the effects of transporting either goods or materials or transporting people, which avoids turnover costs, shortens time (from 3-4 hours to less than 1 hour) and increases the premises for an economic boom. The main settlements, where the architectural constructions of the "tower" type stand out, and most of them lie directly in the valley, at altitudes of 550-850m. Above this altitude, settlements and population density decrease and their network is weaker. In the last three decades the area has suffered a deep demographic shock, as 30% of its population has emigrated, and in some mountain villages up to 75%, but with the opening of the Arbri Road there will be a geographical reorganization of the valley of Bulqiza.

**Keywords:** *Bulqiza, Arbri Road, valley, Dibër, geographical reorganization, mining deposits.*

## I. Hyrje

Qyteti i Bulqizës dhe njësitë e tij administrative shtrihen në verilindje të Shqipërisë e nga pikëpamja fiziko-gjeografike bëjnë pjesë në Krahinën Malore Qendrore. Në lindje kufizohet me luginën e Drinit të Zi, në veri kufiri vijon me kreshtat e malit të Arithit e të Balgjait, në perëndim me pellgun e Matit e në jug me kreshtat malore të malësisë Martanesh-Çermenikë-Gollobordë. Brenda këtyre kufijve shtrihet kështu një nga ndarjet administrative, bashkia e Bulqizës, me njësitë e saj. Gjatësia maksimale lindje perëndim është 35 km dhe veri-jug 25 km, me sipërfaqe afro 670 km<sup>2</sup>. Rruga e Arbrit nis nga Tirana e përfundon në Dibër. Ajo është një gjurmë e dikurshme e rrugës së vjetër, e cila niste nga Durrësi në bregdetin Adriatik e përfundonte në pellgun e Pelagonisë në Maqedoni, duke qenë një nga degëzimet e rrugës *Egnatia*, e që shënonte aksin më të rëndësishëm mesjetar në shtetin e Arbrit. Për shekuj me radhë ajo është quajtur rruga e Dibrës, e pas vitit 1990 mori pikërisht emrin *Rruga e Arbrit*.



Fig.1 dhe Fig.2. Paraqitja e Rrugës së Arbrit në hartën administrative të Bulqizës (hartë e Bashkisë Bulqizë), si dhe pamje të rrugës së Arbrit në sektorin e mesëm të luginës së Bulqizës (foto: A. Balla).

Nga pikëpamja administrative Bulqiza është pjesë e qarkut të Dibrës. Është një zonë me peizazh mesdhetaro-alpin dhe karakterizohet nga një relief i thyer malor i shoqëruar me një erozion të fuqishëm (*Gruda, 2011*). Rruga e Arbrit është një projekt i konkretizuar, me gjatësi Tiranë-Bllatë 75 km. Në aspektin e distancave, rruga Tiranë-Bulqizë 48 km, shkurtohet me afro 90 km nga aksi i mëparshëm (me mbylljen e loteve që nuk janë konkretizuar ende, si tuneli i Murrizës etj., rruga Tiranë-Bulqizë shkurtohet me afro 100 km). Ky shkurtim distance vlen edhe për bashkitë Mat, Klos e Dibër (Peshkopi). Rruga e Arbrit shkurton, gjithashtu, me mbi 100 km distancën Tiranë-Shkup.

## II. Metoda

Për të përcaktuar ndikimin e Rrugës së Arbrit në riorganizimin gjeografik të zonës së Bulqizës në tërësi dhe veçmas luginën e saj, është mjaft e vështirë për t'u arritur në terma apo përdorim variablash matematikorë. Kjo për shkak të numrit të madh të faktorëve që hyjnë në proces dhe ndikimet anësore që nuk lidhen vetëm me rrugën, veçoritë fiziko-gjeografike apo organizimin administrativ të zonës, por edhe për angazhimet e pushtetit

qendror e lokal në nisma me interes specifik ekonomik, shfrytëzimin e resurseve minerare, ndotjet e mjedisit etj. Autori ka përdorur metoda të njohura gjeografike, të tilla si vizitat në terren, njohja dhe seleksionimi i kujdesshëm i literaturës ekzistuese duke e ballafaquar me faktet e terrenit, analizat e grafikëve nga sektorë të ndryshëm ekonomikë, krahasim hartash topografike të viteve të ndryshme etj. Janë përdorur, gjithashtu, metodat krahasuese statistikore për burimet zyrtare të shprehura në shifra dhe kategorizimi i fenomeneve, për të dalë në konkluzione të bazuara tërësisht në parime shkencore.

### III. Fakte dhe diskutime

#### 3.1. Të dhënat historike dhe arkeologjike mbi vendbanimet dhe ndikimi i Rrugës së Arbrit

Pozicioni gjeografik i Bulqizës dhe njëherësh roli lidhës i luginës së saj midis lindjes e perëndimit, ka bërë që rëndësia e rrugës që kalon në këto territore të jetë shumë e madhe e njëherësh të lulëzojnë edhe vendbanimet e para prehistorike e historike. Të gjitha këto vendbanime janë në aksin e rrugës së tanishme të Arbrit, pra, përgjatë luginës së zallit të Bulqizës. Popullsia e këtyre anëve i përkiste në antikitet fisit të njohur të penestëve. Nga informacioni i deritanishëm janë zbuluar tri vendbanime të hershme (*Bunguri, 2010*). Njëri në Sofraçan, një qytezë prehistorike, ku muret e kësaj periudhe ruhen në trajtë rrënojash. Vendbanim tjetër i hershëm është ai i Krajkës, mbi një kreshtë shkëmbore në 778 m, në pikëtakimin e rrugës së vjetër mes Sofraçanit e Krajkës, me fortifikime të tipit gajtan. Në të dyja fortifikimet janë gjetur objekte arkeologjike të rëndësishme. Vlen për t'u theksuar se u gjetën vetëm pak vite më parë gjatë hapjes së Rrugës së Arbrit dy përkrenare bronzit të tipit ilir, me mjaft rëndësi, që gjenden aktualisht në Muzeun Historik Kombëtar. Në antikitetin e vonë, në zonë shfaqet një tjetër vendbanim, që ka



arritur një pjekuri të konsiderueshme dhe rrënojat e tij shtrihen në lindje të fshatit të sotëm Strikçan (në fusha e Gurrës). Të dhënat e gjetura këtu dëshmojnë për një nivel të lartë të qytetërimit ilir. Kurse qyteza e mesjetës së hershme më e përmendur dhe më e zhvilluar ka qenë Geties, pranë fshatit të sotëm Valikardhë, shumë pranë Urës së Qytetit, në kuotën 609 m. Këtu janë gjendur dhe gjurmë të fortifikimit antik të vonë. Në mesjetë do të kishte rëndësi të madhe si kontrolluese e rrugës që lidhte Dibrën me bregdetin, një nga vendet strategjike të Skënderbeut në luftërat e shumta që ai ka zhvilluar në këtë zonë (*Bunguri, 2010*).

### **3.1.1. Lindja e vendbanimeve mesjetare e të sotme**

Vendbanimet e sotme i kanë fillesat në mesjetë, por ka shumë pak të dhëna rreth tyre. Vendosja e tyre e çrregullt në shpatet e maleve në të dyja anët e luginës së zallit të Bulqizës lidhet drejtpërdrejt me kushtet gjeomorfologjike që kanë përcaktuar edhe fizionominë e shtrirjes së tyre. Vendbanimet pak nga pak pushtuan edhe pjesën luginore, por këtu janë relativisht me moshë më të re. Kështu p.sh. fshati Fushë-Bulqizë përmendet në dokumentet arkivore më 1830, por në këtë periudhë fshatrat dhe lagjet e tyre në sektorin e sipërm luginor kishin arritur një pjekuri dhe ishin afirmuar si qendra banimi prej të paktën 3-4 shekujsh.

## **3.2. Organizimi i vendbanimeve, stili dhe rëndësia e tyre**

### **3.2.1. Evolucioni administrativ**

Bulqiza historikisht përfshihet në Dibër të Epërme. “Bulqizë” lidhet me fjalën Bue (Buall, qafa e Buallit etj.). Para vitit 1912 përfshihej në “9 Malet e Dibrës”, kurse regjistrimi austriak (1916), e përfshin me Zhurin, nënprefekturën e Dibrës së Poshtme<sup>1</sup>. Në vitin 1912, pjesë e prefekturës së Drinit, nënprefektura Zerqan.

---

<sup>1</sup> Në këtë regjistrim, sektori ku kalon Rruga e Arbrit në Bulqizë përfshiheshin konkretisht në nënjësitë e Sheh Hysenajt (Zerqani sot) si dhe Skënderas (Shupenza e sotme).

Nga viti 1945 deri në vitin 1993, pjesë e rrethit Dibër. Këtu vlen të theksohet se më 14.11.1947 ishte pjesë e rrethit të Shupenzës, vetëm për pak kohë (*Keta, 2008*). Nga viti 1993 rreth më vete, kurse Martaneshi i bashkohet zyrtarisht pas atij viti. Sot është organizuar në bashkinë e Bulqizës, e cila ka 2 qendra urbane (Bulqiza, Krasta), 6 njësi administrative rurale, 64 vendbanime gjithsej.

### **3.2.2. Organizimi i sotëm hapësinor dhe karakteristikat morfologjike të vendbanimeve**

Në territorin e bashkisë së Bulqizës janë të regjistruara 64 vendbanime, prej të cilave dy janë vendbanime urbane, konkretisht qyteti i Bulqizës dhe Krasta në Martanesh. Duhet thënë se raporti i popullsisë urbane me atë rurale është 1/3 (sipas censusit 2011). Në luginë (70 km<sup>2</sup>) shtrihen 1/3 e vendbanimeve, me distancë mesatare nga njëri-tjetri 1-1.5 km; banojnë ¾ e popullsisë së bashkisë; 95% e popullsisë urbane; operojnë mbi 85% e bizneseve; mbi 70% e tokës së kultivuar; të vetmet rrugë të asfaltuara; pothuajse i gjithë rrjeti i shërbimeve. Në përgjithësi vendbanimet e sotme në territorin e luginës së Bulqizës e në zonën malore kufizuese janë të tipit të shpërndarë, pa ndonjë rregullator qendërzues. Gjithsesi, disa qendra të mëdha kanë konturet e vendbanimeve të organizuara me rrugë lineare paralele (qyteti i vjetër i Bulqizës dhe Shupenza), ose të qendërzura e që dalin në formë rrezesh nga qendra e vendbanimit si Zërqani, apo dhe me grupe lagjesh pa ndonjë rregull të veçantë, sikurse ndodh me shumicën e fshatrave në sektorin e sipërm luginor të Bulqizës, në Martanesh dhe Gollobordë. Në përgjithësi, vendbanimet rurale janë mesatare e të mëdha në luginë, e vijnë e dobësohen, e bëhen të vogla e shumë të shpërndara në lartësitë mbi 800-900 m. 2/3 e vendbanimeve në Bulqizë kanë një popullsi mesatare prej 600 banorësh për fshat. Ndërkohë, nga 600-800 m shtrihen vetëm 1/3 e vendbanimeve,

por jetojnë  $\frac{3}{4}$  e popullsisë, duke dëshmuar për rolin e rëndësishëm të luginës jo vetëm në numrin e vendbanimeve, por më së pari në përmasa dhe në numrin e popullsisë.

Tab.1.Kategorizimi i vendbanimeve sipas lartësisë së relievit

Lartësia (m)	Nr.vendbanimeve	Në %
450-650	16	26
650-850	20	31
Mbi 850	28	43
<b>Gjithsej</b>	<b>64</b>	<b>100</b>

Burimi: Përpunoi autori (bazuar në hartën topografike)

Tab.2.Kategorizimi i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë.

Vendbanime	Banorë
7	0-200
25	200-500
21	500-1000
11 (2 urbane)	>1000

Burimi: Përpunoi autori (bazuar në të dhënat demografike të fshatrave sipas njërive administrative).

### 3.3.3. Kullat, simbol karakteristik i ndërtimeve

Pas vitit 1600-1700, të gjitha vendbanimet në këtë zonë kanë një stil ndërtimi unik, të bazuar në shtëpitë tip “kullë”, mjaft të përhapur në Shqipërinë e Veriut. Por kullat si shtëpi banimi duket se kanë një histori shumë më të hershme, që prej fillimit të mesjetës. Kullat ndërtoheshin me dy e tri kate në varësi të gjendjes ekonomike të familjeve. Kullat shërbenin si vend jetese, por edhe mbrojtjeje dhe e gjithë arkitektura e tyre e dëshmon këtë. Në territorin që menazhohet sot nga bashkia e Bulqizës, janë evidentuar 16 banesa me vlera arkitektonike, të shpallura monument kulture që prej mesit të shekullit të kaluar. Të gjitha

janë kategorizuar si monumente tip “arkitekturë”, e që paraqesin një vlerë të çmuar për trashëgiminë kulturore.



Fig.3 dhe Fig. 4. Shtëpi tip “kullë” (foto: A. Balla), përfaqësuese e ndërtimeve dhe vendbanimeve në luginën e Bulqizës shprehur edhe në pullën postare të emetuar në vitin 1982.

### 3.4. Popullsia, shpërndarja dhe disa probleme demografike

Fenomeni i emigracionit, mjaft i përhapur në këtë zonë, ka sjellë jo vetëm zbrazjen e shumë fshatrave të Bulqizës, por edhe pakësimin e ndjeshëm të numrit të popullsisë në qytetin minerar të Bulqizës. Në zonat malore të Martaneshit dhe Gollobordës janë larguar nga 50-80% e popullsisë, kurse në njësitë administrative në luginën e Bulqizës midis 20-40%. Ka emigruar popullsia në moshë të re, kryesisht mashkullore, ndërkohë që vërehet fenomeni i plakjes së shpejtë të popullsisë, rënie e lindshmërisë dhe rënia e shërbimeve. Mbi gjithçka, flet numri i popullsisë në rang qarku (Dibër) krahasuar me vitin 1989, nga 226 mijë në 113 mijë, pra 50% më pak. Nëpërmjet tabelave shprehen treguesit sasiorë dhe cilësorë të ndryshimeve demografike gjatë 33 vjetëve të fundit.

Tab.3. Tipare të ecurisë së numrit të popullsisë së qarkut dhe bashkive në 3 dekadat e fundit.

Viti \ Bashkia	1989	2001 (Regjistri Civil)	2001 (census)	2011 (census)	2021 (Regjistri civil)
Mat	76000	68623	61187	44218	59600 <sup>1</sup>
Dibër	150000 <sup>2</sup>	104782	85699	61619	78940
<b>Bulqizë</b>	---	<b>52 140</b>	<b>42 968</b>	<b>31 210</b>	<b>40292</b>

Burimi: Instituti i Statistikave dhe Regjistri Civil. Përpunoi autori

Tab.4. Popullsia gjithsej dhe sipas njësive administrative të Bashkisë Bulqizë (2011, 2021)

Njësia administrative	Pop. Sipas censusit 2011	Pop. Sipas zyrës civile 2021
Bulqiza qytet	8177	12187
Fushë-Bulqiza	3342	4090
Zerqani	4111	5014
Martaneshi	1836	2194
Shupenza	5503	6936
Gjorica	4214	5404
Ostren&Trebisht	3034	4428
<b>Bashkia gjithsej</b>	<b>31210</b>	<b>40292</b>

Burimi: Instituti i Statistikës dhe Bashkia Bulqizë.

Një tjetër e dhënë interesante që shpreh drejtpërdrejt shqetësimin demografik dhe shpopullimin në zonat malore të Bulqizës është ndryshimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë, sipas njësive administrative nga viti 1989 e deri më sot.

<sup>1</sup> Shifra i përket popullsisë së bashkive të Matit dhe të Klosit.

<sup>2</sup> Shifra i përket popullsisë së rrethit Dibër në vitin 1989, që përfshinte dy bashkitë e sotme, Dibërën dhe Bulqizën.

Tab.5. Ndryshimi i popullsisë 1989-2011 (%)

Njësia administrative	Ndryshimi në %
Bulqiza qytet	-30 <sup>1</sup>
Gjorica	-16.17
Fushë-Bulqiza	-20.73
Shupenza	-27.22
Zerqani	-44.22
Ostreni	-58.21
Trebisht	-67.75
Martaneshi	-71.41

Burimi: INSTAT

Tab.6. Kategorizimi i dendësisë së popullsisë (banorë/km<sup>2</sup>) sipas njësive administrative.

Kategoria	Njësia administrative	Dendësia e popullsisë (banorë/km <sup>2</sup> )
>100	Bulqiza qytet	200.1
	Gjorica	134.22
50-100	Shupenza	67.87
30-50	Fushë-Bulqiza	48.20
	Zerqani	33.51
<30	Ostren	26.32
	Trebisht	19.36
	Martanesh	11.48

Burimi: Instituti i Statistikave, census i vitit 2011 (përpunuar dhe kategorizuar nga autori).

Si konkluzion, mund të themi se Bulqiza humbi 27.4 % të popullsisë (sipas censusit), ndërmjet dy regjistrimeve (2001-2011) e ka një trend në rënie të numrit edhe pas vitit 2011. Krahasuar

<sup>1</sup> Instituti i Statistikave jep shifrën 6.4%, por kjo nuk korrespondon me të dhënat konkrete të Bashkisë. Nga përpunimi i të dhënave del një shifër mbi 30%.

me të dhënat e gjendjes civile, ka humbur afro 40% të popullsisë në 20 vjet. Shifra ka kaluar 50% në vitin 2021 sipas të dhënave të INSTAT-it për nivel qarku.

### **3.5. Elemente të ekonomisë**

#### **3.5.1. Industria minerare**

Bulqiza shënon vendburimin kryesor të kromit në Shqipëri. Ajo është një prej dy-tri vendburimeve kryesore të kromit në Europë dhe ndër dekada Shqipëria ka qenë zë i rëndësishëm eksportues në tregun ndërkombëtar të kromit. Vendburimi kryesor ka qenë në Bulqizë të vjetër, por me kalimin e viteve shfrytëzimi i kromit është shtrirë edhe në sektorë të caktuar në Martanesh si në Batër, Thekën etj. Prej vitit 1948 e deri më sot, nga masivi krommbajtës i Bulqizës janë nxjerrë afro 20 milionë tonë krom. Llogaritet se ka ende 10-20 milionë tonë rezerva. Kulmi i prodhimit arriti në vitet '80 të shekullit XX, me afro 1 milion ton/vit (prodhimi kombëtar i kromit), e ku eksporti i kromit jepte 37% të të ardhurave në rang kombëtar (*Doka etj, 2013*). Para vitit 1990 ka pasur mbi 5 mijë të punësuar në minierë dhe në fabrikat derivate të minierës (fabrika e pasurimit, e furnizimit të punëtorëve, ndërtim-miniera etj.), kurse në ditët e sotme kromi shfrytëzohet në shumicën e rasteve nga kompani private, që punojnë tërësisht jashtë kushteve teknike. Gjithsesi, ishte dhe mbetet një burim jetese për shumicën e familjeve jo vetëm në qytetin e Bulqizës, por edhe në njësitë rurale të baskisë së Bulqizës.



Foto 5 dhe 6. Bulqiza, qyteti i minatorëve, dhe sektori qendror i minierës së Bulqizës (foto: autori).

### 3.5.2. Përdorimi i tokës

Pas vitit 1990, me rikthimin e pronës private ndryshoi shumë organizimi ekonomik dhe u krijuan njësitë ekonomike të bazuara kryesisht në prodhimin bujqësor e blegtoral. Zona ka potencial të madh blegtoral, dëshmuar me hapësirat e gjera që zënë kullotat në Balgjai, Arith, Martanesh e Gollobordë, por edhe kulturat bujqësore gjejnë vend të përshtatshëm për kultivimin e tyre. Ndër produktet më të kultivuara është misri e më pas vijnë foragjeret, e si zë i tretë është frutikultura. Referuar të dhënave zyrtare në rang qarku, bashkie apo njësisish administrative konstatohet një rënie e sipërfaqes së kultivuar e shtimit të sipërfaqes livadhe e troje. Kështu nga 8418 hektarë të regjistruar në rang të bashkisë së Bulqizës, kultivohen me drithëra vetëm 1184 ha, perime e të tjera më pak se 200 ha e 266.2 ha të tjera pemëtoje. Në total, toka e kultivuar zë një sipërfaqe midis 15-20%, që do të thotë më pak se 1/5 e fondit total të tokës bujqësore të regjistruar. Po 1/5 e tokës bujqësore (20-22%) mbillet me jonxhë, pra është regjistruar si foragjere në shërbim të blegtorisë. Më shumë se gjysma e fondit të tokës bujqësore është e regjistruar “livadhe e troje” (4927.9 ha), thënë ndryshe 59%. Kjo tregon se shumica e fondit të tokës nuk shfrytëzohet. Këta tregues të përdorimit të tokës, ku shumica nuk kultivohet, ndodh sepse nuk ka fuqi punëtore, nuk depërton mekanika, ka gardhim që pengon zhvillimin dhe kultivimin, nuk



ka treg për produkte, nuk ka orientim politikash ekonomike bujqësore, mungojnë subvencionet etj. Një tjetër tregues që pengon zhvillimin bujqësor është mungesa e një rrjeti efikas ujitjeje. Edhe pse të dhënat e bashkisë për fondin e pyjeve mungojnë aktualisht, si pasojë e dëmtimeve të rënda, rreth vitit 2005 Bulqiza si rreth kishte 36 mijë hektarë (*Keta, 2008*). Në gamën e gjerë të treguesve ekonomikë dhe socialë, një e dhënë shqetësuese me zonën lidhet me numrin e madh të familjeve që marrin ndihmë ekonomike, plot 1976 familje nga 11939 familje gjithsej, nga këto, afro 200 familje brenda qytetit të Bulqizës<sup>1</sup>. Sa i takon sektorit blegtoral, ka pësuar rënie të ndjeshme vitet e fundit, por potenciali natyror ofron shumë në këtë drejtim dhe mund e duhet të jetë një sektor ekonomik me vlerë në të ardhmen.

## Përfundime dhe rekomandime

### 1 Konkluzione mbi avantazhet e Rrugës së Arbrit në riorganizimin gjeografik të luginës së Bulqizës dhe zonës malore kufizuese

Nga ndërtimi i Rrugës së Arbrit, si pasojë e zvogëlimit të distancës me qendrat e mëdha urbane dhe metropolin Tiranë-Durrës, lindin disa avantazhe, kryesisht të transportit, e indirekt prej tij, në disa drejtime e me peshë të karakterit socio-ekonomik edhe avantazhe të tjera.

**1.1. Avantazhet e transportit** – Shkurtim i distancës në më pak se 50 km, pothuajse sa Tiranë-Durrës; koha e bërjes së rrugës është më pak se një orë nga 3-4 orë që zgjaste më parë. Rritet vëllimi i qarkullimit që përkthehet në zhvillim ekonomik; afrim dhe përfitim në transport me Maqedoninë e Veriut; çdo njësi lokale e Dibrës, në rastin më të largët, do të jetë më pak se 1 orë larg Tiranës; çdo vendbanim i qarkut do të jetë jo më larg se 15-20

---

<sup>1</sup> Kjo e dhënë është ekzaktësisht 194 dhe është dhënë nga Bashkia Bulqizë, nëntor 2021.

minuta nga aksi kombëtar; rruga të çon në zemër të Gadishullit Ballkanik, duke qenë lidhësja më e shkurtër, më e shpejtë, e më e sigurt e rajoneve të brendshme me bregdetin Adriatik.

**1.2. Avantazhet ekonomike** – Shpeshtimi i lëvizjeve sjell punësim dhe përfitim ekonomik nga zvogëlimi i shpenzimeve materiale dhe të kohës. Po ashtu, ulja e kostove të transportit sjell përfitime që përkthehen në investime publike. Me rrugën do të gjallërohen disa degë të industrisë, ndërsa prodhimet bujqësore e blegtorale do të gjejnë treg deri në metropolin Tiranë-Durrës. Vënia e rrugës në funksion të plotë do të nxisë banorët të shfrytëzojë maksimalisht tokën dhe blegtoria mund të kthehet në kapacitetet maksimale të saj. Rruga do të ketë ndikim pozitiv në hapjen e degëve artizanale, duke shfrytëzuar krahun e punës. Me shkurtimin e distancës nga kryeqyteti, do të gjallërohet rrjeti hotelarik, por edhe drejtime të veçanta ekonomike si frutikultura, bletaria etj.

**1.3. Avantazhet demografike dhe ripopullimi** – Rruga e Arbrit i shërben qarkut të Dibrës me 113 mijë banorë (Instat) por ajo ka një ndikim për 2 milionë banorë nga Tirana në Shkup. Shkurtimi i distancës me Tiranën dhe Durrësin pritet të sjellë kthimin në zonë të shumë banorëve. Nga ana tjetër, me rrugën pritet të frenohet procesi i emigrimit dhe do të marrin jetë fshatra të tëra që kanë pësuar krizë demografike. Për shumë banorë që janë larguar tashmë në 30 vitet e fundit, zona mund të shërbejë për ndërtimin e një shtëpie të dytë. Në pikat që gjallëron tregtia mund të ketë krijim vendbanimesh të reja, ose rritje e atyre ekzistuese, kryesisht përgjatë rrugës.

**1.4. Avantazhet kulturore dhe historike** – Me ndërtimin e rrugës, Bulqiza shndërrohet në “lagje të kryeqytetit”, e kryeqyteti do të njohë dhe mësojë nga traditat dhe historia e zonës (Cami, 2020). Studentë, punëtorë ditorë etj., do të kenë mundësinë të kthehen pasdite në zonë dhe vetë zona do të përfitojë nga

zhvillimet kulturore në kryeqytet. Tirana do të plotësojë në njëfarë mase këtë mangësi.

**1.5. Avantazhet turistike** – Nga shkurtimi i distancave me Tiranën dhe qytetet e mëdha, zona merr përparësi edhe sa i takon ofertës turistike që ajo prezanton (*Balla, 2011*). Kjo pasi Bulqiza shquhet për ajër të pastër, ujë qelibar, pyje, freski dhe çlodhje. Zona ka mundësi për hiking dhe alpinistët profesionistë. Në zonën e Bulqizës (Martanesh, Balgjai e Arith) gjenden një numër i madh liqenesh akullnajore. Gjenden shumë monumente natyrore (*Qiriazhi, 2019*), ka befasi të relievit, pasuri të mëdha historiko-kulturore etj.



Foto 6 e 7. Ujëvara e Duriçit dhe liqeni akullnajor i Gjuriçës në sektorin verior të Dhoksit (foto autori).

**1.6. Avantazhet sociale, mjekësore, politike etj.** – Me këtë nënkuptohet hapje alternativash për shkollimin e të rinjve në shkollat profesionale në Tiranë e në Durrës; bashkëpunime në art, përvojë etj.; afrimi me qendrat mjekësore të specializuara dhe spitalet universitare; rritja e ndikimit politik dhe angazhimet në shoqata kulturore, arsimore e shkencore; afrimi në zonë i mjekëve të specializuar, si pasojë e shkurtimit të rrugës etj.

**1.7. Avantazhet kombëtare, politike dhe gjeopolitike** – Shkurtimi i distancës me Tiranën, do të ketë një ndikim ekonomik (kryesisht) në rritje të Dibrës në kryeqytet dhe anasjelltas;

gjallërimin e fshatrave kufitarë si dhe projekte zhvillimi ndër-kufitar; ridimensionim tërësor të vendbanimeve në luginën e Zallit të Bulqizës dhe fuqizim i faktorit shqiptar në rajon.

## 2. Rekomandime

Pas kësaj analize, shihet e domosdoshme të jepen disa rekomandime, të cilat radhiten më poshtë:

- Domosdoshmëria për të investuar në përtëritjen e disa sektorëve të industrisë minerare sikurse është fabrika e pasurimit në Bulqizë apo dhe orientimi i shfrytëzimit për dekadat në vijim, duke marrë parasysh kriteret e sigurisë teknike qoftë në galeritë e Bulqizës, ashtu dhe në ato të Martaneshit, Balgjait etj.

- Ngritjen e një muzeu të minierës në qytetin e Bulqizës, i cili do të tërhiqte vëmendjen jo vetëm për punën kolosale që ka ndodhur këtu në më shumë se 7 dekada, por edhe për t’u njohur me “heronjtë e nëntokës”, vlerat e mineralit e të minierës etj.

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore drejt njësive administrative në Martanesh dhe Gollobordë si mundësi për të frenuar shpopullimin dhe për t’iu dhënë mundësinë afrimit të tyre me qendrën urbane (Bulqizë) dhe qendrat e tjera (Peshkopi, Librazhd, Tiranë). Kjo është dhe një mundësi e mirë për shfrytëzimin e kapaciteteve të mëdha turistike që ofrojnë zona të tilla malore.

- Dhënien e subvencioneve për fermerët që të nxisin rritjen e prodhimeve bujqësore, duke ndjekur politikat efikase bujqësore nëpërmjet varieteteve për të cilat shquhet zona (frutikulturë, misër, perime etj.).

- Nxitje për rikthimin e blegtorisë në kapacitete maksimale si pasojë e kushteve të shkëlqyera që ofron zona dhe kullotave të pasura alpine. Kjo mund të realizohet nëpërmjet kredive të buta për fshatarët dhe rekomandimit të mbarështimit të racave të njohura të bagëtive të imëta.

- Ndalimin në mënyrë urgjente të çfarëdolloj shfrytëzimi të pyjeve dhe liqeneve akullnajore. Duke reklamuar bukuritë natyrore të shumta, bashkia e Bulqizës (dhe banorët e saj) mund të përfitojë në të ardhmen në fushën e turizmit.

- Investime në disa degë të artizanatit, si punishtet e përpunimit drurit, bletaria etj.

- Investimin në rrjetin kanalizues për të vënë nën ujë sipërfaqe më të mëdha toke, sidomos në njësitë e specializuara për agroturizëm.

- Rikthimin në Bulqizë në shkollës së mesme profesionale, duke hapur degë të reja inxhinierike në përputhje me nevojat e tregut të punës.

### **Literatura**

Akademia e Shkencave e Vjenës, Rezultatet e regjistrimit kombëtar në Shqipëri, në zonën e pushtuar nga trupat austro-hungareze (1916-1918).

Balla, A., (2011), "Potenciali natyror dhe human i komunës së Zerqanit janë bazë e një zhvillimi të qëndrueshëm", në Studime Albanologjike, nr.IV/1.

Bunguri, A., (2010) "Vështrim arkeologjik në zonën e Zerqanit", prezantuar me rastin e 100-vjetorit të shkollës së parë shqipe të Zerqanit.

Doka, Dh, et al, (2013) "Industria e kromit në Shqipëri dhe roli i saj në përdorimin e territorit", Studime Albanologjike, Gjeografia IV, Ani Print, Tiranë, f. 88-97.

Gruda, Gj., (2010) "Karakteristikat fiziko-gjeografike të Komunës së Zerqanit" (prezantuar me rastin e 100-vjetorit të shkollës së parë shqipe në Zerqan).

Instituti i Statistikës - Vjetari statistikor i qarkut Dibër, për vitet 1998, 2001, 2005, 2010, 2021.

Keta, Y., (2008) "Bulqiza dhe bulqizakët", Mirgeeralb, Tiranë, f. 8-11, 257-259.

Qiriaz, P., (2019), "Gjeografia Fizike e Shqipërisë", Mediaprint, Tiranë. f. 188, 270-271, 376,

[www.dibraon.com/zerqani-nje-nga-100-fshatrat-turistike-te-shqiperise/aktualitet/S.Cami](http://www.dibraon.com/zerqani-nje-nga-100-fshatrat-turistike-te-shqiperise/aktualitet/S.Cami).

**Doc. dr. Arben Belba<sup>1</sup>**  
**Msc. Amarildo Shallas<sup>2</sup>**

## **SHPËRNDARJA HAPËSINORE E QYTETEVE DHE MODELET E LËVIZJES NË NIVEL BASHKIE DHE QARKU**

### **Abstrakt**

Qendrat e banuara në Shqipëri datojnë që nga antikiteti dhe shumica e tyre kanë një vazhdimësi të pandërprerë zhvillimi që nga koha e krijimit të tyre. Në tërësinë e kompleksitetit të tyre qendrat e banuara kategorizohen dhe ndahen duke marrë për bazë faktorët fizikë, resurset humane, demografinë, historinë, ekonominë etj. Në rastin e këtij punimi do të analizohet situata e vendbanimeve në rajonin e Korçës, vështruar si pjesë e kompleksit shqiptar të zhvillimit urban të këtyre vendbanimeve, në kontekstin hapësinor dhe atë kohor. Për nga aspekti metodologjik, përbri metodave tradicionale të analizës shkencore është përdorur dhe analiza nëpërmjet sistemeve GIS. Kjo e fundit mundëson trajtimin e informacionit në mënyrë më cilësore duke zhvilluar modele parashikuese të zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirave urbane. Rezultatet e nxjerra mund të përdoren për të krijuar modele të ngjashme dhe për rajonet e tjera, si dhe për krahasime në nivel kombëtar.

*Fjalë çelës: Shpërndarje hapësinore, rajoni juglindor, faktorët fizikë, zhvillim i qëndrueshëm, GIS.*

### **Abstract**

The inhabited centers in Albania date back to antiquity and most of them have an uninterrupted continuity of development since the time of their creation. In all their complexity, inhabited centers are categorized and divided based on physical factors, human resources, demography, history, economy,

---

<sup>1</sup> Departamenti i Gjeografisë, UT.

<sup>2</sup> Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

etc. In the case of this paper, the situation of settlements in the Korca region will be analyzed, viewed as part of the Albanian urban development complex of these settlements, in the spatial and temporal context. From the methodological point of view, in addition to the traditional methods of scientific analysis, analysis through GIS systems has also been used. The latter enables the treatment of information in a more qualitative way by developing predictive models of sustainable development of urban spaces. The results obtained can be used to create similar models for other regions as well as for comparisons at the national level.

**Keywords:** *Spatial distribution, southeast region, physical factors, sustainable development, GIS.*

## I. Hyrje

Vendbanimet në Shqipëri datojnë që nga periudha antike dhe shumë prej tyre mbartin vlera të rëndësishme historike dhe kulturore edhe në nivel global. Sipas elementeve që i karakterizojnë vendbanimet mund të klasifikohen në aspektin kohor dhe atë hapësinor. Në aspektin kohor vendbanimet në Shqipëri kategorizohen në vendbanime prehistorike, të antikitetit, të mesjetës dhe të shekullit XX e në vazhdim. Ndërsa në atë hapësinor, ndahen në aspektin vertikal me anë të elementit të lartësisë mbi nivelin e detit dhe atë horizontal, me anë të vendndodhjes hapësinore dhe shtrirjes territoriale. Në nënndarjen e parë, në aspektin vertikal, ato klasifikohen në bregdetare, fushore, kodrinore dhe malore. Në nënndarjen e dytë, në aspektin horizontal, vendbanimet ndahen sipas tipologjisë, të shpërndara ose të grupuara dhe sipas elementeve të tjera të zhvillimit kulturor, historik, ekonomik etj.

Nga statistikat e ASIG del një numër prej 5802 vendbanimesh apo njësisish vendbanimi të klasifikuara mbi bazën e hartës topografike 1:25000 të vitit 1985. Këto gjenden në gjeoportalin kombëtar në shtresën "Emërtimet Gjeografike". Ajo që vërehet është se një pjesë e madhe e këtyre vendbanimeve janë aktualisht pa asnjë banor apo edhe në disa raste me banorë sezonalë. Me

miratimin e ligjit 115/2014 mbi ndarjen e re territoriale – administrative, njësitë e qeverisjes vendore ndahen në 61 bashki dhe 12 qarqe. Termi “bashki” zëvendëson termin “rreth”, i cili i përkonte ndarjes së mëparshme administrative. Pjesa dërmuese e bashkive përputhen me njësinë e kaluar administrative “rreth”, si p.sh., Kolonjë, Pogradec etj. Por ka edhe mospërputhje, si p.sh., ish-rrethi i Korçës, i cili përbëhet nga bashkia: Korçë, Maliq dhe Pustec. Në këtë ligj gjithashtu përcaktohet dhe numri i vendbanimeve me statusin “qytet”, ku vërehen gjithsej 72 qytete të ndara në 61 bashki.

Nga sa u përmend më sipër, në qarkun e Korçës ku fokusohet studimi gjenden 6 vendbanime me statusin qytet, të cilat janë: Korça, Pogradeci, Bilishti, Maliqi, Erseka dhe Leskoviku. Ndër to, rëndësinë më të madhe nga pikëpamja administrativo – ekonomike e ka qyteti i Korçës, i cili njëkohësisht është edhe qendër e qarkut.

Nëse do të krahasonim ecurinë zhvillimore të qyteteve të rajonit juglindor me qytetet e tjera në nivel kombëtar, vihen re tipare të përbashkëta, si shkatërrimi i qendrave industriale apo regresi i tyre, siç është rasti i qytetit të Maliqit dhe Leskovikut, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë si dhe trendi drejt globalizmit.

Faktori i largësisë gjeografike nga qendra, kushtet natyrore, klima, peizazhi, vegjetacioni përcaktojnë specifikën e kulturës materiale dhe shpirtërore të qyteteve të vogla dhe ndikojnë në mënyrën e jetesës së banorëve, si edhe në aftësitë e tyre krijuese në aspektin kulturor. Kjo formë lokaliteti është kthyer në një vlerë të shprehur në artin popullor, artizanat (*Kasatkina 2015: 628 – 634*).

Mentaliteti provincial ruan traditat e njerëzve (*Kasatkina 2015: 630*). Në aspektin filozofik të studimeve urbanistike, në formën dialektike të tyre, mund të krahasojmë provincializmin dhe globalizmin (Misyurov 2019). Në rastin e Shqipërisë, qytetet e vogla priren drejt ruajtjes së identitetit dhe vlerave të tyre



kulturore të krijuara në mënyrë të veçuar, ndërsa qytetet e mëdha priren drejt globalizmit dhe inovacionit, pra vërehet një zhvillim kompleks me kahe të kundërta.

## II. Metoda

Metodologjia e përdorur në realizimin e këtij punimi konsiston në kombinimin e metodave të larmishme si p.sh., si ajo e hulumtimit, krahasimit, analizimit, vlerësimit dhe hartografimit. Kjo metodologji konsiston në mbledhjen e informacionit nga burime ekzistuese, sintezën e këtij informacioni, aplikimin e teknologjisë GIS në analizat gjeohapësinore dhe analizën përmbledhëse të informacionit.

## III. Roli i faktorëve natyrorë në shpërndarjen hapësinore të qyteteve në qarkun e Korçës

Ndikimi i mjedisit natyror në krijimin dhe shpërndarjen hapësinore të qyteteve të qarkut të Korçës mund të konsiderohet pozitiv. Pellgu i Korçës shtrihet në pjesën juglindore të vendit dhe rezulton të jetë “zona më e pasur me vendbanime prehistorike e protohistorike” (Belba 2013:17). Kjo hapësirë gjeografike është dalluar për popullim të hershëm dhe vijueshmëri të pandërprerë të jetës, nga neoliti i hershëm deri sot.

Zhvillimi human i kësaj treve është ndikuar nga pozita gjeografike. Në lashtësi në territorin e saj kalonte Via Egnatia, që ishte korridori që siguronte lidhjen midis lindjes dhe perëndimit, ose Romës dhe Kostandinopojës.

Voskopopjarët në mesjetë njihnin dhe shfrytëzonin mjaft mirë segmente të Via Egnatia-s. Nga kohët më të vjetra ata zotëronin ekskluzivitetin e përcjelljes së postës diplomatike midis Venedikut dhe Kostandinopojës përmes “via di Voscopoli” (Adhami 1989:64). Gjithashtu voskopopjarët kishin monopolin e qiraxhillëkut për lëvizjen e karvanëve nga Durrësi në Stamboll.

Fluksi në rritje i qarkullimit të mallrave ndikoi gradualisht në lulëzimin e qytetit të Voskopojës të shek. XVIII. Qyteti i Voskopojës u shndërrua në një “*stacion tranzit, por të sigurt midis lindjes e perëndimit*” (Belba 2017:397).

Përtej limaneve të Durrësit e Vlorës shtriheshin rrugët tregtare të vendeve perëndimore ku ata zhvillonin tregtinë me Vienën, Mishkolcin, Budapestin, Lajpcigun dhe Berlinin. Drejt lindjes ata rrugëtonin për tregti te fqinjët ballkanas, por destinacioni më kryesor ishte Kostandinopoja (më vonë Stambolli), si qendra më e rëndësishme në pikëlidhjen e tri kontinenteve.

Dinamika e zhvillimit të qytetit të Korçës midis fundit të shek. XIX dhe gjysmës së parë të shek. XX u favorizua nga pozita e veçantë gjeografike. Vendndodhja pranë rrugëkalimit Manastir – Janinë nxiti fuqizimin ekonomik të Korçës dhe urbanizimin e saj.

Korçarët shfrytëzuan ndërtimin e hekurudhës Selanik - Manastir (1894) për transportin e mallrave që ata sillnin nga Porti i Selanikut (*Skënderi; Hamiti 2019:8*).

Qyteti i Korçës u shndërrua në qendrën kryesore të prodhimit e tregtimit në nivel rajonal. Zhvillimi arriti kulmin në vitet '20-'30 të shek.XX, kur Korça konsiderohej si “*modeli i zhvillimi ekonomik*” për gjithë vendin (*Belba 2013:21*).

Pozita gjeografike ka ndikuar edhe në krijimin e qyteteve të Pogradecit, Bilishtit dhe Leskovikut. Vendndodhja pranë rrugëkalimeve ndërkufitare dhe akseve rrugore nacionale u dha mundësinë e zhvillimit ekonomik e urban qyteteve Pogradec e Bilisht, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit. Ndërsa në rastin e Leskovikut, izolimi gjeografik nga mbarimi i Luftës II Botërore deri në rënien e sistemit komunist ishte shkak i zvogëlimit urban deri në “*harresë*”.



Fig. 1. Harta e rrugëve të Shqipërisë në shek. XV-XIX

Aktualisht në qarkun e Korçës kalon Korridori VIII, që lidh Adriatikun me Detin e Zi, i cili mbivendoset mbi gjurmët e Via Egnatia-s. Ndërkohë, rruga Qafë Thanë-Korçë-Kapshticë lidh boshtet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe Greqisë (*Belba 2013:30*). Korça komunikon me rrugë automobilistike me shtetet fqinje përmes doganave të Qafë Thanës, Tushemishtit, Goricës dhe Kapshticës, duke merituar statusin e “nyjës së rëndësishme e transportit rrugor”.

Trevat juglindore të vendit kanë përjetuar një evolucion morfotektonik mjaft interesant. Tektonika shkëputëse i ka dhënë indentitet të veçantë gjeologjik. Këtu “ndërthuren strukturat rrudhosëse më të vjetra dhe strukturat shkëputëse Horst – Graben natyrisht më të reja (*Belba 2013:30*). Thyerjet tektonike dhe lëvizjet diferencuese neotektonike kanë formuar një zinxhir depresionesh relievi, që përbëjnë boshtin qendror të albanideve juglindore. Pjesa qendrore e të gjitha njësive administrative zihet nga struktura grabenore, ku shfaqen forma depressive relievi, si: fusha ndërmalore (Korçës, Përrenjasit), gropa (Pogradecit, Kolonjës, Prespës) dhe lugina lumore (Devollit). Ato rrethohen nga vargje malore me drejtim pliokuaternar gati meridional.

Relievi është elementi kryesor i mjedisit natyror, që dallohet për larminë e formave, me male, vargje malore e malësi me pasuri të shumta minerale dhe cilësi të lartë të peizazhit turistik. Ndërsa luginat, fushat dhe gropat ndërmalore ofrojnë mundësi reale për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë, bletarisë etj. Relievi tradicionalisht ka përcaktuar nivelin e zhvillimit human dhe shpërndarjen gjeografike të vendbanimeve urbane në qarkun e Korçës.

Densiteti i lartë i popullimit dhe i vendbanimeve është favorizuar nga kushtet klimatike që kjo hapësirë ka pasur nga holoceni deri sot. Vlerësimi gjeoklimatik i shtresave në

vendbanimin arkeologjik të Podgories, i kryer nga ekspedita franceze në vitin 2005, tregoi se klima në periudhën gjeologjike të holocenit (rreth 10.000 vjet më parë) ka qenë +2°C deri +3°C më e lartë sesa sot (Belba 2013:17).

Identiteti klimatik i qarkut të Korçës prezantohet me vlerat ekstreme (Grup autorësh 1991:100) të minimumit absolut të temperaturës (- 26.9° C) dhe minimumit pluviometrik (608.7 mm reshje në vit) në nivel kombëtar. Brenda larmisë klimatike (mesdhetare: kodrinore, paramalore e malore JL) largësia nga deti<sup>1</sup> shkakton zbehjen graduale të klimës mesdhetare dhe shfaqjen e nuancave të klimës kontinentale.

Banorët i formuan vendbanimet e tyre duke sfiduar pengesat natyrore, si: relievin malor, temperaturat e ulëta, reshjet e pakta vjetore dhe dominimin e reshjeve të borës në dimër. Formimi i qytetit të Voskopojës mund të konsiderohet si shembull i tezës së babait të regjionalizmit Vidal de la Blache, që thoshte se: *qytetërimi përbëhet nga lufta kundër pengesave të ngritura prej natyrës për të provuar gjenitë njerëzore* (Belba 2018:398). Banorët e hershëm të Voskopojës sfiduan ashpërsinë klimatike me “*reshjet e borës që gjatë dimrit arrin deri në dhjetë pëllëmbë*” dhe ku “*më 28 gusht 1825, gruri mbeti pa u korrur*” (Adhami 1998:48).

Pasuria ujore e kësaj hapësire gjeografike shfaqet nga ujërat nëntokësore deri tek ato sipërfaqësore. Rrjeti lumor i hapësirës së qarkut të Korçës ka dendësi mbi mesataren e vendit dhe përshkohet nga rrjedhja e sipërme e lumenjve Shkumbin, Devoll e Osum (Qiriazi 1985:14).

Liqenet e Ohrit dhe Prespës nga sipërfaqja renditen në vend të dytë e të tretë në Ballkan. Liqeni i Ohrit përfaqëson një nga liqenet më të vjetra dhe me biodiversitetin më të lartë në Europë. Ai është

---

<sup>1</sup> Shënim: largësia e qytetit të Korçës nga bregdeti i Adriatikut është 121 km

shpallur *pasuri botërore natyrore* në vitin 1979( pjesa e ish-Jugosllavisë) dhe në korrik 2019 edhe pjesa shqiptare.

Pasuria liqenore plotësohet edhe nga liqenet akullnajore në malet e Shebenikut, Valamarës, Gurit të Topit, Gurit të Zi dhe Gramozit. Ato dallohen për përmasat e vogla dhe vlerat ekologjike e peizazhore (*Belba 2015:10*).

Liqenet artificiale të Banjës (14 km<sup>2</sup>) dhe Moglicës (7.2 km<sup>2</sup>) janë krijuar në kaskadën hidroenergjitike të Devollit, përkatësisht në vitin 2016 dhe 2020.<sup>1</sup> Ndërsa liqeni artificial i Gjançit (0.4 km<sup>2</sup>) ka funksion hidroenergjitik, rekreativ dhe për ujitjen e tokave bujqësore.

Zhvillimi human i kësaj treve nuk do të kuptohej pa pasuritë tokësore e bimore, që kanë ndihmuar sidomos në veprimtarinë bujqësore e blegtorale. Shumëllojshmëria e tokave dominohet kati i tokave të kafenjta, magneziale, që vijojnë në lartësi me tokat e murrme pyjore dhe ato livadhore-malore. Në luginat e gropat e RjL ka toka aluvionale, ndërsa në kënetat e dikurshme të bonifikuara, si e Maliqit, Buçimasit, fushën e Domosdovës gjenden tokat torfike. Ato janë një pasuri të madhe për zhvillimin e bujqësisë.

Bimësia është e pasur dhe e shumëllojshme, e zhvilluar sipas kateve. Shkurret mesdhetare shfaqen vetëm në pjesën P të luginës së Shkumbinit. Përhapje të gjerë ka kati i dushkut, mbi të cilin vendoset brezi i ahut dhe i halorëve, që formojnë pyje masive. Mbi 1600 m lartësi rritet bimësia e kullotave alpine.

---

<sup>1</sup> <https://www.monitor.al/investimet-ne-devoll-hec-moglices-kapacitet-sadyfishi-banjes/>

#### IV. Shpërndarja gjeografike e qyteteve në qarkun e Korçës sipas periudhave historike

Në Shqipëri historia e vendbanimeve fillon me ato prehistorike dhe prania e tyre dëshmohet nga gjetje të shumta arkeologjike. Vendbanimet e kësaj kohe ndërtoheshin me qëllimin për t'u mbrojtur nga kafshët e egra, nga i ftohti dhe për të ruajtur të sigurta rezervat ushqimore.

Klasifikimi i vendbanimeve shqiptare gjatë epokës së antikitetit është kryer nga prof. Muzafer Korkuti dhe Frano Prendi. Duke u nisur nga vendndodhja dhe shfrytëzimi i kushteve të terrenit vendbanimet mund të grupohen në tre tipa kryesorë: të hapura, shpellore dhe palafite (*Korkuti, Prendi 1992:21*). Vendbanimet në rajonin e Korçës, si p.sh., Treni, Maliqi, Dunavec, Podgorie, Kamniku, Barçi etj. u përkasin të tre këtyre tipave.

Gjetjet në vendbanimet arkeologjike në fushën grabenore të Korçës, Devollit, në Kolonjë e paraqesin zhvillimin human në nivel më cilësor krahasuar me trevat e tjera të vendit. Banorët neolitikë të këtij pellgu e bazonin zhvillimin e tyre ekonomik te bujqësia. Jeta e këtyre banorëve ishte e begatë dhe kjo duket nga *qypat me përmasa të mëdha të gjetura shpesh në gërmimet arkeologjike (Belba 2013:17)*.

Materialet arkeologjike në trevën juglindore tregojnë se krahas zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë mori zhvillim edhe metalurgjia prehistorike. Veglat e punës prej bakri të zbuluara në Kamnik (Kolonjë) janë të vetmet e këtij lloji të zbuluara deri më sot në Shqipëri. *“Numri i madh i stolive dhe shumëllojshmëria e formave të tyre ... tregojnë për praninë e prodhimit lokal të tyre dhe për ekzistencën e një veprimtarie metalurgjike dhe artizanale të mbështetura në një traditë të gjatë, fillimet e së cilës mund të ndiqen në këtë krahinë që në epokën e vonë të bronzit të ushtruara në punishte të organizuara mirë” (Andrea 1985:209)*.



Fig. 1. Vendbanimi prehistorik i Maliqit (Korkuti, Prendi 1992:10)

Rajoni ynë mund të konsiderohet si një vatër e rëndësishme e prodhimeve të bakrit dhe hekurit. Zbulimet e *“skorjeve të bakrit si dhe kallëpet prej guri, të zbuluara në shtresat eneolitike të Maliqit”* (Aliu 2006:4), kanë shërbyer për derdhjen e veglave dhe stolive dhe janë dëshmi e prezencës së kësaj metalurgjie, dhe njëherazi



edhe e niveleve të larta të zhvillimit të shoqërisë ilire të këtyre trevave.

Prodhimi i qeramikës gjatë neolitit të vonë realizohej në punishte me disa komplekse furrash si në Kamnik (Kolonjë). Ky fakt mund të konsiderohet unikal në Shqipëri dhe “përfaqëson një nga dukuritë kulmore të qytetërimit neolitik” (Aliu 2006:4). Arritje tjetër kulmore e neolitit është edhe “ekzistenca e marrëdhënieve të këmbimit të banorëve të rajonit tonë, madje, edhe me bashkësitë fqinje e të largëta egjeane” (Aliu 2006:4).

Diferencimi shoqëror tregon zhvillimin e lartë social të kësaj popullate. Gjithashtu dalja e akropolit si element arkitektonik urbanistik dëshmon për shtresëzimin shoqëror të elitës së fisit. *Tërësia e këtyre gjetjeve arkeologjike tregojnë se jo rastësisht ky rajon më parë se çdo njësi tjetër e Ilirisë kaloi në formacionin politik të Mbretërisë së Enkelejdhëve* (Belba 2013:18).

Mesjeta tregon se në territoret e Arbrit dy qendrat urbane më të rëndësishme ishin *Sellasfori* në zonën e Korçës dhe Gllavinica në Ballsh. Megjithëse burimet historike gjenezën e vendbanimit Korçë edatojnë rreth viteve 1280, qyteti mori zhvillim të shpejtë sidomos në mesjetën e vonë nga shek. XVIII (Gjata 2006:16).

Fillimisht, në mesjetën e hershme në qarkun e Korçës “*procesi i shthurjes së ekonomisë natyrore dhe forcimi i lidhjeve fshat – qytet përfundoi me shndërrimin e disa fshatrave në qytete që në shek. XVIII, siç qenë Llënga, Grabova, Niça, Nikolica, Dardha e Vithkuqi*” (Mile, 2001:19). Ndërsa Voskopoja “*arriti të shndërrohej në Metropolin tregtar të Epirit* (Pokëvili 2001:19), në qendrën më të rëndësishme urbane në gjithë hapësirën e Ballkanit Jugperëndimor. Djegia e shkatërrimi i Voskopojes (1769, 1772 e 1789) shtoi shanset e rritjes demografike e ekonomike të Korçës, që u shndërrua në një qendër të rëndësishme tregtare dhe artizanale nga fundi i shek. XIX. Ndikimi rajonal i Korçës u rrit fuqishëm dhe karvanët e

produkteve të saj drejtoheshin drejt Turqisë, Greqisë, Rosisë dhe Austrisë.

Fillimi i shek. XX u shoqërua me rritjen graduale të popullsisë urbane, por edhe me migrimin e lirë të banorëve të saj. Destinacioni i parë ishin vendet fqinje, si: Greqia, Vllahia (Rumania), Bullgaria, Maqedonia, por edhe qytetet e vendeve të Europës Perëndimore, deri në Amerikë dhe Argjentinë. Nga emigracioni korçarët sollën jo vetëm kapitale të shumta, por edhe idetë, vizionin e përvojën më të përparuar të shoqërisë në vendet më të emancipuara të kohës. *“Në këtë kohë pati një bum ndërtimesh në qytet dhe Korça mori fizionominë e një qyteti të rregullt, me plan urbanistik, rrugë të drejta e të shtruara me kalldrëme”*. (Turizmi Shqiptar 2005:5)

Qytete të tjera në këtë hapësirë gjeografike veç qytetit të Korçës janë edhe Leskoviku e Bilishti. Pogradeci mori statusin e bashkisë në vitet '30 të shekullit të kaluar, duke dalë mbi dominimin historik të Starovës.

## **V. Dinamika e rritjes së popullsisë dhe qyteteve në qarkun e Korçës**

Vendbanimet me nivelin më të lartë të urbanizimit gjatë mesjetës së vonë ishin Voskopoja dhe Korça.

Voskopoja arriti kulmin e zhvillimit të saj urban në shek. XVIII. Ajo shtrihej në një sipërfaqe prej 180 ha; kishte 14 lagje që lidheshin midis tyre prej 15 urash të ngritura mbi disa përrenj dhe lumin e Voskopojës; kishte 4 ujësjellës dhe 25 mullinj (*Adhami 1989:76*). Një nga treguesit më kuptimplotë për nivelin e urbanizimit dhe zhvillimit human është edhe numri i popullsisë. Vlerësimi i popullsisë voskopojsë varion nga rreth 40000 mijë banorë sipas rumunit V.Papahaxhi (Belba 2017:400), kurse

Weigand<sup>1</sup> thotë se: “uji nuk ka munguar as për 60000 banorë” (*Adhami 1989:76*). Voskopoja në shek. XVIII ishte qyteti më i madh i trojeve shqiptare, duke arritur një popullsi prej rreth 15 deri në 20000 banorësh (*Adhami 1998:38*). Sipas studiuesit grek Kurila<sup>2</sup> Voskopoja ka qenë qyteti më i madh në Ballkan pas atij të Selanikut, dy herë më i madh se Janina, në një kohë që Beogradi nuk ishte veçse një fshat i prapambetur dhe Athina një gërshtetim kasollesh të rrënuara rrëzë Akropolit, me popullsi 9-10 mijë banorë (*Adhami 1998:38*).

Ndërkohë, rritja demografike e qytetit të Korçës ishte shumë e shpejtë në fund të shek. XVIII, kur ajo u bë me 1300 shtëpi (*Shkodra, 1973: 295*), ose me 10000 banorë (*Thomo, 1988: 61*). Fuqizimi i vazhdueshëm ekonomik solli edhe shtimin e popullsisë së Korçës. Në vitet '20 – '30 të shek. XX, Korça në regjistrimin e vitit 1923 (saktësuar në vlerësimin e 1927), arriti të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë me 25.598 banorë (*Zavalani, 1928: CXXII*). Situata demografike e qyteteve të tjera në këtë periudhë (Shqipëria më 1927) ishte; Pogradeci dhe Bilishti kishin 2312 banorë secili dhe Leskoviku 2211 banorë (*Zavalani, 1928: CXXII*).

Politika demografike gjatë periudhës 1945 – 1991 ishte pronataliste. Ajo u karakterizua nga shtimi i lartë i numrit të përgjithshëm të popullsisë. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1989 tregon se popullsia urbane në rrethet Korçë<sup>3</sup>, Pogradec e Kolonjë ishte respektivisht 75109, 20123 dhe 7481 banorë, ose 34.4; 29.6 dhe 27.4 % të popullsisë të përgjithshme. Kjo hapësirë gjeografike dominohej nga popullsia rurale. Ritmet e urbanizmit ishin të

<sup>1</sup> Shënim A.B: G. Weigand e vizitoi Voskopojën në vitin 1889.

<sup>2</sup> Shënim A.B: E. Kurila është autor grek që ka shkruar për Voskopojën, ka lindur në fshatin Ziçisht (Devoll)

<sup>3</sup> Shënim: Popullsia urbane e rrethit Korçë në vitin 1989 përbëhej nga popullsia e qyteteve: Korçë, Bilisht dhe Maliq.

ngadalta, ndërkohë që në shkallë vendi 36.1 % e popullsisë jetonte në qytete.

Regjistrimi i fundit i popullsisë (2011) tregoi se popullsia urbane në qarkun e Korçës ishte 87,811 banorë, ndërsa ajo rurale 132,546 banorë. Pra popullsia urbane zinte 39.9% dhe ajo rurale 60.1%. Me gjithë intensitetin e migrimit demografik dhe flukseve migruese të brendshme e të jashtme, përsëri ruhet në dominancë ruraliteti. Kjo lidhet me traditën e pasur në agrokulturë dhe frutikulturë që ka rajoni juglindor, i cili shquhet për potencialin e lartë prodhues dhe cilësinë e kulturave bujqësore, si p. sh., gruri, molla, patatja, qepa, perimet etj.

Lëvizjet migruese të popullsisë në rajonin juglindor kanë ndikuar fuqishëm jo vetëm në numrin e përgjithshëm të popullsisë, por edhe në shfaqjen e uljes së nivelit të popullimit. Madje ka nisur procesi i braktisjes së vendbanimeve rurale apo edhe urbane, duke filluar nga zonat më malore dhe periferike të çdo bashkie të qarkut të Korçës. Migrimi në rajonin juglindor karakterizohet me lëvizjen monocentrike gravitative, pra drejt fshatrave dhe qyteteve në fushë, apo edhe në qendër të formave depresive të relievit në strukturat grabenore.

Modeli i lëvizjes rajonale është me kah të njëanshëm nga periferitë malore drejt qendrës ku vendosen: qyteti i Korçës, Pogradeci, Bilishti, Erseka. Ndërsa në nivel kombëtar shohim lëvizje policentrike të popullsisë. Të dyja këto modele janë në mënyrë konstante nën presion nga lloji i lëvizjes, i konsideruar si lëvizje e përkohshme.




Fig 3 Harta e arritshmërisë në qarkun e Korçës, B: (autorët)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë raport janë dy: tradita dhe arritshmëria. Arritshmëria ndikon me faktin se shumë qendra rurale janë shumë pranë qendrave urbane në kontekstin e shpërndarjes hapësinore, dhe kjo bën që ato të marrin të njëjtat

shërbime që ofrohen në zonat urbane për një periudhë të shkurtër kohore. Për nga pikëpamja funksionale qytetet e këtij rajoni karakterizohen nga veprimtaria e karakterit administrativ, me përjashtim të qytetit të Korçës i cili ofron larmi funksionale.

## **VI. Roli i faktorit ekonomik në shpërndarjen hapësinore të qyteteve në qarkun e Korçës**

Historikisht territori i qarkut të Korçës ka bërë pjesë në trevat me zhvillimin më të lartë të ekonomisë së kombit shqiptar. Baza e suksesit ka qenë harmonia funksionale e trinomit, potencial natyror, kapitali human dhe kapitali financiar. Popullsia e kësaj hapësire gjeografike, sidomos ajo urbane, ka ditur të orientojë zhvillimin human në tërësi dhe atë ekonomik me tregtinë, zejtarinë (apo industrinë) dhe shërbimet në veçanti.

Qytetet si Voskopoja e shek. XVIII dhe Korça gjatë shek. XX kanë dëshmuar jo vetëm fuqinë ekonomiko – financiare, por kanë arritur nivelet më të larta të zhvillimit human, përkatësisht: Voskopoja –në bërthamë civilizimi (*Belba. A 2017: 404*) dhe Korça –model zhvillimi (*Belba. A 2013:21*).

Aktualisht veprimtaria ekonomike në qarkun e Korçës shfaq tipare uniformiteti në zhvillimin lokal. Ekziston një ngjashmëri e lartë në zhvillimin human midis njësive fiziko – gjeografike: fusha grabenore e Korçës, gropës së Pogradecit dhe Kolonjës, si dhe luginës së Devollit të Sipërm.

Kjo ngjashmëri shkaktohet nga shpërndarja “gravitative” e popullsisë, e cila ka përcaktuar edhe karakterin e zhvillimit ekonomik. Relievi fushor dhe qendrat urbane lokalizohen në pjesën qendrore të çdo njësie fiziko – gjeografike. Përreth zonave fushore shtrihet relievi kodrinor dhe, më në periferi, ngritjet e fuqishme malore. Në këtë hapësirë dominon tipi rural i vendbanimit dhe sektori parësor i ekonomisë (bujqësi, blegtori, pylltari, bletari etj.). Në ndonjë rast si: në Rehovë (Kolonjë),

Lozhan (Korçë) Alarup, Çervenakë (Pogradec) dhe Bitinckë (Devoll) shfaqet edhe prania e industrisë nxjerrëse minerale. Blegtoria është veprimtaria kryesore, e fokusuar në mbarështimin e të imtave dhe më pak të gjedhëve. Paralelisht me të zhvillohen edhe pylltaria, apikultura dhe pemëtaria. Përgjithësisht në zonat më të thella malore pemëtaria ka karakter natyror, si p.sh. me kumbullat, arrat, por edhe pemëtari e kultivuar sidomos me mollën, hardhinë. Në bashkinë e Kolonjës, 4 njësi administrative nga 6 gjithsej, si: Novoselë, Mollas, Barmash kanë si strukturë funksionale simbiozën bujqësi – frutikulturë. Kurse njësia administrative Qendër Leskovik, përtej vreshtarisë e frutikulturës, ka në strukturën ekonomike edhe industri agropërpunuese, kryesisht në prodhimin e verërave. Struktura ekonomike ndryshon në zonat fushore, ku veprimtaria bujqësore dominohet prej drithërave, perimeve, drufrutorëve kryesisht në Devoll, Pogradec dhe pjesërisht në fushëgropën e Korçës.

Kalimi nga vendbanimet rurale periferike drejt qendrës ku lokalizohen përgjithësisht vendbanime urbane, shoqërohet me ndryshim cilësor të strukturës ekonomike. Në qytetet kryesore, si p.sh. në Korçë, mbizotëron industria e lehtë, tregtia, shërbimet dhe turizmi; në Pogradec struktura ekonomike përbëhet nga turizmi, peshkimi, shërbimet. Kurse në qytetet më të vogla, si Bilishti, përveç industrisë së lehtë e ushqimore, tregtisë e shërbimeve zhvillohet edhe veprimtari bujqësore, në Ersekë edhe përpunimi i drurit, në Leskovik prodhimi i verës, rakisë dhe vreshtaria. Kurse në qytete si Maliqi, Erseka, pas falimentimit të ekonomisë socialiste, funksioni i tyre urban është zbehur ndjeshëm, duke pasur vetëm funksion administrativ.

Hierarkia urbane e qarkut të Korçës dominohet nga qyteti i Korçës, që ruan ende një strukturë ekonomike më komplekse. Korça së bashku me qytetin e Pogradecit mbizotërojnë qendrat e tjera urbane. Tendencat aktuale të zhvillimit urban tregojnë rritje

për Bilishtin, por rënie të theksuar për Ersekën, Leskovikun dhe Maliqin.

Korça ruan ende tipare të zhvillimit industrial, por ka rënie të ndjeshme në krahasim me qytetet e tjera kryesore në pjesën perëndimore të vendit.

### **Përfundime**

Faktorët gjeografiko – natyrorë të qarkut të Korçës kanë ndikuar në:

- shpërndarjen hapësinore të vendbanimeve dhe sidomos të qendrave urbane,
- dendësinë e vendbanimeve, dhe
- zhvillimin sasior dhe cilësor të tyre, veçmas në qytetet ku Korça historikisht ka pasur rolin kryesor të zhvillimit rajonal.

Faktorët humanë me aspektin historik, demografik dhe ekonomik kanë ndikuar në:

- shpërndarjen hapësinore të vendbanimeve,
- popullsia e qarkut shpreh identitet të fortë rajonal, ku filantropia dhe solidariteti kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social-kulturor të vendbanimeve, sidomos të qyteteve,
- lulëzimin e qyteteve të Sellasforit, Voskopojes dhe Korçës deri në nivelin e qendrave kulturore (Korça e shek. XX) dhe bërthamave të civilizimit (Voskopoja e shek. XVIII).

### **Rekomandime**

• Të hartohen strategji efektive për të ulur në maksimum nivelin e emigrimit dhe për ruajtjen e vendbanimeve të qarkut të Korçës nga braktisja.

• Të rikthehet decentralizimi i shërbimeve direkte për banorët pranë vendbanimit.

• Të mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë lokale, sipas peshës së sektorëve ekonomikë dhe për secilin prej tyre



(bujqësi-blegtori, industria agropërpunuese, sektori dytësor dhe ai tretësor).

- Të hartohet një strategji rajonale për të vendosur në harmoni prodhimet dhe shërbimet që ofrojnë të gjitha njësitë administrative të qarkut të Korçës në tregun kombëtar dhe atë ballkanik.

- Të forcohet identiteti lokal përmes ruajtjes së trashëgimisë kulturore, historike, materiale e shpirtërore të transmetuar brez pas brezi.

- Të mbrohen vlerat e jetës qytetare duke i ekspozuar si një produkt turistik në nivel marke.

### Literatura

Adami, J., (1983), *Rrugë dhe objekte arkeologjike në Shqipëri*, Shtypshkronja e Re, Tiranë

Adhami, S., (1989), *Voskopoja*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë.

Adhami, S., (1998), *Voskopoja dhe Monumentet e saj*, Shtypshkronja INFOBOTUES, Tiranë.

Aliu, S., (2006), *Kërkimet e studimet arkeologjike në Shqipërinë Juglindore dhe vlerat e tyre në fushën e prehistorisë*, Mali Pleshti, Tiranë

Belba, A., (2013), *Gjeografia e Sektorit Terciar në Rajonin e Korçës*, Disertacion, Tiranë.

Belba, A., (2015), *Rajoni Juglindor i Shqipërisë*, dorëshkrim, Tiranë,

Belba, A., (2017), *Geopolitical Assessment Of Cultural Diffusion In The Moscopole (Voskopoja) Of The XVIII Century*, Veliko Tarnovo, Bulgaria.

Grup autorësh, (1991), *Gjeografia Fizike e Shqipërisë II*, Botim i Akademisë së Shkencave e R.P.SH, Tiranë

Gjata, A., (2006), *Mbi themelimin e Korçës*, Korçë

Hofrat Dr. Karl Patsch, (1923), *Ilirët*, Shtypshkronja Nikaj, Tiranë

INSTAT, (2011, 2012,) *Censusi i popullsisë dhe banesave* Tiranë

INSTAT, (2011, 2013), *Censusi i popullsisë dhe banesave* Korçë Tiranë

Kasatkina, S., (2015), *Russian City as a Philosophical Category of Urban Studies*, Published by Elsevier Ltd,

Korkuti, M., Prendi, F., (1992), *Forma dhe struktura të vendbanimeve neolitike dhe eneolitike në Shqipëri*, Iliria, vol. 22.

Lera, P., (2006), *Raporti i ekspeditës shqiptaro – franceze*, Korçë,

Mile, L., (2001), *Zejtaria fshatare shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare*, Marin Barleti, Tiranë,

Misyurov, D., (2019), “*Problemet filozofike të shkencave natyrore*”, Universiteti shtetëror i Moskës i Gjeodezisë dhe Hartografisë,

Plasari, A., (2000), *Fenomeni Voskopojë*, Tiranë, PHOENIX,

Pokëvili, (2001), *Udhëtim nëpër Shqipëri*, Tiranë,

Qiriazi, P., (2001), *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, Afërdita, Tiranë,

Qiriazi, P., (1985), *Morfologjia dhe morfogjeneza e Gropave Juglindore dhe e maleve përreth tyre*, Monografi, Tiranë.

Selenica, T., (1928), *Shqipëria në 1927, e ilustruar, vëllimi i 2-të*, Tiranë

Skënderi, F., Hamiti, R., (2019), *Karakteristikat Ekonomike-Gjeografike të Komunikacionit Hekurudhor në Republikën e Maqedonisë*, Studime Gjeografike 20, Shtypur Jupiter Group, Tiranë

Shkodra, Z., (1973), *Esnafet Shqiptare*, Tiranë,

Turizmi Shqiptar, (2005), *Korça e Serenatave*, Nr 12,

Thomo, P., (1988), *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura*, Tiranë,

Andrea, Zh., (1985), *Kultura ilire e tumave në pellgun e Korçës*, Tiranë

<https://www.monitor.al/investimet-ne-devoll-hec-moglices-kapacitet-sa-dyfishi-banjes>

## **PANELI IV**

# **FUNKSIONET, ZHVILLIMET DHE TIPOLOGJIA E VENDBANIMEVE NË NJËSI ADMINISTRATIVE NË SHQIPËRI**



**Prof. dr. Skënder Sala<sup>1</sup>**

## **NATYRA DHE VENDBANIMET NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TË BALDUSHKUT**

### **Abstrakt**

Për gjeografët është tërheqës mjedisi gjeografik rural. Banorët kanë lidhje historike me këtë mjedis. Në vartësi të kushteve e burimeve natyrore, janë vendosur dhe vendbanimet. Shkëmbinjtë terrigjenë, relievi kodrinor, klima, bimësia kanë qenë përcaktues në zgjedhjen e ndërtimit të vendbanimit: për jetesën, bujqësinë, blegtorinë. Banimi është i hershëm: kalatë pranë Petrelës, Bodinit, Vrapit, qytezat e Dorëzisë, Përsqopit, gjetjet arkeologjike në Koçaj etj. Territori përshkohej nga degëzime të rrugëve që e lidhnin me Durrësin dhe Elbasanin. Tradita mesjetare e vendosjes së vendbanimeve në kodra është ruajtur deri vonë. Gjatë mesjetës pasiguria ishte faktor kryesor në vendosjen e fshatit. Më pas, banorët iu japin përparësi kushteve natyrore: ujit, dritës, ngrohtësisë, tokës e kullotës. Sot pjesa më e madhe e tyre janë të ekspozuar gjatë ndaj dritës dhe ngrohtësisë së diellit. Zgjerimi i vendbanimit është bërë gradualisht: ekonomia e popullsia. Nga shekulli XIV, shtëpitë afrohen drejt qendrave, objekteve të kultit, luginave. Rol luan popullsia që vjen për arsye të ndryshme. Lejohej vendosja në periferi të fshatit. Para 30 viteve, banorët ruajtën moszënieën e tokës prodhuese me ndërtime. Më pas situata përmbysset, banorët largohen drejt luginave e pranë Tiranës: gati braktisen toka, bujqësia, blegtoria, shtohen problemet mjedisore (degradimi, rrëshqitjet, erozioni, dëmtimi bimësisë, ekonomike e sociale). Fshatrat Vrap, Shpat i Sipërm, Shënkoll, Parret, Kakunjë kanë më pak banorë krahasuar me 1990. Ata përgjatë Zhullimës janë zgjeruar në tokën më pjellore, popullsia është rritur, veprimtaria e ekonomike po rritet gradualisht, struktura bujqësore ka ndryshuar etj. Është koha e rivlerësimit të burimeve natyrore: zhvillimi i qëndrueshëm, natyra, banorët, afërsia me Tiranën.

---

<sup>1</sup> *Gjeograf*

*Fjalë çelës: Natyrë, territor, burime natyrore, vendbanim, degradim, përdorim, rivlerësim*

### **Abstract**

For geographers the rural geographical environment has become attractive. The inhabitants who live and work there they have historical connection with this environment. Depending on the conditions and natural resources, settlements are located. Terrigenous rocks, hilly relief, climate, vegetation have been determined in the choice of settlement construction: for living, agriculture, livestock activities. The habitation of this territory is quite early: the fortresses near: Petrela, Bodini. Vrap, the towns of Dorëzi, Përsqop, archeological findings in Koçaj, etc. The territory is crossed by branches of roads that connected it with Durrës and Elbasan. The medieval tradition of settling in the hills has been preserved until recently. During the Middle Ages insecurity was a major factor in the settlement of the village. Residents then give priority to natural conditions: water, light, warmth, land and pasture. Today most of them are long exposed to sunlight and heat. The settlement expansion done gradually according: the economics of the population. From the 14th century, houses approached the centers, places of worship, valleys. The population that comes for different reasons plays a role. Placement on the outskirts of the village was allowed. 30 years ago, the inhabitants maintained the non-use of the productive land with constructions. Then the situation reverses, residents move to the valleys near Tirana: land, agriculture, livestock are almost abandoned, environmental problems: degradation, landslides, erosion, vegetation damage, and economic-social. The villages of Vrap, Shpat i Sipërm, Shënkoll, Parret, Kakunjë have several times less inhabitants compared to 1990. They have expanded to more fertile land long Zhullima, the population has increased, economic activity is gradually increasing, the agricultural structure has changed, etc. It is time to re-evaluate natural resources: sustainable development, nature, inhabitants, proximity to Tirana.

*Keywords: Nature, territory, natural resources, habitat, degradation, use, revaluation*

## **I. Hyrje**

Prej kohësh gjeografët shqiptarë kanë dhënë ndihmesë të dukshme në studimet fiziko-gjeografike, por ato për vendbanimet janë të pakta. Është koha që të dytat të marrin rëndësinë si në

vendet e zhvilluara. Teknologjia e sotme e komunikimit lehtëson njohjen e përvojave. Për ne ka rëndësi kjo njohje. Zbatimi bëhet në terrenin tonë konkret. Për herë të parë gjeografët organizuan veprimtarinë shkencore për natyrën e vendbanimet (dhjetor 2021). Pjesëmarrja e studiuesve të tjerë tregoi interesin e madh për këtë drejtim studimi. Mundësitë për studime cilësore janë, por duhen mjetet financiare për t'i realizuar. Prania e madhe e vendbanimeve rurale në vendin tonë, veprimtaria në shekuj e popullsisë mbi territorin ku jeton e banon, eksodi i madh rural në 30 vitet e fundit mjaftojnë për të kuptuar rëndësinë e këtyre studimeve. Në dobi të këtij qëllimi është edhe ky artikull. Ai bën vlerësimin e pasurive natyrore në njësinë administrative të Baldushkut: ndërtimin gjeologjik, karakteristikat morfologjike dhe gjeomorfologjike të relievit, treguesit kryesorë klimatikë, rrjetin hidrografik, tipat gjenetikë të tokave dhe bimësinë natyrore. Vlerësimi dhe analiza japin gjendjen e cila ka qenë dhe mbetet shumë e lidhur me veprimtarinë bujqësore e blegtorale të banorëve të fshatrave të shumta. Kjo veprimtari ka ardhur gjithnjë në rritje, duke krijuar dhe shqetësime, probleme në mjedisin gjeografik. Njëherazi, i jepet rëndësia e duhur vendndodhjes së vendbanimit, i cili është aty i kushtëzuar shumë nga burimet natyrore sa më të mira e më pranë tij. Në këtë territor shprehet qartë lidhja natyrë-vendbanim, kujdesi dhe moskujdesi i banorëve në përdorimin e tokës, bimësisë, ujërave etj. Për aq sa është e mundur sot për të dhënat statistikore, jepen shifra për numrin e popullsisë, duke shënuar se lëvizja mekanike e popullsisë nga fshatrat e kësaj njësie administrative është e dukshme. Veçohen fshatrat më kodrinore për 30 vjeçarin e fundit. Eksodi është shoqëruar dhe me rritje të proceseve gjeomorfologjike, degradimit të tokës, me probleme mjedisore, social-ekonomike. Vendndodhja e këtyre banorëve pranë kryeqytetit, burimet natyrore-njerëzore mundësojnë pakësimin e

dukshëm të eksodit rural, zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit rural, rritjen e mirëqenies së tyre.

## II. Metoda

Në studimet për përdorimin e territorit rural nga popullsia banuese, por jo vetëm, bëhet e domosdoshme njohja e saktë e burimeve natyrore dhe atyre njerëzore dhe rivlerësimi i tyre. Natyra dhe popullsia në këto vendbanime kanë lidhje-varësi shekullore midis tyre. Analiza e kësaj lidhjeje kërkon zbatimin e disa metodave. Në rastin tonë janë përdorur ato të vëzhgimit të drejtpërdrejtë të terrenit (gjendja dhe ecuria e mundshme e proceseve gjeomorfologjike, demografike, ndikimet e veprimtarisë ekonomike të njeriut në to, pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike etj.), hartografike (shtrirja sipërfaqësore territoriale e vendbanimeve dhe proceseve gjeomorfologjike, zgjerimi i tyre etj.), analizës (lidhja komplekse e faktorëve natyrorë me vendbanimet, veprimtarinë ekonomike të banorëve, faktorët, pasojat mjedisore, gjendja e elementeve kryesore mjedisore-ekonomike, prirja e zhvillimit të tyre, rivlerësim i burimeve natyrore dhe njerëzore për rritjen e mirëqenies, pakësimin e largimit të banorëve nga fshati, zhvillimin ekonomik duke respektuar, mbrojtur natyrën etj.

## III. Pozita gjeografike

Njësi administrative e Baldushkut u krijua me ndarjen territoriale të viti 2014: Qarku, prefektura e bashkia e Tiranës (Sala, etj. 2021). Zë pjesën jugore-juglindore të bashkisë. Ka 14 fshatra: Baldushk, Mumajës, Fushas (Ballhaxhias), Ballshaban, Shpata, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunjë, Veski (Vesqi), Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat dhe Shpat i Sipërm. Është pjesë e Ultësirës Perëndimore: pjesa veriore e malësisë së Kërrabës



(Kolektiv autorësh, 1991). Me Kërrabë gjeografët përfshijnë territor më të gjerë se ai etnografik: midis luginave Shkumbin-Erzen; fushës së Kavajës-luginës së Kushes-Qafë Kërrabë-Gryka e Murdarit (Zallit). Ndodhet 15 km larg nga kryeqyteti. Kufizohet me fshatrat: Vishnjë, Arbanë (veri), Galush e Hasjok (jug), Lugë, Shalqizë, Durisht, Petrelë (lindje), Çaus, Dorëz, Grecë, (perëndim), Cacabezë, Bodin, Gracen (juglindje). Ka sipërfaqe 112.88 km<sup>2</sup> (10.16% të sip. së bashkisë Tiranë) e 5540 banorë (2021). Pozicioni gjeografik mundëson lidhje të shpejtë me malësinë e Tiranës, kodrat e Kërrabës, fushat e Durrësit, Tiranës (luginat e Shkumbinit, Erzenit, Pezës). Falë pozicioni gjeografik, përshkohej dhe ishte pranë rrugëkalimeve të hershme (Egnatia etj.). Relievi luginor-kodrinor lehtësonte kalimin, lidhjen e vendbanimeve të rëndësishme të hershme brenda e pranë, lidhje-komunikim në të gjitha drejtimet. Rruga kryesore e hershme ishte Vromi: rruga (ruhet toponimi): gjurmë në luginën e Zhullimës etj. Sot i ka zgjeruar këto lidhje: shumë pranë rrugës Tiranë-Ndroq-Durrës, autostradave Tiranë-Durrës, Tiranë-Elbasan, kryeqytetit të Shqipërisë: Tiranës, aeroportit të Rinasit, hekurudhës Durrës-Shkodër, lidhje e shpejtë me Korridorin VIII (Elbasan etj.). Ai iu ka mundësuar banorëve kushte natyrore shumë të mira për jetesën dhe zhvillimin ekonomik. Ky pozicion në të ardhmen pritet të jetë më shumë dobiprurës për zhvillimin e kësaj njësie. Afërsia me qytetin e Tiranës, ku gjendet popullsia dhe zhvillimi më i madh ekonomik i vendit, krijon kushte shumë të mira për banorët: rol të ndjeshëm në furnizimin e tregut me prodhime bujqësore dhe blegtorale, të ngrenë infrastrukturën e nevojshme (turizmi rural), ku popullsia e kryeqytetit të gjejë mundësi të shëtisë në natyrë, të kalojë ditën apo fundjavën, të shijojë prodhimet bio në gastronominë lokale etj. Tashmë është koha e rivlerësimit të tyre për përdorim më efektiv e sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Patjetër që këto zhvillime kërkojnë edhe më shumë

rrugë të mira brenda territorit, lidhjen e tij me fqinjët e më gjerë. Komunikimi i shtuar do t'i shërbejë drejtpërdrejt turizmit rural, qarkullimit të njerëzve, mallrave, traditave dhe të kulturave: ata marrin e japin me popullsinë urbane. Kështu mundësohet dhe përmirësimi i mirëqenies së banorëve, kufizimit të eksodit rural etj.

#### **IV. Kushtet natyrore**

Kushtet natyrore kanë rol shumë të rëndësishëm në vendzgjedhjen e vendbanimeve. Janë të domosdoshme për kushtet e jetesës dhe mundësisë së zhvillimit të veprimtarisë ekonomike të banorëve. Me to lidhen pasuritë natyrore më kryesore. Pothuajse kudo në territoret rurale kodrinore, tri kanë qenë kushtet natyrore kryesore që kanë kushtëzuar vendzgjedhjen e vendbanimit. Kështu ka ndodhur në territorin e njësisë administrative të Baldushkut. Relievi, klima, tokat, bimësia kanë qenë faktorët më kryesorë. Patjetër, të gjithë këta janë vlerësuar të lidhur drejtpërdrejt me burimet ujore: elementin jetësor natyror. Në vijim do të trajtohet secili prej tyre veçmas, por i lidhur e varur dhe nga faktorët e tjerë.

##### **IV.1. Ndërtimi gjeologjik**

Zhvillimi gjeologjik në territorin në studim dhe rreth tij është bërë në kuadër të Ultësirës Perëndimore. Kjo ka ndodhur disa dhjetëvjeçarë më parë (*Kolektiv autorësh, 1991*). Sipas zonimit tektonik të Shqipërisë, territori i kësaj njësie administrative (dhe ai përreth) përfshihet në Zonën Tektonike Jonike. Studimet gjeologjike kryesore janë ato në vitet '80 të shekullit të kaluar. I kësaj kohe është pusi i shpim-kërkimit në Rovë i cili dha sqarime të plota për ndërtimin strukturor-litologjik (*Bezerjani, et al, 1986*). Falë këtyre studimeve mundemi të paraqesim zhvillimin

strukturor-gjeologjik të territorit. Në vijim jepen strukturat kryesore gjeologjike, ndërtimi litologjik, sepse ato kanë rol shumë të madh në format e relievit, proceseve të jashtme modeluese etj. *Antiklinali i Rovës*: përfshin territorin kodrinor të fshatrave Koçaj-Shpat-Isufmuçaj-Mumajës-kodra e Gjelit (Arbanë, etj.). Ka kontakt tektonik (*Leka, Nocka, 1981*) me sinklinalet e Tiranës (kodrat e Petrelës etj.), Vrapit (Baldushk, Vrap etj.). Pjesa më veriore e këtij antiklinali ka kontakt tektonik me strukturën antiklinale të Fortuzit (*Xhafa, etj., 1976*). Ndërtohet nga shkëmbinjtë flishorë (Pg): ranorë, argjilorë, alevrolitorë dhe konglomeratë. Këta shkëmbinj shtrihen më shumë në territorin e kësaj njësie administrative. U formuan kur deti zinte këto dhe territoret përreth. Këtu depozitoheshin materialet e ngurta, llumrat që sillnin lumenjtë e përrenjtë që ishin në lindje të tij. Këta shkëmbinj dalin në sipërfaqe në territorin Kodra e Gjelit-Rovë-Shpat-Koçaj etj. Më vonë ngritja e territorit bëri që deti të tërhiqet. Në këtë periudhe gjeologjike ishin mjaft të zhvilluara bimët, gjitarët, shpendët etj.: në tokë dhe ujë, por jo ata primatë prej nga mund të vinte njeriu.



Foto 1. Shkëmbinjtë flishorë të sinklinalit të Vrapit.

Gjatë paleogjenit edhe territori në perëndim të kësaj strukture ishte mbuluar nga deti. Këtu ishte formuar sinklinali i Vrapit: vazhdonte drejt Pezës dhe Shijakut (*Bezerjani, et al, 1986*). Shkëmbinjtë e kësaj moshe përfshijnë territorin në lindje të Vrapit drejt Baldushkut dhe Arbanës. Gjatë neogjenit pjesa më e madhe e tij në perëndim u fundos. Deti i Tortonianit depërtoi thellë deri në fshatin Vrap etj.: kjo dëshmohet me shkëmbinjtë ranorë, konglomeratë, argjilorë etj. Territori i sotëm më në lindje të kodrave të Vrapit është formuar mbi bërthamën e *ngritjes antiklinale të Vesijës (Veqisë)*. Ka shkëmbinj ranorë të çimentuar me lëndë karbonatike, argjila dhe alevrolite (Pg). Në sipërfaqe del mirë nga Vesija në Bajzë (*Xhafa, et al, 1976*). Edhe pjesa juglindore e territorit të kësaj njësie administrative ndërtohet nga shkëmbinjtë flishorë të sipërpërmendur, por ndërtojnë pjesën veriore të *sinklinalit të Cacabezës*. Në sipërfaqe, duket në territoret e fshatrave Kakunjë-Lug Shalqizë e drejt veriperëndimit (*Xhafa, et al, 1976*). Duket se dalja e gjerë në sipërfaqe e shkëmbinjeve argjilorë-alevrolitorë është faktor për prani të gjerë të proceseve të erozionit sipërfaqësor.

Shkëmbinjtë sipërfaqësorë flishorë të paleogjenit zënë sipërfaqen më të madhe territorit. Më shpesh del pakoja argjilo-alevrolitore, sidomos në kodrat: Ballhaxhias-Bajzë, Vesijë-Shënkoll, Kakunjë-Mustafakoçaj. Këtu është numri më i madh i vendbanimeve. Shkëmbinjtë ofrojnë më shumë mundësi përdorimi për rritjen e tokës së punueshme etj. Midis tyre kanë shtresa ranore me trashësi të ndryshme që kanë gjetur përdorim në ndërtimin e shtëpive, mureve të oborreve, ledheve antierozive etj. Po kështu, por më pak, dhe ai konglomerat: dalin në sipërfaqe në kodrat e Rovës, Shpatit në veri të Fushasit (kodra e Gjelit-Arbanë). Të paleogjenit janë dhe prania e kufizuar e shkëmbinjeve gëlqerorë të eocenit: Sharra e Vrapit, kodra e Korbit etj. Ata janë përdorur dhe për prodhimin e gëlqeres. Në kodrat e Vrapit-Shpat

i Sipërm në sipërfaqe dalin shkëmbinjtë molasikë të neogjenit: kati tortonian (*Kolektiv autorësh, 1983*). Ranorët janë shtresëtrashë, të çimentuar mirë me lëndë karbonatike. Janë përdorur nga banorët për ndërtimin e shtëpive. Shkëmbinjtë argjilorë dhe alevrolitorë kanë pasur përdorim në prodhimet qeramike: tjegulla për mbulimin e çative të shtëpive etj. Aty-këtu, për këtë qëllim janë përdorur dhe llumrat argjilorë të depozitimeve të kuaternarit në luginën e Zhullimës. Këto depozitime përfaqësohen nga rëra, surëra, argjila, suargjila, zhavorre. Shtrirjen më të madhe e kanë në luginën e Zhullimës. Mbizotërojnë argjilat e suargjilat, ndaj kanë përdorim të paktë për inerte. Në zallishte ka popla, zaje (me diametër 10-15 cm) që gjatë verës merren nga banorët e përdoren në ndërtim, shtrim të oborreve, rrugicave etj.

#### **IV.2. Relievi**

Veçoritë e relievit janë të lidhura me kushtet natyrore: ndërtimi strukturor-litologjik dhe klima kanë rolin më kryesor. Morfologjia e relievit përfaqësohet nga kodrat dhe luginat. Lartësitë janë nga 120-130 m (lugina e Zhullimës) në 679 m (Sharra e Qytetit në Vrap). Janë mbizotëruese ato 200-250 m. Relievi ka copëtim të vogël vertikal e të lartë horizontal, prani të gjerë të proceseve gjeomorfologjike të shpatit. Luginat kryesore kanë formë relativisht të gjera, elemente gjeomorfologjike lumore të shprehura disi mirë, prani të proceseve gjeomorfologjike, të veprimtarisë së banorëve në shpate. Kodrat kanë formë vargu. Ruajnë drejtimin e strukturës gjeologjike ku ndodhen. Dallueshëm janë vargjet kodrinorë Shënkoll-Vrap-Dorëz dhe Koçaj-Shpat-Rovë-Kodra e Gjelit. Më poshtë japim veçoritë më kryesore morfologjike e gjeomorfologjike të tyre. Vargu Shënkoll-Vrap-Dorëz përfshin gjithë territorin perëndimor të njësisë administrative Baldushk. Formohet në krahun lindor të sinklinalit të Vrapit dhe ngritjen e Vesijës. Këtu janë lartësitë më të mëdha të

relievit: Sharra e Qytetit, 679 m. Kurrizi kodrinor më shpesh ka formën e kreshtës, sidomos pjesa jugore e tij: dallohet shumë qartë falë pranisë së shkëmbinjve gëlqerorë eocenikë (Shënkoll-Vrap). Këtu, pjesa lindore e kreshtës është rrëpirë shkëmbore: lartësi mesatare mbi 10-12 m. Përgjatë kurrizit janë disa maja: dallojnë ato të malit të Rmushit (572 dhe 561 m), Sallavakut (655 m), Sharra e Shtetezës (639 m), Polloshit (511.3 m).



Foto 2. Pjesa verilindore e kodrave të Vrapit. S. Sala

Kurrizi kodrinor ndërpritet nga disa qafa, ku veçojmë: qafën e Shënkollit, 470 m lartësi mbidetare (e ndan me kodrat e Galushit, lidh fshatin Vrap me luginën e Zhullimës së Vogël); të Vrapit, 490 m (lidh Vrapin me Sharrën e Qytetit); të Kumonës, 480 m (lidh Vrapin me Mustafakoçaj); Rushit (lidh luginat e Pezës e Zhullimës), Grorit, Belbës etj. Në qafat e Kumonës dhe Shënkollit kalojnë rrugë automobilistike rurale, ndërsa në të tjerat, kryesisht rrugët këmbësore. Meqenëse relievi formohet në krahun lindor të

sinklinalit të Vrapit, shtresat shkëmbore bien në perëndim, kryesisht 20-30° (*Kolektiv autorësh, 1983*). Luginat e Zhullimës (L) dhe Pezës (P) kushtëzojnë uljen e lartësive në këto drejtime. Ndërthurja e shtresave me shkallë qëndrueshmërie të ndryshme ndaj erozionit mundëson prani të shumë maja kodrash, më shpesh në shkëmbinjtë ranorë. Relievi ka shkallëzime morfologjike: përfaqësojnë kuestet, relativisht të shprehur. Në territorin e fshatit Vrap është gati qendra e sinklinalit, në sipërfaqe del pakoja e shkëmbinjve argjilorë (*Bezerjani, et al. 1986*). Ajo mundëson sipërfaqen e tokës së punueshme më të mirë të Vrapit. Shpati lindor i kurrizit ka shkallë të vogël deri mesatare të copëtimit vertikal: mbizotërojnë vlerat 130-250 m/km<sup>2</sup>. Për copëtimin horizontal shtrirjen më të madhe e kanë vlerat mesatare dhe të larta: 3-5 m/km<sup>2</sup> (*Sala, 2005*). Në mjaft sektorë vlera janë më të larta: pranë Vesijës, Baldushkt, Ballhaxhiasit, Ballshabanit, Mustafakoçajt. Këtu, në sipërfaqe dalin shkëmbinjtë argjilorë-alevrolitorë, por ndikon dhe keqpërdorimi i tokës e bimësisë nga banorët. Ka numër të madh rrjedhjesh ujore sipërfaqësore. Ato janë shpesh janë të thata, tipike baltore. Krahas faktorit litologjik, pjerrësisë së shpateve, rrjedhjet ujore kanë ndihmuar shumë në zhvillimin e proceseve gjeomorfologjike të shpatit: rrëshqitjet, erozionin etj. Në luginat e përrenjve, në skarpatën e rrugëve rurale ka mjaft rrëshqitje, kryesisht të vogla. Në veriperëndim e perëndim të Vrapit përmasat e tyre rriten: mbi 30-40 m gjatësi, mbi 10 m gjerësi. Ndikimi në morfologjinë e shpatit, në mbulesën e tokave, bimësisë është i dukshëm. Nuk mungojnë rastet e bllokimit të rrugës Mustafakoçaj-Vrap në dimër. Në fshatin Shpat i Sipërm rrëshqitjet u riaktivizuan në brezaret e mbjella me qershi (pas 1980). Shtrirje të gjerë kanë vatrat e erozionit. Dallojnë territoret ku në sipërfaqe dalin pakot e shkëmbinjve argjilo-alevrolitorë. Veçojmë pellgjet ujëmbledhëse të përrenjve të Fushasit, Hijes, Polloshit, Baldushkut, Bajzës,

Shelëzit, Vesijës, Lashtës etj. Gjatësia e tyre më e madhe e pandërprerë arrin mbi 250 m, ndërsa gjerësia mbi 30-40 m. Terreni është degraduar deri në shkretëtirizim. Ka rol të ndjeshëm faktori njeri: prerja e bimësisë në shekuj. Gjatë verës materiali argjilor thahet, plasaritet, shkrifërohet shumë dhe gërryhet lehtësisht me fillimin e shirave të vjeshtës. Përrenjtë transportojnë sasi të madhe materiali të ngurtë.

Vargu i dytë kodrinor Koçaj-Shpat-Rovë etj. përfshin kodrat në të djathtë të luginës së Zhullimës. Në jug, lugina e Zhullimës së Madhe e ndan nga ato të Kakunjës, ndërsa gryka e Zhullimës (Fushas) e ndan nga kodra e Gjelit-Arbanë. Relievi është formuar në strukturën antiklinale të Rovës. Pjesa verilindore e këtij vargu kufizohet me luginën sinklinale të Zaranikës, ndërsa ajo lindore ndahet me shkëputje tektonike me kodrat e Petrelës-qafa e Kaçalitës. (*Leka, Nocka, 1981*): sinklinali Tiranës. Lartësitë më të vogla janë në pjesën veriore të luginës së Zhullimës (100 m). Pak më në juglindje të fshatit Shpat është lartësia më e madhe mbidetare: shkëmbi i Korbit: 554.9 m. Relievi është formuar në shkëmbinjtë flihorë të paleogjenit. Pjesa veriore dhe qendrore mbizotërohet nga dalja në sipërfaqe e atyre ranorë e konglomeratë. Përreth majës më të lartë të këtij vargu, i cili njihet dhe me emrin mali i shkëmbit të Korbit, dalin dhe gëlqerorët eocenikë. Në pjesën jugore dalin dukshëm në sipërfaqe shkëmbinjtë argjilorë e alevrolitorë. Një pjesë e tyre i përkasin pjesës periklinale veriore të sinklinalit të Cacabezës (*Xhafa, et al, 1976*): territori më i degraduar në njësinë administrative të Baldushkut.





Foto 4. Tarraca e parë e Zhullimës në Baldushk.

Ulja e lartësive drejt veriperëndimit lidhet me zhytjen e strukturës gjeologjike në këtë drejtim (maja e Lajthisë, më e larta, 313 m), ndërsa ajo në veri me sinklinalin e Zaranikës. Veprimtaria e përroit të Zhullimës dhe asaj të Madhe kushtëzon uljen e lartësive në perëndim dhe jug. Në lindje faktor bëhet edhe kontakti tektonik me sinklinalin e Tiranës. Në relief ka shkallëzime morfologjike për shkaqe litologjike: shprehje dobët e kuesteve, të cilat përfaqësojnë majat e kodrave në shkëmbinjtë ranorë, konglomeratë, gëlqerorë.

Copëtimi vertikal i relievit arrin deri 250 m/km<sup>2</sup>. Deri mesatare është dhe ai horizontal, por në territoret e degraduara e dezertifikuara vlera mbi 5-7 km/km<sup>2</sup> (Sala, 2005). Veçoritë gjeomorfologjike të këtij vargu janë shumë më të zhvilluara se në të parin. Proceset gjeomorfologjike të shpatit kanë shtrirje sipërfaqësore të dukshme, sidomos vatrat e erozionit. Dallojnë ato në pjesën jugore: Shpat-Mustafakoçaj, Koçaj-Tavaren etj. Në të parin, me ndërprerje të vogla, sipërfaqja e degraduar arrin gjatësinë mbi 1 km e gjerësinë mbi 300 m. Midis dallon maja

ranor-konglomeratike: 304 m. Ka numër të madh përroskash, përrenj të shkurtër e baltorë. Sipërfaqe e dezertifikuar është e madhe. Banorët i emërtojnë bokërrima. Këtu duket qartë kombinimi faktorëve natyrorë dhe njerëzorë në formimin e tyre. Prej vitit 2002 janë shpallur monument natyre (*Qiriazhi, Sala, 2007*). Po kështu në Koçaj-Tavaren, ndonëse përmasat janë disi më të vogla. Pellgjet ujëmbledhëse të përrenjve të Margës e Gurrës kanë shkallë të lartë degradimi e dezertifikimi: kushtëzuar dhe nga trysnia e popullsisë në kushte natyrore të përshtatshme. Këta përrenj në dimër dhe gjatë shirave të rrëmbyeshme bëhen tipikë baltorë. Po kështu dhe përroi i Ballalliut etj. (Zhullimë e Madhe). Në të dyja rastet, në vatrat e erozionit, buzët anësore kapen vazhdimisht nga rrëshqitje, shembje që rrisin sipërfaqen e degraduar. Rrëshqitjet në shpatet e skarpatin e rrugëve rurale janë të konsiderueshme. Mbizotërojnë ato me përmasa të vogla, por ka dhe me gjatësi mbi 100 m e gjerësi deri 10-15 m: p.sh. në lindje të kodrës së Lajthisë, në perëndim të Mumajësit, në lindje të kodrës së Gjelit, Alltatë, Tavaren etj. Në skarpatin e rrugëve rurale dallojnë rrëshqitjet në rrugën Petrelë-Rovë-Isufmuçaj. Në terren ka mjaft ngastra toke të punueshme të degraduara në 40-50 vitet e fundit. Proceset gjeomorfologjike janë shtuar dukshëm në 30 vitet e fundit: eksodi rural mbetet faktor kryesor. Toka e punueshme e lënë djerrë, e braktisur, është e konsiderueshme. Vlen të shënojmë se ripyllëzimet me pishë bregdetare të bëra (vitet 1970-1980 sollën shumë të mira: natyrës i është rikthyer një element kryesor (bimësia), fauna, vlerat tërheqëse të peizazhi janë shtuar, erozioni është pakësuar (Sala, et al, 2021). Kjo përvojë ripyllëzimi përdoret pak në dhjetëvjeçarin e fundit. Po kështu dhe ledhet antierzive. Lugina e Zhullimës është më e madhja. Përshkon territorin e njësisë nga veriu në jug. Në jug bigëzohet: Zhullimë e Madhe dhe e Vogël. Këto të fundit kanë morfologji dhe elemente gjeomorfologjike të ngjashme. E para është më e gjerë.



Foto 3. Vatër erozioni në Koçaj.

Ka drejtim lindje-perëndim. E dyta ruan drejtimin veri-jug dhe ndjek disi shkëputjen tektonike (Kolektiv autorësh, 1983). Në të dyja është e pranishme zallishtja, lumorja dhe tarraca e parë. Mesatarisht dy të parat në një rën anë janë 3-4 m, por jo gjithnjë në vazhdimësi. Shifra rriten aty ku janë grykëderdhjet e përrenjve. Ata transportojnë shumë material të ngurtë, ndaj spostojnë shtratin e Zhullimave në krahun e kundërt, shtojnë gjarpërimin e tij. Pranë fshatit, ai Koçaj ka degëzime, ishuj zallorë të vegjël. Në pjesën më të madhe ka ujë gjatë vitit. Në verë zvogëlon gjerësinë: mesatarja 1.5 m. Tarraca e parë shprehet në fshatrat Vesijë, Kakunjë (fushë) deri në Koçaj. Mesatarisht janë 1-2 m mbi zallishten apo lumoren. Materiali përbërës mbizotërohet nga rëra, argjila. Ka çimentim të dobët. Nuk mungojnë zaje gëlqerore me origjinë shkatërrimin e konglomeratëve dhe gëlqerorët në Parret-Cacabezë. Përmasat më të mëdha të tarracës janë në fushat pranë shkollave të Koçajt e Vesijes: mbi 250 m x 40 m. Banorët i emërtojnë fusha: Kakunjës, Vesijës, Lugës. Pas bashkimit të Zhullimave lugina zgjerohet, përjashto dy ngushtimet: Isufmuçaj dhe Fushas. Elementet gjeomorfologjike kanë përmasa deri trefishin e atyre që përmendëm më sipër. Spostimet në

grykëderdhjet e përrenjve janë të dukshme. Tarraca e parë gati ruhet në gjithë luginën: fushat me emrat e fshatrave pranë. Mesatarisht është 2-3 m mbi zallishten apo lumoren. Gjerësia i kalon 60-80 m. Materiali përbërës është ai që përmendëm më sipër. Pranë janë numri më i madh i vendbanimeve, bujqësia më e zhvilluar. Në Koçaj, Mustafakoçaj, Baldushk, Ballhazhias, Ballshaban ruhet dhe tarraca e dytë. Mesatarisht është 4-6 m mbi të parën. Përbërja është e njëjtë si tek e para.

### IV.3. Klima

Territori e banorët e kësaj njësie administrative janë të privilegjuar me klimën: zonat mesdhetare fushore e kodrinore (*Kolektiv autorësh, 1984*). Nuk ka të dhëna brenda territorit (përjashto reshjet). Nga stacionet më të afërta mund të bëjmë vlerësim. Sipas atij të Tiranës numri i orëve me diell duhet të jetë afërsisht: dhjetor-janar 108-114 orë; maj, 255; korrik 353; shtator 251. Janë të konsiderueshme dhe burim natyror i papërdorur për prodhimin e energjisë elektrike. Përdoren në serat diellore. Dielli është i vlerësuar mirë për vendzgjedhjen e vendbanimeve. Erërat vijnë nga të gjitha drejtimet, por ato nga veriu, jugu dhe juglindja mundësohen nga luginat. Pjesa më e madhe e vendbanimeve janë në shpate me diell, të mbrojtura nga erërat e ftohta. Temperatura e ajrit nuk ka vlera të ulëta. Nga të dhëna e ish-stacionit të Qafë Kërrabës rezulton: janar  $-0.5^{\circ}\text{C}$ - $3^{\circ}\text{C}$ , prill  $5$ - $7.3^{\circ}\text{C}$ , korrik  $16^{\circ}\text{C}$ - $18.5^{\circ}\text{C}$ , dhjetor  $2.5^{\circ}\text{C}$ - $4.1^{\circ}\text{C}$ . Mesatarja vjetore rreth  $9.5^{\circ}\text{C}$  (*Kolektiv autorësh, 1989*). Në Vrap, Shpat të Sipërm, Parret, Shënkoll e Kakunjë vlerat duhet të jenë shumë të përafërta: lartësitë gati të njëjta. Këtu vlerat negative duhet të jenë më të pranishme: jo shqetësuese. Në fshatrat e tjera vlerat duhet të jenë më të larta: më shumë vendbanime dhe veprimtari ekonomike (lugina e Zhullimës). Sa u takon reshjeve, sipas ish-stacioneve Vrap e Petrelë, i dyti ka më shumë: lartësia mbidetare më e madhe: janar

123-143 mm, gusht 32-92 mm, nëntor 144-175 mm; vjetore 1123-1370 mm (*Kolektiv autorësh, 1972*). Si në gjithë vendin, reshjet kanë shpërndarje të çrregullt mujore e vjetore. Ato nuk e ndihmojnë bujqësinë në verë. Interes kanë reshjet 24 orëshe për ndikimin e madh në proceset gjeomorfologjike të shpatit, materialin e ngurtë në rrjedhjet ujore, mbathjen e ujëmbajtësve etj. Sipas ish-stacioneve të mësipërme rezultojnë: 99-195 mm në 2 ditë: 141-275 mm (maj 1972). Bora është e përkohshme në relievin më të lartë (jug), në shtresë e kohëzgjatje të vogël: në janar 2011 zgjati mbi 3-4 ditë: Vrap, Shënkoll, Parret, Kakunjë; në 2017 zgjati gati dyfish: dimri më i ftohtë në 35 vitet e fundit. Ato sjellin shqetësim për bllokimin e rrugëve drejt Vrapit e Parretit.

#### **IV.4. Hidrografia**

Rrjeti hidrografik ka shtrirje të konsiderueshme. Rrjedhjet ujore janë të vogla, më shpesh kanë ujë përkohësisht: lartësitë dhe elementet klimatike nuk e favorizojnë. Përroi i Zhullimës është më i madhi. Përshkon territorin nga jugu në veri. Të dhëna për të janë dhënë në një studim tjetër (*Sala, 2005*). Për qëllimin tonë shënojmë se ka dy degë kryesore: Zhullima e Madhe dhe ajo e Vogël. Bashkohen pranë fshatit Koçaj. Më pas deri në lumin Erzen quhet Zhullima (Zhëllima). Në këtë sektor merr shumë degë, por të majta më shumë: ka lartësitë më të mëdha të relievit. Veçojmë ato të Hijës, Baldushkut, Ballhaxhisë, Alltatës, Bajzës, Shelezit, i Lashtë etj. Të djathta dallojnë ato të Rovës, Shpatit, Margës, Gurrës etj. Grupi parë ka gjatësi më të madhe: shpati më i gjatë, më i lartë. I dyti dallon për prurjen e ngurtë më të madhe: më shumë terrene të degraduara-dezeretifikuara. Të dy kanë numër të madh përroskash e rrëkesh, të shkurtra, shumë erozive, shpesh baltore. Në përrenjtë kryesorë ka pasur mullinj të bluarjes së drithit. Burimet që ushqejnë rrjetin hidrografik janë të vogla, të tipit të kontaktit litologjik e zbritës: prurje 80-100 l/orë. Vetëm në

Parret janë dy burime me prurje 400 l/orë dhe 500 l/orë: kontakti i gëlqerorëve me flishet. Roli tyre në ujëshmërinë e Zhullimës është më i rëndësishmi. Tradita e kthimit të burimeve në çezma u ruajt deri në vitet 1980-1985. E njohur është ajo e Mamices (Shpat), e cila po shkon drejt tharjes. Ndërtimi i ujësjellësve (1975-1985) çoi në braktisje të kujdesit për to. Janë përdorur dhe për ujitjen e kopshteve me perime aty pranë. Gjatë 1970-1985 u ndërtuan ujëmbajtësit e Rovës, Baldushkut, Ballhaxhiasit, Alltatës, Hykëve (Bajzës) etj. Investimi e ndihmoi shumë bujqësinë. Tokat e punueshme në lugina ishin nën ujë. Ripyllëzimet kufizuan mbathjen e tyre nga erozioni në pellg. Pas vitit 1990 nuk pati më kujdes. Mbathja e tyre duhet të jetë e ndjeshme.

#### **IV.5. Bimësia dhe tokat**

Kushtet natyrore kanë mundësuar katet bimore të shkurreve mesdhetare dhe dushkut. Mbi 100 vjet më parë mbizotëronte pylli i dushkut. Shtimi popullsisë shtoi nevojën për tokë të re, për lëndë ndërtimi, dru zjarri, përfshi shitjen e druve për banorët e qytetit të Tiranës. Pylli pakësohej. Ish-ndërmarrja e druve e përdori deri vonë për të plotësuar nevojat e banorëve të Tiranës me dru zjarri. Gradualisht ai ua la vendin shkurreve. Këto kanë shtrirjen më të madhe, sidomos larg vendbanimeve. Pranë fshatrave hapja e tokave të reja ka qenë e vazhdueshme, ku piku arriti në vitet '70 të shekullit të kaluar. Shkurret i pakësoi dhe prerja për furrat e bukës në fshatra. Rrjedhojë ishte dhe degradimi i tokës, përfshi ato të reja. Të njëjtin fat patën pylli me dushk, disi i ruajtur: Parret, Polloshët, Tavaren. Eksodi rural pas vitit 1990 ka favorizuar ripërtëritjen e bimësisë. Ndikim ka dhe përdorimi i energjisë elektrike e gazit të lëngshëm në banesë. Megjithatë, ka prerje jo të vogla për disa furra buke e picash të Tiranës. Administrimi i pyjeve nga shteti i ka kufizuar prerjet. Banorët paguajnë taksë për drutë e zjarrit. Ripërtëritja ka shtuar faunën e

egër. Rol ka dhe moratoriumi i zgjatur i gjuetisë. Ripyllëzimet me pishë-akacie para mbi 50 vitesh janë vlerë e shtuar, investim i goditur (770 ha): Balhaxhiasit, Koçaj, Shpat, Vesqi-Parret-Shënkoll, Vrap, Kakunjë etj. Të pranishme janë dhe disa shkurre mjaltëse: shqopa, mersina, mareja, por dhe bimë mjekësore, rigoni, trumza etj. Flora dhe fauna janë mundësi e madhe për tërheqjen e banorëve të kryeqytetit: shëtitje, ekskursion në natyrë, bare-restorante me gastronomi tradicionale, trashëgimi kulturore etj. Tipat gjenetikë të tokave janë të hirta, kafe, pjesërisht të kafenjta. Lloji i shkëmbinjve, klima, relievi dhe bimësia janë kushtëzues për formimin e tyre. Tipi parë shtrihet në gjithë territorin, përjashto relievet më të larta. Janë të varfra në humus dhe kërcënohen shumë nga erozioni.



Foto 5. Erozion i lartë në toka të punueshme të braktisura, Baldushk.

Në lugina mbajnë lagështinë e tepërt në dimër, prandaj duan kullim. Ish-tokat e reja të braktisura janë përfshirë nga erozion intensiv, rrëshqitje: pasojë edhe e eksodit rural në: Baldushk, Vrap, Kakunjë, Tavaren. Në shtretërit e përrenjve (Zhullimës më

shumë) janë tokat azonale aluvionale në formim e sipër. Aty-këtu, ato lumore përdoren për kultura bujqësore pranverore. Mund të përdoren për kultivim të shelgut për punime artistike, por jo për prodhim inertesh. Tokat e punueshme janë me pronarë, por duhet kujdes në përdorimin, pjellorinë e administrimin e tyre. Pronari duhet ta përdorë edhe në dobi të së ardhmes së përbashkët.

## V. Vendbanimet

Ato janë element i rëndësishëm i peizazhit gjeografik të territorit ku ndodhen. Sipas Konventës Europiane të Peizazhit, ai është element kryesor i jetës, identitetit të popullsisë që jeton e punon aty. Njësia administrative e Baldushkut ka 14 vendbanime (fshatra). Për banorët vendzgjedhja ka pasur motiv kryesor mundësitë që iu ofrojnë kushtet natyrore, pasuritë natyrore. Tre kanë qenë më kryesoret: tokat, bimësia dhe uji. Nga vendndodhja e hershme e tyre vërejmë se me kujdes janë zgjedhur dhe drita e ngrohtësia e diellit: vendosur në kodra me më shumë diell. Territori ka qenë i banuar herët. Fshatrat ishin pranë rrugëkalimeve kryesore, qendrave më të zhvilluara: qyteza Dorëz e Përsqop, kalatë e Petrelës, Vrapit, Bodinit. Rruga e vjetër (vrromi) përshkonte luginën e Zhullimës: lidhte luginat e Erzenit dhe Shkumbinit. Gjetjet arkeologjike më të hershme janë në Baldushk, Koçaj: skulptura varri monumental e mbishkrimi (shek. I i erës sonë). Ato dëshmojnë vendbanime të antikitetit të vonë (shek. III-VII pas Krishtit). Gjatë mesjetës vërehet numri më i madh i vendbanimeve larg rrugës. Janë në kodra mbizotëruese. Ndoshta kjo lidhet me pasigurinë e kësaj kohe, mbrojtjen më të mirë, pse jo dhe sigurinë e qëndrueshmërisë së truallit: sidomos nga rreziqet gjeomorfologjike (Sala, 1999), afërsia me objektet e kultit.

Nga format e relievit ku ndodhen, vendbanimet janë: *kodrinore*: 200-450 m (Vrap: 500 m, Shpat i Sipërm, Shënkoll, Parret,



Kakunjë, Shpat, Rovë, Mumajës) dhe *luginore*: 150-200 m (Koçaj, Mustafakoçaj, Isufmuçaj, Fushas, Baldushk, Vesijë (Veqi), Ballshaban, Ballhaxhias). Sipas numrit të popullsisë janë: fshatra të vogla e të mesme, por referimi shifror sot ka probleme. Shpat i Sipërm, Shënkoll, Parret, Rovë, Vesijë ishin e mbetën të vogla. Pas vitit 1990, ato në luginën e Zhullimës: Fushas, Ballhaxhias, Ballshaban, Mustafakocaj, Baldushk, janë shtuar me të ardhur. Ndërtimet e banimit etj. janë shtuar pa plan rregullues. Kufijtë po bëhen më pak të dallueshëm. Gjithnjë popullsia rritej nga shtesa natyrore dhe të ardhurit. Motivet kryesore kanë qenë: blegtorët, kushtet natyrore, gjakmarrja etj. Në Kakunjë (Lumarët: blegtorë nga Luma e Kukësit), në Vesijë (Zelët: nga Peqini etj.). Fshatrat kanë disa lagje. Ato më larg tregojnë se të ardhurit lejoheshin në mushatë e fshatit: Polloshët etj. Më vonë blejnë truall, bëjnë krushqi me vendës, vendosen brenda fshatit. Largimet gjithnjë ishin të kufizuara. Në fundin e viteve 800 pati emigrim personash në Turqi etj. Ka pasur dhe braktisje lagjesh nga epidemitë: lagjja Zelët në Vesijë. Ripopullimi me të ardhur bëhet dhjetëra vite më pas. Në vitet 1945-1990 largimi ndalohej. Pas vitit 1990 ai është jashtë çdo kontrolli shtetëror. Motiv kryesor mbetet kërkimi i jetesës më të mirë: lagje të Koçajt, Kakunjës, Rovës, Parreti, Shënkolli, Shpati i Sipërm kanë mbetur në kodër, me pak familje. Eksodi është rritur dukshëm drejt luginave e periferisë së Tiranës. Mumajësi, Kakunja kanë zbritur në luginë gati plotësisht. Lëvizje mekanike të tillë ka dhe nga Shënkolli e Parreti drejt Vesijës, nga Shpati drejt Baldushkut, Isufmuçajt etj. Pas tërmetit (2019), grupe familjesh nga Vrapit e Shpati përfituan ndërtesat e reja të ndërtuara nga shteti në Mustafakoçaj. Nga vëzhgimi në terren rezulton se shtëpitë më herët ishin larg luginës së Zhullimës, të paktën rreth 2 shekuj më parë: Isrosa në Ballshabanit, kodra e Gjellit etj. Lëvizjet duhet të kenë qenë graduale deri në kodrat

pranë luginës, jo në luginë. Ndoshta tokën pjellore e kishin të pasurit, apo ruhej tradita e moszënies së saj me ndërtime.

Nisur nga vendndodhja e shtëpive fshatrat ishin tipike të shpërndara, me disa lagje-fise: deri 2-3 km larg qendrës (Kostani në Vrap, Polloshët në Baldushk, Tavareni në Koçaj). Më herët kishte mjaft banesa me dy kate: mure guri, mbuluar me rrasa e tjegulla vendi. Në madhësinë e shtëpisë ndikon pasuria e familjes. Deri në fillimet e ish-kooperativave, shtëpitë pranë luginës kanë qenë pranë kodrave e në tarracën e dytë të Zhullimës: Baldushk, Ballhaxhias, Ballshaban, Koçaj. Rrallë, në 1985-1989, u ndërtuan shtëpi të reja poshtë këtij niveli. Shteti përcaktoi vijat e verdha dhe kontrollonte territorin. Banorët pranojnë se kryesore ishte moszënia e tokës pjellore me ndërtime. Edhe tipi i banesës “elbasançe” zbatohet kudo. Është disi më funksionale se ato të hershmet dhe hiqen muret rrethuese të larta. Vlerësuar në dobi të shëndetit, vendzgjedhja e parë ishte më e mirë: larg mjegullës, lagështisë, kishte panoramë tërheqëse, diell më shumë etj. Të pasurit i kishin vlerësuar të mirat në kodër: kodra e Çiflikut (Baldushk), Kasëve (Koçaj), Beut (Alltatë) etj. Pas vitit 1990 situata doli jashtë kontrollit. Shteti pothuaj braktis gjithçka. Infrastruktura, ekonomia shkatërrohen: politika e mbrapshtë me thirrjen “të fillojmë nga zero!” ishte katastrofë e vërtetë. Eksodi gjeti liri të plotë, kryesisht drejt kodrave të Saukut (ish-ferma): blerje e zaptim i tokës (Shpat: larguar 11 familje, mbetur 18, Mumajës larguar 35 familje etj.). Disa rikthehen në vendlindje për punët e bujqësisë. Favorizohen nga largësia e vogël, rruga e asfaltuar dhe linja e autobusit. Në shtëpitë e rindërtuara shpesh jetojnë prindërit, ose familjarët vijnë në fundjavë. Shtëpitë-vila janë ndërtuar në tokën më pjellore. Aty-këtu për specialistët shqetësimi kishte nisur në fundin e viteve '70 të shekullit të kaluar (*Leka, Shehu, 1979*), kurse tani ai është bërë fenomen. Brezat e

ardhshëm ku do të mbjellin perime etj.? Përgjigjja është e qartë: të ndalet fenomeni, pavarësisht se fshatari është pronar i tokës.

Sipas numrit të popullsisë vendbanimet janë të vogla (Vrap, Shënkoll, Parret, Shpat i Sipërm, Kakunjë). Aty janë lagjet më kodrinore. Sipas të dhënave (*Selenica, 1928, Zyra e Statistikës Baldushk, 2020*) rritja e popullsisë nga vitit 1927 deri në 1989 është respektivisht: Vrap-Shpat sipërm 381 banorë dhe 1078 banorë, Parret-Shënkoll 67 (vetëm Shënkolli) dhe 593 banorë, Vesqi 67 dhe 424 banorë, Koçaj 100 dhe 386 banorë, Mustafakoçaj 98 dhe 486 banorë, Isufmuçaj 140 dhe 429 banorë, Shpat-Rovë 106 dhe 372 banorë, Ballshaban 140 dhe 1112 banorë (shtuar Baldushku), Mumajës (?) 361 banorë, Ballhaxhias 115 dhe 708 banorë, Kakunjë 79 dhe 406 banorë, Fushas (?) 359 banorë. Është vlerësuar se në periudhën 1965-1985 shtesa natyrore ishte 26% lindjet të larta, vdekje të pakta (*Qiriaz, Sala, Laçi, 1998*). Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe i mirëqenies ishin faktorët kryesorë të rritjes. Pak familje lejoheshin drejt fermave bujqësore si krahë pune. Në ish-qendrat Baldushk, Mustafakoçaj u rrit numri i popullsisë, madje Fushasi gati u krijua i ri. Pas vitit 1991 largimet rriten: në vitet 1996-1997 largohen 295 banorë. Në vitin 2021 njësia administrative kishte 5440 banorë: 888 banorë më pak se në vitin 1989. Shifra e parë ka probleme pasi ka familje që nuk e kanë tërhequr gjendjen civile. Në vitin 2020 numri të larguarve dhe të ardhurve ishte respektivisht: 86 dhe 59. Në fshatrat e luginës ka rritje me ndërtime, biznese, kryesisht të ardhur nga fshatrat kodrinore përreth. Këtu ka sipërfaqe të konsiderueshme toke që punohet. Sipërfaqja e tokës së punueshme në vitin 1991 dhe 2021 ishte respektivisht: 1891 ha dhe 1877 ha (*Zyra e statistikës Baldushk, 2021*). Diferenca është tokë e varfër, e pandarë, e braktisur, e degraduar nga erozioni, rrëshqitjet etj. Eksodi favorizon prirjen e rritjes së kësaj difference. Specialistët kanë vlerësuar erozionin të lartë në pellgun e Erzenit me 4.4 mm/vit (Kovaçi, Belalla, 1998).

Këtu përfshihet edhe territori në studim. Në fshatrat kodrinore, familjet e mbetura (ato të larguara) kanë mbjellë ullinj më shumë: në 2021 ishin 25 mijë rrënjë gjithsej. Në Fushas është fabrika e vajit. Ka familje që kanë krijuar vreshta, por sipërfaqja është shumë më e vogël se para vitit 1990 (Shpati ka 5-6 ha). Pak familje kanë rimbjellë pemë. Si në gjithë Shqipërinë (*Qiriazzi, Sala, 1997*), banorët kanë rritur presionin ndaj natyrës. Vlera e përfitimit të drejtpërdrejtë nga natyra është rritur. Toka, bimësia, ujërat patën *vlerën përdoruese* kryesore deri në vitin 1989: zhvillimi i bujqësisë e blegtorisë. Më pas struktura bujqësore ndryshoi: për prodhimet që do tregu janë shtuar *vlerat e zgjedhjes*: konsumi i territorit për soditje-lëvizje-argëtim në natyrë, gastronomi tradicionale në restorante (turizmi rural). Rritja e ndikimit socio-ekonomik mbi territor-mjedisin gjeografik vazhdon, ndaj kërkon rivlerësim të burimeve natyrore. Kemi theksuar dhe në raste të ngjashme (*Sala, 2017; Sala, Lirëza, 2014*) se ai bëhet në përputhje me politikat e zhvillimit, përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore: shoqëruar me masa teknike-ligjore mbrojtëse konkrete në këtë mjedis rural. Nuk duhet harruar se peizazhi rural ka të nevojshme ruajtjen e identitetit (*Lacument, 2005*), pa respektuar kufirin administrativ. Studiuesit rekomandojnë përfshirjen e një hapësire më të gjerë (*Mathieu, Paix, 1997*).

### **Përfundime**

Nga analiza e mësipërme arrijmë në këto përfundime kryesore.

Territori ka pozitë gjeografike të favorshme: afërsia me kryeqytetin, luginat e Shkumbinit, Erzenit, Pezës.

Kushtet dhe burimet natyrore janë shumë të mira për jetesën, zhvillimin e bujqësi-blegtorisë, por përdorimi i tokës dhe i burimeve të tjera natyrore, rregullimi i territorit, vlerat e peizazhit kërkojnë rivlerësim sipas kërkesave të kohës.

Lidhja me Tiranën me rrugë të asfaltuar (15 km) lehtëson daljen e prodhimeve në treg, por rrugët midis fshatrave kërkojnë investime.

Eksodi rural ka ato shkaqe e pasoja si në gjithë vendin në këto 30 vite, por nëse i jepet rëndësia natyrës, vlerave të peizazhit, zgjerimit të bar-restoranteve, gastronomisë tradicionale, krijohen kushte që ai të kufizohet, ndoshta deri në rikthim të familjeve të larguara.

Vendbanimet në luginë po zgjerohen (shtëpi-vila), duke zënë tokën e punueshme më pjellore, ndaj duhet rikthimi i vijave të verdha të fshatrave dhe kontroll-rregullimi shtetëror i territorit.

### Literatura

Bezarjani, V., (1986). Raport gjeologjik i rajonit Fortuzaj-Rovë. Fondi Qendror i Gjeologjisë. Tiranë.

Instituti Hidrometeorologjik, (1989). Buletini i reshjeve. Tiranë.

Instituti Hidrometeorologjik, (1989). Buletini i temperaturave. Tiranë.

Kolektiv autorësh, (1972). Klima e Shqipërisë. Tiranë.

Kolektiv autorësh, (1983). Harta gjeologjike e Shqipërisë: shkalla 1:200 000. Tiranë.

Kolektiv autorësh, (1984). Atlasi klimatik i Shqipërisë. Tiranë.

Kolektiv autorësh, (1991). Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi 2. Tiranë.

Kovaçi, V., Belalla, S., (1998). Erozioni në Shqipëri, dëmet që sjellë dhe problemet që kërkojnë rrugë zgjidhje për të ardhmen. Seminar Kombëtar për dezertifikimin. Tiranë.

Mathieu, N., Paix, C., (1997). Une carte en trois axes de recherches. STARTES-7. Paris.

Laucement, G., (2005). Les changements fonctionnels dans les territoires ruraux des nouveaux lands allemands. BAGF-2. Paris.

Leka, Sh., Shehu, A., (1979). Disa mendime mbi problemin e mbathjes së rezervuarëve në zonat kodrinore. Ndërtuesi nr. 3. Tiranë.

Leka, Y., Nocka, V., (1981). Raport përpunimet gjeologjike për zbulimin e lëndëve të para për fabrikën e tullave silikate. Fondi Qendror i Gjeologjisë. Tiranë.

Qiriazhi, P., Sala, S., Laçi, S., (1998). Kodrat e Kërrabës shembull klasik i dezertifikimit human. Seminar Kombëtar për dezertifikimin. Tiranë.

Qiriazhi, P., Sala, S., (1997). Aktivites humaines et la degradation de montagnes en Albanie. Borovetz-Sofia.

Qiriazhi, P., Sala, S., (2007). Monumentet e natyrës në Shqipëri. Tiranë.

Sala, S., (1999). Rreziqet natyrore në kodrat e Kërrabës. Studime albanologjike nr.1. Tiranë.

Sala, S., (2005). Vecoritë morfologjike e gjeomorfologjike të kodrave të Kërrabës. Tiranë.

Sala, S., Lirëza, Q., (2014). Vendbanimet në krahinën e Tomorricës. Tiranë.

Sala, S., (2017). Skura-natyra dhe njerëzit. Tiranë.

Sala, S., Qiriazhi, P., Nikolli, P., (2021). Trashëgimia natyrore e Bashkisë së Tiranës. Tiranë.

Selenica, T., (1928). Popullsia e Shqipërisë. Tiranë

Zyra e statistikës, Baldushk, (2021). Të dhëna social-ekonomike.

Zhafa, Z., etj. (1976). Raport gjeologjik i rajonit Tiranë-Rovë. Fondi Qendror i Gjeologjisë. Tiranë.

**Dr. Adelajda Halili<sup>1</sup>**

**Prof. dr. Pal Nikolli<sup>2</sup>**

## **VLERËSIMI DHE ANALIZA E RRRITJES URBANE TË QYTETIT TË VLORËS ME ANËN E GIS/REMOTE SENSING**

### **Abstrakt**

Rritja urbane është një fenomen thelbësor që tregon zhvillimin e një zone. Ajo mund të manazhohet më mirë përmes të kuptuarit të dinamikës së rritjes, ndikimeve të faktorëve shtytës dhe planifikimit optimal të përdorimit të tokës për të cilat vlerësimi dhe parashikimi i rritjes urbane janë shumë të rëndësishme. Më tej, për të shmangur ose zvogëluar rreziqet e shumë fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu dhe ato natyrore, planifikimi i duhur i zonave urbane është nevojë e kohës.

Për të fituar një kuptim të qartë hapësinor të dinamikës urbane në dhe rreth qytetit të Vlorës deri në vitin 2018, është aplikuar një qasje e integruar duke përdorur hartat e kohëve të ndryshme, imazhet satelitore dhe teknologjinë GIS/Remote Sensing. Ndryshimet e zonave urbane në qytetin e Vlorës janë vlerësuar për periudhat 2000 – 2006, 2006 – 2012 dhe 2012 - 2018. Sipërfaqja e strukturave urbane të ndërprera (banesave etj.) është rritur me 18% (2000 – 2006) dhe 0.64 % (2006 – 2012). Po ashtu është rritur edhe sipërfaqja e njësive industriale dhe tregtare me 100 % (2000 – 2006) dhe 4.4 % (2006 – 2012) dhe sipërfaqja e mjediseve sportive me 8 % (2000 – 2006). Në të kundërt, janë zvogëluar sipërfaqet e tokave arë me 60.3 % (2000 – 2006) dhe 7% (2006 – 2012), sipërfaqet e ullishtave me 9 % (2000 – 2006) dhe 0.4 % (2006 – 2012), sipërfaqet e kultivimit kompleks me 73.5 % (2000 – 2006), sipërfaqet e pyjeve halorë me 14.1

---

<sup>1</sup> *adelahalili@yahoo.com*

<sup>2</sup> *palnikolli@yahoo.com*

% (2000 – 2006) dhe 1.3 % (2006 – 2012) dhe sipërfaqet e plazheve me 70.7% (2000 – 2006).

Pra, konstatohet se ndryshimet më të mëdha të mbulesës së tokës kanë ndodhur deri në vitin 2006. Më pas, deri më 2018, vërehet një prirje stabilizimi në drejtim të rritjes urbane dhe ruajtjes së sipërfaqeve të gjelbra etj.

Ashtu si qytetet e tjera shqiptare, edhe qyteti i Vlorës shfaq shumë probleme që lidhen me urbanizimin e pamenzhuar.

Përfundimet e studimit janë të rëndësishme dhe duhen marrë në konsideratë për një zhvillim urban të qëndrueshëm të qytetit të Vlorës.

*Fjalë-çelës: Vlorë, hartë, mbulesa e tokës, rritja urbane, GIS*

### **Abstract**

Urban growth is an essential phenomenon that indicates the development of an area. It can be better managed through understanding the dynamics of growth, motivating factors and optimal land use planning for which the assessment and forecast of urban growth are very important. Further, to avoid or reduce the risks of many man-made and natural disasters, proper urban planning is a need of the time.

To gain a clear spatial understanding of urban dynamics in and around the city of Vlora by 2018, an integrated approach has been used using maps of different times, satellite images and GIS / Remote Sensing technology. The changes of urban areas in the city of Vlora are estimated for the periods 2000 - 2006, 2006 - 2012 and 2012 - 2018. The area of discontinued urban structures (dwellings, etc.) has increased by 18% (2000 - 2006) and 0.64% (2006 - 2012). The area of industrial and commercial units has also increased by 100% (2000 - 2006) and 4.4% (2006 - 2012) and the area of sports facilities by 8% (2000 - 2006). In contrast, arable land areas decreased by 60.3% (2000 - 2006) and 7% (2006 - 2012), olive groves by 9% (2000 - 2006) and 0.4% (2006 - 2012), arable land areas complex with 73.5% (2000 - 2006), coniferous forest areas with 14.1% (2000 - 2006) and 1.3% (2006 - 2012) and beach areas with 70.7% (2000 - 2006). So, it is concluded that the biggest changes in land cover occurred until 2006. Then, until 2018, there is a stabilizing trend in terms of urban growth and preservation of green areas, etc.

Like other Albanian cities, Vlora shows many problems related to unmanaged urbanization. The conclusions of the study are important for a sustainable urban development of the city of Vlora.

*Keywords: Vlora, map, land cover, urban growth, GIS,*



## I. Hyrje

Rritja urbane mund të përkufizohet si lëvizja e banorëve nga komunitetet që kanë lidhje kryesisht ose vetëm me bujqësinë në komunitete të tjera, aktivitetet e të cilave janë të përqendruara kryesisht në qeveri, tregti, prodhim ose interesa të afërta me to (*Weber, Puissant, 2003*). Ky proces është i dyanshëm sepse përfshin jo vetëm lëvizjen nga fshati në qytet dhe ndryshimin nga profesioni bujqësor në biznes, tregti dhe shërbim, por përfshin gjithashtu ndryshim në qëndrimet, besimet, vlerat dhe modelet e sjelljes së migrantëve. Rritja urbane, e cila lidhet me shtimin e shpejtë të popullsisë urbane, ngritjen e nivelit të rëndësisë së qytetit dhe zgjerimin e tij ekonomik, shoqërohet me ndryshime të rëndësishme të përdorimit dhe mbulesës së tokës. Gjithashtu, rritja e shpejtë e urbanizimit të qyteteve dhe fshatrave mbizotëron burimet e pakta duke i cenuar ato, gjë që çon në një situatë zhvillimi të pamenzhuar dhe të paqëndrueshme. Ne mund ta menazhojmë rritjen urbane në një mënyrë të planifikuar, duke parashikuar skenarë të ardhshëm për të cilët dinamika e ndryshimit të sipërfaqes së mbulesës/përdorimit të tokës është thelbësore për t'u kuptuar (*Bengston, 2004*).

Analiza e ndryshimit të përdorimit/mbulesës së tokës mund të realizohet nëpërmjet integritit të metodave dhe teknikave nga fusha shumëdisiplinore si Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), Remote Sensing, Gjeografia Urbane dhe Shkenca Kompjuterike. Ndërkohë, modeli dhe shtrirja e sipërfaqes urbane mund të analizohen me ndihmën e të dhënave hapësinore dhe kohore (*Ertugay, Duzgun, 2011*).

Ky punim shqyrton dhe vlerëson zgjerimin urban të qytetit të Vlorës nëpërmjet GIS-it. Zonat e rritjes urbane janë hartuar dhe analizuar për një periudhë 18-vjeçare duke përdorur të dhënat hapësinore nga hartat dhe imazhet satelitore. Përparësitë kryesore

të të dhënave RS janë disponueshmëria e tyre në një zonë të madhe mbulimi dhe zbulimi i ndryshimeve të përkohshme.

Gjetjet e këtij punimi do të jenë të dobishme për të kuptuar të tashmen dhe projektuar skenarin e rritjes së qytetit të Vlorës në të ardhmen. Më tej, punimi do të ndihmojë gjithashtu në planifikimin efikas për shtrirjen urbane sistematike dhe të kontrolluar në qytetin e Vlorës.

## II. Zona e studimit

Qyteti i Vlorës<sup>1</sup> ndodhet në anën lindore të gjirit të Vlorës dhe në kodrinat e maleve Ceraunian, përballë ngushticës së Otrantos. Ai shtrihet ndërmjet Ujit të Ftohtë dhe Zvërnecit (harta 1). Rrafshi mbi të cilin ngrihet qyteti i Vlorës ka lartësi nga 6 m deri në 76 m mbi nivelin e detit dhe përfaqëson një nivel bazë kontinental, ende aktiv. Zona ka një ndikim shumë të madh nga deti dhe ka një klimë mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të butë e të lagësht.

---

<sup>1</sup> Shënim: Vlora, e cila në lashtësi quhej Aulona, përmendet nga shumë udhëtarë dhe kronikanë të huaj, si një nga qytetet – skelë kryesore të Ilirisë së Jugut, që lulëzoi pas rënies së Apolonisë dhe Orikut. Si një qendër e zhvilluar dhe e kulturuar Vlora shfaqet edhe në mbretërinë e Arbërisë më 1272, ku kronikat e kohës shënojnë lulëzimin e zejtarisë, tregtisë, blegtorisë dhe pemëtarisë, të përfshirë si despotat më vete. Në shek.XVII-XVIII Vlora ishte një nga limanet më të rëndësishme të Shqipërisë së Jugut, pas Prevezës, pasi gjiri i saj u siguronte anijeve mbrojtje nga stuhitë.



Harta 1. Shtrija gjeografike e qytetit të Vlorës  
Burimi: <http://vlora.gov.al/2019/10/16/9084/>

Vlora dallohet për një pozicion të volitshëm gjeostrategjik pasi ka dalje të menjëhershme në det (P) dhe mbështetje në vargmalet në lindje; gjendet në kryqëzimin e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në të gjithë rajonin dhe distanca nga kryeqyteti i vendit,

Tirana, është 135 km, ndërkohë që vetëm 72 km e ndajnë nga Italia dhe 130 km nga Greqia. Pozicioni që ka Vlora garanton një lëvizje masive të turistëve vendës dhe të huaj.

Qyteti i Vlorës ka 144744 banorë, 48751 familje dhe 38,935 banesa (janar 2020). Ai zë vetëm 45% të sipërfaqes totale të tokës urbane pavarësisht nga fakti se, në të përqendrohet 71% e popullsisë së bashkisë së Vlorës<sup>1</sup>.


Si qytet, i ka rrënjët e zhvillimit të jetës qytetare dhe tregtare në brendësi të territorit, pranë Sheshit të Flamurit (harta 2). Në këtë vend, dikur, lulëzonte qyteti i vjetër me rrugë të ngushta, me ndërtime karakteristike 2-3 katëshe, me një arkitekturë neoklasike të pasur me dekore. Në këtë zonë ndodhen objektet dhe rrugët më të rëndësishme, rruga “Justin Godard”, e njohur që herët për karakterin e saj tregtar, pulsi ekonomik i qytetit, “Rruga e Hebrenjve”, rrugë historike ku kanë jetuar familje hebrejsh, bashkia e qytetit ose ish-Konsullata Italiane me sheshin përpara saj, si dhe një nga objektet më të rëndësishme e ndërtuar me kontributin e tregtarëve, merkatoja e qytetit. Kjo zonë ka qenë pulsi ekonomik i qytetit në fundshekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX. Aty ishin të përqendruara funksionet më të rëndësishme si bashkia e qytetit, merkatoja e fruta-perimeve dhe përbri saj pazari i vjetër, galeria e arteve, muzeu historik, libraria, hotel *Gambino*, hoteli i kinezëve etj.

Gjatë historisë së tij, qyteti i Vlorës është zhvilluar në të gjitha drejtimet si: turizëm, urbanistikë, ndërtim, industri, tregti etj. Qendra historike ose Vlora e Vjetër, e rikonstruktuar, është shndërruar tashmë në një mjedis atraktiv dhe me interes për vizitorët. Kjo hapësirë me vlera të shumëfishta përmbledh në vetvete historinë e qytetit, ngjarje e momente me rëndësi kombëtare e mbarëkombëtare, ndërkohë që evokon segmente të

---

<sup>1</sup> <https://www.empowermed.eu/wp-content/uploads/2020/11/D1.1-Vlora-Albania.-Pilot-site-2.pdf>

së shkuarës shumëshekullore në aspekte të ndryshme, një prej të cilave është tradita në arkitekturë. Ndërtimet në këtë zonë, të evokuara në kohë përmes procesit të restaurimit selektiv dhe në tërësi, përfaqësojnë vlera të vërteta në arkitekturë, të materializuara në shekujt XIX dhe XX, vazhdë e traditave shumë më të hershme.



Harta 2. Zona e vjetër e qytetit të Vlorës  
Burimi: <http://vlora.gov.al/2019/10/16/9084/>

Aktualisht, qyteti i Vlorës po ndryshon me shpejtësi. Zona qendrore bregdetare rreth dhe prapa portit e dëshmon këtë. Kështu, përreth kësaj zone janë duke vazhduar projekti i bulevardit dhe projekti i rikonfigurimit të portit. Shëtitorja e Vlorës ka sjellë një rigjallërim të jetës dhe po shoqërohet me projekte të tjera për rikualifikimin e zonave të ndryshme si asaj historike etj. Gërshetimi i resurseve gjeografike me resurset humane dhe resurset e tjera, do t'i japin qytetit të Vlorës impulset e duhura të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.


### III. Marrja dhe përpunimi i të dhënave

Në studimin tonë, për të analizuar ndryshimin e përdorimit/mbulesës së tokës janë përdorur imazhet satelitore të viteve të ndryshme (tab. 1).

Tab. 1. Detajet e të dhënave hyrëse

Nr	Lloji i të dhënave të përdorura	shkalla/ rezolucioni	Viti	Numri i bandave
1	Landsat ETM+ Dhe të dhënat PAN	14.25 m	2000	9
2	Imazh Landsat ETM+	28.50 m	2006	6
3	Landsat ETM+ dhe të dhënat PAN	28.50 m	2012	8
4	Imazh Landsat ETM+	28.50 m	2018	7

Për të përpunuar dhe analizuar të dhënat satelitore multispektrale dhe për të përgatitur hartën e përdorimit/mbulesës së tokës për vite të ndryshme, janë përdorur teknikat standarde të përpunimit të imazhit si korrigjimi, përmirësimi, klasifikimi dhe vlerësimi i saktësisë. Të dhënat satelitore të mësipërme janë përpunuar dhe analizuar sipas skemës 1.



Skema 1. Burimi: Autorët

Korigjimi i saktë gjeometrik dhe radiometrik është një parakusht për përpunimin e imazheve satelitore (Lillesand et al., 2008). Imazhet janë gjeoreferuar duke përdorur pikat e kontrollit tokësor të shpërndara në mënyrë uniforme. Ato janë transformuar dhe projektuar në të njëjtin sistem koordinativ dhe projektion (UTM WGS 84 zona 34 N)

Metodat e klasifikimit të imazheve zakonisht ndahen në tri grupe kryesore bazuar te “Njësia themelore e analizës”: klasifikimi i bazuar në piksel, klasifikimi i bazuar në nënpiksel dhe metodat e klasifikimit të bazuara në objekte (Nikolli, 2009). Metodat e klasifikimit të bazuara në pixel ndahen në metodat e mbikëqyrura, të pambikëqyrura dhe hibride. Klasifikimi i


pambikëqyrur nuk kërkon të dhënat e trajnimit si bazë për klasifikim dhe lejon identifikimin e grupimeve spektrale me një shkallë të lartë objektiviteti. Kjo metodë përdor një distancë minimale spektrale për të caktuar një piksel në një grup dhe ishte e suksesshme në klasifikimin e veçorive të mbulesës së tokës në rastin tonë. Të dhënat e klasifikimit të pambikëqyrura u përdorën më pas si të dhëna për krijimin e hartës së mbulesës së tokës.

Për analizën e ndryshimeve të sipërfaqeve të kategorive dhe klasave të mbulesës së tokës janë përdorur skedarë/shape të prodhuar nga interpretimi i imazheve satelitore sipas Corine Land Cover. Përpunimi i imazheve është bërë me anën e ArcGIS 10.1, duke kaluar nëpër këto etapa: gjeoreferimi; gjurmimi i kontureve dhe veçorive gjeografike; përcaktimi i kategorive dhe klasave të mbulesës dhe vlerësimi i sipërfaqeve të këtyre kategorive dhe ndryshimeve të tyre në këto periudha.


#### **IV. Rezultatet**

Nga përpunimi i të dhënave të përfuara nga hartat topografike dhe imazhet satelitore, me anën e ArcGIS janë përftuar hartat e ndryshimeve të sipërfaqeve sipas klasave/kategorive të mbulesës së tokës (hartat 3 dhe hartat 4). Gjithashtu janë llogaritur edhe vlerat e sipërfaqeve sipas klasave të mbulesës së tokës (tabela 2). Ndryshimet në sipërfaqet e kategorive të mbulesës së tokës sipas periudhave jepen në grafikun 1.






Harta 3. Ndryshimet sipas klasave e mbulesës së tokës (2000-2018) Burimi: Autorët



Harta 4. Ndryshimet sipas kategorive të mbulesës së tokës (2000-2018), Burimi: Autorët

Tabela 2. Sipërfaqet sipas klasave të mbulesës së tokës. (në ha) Burimi:  
Përpunuan autorët

Klasat	Kodi/ Klasa	Sip_00	Sip_06	Ndryshimi 00-06	Sip_12	Ndryshimi 06-12	Sip_18	Ndryshimi 12-18
Struktura urbane e vazhdueshme	111		231.93	-	231.93	0.00	231.93	0.00
Struktura urbane e ndërprerë	112	966.39	1141.24	+174.85	1148.51	+7.27	1148.51	0.00
Njësi industriale ose tregtare	121	78.06	156.06	+78.00	162.96	+6.90	162.96	0.00
Vendet e nxjerrjes së mineraleve	131		29.59	-	29.59	0.00	29.59	0.00
Mjedise sportive dhe kampingje, piknik etj.	142	41.26	44.57	+3.31	44.57	0.00	44.57	0.00
Tokë arë e paujitshme	211	248.69	98.80	-149.89	91.90	-6.90	91.90	0.00
Ullishte	223	762.08	693.67	-68.41	690.50	-3.17	690.50	0.00
Livadhe	231	34.38		-		-		-
Modele të kultivimit kompleks	242	210.1	64.67	-154.43	64.67	0.00	64.67	0.00
Bujqësi me bimësi natyrale	243	3.65	3.65	0.00	3.65	0.00	3.65	0.00
Pyje halore	312	253.99	218.2	-35.79	215.26	-2.94	215.27	+0.01
Pyje të përziara	313	23.02	1.29	-21.73		-		-
Barëra natyralë	321	31.63		-		-		-
Shkurreta	323	6.59	6.59	0.00	9.64	+3.05	9.64	0.00
Shkurre-pyje kalimtare	324	20.37	20.37	0.00	20.37	0.00	20.37	0.00
Plazhe, duna, ranishte	331	34.03	9.96	-24.07	9.96	0.00	9.96	0.00



Grafiku 1. Burimi: Autorët

### Përfundime dhe diskutime

Urbanizimi është një proces i pashmangshëm i cili rritet me shtimin e numrit të popullsisë, industrializimin dhe migrimin e banorëve nga zonat rurale në ato urbane, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës. Ndryshimi i përdorimit/mbulesës së tokës në zonat urbane mund të zbulohet duke diferencuar informacionin e nxjerrë nga imazhet e klasifikuara satelitore me anën e GIS-it.

Ndryshime të rëndësishme në mbulesën/përdorimin e tokës në bregdetin shqiptar kanë ndodhur që nga fundi i viteve 1990, kur filloi lëvizja e lirë dhe pa kriter e banorëve dhe të ardhurat e emigrantëve filluan të shtoheshin. I njëjti fenomen vërehet edhe në zona të ndryshme të qytetit të Vlorës, veçanërisht në periudhën 2000-2006, kur migrimet po stabilizoheshin, por remitancat ishin në nivelin më të lartë, duke rezultuar në rritjen më intensive të urbanizimit. Në vitet e mëvonshme si migrimi, ashtu edhe ndryshimet mjedisore janë ende në progres, por në një masë shumë më të vogël se në periudhat e mëparshme.

Nga analiza e hartës nr. 3, tabelës nr. 2 dhe grafikut nr. 1, rezulton se sipërfaqja e strukturave urbane të ndërprera

(banesave etj.) është rritur me 18% (2000 – 2006) dhe 0.64 % (2006 – 2012). Po ashtu është rritur edhe sipërfaqja e njësive industriale dhe tregtare me 100 % (2000 – 2006) dhe 4.4 % (2006 – 2012) dhe sipërfaqja e mjediseve sportive me 8 % (2000 – 2006). Në të kundërt, janë zvogëluar sipërfaqet e tokave arë me 60.3 % (2000 – 2006) dhe 7% (2006 – 2012), sipërfaqet e ullishtave me 9 % (2000 – 2006) dhe 0.4 % (2006 – 2012), sipërfaqet e kultivimit kompleks me 73.5 % (2000 – 2006), sipërfaqet e pyjeve halore me 14.1 % (2000 – 2006) dhe 1.3 % (2006 – 2012) dhe sipërfaqet e plazheve me 70.7% (2000 – 2006). Pra, konstatohet se ndryshimet më të mëdha të mbulesës së tokës kanë ndodhur deri në vitin 2006. Më pas, deri më 2018, vërehet një tendencë stabilizimi në drejtim të rritjes urbane dhe ruajtjes së sipërfaqeve të gjelbra etj.

Aktualisht, qyteti i Vlorës vazhdon të zgjerohet në të gjitha drejtimet e veçanërisht drejt bregut të detit, sidomos drejt Ujit të Ftohtë dhe Jonufrës. Faktorët ekonomikë si Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e zonës urbane të Vlorës. Faktorë të tjerë, si distanca nga rrugët, distanca nga shqetësimet dhe politikat kontribuojnë gjithashtu në rritjen urbane. Kushtet geomorfologjike midis Nartës dhe Plazhit të Vjetër nuk lejojnë avancimin e shpejtë të qytetit drejt bregdetit. Këtu ndikon ekzistenca e sektorëve moçalorë si dhe qëndrueshmëria e dobët e bazamentit të tokës.

Popullsia e Vlorës është 79513 banorë (2011), ndërsa dendësia e popullsisë është 2650 banorë/km<sup>2</sup>. Rritja e popullsisë është shtytësi kryesor i urbanizimit. Për rrjedhojë, një popullsi në rritje do të rëndojë ekosistemet tashmë të brishta që karakterizojnë peizazhin urban. Shkalla e përgjithshme e zgjerimit urban nga viti 1995 në 2015 ishte 3,4 %.

Gjetjet e këtij punimi iu japin vendimmarrësve si dhe publikut një informacion të besueshëm rreth ndryshimeve të mbulesës dhe përdorimit të tokës dhe faktorëve që ndikojnë në këto ndryshime.

### **Literatura**

Bengston, D.N., Fletcher, J.O., Nelson, K.C., (2004) "Public policies for managing urban growth and protecting open space: policy instruments and lessons learned in the United States", *Landscape and Urban Planning* 69.

Ertugay, K., Duzgun, S., (2011) "GIS-based stochastic modeling of physical accessibility using GPS-based floating car data and Monte Carlo simulation", *International Journal of Geographical Information Science*, 25:9,

Lillesand, Ralph W. Kiefer, and Jonathan W. Chipman. (2008). *Remote Sensing and Image Interpretation*, Sixth edition Thomas M., John Wiley and sons, Inc. New Jersey.

Nikolli, P., (2009). Përftimi dhe përpunimi i imazheve satelitore për analizat gjeografike SHBLU, Tiranë, f. 245.

Weber, C. & Puissant, A., (2003) "Urbanization pressure and modeling of urban growth: example of the Tunis Metropolitan Area", *Remote Sensing of Environment* 86

**Prof. dr. Qamil Lirëza<sup>1</sup>**

## **EVOLUCIONI HAPËSINOR I NJËSISË ADMINISTRATIVE ZHEPË, BASHKIA ÇOROVODË, PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM**

### **Abstrakt**

Qëllimi kryesor i këtij referimi është vlerësimi shkencor i hapësirës së kësaj zone nga pikëpamja; natyrore, historike, social-ekonomike dhe kulturore, duke i studiuar këta komponentë në faza të ndryshme kohore. Për përgatitjen e këtij punimi jemi bazuar në një vëzhgim të gjatë dhe punë kërkimore në hapësirën gjeografike të kësaj komune, në aspektin natyror, demografik, kulturor dhe ekonomik, duke dhënë tregues të shumtë për ritmet e zhvillimit natyror, demografik dhe ekonomik të kësaj komune. Fillimisht në këtë punim jepet një vlerësim të përgjithshëm i natyrës, klimës dhe mjedisit. Më tej, është bërë një analizë e demografisë së të gjitha fshatrave të njësisë administrative në fjalë, duke theksuar ritmet e ndryshme të popullsisë 1926-2020, tendencat në të ardhmen. Për ilustrimin e fakteve janë ndërtuar dhe grafikë të ndryshëm. E gjithë analiza që është kryer në këtë kumtesë lidhet me këndvështrimin për një zhvillim të qëndrueshëm, mundësitë për zhvillimin ekonomik të kësaj zone. Po kështu vlerësohet dhe ndarja e re territoriale, funksionet që do të këtë në shërbim të komunitetit. Një vend të rëndësishëm në këtë punim zë vlerësimi i figurave patriotike dhe intelektuale të kësaj komune. Më tej analizohet situata ekonomike dhe mënyra e jetesës, problemet që evidentohen. Në fund të kësaj kumtese jepen konkluzionet dhe disa rekomandime përkatëse.

*Fjalë çelës: Evolucion, natyrë, mjedis, vendbanim, zhvillim i qëndrueshëm*

### **Abstract:**

The main purpose of this reference is the scientific evaluation of the space of this area from the point of view; natural, historical, socio-economic and

---

<sup>1</sup> *Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, E-mail: liptongreg@yahoo.com*

cultural, studying these components at different time stages. For the preparation of this paper, we are based on a long observation and research work, in the geographical space of this municipality, in the natural, demographic, cultural and economic aspect. Giving many indicators for the rates of natural, demographic and economic development of this municipality. Initially in this paper a general assessment of nature, climate and environment is given. Further, an analysis of the demographics of all the villages of the administrative unit in question was made, highlighting the different population rates 1926-2020, future trends. Various graphics have been constructed to illustrate the facts. All the analysis that has been carried out in this press release is related to the perspective for a sustainable development, the opportunities for economic development of this area. The new territorial division is also appreciated, the functions it will have in the service of the community. An important place in this paper is occupied by the evaluation of patriotic and intellectual figures of this municipality. The economic situation and the way of life are further analyzed, the problems that are identified. At the end of this paper are given the conclusions and some relevant recommendations.

*Keywords: Evolution, nature, environment, habitat, sustainable development,*

## I. Hyrja

Emri Zhepë duhet të lidhet me sllavishten gjatë pushtimit bullgar (shek. IX-X). Në dokumente të mesjetës është shkruar Japova. Në hartë gjendet dhe me emrin Xhepë. I pari gjendet (gati të njëjtë) në rrethe të tjera (Zhepovë-Përmet). Profesor Eqrem Çabej emrin Zhepë e ka gjetur në Kalabri, që do të thotë se tomorricarët e këtij fshati, pas vdekjes së Skënderbeut emigruan në Italinë Jugore. Në vitin 1906 ishte fshat çifçinjsh (Vlora, 2003). Me vendimin e qeverisë në vitin 1938 u propozua të quhej Shega. Ndodhet në kurrizin kodrinor midis përrenjve të Marianit (veri) e Rovenit (jug), të cilët e ndajnë me fshatrat Çorrotat, Gurazez e Leskovë. I përket Tomorricës së Zezë ose asaj të Skraparit. Është mbi 1 km larg Çërricës (perëndim) e Leskovës (jug), 1.7-2 km nga Gurazezi (veri), 7.5 km nga Gjerbësi dhe mbi 5 km larg luginës së Tomorricës. Në regjistrimin e vitit 1431 (Japova) kishte 9 shtëpi, 1



grua të ve e të ardhura 755 akçe/vit. Dekreti Nr. 2593, dt. 6.2.1958 e përfshiu në lokalitetin e Gjerbësit; ai Nr. 4834, dt. 30.3.1971 krijoi fshatin e bashkuar me të njëjtin emër (Zhepa qendër), ku u përfshin: Çërrica, Çorrotati, Gurrazezi e Leskova. Popullsia e kooperativës ishte 1942 banorë, ndërsa drejtimi ekonomik ishte bujqësia e blegtoria. Mbizotëronin drithërat e bukës.

Organizimi administrativ vendor i vitit 1992 dhe Ligji nr. 8653, dt. 31.07.2000, përditësuar në vitin 2003, e shpallën qendër komune me 16 fshatra. Qendra e njësisë administrative është vendosur në Konak (më herët pjesë e Treblës), pranë luginës së Tomorricës e djathtas lumit. Kjo është zgjedhur për të mundësuar shërbime për fshatrat e komunës majtas lumit Tomorricë (Trebël, Shpatanj, Luadh, Rromas, Tërrovë e Duncka). Kjo e fundit tashmë është braktisur. Në fillimet e shekullit të kaluar, në fshatin Konak organizohej pazar i madh krahinor. Vinin banorë nga gjithë fshatrat përreth. Shiteshin e bliheshin prodhimet bujqësore e blegtorale, por dhe industriale të marra nga tregu i qyteteve. Tregu vazhdoi dhe shumë kohë më pas. Në Konak janë 2-3 shtëpitë e familjeve Fusha, një shkollë e ciklit të ulët, zyrat e komunës, një lapidar i ndërtuar vitet e fundit, por në vitin 2012 ende s'kishte pllakën përkujtimore. Kjo njësi ka këto koordinata gjeografike (1): Gjerësi gjeografike  $40^{\circ}40'11''$  e  $40^{\circ}44' 17''$  gjatësi gjeografike  $20^{\circ}14'21''$  e  $20^{\circ}16' 23''$ .



Foto 1. Hartë fizike e Tomorricës

Burimi: Lirëza, Q., Monografi "Tomorrica", Trashëgimi Natyrore. Tiranë 2014

Trualli ka ndërtim gjeologjik të njëjtë me fshatrat përreth (disa të përmendur më sipër). Shkëmbinjtë flishorë të paleogjenit (oligocen i mesëm), janë pjesë e krahut perëndimor të sinklinalit të Tomorricës. Kanë rënie në lindje  $15-20^\circ$ . (Lirëza, 1994). Banorët kanë përdorur gjerësisht ranorët në ndërtimin e mbulimin e shtëpive, haureve, ledhe dhe shtrim të oborrit e rrugicave. Relievi është kodrinor-malor, ku lartësitë janë nga 600-780 m (përrenjtë e Rovenit, Gurrës) në 1350 m në Koshnicë. Shtrirjen më të madhe e ka relievi kodrinor. Në të shprehet dobët morfologjia e shkallëzuar dhe majat e kodrave janë pak të rrumbullakosura. Relievi është i copëtuar nga rrjedhje ujore, ku mbizotërojnë ato të përkohshme. Copëtimi vertikal është  $150-200 \text{ m/km}^2$  (pjesa qendrore) deri  $300 \text{ m/km}^2$  (ajo lindore). Rritja e shifrës ë dytë kushtëzohet nga litologjia e struktura e Koshnicës. Janë të konsiderueshme vlerat e copëtimit horizontal. Në shpatin e Koshnicës,  $3 \text{ km/km}^2$ , ndërsa në territorin përreth fshatit mbi 4

km/km<sup>2</sup>. Ka sektorë (lugina Rovenit) ku vlerat rriten 5 km/km<sup>2</sup>. Shpati është degraduar, ka vatra erozioni të favorizuara shumë edhe nga dalja në sipërfaqe e shkëmbinjve argjilo-alevrolitorë, dëmtimi bimësisë etj. (lugina e Marianit, pranë majës së Çukës, 1075 m). Ashtu si në raste të ngjashme (Sala, 2007), përfshi dhe Tomorricën, shpesh pikënisje e tyre kanë qenë rrëshqitjet. Zgjerimi i tyre vazhdon ende. Në Zhepë shprehet mirë dhe procesi i rrëzimeve, veçanërisht Shkëmbi i Zhepës (konglomerat). Rrëpira litologjike në formë gjysmë harku (lartësi 744 m) është në jug- jugperëndim të fshatit, me përmasa gati 1 km gjatësi e lartësi mesatare 35-40 m. Në pjesën e sipërme ka shkurre të rralla. Materiali që rrëzohet ka formuar kon depozitimi rrëzë kësaj rrëpire. Për vlerat që ka është propozuar monument natyre (*Lirëza, Sala, 2014*). Luginat përfaqësohen me pjesë të Gurrës e Rovenit, që shërbejnë si kufi ndarës me fshatrat Çorrotat, Gurazet e Leskovë. Ajo e Gurrës përfaqësohet më shumë dhe me të Marianit. Është obsekuente dhe për shkaqe litologjike ka pak gjarpërime, me zallishte të vogla në grykëderdhje përrenjsh. Brigjet mbi shtrat janë deri 1 m lartësi, veçanërisht midis lartësive 650-950 m. Lugina e Rovenit, pranë ish-mullirit të Leskovës, është më pak e përpunuar. Shpatet kanë pjerrësi të vogël deri mesatare, por rrëshqitje, shembje e rripa, ndonëse në përgjithësi ruhet bimësia (dallon ajo e Marainit). Sipas Atlasit Klimatik të Shqipërisë, klima është mesdhetare kodrinore e pjesërisht paramalore (lindje).

## II. Metoda

Për hartimin e kësaj kumtese jemi bazuar në metoda shkencore hulumtuese. Janë kryer vëzhgime të drejtpërdrejta në terren, për t'u njohur me kushtet natyrore të kësaj komune, duke evidentuar qartë pozitën gjeografike, kushtet natyrore, potencialet e saj për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. Metodologjia bazë ka


qenë ajo e vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren si dhe shfrytëzimi i shumë materialeve arkivore pranë këshillit të rrethit të Skraparit apo dhe burimet arkivore që ka pasur vetë komuna. Për të dhënë fakte sa më të sakta janë hartuar dhe pyetësorë të ndryshëm me banorët e fshatrave të kësaj zone, sipas një kriteri shkencor. Metoda e krahasimit të të dhënave dhe fakteve të ndryshme me zonat përreth është një tregues tjetër i punës studimore. Vend të rëndësishëm zë dhe literatura e gjerë që është përdorur në këtë kumtesë, e autorëve të vendit dhe të huaj.

### III. Rezultatet

Relievi i kësaj zone është kodrinor-malor, me lartësi 450 m (lugina e Tomorricës) dhe rreth 2000 m (mali Kulmakut. Në këtë të fundit shtrihen gëlqerorë të pasur me karbonat kalciumi, ndaj formohet relievi tipik karstik (hinka, dolina, uvala karstike etj. (Sgobba, Savino, 1995) mbi 4-5 dolina e gropa/km<sup>2</sup>. Rrëzë shpatit verior të Kulmakut është shpella e Dërvalmit me stalaktite e stalagmite e mjaft legjenda. S'është e eksploruar në thellësi, por në vitet '70-'80 u dëmtua nga tunelet ushtarake. Duhet të ketë shpella të tjera sipër saj, sepse kushtet janë shumë të përshtatshme. Në lartësi janë disa maja mbi 1700 m (Burranjit, 1619 m) plot forma karstike përreth. Në jug të Gjerbësit ka disa rrëpira litologjike (lartësitë 1200-1700 m) si pasojë e neotektonikës dhe erozionit. Më e madhja e kalon gjatësinë 350-400 m e lartësi mesatare mbi 35 m. Në to ka guva karstike, ndoshta në brendësi vazhdojnë shpellat.

Trualli ka ndërtim gjeologjik të njëjtë me fshatrat përreth (disa të përmendur më sipër). Shkëmbinjtë flishorë të paleogjenit (oligocen i mesëm) janë pjesë e krahut perëndimor të sinklinalit të Tomorricës. Kanë rënie në lindje 15-20°. (Lirëza, 1984) Banorët kanë përdorur gjerësisht ranorët në ndërtimin e mbulimin e shtëpive, haureve, ledhe dhe shtrim të oborrit e rrugicave. Relievi

është kodrinor-malor, ku lartësitë janë nga 600-780 m (përrenjtë e Rovenit, Gurrës) në 1350 m në Koshnicë. Shtrirjen më të madhe e ka relievi kodrinor (profil gjeomorfologjik Tomorr- Tomorricë). Në të shprehet dobët morfologjia e shkallëzuar dhe majat e kodrave janë pak të rrumbullakosura.



Profil shkronjor gjeomorfologjik Tomorr-Tomorricë. Qëndrore, C. Shkollaj, E. Pajçiq  
1. Gurgureti, 2. Pishë, 3. Çeljanjtë, 4. Konglimerate

Burimi: Lirëza., Q. Gjeomorfologjia, Tiranë, 2012

Kurrizi kodrinor midis përrenjve Roven-Gurrës ka mbi 10 maja (kueste), kryesisht në 780-1000 m. Përgjatë qafave subsekuente ndarëse kalojnë rrugët këmbësore që e lidhin Zhepën me fshatrat fqinje e Koshnicën. Në dy prej tyre janë vendosur pjesa më e madhe e shtëpive.

Kuestet s'dallohen mirë, sepse rrjedhjet dytësore janë të përkohshme.

### 3.1 Treguesit socialë - ekonomikë të kësaj njësie administrative

Në fshatin Zhepë janë këto fise: Çelanjt (më i madhi), Boçët, Lamenjt, Liçollarët, Seitajt e Ramët (shumë për një fshat të vogël). S'dihet nga kanë ardhur, por motiv ishin kullotat, burimet, gjakmarrja etj. Në vitin 1906 Eqerem bej Vlora përmend disa

kasolle e njerëz të varfër në Qafë Dardhë. Aty pranë ka ndeshur dhe një rrugë 6 m të gjerë, e ruajtur mirë, sipas tij e kohës romake (*Vlora, 2003*) Në vitin 1926 kishte 73 banorë (*Basha, 2005*)<sup>1</sup>, në vitin 1945 kishte 115 banorë, më 1989 kishte 302 banorë (250 ishin meshkuj), në vitin 2005 kishte 182 banorë, më 2012 kishte me gjendje civile 245 banorë (225 meshkuj), por atje janë shumë pak. Pas vitit 1990 popullsia emigroi: nga 20 persona në Greqi e Itali (më shumë se gjysma e legalizuar). Një mësues me arsim të lartë iku (1998) me lotarinë amerikane. 10 familje shkuan në Tiranë, 2 Durrës, 2-3 Gramsh dhe kaq në qytete të tjera bregdetare. Tërrova u bë kooperativë për herë të parë në vitin 1958, me kryetar Qemal Çelon e më pas Demir Liçollarin. Në vitet '70 u bë pjesë e kooperativës së bashkuar Dobrenj (Rromas, Trebël, Dunckë, Luadh, Buranj). Drejtimi kryesor ishin bujqësi-blegtoaria. Në vitin 1989 kishte 632 ha tokë të punueshme: 6 ha vresht, 3-4 ha pemë frutore, 6 ha pjergulla, 250 ha grurë, mbi 100 ha misër, 5-6 ha perime të vona (domate 2 ha), 3-4 ha fasule etj. Puna, farërat dhe agroteknika mundësuan rendimente relativisht të mira (grurë 30-40 kv/ha, misër, fasule 10-15 kv/ha). Kishte 400 krerë bagëti të imta (220 dhi), 40-50 gjedhë, 12-15 kuaj, 18-20 mushka e 4-5 gomarë. Disa ha plugoheshin me traktorë, gruri shihej me makinë. Transporti, ndarja e prodhimeve bëhej si në gjithë fshatrat e tjera. Qumështi përpunohej në baxho e prodhimet cilësore të bulmetit shkonin në tregun e qytetit. Të ardhurat për ditë punë ishin 130 lekë (1970) e 12 lekë në vitin 1987. Baxhoja ende prodhon në vit gati 55 kv djathë, 2 kv gjalpë 5-6 kv gjizë. Me shumë vështirësi e çmim të ulët gjendet tregu nëpërmjet rrugës rurale malore të braktisur. Nga popullsia e mbetur janë të punësuar 2 në administratën e njësisë. Tërrova lidhet me rrugë

---

rurale me komunën (12 km), por një pjesë përgjatë zallishtes së Tomorricës 5-6 muaj nuk përdoret.

Komuna paguan 1 person me 7000 lekë/muaj për mirëmbajtje. Fshati ka vetëm 1 makinë "Land Rover". Gjatë viteve 1968-1970 fshati u elektrifikua. Sot përdoret pak energjia në ngrohjen e bolierëve. Familjet e paguajnë rregullisht atë e drutë e zjarrit. Ujin e pijshëm e marrin vetë nga burime deri 2 km larg. Banorët përkrahën edhe Luftën Nacionalçlirimtare. Disa iu bashkuan Brigadës së Parë Sulmuese me komandant Mehmet Shehun. Lapidari në Qafën e Tërrovës përkujton një ndër betejat e forcave partizane kundër pushtuesit e bashkëpunëtorëve të tyre. Fshati u çlirua nga forcat partizane të Grupit "Myzeqeja" në dimrin e vitit 1944.

Shkolla u hap në vitin 1949 me 20 nxënës e mësues Idari Çelën me arsimin e mesëm profesional (Elbasan). Nxënës vinin dhe nga Rromasi. Në vitin 1968 shkolla u bë 8-vjeçare me 48 nxënës e 4 mësues (nga Korça e Gjirokastra, me arsimin përkatës). Mësuesit qëndronin në mjediset e shkollës, por banorët i ftonin shumë shpesh në familje. Kishte respekt reciprok shumë të lartë mësues-banorë, për të cilin sot ka nostalgji. 5- 6 nxënës ndiqnin shkollë të mesme pedagogjike dhe 2-3 atë të lartë (pë mësuesi, mjekësi). Ata ktheheshin në fshat duke siguruar kuadrin vendës. Kjo funksionoi mirë deri në vitin 1989. Në vitin 2012 vazhdonte shkolla 9-vjeçare "Syrja Zaimi": 20 nxënës (plus Rromas) e 2 mësues vendës. Në vitin 1989 kishte kopsht e çerdhe (me nga 10-12 fëmijë), vatër kulture, ambulancë e dyqan. Sot ka ambulancë (punësuar vendës me arsim të mesëm përkatës). Në vitet '80 kishte grup folklorik, i njohur në veprimtaritë kulturore në rreth. Banorët kanë dhënë e marrë nuse në fshatrat përreth, madje një vajzë është martuar në Gjergjovë-Potom (*Gërxhani, 2013*).

Shkolla u hap në vitin 1967 (me 23-25 nxënës dhe mësues Sali Hoxhën (vendës) me arsimin e mesëm pedagogjik). Më parë

nxënësit shkonin në shkollën e Tërrovës. Më 1989 pranë shkollës ishte kopshti e çerdhja (me nga 10-12 fëmijë), ambulanca e dyqani. Rrjeti elektrik u lidh me Tërrovën e Dunckën që nga viti 1967, por tani po përballet me amortizimin e gjatë. Banorët janë pagues të rregullt të energjisë elektrike. Vitet e fundit, falë të ardhurave nga emigracioni janë ndërtuar (rindërtuar) 3-4 shtëpi të reja, por s'kanë ujë të rrjedhshëm brenda (mungon ujësjellësi). Nëse gjen makinë të udhëtosh në Rromas-Gramsh-Rromas kostoja e biletës është 1000 lekë. Pak më shumë duhet për në Çorovodë.

Në regjistrimin e vitit 1431 kishte 40 shtëpi e 1330 akçe të ardhura/vit, më 1926 kishte 181 banorë (*Bakillari, 2008*), më 1945 kishte 186 banorë, më 1989 kishte 374, më 2001 kishte 109 banorë, më 2005 kishte 138 banorë, më 2012 kishin mbetur rreth 20 banorë, në pritje të mundësisë financiare për t'u larguar. Në vitin 1989 kishte shkollë 8-vjeçare, dyqan, ambulancë e vatër kulture. Banorët kanë bërë krushqi me fshatra në Tomorricë, por edhe jashtë saj, deri në Gjergjovë (*Gërzhzni, 2013*), ku një vajzë ka shkuar nuse. Muharrem Trebla ishte pjesëmarrës në Çetën Plakë të Skraparit. Forcat e milicisë fashisto-balliste dogjën (1942) fshatin dhe shtëpinë e tij në Trebël.

Në regjistrimin e 1431, emërtohet Kirovë (59 shtëpi, 1 grua të ve e 3410 akçe të ardhura/vit). Shënojmë se Viktor Bakillari ka botuar një libër për Grevën, por jo në këndvështrimin tonë (*Bakillari, 2012*). Qeramika e rastësishme e dëshmon vendbanim të hershëm. Greva është ndër fshatrat kryesorë të Tomorricës (gati në qendër të Tomorricës së Zezë); në ujëndarësin midis përrenjve Kovaçanj e Leskovë; në lartësitë mbidetare 870-970. Në fakt, ujëndarësi pranë fshatit ndahet nga një përrua në dy më të vegjël. Është shumë pranë Kovaçanjit (juglindje) e Postenës (lindje); rreth 10 km nga qendra e komunës (Konak), 6.5 km larg nga Gjerbësi, 3-3.5 km larg Zhepës, rreth 40 km nga Gramshi e mbi 40 km nga Çorovoda. Kovaçanj, Kuç, Postenë, Rehovë, Straficë e Vishanj).



Ndarja organizative territoriale vendore e vitit 1992 dhe ligji përkatës në vitin 2000 e la në komunën Zhepë.

Të dhënat social-ekonomike (të përafërta) i ofroi ekonomisti Fatos Mezini. Fshati ka tri fise: Mollaj, Mezini e Dervishi. Këto emërtime i gjemë dukshëm në jug të Shqipërisë, Mallakastër, etj. Mendohet se i pari erdhi fisi Mollaj (Mollaj fshat në Cakaran-Mallakastër, Mollas në Sulovë e Korçë), por s' dihet motivi kryesor i ardhjes dhe origjina. Një pjesë e këtij fisi ka shkuar në Lapardha (Berat), por ruajnë lidhjet miqësore, origjinën dhe mbiemrin Mollaj. Lidhja shpirtërore e nostalgjia me ish-vendbanimin ruhet mirë, sepse atje lindën, punuan dhe u martuan, lindën e rritën fëmijë, kanë varret e të parëve. Kjo lidhje shpirtërore do të vazhdojë edhe disa kohë. Dy fiset e tjera janë më të mëdha në numër. Para Çlirimit emigruan dy burra në Turqi (arsye ekonomike). Në vitin 1926 kishte 171 banorë (*Selenica, 1927*), në vitin 1945 kishte 186 banorë, në 1989 kishte 450 banorë në 105 familje (*INSTAT, 1989*), në vitin 2001 kishte 187 banorë, ndërsa në vitin 2012 (sipas gjendjes civile) kishin mbetur 40 banorë (28 meshkuj e 12 femra, 15 familje). 8 persona ishin në pension. Pas vitit 1990 largimet kanë qenë: në Greqi rreth 30 persona, në Itali 20-22. S' dihet numri në Angli etj.

Në vitin 1989 kishte kopsht (me 20-25 fëmijë) e çerdhe (me 18-20 fëmijë). Si qendër kooperative kishte spital (8 shtretër e 4 personel i shkolluar), dentisti nga Vëndresha, farmacisti nga Gjerbësi (arsimi i mesëm profesional). Sot shërbimi shëndetësor mbulohet nga Dobrenji. Në vitin 1989 kishte dhe shtëpi kulture, dyqanin e varfër në mallra, magazinat etj. Në vitin 2012 kishte shkollë me 12 nxënës e 1 mësues (vendës). Banorët kanë qenë të prirë të luftojnë për liritë e të drejtat e tyre. Në vitin 1700 ishin pjesëmarrës në kryengritjen kundër pushtuesve osmanë. Në udhëtimin me kalë nga Dobrenji drejt Voskopojës e Korçës (25 orë në vitin 1923) Fan Noli qëndroi një natë në Dobrenj. Në Parlament

ai deklaroi se kudo kishte parë katunde të prishura (shkatërruar), patriotizmin e sakrificat e pakursyera të popullit. Fshati u dogj e shkatërrua nga grekët (lufta italo-greke). Banorët mbështetën në çdo drejtim Luftën Nacionalçlirimtare. Disa shtuan radhët e Brigadës XVI Sulmuese. U dalluan familjet e Asllan Mezinit e Shaban Mezinit. Mitat Petref Mezini është dëshmor i fshatit. Gjatë funksionimit të ish-kooperativës, Meriban Mezini ishte deputete në ish-Kuvendin Popullor.

Shumë të rinj nga Dobrenji u shkolluan, punuan e punojnë në qytetet kryesore të vendit. Ata që ishin kthyer në fshat pas shkollimit emigruan të parët pas vitit 1990. Disa kthehen për vizitë, me nostalgji e mall të paparë për vendlindjen, p.sh. Fejzi Mezinin, i cili prej 23 vitesh vazhdon biznesin e ndërtimit në Tiranë. Ai ka ndihmuar familje në nevojë nga fshati i vet dhe në një nga itineraret tona të vështira na shoqëroi në terren. Fshati ka dy automjete fuoristradë që mundësojnë lëvizje të detyruara drejt Gramshit e Çorovodës. Ujësjiellësi u ndërtua në vitet '70 nga burimet në Koshnicë. Banorët përdorin ende burimet e çezmat e rregulluara vite më parë. Në Dobrenj vinte kanali ujitës (1.5 km), por tani është i braktisur. Rrjeti elektrik përfundoi në vitin 1968, ndaj ka amortizim. Janë shtuar pajisjet elektro-shtëpiake, por s'ka problem ngarkese për pak familjet e mbetura. Energjia, uji e drutë e zjarrit paguhen rregullisht.

Mësuesi Stefan Shatro mundi të mbledhë disa të dhëna social-ekonomike. Para vitit 1920 emigruan në Turqi (për arsye ekonomike) 8-10 persona. Të tjerë shkuan si krahë punë në rrethet bujqësore të Shqipërisë (1960-1980). Në vitin 1926 kishte 155 banorë (*Selenica, 1927*), më 1945 kishte 230 banorë, më 1989 kishte 261 banorë (*INSTAT, 1989*), më 2005 kishte 225 banorë e në vitin 2020 kishte 24 banorë (*Zyra e statistikës, njësia Zhepë, 2013*). Emigrimi i meshkujve mundëson numër më të madh të femrave (50 banorë). 20 ishte numri i pensionistëve. Mendohet se pas vitit

1990 kanë emigruar 40-50 persona në Greqi, 10-15 në Itali, 18-20 familje në Tiranë e Durrës, 3-4 në Çorovodë, Elbasan, Gramsh dhe 20-25 në Korçë. Disa familje rikthehen në verë përkohësisht. Leskova u bë kooperativë në vitin 1956 (Sefer Kovo, kryetar). Sipërfaqja e tokës së punueshme u rrit, veçanërisht në vitet '70. Shtesa natyrore e lartë dhe ndalimi i largimeve e rriti popullsinë në fshat, e cila donte punë e prodhime bujqësore. Në fundin e vitit 1989 sipërfaqja e tokës së punueshme ishte mbi 120 ha. Grurë mbillej mbi 50 ha (30 kv/ha), misër 20-25 ha (40-50 kv/ha), vresht 1.5 ha, mollë 3-4 ha, etj. Investimet në mekanikë bujqësore, agroteknikë, ujitje etj. rritën prodhimin, por kostoja ishte e lartë. Traktorët plugonin sipërfaqe të konsiderueshme toke arë. Gruri shihej me makinë. Mbjelljet bëheshin me parmendë. Me kafshët e ngarkesës e kamionin e kooperativës prodhimet shkonin në magazina. Ndarja bëhej për frymë/familje dhe ishte e ligjëruar. Leskova renditej në kooperativat e mira në Skrapar me pagesa: 150 lekë ditë/pune në vitin 1970 dhe 130 lekë në vitin 1987. Pas vitit 1990 toka u nda e familjet morën tapitë. Tani në Mitrovicë etj. toka e braktisur e djerrë po shkatërrohet nga rrëshqitjet dhe erozioni. Në vitin 1989 kishte kopsht e çerdhe (nga 15-20 fëmijë). Shkollën e parë e hapi shteti (1946) me 12-15 nxënës, ku punuan mësuesit Todi Linko, Asllan Shatro etj.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm i kësaj hapësire gjeografike do të rendisim disa konkluzione të përgjithshme. Kjo zonë shtrihet në krahinën e Tomorricës dhe i përket rrethit të Skraparit. Shtrihet në pjesën verilindore të këtij rrethi, kryesisht përgjatë luginës kryesore të kësaj zone, luginës së Tomorricës. Është një zonë me vendbanime të hershme dhe ka kaluar përmes një evolucioni të gjatë si natyror, ashtu dhe historik, demografik dhe ekonomik. Në këtë komunë ndodhen 14 fshatra që shtrihen

në pjesën e mesme të luginës së Tomorricës, në të dy krahët e lumit të Tomorricës. Në krahun e majtë, në pjesën e mesme të luginës ndodhen fshatrat: Tërrovë, Rromas, Luadh, Shpatanj dhe Trebël. Kurse në krahun e djathtë ndodhen fshatrat: Grevë, Kovaçanj, Postenë, Leskovë, Zhepë, Gurazes, Burranj, Çorrotat, Dobrenj. Disa nga këto fshatra janë gati të braktisura si; Shpatanji, Luadhi dhe Davidhi. Kurse te të tjerët vihet re një rënie e madhe e numrit të popullsisë. Ky fenomen ka ndodhur pas viteve '90 kur filloi lëvizja e lirë e qytetarëve. Relievi i kësaj zonë është tipik kodrinor, me kuotën më të lartë malin e Grevës, 1400 m mbi nivelin e detit. Klima përgjithësisht është mesdhetare kodrinore dhe paramalore, me reshje të bollshme. Nga pikëpamja social-ekonomike është një njësi administrative me rënie të madhe të numrit të popullsisë, për shkak të lëvizjeve të brendshme mekanike si dhe emigracionit në vende të tilla si Greqi dhe Itali. Dega bazë e ekonomisë është bujqësia dhe blegtoria. Në kumtesë jepen shumë tregues të ndryshëm për vlerësimin e saj nga pikëpamja ekonomike, që në periudhat më të hershme deri në vitin 2014.

Disa rekomandime për këtë zonë do të ishin:

Të rishikohet reforma territoriale, për shfrytëzimin më të mirë të burimeve natyrore, sepse kjo ndarje është inefficente. Të merren masa për investime në infrastrukturë. Të stimulohen fermerët me kredi të buta, me qëllim rritjen e prodhimit vendës. Të zhvillohet agroturizmi në këtë zonë, sepse i ka kushtet natyrore dhe klimatike shumë të favorshme. Ndërtimi i rrugës automobilistike Çorovodë – Korçë do të sillte një rivitalizim të të gjithë krahinës së Tomorricës.

### **Literatura**

- Basha, (2005). Tomori përballë nesh. Tiranë, f. 120  
 Bakillari, (2008). Visaret e Skraparit. Tiranë. f. 45

- Bakillari, (2012) Visaret e Skraparit Tiranë. f. 23
- Gërkhani, (2013). Monografi "Gjergjova" Skrapar. f. 34
- INSTAT, (1989). Tiranë
- INSTAT, (2011). Regjistrimi i popullsisë. Censusi. Tiranë.
- Instituti i Topografisë Ushtarake, (1983). Harta topografike (1:25 000). Tiranë.
- Instituti i Gjeologjisë dhe Minierave (1983) Harta gjeologjike e Shqipërisë. Tiranë.
- Lirëza, Q., (1994). Harta gjeomorfologjike e rrethit të Skraparit. Disertacion. Tiranë, f. 110-112
- Lirëza, Q., (2004). Harta gjeomorfologjike e rrethit të Skraparit. Tiranë, f. 56
- Lirëza, Q., (2008). Potencialet turistike në Qarkun e Elbasanit. Buletini UNIEL. Elbasan, f. 12
- Lirëza, Q., (2010). Rreziqet gjeomorfologjike në zonën e Tomorricës, Studime Albanologjike, nr. 4. Tiranë.
- Lirëza, Q., Sala, S., (2011). Tomorrca: Trashëgimia natyrore. Tiranë, f. 24
- Lirëza, Q., (2012). Gjeomorfologjia
- Zyra e Statistikës, Njësia Zhepë, 2013.

**Prof. dr. Shyqyri Hysi<sup>1</sup>**

**Dr. Arben Hysi**

## **PROBLEME ADMINISTRATIVE NË BASHKITË TEPELENË DHE MEMALIAJ NË VITET 1944 -2014 DHE NDIKIMI I TYRE NË TIPARET DHE ZHVILLIMIN E KËTYRE QENDRAVE TË BANUARA**

### **Abstrakt**

Lugina e Vjosës ose Aos-it, me resurset e saj ka shërbyer si një areal i rëndësishëm për vendosjen e qendrave të banimit nga lashtësia deri në ditët tona. Në krahun e majtë të rrjedhës së mesme të saj gjenden dy qendra urbane: Tepelena dhe Memaliaj.

Tepelena është një qendër historike që starton nga shek. II e.s. Ajo evidentohet gjatë antikitetit, mesjetës, Rilindjes dhe ka shërbyer si qendër administrative për trevën. Pas Luftës II Botërore, ajo u shndërrua në qendër nënprefekturë dhe rrethi. Pas zgjedhjeve të vitit 1945 Tepelena u shndërrua në nënprefekturë me katër njësi administrative: Kurveleshin, Lopsin, Krahësin dhe Buzin. Në vitin 1945 Tepelena kishte në administrim 61 qendra banimi, përfshi edhe Memaliajin që deri në vitin 1955 nuk kishte statusin e qytetit. Këtë status e mori më 2 maj 1955, ditë e cila është shpallur edhe si data e themelimit të qytetit të minatorëve.

Memaliaji është një qendër urbane e re dhe u formua me hapjen e MQGM në vitin 1955. Deri në vitin 1992 Memaliaji është administruar prej Tepelenës, si qendër rrethi. Në vitin 1992 mori statusin e bashkisë. Ndërsa në vitin 2014 nën juridiksionin e saj kaluan edhe komunat: Buz, Luftinjë, Memaliaj Fshat, Qesarat

---

<sup>1</sup> *Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Arben Hysi, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë*

dhe Krahës. Pra, gjithë trevën në krahun e djathtë të Vjosës. Tepelena nga rreth kaloi në qendër bashkie. Bashkia e Tepelenës (2014) mori nën administrim edhe komunat: Komuna Qendër, Lopsin, Kurveleshin. Komuna të cilat ndodhen në krahun e majtë të Vjosës. Ndryshimi i kushteve politike, ekonomike e sociale ka bërë që herë pas here, organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor të përshtatet, por me metoda radikale nga pushteti qendror ose organet ligjvënese. Resurset ekonomike përfaqësohen nga: minerali i qymyrit, fosforit, zhavorret, pyjet, kullotat alpine, tokat bujqësore, fauna dhe flora e pasur, ujërat e lumenjve (Vjosa me afluentët e saj: Drino, Bënçë, Luftinjë).

*Fjalë çelës: urbanizim, bashki, popullsi, Vjosa, shoqërore.*

### **Abstract**

The Vjosa or Aos valley, with its resources, has emerged as an important area for the establishment of residential centers from antiquity to the present day. On the left side of its middle course, there are two urban centers: Tepelena and Memaliaj. Tepelena is a historical center, starting from the century II b.c. It is evidenced during antiquity, the Middle Ages, the Renaissance and served as an administrative center for the region. After World War II, it became the center of the Sub-Prefecture and the district. According to the elections of 1945, Tepelena was transformed into a Sub-Prefecture with four administrative units: Kurvelesh, Lopws, Krahws and Buzin. In 1945 Tepelena had in administration 61 residential centers, including Memaliaj which until 1955 did not have the status of a city. He received this status on May 2, 1955, the day which was also announced as the founding date of the city of miners. Memaliaj is a new urban center. It was formed with the opening of the MQGM in 1955. Until 1992 Memaliaj was administered by Tepelena, as the center of the district. In 1992 it received the status of municipality. Whereas, in 2014 under its jurisdiction passed the municipalities: Buz, Luftinjw, Memaliaj Fshat (Memaliaj Vilage), Qesarat and Krahws. So, the whole area on the right bank of the Vjosa. While Tepelena from the district moved to the center of the municipality and in 2014 took under administration the municipalities: Komumna Qendër, Lopsin, Kurveleshin. Municipalities which are located on the left bank of the Vjosa. The change of political, economic and social conditions has caused from time to time, the organization and functioning of local government to be adapted, but with radical methods by the central government or legislative bodies. Economic resources are represented by: coal mineral, phosphorus, gravel,

forests, alpine pastures, agricultural lands, rich fauna and flora, river waters (Vjosa with its tributaries: Drino, Bënçë, Luftinjë).

*Keywords:* urbanization, municipality, population, Vjosa, social.

## I. Hyrje

Shqipëria ka pasur një zhvillim të hershëm të qyteteve, por në kohën e sotme të zhvillimit të shoqërisë në dimensionet e zhvillimit politik, ekonomik, teknologjik, social-kulturor të qyteteve shqiptare klasifikohen jo në një kriter të përshtatshëm me qasjet OECD dhe KE (*Dijkstra, 2012*). Urbanizimi duhet të plotësojë kushtet që lidhen me faktorët demografikë, ekonomikë, punësim, shoqërorë. Në bazë të këtyre faktorëve, në periudhën 1944-1990 u krijuan qytete të reja, midis tyre edhe Memaliaji. Memaliaji njihet si qytet industrial i nxjerrjes së qymyrgurit. Por, mbas vitit 1991 reduktimi e mbyllja e minierës së qymyrgurit e vuri në pikëpyetje ekzistencën e tij si qytet. Urbanizimi është procesi që përmban ndryshimet social-kulturore, procesin e ambientimit, bashkimit ose unifikimin e imigrantëve me masën qytetare (*Erkan, 2002:19*).

Strukturimi i shoqërisë shqiptare mbas viteve 1944, në lidhje me elementet strukturore (shoqëri, vendbanim, individ) dhe të organizimit shoqëror, ishte i detyruar nga politikat e centralizuara, ku individi si element ishte i varur të gjente veten në këtë strukturë. Pas viti 1991, me ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik, individi në mënyrë të pavarur ishte përcaktues në zhvillimin urban të vendit.

Për shkak të kalimit nga një ekonomi e planifikuar në atë të tregut, u shfaqën probleme të shumta sociale: papunësia, varfëria, arsimit, shëndetësia etj. Pas vitit 1991 riorganizimi politik i shoqërisë mbi bazën e ish-organizimit administrativ të mëparshëm (shumica e komunave mbi bazën e kooperativave



bujqësore) solli dështimin e pushtetit vendor në realizimin e misionit të vet.

Gjatë periudhës 1991-2014, u evidentuan një sërë problemesh të administrimit të pushtetit vendor. Me ndihmën e organizatave të huaja dhe vendore mbas vitit 2013, u realizua reforma territoriale e vitit 2014. Koncepti i ri administrativ e nënkuptonte njësinë vendore të integruar në: drejtim të infrastrukturës, ekonomisë, aspekteve sociale, demografike, shpirtërore etj. Me reformën e vitit 2014 u transferuan dhe disa funksione, por nuk u shoqëruan me transferimin e duhur financiar.

## **II. Metoda**

Grumbullimi i të dhënave prej burimeve parësore dhe dytësore është pasuar nga analiza e faktorëve administrativë e historikë në zhvillimin e qendrave urbane Tepelenë dhe Memaliaj. Metoda krahasimore e të dhënave është përdorur për të dyja periudhat, 1945 – 1990 dhe 1991 - 2014. Induktiviteti dhe deduktiviteti kanë qenë metoda kushtëzuese në përpunimin e këtij materiali. Analiza e të dhënave është bërë nëpërmjet metodës: statistikore, përshkrimit, paraqitjes grafike, ndërtimit të tabelave etj.

## **III. Historiku i zhvillimit urban dhe administrativ i Tepelenës dhe Memaliajit**

Tepelena dhe Memaliaji janë dy qendra banimi që ndodhen në krahun e majtë të lumit Vjosë. Lumë i cili në lashtësi njihet me emrin Aos ose Aoos dhe që do të thotë lumi i Zotit. Për këto qendra banimi kanë shkruar: H. Holand, E. Çelebiu, Burecart, Novak, Paster, N. Meçaj, S. Hasa, B. Musta, M. Cukalla, N. Shehu, K. Prifti, N. Beluli, V. Krutaj, Gj. Jupe, M. Jera, E. Ruçi, Z. Skëndi, Xh. Cana, Xh. Xhemalaj, Sh. Daja, J. Cana, S. Lupo, A. Zeqaj, A. Tota, E. Shehu etj.

Relievi ku shtrihen këto dy qendra urbane është malor. Maja më e lartë, Këndrevica, është në malin e Gribës, 2122 m (*Meçaj, 2007: 66.*), ndërsa pika më e ulët gjendet në lumin e Vjosës, Kalivaç, 64 m mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e trevës është 732 m. Ndërsa zona kodrinoro – malore zë 40% të territorit. Tepelena është një qendër historike urbane, ndërsa Memaliaji është një qendër e re, e themeluar në vitin 1955 (*Fletore Zyrtare, 1955: 64.*) Bashkia e Memaliajit feston 2 majin 1955 me vendim të Këshillit Bashkiak, nr. 26, datë 16. 10. 2014, si datën e themelimit të qytetit. (*Arkivi i Bashkisë Memaliaj*). Ngritja dhe zhvillimi i kësaj qendre banimi lidhet me shfrytëzimin e qymyrgurit (1914, 1916, 1941, 1947, 1955).

Tepelena evidentohet si qendër banimi qysh në periudhën romake dhe sipas Sami Frashërit njihej me emrin Tamita (*AQSH, F. 200, D. 25: 42*). Në hartën e Ptolemeut fisi që banonte në Tepelenë quhej TIMPHALIA. Ka studiues që emrin e Tepelenës e nxjerrin nga Typhalia – Tympalia – Timpalia – Timpalën – Tempelenë – Tepelenë. Ka gjithashtu mendime se “emri i qytetit rrjedh prej princshës Helena” (*Shehu, 2005*) dhe fjalës osmane tepe = kreshtë. Gjithsesi emri Tepelenë është mesjetar, emër të cilën mban edhe sot kjo qendër urbane.

Tepelena ishte qytet dhe qendër administrative gjatë pushtimit osman në shek. XV – 1912. Ajo e ka ruajtur këtë status gjatë gjithë ekzistencës së shtetit shqiptar. Tepelena ka shërbyer si qendër administrative (rreth) edhe për Memaliajin dhe trevën përreth, që nga viti 1944 deri në vitin 1990 (*Meçaj, Tiranë, 1978: 24*). Ndërsa Memaliaji u njoh si qendër administrative - bashki në zgjedhjet e para pluraliste për pushtetin vendor të vitit 1992. Edhe me reformën e vitit 2014 Memaliaji e ruajti këtë status, duke përfshirë edhe pesë ish-komunat e krahut të djathtë të Vjosës.

Qendra urbane e Tepelenës është historike. Ajo starton në shek. II të e.s dhe lidhet me ngritjen e funksionimin e kështjellës së

qytetit. Ajo ruhet në një gjendje të mirë dhe është ndërtuar në disa faza:

a) Shek. II – VI e.s.

b) Shek. VI – XI

c) Familja e madhe feudale e Zenebishëve

d) Pushtuesit osmanë e shkatërruan kështjellën në vitin 1419 – 1420. Bajaziti II në vitet 1492 – 1493 e ringriti përsëri kështjellën me gurët e së parës.

dh) Kështjella që ruhet edhe sot është produkt i Ali Pashës. Aliu rindërtoi Sarajet e të parëve, në të cilat priti edhe Bajronin (1809). Ndërsa kështjellën e përfundoi në vitin 1819. Gurorja ishte midis Turanit dhe Dukajt dhe që andej gurët vinin dorë më dorë si një rrip transmetimi i pandërprerë. *“Gurorja në Çekane është vendi ku u nxorën gurët për kështjellën dhe sarajet e famshme të Ali Pashës në Tepelenë”* (Ruka, 2021:52)

Nga dita e çlirimit të qytetit më 15 shtator 1943 e deri në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, Tepelena u qeveris nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar. Mbi bazën e *“Vendimit për: Emërimin e komisioneve për rrethet elektorale”* (Gazeta Zyrtare nr. 68. Nëntor 1945: 1.) dhe *“Ligjit nr. 15, datë 22 dhjetor 1944”* edhe në Tepelenë u zhvilluan zgjedhjet për KANÇ. Ligji i zgjedhjeve *“Mbi KANÇ-in, të lokaliteteve, N/Prefekturave dhe Prefekturave”* (Gazeta Zyrtare, dhjetor 1944). Propozimi për zgjedhje të Asamblesë Kushtetuese u bë nga Kongresi I i Frontit Nacionalçlirimtar, gusht 1945. Këtë propozim e shqyrtoi Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në mbledhjen e tetë të tij, në shtator 1945 (Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, 1983:41), i cili miratoi tri ligje: *“Mbi Asamblenë Kushtetuese”, “Mbi zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit për në asamblenë kushtetuese”, “Mbi listat elektorale”*. (Histori e popullit shqiptar, Tiranë, Toena: 2008: 174). Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar me vendimin nr. 120, datë 1. 10. 1945 theksonte edhe masat për zhvillimin e

zgjedhjeve: “Zgjedhjet për përfaqësues të pushtetit të popullit dhe Asamblenë Kushtetuese të bëhen 2 dhjetor 1945, ditën e diel, duke filluar nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 19 të mbrëmjes” (Gazeta Zyrtare, 54: 1945).

Sipas zgjedhjeve të vitit 1945, Tepelena u shndërrua në n/prefekturë me katër njësi administrative: Kurveleshin, Lopsin, Krahësin dhe Buzin. Në vitin 1945 Tepelena kishte 61 qendra banimi; 60 fshatra dhe një qytet, Tepelenën me 435 banorë (Vjetar statistikor, 1958:24), ndërsa në vitin 1958 kishte 62 qendra banimi, sepse në vitin 1955 u shtua qyteti i Memaliajit. U krijuan Memaliaj fshat dhe Memaliaj qytet, me 1100 banorë (Vjetar statistikor, 1958: 72). Në vitin 1958 Tepelena si rreth kishte: *Sipërfaqja 815 km<sup>2</sup>, dy qytete, Tepelenë dhe Memaliaj, pesë lokalitete dhe 62 fshatra* (Vjetar statistikor, 1954:5). Ndërsa në vitin 1968 kishte: *“Sipërfaqja 817 km<sup>2</sup> dy qytete nën drejtimin e Këshillave Popullorë (Tepelenë – Memaliaj), katër lokalitete, gjashtë fshatra të bashkuar dhe 61 fshatra* (Vjetar statistikor, 1968:5).

#### **IV. Analiza e zhvillimit social-ekonomik- Tepelenë, Memaliaj (1944-2014)**

Zhvillimi ekonomik i të dyja qyteteve (Tepelenë – Memaliaj) është lidhur kryesisht me prodhimet bujqësore e blegtorale, si dhe përpunimin e tyre. Por, Memaliaji si qendër urbane mbështetej kryesisht te punëtorët që shfrytëzonin shtresat qymyrgurore. Vendburimi i qymyrgurit është studiuar prej italianëve në vitet 1914 - 1916, 1922 – 1924. Në vitin 1926 firma italiane “*Sindicate Italiano Giaccimenti Minerali Albanisi*” mori koncesionin për shfrytëzimin e qymyrgurit në Memaliaj. Ky koncesion u anulua me Ligjin nr. 183, datë 22. 12. 1945 “*Mbi revokimin e komisioneve minerale të akorduara në bazë të Ligjit të Minerave në fuqi*” (Gazeta Zyrtare, nr. 2, janar 1945: 2). Italianët bënë përpjekje për nxjerrjen e qymyrit edhe në vitet 1940 - 1941. Në vitin 1924, një arkeolog

austriak bëri një vlerësim të shkurtër të këtij vendburimi, ndërsa inxhinierët polakë hartuan në vitin 1956 një studim më të plotë. Studiuesit shqiptarë kanë dhënë vlerësime në vitet 1950-1951. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në vitin 1965, ndërmarrja e Gjeologji Minerës, Gjirokastër, më 1974 dhe 1987. Qymyr gjendet në shtresat qymyrbajtëse në molasën miocenike (tortonian) (*Fjalori Enciklopedik*, 2009: 2190).

Shfrytëzimi sipërfaqësor filloi në vitin 1916. Në vitin 1941 u nxorën 800 tonët e parë të qymyrit. Ndërmarrja *Miniera e Qymyrgurit Memaliaj* (më tej - MQGM) u ligjërue më 16 korrik 1949 dhe u shpall më 15 gusht 1949. Si vendburim nxjerrës i qymyrgurit kishte punuar edhe në vitet 1946 – 1949 (*Hoxha*, 2005:85). Në vitin 1946 kishte 82 punëtorë, ndërsa në vitin 1949 - 100 punëtorë. Numri i punëtorëve erdhi duke u rritur, në vitin 1990 kishte 2800 punëtorë, pa repartet ndihmëse. Së bashku me to llogariteshin 4800 punëtorë. Nga këta, 73 me arsim të lartë, 42 inxhinierë, 612 me arsim të mesëm, 510 punëtorë të kualifikuar me kategori të 7-të, minatorët zinin 48% të klasës punëtore të rrethit të Tepelenës në vitin 1990 (*Cukalla, Gazeta "Telegraf", 22 shkurt 2021*). Në vitin 1987 miniera nxori 500 000 tonë qymyr. MQGM nxori 160 herë më shumë qymyr se në vitin 1951. Qymyri i tipit linjit i MQGM kishte 5500 kil.kal/kg dhe një përmbajtje squfuri 1 – 3%. Qymyri i saj shkonte për fabrikat e tullave, për tecet, në industrinë e përpunimit, për ngrohje në institucione publike e shtetërore dhe në popullatë. Sasia më e madhe e shitur deri në vitin 1989, kur ndërmarrja deklaroi se kishte shitur (1946 – 1989), 10 126 000 tonë qymyr, në 24 rrethe të Republikës (*Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985*). Nga viti 1993 deri në vitin 2000, MQGM shiste 25 000 tonë qymyr në vit. Gjithsej llogariten 10 519 193 tonë qymyr të nxjerrë prej MQGM (*Gazeta "Telegraf", 4 nëntor 2021*). Gjatë viteve të demokracisë, MQGM erdhi duke e minimizuar aktivitetin prodhues. Ajo u privatizua nga dy firma

aksionere më 1 janar 2000, (Meta, L., Gazeta “Telegraf”, 4 dhjetor, 2014), pasi ishte mbyllur me ligjin e falimentimit në vitin 1999. Sot ajo nuk funksionon, duke sfumuar edhe shpresën e rigjenerimit të qytetit që e kishte jetën të lidhur me veprimtarinë e saj. Memaliaji ka pesë lagje: “27 Qershori”, “Heronjtë e Minierës”, “Lame Kanani”, “Qazim Hasimi”, “Manxhar Skëndo”. Qyteti i Tepelenës është organizuar në shtatë lagje: “15 Shtatori”, “Mustafa Matohiti”, “Selam Musai”, “Gurëz”, “Demokracia”, “Majkosh”, “Corodoli”.

Tabela 3.1 - Popullsia qytetare në 20 vitet e para, 1945 – 1965 rezulton në rritje.


Nr.	Viti	Tepelenë (banorë)	Memaliaj
1	1945	435	-
2	1955	1100	2118
3	1960	1913	2948
4	1964	2540	4035
5	1965	6575	-

Burimi: Vjetar statistikor, 1965:69


Tabela 3.2 – Popullsia, Bashkia Memaliaj 2016-2020

Nr.	Viti	Popullsia total	Memaliaj	Njësitë administrative rurale
1	2016	21 035	6 645	14 590
2	2017	20 879	6 567	14 312
3	2018	20 136	6 354	13 782
4	2019	19 956	6 357	13 599
5	2020	19 866	6 325	13 541


Burimi: Bashkia Memaliaj



Grafiku 3.1 - Popullsia e Bashkisë Memaliaj 2015-2020



Grafik. 3.2 Popullsia e qytetit Memaliaj 1969 – 2014



Grafiku 3.3 Popullsia, raportet fshat-qytet

Ndryshimet në sistemin politik, kalimi në ekonomi tregu, lëvizja e lirë nga viti '90 deri në vitin 2000, solli një rritje të popullsisë në qytetin e Tepelenës me 22.6%. Në shkallë rrethi, menjëherë pas vendosjes së demokracisë, u vu re pakësimi i popullsisë rurale. Rënia e kësaj popullsie llogaritet me 10.7% deri në vitin 2001. Deri në vitin 1999 popullsia në qytetet Tepelenë, Memaliaj ka ardhur në rritje: “në vitin 1999 popullsia e qyteteve ishte 17,917 ose 33% e popullsisë së rrethit, në vitin 2004 kjo popullsi ishte më e vogël në numër, 16,408, por zinte 36% të peshës specifike, sepse edhe në fshat popullsia u pakësua për shkak të largimeve. Popullsia sipas censusit të vitit 2011 ishte: Tepelena – 8 949 banorë, sot 757 361 banorë. Memaliaj - 10 657 banorë. Qendrat urbane Tepelenë – Memaliaj u përballën edhe me problemin e ndotjes së mjedisit. U rritën ndjeshëm mbetjet e ngurta e të lëngshme, dëmtimi i zonave të gjelbra, zënia e trotuareve e rrugëve për ndërtime, dëmtimi i ambienteve publike, dëmtimi nga ndërhyrjet në rrjetin e infrastrukturës së dritave dhe ujësjellësve e vështirësoi shumë situatën, duke dëmtuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

Tabela 3.3 - Të dhëna demografike 1969-2001

Treguesit	Gjendja e popullsisë sipas viteve								
	1969	1979	1990	1995	1998	2000	2005	2001	
								Gjendja Civile	Census 2001
Popullsia total	-	-	51,022	51,714	50,680	49,563	49,274	33,325	16,727
Bashki (Tep+Mem)	7,700	9800	14,413	17,599	17,849	17,668	17,581	15,173	9,738
Komuna	-	-	36,609	34,115	32,831	31,895	31,693	18,152	6,989
Qyteti Tepelenë	3,700	4,800	7,413	9,478	9,214	9,512	9,620	8,130	4,342
Qyteti Memaliaj	4,400	5,100	7,000	8,121	8,542	8,650	9,015	7,043	2,647

Burimi: Bashkia Tepelenë dhe Memaliaj

Në pesëvjeçarin midis shekullit dhe milenumit të ri 1999 – 2004, gjendja e shtesës natyrore të popullsisë paraqitet si vijon: (Lilo, 2005:11).

Tabela 3.4 Raporti i popullsisë qytet - fshat 1999-2004

Nr	Emërtimi	Viti 1999			Viti 2004		
		Total	Qyteti	Fshati	Total	Qyteti	Fshati
1	Lindje gjithsej	577	217	360	614	183	431
2	Vdekje gjithsej	176	60	116	178	78	100
3	Vendosja gjithsej	561	337	224	642	288	354
4	Shpërngulje gjithsej	1042	426	616	2072	717	1355
5	Shtesa natyrore	401	157	244	436	105	231
6	Shtesa mekanike	-481	-39	392	-1430	-429	-1001

Burimi: Bashkia Tepelenë dhe Memaliaj

Largimi i popullsisë në emigracion (më i theksuar në Memaliaj, deri në vitet 2000 u largua 20% e popullsisë), konsiderohet nga më të lartat ndër qytetet shqiptare. Kjo, përpos të tjerash, lidhet me burimin kryesor të formimit të qytetit, me shfrytëzimin e



mineralit të qymyrgurit, i cili u reduktua deri në mbylljen përfundimtare të MQGM.

*Institucionet deri 2005.* Në Tepelenë funksiononin: Komisariati i Policisë, Gjykata e Faktit, Prokuroria, Kadastra dhe drejtori të ndryshme si: arsimore, shëndetësore, e tatim-taksave, shërbime, sigurimet shoqërore, bankat etj. Sot bashkia e Memaliajit ka 9 institucione, ndërsa bashkia e Tepelenës ka 24. Në Tepelenë funksionojnë këto institucione: Kadastra, Zyra Arsimore, Zyra Shëndetësore, Instat, Shërbime Sociale: Shtëpia e Fëmijës, Shtëpia e të Moshuarve, Qendrat e Formimit Profesional, Qendrat e Zhvillimit, të cilat nuk i ka bashkia e Memaliajit. Për sa u përket bizneseve, Tepelena ka të regjistruara 64, ndërsa Memaliaj 31. Më të zhvilluara janë bizneset e vogla tregtare dhe shërbimi, por jo me natyrë prodhimi e përpunimi. Largimi i të rinjve nga qendra e banimit rriti peshën specifike të moshës së tretë. Numri i pensionistëve mbas vitit 1990 erdhi në rritje. Ky raport shtoi dhe problemet sociale për të dyja qytetet.

Tabela 3.5 Numri i nëpunësve në pension

Qytetet	Vitet						
	1980	1985	1986	1987	1988	1989	1990
Tepelenë-Memaliaj	1667	2195	2318	2434	2561	2655	2855

Burimi: Statistikat Vjetore 1990

Të dyja qytetet, arsimin fillor e kishin të detyrueshëm mbi bazën e Ligjit nr. 115, dekretuar me nr. 282, datë 17. 08. 1946 (*Gazeta Zyrtare, 1946: 85*).

Tabela 3.6 Numri i nxënësve 1997 – 2005

Bashkitë (Qytet)	Nr. Nxënësve 97-98			Nr. nxënësve 2000			Nr. nxënësve 2005		
	Parashko llor	8-vjeçar	Mesme	Parash kollor	8-vjeçar	Mesme	Parashko llor	8-vjeçar	Mesme
Tepelenë	529	1330	429	546	1345	400	562	1345	389
Memaliaj	396	1043	363	406	1106	360	432	1099	350

Burimi: Statistikat Vjetore, Drejtoria Arsimore Tepelenë: 2005.

*Numri i mjekëve në 2005, Tepelena gjithsej: mjekë 37, infermierë 237; 21 mjekë në shërbimin ambulator dhe 158 infermierë; në shërbimin spitalor: 16 mjekë dhe 79 infermierë (Vjetar statistikor, Tiranë, 2005:33).*

## V. Performanca administrative e bashkive Tepelenë, Memaliaj

### 1.1. Analiza e efektivitetit administrativ të njësive vendore Tepelenë – Memaliaj (2014)

Në tabelën (nr.4.1.1) është llogaritur aktiviteti ekonomik i njësive vendore në vitin 2014, para reformës territoriale dhe administrative, të dhjetë njësive administrative: Tepelenë, Memaliaj, Krahës, Lopës, Kurvelesh, Fshat Memaliaj, Qesarat, Luftinjë, Buz dhe Komuna Qendër Tepelenë. Janë llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet si dhe investimet e kryera nga çdo njësi.

Tabela 4.1.1 - Të ardhurat e shpenzimet e njësive administrative në bashkitë Tepelenë – Memaliaj

Bashkitë	Popu llsia cens us 2011	Të ardhur Veta	Grant i Pakushtë-zuar	Total i të ardhur ave	Ta/ frymë	Shpenzi-me adminis-trative Total	Sh/ frymë	Investi-me	% Inves t /shp.t otal
B.Tepelenë	4334	21500	35624	64919	14.97	23947	5.08	7630	11.7
Q. Tepelenë	3179	8226	17175	26000	8.17	15762	4.01	1590	6.1
K. Lopës	723	1827	7188	9015	12.46	8700	10.78	100	1.1

K.Kurvelesh	705	3978	15825	19944	28.28	14391	18.55	1630	8.1
Total	8,941	35,531	75,812	119,878	13.40	62,800	6.22	10,950	9.1
B.Memaliaj	2647	2227	38260	40487	15.29	23763	8.13	1200	2.9
K.F. Memaliaj	1606	2900	11765	14665	9.13	12215	5.73	1387	9.4
K.Luftinjë	1734	3000	16005	23877	13.76	12402	6.28	7320	3.0
K.Qesarat	1379	2890	9131	12358	8.96	10715	6.77	1479	11.9
K.Krahës	2554	2100	13369	15769	6.17	12779	4.39	1550	9.8
K.Buz	737	4860	9912	14772	20.04	9988	11.36	2170	14.6
Total	10,657	17,977	98,442	121,928	11.44	81,835	6.62	15,106	12.3

Burimi: Bashkia Tepelenë dhe Memaliaj

Në tabelë konsiderohet grant i pakushtëzuar fondi i dhënë nga qeveria për bashkitë, por pa u përcaktuar destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve. Ky fond përdorej nga bashkitë në funksion të nevojave të njësive administrative. Destinacioni i tij përcaktohej nga këshillat e njësive administrative.

## 1.2 Analiza e performancës së bashkisë së Memaliajit pas reformës administrative-territoriale 2014

Analiza e të ardhura të buxhetit të bashkisë së Memaliajit, duke pasur parasysh që ka në përbërje të saj dhe njësitë administrative: Fshat Memaliaj, Krahës, Qesarat, Luftinjë, Buz me sipërfaqe 372 km<sup>2</sup> dhe popullsi në regjistrin civil: 21,476 banorë dhe në censusin e vitit 2011: 10,657 banorë. Të ardhurat buxhetore përfshijnë transfertat e pakushtëzuara, të kushtëzuara, si dhe transfertat specifike për funksionet shtesë pas reformës.

Tabela 4.2.1 - Burimet financiare faktike Bashkia Memaliaj 2017-2019  
në 000 lekë

Burimet	2017		2018		2019	
	Vlera	%/total	Vlera	%/total	Vlera	%/total
Të ardhurat e veta	15,952	9.55	13,272	7.55	14,028	4.1
Transferta nga Buxheti Qendror të ndara në:	150,231	90.45	162,452	92.45	326,860	95.9
Transferta e pakushtëzuara	97,153	58.5	99,342	56.5	142,502	41.8
Transferta e kushtëzuara	0	0	0	0	120,737	35.4
Transferta specifike	53,078	31.9	63,110	35.9	63,621	18.7
Total	166,183	-	175,679	-	340,888	-

Burimi: Bashkia Memaliaj

Nga tabela shikojmë që pesha e të ardhurave të veta në raport me totalin e të ardhurave është në përqindje të vogël, 9.5% në vitin 2017, duke u zvogëluar në 4.1% në vitin 2019 (tabela nr.4.2.1). Të ardhurat nga transfertat e buxhetit qendror përbëjnë 90.5% në vitin 2017 dhe janë rritur në vitin 2019 në 95.9%. Mund të themi se kjo bashki ka burim financiar buxhetin e shtetit. Për shkak se është një bashki rurale, s'ka mundësi për të ardhura të vetat. Disa nga zërat e shpenzimeve janë zero, sidomos ata për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shpenzimet për sport dhe argëtim në dy vite 2017, 2019 (tabela nr.4.2.1). Transferta e kushtëzuar është zero deri në vitin 2019, gjë që e vendos bashkinë e Memaliajrit në vështirësi për investime, dhe në disfavor me bashkinë e Tepelenës, që ka përfituar këtë grant në masë të konsiderueshme në raport me të ardhurat e përgjithshme.

Tabela 4.2.2 - Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Klasifikimi	2017		2018		2019	
	Vlera	%/total	Vlera	%/total	Vlera	%/total
Shpenzime korrente	244,682	76.7	145,844	43.2	165,209	50.7
Shpenzime kapital	74,209	21.2	72,015	21.3	44,050	13.5
Total	318,891		337,470		325,389	

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunimi nga autorët

## VI. Rezultate dhe diskutime

Gjatë punës për realizimin e kësaj teme kemi evidentuar këto dukuri shkencore:

1. Midis dy periudhave 1945 – 1990 dhe 1991 – 2014, vihet re se në periudhën e parë janë krijuar qendra të reja urbane. Përveç zonës rurale, përmendim qytetin e Memaliajit themeluar më 2 maj 1955.

2. Qendrat urbane edhe brenda së njëjtës periudhë nuk kanë të njëjtën fizionomi, zhvillim ekonomik, social, demografik, kulturor e shpirtëror.

3. Popullsia vjen në rritje gjatë periudhës 1945 – 1991, madje edhe në vitet e para të demokracisë deri në vitin 1997.

4. Tepelena si qendër rrethi kishte natyrë administrative, ndërsa Memaliaji u konceptua si një qendër urbane në shërbim të punëtorëve të MQGM, pra si qendër industriale.

5. Shfrytëzimi i burimeve natyrore si: minerare (qymyrguri), fosforitet, zhavorreve, guroreve, ujërave, pyjeve, kullotave, por edhe bujqësisë, forcave prodhuese etj., nuk është bërë në mënyrë racionale. Për më tepër, shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe prodhimet bujqësore janë ndërprerë pas vitit 1991.

6. Reformat administrative (1992 – 2014) shpesh e kanë çekuilibruar faktorin e zhvillimit administrativ. Veç kësaj, ato nuk kanë efekt pozitiv në zhvillimin e trevës. Prandaj, kemi sugjeruar

që në një kohë sa më të afërt kjo trevë të ketë vetëm një qendër administrative të vetën.

7. Në këtë gjendje, të dyja bashkitë kanë pak shanse për integrim rajonal, kombëtar dhe më gjerë.

8. Një dëm të pallogaritshëm eko-social dhe ekonomik ka bërë ndërprerja e punimeve në hidrocentralin e Kalivaçit. Ai jo vetëm që ndikoi në zhvillimin industrial të zonës, por me ndërprerjen e punimeve la në gjendje të shkatërruar ekosistemin. Pa llogaritur efektet psikologjike, ekonomike, orientimet demografike të lidhura me punësimin etj.

### **Përfundime**

1. Politikat e zhvillimit ekonomik të centralizuara para vitit 1990 sollën lindjen e qytetit Memaliaj, 2 maj 1955.

2. Mbas vitit '90, të dyja qytetet u ndeshën me probleme sociale, më shumë Memaliaji si qytet industrial, me papunësinë, emigracionin, varfërinë.

3. Mbas vitit '90, të dyja qytetet ishin me natyrë administrative, më shumë Tepelena si qytet në të cilin ndodhen administratat qendrore për shërbime si: gjykatë, polici, mbrojtja kundër zjarrit, spitale, arsim, shëndetësi.

4. Popullsia e qyteteve njohu një rritje të lehtë deri në vitin 2000, ndërsa pas këtij viti ajo filloi të bjerë.

5. Mosha mesatare ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Shkaku kryesor është lindshmëria e ulët.

6. Tepelena si njësi vendore, ka më shumë biznese dhe ka performancë më të mirë se Memaliaji.

7. Në bashkinë e Tepelenës është investuar në infrastrukturën e qytetit dhe qendrat historike, si në kala, muze, objekte historike etj., duke e shndërruar atë edhe në një qendër turistike.

**Literatura:**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Histori e Shqipërisë, Vëll. IV, 1983, f. 41.

AQSH, F. 200, dos. 25, f. 42.

Arkivi i Bashkisë Memaliaj.

Arkivi i Bashkisë Tepelenë

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, zëri: Industria e qymyrgurit.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Vëll. III, Tiranë, 2009, f. 2190.

Gazeta *"Telegraf"*, 28. dhjetor 2014, 22 shkurt 2021, 4 nëntor 2021.

Gazeta Zyrtare, dhjetor 1944, f. 9; nr. 54, 1. 10. 1945; nr. 68, 22. 11. 1945, nr. 2, datë 5. 01. 1945, nr. 85, 11. 09. 1946.

Histori e popullit shqiptar, (2008), vëll. IV, TOENA, Tiranë, f. 174.

Hoxha, R., Koha e minierës (2005) (Memaliaj 1949 – 19205), *"Publicita"*, Tiranë, f. 85.

Informacion i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, Bashkia Memaliaj, Emigerta Shehu, dhjetor 2021.

Lulo, K. Lulaj, (2005), Arsimi në Tepelenë 1908 – 2005, *"Argjiro"*, f. 11.

Meçaj, N., (1978), Të njohim vendlindjen, Tiranë, f. 66,113.

Meçaj, N., (2010), Tepelena, Tiranë, f. 66.

Ruka, R., (2021), Rikthim në vendlindje, *"Mediaprint"*, Tiranë f. 52.

Shehu, N., (2005), Enciklopedia e Tepelenës, Tiranë, zëri Tepelena.

Vjetari statistikor 1954, 1958, f. 24; 1965, f. 69, 2005, f. 33.

**Prof. asoc. dr. Albina Sinani<sup>1</sup>**

**Dr. Fatlinda Shkurti<sup>2</sup>**

## **TIPOLOGJIA FUNKSIONALE DHE MADHËSIA E VENDBANIMEVE RURALE NË QARKUN E GJIROKASTRËS**

### **Abstrakt**

Vlerat e vendbanimeve rurale janë shumëpërmasore e komplekse si në aspektin funksional, ashtu edhe në atë kompozicional e artistik. Shpërndarja gjeografike e tyre kushtëzon jetën social-ekonomike, rrjetin e infrastrukturës fizike e sociale, rregullimin e territorit dhe shkallën e përdorimit hapësinor. Ky studim vjen si një përpjekje për të analizuar tipologjinë, madhësinë dhe tendencat demografike të shpërndarjes dhe zhvillimit të vendbanimeve rurale në qark përmes një qasjeje të posaçme dhe gjithëpërfshirëse. Në këndvështrimin rajonal, tipologjia e vendbanimeve është rezultat i riorganizimit shoqëror në epoka të ndryshme historike. Ky fakt i dukshëm, në një gamë rrethanash kulturore dhe ekologjike na sugjeron nevojën e një perspektive rajonale, për të kuptuar pse dhe si ka ndodhur ky evoluim. Pa rindërtimin afatgjatë demografik, të mundësuar nga një studim i hollësishëm me mbulim të plotë, ne do ta kishim parë këtë tranzicion 30-vjeçar, shumë më të shpejtë dhe shumë më pak të lidhur me situatën aktuale. Edhe pse vendbanimet e qarkut të Gjirokastrës janë shumë të hershme, pamja e tyre sot është produkt kulmor i shumë proceseve demografike dhe njëkohësisht rezultat i transformimeve organizative shumë të shpejta dhe cilësore. Megjithatë, siç do të shohim, historia aktuale e vendbanimeve është shënuar nga fitime dhe humbje të ndryshme, nga suksese dhe nga pengesa. Sigurisht,

---

<sup>1</sup>Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë. E-mail: [sinaniaalbina@yahoo.com](mailto:sinaniaalbina@yahoo.com)

<sup>2</sup>Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Edukimit. E-mail: [fshkurti@yahoo.com](mailto:fshkurti@yahoo.com)



qëllimet prioritare duhet të jenë lufta kundër varfërisë, marginalizimit dhe shpopullimit të fshatit, të varura shpesh edhe nga vendimet politike, me synimin prioritar të rrizhfillimit, rivitalizimit, lehtësuar nëpërmjet stimulimit të opsioneve, strategjive dhe programeve të zhvillimit cilësor dhe politikave rajonale të qëndrueshme dhe të suksesshme.

*Fjalë çelës: rrjet vendbanimesh, habitate, tipologji funksionale, braktisje e vendbanimeve, strategji dhe programe zhvillimore, perspektivë funksionale.*

### **Abstract**

The values of rural settlements are multidimensional and complex both in the functional, compositional and artistic aspect. Their geographical distribution determines the social –economic life, physical and social network of infrastructure, territory regulation and the degree of area exploitation. This study stems as an effort to analyze the typology, size and demographic tendencies of the distribution and development of the rural settlements in this district, though a particular and comprehensive approach. In the regional aspect, the typology of settlements is the result of social reorganization over various historical epochs. This obvious fact, in a range of cultural and ecological circumstances, suggests the need for a regional perspective in order to comprehend why and how this evolution has occurred. Without the long-term demographic reconstruction, enabled by an elaborate and complete study, we would examine this 30-year transition period as a faster and less related to the actual situation. Although the settlement in Gjirokaster is rather ancient, the view they have today is a culminating product of numerous demographic processes as well as a result of very realistic and qualitative organizational transformations. However, as we are further observing, the factual history of settlements has undergone victories and losses, successes and obstacles too. Naturally, the priority aims should be the fight against poverty, marginalization and depopulation of the rural regions, depended often on the political decisions, in order to redevelop, revitalize and reach facilitation through the stimulation of options, strategies programs, qualitative development and stable successful regional policies.

*Keywords: network settlements, habitats, functional typology, abandonment of settlements, strategy and development programs, functional perspectives.*

## **I. Hyrje**

Banorët e qarkut jo vetëm që shkatërruan burime të vlefshme natyrore, por krijuan edhe habitate alternative. Një sfidë e madhe

me të cilën përballet rajoni është shpjegimi i braktisjes së vendbanimeve rurale midis komuniteteve bujqësore dhe blegtorale, veçanërisht atyre që kanë investuar një sasi të konsiderueshme energjie dhe kohe në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e vendbanimeve. Përpyjekjet për të shpjeguar këto braktisje fokusohen shpesh në ndodhjen e një katastrofe sociale ose mjedisore (faktorë historikë, luftë, përmbytje, thatësi etj.), që kanë prekur drejtpërdrejt të gjithë rajonin. Megjithatë, vështirë se mund të japim shpjegime për të dhënat arkeologjike ose paleomjedisore që lidhen me shumicën e braktisjeve në rajon, kjo sepse peizazhet në të cilat banonin komunitetet parahistorike rrallë ishin mjedise uniforme ose të integruara sociopolitikut sa që një ngjarje katastrofike të kishte prekur rajonin në tërësi, në atë masë sa të gjitha vendbanimet e rajonit të ishin braktisur.

## **II. Metoda**

Për arritjen e rezultateve studimore, të dhënat e grumbulluara nga burime të shumta janë përpunuar, sintetizuar dhe analizuar në funksion të arritjes së objektivave të punimit. Tematika komplekse e punimit nuk mund të trajtohej pa një larmi metodash kërkimore, ndër të cilat spikasin metoda e konsultimit të dokumentacionit dhe studimeve ekzistuese, e vëzhgimit dhe grumbullimit të të dhënave në terren, historiko-krahasuese, e analizës statistikore, interpretimit të fotografive ajrore dhe imazheve satelitore, e hartografimit, si dhe metoda e analizës shumëplanëshe në dinamikë të objektit të studimit.

### III. Gjetje dhe diskutime

#### 1. Ecuria e numrit dhe e madhësisë së vendbanimeve rurale

Roli i rrjetit të qendrave të banuara dhe vendbanimeve rurale në përdorimin e hapësirës dhe rregullimin rural ka ndryshuar në varësi të faktorëve natyrorë, politikë, ekonomiko-shoqërorë e demografikë, duke ndikuar në shkallën e përdorimit të territoreve rurale të qarkut (*Figura 1,2*).



Figura 1. Harta administrative territoriale e bashkive të Shqipërisë



Figura 2. Harta administrative territoriale e qarkut Gjirokastrë.

*Burimi:* Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.137, datë.11/09/2014: Ligji Nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësjive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

### ***1.1. Rrjeti i qendrave të banimit në periudhën para vitit 1945 dhe veçoritë e tij***

Periudha e pushtimit osman ndikoi drejtpërdrejt në ngushtimin e rrjetit të vendbanimeve rurale. Sipas regjistrimit osman të Vilajetit Shqiptar (1431-1432), numrin më të madh të fshatrave e kishte Nahija e Gjirokastrës (118 fshatra, 2629 banesa/hane), ndërkohë Nahija e Këlcyrës kishte 37 fshatra, 882 banesa/hane (*Shkurti, 1997*). Gjatë shek.XVI u pakësua popullsia në disa vendbanime për shkak të politikave shfarosëse dhe shpërngulëse të ndjekura nga pushtuesit (në kazanë e Përmetit 30 fshatra u zhdukën). Në periudhën 1912-1914 shumë fshatra të mëdha si: Dangëllia, Shqeria, Cerja, Dëshnica, Dropulli etj. u dogjën dhe u shkatërruan nga pushtuesit. Në periudhën 1908-1936 (*Enciklopedia e Tepelenës, 2005*), emigrimi në masë i popullsisë drejt Rumanisë, Bullgarisë, Turqisë, Francës, Italisë, Greqisë etj. ndikoi në numrin dhe madhësinë e vendbanimeve. Ndarja e re administrative e vendit në vitin 1928 dhe krijimi për herë të parë i komunave në prill të vitit 1929 ndikuan drejtpërdrejt në numrin dhe madhësinë e vendbanimeve.

Ecuria e numrit dhe madhësisë së vendbanimeve rurale është analizuar në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (AQSH, 1940, 1945). Në vitin 1923 kishte 3 qytete (Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë) dhe 258 katunde (78, 106 e 74 n/prefekturat Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë). Në vitin 1938 kishte 3 qytete dhe 250 katunde (81, 102 e 67 n/prefekturat Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë). Pra, numri i vendbanimeve u pakësua me -3.1%, ndërkohë në n/prefekturën e Gjirokastrës u shtuan me 3.8%, si rezultat i bonifikimeve, sistemimeve ujitëse dhe kulluese, hapjes së tokave të reja (*Tirta, 1999*). Sipas regjistrimit të vitit 1945, kishte 3 qytete dhe 249 katunde (83, 104 e 62 n/prefekturat Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë).

*Numri i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë:*

-vendbanimet me numër të vogël (÷ në 200 banorë), 41.4% të vendbanimeve (n/p. Përmet).

-vendbanimet me numër mesatar (200-600 banorë), 47.4% të vendbanimeve (Tep. dhe Gjir.).

-vendbanimet me numër të madh (mbi 600 banorë) zënë 11.2% të vendbanimeve.

*Shpërndarja e vendbanimeve sipas lartësisë:*

-13.4% e vendbanimeve shtrihet deri në 300 m (Tepelenë e Gjirokastrër).

-44.8% e vendbanimeve shtrihet në 301-600 m (Tepelenë 44.4% dhe Gjirokastrër 54.8%).

-34.5% e vendbanimeve shtrihet në 601-900 m (nënprefektura Përmet 42.9%).

-8.3% e vendbanimeve shtrihet në 901-1200 m (nënprefektura Përmet 14.3%).




Figura 3. Popullsia mesatare para vitit 1945 në banorë/1 vendbanim (punuar nga autorët)

Në 19.9% të sipërfaqes, e cila shtrihet në lartësinë mbi 1200 m, nuk përqendrohet asnjë vendbanim i prefekturës. Në vitin 1945 (Figura 3), *popullsia mesatare/çdo qendër e banuar* u pakësua me -

8.5% kundrejt vitit 1923 (354 banorë nga 387 në vitin 1923), ku uljen më të madhe e patën nënprefekurat Libohovë, Kurvelesh dhe Gjirokastrë (përkatësisht me -26.5%, -13.9%, -11.7%, sidomos: komunat Qendër Gusmar, Pogon, Labovë dhe Qendër Gjirokastrë). *Popullsia mesatare për një vendbanim*, në lartësinë deri në 300 m, në vitin 1945 kundrejt vitit 1923 u rrit me 10.1% (755 nga 686), ndërsa në lartësitë 301-600 m, 601-900 m dhe 901-1200 m, u ul përkatësisht me -9.1% (299 nga 329), -13.3% (299 nga 345) dhe -24.9% (289 nga 385). Sipas formave të relievit, relievi fushor ka mesataren më të lartë të popullsisë, ritëm më të shpejtë të shtimit të saj, ndërsa në vendbanimet malore ritmi i rritjes së popullsisë është më i ulët se mesatarja e prefekturës (289 banorë/1 vendbanim). Ulja e numrit të vendbanimeve çoi në rritjen e largësisë mesatare midis tyre (n/prefektura e Kurveleshit: komunat Qendër e Gusmar dhe n/prefektura e Tepelenës: komunat Labovë, Lopës e Krahës), ndërkohë që në n/prefekturën e Gjirokastrës largësia mesatare u ul, si rezultat i shtimit të numrit të tyre. Largësia mesatare midis vendbanimeve sipas formave të relievit është 3.8 km në zonat fushore, me popullsi mesatare 2.1 herë më e lartë se mesatarja e prefekturës (354) dhe 2.9 km në zonat kodrinore, me popullsi mesatare 0.8 herë më e ulët se mesatarja e prefekturës si dhe 5.9 km në zonat malore, me popullsi mesatare 0.8 herë më e ulët se mesatarja e prefekturës.

### ***1.2. Rrjeti i qendrave të banimit në periudhën para viteve 1946-1989 dhe veçoritë e tij***

Gjatë regjimit të kaluar rrjeti i vendbanimeve u transformua jo vetëm në aspektin hapësinor, por edhe në atë funksional e tipologjik. Në këtë periudhë rrjeti i vendbanimeve u zgjerua me 24 qendra të reja, nga të cilat 3 vendbanime urbane (Këlcyra në v.1965, Libohova në v.1969 dhe Memaliaj në v.1955) dhe 21

vendbanime rurale. Numri i vendbanimeve rurale u shtua nga 249 katunde në vitin 1923, në 270 fshatra në vitin 1989 nëpërmjet:

- › zhvillimit të bujqësisë, hapjes dhe përfitimit të tokave të reja nëpërmjet bonifikimeve, ngritjes së ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore etj.,

- › ndërtimit të vendbanimeve të reja rurale, kryesisht në rajonet fushore ose pas fatkeqësive natyrore (tërmetet etj.).

*Numri i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë:*

-vendbanimet me numër të vogël ( $\div$  në 200 banorë) zënë 28.1% të vendbanimeve dhe 10.1% të popullsisë (rrethi Përmet 42.8%).

-vendbanimet me numër mesatar (200-600 banorë) zënë 59.9% të vendbanimeve dhe 60.3% të popullsisë (rrethet Tepelenë e Gjirokastrër).

-vendbanimet me numër të madh (mbi 600 banorë) zënë 12.0% të vendbanimeve dhe 29.6% të popullsisë (rrethi Gjirokastrër 12.7%).

Numrin më të madh të vendbanimeve e ka rrethi i Përmetit (36.6%), komunat Qendër Piskovë, Petran e Dëshnicë si dhe komunat Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm të rrethit të Gjirokastrës.

Gjatë periudhës 1969-1989, është ulur largësia mesatare midis vendbanimeve si dhe dendësia e popullsisë si rezultat i rritjes së numrit të tyre (276 nga 238).

*Shpërndarja e vendbanimeve sipas lartësisë:*

Në 1989, 18.8% e vendbanimeve shtrihet deri në 300 m, nga 16.0% në 1969.

Në 1989, 46.4% e vendbanimeve shtrihet në 301-600 m, nga 47.1% në 1969.

Në 1989, 33% e vendbanimeve shtrihet në 601-1000 m, nga 34.9% në 1969.

Në 1989, 1.8% e vendbanimeve shtrihet mbi 1000 m, nga 2.1% në 1969.



*Popullsia mesatare/për një vendbanim, në lartësitë deri në 300 m, 301-600 m dhe 601-1000 m, në vitin 1989 kundrejt vitit 1969 u rrit përkatësisht me 18.9% (1400 nga 1177), 14.6% (431 nga 376) dhe 10.9% (337 nga 304). Sipas formave të relievit, relievi fushor ka mesatare më të lartë të popullsisë si dhe ritëm më të shpejtë të shtimit të saj, ndërsa në vendbanimet malore ritmi i rritjes së popullsisë është vazhdimisht edhe më i ulët sesa mesatarja e qarkut.*

Vendbanimet në zonat kodrinore kanë popullsi mesatare më të ulët (362 banorë) se mesatarja e qarkut (582 banorë) dhe distancë të shkurtër, zonat fushore kanë popullsi mesatare më të madhe (1400 banorë) dhe distancë të shkurtër midis tyre, ndërsa zonat malore kanë popullsi mesatare 1.3 herë më të vogël se mesatarja e qarkut si dhe me distancë të madhe (14.2 km).

### ***1.3. Rrjeti i qendrave të banimit në periudhën pas vitit 1990 dhe veçoritë e tij***

Ndryshimet politike, ekonomike dhe juridike sollën nevojën e shpërbërjes së formave të vjetra të qeverisjes dhe kryerjen e një reforme administrativo-territoriale. Statistikat rajonale mbi hapësirën mbështeten në reformën territoriale të vitit 1992, 2000 (*Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000*) dhe 2014 (*Ligji Nr.115/2014*). Prefektura e Gjirokastrës përbënte një njësi të re administrative. Qarku i Gjirokastrës përbëhet nga 26 komuna dhe 3 bashki (*Fletore Zyrtare, 2000*). Në vitin 1989 qarku kishte 270 vendbanime (95 rrethi Gjirokastrë, 99 rrethi Përmet dhe 76 rrethi Tepelenë), në vitin 2004 kishte 272 vendbanime (96 Gjirokastra, 99 Përmeti dhe 77 Tepelena), në 2014, 265 vendbanime rurale.

*Për numrin e vendbanimeve sipas numrit të popullsisë:*

-vendbanimet me numër të vogël ( $\div$  në 200 banorë), 32.4% të vendbanimeve në 2004 nga 21.8% në vitin 1989 (rrethi Përmet).

-vendbanimet me numër mesatar (200-600 banorë), 52.9% të vendbanimeve në 2004 nga 60.8% në vitin 1989 (rrethi Tepelenë).

-vendbanimet me numër të madh (mbi 600 banorë), 14.7% të vendbanimeve në 2004 nga 17.4% në vitin 1989 (rrethet Tepelenë dhe Gjirokastër).

*Shpërndarja e vendbanimeve sipas lartësisë:*

-Në vitin 2004, 19.4% e vendbanimeve shtrihet deri në 300 m, nga 18.8% në vitin 1989 (rrethi i Gjirokastrës 0.8%).

-Në 2004, 46.0% e vendbanimeve shtrihet në 301-600 m, nga 46.4% në vitin 1989.

-Në 2004, 32.4% e vendbanimeve shtrihet në 601-1000 m, nga 33.0% në vitin 1989.

-Në 2004, 2.2% e vendbanimeve shtrihet mbi 1000 m, nga 1.8% në vitin 1989.

Ndryshimet në numrin e vendbanimeve sipas rretheve dhe komunave kanë ndikuar në *dendësinë e qendrave të banimit për njësi të sipërfaqes*. Në vitin 2004, për qarkun ky tregues është 10.4 km<sup>2</sup>/vendbanim, kundrejt 10.5 km<sup>2</sup>/vendbanim në vitin 1989. Dendësinë më të madhe të rrjetit të vendbanimeve e kanë komunat Picar, Pogon e Qendër Libohovë (rr. Gjirokastër 11.6 km<sup>2</sup>/vendbanim), Çarçovë e Petran (rr. Përmet), Kurvelesh e Qendër Tepelenë (rr. Tepelenë). Të gjitha komunat e tjera kanë dendësi më të ulët se mesatarja e qarkut, veçanërisht Lunxhëria, Dropulli i Poshtëm, Dropulli i Sipërm, Qendër Piskova, Suka, Buzi, Luftinja, Krahësi dhe Memaliaj Fshat. Sipas niveleve hipsometrike, dendësia më e madhe e vendbanimeve është në lartësitë mbi 1000 m dhe 601-1000 m, ndërsa dendësia më e vogël është në relievin fushor, veçanërisht në rrethet Tepelenë dhe Gjirokastër. Distanca mesatare midis vendbanimeve (Lmes. =  $1.07457 \cdot \sqrt{S/N}$  ku: S – sipërfaqja e rrethit dhe N – numri i vendbanimeve rurale) ka ndryshuar me kalimin e kohës. Distanca mesatare midis vendbanimeve është 3.5 km (3.3 km në rrethin e Përmetit, 3.7 km në rrethin e Gjirokastrës).




Figura 4. Popullsia mesatare pas vitit 1989 në banorë/1 vendbanim (përpunuar nga autorët)

Sipas lartësisë, distanca më e shkurtër mesatare është në lartësinë 301-600 m (2.5 km). Në lartësitë deri në 300 m, 3.0 km, 601-1000 m, 3.4 km dhe mbi 1000 m është 13.0 km (2.7 herë më e lartë se mesatarja). Vendbanimet në zonat kodrinore (Figura 2) kanë popullsi mesatare më të vogël se mesatarja e qarkut dhe distancë të shkurtër nga njëra-tjetra (në 301-600 m, 406 në 2004 nga 431 në 1989), ndërsa (në 601-1000 m, 240 në vitin 2004 nga 337 në vitin 1989). Zonat fushore kanë popullsi mesatare të madhe (1709 në vitin 2004 nga 1400 në vitin 1989) dhe distancë të shkurtër midis tyre, zonat malore kanë popullsi mesatare rreth 3 herë më të vogël se mesatarja e vendit dhe distancë të madhe nga njëri-tjetri (200 në vitin 2004 nga 420 në vitin 1989).

## 2. Tipat dhe organizimi hapësinor i vendbanimeve rurale

Tipat e vendbanimeve shprehin raportet ndërmjet grupeve sociale me mjedisin natyror, kushtet e jetës materiale dhe infrastrukturën rrugore. Ato kanë lindur dhe janë zhvilluar duke krijuar origjinalitetin e tyre, që mishërohet në fizionominë dhe tipologjinë, arkitekturën dhe peizazhet e larmishme, ku pasqyrohet ndikimi i faktorëve natyrorë, historikë, psikologjikë, etnografikë e ekonomikë. Vlerat e tyre janë shumëpërmesore dhe

komplekse si në aspektin funksional, ashtu edhe kompozicional e artistik. Në varësi të faktorëve natyrorë (relievit, tokave, bimësisë dhe rezervave ujore), humanë, rrjeti i vendbanimeve rurale prezantohet me lloje të ndryshme ngulimesh.

Shpërndarja e vendbanimeve rurale ka ndikuar në jetën social-ekonomike të banorëve, rrjetin e objekteve të infrastrukturës fizike dhe sociale (rrugore, arsimore, kulturore e shëndetësore), rregullimin e territorit dhe shkallën e përdorimit të hapësirës rurale. Ndikim të veçantë në strukturën e vendbanimeve rurale ka pasur struktura sociale. Në aspektin social-ekonomik, tipat e vendbanimeve rurale janë shprehje e organizimit bujqësor dhe trashëgimisë kulturore të zonës, të pasqyruara në teknikat bujqësore, zakonet, folklorin, traditat materiale, stilin arkitektonik, dekorativ e konstruktiv. Duke marrë parasysh veçoritë e territorit, veprimtaritë ekonomike, formën e pronësisë, organizimin administrativ e veçoritë urbanistike, qendrat rurale shfaqin tipizime të ndryshme.

### ***2.1. Klasifikimi i vendbanimeve në varësi të lartësisë dhe sipas formave të relievit***

*a. Vendbanime fushore*, ku ushtrohet gjerësisht veprimtaria bujqësore. Shtrihen në lartësitë deri në 300 m, në territoret me pjerrësi nga 3-5%. Janë vendbanime të dendura dhe me hapësira jetese të mëdha. Për shkak të kushteve topografike, hidrologjike e klimatike, përqendrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë në këto lartësi ka ardhur në rritje. Në vitin 1989, një vendbanimi i takonin 8.2 km<sup>2</sup> dhe 1400 banorë, ndërsa në vitin 2004 - 7.9 km<sup>2</sup> dhe 1709 banorë. Largësia mesatare midis vendbanimeve është ulur nga 3.1 km në vitin 1989, në 3.0 km në vitin 2004, si rrjedhojë e zgjerimit të sipërfaqes dhe e shtimit të numrit të tyre. 40.7% të vendbanimeve të kësaj kategorie i përkisnin rrethit të Gjirokastrës, ku përbëjnë 23.5% të vendbanimeve të rrethit (22.7% në vitin 1989). Numri më i madh i këtyre vendbanimeve ndodhen

në luginën e Drinos, komunat Dropull i Poshtëm, Cepo, Antigone, Lunxhëri, Qendër Libohovë, Odrie, Lazarat etj. Në rrethin e Përmetit, numri më i madh i vendbanimeve ndodhen në luginën e Vjosës dhe të Dëshnicës, komunat Qendër Piskovë, Sukë, Petran, Dëshnicë dhe bashkitë Përmet e Këlcyrë, ku në vitin 2004 ato përbënin 10.9% të vendbanimeve të rrethit. Në rrethin e Tepelenës numri më i madh i vendbanimeve ndodhen në luginën e Drinos, Vjosës, Luftinjës, Bënçës dhe fushën e Krahësit, ku në vitin 2004 ato përbënin 25.3% të vendbanimeve.

*b. Vendbanime kodrinore*, shtrihen në lartësitë 301-600 m (relievi i ulët) dhe 601-1000 m (relievi i lartë), në territoret me pjerrësi 6-25%, në luginën e Luftinjës, Bënçës, Dëshnicës, Zagories, Pogonit, Lemnicës, lumin e Lengaricës, Kardhiqit e Suhës. Janë vendbanimet më të përhapura e shtrihen në terrenet më të përshtatshme për banim, me ekspozim të mirë, burime të bollshme të ujit të pijshëm, tokë të përshtatshme për bujqësi, blegtori, bletari, pylltari etj.

*Relievi i ulët kodrinor*, zë 23.8% të sipërfaqes së qarkut, ku në vitin 2004 shtriheshin 128 vendbanime që përbënin 46% të vendbanimeve. Largësia mesatare ndërmjet tyre ishte 2.5 km. Një vendbanimi i takonte 5.4 km<sup>2</sup> dhe 406 banorë. Largësinë mesatare më të madhe midis vendbanimeve e kishte rrethi i Tepelenës me 2.8 km, ku një vendbanimi i takonte sip. 6.8 km<sup>2</sup> ndërsa më të vogël rrethi i Gjirokastrës me 2.4 km, ku një vendbanimi i takonte 4.9 km<sup>2</sup> dhe 523 banorë. 37.5% të vendbanimeve të kësaj kategorie i takonin rrethit të Gjirokastrës. Në rrethin e Gjirokastrës, në lartësitë 301-600 m gjendeshin 49 vendbanime, që u takonin komunave Dropull i Sipërm (13), Lunxhëri (9), Cepo dhe Dropull i Poshtëm (nga 7), Qendër Libohovë (4), Picar (3) dhe Antigone (2). Në rrethin e Përmetit, në lartësitë 301-600 m ndodheshin 45 vendbanime, që u takonin komunave Petran (9), Dëshnicë dhe Çarçovë (nga 8), Qendër Piskovë (7), Ballaban (6), Sukë (4) dhe

bashkia Këlcyrë. Në rrethin e Tepelenës, në lartësitë 301-600 m ndodheshin 34 vendbanime, që u takonin komunave Luftinjë (10), Qendër Tepelenë (7), Krahës (5), Qesarat, Memaliaj Fshat, Lopës dhe Buz (nga 3).

*Relievi i lartë kodrinor*, zë 31% të sipërfaqes së qarkut, në vitin 2004 gjendeshin 90 fshatra, që përbënin 32.4% të vendbanimeve. Largësia mesatare ndërmjet tyre ishte 3.4 km. Një vendbanimi i takonin 9.9 km<sup>2</sup> dhe 240 banorë. Largësinë mesatare më të madhe midis vendbanimeve e kishte rrethi i Gjirokastrës me 3.9 km, ku një vendbanimi i takonin 13.5 km<sup>2</sup> dhe 255 banorë, ndërsa më të vogël rrethi i Përmetit me 3.1 km, ku një vendbanimi i takonte 8.2 km<sup>2</sup>. 44.4% e vendbanimeve të qarkut në lartësinë 601-1000 m i përkasin rrethit të Përmetit. Në rrethin e Gjirokastrës ndodheshin 25 vendbanime të kësaj kategorie, në komunat Zagorie (10), Pogon (7), Dropull i Sipërm (3), Qendër Libohovë (2), Picar, Odrie dhe Antigone (nga 1). Në rrethin e Përmetit ndodheshin 40 vendbanime, në komunat Ballaban (8), Frashër, Qendër Piskovë e Sukë (nga 7), Dëshnicë (5), Petran (3), Çarçovë (1) dhe bashkisë Këlcyrë (2). Në rrethin e Tepelenës ndodheshin 25 vendbanime, që ndodhen në komunat Buz (10), Kurvelesh (5), Luftinjë (4), Qendër Tepelenë (2), Krahës (2) dhe Memaliaj e Qesarat (nga 1).

*c. Vendbanime malore*, që shtrihen në lartësitë mbi 1000 m, në territoret me pjerrësi mbi 25% (në malësinë e Kurveleshit e të Dangëllisë). Janë vendbanime të shpërndara dhe me mundësi të kufizuara për jetesë, ku zhvillohet blegtoria, bletaria, pylltaria, turizmi malor, gjuetia etj. Në 30.4% të sipërfaqes së qarkut, në vitin 2004 shtriheshin 6 vendbanime malore, me largësi mesatare 13.0 km. Një vendbanimi i takonin 146.1 km<sup>2</sup> dhe 200 banorë. Largësia mesatare midis vendbanimeve për rrethin e Përmetit ishte 8.2 km, ku një vendbanimi i takonin 57.8 km<sup>2</sup> dhe 160 banorë. Rrethi i Përmetit kishte 5 vendbanime në këto lartësi: 4 në

komunën Frashër dhe 1 në Petran (fshati Lupckë) dhe rrethi i Gjirokastrës ka fshatin Golem në komunën e Picarit.

*d. Orientimi ekonomik i vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare*

Në relievin fushor dega kryesore e ekonomisë është bujqësia. Banorët e këtyre vendbanimeve merren kryesisht me kultivimin e bimëve të arave, mbarështimin e blegtorisë, frutikulturën, përpunimin (artizanal dhe industrial) të produkteve bujqësore e blegtorale, tregtinë etj.

Në relievin e ulët kodrinor drejtimet kryesore të ekonomisë janë blegtoria dhe pemëtaria. Kësaj kategorie u përkasin vendbanimet që shtrihen nga fshati Hormovë në veriperëndim e deri te Gryka e Selckës në jug, nga kreshta e malit të Lunxhërisë në lindje e deri te lugina e Drinosit në perëndim.

Në relievin e lartë kodrinor drejtimi kryesor i ekonomisë është blegtoria (mbarështimi i dhive), bujqësia, frutikultura (sidomos pjergullat në komunën e Ballabanit), nxjerrja e qymyrgurit (në komunën Buz), tregtia etj. Në ekonominë e komunës Kurvelesh luan rol të dorës së parë blegtoria e imët (dhentë, dhitë). Në relievin malor vendbanimet kanë drejtim kryesor blegtorinë e imët. Të tilla janë vendbanimet e komunave Cepo, Picar, Pogon, Frashër, të përmendura edhe për rritjen e hardhisë, punimin e vozave etj.

## **2.2. Klasifikimi tipologjik i vendbanimeve rurale**

Klasifikimi tipologjik i vendbanimeve mbështetet në tiparet e përbashkëta dhe në veçoritë thelbësore të grupeve të ndryshme të vendbanimeve. Ai evidenton tipat dhe fizionominë e fshatrave të qarkut të Gjirokastrës, strukturën dhe jetën e shoqërive rurale të vjetra dhe të reja.

*a. Fshatra të shpërndara, janë vendbanime të hapura dhe me shtëpi të veçuara. Në rrethin e Përmetit të tilla janë fshatrat Limar, Malëshovë, Mbrezhdan, Ballaban, Ball, Bubës, Kajcë, Mazhanj,*

Psar, Toshkëz, Bedyqas, Bënjë, Fratar, Katundishtë, Kuqar, Riban, Seniçan, Tolar, Varibop, Dëshnicë, Gostivisht, Kreshovë, Miçan, Ogren-Kostrec, Surropull, Shijan-Goroshijan, Zavalan, Qilarisht, Tremisht, Alipostivan, Argovë, Grabovë, Hotovë, Kosinë, Mokricë, Pacomit, Rapckë, Zleushë etj. Në rrethin e Tepelenës të tillë janë fshatrat Zhulaj, Krahës, Levan, Sinanaj, Dorëz, Dhëmban, Gllavë, Komar, Selckë, Shalës, Izvor, Luftinjë, Rabie, Zhapokikë, Maricaj, Toç, Koshtan, Qesarat, Kashisht, Damës, Lekël, Peshtan etj.

*b. Fshatra të përquendruara*, janë vendbanime të rregullta dhe të mbyllura, ku ndërtesat kolektive dhe të shërbimeve krijojnë qendrën e fshatit (bërthama e vendbanimit), ndërsa shtëpi (të ndërtuar më afër njëra-tjetrës) rrethojnë qendrën. Blloqet e banesave ndahen nga rrugë që vijnë nga periferia në drejtim të qendrës së fshatit. Të tilla vendbanime kompakte janë ato të luginës së Drinos, Vjosës, Dëshnicës, krahinës së Lunxhërisë, Zagories e Rrëzës së Përmetit.

*c. Fshatra lineare*, janë zhvilluar përgjatë rrugës, rrëzës së malit, rrjedhës së lumit etj.

*Në rrethin e Gjirokastrës*, janë fshatrat Çatistër e Hllomo-Mavrojer: komuna Pogon, Asim Zeneli (komuna Antigone), Shtëpëz (komuna Picar), Glinë e Vllaho Goranxi (komuna Dropull i Poshtëm), Bularat, Bodrishtë e Sotirë (komuna Dropull i Sipërm).

*Në rrethin e Përmetit*, janë qyteti Përmet (përgjatë luginës së Vjosës), fshati Riban (komuna Dëshnicë), Topojan e Podgoran (komuna Sukë), Çarçovë dhe Petran-Gjinkar.

*Në rrethin e Tepelenës*, janë fshatrat Dragot, Salari, Hormovë e Bëncë (komuna Qendër Tepelenë), Progonat (komuna Kurvelesh).

*d. Fshatra në kryqëzime rrugësh*, janë fshatrat e Gjirokastrës (Sopik, Skore e Poliçan të Pogonit, Sotirë i Dropullit të Sipërm),



fshati Çarçovë i Përmetit, fshatrat Luzat, Fshat Memaliaj, Gusmar, Nivicë dhe Dukaj të Tepelenës etj.

*e. Mënyrat e ndryshme të organizimit dhe përdorimit të hapësirës janë të larmishme. Shtëpitë kanë kryesisht oborr e kopshtije me pemë frutore e perime. Rreth vendbanimit shtrihen tokat e punueshme, kultivuar me perime, bostan, fasule, patate (rrethi i parë), pemë frutore, drithëra e foragjere (rrethi i dytë), pyje e kullota (rrethi i tretë). Në qendra zakonisht ndodhen rrapet, çezmat, objektet e kultit, ato social-kulturore, tregtare, të artizanatit. Duke filluar nga qendra e fshatit, një rrjet rrugësh kryesore e dytësore u shërbejnë territoreve rurale.*

### **3. Klasifikimi i vendbanimeve rurale sipas funksionit kryesor**

Klasifikimi u realizua mbi regjistrin e pasurive të paluajtshme (*Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, 2005*), i cili përmban librat e ngastrave me sipërfaqet sipas kategorive (tokë arë, pemëtore, vreshta, pyje, kullota dhe toka joprodhuese). Në këtë aspekt, fragmentarizimi i tokave dhe antiligji përballë ligjit pengojnë funksionimin e tregut të tokës (*Musta, B., Musta, F. 2001*).

**3.1. Funkzioni bujqësor**, ushtrohet kryesisht në relievin fushor dhe kodrinor të ulët. Me interes për trajtimin e tregjeve të pasurive, copëzimit të lartë të tokës, konflikteve për të drejtat mbi tokën, me probleme serioze në të ardhmen për shërbimet publike, është treguesi i peshës së sipërfaqes bujqësore në sipërfaqen e përgjithshme të çdo fshati (*Vata, 2005*). Për këtë tregues dallohen njësitë administrative: Dropull i Poshtëm: 70.5%, Lunxhëri: 44.2%, Dropull i Sipërm: 42.4% dhe Buz: 47.3%.

*Në Gjirokastrë, me funksion bujqësor mbizotërues janë fshatrat e njërive Dropull i Sipërm, Lunxhëri (Valare, Nokovë, Erind dhe Gjatë), Odrie (Hundëkuq dhe Labovë e Madhe), Dropull i*

Poshtëm (Bularat, Vodhinë, Likomil, Bodrishtë, Zervat, Jergucat, Kakavie dhe Dritë), Qendër Libohovë (Bulo, Labovë e Sipërme dhe Nepravishtë), Cepo (Çepunë, Palokastër, Mashkullorë dhe Kodër), Antigone (Arshi Lengo), ku sipërfaqja bujqësore përbën mbi 40% të sipërfaqes së përgjithshme (Figura 5).



Figura 5. Fshatra të fushës së Dropullit të Poshtëm, ku ushtrohet funksioni bujqësor (burimi: autorët)

Në Përmet, me funksion bujqësor mbizotërues janë fshatrat e njësive Dëshnicë (Tolar, Bedyqas, Kuqar, Kodrishtë dhe Katundishtë), Qendër Piskovë (Kutal, Kosinë, Piskovë, Rapçkë dhe Pacomit), Petran (Bodar, Gjinkar, Qilarisht, Petran dhe Badëlonjë), Çarçovë (Çarçovë dhe Draçovë), Sukë (Goricë) dhe Fshat Këlcyrë, ku sipërfaqja bujqësore përbën mbi 40% të sipërfaqes së përgjithshme.

Në *Tepelenë*, me funksion bujqësor mbizotërues janë fshatrat e njësisive Buz (Selckë, Gllavë, Golemaj dhe Shalës), Qesarat (Anë Vjosë dhe Qesarat), Luftinjë (Tosk Martalloz, Ballaj dhe Luftinjë e Sipërme), Krahës (Krahës, Zhulaj, Përparim dhe Lulëzim), Memaliaj Fshat (Cërrilë, Memaliaj Fshat dhe Mirinë), Lopës (Sinanaj) dhe Qendër (Dragot), ku sipërfaqja bujqësore përbën mbi 41% të sipërfaqes totale.

**3.2. Funksioni blegtoral**, ushtrohet në vendbanimet me reliev të lartë kodrinor dhe malor, me sipërfaqe kullimore (kullota, livadhe dhe ledhe) të konsiderueshme. Për identifikimin e fshatrave me funksion blegtoral është përdorur treguesi i sipërfaqes kullimore, me faktin se tokat pyjore e kullimore vazhdonin në gjendje konfuzioni (Vata, 2005). Për këtë tregues dallohen njësitë Zagorie, Odrie, Antigone, Picar, Cepo e Lunxhëri, me sipërfaqe kullimore mbi 40% të sipërfaqes së përgjithshme, si dhe njësitë Qendër Tepelenë, Memaliaj Fshat dhe Kurvelesh, ku sipërfaqet kullimore zënë mbi 35 % të sipërfaqes së përgjithshme.

Në *Gjirokastër*, funksion blegtoral mbizotërues kanë fshatrat e njësisive Zagorie (Lliar, Hoshtevë-Vithuq, Konckë, Ndëran, Doshnicë, Nivan dhe Sheper, Dropull i Sipërm (Selo, Klishar, Kërrë, Sotirë, Llovinë, Krioner dhe Koshovicë), Picar (Golem dhe Kolonjë), Odrie (Andon Poçi dhe Labovë e Vogël), Poliçan (Selckë, Poliçan dhe Skore), Lunxhër (Mingul, Karjan, Kakoz, Dhoksat, Këllëz dhe Gjatë), Antigone (Krinë, Saraqinishtë dhe Asim Zeneli), Cepo (Prongji, Kardhiq, Humelicë dhe Mashkullorë), Qendër Libohovë (Labovë e Poshtme), Dropull i Poshtëm (Radat), me sipërfaqe kullimore mbi 41% të totalit.

Në *Përmet*, funksion blegtoral mbizotërues kanë fshatrat e bashkisë Këlcyrë (Mbrezhdan), me sipërfaqe kullimore 36.5% të sipërfaqes totale.

Në *Tepelenë*, funksion blegtoral mbizotërues kanë fshatrat e njësisive Krahës (Xhaxhaj, Lekdush, Progonat dhe Nivicë), Luftinjë

(Izvor, Arrëz e Madhe, Vagalat dhe Zhapokikë), fshatrat Hormovë, Veliqot, Lekël, Mezhgoran, Mamaj, Turan, Dukaj, Damës, Vasjar, Kashisht, Memaliaj Fshat, me sipërfaqe kullosore 45% të totalit.

**3.3. Funkzioni bujqësor-turistik,** ushtrohet kryesisht në vendbanimet me tradita të spikatura bujqësore (ku ushtrohen praktika bujqësore tërheqëse për turistët), por edhe në vendbanimet me tradita në menazhimin e sipërfaqeve pyjore, ujërave etj. Për identifikimin e fshatrave me funksion bujqësor-turistik shërben treguesi i peshës së sipërfaqes pyjore dhe ujore (lumenjve, përrrenjve dhe liqeneve) në sipërfaqen e përgjithshme të çdo fshati. Për këtë tregues dallohen njësitë Pogon, Petran, Çarçovë, Qendër Piskovë, Dëshnicë, Sukë, Kurvelesh, ku sipërfaqet pyjore dhe ujore zënë mbi 45% të sipërfaqes së përgjithshme. Në *Gjirokastrë*, funksion bujqësor-turistik mbizotërues kanë fshatrat e njësisë Pogon (Sopik, Çatistër, Hllomo dhe Mavrojer), Zagorie (Topovë dhe Zhej), Picar (Shtëpëz dhe Picar), Dropull i Sipërm (Pepel) dhe Odrie (Tërbuq), ku sipërfaqet pyjore dhe ujore zënë mbi 45% të sipërfaqes së përgjithshme.

Në *Përmet*, funksion bujqësor-turistik mbizotërues kanë fshatrat e njësisë Qendër Piskovë (Alipostivan, Pagri, Grabovë-Argovë, Buhal, Pacomit dhe Rapckë), Petran (Lipë, Bënjë Novoselë, Leusë, Kaludh, Badëlonjë, Leshicë dhe Gjinkar), Dëshnicë (Seniçan, Panarit, Riban, Varibop dhe Kuqar), Çarçovë (Biovizhdë, Vllaho-Psilloterë, Strëmbec, Kanikol, Zhepë, Draçovë dhe Pëllumbar) dhe Sukë (Sukë dhe Taroninë), ku sipërfaqet pyjore dhe ujore zënë mbi 43% të sipërfaqes së përgjithshme.

Në *Tepelenë*, funksion bujqësor-turistik mbizotërues kanë fshatrat e njësisë Kurvelesh (Gusmar dhe Rexhin), Buz (Arrëz e Vogël, Badër, Kurtjez, Buz Kalemaj, Komar, Selckë e Vogël, Xhafaj, Shalës dhe Buz), Lopës (Lab Martalloz dhe Dorëz),

Memaliaj Fshat (Bylysh dhe Kallëmb), Qesarat (Ahmanikaj, Koshtan, Iliras dhe Qesarat), Qendër Tepelenë (Peshtan dhe Luzat), Luftinjë (Luadhaj, Maricaj, Zhapokikë e Sipërme, Dervishaj dhe Rrapaj), Krahës (Allkomemaj, Krahës i Sipërm, Levan dhe Kalivaç), ku sipërfaqet pyjore dhe ujore zënë mbi 40% të totalit.

**3.4. Funkzioni bujqësor-industrial**, ushtrohet kryesisht në vendbanimet afër qyteteve, ku është zhvilluar artizanati dhe industria e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Në *Gjirokastrë*, funksion bujqësor-industrial kanë fshatrat e njëjësive Dropull i Sipërm (Vrisera, Sotirë, Bularat etj.), Dropull i Poshtëm (Dhuvjan, Sofratikë, Vanistër, Goranxi, Terihat etj.), Cepo (Kodër, Mashkullorë, Palokastër, Humelicë, Kardhiq etj.), Lunxhëri (Erind, Mingul, Valare etj.), Qendër Libohovë (Bulo dhe Nepravishtë), Antigone (Arshi Lengo), Pogon (Poliçan) dhe Zagorie (Sheper).

Në *Përmet*, funksion bujqësor-industrial kanë fshatrat e bashkisë Këlcyrë (Fshat Këlcyrë) dhe komunës Petran (Leshicë, Petran, Bodar dhe Badëlonjë), Qendër Piskovë (Kosinë, Kutal dhe Piskovë), Sukë (Zhepovë), Dëshnicë (Bedyqas, Kuqar dhe Tolar) dhe Çarçovë (Çarçovë dhe Pëllumbar). Në *Tepelenë*, funksion bujqësor-industrial kanë fshatrat e njëjësive Lopës (Dhëmban, Sinanaj dhe Matohasanaj), Krahës (Lulëzim dhe Krahës), Luftinjë (Dervishaj, Zhapokikë dhe Ballaj), Qendër Tepelenë (Dragot dhe Lekël), Buz (Buz dhe Xhafaj), Kurvelesh (Progonat), Memaliaj Fshat (Cërrilë, Memaliaj Fshat dhe Mirinë), Qesarat (Anëvjosë dhe Qesarat).

**3.5. Vendbanime me funksione administrative**, janë vendbanime që kanë pasur dhe kanë funksione administrative (qendra lokalitetesh, kooperativash dhe ndërmarrjesh bujqësore, fshatrash të bashkuara, komunash).

### 3.6. Organizimi hapësinor në funksion të veprimitarisë mbizotëruese

Fshatrat e mësipërme, që gëzonin statusin e *qendrës administrative* ishin njëkohësisht qendrat e sistemeve territoriale të fshatrave të lokalitetit, kooperativës apo NB-së. Këto *qendra administrative* ishin promotoret e veprimitarive ekonomike dhe social-kulturore të territoreve rurale që kishin nën juridiksion. Në organizimin e hapësirës rurale rol parësor kishte veprimtaria ekonomike mbizotëruese, që varej nga relievi dhe kushtet e tjera natyrore.

Nisur nga kjo, qendrat administrative klasifikohen në:

-qendra administrative *në reliev fushor*, ku ushtrohet bujqësia, mbarështimi i gjedhëve, peshkimi etj. Të tilla janë: Jergucati, Sofratika dhe Vriseraja, në rrethin e Gjirokastrës; Këlcyra dhe Suka në rrethin e Përmetit; Sinanaj, në rrethin e Tepelenës.

-qendra administrative *në reliev kodrinor*, ku ushtrohet kryesisht frutikultura, blegtoria, bujqësia e bletaria. Të tilla janë: Prongji, Kardhiq, Nokovë, Erind, Labovë e Madhe, Topovë, Konckë dhe Poliçan, në Gjirokastrë; Draçovë, Petran, Ballaban, Çarçovë, Pavar, në rrethin Përmet; Buz i Madh, Rabie, Krahës, Toç, Lab Martaloz e Progonat, në Tepelenë (Figura 6).






Figura 6. Fshatra të shtrira në relievin e ulët dhe të lartë kodrinor (burimi: autorët)

-qendra administrative në *reliev malor*, ku ushtrohej kryesisht mbarështimi i blegtorisë, bletaria, mbledhja e bimëve mjekësore etj. I tillë është fshati Frashër në rrethin e Përmetit.

### Përfundime

Në zonat *fushore*, popullsia mesatare e vendbanimeve rurale është e lartë: 2.1 herë më e lartë se mesatarja e prefekturës (para 1945), 2.4 herë më e lartë se mesatarja e qarkut (1946-1989) dhe 2.8 herë më e lartë se mesatarja e qarkut (pas 1990), ndërsa largësia mesatare midis vendbanimeve rurale është ulur: 3.8 km (para 1945), 3.1 km (1946-1989) dhe 3.0 km (pas 1990).

Në *relievin e ulët kodrinor*, popullsia mesatare e vendbanimeve rurale është e ulët: 0.8 herë më e ulët se mesatarja e prefekturës (para 1945), 0.7 herë më e ulët se mesatarja e qarkut (1946-1989) dhe 0.6 herë më e ulët se mesatarja e qarkut (pas 1990), ndërsa largësia mesatare midis vendbanimeve rurale është ulur: 2.9 km (para 1945), 2.7 km (1946-1989) dhe 2.5 km (pas 1990).

Në *relievin e lartë kodrinor*, popullsia mesatare e vendbanimeve rurale është e ulët: 0.8 herë më e ulët se mesatarja e prefekturës (para 1945), 0.6 herë më e ulët se mesatarja e qarkut (1946-1989) dhe 0.4 herë më e ulët

se mesatarja e qarkut (pas 1990), ndërsa largësia mesatare midis vendbanimeve rurale është rritur: 3.1 km (para 1945), 3.4 km (1946-1989) dhe 3.5 km (pas 1990).

Në zonat malore, popullsia mesatare e vendbanimeve rurale është e ulët: 0.8 herë më e ulët se mesatarja e prefekturës (para 1945), 0.7 herë më e ulët se mesatarja e qarkut (1946-1989) dhe 0.3 herë më e ulët se mesatarja e qarkut (pas 1990), ndërsa largësia mesatare midis vendbanimeve rurale është rritur: 5.9 km (para 1945), 14.2 km (1946-1989) dhe mbi 15 km (pas 1990).

Vendbanimet rurale kanë prirje të shtrihen drejt zonës së ulët fushore, pranë rrugëve nacionale, si dhe drejt vendbanimeve më të mëdha. Organizimi administrativo-territorial ka ndikuar në shpërndarjen racionale të vendbanimeve dhe infrastrukturës (njësive tregtare, infrastrukturës arsimore e shëndetësore) dhe shpreh tiparet e evolucionit historik dhe të zhvillimit social-ekonomik të qarkut.

Deri në vitin 1990, faktori social-ekonomik përcaktonte në mënyrë të kufizuar zbatimin e politikave rregulluese të vendbanimeve rurale. Sistemi i atëhershëm synonte kufizimin e zënies së tokës bujqësore dhe rritjen e dendësisë së popullimit në hapësirën rurale. Pas vitit 1990 nuk janë zbatuar politika të mirëfillta për zhvillimin e vendbanimeve rurale, përkundrazi ka ndodhur një shtrirje spontane e banesave individuale 2-3 katëshe në sipërfaqet bujqësore të qarkut.

### **Rekomandime**

Në braktisjen e një sistemi rajonal të vendbanimeve me akses të pabarabartë në lëndët e para, tokën, pushtetin apo një farë shkalle dominimi ekonomik, territorial ose ideologjik, duhet fokusuar në një shpjegim sa më të përshtatshëm mbi shkaqet dhe mekanizmat e saj, që të vihen në pah mundësitë optimale për rrizhvimin dhe ringritjen e tyre.

Zhvillimi normal i politikave të përdorimit të tokës dhe i pasurive të tjera të paluajtshme, duhet të realizohet në përputhje me interesat e individëve, interesat kombëtarë dhe lokalë.



Garantimi i të drejtave të zotërimit të pronës duhet të bashkëshoqërohet me fitimin e së drejtës mbi tokën dhe pasuritë e tjera të paluajtshme.

Me qëllim përdorimin racional të territorit, është e nevojshme të hartohen *Planet e Rregullimit të Territorit*, të cilat përcaktojnë ndërhyrjet rregulluese në funksion të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

### Literatura

AQSH.: *Fondi 188. Dosja 41*. Korrik 1940, f. 256.

AQSH.: *Fondi 490. Dosja 376*. 30.XI.1945, f. 24-28.

Shehu, N Xh., (2005) *Enciklopedia e Tepelenës*, Tiranë, f. 45-76, 17.

Tirta, M., (1999). Migrime të shqiptarëve të brendshme dhe jashtë atdheut (vitet '40 të shek. XIX-vitet '40 të shek. XX), *Etnografia Shqiptare* 18, Tiranë, f. 25-98.

Qendra e Publikimeve Zyrtare. (2000). *Fletore Zyrtare* Nr. 25, Datë 08/08/2000. Ligj Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (Ndryshuar me ligj Nr. 9208, datë 18.3.2004).

Qendra e Publikimeve Zyrtare. (2000). *Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë* Nr.137, Datë.11/09/2014: Ligj Nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Shkurti, S., (1997). *Vendbanimet fshatare dhe ekonomia bujqësore në Shqipërinë mesjetare*, *Etnografia Shqiptare* 17, Tiranë, f. 13-25.

Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme): *Gjirokastër, Përmet dhe Tepelenë*. (2005).

Vata, N., (2005). *Regjistrimi i tokës*, Tiranë, f. 26-54.

Musta, B., Musta, F., (2001). *Vlerat dhe tregu i tokës*, Tiranë, f. 129-156.

**Dr. Rudina Uruçi<sup>1</sup>**

## **NDIKIMI I FAKTORËVE NATYRORË DHE SOCIALË NË ECURINË E NUMRIT DHE TË SHPËRNDARJES SË VENDBANIMEVE DHE POPULLSISË NË BASHKINË E KOLONJËS**

### ***Abstrakt***

Studimet rajonale, si ndërthurëse të analizave me natyrë fiziko-gjeografike me ato demografike, sociale dhe ekonomike, janë vënë gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes së studiuesve në mbarë botën. Një tendencë e tillë vërehet edhe në vendin tonë. Kolonja me qendër Ersekën e ka zanafillën që në fillim të shek. XVII, duke u populluar dhe zhvilluar në vazhdimësi, në varësi të ngushtë nga kushtet fiziko-gjeografike. Sot, Kolonja përfaqëson një bashki të përbërë nga 4 njësi administrative, pjesë të qarkut të Korçës. Është një ndër bashkitë me numrin më të vogël të popullsisë, duke numëruar gjithsej 18683 banorë, prej të cilëve rreth 10000 në zonat rurale. Numri i popullsisë ka ardhur vazhdimisht në rënie, sidomos pas viteve 1990, si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe ekonomike që ndodhën në vendin tonë. Zona ka njohur edhe lëvizjen më të madhe migruese, kryesisht sipas dy drejtimeve: nga fshatrat drejt Ersekës dhe Leskovikut, si dhe nga Erseka drejt qyteteve të tjera, në veçanti drejt Tiranës dhe jashtë kufijve shtetërorë. Janë pikërisht këto dinamika interesante demografike si dhe të vendbanimeve, sidomos gjatë dekadave të fundit, që përbëjnë boshtin kërkimor të këtij punimi, duke synuar njëkohësisht nxjerrjen në pah të faktorëve që kanë ndikuar në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve.

*Fjalë çelës: vendbanim, popullsi, njësi administrative, faktor, shpërndarje e popullsisë*

---

<sup>1</sup> "Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan; E-mail: rudina-uruci@yahoo.com

## Abstract

Regional studies, as a complement to analyzes of physical-geographic, demographic, social and economic nature, have increasingly become the focus of researchers around the world. Such a tendency is noticed even in our country. The colony with Erseka's city dates back to the beginning of the 16th century. XVII, being populated and developed continually, depending closely on the physical-geographical conditions. Today, Kolonja represents a municipality comprised of 4 administrative units, part of the Korça district. It is one of the municipalities with the smallest number of populations, counting a total of 18683 inhabitants, out of which about 10000 in rural areas. The number of the population has been steadily declining, especially since the 1990s, as a result of the political and economic changes that occurred in our country. The area has also known the largest migratory movement, mainly in two directions: from villages to Erseka and Leskovik, as well as from Erseka to other cities, especially towards Tirana and other states. It is precisely these interesting demographic dynamics, especially during the last decades, which make up the research axis of this paper, while at the same time aiming to highlight the factors that have influenced the migration movement of the population and settlements.

*Keywords:* settlements, population, administrative units, factor, distribution of population.

## I. Hyrje

Pozita gjeografike që ka kjo bashki, në të cilin kalojnë rrugë që e lidhin atë me pjesë të tjera të Shqipërisë e më gjerë, ka bërë që shumica e popullsisë që ndodhet në zonat e thella dhe fshatrat e thella malore të zhvendosen buzë këtyre rrugëve për të ushtruar aktivitetin e tyre jetësor. Pozita gjeografike e bashkisë ndikon më së shumti te banorët e zonave më të thella malore, ku për shkak të largësisë nga qendrat e zhvilluara ekonomiksht të vendit, bën që zhvillimi i këtyre banorëve si ekonomiksht, ashtu edhe nga ana arsimore dhe kulturore të mos jetë në nivelet e duhura. Gjithashtu rrugët e vetme për t'u lidhur me zonat e tjera janë ato rrugore automobilistike. Në të ardhmen shihet me optimizëm rikonstruksioni i aksit nacional Korçë – Leskovik, punime të cilat aktualisht janë në proces.

Bashkia e Kolonjës ka 18.683 banorë (Instat 2020), ndërsa qyteti i Ersekës që është dhe qendra më e madhe administrative ka një popullsi prej 4426 banorësh (Instat, 2011). Në ditët e sotme dendësia shkon në 17.7 banorë/km<sup>2</sup>, pra rreth 49.6% më pak se 10 vite më parë. Është bashkia e dytë me migrimin më të madh të popullsisë pas bashkisë të Hasit. Shtirirja në hapësirë e vendbanimeve është e kufizuar përgjatë rrugës kryesore nacionale dhe pranë burimeve dhe përrrenjve lumorë ku ofrohen kushte më të mira për zhvillimin ekonomik.

Qyteti i Leskovikut në ditët e sotme numëron një popullsi prej rreth 1500 banorësh (Zyra e gjendjes civile Ersekë 2021).

## II. Hapësira e studimit

Si hapësirë studimi është marrë territori që përfshin bashkinë e Kolonjës, së bashku me 4 njësitë administrative që përfshihen brenda saj. Pra, gjithsej një sipërfaqe prej 864.06 km<sup>2</sup>.

Bashkia e Kolonjës kufizohet në veri me bashkitë e Devollit dhe të Korçës, në perëndim dhe jug me bashkinë e Përmetit, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Ersekës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative me ndarjen e re administrative, pasi më të vjetrën kishte 8 njësi të cilat janë: 1. Ersekë dhe Barmash, 2. Qendër Ersekë dhe Novoselë, 3. Leskovik dhe Qendër Leskovik, 4. Mollas dhe Çlirim. Bashkia e Kolonjës ka në administrimin e saj 2 qytete: Ersekë dhe Leskovik, si dhe 76 fshatra, që janë të përfshira në njësitë administrative si në vijim:

🚩 **Novoselë:** Novoselë, Mesiçkë, Kagjinas, Zharkan, Piskal, Vitisht, Shijan, Kaduç, Ndërrmarr, Mbreshtan.

🚩 **Barmash:** Barmash, Leshnjë, Shalës, Gozhdorazhd, Sanjollas, Kamnik, Bënjëz, Radimisht, Arrëz, Radjan.

🚩 **Mollas:** Mollas, Skorovot, Qinam, Vodice, Qafzez, Helmës, Shtikë, Pepellash, Butkë, Kozel, Milec, Bezhan, Boshanj, Blush.

✚ **Qendër Ersekë:** Starie, Bejkovë, Psar, Selenicë, Kreshovë, Gostivisht, Lëngës, Kodras, Kabash, Borovë, Taç Qëndër, Taç Poshtë, Taç Lartë, Rehovë, Gjonç, Prodan.

✚ **Qendër Leskovik:** Pobickë, Cerckë, Radat, Radovë, Postenan, Lashovë, Peshtan, Podë, Kovaçisht, Vrepckë, Gërmenj, Radanj, Glinë, Gjirakar.

✚ **Çlirim:** Çlirim, Qesarak, Kaltanj, Qytezë, Selenicë e Pishës, Luaras, Lënckë, Kurtez, Orgockë, Qinam- Radovickë, Radovickë, Psar i Zi.

### III. Metoda

Punimi “Ndikimi i faktorëve natyrorë dhe socialë në ecurinë e numrit dhe të shpërndarjes së vendbanimeve dhe popullsisë në bashkinë e Kolonjës”, ka për synim të evidentojë fakte dhe të dhëna shkencore mbi popullimin e hershëm të zonës si dhe numrin e popullsisë sipas njësive administrative. Metodologjia e përdorur konsiston në dy aspekte të rëndësishme: në aspektin kohor dhe në atë hapësinor. Kjo për të pasqyruar sa më drejt e në mënyrë shkencore fillesat e qendrave urbane e rurale në Kolonjë, si dhe ndryshimet e tyre në periudha të ndryshme kohore në varësi të faktorëve ndikues. Këto ndryshime janë parë dhe në aspektin hapësinor. Kjo duke pasur për qëllim evoluimin që pësuan vendbanimet me zgjerimin e tyre në veçanti në periudhën e viteve 1960-1989. Për të nxjerrë më në pah këto ndryshime jam mbështetur në metodën e hulumtimit historik me të dhënat e mbledhura në Arkivin e Shtetit dhe në zyrën e gjendjes civile për vite të ndryshme, si dhe nga burime të tjera. Pra nëpërmjet kësaj metode jepen fakte bindëse mbi historinë e hershme të krijimit të këtyre vendbanimeve në zonë, si dhe ndryshimet në kontekstin kohor që ka pësuar popullsia e zonës si në aspektin sasi, por dhe në atë cilësor. Kjo duke u bazuar në të dhëna statistikore dhe shoqëruar me grafikë dhe tabelat përkatëse. Përdorimi i metodës

statistikore me ato krahasuese dhe grafike na mundësojnë të japim konkluzione të sakta mbi popullsinë sot dhe prognozën e saj, si dhe faktorët që ndikojnë në numrin dhe shpërndarjen e popullsisë. Për sa parashtruam më lart, përdorimi i këtyre metodave të ndërlidhura me njëra-tjetrën na japin mundësi për të dhënë në një analizë shumë më të thelluar, njëherazi të parashtrorjme rrugët e zhvillimit dhe integritit të saj jo vetëm me zonat më të zhvilluara në vend, por dhe më gjerë.

#### IV. Gjetje dhe diskutime

##### 1. Rrjedha historike e vendbanimeve

Territoret e bashkisë të Kolonjës kanë qenë të banuara që në kohët prehistorike. Janë gjetur gjurmë të vendbanimeve neolitike në Luaras dhe në Kamnik që datojnë rreth 2800-2600 vjet p.e.s. Banorët e Kamnikut kanë qenë mjeshtër të prodhimit të qeramikës dhe punimet e tyre janë cilësuar si veprat më të arrira dekorative të neolitit në Europën Juglindore.

Gjatë periudhës ilire kjo trevë ka qenë pjesë e shtrirjes së fisit të Dasaretëve, një fis ilir sipas historianëve shqiptarë, por që në enciklopedinë angleze dhe europiane njihet si një popullsi greke. Mendimi i dytë është tërësisht i gabuar, për vetë faktin se janë vetë historianët e antikitetit grek që thonë se në këto zona jetonin “barbarët”, pra popullsi jogreke. Madje, kjo trevë përmendet edhe në dokumentet romake të kohës, ku në vitin 200 p.e.r ushtria romake e ardhur nga lugina e Osumit shkatërroi vendbanimet ilire të zonës (Aliu, 1975).

Nga kjo kohë, popullsia ka ardhur duke u shtuar me përjashtim të disa dekadave të veçanta ku ajo është detyruar të migrojë ose emigrojë në raste epidemish dhe luftërash. Sipas autores angleze Edith Durham, qyteti Ersekës është krijuar rreth vitit 1768 me rreth 100 shtëpi, me banorë të ardhur nga fshatrat përreth dhe

të vendosur buzë rrugës që lidhte Korçën me Leskovikun (Durham, 1905).

Për qytetin e Leskovikut flitet për herë të parë në dokumentet e shkruara në shekullin XV, por kulmin e ka arritur në fillimshekullin XX, ku popullsia arrinte në 10000 banorë. (Aliu, 2007) Shkaku kryesor i shtimit të popullsisë ishte zhvillimi ekonomik që mori qyteti pas shtimit të marrëdhënieve tregtare midis Korçës dhe Janinës e Prevezës. Madje, sipas Sami Frashrit në librin e tij “Enciklopedia”, Leskoviku gradualisht kaloi nga qendër kazaje në qendër sanxhaku (Mita, 2017).

## **2. Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve dhe roli i kushteve natyrore dhe politike**

### **2.1. Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve**

Në bashkinë e Kolonjës, sikurse u përmend edhe më sipër, kemi 2 vendbanime urbane të cilat janë qytetet e Ersekës dhe të Leskovikut dhe 76 vendbanime rurale. Numri i vendbanimeve rurale ka qenë më i madh në periudhat e mëparshme, por në disa nga këto vendbanime, kryesisht në 25 vitet e fundit popullsia ka migruar dhe emigruar në masën 100 % dhe shumë fshatra në komonat Novoselë dhe Çlirim nuk kanë më banorë rezidentë të përhershëm, por gjatë verës vihet re një popullim stinor i këtyre fshatrave, kryesisht nga popullsi e moshës së tretë (*Zyra e Gjendjes Civile Ersekë. 2021*). Por, në krahasim me zonat urbane vëmë re se pjesa më e madhe e popullsisë jeton në zonat rurale, pra në zonat urbane kemi një numër prej 5271 banorësh ose 47.6 % e popullsisë së bashkisë, ndërsa në ato rurale një numër prej 5799 banorësh ose 52.4 % të popullsisë. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar rreth qytetit të Ersekës, ku qyteti i Ersekës së bashku me komunën qendër Ersekë kanë 6419 banorë ose 57.9 % të popullsisë. Faktori kryesor i kësaj shpërndarjeje të popullsisë është ai social dhe si kriter kryesor mund të përmendim punësimin. Numrin më të lartë të popullsisë si njësi

administrative e ka qyteti i Ersekës me 33.8 % ndërsa më të ulëtën komunat Çlirim dhe Novoselë, me përkatësisht secila me 3.2 %.

Bashkia e Kolonjës kufizohet në veri me bashkitë e Devollit dhe të Korçës, në perëndim dhe jug me bashkinë e Përmetit, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Ersekës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative me ndarjen e re administrative, pasi me atë të mëparshmen kishte 8 njësi të cilat janë: 1.Ersekë dhe Barmash, 2.Qendër Ersekë dhe Novoselë, 3. Leskovik dhe Qendër Leskovik, 4. Mollas dhe Çlirim. Bashkia e Kolonjës ka në administrimin e saj 2 qytete: Ersekë dhe Leskovik, si dhe 76 fshatra që janë të përfshira në njësitë administrative si në vijim:

✚ **Novoselë:** Novoselë, Mesiçkë, Kagjinas, Zharkan, Piskal, Vitisht, Shijan, Kaduç, Ndërrmarr, Mbreshtan.

✚ **Barmash:** Barmash, Leshnjë, Shalës, Gozhdorazhd, Sanjollas, Kamnik, Bënjëz, Radimisht, Arrëz, Radjan.

✚ **Mollas:** Mollas, Skorovot, Qinam, Vodice, Qafzez, Helmës, Shtikë, Pepellash, Butkë, Kozel, Milec, Bezhan, Boshanj, Blush.

✚ **Qendër Ersekë:** Starie, Bejkovë, Psar, Selenicë, Kreshovë, Gostivisht, Lëngës, Kodras, Kabash, Borovë, Taç Qëndër, Taç Poshtë, Taç Lartë, Rehovë, Gjonç, Prodan.

✚ **Qendër Leskovik:** Pobickë, Cerckë, Radat, Radovë, Postenan, Lashovë, Peshtan, Podë, Kovaçisht, Vrepckë, Gërmenj, Radanj, Glinë, Gjirakar.


✚ **Çlirim:** Çlirim, Qesarak, Kaltanj, Qytezë, Selenicë e Pishës, Luaras, Lënckë, Kurtez, Orgockë, Qinam- Radovickë, Radovickë, Psar i Zi.

## 2.2 Faktorët ndikues në shpërndarjen e popullsisë dhe vendbanimeve të bashkisë së Kolonjës


Shumica e popullsisë që jeton në gropën e Kolonjës, kryesisht përgjatë rrugës nacionale, ndikohet edhe nga:



### **Faktorët natyrorë, si;**

 **Faktori klimatik:** kjo pasi ka ndikim të drejtpërdrejtë sepse zonat e thella malore kanë klimë më të ashpër se pjesa e brendshme, kjo për pasojë ka çuar në krijimin e një sërë vendbanimesh rurale pranë rrugës nacionale Korçë – Leskovik. Gjithashtu klima ndikon dhe në shpërndarjen e kulturave bujqësore, për shembull klima më në jug të bashkisë në krahinën e Leskovikut është më e favorshme për zhvillimin e vreshtarisë se gjithë pjesa tjetër e bashkisë dhe kjo ka bërë që ekonomia e popullsisë në këtë pjesë të varet nga ecuria e klimës. Gjithashtu, një tjetër aspekt është edhe turizmi i cili nuk është një degë shumë e zhvilluar, pavarësisht potencialit të madh turistik që ofron kjo zonë.

Këtu mund të zhvillohet si turizmi i bardhë dhe ai historik. Në këtë bashki ndodhen mbi 20 monumente natyrore dhe 2 zona të mbrojtura si parqe kombëtare, të cilat janë dhe fokusi kryesor i turistëve të huaj që vizitojnë këtë territor, ku si zona më të vizituara mund të përmendim zonën e Gërmenjtit dhe atë të Shelegurit (*Qirjazi, 2006*).

 **Relievi** me tërësinë e veçorive të tij si copëtimi horizontal dhe vertikal, pjerrësia dhe ekspozicioni i shpateve malore, lartësia absolute mbi nivelin e detit ka bërë që shpërndarja e qendrave të banuara, urbane dhe rurale, të kufizohet në ato pjesë ku popullsia ka kushte më të mira për jetesë, kryesisht pranë tokave më të pasura bujqësore. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në gropën e Kolonjës dhe një pjesë më e vogël, në lartësi më të mëdha. Relievi ndikon gjithashtu dhe në komunikim dhe transport, për shembull duke qenë një zonë malore komunikimi gjatë stinës së dimrit vështirësohet si pasojë e bllokimit të aksit kryesor nacional Korçë – Leskovik, si dhe rrugët lidhëse ndërmjet fshatrave malore nga reshjet e borës.

✚ **Hidrografia** ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo pasi çdo vendbanim rural dhe urban në këtë bashki është i vendosur pranë një rrjedhe ujore. Duke qenë e vendosur pranë këtyre pjesëve, popullsia e zhvillon aktivitetin e saj ekonomik, kryesisht atë bujqësor, nën ndikimin e këtij faktori. Tarracat lumore dhe tokat aluvionale pranë këtyre rrjedhjeve ujore bëjnë që prodhimi bujqësor të jetë më i madh në këto pjesë, pra duke e pasur më të lehtë sigurimin e ushqimit dhe aktiviteti human i popullsisë do të jetë më i lartë në këto pjesë. Gjithashtu, kohët e fundit rrjeti hidrografik po përdoret edhe për prodhimin e energjisë elektrike, ku mund të përmendim HEC-in e ndërtuar në lumin Osum.

✚ **Tokat** më të mira dhe më prodhuese gjenden në pjesët e sipërpërmendura të bashkisë, për pasojë aktiviteti më i madh ekonomik bujqësor ndodh në këto pjesë, edhe pse është shumë i vogël në krahasim me njësitë e tjera të ngjashme të rajonit juglindor, si fushëgropa e Korçës e Prrenjasit dhe gropa e Pogradecit. Ndikimi i tokave nuk është tepër i madh pasi bujqësia nuk zë një pozicion kyç në ecurinë ekonomike të zonës. Gjithashtu, dhe pasuritë nëntokësore nuk janë të larta, ku në të gjithë rrethin gjenden vetëm disa rezerva qymyrguri, por dhe këto nuk shfrytëzohen për shkak të cilësisë së dobët.

### 2.3 Roli i faktorit politik dhe luftërave

E parë në këndvështrimin historik, faktorët politikë dhe luftërat kanë pasur ndikim të herëpashershëm mbi popullsinë. Më poshtë janë të renditura disa nga periudhat ku popullsia është detyruar të emigrojë ose është zhdukur nga luftërat dhe sëmundjet epidemike.

Periudha e parë ndër to është koha e kryengritjes së vitit 1443, ku nën frymën e krijuar në atë kohë nga kryengritja e Gjergj Kastriotit, popullsia e zonës çliroi krahinën dhe vendbanime të tjera përreth duke përfshirë edhe qytetin e Kosturit, por fill pas saj

zona u ripushtua dhe u plaçkit nga ushtritë turke. Një pjesë e popullsisë për t'u shpëtuar vrasjeve mund të ketë emigruar. Këtë arsyetim e bazoj edhe te fakti se vetë Marin Barleti në librin e tij "Historia e jetës dhe veprës së Skënderbeut" thekson se "ajo pjesë e popullsisë shqiptare e cila mori pjesë në kryengritje, më vonë u detyrua të emigronte drejt Italisë për t'u shpëtuar hordhive pushtuese osmane".

Periudha e dytë është ajo e viteve 1700- 1709, ku mendohet se numri i kryengritësve arrinte në 12000 vetë, me banorë të Kolonjës dhe zonave përreth. Këta 9 vjet zona u transformua në një arenë luftimesh midis kryengritësve dhe ushtrive turke, deri sa këta të fundit e pushtuan zonën.

Periudha e tretë dhe më e rëndësishmja ishte pushtimi nga ana e andartëve (*Akademia e Shkencave, 1965*), të cilët pushtuan dhe masakruan popullsinë e zonës, madje 50 fshatra u shkretuan plotësisht. Kjo ndodhi pasi popullsia e zonës nuk pranoi të hynte në varësi të qeverisë vorio – epirote të filogrekëve të Shqipërisë së Jugut. Masakrat ishin nga më të çuditshmet, për shembull në fshatin Peshtan të Leskovikut u therën 27 fëmijë, kokat e të cilëve i hodhën në një pus. Një tjetër masakër është edhe ajo në fshatrat Selenicë e Taç, ku të gjithë burrave të fshatit iu pre koka dhe kokat e tyre i varën në rrugët që të çonin në këto fshatra për disa ditë me radhë. Organizimi i këtyre masakrave kishte si qëllim largimin e popullsisë shqiptare myslimane nga kjo zonë. Në këto rrethana të vështira, një pjesë e madhe e popullsisë u detyrua të migrojë<sup>1</sup>.

E katërta është Masakra e Borovës, më 6 korrik 1943, ku u dogj i gjithë fshati dhe u vranë të gjithë banorët, 107 veta. (*Mita, 2000*).


### **3. Shtimi natyror në bashkinë e Kolonjës**

---

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i studimit të popullsisë është dhe shtesa natyrore e saj, që paraqet diferencën midis lindjeve dhe vdekjeve. Për bashkinë e Kolonjës shtesa natyrore e popullsisë llogaritet të jetë rreth 15 banorë për mijë. Tendenca në vitet e fundit është gjithnjë e më shumë në ulje (*Zyra e Gjendjes Civile, Ersekë 2021*). Kjo, për një sërë faktorësh, ku mund të përmendim: faktorin ekonomik, faktorin social ku futen arsimimi, shëndetësia, karriera dhe faktorin politik e kulturor. Të gjithë këta faktorë që u përmendën më sipër kanë ndikuar në një nivel të ulët të lindshmërisë dhe të shtesës natyrore në përgjithësi. Kësaj i shtohet dhe migrimi, dhe si rezultat shohim një numër popullsie gjithnjë e më të vogël. Një shembull se si shtesa natyrore luan rolin e saj, mund të përmend se gjatë viteve të para të sistemit socialist, nga 1945 në 1970 popullsia e qytetit të Ersekës dhe Leskovikut u tetëfishua në këto 25 vite, pra nga rreth 300 banorë që kishte në vitin 1945 shkoi në rreth 2500 banorë. Natyrisht, që nuk ishte vetëm roli i shtesës natyrore, sepse ndikim kishin edhe lëvizjet migruese “të detyruara” për të mbështetur krijimin e industrisë së lehtë ushqimore dhe asaj të drurit, por mendoj se shtesa natyrore kishte ndikim kryesor me ndjekjen e politikave pronataliste dhe me përmirësimin e kushteve të jetës në përgjithësi (*Akademia e Shkencave, 2006*). Të dhënat për vitin 2020 flasin për një numër total prej 18683 mijë banorësh dhe 6,343 familje të regjistruara në gjendjen civile (*Zyra e gjendjes civile 2021*), krahasuar përkatësisht me rreth 22,6 mijë banorë dhe 5005 familje në vitin 2000 (*Zyra e gjendjes civile 2000*). Qendrat e banuara janë vendosur kryesisht rrëzë Gramozit. Qyteti i Ersekës shtrihet gati në qendër të pllajës së Kolonjës, në këmbë të malit të Gramozit, me distancë 2 km nga rrëza e tij dhe ka një sipërfaqe prej 1.1 km; 3100 familje dhe 7330 banorë. Qyteti i Leskovikut për vitin 2015 numëronte rreth 2266 banorë dhe 800 familje. Sot numëron bashkë me fshatrat 3127 banorë dhe 1176 familje. Duket

se rënia e numrit të popullsisë, sipas regjistrave, është frenuar pas vitit 2011, madje ka pasur rritje drejt niveleve të para 15 viteve (*INSTAT 2020*).

Raporti gjinor, sipas të dhënave të censurit të vitit 2011 rezulton të jetë 104.2, pak më i lartë se mesatarja kombëtare prej 100.4, gjë që mund të shpjegohet pjesërisht me fenomenin më të lartë të migrimit të gjinia femërore, kryesisht për arsimim të mëtejshëm e punësim. Në bashkinë e Kolonjës, grupmosha 15 – 64 vjeç përbën 68.1 % të totalit të banorëve, duke qenë thuajse po aq sa mesatarja kombëtare (68%), ndryshe nga grupmosha e fëmijëve: 15,6% (mesatarja në rang vendi 20%), gjë që tregon për rënie të lindshmërisë në dekadat e fundit (*INSTAT 2020*).



Grafiku. 1 Numri i popullsisë nga 1945-2020. Burimi; Gjendja civile, Ersekë

#### 4. Lëvizja hapësinore e popullsisë së bashkisë së Kolonjës

Duke parë ritmin e shtimit dhe zvogëlimit të popullsisë në kohë, rezulton se që prej statistikave të para të mbajtura për këtë zonë në vitin 1926 e deri në vitin 1991 popullsia ka ardhur duke u shtuar, madje gjatë periudhës 1945 – 1990 popullsia u dyfishua, kjo, si pasojë e politikave të ndjekura në atë periudhë kohore. Por gjatë 25 vjeçarit të fundit ajo pothuajse është zvogëluar trefish në krahasim me periudhën paraardhëse, kjo për disa faktorë që janë: (*Nikolli, Draci, Kosovrasti, 2013*).

**+** *Largësia e madhe nga qendrat e zhvilluara ekonomikisht të vendit* ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, në

pamundësi për të zhvilluar bizneset e tyre në këtë zonë, janë larguar kryesisht drejt kryeqytetit dhe në Ultësirën Perëndimore. Zona është 254 km larg aeroportit “Nënë Tereza” dhe 300 km larg portit të Durrësit.

✚ *Lindjet e pakta* janë një tjetër shkak që ka ndikuar në zvogëlimin e popullsisë, pasi në vitet e fundit numri i tyre pothuajse është përgjysmuar, kjo edhe për shkak të emigrimit dhe migrimit të shumtë, por edhe për shkak të politikave të planifikimit familjar.


✚ *Emigrimi dhe migrimi i popullsisë, kryesisht pas vitit 1990* ka qenë masiv dhe i pakontrolluar, çka ka çuar në braktisjen totale të shumë vendbanimeve rurale, madje në disa fshatra të kësaj zone nuk ka më asnjë banor rezident. Aty kanë ngelur vetëm rrënojat e banesave të dikurshme, kryesisht në fshatrat e malësisë së Kolonjës.

✚ Një tjetër faktor është dhe *pamundësia* që ka popullsia për të *vazhduar arsimimin në shkollët e larta të tij*, faktor që çon në një fenomen shqetësues siç është braktisja masive nga ana e të rinjve e kësaj zone për të shkuar në qytete më të zhvilluara të vendit ose në shtete të tjera për të vazhduar arsimimin. Në gjithë bashkinë ka vetëm 3 shkolla të arsimit të mesëm.

✚ *Shëndetësia* është një tjetër faktor, pasi shërbimi shëndetësor ka probleme. Në të gjithë rrethin ka vetëm 2 spitale rajonale, si dhe disa urgjenca modeste në fshatrat më të populluara. Por, problemi kryesor nuk qëndron në numrin e tyre, por tek infrastruktura që ato kanë, me investime që nuk janë realizuar që prej më se 20 vjetësh. (*Bashkia Kolonjë 2021*).

✚ *Papunësia* kap nivele rekord në këtë bashki, ku 64 % e popullsisë aktive është e papunë (*Belba, 2013*). Nga një shikim i përgjithshëm i statistikave për qarkun e Korçës shohim se bashkia që ka të punësuarit me nivelin më të lartë të shkollimit është ajo e Kolonjës. Për sa i përket ndikimit të hapësirës në shpërndarjen e

popullsisë, siç edhe theksuam më lart, popullsia është e përqendruar kryesisht buzë rrugëve kryesore që lidhin këtë rreth me rrethet e tjera.



Grafiku. 2 Numri i familjeve në njësitë administrative Kolonjë. Burimi; Zyra e gjendjes civile, Ersekë

### Përfundime

Pozita gjeografike ka ndikim të drejtpërdrejtë, sidomos në kontekstin e shpërndarjes së popullsisë në hapësirë, ku ndikimi i relievit dhe klimës ka kushtëzuar vendosjen e vendbanimeve buzë rrugëve kryesore që e lidhin zonën me bashkitë e tjera. Pozita gjeografike ndikon gjithashtu në aspektin ekonomik dhe të shërbimeve, ku aktiviteti ekonomik i popullsisë kushtëzohet nga zgjerimi i hapësirës dhe rritja e distancës nga qendra e bashkisë me qytetin e Ersekës. Elementet gjeografike, si tokat dhe klima, kanë ndikim dhe janë në korrelacion të drejtë me zhvillimin.

Sipas zyrës të gjendjes civile, popullsia e kësaj bashkie është rreth 19 919 banorë, ndonëse sipas Censurit 2011 rezultojnë 11 500 banorë. Aktualisht janë 18 683 banorë. Diferenca shifrore flet qartë për migrimin e popullsisë brenda dhe jashtë vendit, ndërkohë që zyrtarisht figurojnë ende rezidentë në bashki. Karakteristikë për zonën është zvogëlimi gjithnjë e më i madh i popullsisë për periudhën pas '90. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar

drejtpërsëdrejti në këtë fenomen janë: largësia e madhe gjeografike nga qendrat e zhvilluara ekonomisht, lindjet e pakta, emigrimi dhe migrimi i brendshëm masiv dhe i pakontrolluar, kushtet klimatike dhe faktorë të tjerë socialë-ekonomikë. Kolonja është një ndër bashkitë me nivelin më të ulët të punësimit, vetëm 64 %. Pjesa më e madhe e popullsisë rurale dhe urbane varet nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, të ardhurat nga emigracioni.

Me faktorin ekonomik lidhet pamundësia që kanë banorët e zonave malore për të nxjerrë prodhimet e tyre, më së shumti blegtorale, në treg dhe gjithashtu në zonat malore rrjeti rrugor është shumë i prapambetur dhe pothuajse i shkatërruar. Shërbimet më të nevojshme janë më të arritshme më pranë akseve rrugore, pasi kuptohet që me rritjen e distancës nga qendra e kësaj bashkie (qyteti i Ersekës) bëhet më e vështirë për institucionet ofrimi i shërbimeve dhe ulet aksesibiliteti dhe kontrolli mbi këtë pjesë të popullsisë.

### **Rekomandime**

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në përfundimet e nxjerra, rekomandohet:

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere mbi popullsinë nga OJQ-të ose qeveria dhe institucionet përkatëse me qëllim frenimin e fenomenit të migrimit masiv.

- Marrja e masave konkrete nga ana e shtetit për problemin e migrimit masiv, duke qenë se, nëse vazhdohet me këto ritme, brenda 20 apo 30 viteve të ardhshme numri i popullsisë do të jetë në ulje të vazhdueshme.

- Investimi në infrastrukturën rrugore, si ura e vetme lidhëse me zonat e tjera. Me infrastrukturën e tanishme, komunikimi vështirësohet ndjeshëm gjatë dimrit. Në gjithë zonën kalon vetëm një aks rrugor kombëtar.



## Literatura

- Akademia e Shkencave, (1965), "Historia e popullit Shqiptar" vol. 2. f. 129
- Akademia e Shkencave, (2006), "Historia e popullit Shqiptar" vol. 3
- Aliu, S. (1975) Kërkimet e studimet arkeologjike në Shqipërinë Juglindore dhe vlerat e tyre në fushën e prehistorisë, f. 3.
- Aliu, S. (2007), Vendbanimet e fortifikuara në pllajën e Kolonjës.
- Belba, A., (2013), Gjeografia e sektorit terciar në rajonin e Korçës; Tiranë f. 59
- Durham, M.E., (1905) "Leskoviku është një qendër fare e vogël, e ndërtuar prej guri dhe vendosur mirë, e ngjashme shumë me një fshat të Uellsit të Veriut, por e pastër dhe e rregullt". The Burden of Balkans. London.
- Zyra e Gjendjes civile Erseke. 2021
- Zyra e gjendjes civile Qarku Korçë. 2021
- INSTAT. (2014), Censusi i popullsisë dhe banesave.
- Mita, R., Historia e sotme e Shqipërisë. Cikël leksionesh. f. 186
- Nikolli, P. Draci, B., Kosovrasti, A. (2013). Një krahasim i metodave të parashikimit të numrit të popullsisë. Kërkime Gjeografike nr. 15, f. 89-104. Prishtinë.
- Qirjazi, P., (2006), Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Ideart.

**Dr. Blerta Avdia<sup>1</sup>**

**Dr. Klementina Ngjeci<sup>2</sup>**

## **EMIGRACIONI DHE E ARDHMJA E QENDRAVE TË BANUARA NË BASHKINË E HASIT DHE TË KUKËSIT**

### *Abstrakt*

Emigracioni është një ndër problemet globale që shoqërohet nga një sërë pasojash si për vendet e origjinës dhe për vendet pritëse.

Në Shqipëri, emigracioni është kthyer në një problem të mprehtë pasi rajone të caktuara po përjetojnë një largim masiv të popullsisë, një ndër të cilët është dhe rajoni verior-verilindor. Bashkia e Hasit dhe e Kukësit që janë fokusi i studimit tonë janë prekur nga kjo dukuri.

Objekti i studimit është ndikimi i emigracionit në të ardhmen e qendrave të banuara në bashkinë e Hasit dhe të Kukësit.

Për realizimin e qëllimit të studimit janë shfrytëzuar të dhënat nga: Instituti i Statistikave, konsultimi me literaturën online dhe publikime të tjera shkencore rreth temës etj.

Metodologjia e përdorura për të arritur qëllimin e studimit është: analizuese, krahasuese, statistikore, grafike dhe hartografike. Kjo metodologji do të jetë efikase për të identifikuar, trajtuar dhe sugjeruar zgjidhjen e problemeve.

Në fund të punimit, do të kemi disa gjetje:

- Pse këto bashki po përjetojnë një shpopullim kaq të madh?
- Pse të rinjtë e zonave në studim nuk janë të sigurt për jetesë dhe prirën të largohen?

---

<sup>1</sup> Kolegji Universitar Logos, Departamenti i Menaxhimit -mail: [blerta.avdia@kulogos.edu.al](mailto:blerta.avdia@kulogos.edu.al)

<sup>2</sup> Gjinnazi "Skënderbeu", Has. E-mail: [kngjeci@yahoo.com](mailto:kngjeci@yahoo.com)

- Cilat do të jenë masat që duhet të marrin aktorët përgjegjës për zhvillimin e zonës?

Punimi do të mbyllet me konkluzione dhe rekomandime.

**Fjalë çelës:** *Bashkia e Hasit dhe e Kukësit, emigracion, faktorët natyrorë, shpopullim, struktura demografike.*

### **Abstract**

Immigration is one of the global problems that is accompanied by a number of consequences for both countries of origin and host countries.

In Albania, emigration has become a sharp problem as certain regions are experiencing a massive exodus of the population one of which is the North-Northeast region. The municipalities of Has and Kukes that are the focus of our study are affected by this phenomenon.

The object of the study is the impact of emigration on the future of inhabited centers in the municipalities of Has and Kukes.

To achieve the purpose of the study, data from: Institute of Statistics, consultation with online literature and other scientific publications on the topic, etc. were used.

The methodology used to achieve the purpose of the study are: analytical, comparative, statistical, graphic and cartographic. This methodology will be effective in identifying, addressing and suggesting problem solving.

At the end of the paper, we will have some findings:

- Why are these municipalities experiencing such a large depopulation?
- Why are young people in the study areas not safe to live in and tend to leave?
- What measures will be taken by the actors responsible for the development of the area?

The paper will close with conclusions and recommendations.

**Keywords:** *Has and Kukes municipalities, emigration, natural factors, depopulation, demographic structure.*

## **I. Hyrje**

### **Pozita gjeografike e bashkisë së Hasit dhe Kukësit dhe ndikimi i saj në emigracionin**

Bashkia e Hasit dhe e Kukësit bëjnë pjesë në rajonin verior-verilindor, në kontaktin e përplasjes së zonave tektonike të Mirditës dhe Korabit. Mbizotëron relievi kodrinor-malor, përfshirë nga lëvizjet diferencuese. Bëjnë pjesë në klimën

mesdhetare paramalore dhe mesdhetare malore në lartësitë e maleve; është pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Drini i Bardhë, Drini i Zi. Shtrihen në brezin e tokave të kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore; në katin e dushqeve, ahut e halorëve dhe kullotave alpine. Pozicioni gjeografik ka përcaktuar tiparet e kushteve natyrore (ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, toka, flora, fauna) që krijojnë mundësi për zhvillimin socio-ekonomik të vendbanimeve si: industri nxjerrëse, industrinë tekstile, blegtorisë dhe më pak bujqësinë, turizmin. Krahas avantazheve pozita gjeografike ka përcaktuar dhe dizavantazhet pasi infrastruktura e dobët bën që gjatë dimrit të izohet nga bora, duke ndërprerë komunikimin dhe marrjen e shërbimeve nga qendrat e rëndësishme të vendit (Tiranë, Durrës) apo të rajonit (Gjakovë, Pejë, Prizren, Dragash).

Bashkia e Hasit dhe Kukësit bën pjesë në rajonin gjeografik Verior dhe Verilindor. Bashkitë e marra në studim shtrihen në trevat me zhvillime të vrullshme politike dhe historike, që kanë kushtëzuar tipare të veçanta të zhvillimeve sociale dhe ekonomike, të shprehura në gjithë rajonin, por edhe në diferencat e dukshme midis tyre. Bashkia e Kukësit krahasuar me bashkinë e Hasit luan rolin e qendrës gravitacionale për nga përqendrimi i funksioneve politike, ekonomike dhe sociale. Të dyja bashkitë gëzojnë statusin e të qenit zona kufitare, duke u dhënë atyre rolin e njëjës midis trevave perëndimore dhe lindore shqiptare dhe me treva të tjera në brendësi të Ballkanit. Ndaj, qysh në antikitet, në afërsi të saj kanë kaluar rrugë të rëndësishme (Lissus-Naisus, rruga e Drinit), nëpër të cilat kanë kaluar flukse njerëzish, mallrash, kulturash, informacione etj., të cilat ndikuan edhe në shkallën e zhvillimit social, ekonomik dhe të emancipimit të popullsisë (*Shtylla*, 1997). Bashkia e Kukësit dhe e Hasit, deri në fillim të shekullit të kaluar, ka qenë një hapësirë rurale që gravitonte drejt qendrave urbane tradicionale, si: Prizreni (qendra

më e madh e më e rëndësishme), Gjakova, Peja, Dragashi dhe Opoja, me të cilat janë realizuar shkëmbime tregtare, kapitale, informacione etj., duke siguruar kështu zhvillimin normal të qendrave urbane, por edhe hapësirës rurale të tyre (Avdia, 2015, Ngjeci, 2017). Roli nyjë i pozitës gjeografike midis trevave lindore dhe perëndimore, u ndërpre nga vendosja e padrejtë e kufirit politik të Shqipërisë në vitin 1913. Ky kufi ndau hapësirën rurale të bashkive Has dhe Kukës nga qendrat urbane historike, duke penguar kështu zhvillimin social, ekonomik dhe emancipimin e mëtejshëm të tyre. Roli pengues i këtij zhvillimi të fillimit të shekullit të kaluar u bë shumë i theksuar në gjysmën e dytë të këtij shekulli, kur Shqipëria ishte e izoluar: u ndërpre komunikimi ekonomik, social dhe politik në dy anët e kufirit. Në këto kushte, pozita gjeografike e dy bashkive ndryshoi duke marrë rol periferik deri pas luftës së Kosovës më 1999. Ky karakter u theksua më tej nga faktorët natyrorë, si: relievi malor tepër i thyer dhe klima me dimër të ashpër e dëborë të shumtë që bllokoi rrugët dhe qafat që e lidhin me rajonet e tjera. Natyrisht në këtë izolim rol të madh luan edhe niveli i ulët i infrastrukturës, rrugëve që lidhin rajonin me qendrat e banuara si Kukësin dhe Hasin. Ndryshimet politike pas vitit 1990 krijuan mundësinë e lidhjeve dhe bashkëpunimit midis bashkive në të dyja anët e kufirit, krijuan mundësinë e rikthimit të rolit të nyjës së pozitës gjeografike të tyre. Natyrisht këtë do ta bënte të mundur ngritja e infrastrukturës sipas kërkesave të kohës, realizimi i studimeve mbi vlerësimin e potencialeve zhvilluese natyrore dhe njerëzore të të gjithë hapësirës gjeografike të bashkive të marra në studim në dyja anët e kufirit, mbi bazën e të cilave të përgatiten strategji dhe projekte integruese të përbashkëta zhvillimi ndërkufitar dhe futja e aplikimit të konceptit të eurorajonit të Prizrenit dhe Gjakovës.

## II. Metoda

Metodologjia e punës së përdorur do të jetë në funksion të qëllimit të temës së marrë në studim: Përshkruese, ku do të trajtohen faktorët natyrorë, socialë –ekonomikë, historikë, kulturorë që kanë ndikuar në largimet e popullsisë dhe pasojat negative; analitike dhe statistikore, përmes së cilës do të evidentohen ndryshimet në strukturën demografike, pasojat në popullsi, ekonomi dhe vendbanimet rurale etj., në bashkinë e Hasit dhe Kukësit; metoda krahasuese do të identifikojë bashkinë e cila e ka më të theksuar fenomenin e emigracionit; ndërsa nëpërmjet metodës hartografike do të pasqyrohet fenomeni i emigracionit në bashkinë e Hasit, Kukësit dhe Shqipërisë etj.

## III. Diskutime

### 1. Emigracioni dhe e ardhmja e qendrave të banuara në bashkinë e Hasit dhe të Kukësit

Ndryshimi i rolit të pozitës gjeografike, tiparet natyrore të bashkive të marra në studim, faktorët historikë, politikë, socialë ndikuan në trendet e popullsisë, shpërndarjen e tyre dhe llojet e qendrave të banimit etj.

Shpërndarja e popullsisë është një tregues i zhvillimit të qendrave të banuara në zonën ku ato janë përqendruar. Arsytet e vendosjes së një popullsie në një qendër të banuar janë të lidhura me: kushtet e përshtatshme për zhvillimin e jetesës, me veprimtarinë ekonomike që ato zhvillojnë, me mundësitë e edukimit/arsimit dhe shërbimet e ndryshme që marrin (Avdia, 2015).

Emigracioni është një fenomen që ka shoqëruar popullin shqiptar përgjatë fazave të ndryshme historike, në këtë këndvështrim dhe popullsia e bashkive Kukës dhe Has nuk bënte përjashtim.


Në vitet 1945-1990 nuk mund të flasim për emigracion apo shpopullimin e qendrave të banuara, pasi në këtë periudhë lëvizja e popullsisë ishte e rregulluar nga shteti për arsye pune, edukimi, motive ekonomike apo politike. Në bashkitë e Kukësit dhe Hasit ekonomia kishte karakter industrial (kryesisht nxjerrëse) dhe bujqësor, kjo ndikoi që zonat ku shfrytëzoheshin këto potenciale të kishin një rritje të popullsisë aktive të punësuar në miniera dhe ndërmarrje bujqësore, duke ndikuar në rritjen e numrit të popullsisë nëpërmjet krijimit të familjeve. Profili ekonomik dhe rritja e numrit të popullsisë në fshatin Gjegjan (Kukës), qytetin e Krumës, fshatin Golaj (Has), bëri që aty të ndërtoheshin ndërtesa kolektive, të hapen institucione shëndetësore, arsimore dhe u ofruan shërbime të tjera për të plotësuar nevojat e popullsisë.

Kjo periudhë duket sikur e zbuti izolimin nga mbyllja e kufirit, karakterin kufitar të zonës, egërsinë e tipareve natyrore duke zhvilluar jetën normale të popullsisë.

Pas viteve 1990 dhe në vitet e ardhshme duket sikur këto qendra të banuara dhe popullsia që i populloi ishte fantazmë. Pasi ndryshimet politike nga diktatura në pluralizëm, nga ekonomi e planifikuar në ekonomi të tregut të lirë, nga lëvizje e popullsisë e kontrolluar në atë të lirë, bëri që shumë qendra të banimit të përballen me problemet e shpopullimit.

Ky kalim tranzitor e gjeti popullsinë të papërgatitur, duke e drejtuar vendin në kolaps ekonomik si pasojë e teknologjisë së prapambetur (nuk mund të prodhoheshin mallra të konkurrueshme me tregjet rajonale) dhe mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar, duke sjellë mbylljen e ndërmarrjeve industriale dhe bujqësore (*Avdia, 2015, Ngjeci, 2017*). Në kushtet e papunësisë së lartë dhe dëshirës për një jetë më të mirë, popullsia u largua nga Kukësi dhe Hasi. Gjatë kësaj periudhe është regjistruar një largim masiv i popullsisë në vitet 1993-2011. Nga të dhënat statistikore të INSTAT-it (2014), rezulton se vetëm në

periudhën e sipërpërmendur janë larguar mbi 5 000 banorë. Zonat kryesore në të cilat u vendos popullsia e larguar janë Tirana, Durrësi e qytete të tjera të Ulëtësirës Perëndimore të vendit tonë (fig.1, Harta e normave të lëvizjes sipas çarkut dhe shpërndarjes së popullsisë sipas destinacionit, 2014).





Harta 5. Lëvizjet e brendshme sipas qarkut të destinacionit




Figura 1. Harta e normave të lëvizjes sipas qarkut dhe shpërndarjes së popullsisë sipas destinacionit. Burimi: INSTAT, 2014.

Qarku i Kukësit për periudhën 2001-2011 ka pasur humbje nga migrimi i brendshëm 21% të popullsisë së tij (*Instat, 2014*). Po në këtë periudhë, krahas emigrimit të brendshëm të popullsisë ka mbizotëruar dhe emigracioni i jashtëm (*Instat, 2014*).

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së aftë për punë emigroi jashtë vendit në drejtim të Britanisë së Madhe, Francës, Greqisë, Italisë etj., jo vetëm për shkak të kushteve të vështira të jetesës, por dhe për shkak të minimumit të fshatrave kufitare nga serbët gjatë luftës së Kosovës (*Avdia, 2015*). Si rrjedhojë e kësaj

lëvizjeje të popullsisë ndodhi braktisja e shumë fshatrave si p.sh. rasti i Gjinajve, Zylfaj, i Pogajve, i Kishajve, i Cahanit, i Fajzave, Shishtavec, Zapod, Arrën etj. (*Avdia, 2014, 2015, Ngjeci, 2017*).

Po të analizojmë emigracionin e popullsisë në dy periudha, vitet 1989- 2001 dhe 2001- 2011 duket largimi më i madh i popullsisë nga bashkia e Hasit dhe Kukësit.

Lëvizja e popullsisë nga bashkitë e Kukësit dhe Hasit ka ndodhur për arsye (*Instat, 2014*):

- të kërimit të kushteve më të mira të jetesës;
- pjesa më e madhe e të rinjve që përfundojnë studimet nuk kthehen në vendlindje;
- të bashkimeve familjare me të larguarit në shtetet europiane;
- të pasigurisë, mungesës së vendeve të punës dhe investimeve në bashkinë e Kukësit dhe Hasit.

Largimi i popullsisë nga bashkitë e Kukësit dhe Hasit është shoqëruar më një sërë pasojash negative:

- shpërndarja e pabarabartë e popullsisë; përqendrimi i lartë i saj në vendbanimet si Krumë, Golaj. Aty ku dhe mundësitë e jetesës janë më të favorshme;
- krijohen zona të braktisura ose në prag braktisjeje;
- varësinë e familjeve të bashkisë së Kukësit dhe Hasit nga remitancat.

Nga një analizë më e detajuar e të dhënave statistikore identifikohet që largimet më të mëdha të popullsisë në nivel rrethi , i ka pasur rrethi i Kukësit (referuar tabelës nr.1.).

Tabela nr.1 Numri i popullsisë së rrethit Has dhe Kukës në vite dhe humbja e popullsisë

Bashkia	1989	2001	2011	Humbja e popullsisë
Kukës	79421	63786	47985	-15 801
Has	21881	19660	16790	-2870

Burimi: INSTAT, 2001, 2011, 2014

Ky fenomen shpjegohet me faktin se bashkia e Kukësit, ka luajtur dhe rolin e qendrës rajonale. Kjo do të thotë që aty ishin të përqendruara institucionet publike (rajonale), private, investimet më të mëdha. Të gjitha këto do të sillnin dhe një numër të lartë të popullsisë që do të banonte dhe punonte aty. Duke pasur parasysh që gjatë viteve 1945-1990 lëvizja e popullsisë realizohej në përgjigje të nevojave të shtetit, bëri që aty të vendosej dhe popullsi nga rajonet e tjera të Shqipërisë. Me ndryshimet politike, të parët që u larguan në kërkim të një jete më të mirë ishin popullsia e ardhur, më pas popullsia vendëse; kjo, në dy drejtime, nga Kukësi në drejtim të qyteteve të mëdha; nga zonat rurale të bashkive Kukës dhe Has në qytetin e Kukësit.

Efektet e kësaj lëvizjeje evidentohen në:

- rënien më të lartë të popullsisë në bashkinë e Kukësit se në bashkinë e Hasit- kushtëzuar nga roli si qendër rajonale e saj;
- fshatra që u braktisën nga popullsia si: Arrni, Kalis, Zapod, Malziu etj.;
- fshatra të cilat janë vetëm sezonale siç është Shishtavec etj.

Pasojat të cilat vijnë nga emigracioni i popullsisë janë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Këto pasoja reflektohen jo vetëm në nivel bashkie, por dhe qarku. Qarku i Kukësit është qarku me nivelin më të lartë të varfërisë, në vitin 2017 PBB-ja për frymë është afërsisht 39.5% më e ulët se PBB-ja në shkallë vendi (Zeneli, 2020); Shkalla e papunësisë është gjithashtu e lartë - rreth 50% e fuqisë punëtore të qarkut (Censusi i popullsisë, 2011). Niveli

më i lartë i papunësisë u regjistrua në mesin e të rinjve (65.9%), pasuar nga papunësia te femrat në masën 51.5%, ndërsa te burrat arrin 50.1%. Një pjesë e mirë e popullsisë është e punësuar në sektorin e shërbimeve (57.3%), ndërsa rreth 33% në sektorin bujqësor dhe vetëm 9.5% në industri (*Shoqata e Zhvillimit të Bujqësisë të Rretheve Malore, 2018*). Popullsia mbahet nga remitancat, çfarë tregon që shkalla e emigracionit në këtë qark është e lartë. Kjo sjell pakënaqësi në aspektin social si: varfëri e theksuar dhe përjashtim social; mungesë e jetës kulturore, investimeve që sjellin pakënaqësi dhe zhgënjim (aeroporti).

Në aspektin mjedisor, largimi i popullsisë sjell: krijimin e zonave informale në periferi të qytetit të Kukësit (*Avdia, 2014, Këshilli Kombëtar i Territorit, 2017*), shpopullim të fshatrave (*INSTAT, 2011*), degradim të tokave dhe banesave; mbylljen e institucioneve arsimore ose krijimin e klasave të bashkuara, mbylljen e qendrave ambulatorie etj.

Megjithatë, pavarësisht rolit qendër rajonale apo jo, të dyja bashkitë hasin problematika dhe pasoja të ngjashme. Bilanci i rritjes së popullsisë është negativ. Nëse shteti përmes politikave të tij nuk merr masa për zgjidhje, shumë shpejt dy bashkitë do të shpopullohen plotësisht. Të rinjtë e këtyre bashkive nuk do të kenë arsye të kthehen pas studimeve, sepse Planet e Zhvillimit Vendor janë akoma të pazbatueshme.

### **Përfundime**

- Emigrimi është një dukuri e zakonshme në bashkinë e Kukësit dhe të Hasit.
  - Braktisje e fshatrave dhe banesave.
  - Numri i ulët i popullsisë në vitet 2001-2011 solli uljen e shërbimeve publike, investimeve etj.
  - Lëvizja e lirë e popullsisë nga fshati në drejtim të zonave urbane krijoi zonat informale.

## Rekomandime

- Zbatimi i Planeve Zhvilluese Vendore dhe Territoriale të bashkive të Kukësit dhe Hasit
  - Rritja e investimeve ekonomike sociale të mirëmenduara, që popullsia lokale të këtë përfitime konkrete- referuar aeroportit dhe autostradës, të cilat më shumë e kanë dëmtuar zhvillimin social-ekonomik.
  - Orientimi i arsimit mbi bazën e prioriteteve strategjike që kanë dy bashkitë – referuar hapjes së shkollave profesionale, me profil në shërbime dhe turizëm për ekonomi të qëndrueshme.
  - Rritja e bashkëpunimeve ndërkufitare me komonat e Gjakovës dhe Prizrenit, rritje e shkëmbimeve të produkteve bujqësore dhe artizanale, krijimi i mundësive për punësim ditor etj.

## Literatura

Avdia, B., ( 2015), Vlerësimi dhe Menaxhimi i Resurseve Natyrore dhe Njerëzore të Krahinave Lumë-Gorë (Kosovë) për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, Disertacion, Departamenti i Gjeografisë, FHF, UT.

Avdia. B (2014) Migracioni, rruga e vetme e sfidimit të varfërisë dhe përjashtimit social –Rasti Luma Revista shkencore ndërkombëtare “Diskutime”, nr. 9. Mars 2014 për botimin e shtypur ISSN 1857- 825X

Bashkia Has (2016), Plani Operacional i Zhvillimit Vendor, f. 10, 11

Bashkia Kukës (2017) [Strategjia e Zhvillimit te Territorit](#), f. 23

INSTAT (2011), Censusi i Popullsisë dhe Banesave/ Kukës

INSTAT (2014), MIGRACIONI NË SHQIPËRI, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave, Tiranë, f.20, 21

Këshilli i Qarkut Kukës (2012), Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016, Kukës, f. 8, 9

Meçaj, N., Dida, M., Qarku i Kukësit, burimet natyrore , popullsia dhe zhvillimi i qëndrueshëm” Toena, Tiranë, 2004, f. 108.

Ngjeci, K., (2017), Vlerësimi dhe Menaxhimi i Resurseve Natyrore dhe Njerëzore të Hasit për zhvillimin e qëndrueshëm të tij, Disertacion, Departamenti i Gjeografisë, FHF, UT

Zeneli, M., (2020) Ndhimja ekonomike në 10 vjeçarim 2010- 2020 dhe efikasiteti i saj në luftën kundër varfërisë në qarkun e Kukësit, Revista Demografia / Botim i Shoqatës Shqiptare të Demografëve, Tiranë [http://revistademografia.al/mimoza\\_zeneli\\_artikulli\\_demografisenr12020.html](http://revistademografia.al/mimoza_zeneli_artikulli_demografisenr12020.html), shikuar datë 11.02.2022

**Dr. Edlira Menkshi<sup>1</sup>**

**Dr. Ermiona Braholli<sup>2</sup>**

## **ANALIZA E MORFOLOGJISË URBANE TË QYTETIT TË KORÇËS**

### **Abstrakt**

Morfologjia urbane mund të konsiderohet një qasje e rëndësishme në studimin gjeografik të formës urbane. Ky studim analizon ndryshimin e elementeve fizike, proceset e transformimit dhe faktorët që kanë ndikuar në zgjerimin urban të qytetit të Korçës. Nëpërmjet analizës së proceseve të zhvillimit historik, janë evidentuar tiparet e formës urbane në disa periudha të rëndësishme të evoluimit të qytetit, prej krijimit të tij deri në ditët e sotme. Fizionomia e veçantë urbane e qytetit dëshmon ruajtjen e bërthamës historike dhe vlerave ndërtimore të saj. Ndryshimet e reflektuara vitet e fundit kanë pasur si qëllim krijimin e një mjedisi urban në favor të mirëqenies dhe cilësisë së jetës së komunitetit. Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është përshkruese cilësore, por edhe analizuese bazuar në perspektivën e kërkimit historiko-gjeografik, analizën e transformimit të qytetit, analizën e hartave të periudhave të ndryshme të zhvillimit etj. Karakteri i studimit është ndërdisiplinar, duke ndërthurur njohuritë gjeografike me njohuri nga disiplinat e tjera si: historia, arkitektura dhe planifikimi urban, në këndvështrimin e studimeve urbane. Në përfundim, nëpërmjet analizës së të dhënave të siguruara, janë paraqitur disa përfundime dhe sugjerime në lidhje me ndryshimet aktuale dhe zhvillimin urban të qytetit në të ardhmen.

*Fjalë çelës: morfologji urbane, qyteti i Korçës, infrastrukturë, qendër historike, zhvillim*

---

<sup>1</sup>Departamenti i Histori-Gjeografisë, Universiteti "Fan S.Noli", Korçë E-mail: eda\_ndreko@yahoo.com

<sup>2</sup>Departamenti i Histori -Gjeografisë, Universiteti "Fan S.Noli", Korçë E-mail: ermiona.braholli@yahoo.com

## Abstract

Urban morphology can be considered an important approach in the geographical study of urban form. This study analyzes the development of physical elements and transformation processes that have influenced the urban expansion of the city of Korça. Through the analysis of historical development processes, the features of the urban form have been identified in some important periods of the city's development, from its creation to the present day. The special urban physiognomy of the city identified the preservation of its historical core and its buildings construction values. The changes reflected in recent years have aimed at creating an urban environment in favor of the well-being and quality of life of the community. The methodology used for the realization of the work is qualitative descriptive, but also analytical based on the perspective of historical-geographical research, analysis of the transformation of the city, analysis of maps of different periods of development, etc. The character of the study is interdisciplinary by combining geographical knowledge with knowledge from other disciplines such as history, architecture and urban planning within the perspective of urban studies. In conclusion, through the analysis of the data provided, some conclusions and suggestions are presented regarding the current changes and urban development of the city in the future.

*Key words:* urban morphology, Korça city, infrastructure, historic center, development.

## I. Hyrje

Studimi i morfologjisë urbane ka zgjeruar qasjen e vet të studimit dhe është zhvilluar në shumë drejtime dekadat e fundit (*Matos de Loureiro, 2018*). Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm ka luajtur drejtimi gjeografik i studimit të morfologjisë urbane (*Whitehand, 2007*), në veçanti gjeografisë urbane. Sipas *Whitehand (2001)*, termi “morfologji urbane” është përkufizuar nga studiuesit dhe pranuar gjerësisht si “studim i formës urbane”. Forma urbane është një nga elementet më të rëndësishme për të vlerësuar procesin e evoluimit të qytetit nga e kaluara deri tek e tashmja. Studimi i formës urbane merr në konsideratë studimin e komponenteve fizike dhe hapësinore të strukturës urbane, si:



parcelat, blloqet, rrugët, ndërtesat dhe hapësirat e “hapura”, të cilat janë pjesë e procesit historik të zhvillimit të një qyteti (*Bently, Butina, 1990*). Studiuesi Peter J. Larkham (2006), pohon se morfologjët urbanë nuk e kanë përqendruar vëmendjen e tyre vetëm në kuptimin e ngushtë të formës urbane, por kanë vlerësuar edhe aktorët dhe proceset që kanë ndikuar në transformimin e saj. Në lidhje me origjinën e morfologjisë urbane, shumë prej studiuesve e datojnë atë në fund të shek.XIX, te gjeografët humanë gjermanë si Friedrich Ratzel, Otto Schluter, Hugo Hassinger etj., analiza e të cilëve mbi formën urbane bazohej kryesisht në planin e qytetit (*Hofmeister 2003; Whitehand, 2011; Oliveira, 2013*). Gjeografi Otto Schuler me studimin e tij mbi fizionominë e peizazhit urban (1898) hodhi bazat e studimit të morfologjisë urbane (*Whitehand, 2007; Hofmeister, 2003*). Në vitet '30 të shek.XX morfologjia urbane do të zinte një vend të rëndësishëm në gjeografinë gjermane. Kërkimet shkencore në morfologjinë urbane avancuan më tej duke u zgjeruar përtej origjinës së saj. Në fund e shek.XX, në takimet shkencore ndërkombëtare (*International Seminar of Urban Form, ISUF, 1996*), morfologjia urbane u shfaq si një fushë ndërdisiplinare, që përfshinte krahas gjeografisë edhe arkitekturën, historinë urbane, disenjimin urban, planifikimin urban etj. (*Moudon, 1997; Whitehand, 2011*).

Referuar qasjes ndërdisiplinore Moudon-i (1997), i kategorizon kërkimet shkencore në morfologjinë urbane në bazë të aktivitetit të tri shkollave europiane, britanike, italiane dhe franceze, pa anashkaluar edhe kontributin e një sërë studiuesve kërkimorë nga vende të tjera. Në shkollën britanike përmendet kontributi i rëndësishëm i gjeografit Michael Robert Gunther Conzen (1907-2000), i cili në studimin e peizazhit të qytetit (1960) e vuri theksin tek analiza historike e planit të qytetit (rrugët, parcelat dhe blloqet e ndërtimit) (*Pinho, Oliveira, 2007*). Shkolla Conzeniane do të zinte

një rol thelbësor në kërkimet shkencore të autorëve në shumë vende të botës (*Oliveira, 2013*). Në shkollën italiane spikati arkitektit Saverio Muratori (1910-73), me studimet e tij në qytetet e Romës dhe Venecias, ku ai analizoi tipologjinë e ndërtimeve dhe vendndodhjen e tyre në këto qytete (*Cataldi, Maffei, Vaccaro, 2002*). Studiuesit Castex dhe Philippe Panerai të shkollës franceze (në fund të viteve '60), krahas studimit tradicional të formës urbane, u përqendruan tek analiza e modifikimeve të modernizimit. Në kuadrin e këtyre kërkimeve, shumë autorë pohojnë gjithashtu se studimi i formës urbane nuk duhet të mënjanohet nga trajtimi i aspekteve të tjera urbane, si vendndodhja, faktorët e rritjes urbane dhe funksionet urbane (*Hofmeister, 2003*).

Në Shqipëri, kontributi i kërkuesve shkencorë në studimet urbane nuk ka munguar. Deri në vitet '90 të shek. XX pjesa dominuese e popullsisë (65 %) jetonte në zonat rurale. Studimet urbane ishin të fokusuar te "qyteti i realizmit socialist", kryesisht në fizionominë, urbanistikën dhe arkitekturën e tij. Pas viteve '90, për shkak të ndryshimeve të menjëhershme urbane, qyteti, organizimi, forma dhe elementet e tij, kanë qenë objekt studimi i disa disiplinave, si urbanistika, gjeografia, arkitektura etj. Nga rishikimi i literaturës konstatohet se kërkimet e thelluara shkencore që lidhen me morfologjinë apo formën urbane janë të ndërmarra nga studiues në fushën e urbanistikës apo arkitekturës. Përmendim botimet shkencore të studiuesve shkencorë Pirro Thomo (Thomo, 2012), Emin Riza (Riza, 1991). Koço Miho (Miho, 2003) Petraq Pepo, (1981) etj. Kontributi i gjeografëve urbanë konsiderohet i rëndësishëm, i shprehur në disa drejtime studimi mbi zhvillimet urbane në qytetet shqiptare. Mund të veçohet studiuesja gjeografe Merita Karaguni, e cila në studimet e saj, midis të tjerave, trajton ndryshimet hapësinore të qyteteve, transformimet në kuadër të lëvizjeve të popullsisë dhe perspektivat e zhvillimit të qyteteve në të ardhmen (Karaguni,

2008; 2010; 2011; 2013; 2016). Mund të përmenden gjithashtu kontribute studimore në aktivitete shkencore që prekin aspekte të morfologjisë urbane, duke u përpjekur ta shohin atë në një këndvështrim gjeografik apo si pjesë e një konteksti gjeografik studimi, si botimet në kuadër të konferencës shkencore “Metamorfoza e qyteteve dhe zonave industriale në hapësirën shqiptare prej vitit 1945” (*Studime Albanologjike IV, Gjeografi, viti XIII, 2008/4*), konferencës shkencore “Gjeografia dhe Territori” (*Studime Albanologjike IV, Gjeografia viti XVIII, 2013/4*), si edhe së fundmi konferencës shkencore “Qendrat e banuara të Shqipërisë-gjendja dhe e ardhmja”, të Akademisë së Shkencave.

Në kuadrin e këtyre kontributeve shkencore gjeografike, ky studim analizon tiparet e morfologjisë urbane të qytetit të Korçës, duke nxjerrë në pah elementet fizike që strukturojnë qytetin dhe proceset që kanë ndikuar në formimin e tij.

## II. Hapësira e studimit

Qyteti i Korçës përbën qendrën urbane të bashkisë dhe qarkut të Korçës. Në nivel kombëtar ai është pjesë e një rrjeti të gjerë të qyteteve shqiptare, ndërkohë që në kontekstin rajonal, për sa i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore, qyteti përbën qendrën kryesore urbane të Rajonit Juglindor të Shqipërisë. Favorizuar nga pozicioni gjeografik, roli i qytetit konsiderohet gjithashtu i rëndësishëm edhe në këndvështrimin historik ndërrajonal, ku dominojnë lidhjet e hershme me qendrat urbane në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Ohrin, Manastirin, Shkupin) dhe në Greqi (Kosturin, Follorinën dhe Selanikun). Pas viteve '90 këto lidhje ndërrajonale janë rritur dukshëm dhe përbëjnë akse të rëndësishme potenciale për zhvillimin e qytetit (*Menkshi, Shehu, 2020*).

Territori i qytetit të Korçës ndodhet në gjerësinë gjeografike V  $40^{\circ} 36' 22''$  - J.  $40^{\circ} 37' 23''$  (2.5 km) dhe gjatësi gjeografike L  $20^{\circ} 46' 15''$  - P.  $20^{\circ} 47' 45''$  (1.5 km). Qyteti shtrihet në lartësinë 870-900 m mbi nivelin e detit (përcaktuar sipas imazheve satelitore) në një sipërfaqe prej 17 km<sup>2</sup>. Në aspektin fiziko-gjeografik qyteti shtrihet në lindje të fushëgropës së Korçës dhe pjesërisht rrëzë kodrave të Partizanit (kodrat e Shën Thanasit dhe Shëndëllisë). Morfologjia e relievit me pjerrësi nga lindja në drejtim të perëndimit, ka kushtëzuar zgjerimin dhe shtrirjen e qytetit në pjesën më të madhe të tij, në drejtim të perëndimit kodrat përfaqësojnë mbetje terrigjene (mbizotërim të argjilave) të strukturës grabenore të Korçës (*Gruda, 2020; Qiriaz, 1985*). Qyteti dallohet për klimë mesdhetare paramalore, nënzona jugore me ndikime të klimës kontinentale, e shprehur kjo në temperatura dhe reshje. Temperaturat mesatare vjetore janë  $10.5^{\circ}\text{C}$ , muaji më i ftohtë është janari  $0.5^{\circ}\text{C}$  dhe muaji me temperatura më të larta është korriku me  $39^{\circ}\text{C}$  (*Qiriaz, 2019*). Sasia mesatare vjetore e reshjeve përllëgaritet 790 mm, të cilat janë konsideruar nën vlerën mesatare vjetore të territorit shqiptar. Reshjet e dëborës janë të pranishme në periudhën e ftohtë të vitit. Hidrografia përfaqësohet me lumin e Dunavecit dhe disa burime të vogla ujore. Pozicioni gjeografik dhe faktorët natyrorë kanë ndikuar në shtrirjen dhe zgjerimin e qytetit, në orientimin e sistemit rrugor apo orientimin e ndërtimeve nga lindja drejt perëndimit.

### III. Metoda

Studimi i morfologjisë urbane të qytetit të Korçës është realizuar nga rishikimi i literaturës shkencore, analizës së hartave të qytetit në periudha të ndryshme historike, vëzhgimeve të objekteve në terren, analizës së fotove dhe regjistrimeve të kohës. Karakteri divers i morfologjisë urbane të vendbanimeve shtron nevojën e studimit të saj nëpërmjet ndërthurjes së njohurive nga

shumë disiplina; gjeografia, historia, arkitektura, arkeologjia, planifikimi urban etj. (*Whitehand, 2012*). Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është përshkruese kualitative, bazuar në perspektivën e kërkimit historiko-gjeografik, në analizën e transformimit të qytetit të pasqyruar në harta. Nëpërmjet përdorimit të ArcGIS 10.1 janë krijuar harta digjitale për periudha të ndryshme të zgjerimit të qytetit. Gjithë materiali i siguruar dhe analiza e të dhënave u shoqëruan me ekspertizën në terren, për të parë nga afër gjurmët e ekzistencës historike, ndryshimet aktuale në strukturën urbane të qytetit që përfshijnë rrugët, blloqet e ndërtimit dhe ndërtime, aktivitetet e përdorimit të tokës dhe hapësirat e hapura. Metodologjia e analizës bazohet duke kombinuar evidentimin e disa elementeve: strukturave, materialeve të ndërtimit, blloqeve të ndërtimit dhe ndërtesave që formojnë qytetin dhe i japin karakterin dhe tipologjinë e veçantë.

#### **IV. Rezultatet**

Morfologjia urbane e qytetit të Korçës ka evoluar që nga koha e krijimit të qytetit dhe deri në ditët e sotme. Bazuar në të dhënat historike, fotografitë, regjistrimet e kohës, skicat dhe hartat, është analizuar forma e qytetit dhe tiparet e elementeve fizike që e kanë karakterizuar atë. Nëpërmjet programit Arc.GIS 10.1 është krijuar harta e zgjerimit të qytetit (shek.XVII-XXI), mbi të cilën janë pasqyruar ndryshimet e formës urbane të qytetit (Harta 1).

##### ***- Fillesat e qytetit të Korçës***

Gjetjet arkeologjike (vendbanime, vendvarrime, fortifikime) që janë zbuluar në zonat përreth qytetit të sotëm të Korçës, si: në Maliq, Vashtëmi, Dunavec, Barç, Kamenicë, Mborje etj. dëshmojnë për ekzistencën e jetës dhe vazhdimësinë e pandërprerë të saj që në prehistori (*Menkshi, 2020*). Referuar këtyre dëshmive, studiuesit mendojnë se qyteti mund të ketë ekzistuar si vendbanim qysh në antikitet, megjithatë origjina e

krijimit dhe ekzistencës së tij është ende e diskutuar midis studiuesve. Dokumentet kishtarë dhe burimet e shkruara e përmendin Korçën si vendbanim në gjysmën e parë të shek.XV (*Selenica, 1928*). Të dhëna për ekzistencën e qytetit përcjellin edhe shkrimet e Gjin Muzakës (1510), feudal shqiptar, i cili në një testament të lënë prej paraardhësit të tij Andrea Muzaka (1280-1319) Sebastokrator, përmend si zotërimet të Muzakajve, krahas Myzeqesë, Tomorricës, Oparit, Devollit, Kosturit edhe Korçën. (*Pepo, 1981; Thomo, 2012*). Në Kodikun e Korçës dhe Selaforit (shek.XVIII-fillim shek.XX), shkruhet se në regjistrat osmanë të viteve 1431-1432, bëhet fjalë për një kala të banuar që numëronte 26 shtëpi, pranë së cilës ndodheshin Mborja me 90 shtëpi dhe Peskëpia me 70 shtëpi. (*Pepo, 1981*).

Në qoftë se do t'i referohemi studiuesit Nuçi Naçi, në librin e tij "Korça dhe fshatrat për qark", në vitin 1900 ai shkruan se "...Korça përpara 1487 ka qenë një fshat i vogël me bujq, që ka pasur jo më shumë se 10-15 shtëpi dhe atëherë quhej Pes-stëpi...dhe kishin një kishë me emër Shën e Premte..Koxa Mirahori e bleu, e bëri së pari teqe dhe pastaj xami dhe kjo sot është xami e madhe". Po këtu, studiuesi shprehet "...se në një ferman, Sulltan Bajaziti II, i fal Koxha Mir'ahorit viset e Gjorxesë...", Gjorxesë. Kjo fjalë është turqisht dhe në shqip do të thotë "shiko dhe shko" (N.D.N., 1901). Diskutimet e studiuesve në lidhje me origjinën e emrit, kohën e ekzistencës së vendbanimit mbi të cilin do të ngrihej qyteti i sotëm janë të shumta. Megjithatë kur flitet për qytetin e sotëm, mendimi më i përhapur midis studiuesve për zanafillën urbane të tij lidhet me ngritjen e xhamisë së Iliaz bej Mirahorit, në fund të shek. XV (1496) (*Naçi, 1900; Ramo, 2012; Thomo, 2012*). Për këtë arsye, në funksion të studimit tonë, analizën morfologjike të qytetit të Korçës do ta fokusojmë që prej këtij momenti deri në ditët e sotme, duke trajtuar tri periudha të rëndësishme të zgjerimit dhe ndryshimit të formës së tij.

### *Tiparet e formës urbane të qytetit të Korçës deri në fund të shek.XIX*

Në dokumentet historike të kohës thuhet se Iliaz bej Mirahori shpërnguli pazarin pranë xhamisë dhe ndërtoi gjithashtu edhe një medrese, hamam dhe imaret (institucion bamirësie) dhe zotërimet e tij i ktheu në vakëfe (*N.D.N., 1901; Pepo, 1981; Ramo, 2012*). Këto ndërtime do të përbënin bërthamën e një qendre të re social-ekonomike, tregtare dhe arsimore dhe po kështu të një qendre të re urbane, që do të zgjerohej në mënyrë të qëndrueshme shekujt në vazhdim. Zhvendosja e pazarit dhe nevoja e afërsisë me të diktoi ardhjen e popullsisë nga zonat kodrinore përreth, duke çuar në zgjerimin e territorit në shek.XVI- XVII, me ndërtime të reja, kryesisht të tipit të banesave në drejtim të zonës fushore në perëndim dhe veriperëndim. Për sa i përket formës urbane të qytetit të Korçës, po të shikojmë hartat e vjetra, në shekullin XVIII, kemi të bëjmë me një vendbanim me tri njësi kryesore përbërëse (ngastra), të ndara nga lumi i Moravës që buron nga mali me të njëjtin emër (hartat 1. b). Në të djathtë të lumit, në verilindje ndodhej Varoshi (popullsi ortodokse) dhe në të majtë, në jugperëndim ndodhej Kasabaja (popullsi myslimane). Pazarin ndahej nga lumi, ku pjesa më e madhe e tij ndodhej pranë Kasabasë (*N.D.N., 1923*). Sipas studiuesit Pirro Thomo (2012) gjurmët urbanistike për të paraqitur sa më mirë elementet dhe formën urbane të qytetit në shek XVIII, janë të zbehta. Megjithatë, nga dëshmitë historike dhe nga ajo çka mund të shihet, disa nga tiparet kryesore që kanë shoqëruar zgjerimin e qytetit në këtë periudhë kanë të bëjnë me një rritje spontane e favorizuar edhe nga terreni i butë në drejtim të fushës. Rrjeti rrugor i çrregullt, me rrugë të ngushta që krijojnë parcela të mbyllura ndërtimesh në trajtë qarqesh (*Thomo, 2012*). Ndërtimet janë kryesisht banesa të vendosura buzë rrugës, të tipit dykatëshe, ku kati i dytë del mbi katin e parë. Oborri shoqëron banesën që rrethohet nga mur

kryesisht i ulët (elemente që i konstatojmë edhe në disa banesa aktuale). Në të njëjtën kohë, banesat ruajnë lidhjen e familjes me ekonominë bujqësore, duke kushtëzuar në ambientet e tyre praninë e një sërë mjedisesh ndihmëse si oborri, plevicat, hajati, çardaku ashefi, pusi (*Pepo, 1981; Riza, 1991; Thomo, 2012*). Nuk mungojnë gjithashtu ndërtimet e kultit, në veçanti kishat (në 1707 u ngrit katedralja “Burimi Jetëdhënës” etj.).

Në gjysmën e parë të shek.XIX prodhimi zejtar u rrit ndjeshëm dhe qyteti u fut në rrugën e zhvillimit të shpejtë ekonomik. Për rrjedhojë zgjerohet zona e ndërtimeve (harta 1.c) dhe tipar dallues është krijimi i ansambleve të ndërtimeve, sipas një ndarjeje funksionale të tyre në rezidenciale dhe ekonomike. Aktiviteti zejtar dhe tregtar ishte përqendruar te tregu apo pazari, ndërkohë që ansamblet e banimit ishin dukshëm të veçuara. Ato vazhdojnë të ruajnë tiparet e trashëguara ndërkohë që pajisen me elemente të reja në fizionominë e jashtme. Nga dëshmitë e kohës, struktura urbanistike e banesave evidentonte ndryshimin klasor dhe fetar (myslimanë dhe ortodoksë), ku binin në sy banesat dykatëshe me oborre dhe kopshte, përkundrajt atyre të ulëta njëkatëshe të shtresave të varfra (*Pepo, 1981*), (*N.D.N, 1923; Thomo, 2012*). Përpos tendencës së zgjerimit me ndërtime të reja, nga pikëpamja e formës urbane qyteti dallohet për zgjerim me parcela të reja ndërtimesh, por me probleme në mungesën e infrastrukturës (fig.c).

Në mesin e shek.XIX qyteti shënon një fazë të re të zhvillimit ekonomik, ku prodhimi zejtar mbulon gjithë veprimtarinë ekonomike dhe rrjeti i tregtisë shtrihet në të gjitha qendrat brenda dhe jashtë vendit, me një strukturë shoqërore të organizuar. Në nivel kombëtar, Korça konsolidoi pozitën administrative krahinore dhe fuqinë ekonomike duke u shndërruar në qendër të rëndësishme prodhimi dhe shkëmbimi në gjithë jugun e Shqipërisë. Popullsia u rrit me mbi 10 000-13 000 banorë (*Pepo,*



1981), çka çoi në rritjen e kërkesës për ndërtime, por edhe për cilësinë e tyre. Këto zhvillime ndikuan në fizionominë e qytetit, që përfitoi tipare të reja urbane. Siç mund të shihet edhe nga harta (d), zgjerimi i territorit në këtë periudhë konsiston me krijimin e një rrjeti të dendur ndërtimesh. Qyteti zhvillohet me ritme të shpejta, përtej bërthamës së tij. Konkretisht zgjerimi i qytetit ndodh në dy akset kryesore, rrugën e Shën Gjergjit (bulevard Shën Gjergj), dhe rrugën e Follorinës (sot bulevard *Republika*). Sistemi rrugor i rregullt dhe ortogonal lidh blloqet e ndërtimeve dhe ndërtimet. Në të njëjtën kohë vlen për t'u përmendur krijimi i lagjeve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese, Varoshi, Kasabaja, Varoshi i Poshtëm apo Katavaroshi (*N.D.N., 1901; Thomo, 2012; Pepo, 1981*). Lagjet përshkruhen nga rrjeti i dendur rrugor me kalldrëm, me prirje për krijimin e formave të rregullta gjeometrike.



Harta 1. Zgjerimi i formës urbane të qytetit të Korçës, shek.XVII-shek.XX.. a) qyteti shek.XVII; b) qyteti shek.XVIII, c) qyteti shek.XIX; d) qyteti fundshek.XIX- fill shek.XX; e) qyteti gjysma e dytë e shek.XX. Burimi: Arc GIS 10.1, E.Braholli 2022 (bazuar te plani i qytetit të vitit 1920)

Nga ekzistenca e disa banesave të kësaj periudhe dëshmohet rregullsia që ndjek vendosja e tyre. Sigurimi i materialeve të ndërimit nga mali i Moravës, por edhe nga zonat përreth qytetit si: gurët, argjila, materialet e drurit dhe metalet në vend të

plitharit dhe qerpiçit të përdorur më parë, ndikuan në cilësinë e ndërtimeve dhe në pasurimin e elementeve dekorative në pamjen e jashtme. Krahas rindërtimeve sipas tipologjisë së vjetër, në këtë periudhë konstatohet lindja e një tipi të ri banese e cila u përgjigjej kërkesave të shtresës së re të borgjezisë (Riza, 1991). Tipologjia e banesës dallohet për elemente të pasura si në pamjen e jashtme, ashtu edhe në mjediset e brendshme (Thomo, 1978). Një element që vlen për t'u përmendur në arkitekturën e veçantë të ndërtimeve dhe karakterin dekorativ të tyre, është pasqyrimi në të i elementeve të kulturës perëndimore të sjellë nga korçarët e udhëtuar nëpër vendet e Europës. Ndër ansamblet ndërtimore kryesore të qytetit ishte pazari, roli i të cilit në gjysmën e dytë të shek.XIX ishte fuqizuar duke shprehur qartë natyrën zejtarotregtare të zhvilluar të këtij qyteti (Riza, Strazimiri, 1972). Pazari i Korçës tërhiqte tregtarë dhe udhëtarë nga zonat përreth, por edhe nga vise të tjera të Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Sipas dëshmive historike, rindërtimi i pazarit pas zjarrit të vitit 1879 (u dogjën më se 600 dyqane) nxori në pah një strukturë të rregullt ndërtimesh. Nëse shihej, në hapësirën e zonimit të pazarit binte në sy një ndarje funksionale e aktiviteteve prodhuese, tregtuese, nga mjediset e pushimit (hanet, 16 të tilla) (Thomo, 2012). Nga dëshmitë historike gojore, fotografike si edhe gjurmët që ka trashëguar pazari i sotëm, sheshet e tregtimit ishin të shpërndara në pika të ndryshme të pazarit, në të cilat tregtoheshin prodhime zejtarie, bujqësore dhe blegtorale, por edhe veshje apo produkte të tjera. Dyqanet dykatëshe rrethonin sheshin kryesor të pazarit, ndërsa njësitë brenda pazarit lidheshin nëpërmjet tyre me një sërë rrugicash të drejta. Në fund të shek.XIX struktura urbane e qytetit të Korçës kishte fituar kompaktësinë e vet me një fizionomi të konsoliduar urbane.

- *Tipare të formës urbane të qytetit në shek.XX*

Në fillim të shek.XX qyteti kishte formuar një *strukturë* të rregullt urbanistike, në bazë të të cilit qëndronte sistemi ortogonal, me rrugë dhe rrugica me dritë dhe korrente ajrore për jetën ekologjike të qytetit (*Velo, 2014*). Popullsia e qytetit erdhi duke u rritur, dhe në vitin 1927 Korça ishte qyteti me popullsinë më të madhe ndër qytetet e Shqipërisë, me 25 593 mijë banorë (*Karaguni, Alizoti, 2013*). Një element i rëndësishëm në formimin e fizionomisë së re urbane dhe strukturës së organizmit funksional në këtë periudhë, është krijimi dhe fuqizimi i ansambleve me karakter shoqëror si ndërtesa administrative: bashkia, prefektura, gjykata, biblioteka e qytetit (1921), kinoteatri “Mazhestik”, spitali (1933-1934), shërbime telegrafi, hotele, farmaci, hane dhe një sërë njësisish shitjeje etj. (*Thomo, 2012; Miho, 2003; Velo, 2014*). Në vitet ’20-’30 forma urbane e qytetit ndryshon duke u zgjeruar me rrugë dhe ndërtime të reja. Ngrihen ndërmarrje industriale si fabrika e miellit, e leshit, tullave, duhanit, alkoolit, birrës etj. që pozicionohen në periferi të zonës rezidenciale. Kontributi i përbashkët i popullsisë dëshmohet qartë në ndërtimin kolektiv të objekteve publike. Në të njëjtën kohë, brenda territorit urban rriten ndërtimet (4000 m rrugë, 150-200 dyqane e shtëpi të reja sipas sistemit të ri, kanalizimi i ujërave të zeza etj.) (*Arkiva e Bashkisë, 1950*). Sipas të dhënave të kohës, ndërtimi i lagjeve të reja sipas një skeme ortogonale dëshmon për ekzistencën një plani që ka disiplinuar ndërtimet e qytetit, që kohën e pushtimit turk. Po kështu, në arkivat e bashkisë në vitin 1910 gjendet njoftimi i parë për planin e qytetit, ku parashikohej hapja dhe sistemi i rrugëve të vjetra me gjerësi 8-12 m, për të ardhur te rregullime dhe zgjerime të përcaktuara të qytetit sipas planit të vitit 1930 (dy inxhinierë të huaj vienezë, Kohler dhe Bertoldi) (*Thomo, 2012*).

Pas çlirimit të vendit, qyteti iu nënshtrua një sërë transformimesh në fizionominë urbane. Krahas ndërtimeve me karakter industrial zunë vend edhe ndërtimet me karakter

rezidencial, në trajtën e blloqeve të ndërtimit. Disa prej ndërtimeve të trashëguara nga periudhat e mëparshme u prishën dhe vendin e tyre e zunë ndërtime të reja të realizmit socialist. Një ndër ndryshimet e dukshme në fizionominë e qytetit në vitet '60, ishte devijimi i lumit të Moravës që kalonte përmes qytetit dhe ndërtimi në rrjedhën e tij të një prej bulevardeve ekzistuese. Në vitin 1968 qyteti numëronte 46 300 banorë (Sheri, 1970). Zonifikimi i ndërmarrë në vitin 1973 vuri në mbrojtje qendrën historike të qytetit me tri ansamble; dy Zona Muze, një Zonë e Mbrojtur dhe 14 banesa Monument Kulture. Zonimi i dytë në vitin 1984 e rriti qendrën historike me katër zona; dy Zona Muze, dy Zona të Mbrojtura dhe 23 Monumente Kulture (Bashkia Korçë, 2014). Pas viteve '90 kushtet e reja të zhvillimit social ekonomik dhe rritja e kërkesës për banesë e përballën qytetin e Korçës me zhvillime të dukshme. Në këtë kuadër, qendra historike e qytetit pësoi disa ndryshime në vitet 2002, 2005, 2011, 2017, ku u përcaktuan zonime të reja, që sipas rregullores së mbrojtjes së saj ka synuar ruajtjen e rrjetit rrugor duke kushtëzuar rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja.

- *Struktura aktuale urbane e qytetit*

Me gjithë ndryshimet që u analizuan më sipër, qyteti i Korçës ka arritur deri në ditët tona me një fizionomi të formuar urbanistike dhe arkitekturore ku pasqyrohen elemente të dukshme të zhvillimit. Për sa u përket tipologjive urbane të periudhave të ndryshme historike, ato bashkëjetojnë të ndërthurura me njëra-tjetrën, duke krijuar një mjedis të veçantë ndërtimesh. Ndonëse investimet e bëra pas viteve 1990 dhe në veçanti dekadën e fundit, janë shoqëruar me disa ndryshime të dukshme, ajo çka evidentohet ende nga struktura urbane është natyra e saj kompakte. E projektuar si një zonë rrethore me diametër 1.5-2.5 km, qyteti është i rrethuar nga parku *Rinia* dhe

kompleksi sportiv në veri; nga unaza në perëndim e jug dhe kodrat e Moravës në lindje (*Bashkia Korçë, 2017*), (Fig.1).



Foto 1. Pamje e qytetit të Korçës (Burimi: E.Menkshi)

Po të shohim strukturën e organizimit hapësinor, kemi të bëjmë me një qytet koncentrik, me një sistem të rrugëve që takohen në qendër (pa nënqendra të tjera, pavarësisht disa dyqaneve të vogla të nevojave të përditshme dhe objekteve publike të shërbimit) (*Menkshi, 2020*). Në aspektin administrative përbëhet nga 3 rajone dhe 18 lagje, ku zonat funksionale krijojnë një panoramë të qartë të zhvillimit dhe funksionimit të tij. Kështu: *Qyteti historik* përbëhet nga dy elemente të rëndësishme të strukturës urbane të qytetit, me trashëgimi të pasur historike dhe arkitekturore: *Qendra tradicionale* (shek. XIX dhe fillimit të shekullit XX); *Qendra e qytetit*, e cila ruan vendosjen e objekteve tregtare, kulturore dhe argëtuese së bashku me ndërtesat administrative (Fig.2). *Zona rezidenciale* në aspektin vizual dhe kompozicionit shpreh tipologjitë urbane të periudhave të

ndryshme të përfaqësuara nga: *ndërtimet rezidenciale të periudhës së socializmit*, kryesisht ndërtesa kolektive apartamentesh (4-5 kate), *ndërtimet e periudhës së fundit të socializmit* (1980-90) me ndërtesa 6 kate; *ndërtimet shumëkatëshe* (pas '90) (shumëfunktionale 8-9 kate të larta), të lokalizuara në zonën ish-industriale në hyrje të qytetit, por edhe në zona të tjera. E dallueshme është *zona informale* në periferi të qytetit (pas 1990), përgjatë rrugëve që të çojnë në vendbanime të afërta si, Voskopoja Erseka, Polena (Bashkia, Korçë, 2014). Zgjerimi i zonave rezidenciale ka ardhur si rezultat i rritjes së popullsisë në qytet (87 554 banorë, të regjistruar në gjendjen civile 2021), por edhe kërkesës së lartë për strehim. *Zonat ekonomike* e qytetit përfaqësohet nga një zonë industriale e zhvilluar në periudhën e regjimit socialist, ku aktiviteti industrial ka degraduar në objekte të braktisura. Zona shtesë me aktivitete të reja ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të Bilishtit dhe akseve të tjera rrugore. Një vend të rëndësishëm zënë edhe objektet apo ndërtimet me karakter publik, si ato të arsimit, shëndetësisë, objektet kulturore dhe argëtimit etj. *Hapësirat e lira dhe të gjelbra* përfaqësohen nga hapësirat publike, si: parqet, lulishtet, hapësirat midis ndërtimeve etj., por ekzistojnë edhe një mori hapësirash të lira të përdorura për qëllime të ndryshme. Parku *Rinia* është parku urban më i madh i qytetit, në verilindje të tij.



Foto.2. Qendra e qytetit të Korçës  
(Burimi: E.Menkshi)



Foto3. Banesë tradicionale në qendrën historike

Fizionomia e veçantë e qytetit e gërshetuar me arkitekturën tradicionale kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendës dhe të huaj. Aktualisht qyteti dhe rrethinat e tij janë konfirmuar tashmë si destinacione turistike në zhvillim (Menkshi, 2020). Në funksion të zhvillimit të turizmit, krahas rehabilitimit të rrjetit rrugor janë rikonstruktuar një sërë objektesh kulturore (pazari i vjetër, banesa, parku i qytetit etj.). Qyteti dhe në veçanti qendra e tij, është përfshirë nga ndërtime të reja, me qëllim gjallërimin e jetës dhe tërheqjen e vizitorëve. Ndërtimet kanë të bëjnë kryesisht me përshtatjen e banesave ekzistuese për funksion turistik (hotele, bujtina dhe restorante). Në disa raste këto kanë ruajtur karakterin ekzistues tradicional (Fig.3), në disa të tjera kanë synuar stilin modern jo vetëm në formë dhe arkitekturë, por madje edhe në ngjyra. Nga ana tjetër, mungesa e investimeve ka sjellë braktisjen e disa banesave “monument kulture”, duke shfaqur rrezikun e degradimit të mëtejshëm. Një fenomen që po përhapet me shpejtësi është prishja e banesave individuale në lagjen tradicionale dhe zëvendësimi me ndërtime trikatëshe, të tipit të apartamenteve. Përpos zhvillimeve të ndërmarra, nga konstatimet e bëra në terren pohojmë se në mjaft raste mungon lidhja e ndërtimeve të reja me ansamblet ndërtimore të trashëguara, duke ndikuar ndoshta në krijimin e një fizionomie të re të qytetit në të ardhmen.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Pasi analizuam tiparet e morfologjisë urbane, arrijmë në përfundimin se perspektiva historiko- gjeografike ka ndikuar në formimin e qytetit të Korçës, me një identitet dhe fizionomi të qartë urbane. Zhvillimi ekonomik, social-kulturor, që përfshiu qytetin në mesin e shek. XIX ishin faktorë që do të ndikonin në transformimet e mëtejshme të tipareve fizike të tij. Si rrjedhojë, fillimi i shek. XX, e gjeti qytetin me territor urban të unifikuar,



rrjet rrugor ortogonal, rregullsi të blloqeve të ndërtimit, kompaktësi të strukturës urbane. Proceset aktuale të ndërhyrjeve për rregullimin e infrastrukturës urbane, në funksion të një qyteti që të ofrojë zhvillim dhe mirëqenie për komunitetin, kanë ndikuar në përmirësimin e sistemit rrugor dhe shërbimeve. Zëvendësimi i banesave të vjetra në qendrën tradicionale (fundi i shek. XIX dhe fillimin i shek. XX) me ndërtime të reja kanë synuar rigjallërimin e mjedisit urban. Nga vëzhgimet në terren konstatohet se ndërtimet monument kulture të tipit të banesave, të trashëguara nga, në disa raste i janë përshtatur funksionit turistik sipas arkitekturës ekzistuese, por në shumë raste vuajnë dëmtime të rënda nga mungesa e investimeve. Megjithatë, sugjerojmë se ndërhyrjet me karakter zhvillimor të qeverisjes lokale, por edhe sipërmarrjes private, duhet jenë të kujdesshme në ruajtjen e tipologjisë e trashëgimisë ndërtimore në qendrën historike të qytetit. Për këtë është e nevojshme të merren në konsideratë kriteret e ndërtimeve në zona të rëndësisë historike. Në të njëjtën kohë, nuk duhet të shmangët mendimi i specialistëve të fushës së trashëgimisë për të ruajtur vlerat e saj. Së fundmi, me ndryshimet e shpejta që po pëson qyteti ndikuar nga zhvillimi i turizmit, shtrohet nevoja e ndërmarrjes së studimeve mbi zhvillimin urban të qytetit në të ardhmen, rëndësinë e ruajtjes së fizionomisë dhe identitetit të tij. Në këto studime, kontributi i gjeografit është i domosdoshëm.

### Literatura

- Bently, I., Butina, G., (1990). Urban design. Architects Journal, 61-71. pdf.
- Cataldi, G., Maffei, G. L., Vaccaro, P., (2002). Saverio Muratori and Italian school of planning typology. Urban Morphology 6(1), 3-14. pdf
- Gruda, G., (2020). Relievi Struktural i Shqipërisë. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 523-28.
- Hofmeister, B., (2003). The study of urban form in Germany. Urban Morphology 8(1), 3-12. [www.urbanform.org/pdf/hofmeister 2004.pdf](http://www.urbanform.org/pdf/hofmeister%2004.pdf)
- Karaguni, M., Alizoti, A., (2013), Hapësira urbane shqiptare në harkun kohor të një shekulli, Revista Albanologjike, Tiranë, fq. 159-167

Larkham, P. J., (2006). The study of urban form in Great Britain. *Urban Morphology* (2006) 10(2), 117-42. pdf

Matos de Loureiro, F., (2018), *Urban Morphology: An introduction to the study of physical form of cities*, by Vitor Oliveira, *Journal of Urban Affairs*, 1197-99 , 40:8, DOI: 10.1080/07352166.2018.1470872

Menkshi, E., (2020). *Trashëgimia natyrore dhe kulturore e qarkut Korçë*. Korçë: Promo Print.

Menkshi, E., Shehu, D., (2020). Roli i infrastrukturës në zhvillimin e territorit urban: Rast studimi qyteti i Korçës. *Vjetari FEF*, 66-76

Moudon, A. V., (1997). Urban morphology as an emerging interdisciplinary field. *Urban Morphology* 1, 3-10 .pdf

N, D. N., (1901). *Korça dhe fshatrat për qark*. Sofje

Naçi, N. N., (1923). *Korça dhe katundet e qarkut*. Korçë: Kotti.

Oliveira, V., (2013). The study of urban form: reflection on national reviews. *Urban Morphology* 17(2), 85-92.

Pepo, P., (1981). *Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore, shek.XVIII-filim i shek.XX (Kodiku i Korçës dhe Selasforit)*, Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Pinho P., Oliveira, V. (2007). Cartographic analysis in urban morphology. *Environment and Planning B: Planning and Design*, 1-22.

Plani i Përgjithshëm Vendor, *Bashkia Korçë*. (2014) pdf

Qiriazhi, P., (1985). *Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore dhe maleve përreth tyre*. Tiranë: Universiteti i Tiranës.

Qiriazhi, P., (2019). *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. Tiranë: Mediaprint,

Ramo, S., (2012). *Ilija Panariti dhe Korça*. Korçë: Kotti.

Raport. (2014). *Planifikimi urban*. Korçë: Bashkia Korçë.

Riza, E., Strazimiri, B., (1972). *Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës*. Monumentet 3, 120.

Riza, E., (1991). *Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 231-233

Selenica, E., (1982). *Korça në faqet e historisë*. Tiranë: 8 Nëntori.

Selenica, T., (1928). *Shqipëria më 1927*. Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", f.311-341

Sheri, F., (1970). *Popullsia e Shqipërisë*. Tiranë: 8 Nëntori

Thomo, P., (1978). *Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës*. Monumente historike në vendin tonë, 5-256

Thomo, P., (2012). *Korça, urbanistika dhe arkitektura*. Tiranë: Morava.

Velo, M., (2014). *Betonizimi i Shqipërisë*. Tiranë

Whitehand, J. W., (2001). *British urban Morphology: the Conzenian tradition*. *UrbanMorphology* 5(2), 103-109. pdf.

Whitehand, J. W., (2007). *Conzenian urban morphology and urban landscape*. 6th International Space Syntax Symposium, (pp. 1-9). Instambul.pdf

Whitehand, J. W., (2012). *Issues in urban morphology*. *Urban morphology* 16(1), 56-65.pdf

**Prof. asoc. dr. Jostina Dhimitri<sup>1</sup>**

**Msc. Xhuliana Zdrava<sup>2</sup>**

## **KARAKTERISTIKA GJEOHAPESINORE TË VENDBANIMEVE TË LUSHNJËS**

### **Abstrakt**

Faktorët natyrorë dhe antropogjenë bëhen në periudha të caktuara ndikuesit kryesorë në shtrirjen gjeohapësinore të vendbanimeve dhe shpërndarjes së popullsisë në tërësi. Përfshirja e një territori në pasqyrimin e dinamikës historike reflekton gjurmët e saj nën ndikimin e politikave qeverisëse, orientimeve dhe zbatimeve ekonomike dhe sekuencave të tjera socio-ekonomike.

Studimi fokusohet kryesisht në dinamikën kohore të sintetizuar të shtrirjes së vendbanimeve të popullsisë së Lushnjës, duke përfshirë si hapësirë të saj një territor që ka pësuar shpesh ndryshime koordinative, gjeohapësinore, të reflektuara në numrin e vendbanimeve dhe të popullsisë së tyre.

Organizimi hapësinor i saj iu është nënshtruar organizimeve administrative-territoriale, duke afruar apo shkëputur nga hapësira e saj territore me zonat përreth ndër vite. Aktualiteti paraqitet me një zvogëlim të madh të territorit të paravitit 2014, reflektuar dukshëm me një rënie të numrit të popullsisë dhe vendbanimeve.

Studimi ka natyrë analizuuese, narrative dhe sintetizuese duke synuar të evidentojnë ecurinë e numrit të vendbanimeve, si dhe ndikimin kryesor të faktorëve natyrorë, socio-ekonomikë, organizantivo-administrativë të këtij realiteti.

---

<sup>1</sup> *Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, E-mail: jostina.dhimitri@unitir.edu.al*

<sup>2</sup> *Universiteti i Gjirokastrës, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë. E-mail: xhuli.zdrava@gmail.com*

*Fjalë çelës: vendbanime, Lushnjë, hartë administrative, faktorë gjeografikë, dinamikë gjeohapësimore,*

### **Abstract**

The natural and anthropogenic factors become the main influencers in specific time, in the geospatial distribution of the settlements and the population as a whole. The inclusion of a territory in the reflection of the historical dynamics evidence its traces under the influence of the governmental policies, economic orientations and the implementations, and the other socio-economic sequences.

The study will mainly highlight a synthesized time dynamic of the distribution of the settlements of Lushnja's population, including its geospacer, a territory that has often undergone geospatial, coordinatively changes, reflected in the number of the settlements, their positioning and their population too.

Its organization has been subject of the administrative-territorial organizations by gathering or separating areas with the surrounding parts over the years. Actually, it is presented with a large decrease of the territory's area compare with the pre-2014, reflected is reduced number of the population.

The study has an analytical, narrative, and synthesizing nature aiming to identify the progress of the number of settlements and the main impact of natural, socio-economic, organizational-administrative factors of this reality.

*Keywords: settlements, Lushnje, administrative map, geographic factors, geospatial dynamic*

## **I. Hapësira e studimit**

Zona gjeografike e marrë në studim është e lokalizuar në fushën e Myzeqesë së Madhe, pjesë e Ultësirës Perëndimore. Viti 2014 vendos kufijtë administrativë përfundimtarë të Lushnjës së sotme, duke gati e përgjysmuar sipërfaqen e mëparshme të saj. Sipas Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (*Fletore Zyrtare, Nr. 137, 2014*), njësitë e qeverisjes vendore janë organizuar në 61 bashki dhe 12 qarqe. Referuar këtij ligji, rrethi i

Lushnjës organizohet në dy bashki: bashkia e Lushnjës dhe bashkia e Divjakës, në përëndim të saj. Fig. 1.

Lushnje	Qyteti Lushnje	Lushnjë	Qyteti Lushnje, Fshatrat: Barbutina, Saliç
		Allaj	Fshatrat: Trishën, Zheqerën, Dëshmorët, Bëkaj i çmës, Allaj, Lofaj e Re, Çikaj e Ri, Moshaj
		Bubullinjë	Fshatrat: Bubullinjë, Ertas, Gjevas, Hëllaj, Piri, Kamçoliri, Isnoh
		Hygëshaj	Fshatrat: Hygëshaj, Kurrin, Çanokaj, Kajtaz, Labin
		Golem	Fshatrat: Golem i Madh, Ahyecan, Shëqer, Hëshëra, Piri, Gërben e Vogël
		Dushk	Fshatrat: Gërben, Dushk i Vogël, Komar, Zham Fshaj, Dushk i Madh, Zham Sektor, Thanasaj
		Karbutina	Fshatrat: Karbutina e Sipërme, Mullaç, Kësharaj, Kështerandë, Stanëkarbutina, Zylina, Balin, Gëllin, Murat Pëqja, Beshkaj
		Ballagat	Fshatrat: Ballagat, Gërben, Lumbardh, Gërshaj, Jorçesh, Mammullaj, Xherkë
		Fier Shëngjer	Fshatrat: Jorçaj e Ri, Komar e Vogël, Jan Shëngjer, Kocaj, Babullinjë, Çinar, Sëpërmasa, Thanaj, Çikaj e Vjetër, Murriz Komar, Qyteti i Vjetër, Qyteti i N. Beshkaj e Ri
		Kokënjë	Fshatrat: Kokënjë, Gazi, Bishupshin, Lumbaj, Rrapaj Fshaj, Shikaj, Ardianaj, Bona, Rrapaj Sektor
		Krupje	Fshatrat: Krupje e Sipërme, Krupje e Poshtme, Fier i Ri, Zhyr, Rrapaj i Ri e Vjetër, Kadra, Njerrin e Madh, Njerrin e Vogël, Arën, Gazi
Divjakë	Qyteti Divjakë	Divjakë	Qyteti Divjakë: Fshatrat: Miza, Nonga, Gërshaj i Madh, Gërshaj e Vogël, Halvaçollaj, Bergas, Dushk e Ri, Zhamor, Bishupçaj
		Tërshuf	Fshatrat: Çermë, Sëkambin, Çermë Prushkaj, Sulnitaj, Çermë e Sipërme, Tërshuf, Shëngjerit, Çermë Pisha
		Grahban	Fshatrat: Grahban, Sërvaç, Ferras
		Grahshë	Fshatrat: Kërshinaj, Menoh, Gërshaj, Stoper, Fier Shtan, Grahshë, Gjevas, Spëllaj, Baburaj
Remas	Fshatrat: Remas, Muzan, Kamovaj Fshaj, Gazi, Kryeqaj, Kamovaj, Karavasta e re, Adritik		

Fig. 1. Organizimi i qendrave të banuara për bashkinë Lushnjë dhe atë Divjakë. (Bashki, qendra e bashkisë, njësitë administrative përbërëse, qytete dhe fshatrat në përbërjen e tyre; Fletore Zyrtare, Nr. 137, 2014), f. 6370.

Studimi do të analizojë ecurinë e dinamikës gjeohapësinore të vendbanimeve dhe faktorët ndikues në shtrirjen e tyre gjeografike, në rrethin e Lushnjës dhe bashkinë e sotme duke iu referuar para dhe pas këtij viti.

Si rreth, Lushnja kufizohej me rrethin e Kavajës (lumin Shkumbin) në veri, me rrethin e Peqinit në verilindje, me rrethin e Elbasanit, e Beratit dhe Kuçovës në lindje (në një gjatësi prej 25 km nga të cilat 1.2 kufi tokësor, 20.5 kufi lumor -lumi i Semanit dhe 3.2 km kufi liqenor- rezervuari i Thanës) dhe në juglindje dhe jug nga rrethi i Fierit (kufi tokësor dhe lumor-lumi i Semanit). Ajo gjendej midis koordinatave gjeografike:  $\phi$  V 41°03'01" (fshati Çermë e Sipërme),  $\phi$  V 40°16'01" (fshati Ishëm);  $\lambda$ E 19°30'01

(Karavasta e Re);  $\lambda E 19^{\circ}51'01$  (fshati Murrizë-Kozare). Sipërfaqja e tij ishte  $712 \text{ km}^2$ ;<sup>1</sup>. (Dhimitri, 2013). (Fig. 1)




Fig. 2 Ndarja administrative e rrethit të Lushnjës, harta tematike, Dhimitri, J. 2011, harta bazë, harta topografike 1:200 000, Burimi: Punim doktrature, f. 38

Kufijtë e rinj, tashmë, të bashkisë së Lushnjës (2014) përcaktojnë bashkinë e Rogozhinës në veri, të Peqinit në verilindje, Belshit dhe Kuçovës në lindje dhe juglindje, Urën Vajgurore (Dimal) në juglindje, Roskovec dhe Fier në jug si dhe Divjakë në perëndim. Kjo shtrirje ruan të njëjtin pozicionim gjeografik veri-jug, si dhe kufirin koordinativ lindor, por gati përgjysmon shtrirjen lindje –perëndim duke u kufizuar më në perëndim me kufijtë lindorë të njësive administrative: Tërbuf, Grabjan dhe Gradishtë, të cilat i përkasin bashkisë së Divjakës.

<sup>1</sup> Të dhëna të evidentuara nga harta administrative e Shqipërisë, shk 1:200 000



Fig. 3. Bashkia e Lushnjës dhe Divjakës (qysh prej vitit 2014). Burimi: Fletore Zyrtare, Nr. 137, 2014, f. 6383.

Pavarësisht këtij pozicionimi të ri administrativ, bashkia e Lushnjës ka një pozicion gjeografik lehtësues për sa u përket rrugëve të komunikimit dhe aksesueshmërisë me zonat portuale detare të Durrësit dhe Vlorës, atë ajrore si dhe me kryeqytetin e vendit. Hershmëria e rrugëve kryesore tregtare që përshkojnë këtë hapësirë gjeografike është e lashtë. Pjesë e Rrugës Egnatia: Apoloni-Roskovec-Karburnarë-Golem-Rrogozhinë kanë përshkuar Lushnjën, duke u bashkuar për nga veriu me qytetin e vjetër Klodiana (Peqini i sotëm).

## II. Metoda

Studimi synon një analizë gjeografike hapësinore të shtrirjes së vendbanimeve në Lushnjë duke u ndalur në dinamikën kohore, veçanërisht pas vitit 1945, duke pasqyruar faktorët dhe momentet

kyçe të këtij modelimit gjeohapësinor. Në ndihmë të studimit është shqyrtuar literatura e shkruar për zonën dhe tematikën e studimit. Janë realizuar përpunime statistikore dhe hartografike. Puna në terren ka shërbyer për evidentime dhe intervista me specialistë, si biseda me inxhinierë gjeologë, takim me kryepleq dhe banorë të fshatrave. Ato kanë plotësuar boshllëqet e nevojshme duke përdorur metodën cilësore kërkimore fenomenologjike. Të dhënat numerike janë mbledhur në zyrën e statistikës të bashkisë së Lushnjës, vjetarët statistikorë dhe të dhënat nga Instat-i apo website të ndryshme.

### III. Gjetje dhe diskutime

#### 1. Vlerësimi gjeografik i kushteve natyrore të zonës në studim

*Ndërtimi gjeologjik:* E gjithë hapësira e bashkisë së Lushnjës dhe më në perëndim e Divjakës ka një ndërtim gjeologjik që në drejtim të lindjes përfshihet nga *Zona jonike* dhe drejt perëndimit mbivendoset nga njësia tektonike e rendit më të ulët, nga Ultësira paramalore ose Pranadriatike. Pjesa më e madhe e mbulohet nga depozitimet e kuaternarit, që nga më të vjetrat e deri në të sotmet. Kryesisht këtë hapësirë e zë i ashtuquajturit depresioni i Myzeqesë (sinklinali i Tërbufit), që fillon nga fshati Sulzotaj përgjatë shtratit të lumit Shkumbin në VP, duke vazhduar në Gradishtë, Kolonjë, Bubullimë në jug, duke ardhur deri në Fier-Shegan, Karbunarë e deri në Lushnjë, Çermë e Sipërme në lindje. Po kështu, përfshihen dhe territoret bregdetare që nga derdhja e Shkumbinit e deri në Gradishtë në jugperëndim. Pjesët e ndërtimit dhe përbërjes gjeologjike kuaternare në rrjedhën e lumenjve Seman dhe Shkumbin (pjesërisht bashkia Divjakë), janë me natyrë lumore-kënetore dhe lumore-lagunore (*Grup autorësh, 1982*). Përveç depozitimeve kuaternare, në varësi të fenomeneve gjeotektonike janë formuar struktura gjeologjike si antiklinale, sinklinale,



diapire etj. Dallojmë pjesërisht në pjesën lindore të Lushnjës diapirin e Dumresë, i përberë nga anhydrite, brekcie, gëlqerore, gipse dhe argjila, tashmë pjesë e bashkisë së Lushnjës. Ndërsa struktura antiklinale përmendim antiklinalin e Divjakës, i cili fillon nga Gradishta (bashkia e Divjakës) dhe vazhdon në strukturën e Ballajt, Kryevidhit në Kavajë. Ky antiklinal dallon për vendburime të gazit natyror (*Dhimitri, 2009*).

Molasat e Ultësirës paramalore të vendosura mbi strukturën jonike përfshijnë nga lindja drejt perëndimit pjesë të antiklinalit të Beratit (Kavajë-Golem-Lushnje-Karbunarë-Ura e Kuçit (bashkia e Lushnjës)-Bistrovicë-Gosisë-Shpirag e më tej drejt jugut); pjesë të sinklinalit të Myzeqesë dhe vargun antiklinal Ardenicë-Divjakë (bashkia e Divjakës)-Kryevidh-Durrës. Përshkohen nga shkëputja tërthore e fuqishme Lushnjë-Elbasan-Dibër, me intensitet mesatar 6-9 ballë. Gjithashtu ajo përshkohet nga shkëputja tektonike Lushjë-Dragot. Kjo nyjë tektonike pret tërmete me magnitudë 6.2-6.4 (*Qiriazi, 2001; Sulstarova, Kociaj, Alia, 1980*). Njohja e veçorive sizmike të një hapësire gjeografike ka rëndësi veçanërisht në fushën e ndërtimeve, sepse shpie në jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e objekteve. Lidhja e truallit dhe sizmicitetit të tërmetit ka bërë të mundur kategorizimin e trojeve në 5 kategori, ku territori i Lushnjës ndodhet në kategorinë e 4-t (depozitime të shkrifëta kuaternare me nivel të ulët të ujërave të truallit). Ky truall e rrit intensitetin e tërmetit me 1 ballë më tepër (*Qiriazi, 2001; Sulstarova, Kociaj, Alia, 1980*).

Pasuritë minerale të nëntokës janë shfrytëzuar në dobi të ekonomisë së zonës dhe më gjerë, përmendim lëndët e djegshme fosile: gazin natyror në zonën e Divjakës (bashkia Divjakë), në depozitimet e molasave të cilat dallohen për praninë e ranorëve dhe zona e Bubullimës (bashkia Lushnjë), pjesë e strukturave të Ultësirës Pranëadriatike. Bubullima është shfrytëzuar dhe për naftë duke punësuar dikur banorë të zonës.

Gurorja e Karbunarës (bashkia e Lushnjës) përbën një vendburim të mineraleve të ngurta, si shkëmbinj sedimentarë ranorë dhe karbonatikë, e cila mundëson gëlqeren dhe materiale ndërtimi. Mosha e tyre i përket neogjenit. Ndërsa në vendbanimin e Kosovës së Madhe ka prezencë të shkëmbinjve gëlqerorë karbonatikë.

Prezencë të argjilave hasen në territoret e Golemit, Allprenaj (bashkia e Lushnjës), të cilat janë të moshës së neogjenit.

Ndërsa mineralet e shkrihtërimeve i përkasin vendburimit të Divjakë-Pishës (bashkia e Divjakës) dhe ndodhen në veri të plazhit të Divjakës.

*Relievi:* gjeohapësira gjeografike e dy bashkive ndodhet në një reliev që nuk i kalon 299 m. Konsiderohet një reliev kryesisht fushor, me valëzime kodrash. Kjo lartësi (299 m) ndodhet në kodrën e Mollasit (bashkia e Lushnjës). Është pjesë e Myzeqesë së Madhe, ku karakterin e saj fushor e prishin valëzimet e vogla kodrinore të Divjakës dhe Ardenicës (bashkia e Divjakës). Lartësia e tyre nuk i kalon 211 m (Ardenicë 2011 m), në afërsi të Gradishtës, Guri i Gomares ka lartësi 192 m (*Dhimitri, Sinani, Todi, 2015, referuar hartës topografike shk 1:50 000*). Në këndvështrimin e rrethit, deri në 2009, 88.3% e gjithë popullsisë është përqendruar në relievin fushor, 7% e saj është vendosur në relievin kodrinor. Sipërfaqja e të dyja bashkive përbën 79,7% reliev fushor dhe 20,3% reliev kodrinor, e quajtur dhe Darsia e Lushnjës. Zona kodrinore përbëhet nga flishi i origocenit (*Dhimitri, 2012; Qiriazi 1998*). Ziu (2004) thekson se hipsometria e Lushnjës së para vitit 2014 tregon se 568 km<sup>2</sup> e sipërfaqes ndodhet në lartësinë 0-99 m mbi nivelin e detit, ndërsa 144 km<sup>2</sup> ndodhen në lartësinë 100-299 m mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit llogaritet 20 m në pjesën lindore dhe 3 m në pjesën perëndimore (*Ziu, 2004*) të territoreve të paravitit 2014.

*Klima:* Dallon për një klimë të butë dhe të nxehtë, ku relievi i ulët dhe afria me detin ndikojnë në praninë e erërave të ngarkuara me lagështirë dhe zbutjen e klimës. Temperatura mesatare vjetore është 16.2°C. Sasia e reshjeve është 1002 mm, duke u konsideruar në zona me reshje të pakta të vendi. Izohieta 1000 mm në vit kalon nëpër këto territore (*Pumo et al, 1990, p.200*). Ditë me reshje numërohen mesatarisht 102,6 ditë në vit. Bora konsiderohet fenomen i rrallë. Shpejtësia mesatare e erës llogaritet në 2-4 m/s, me maksimume në Karavasta me 5-6m/s. (*Qiriazi, 2001*). Ditë me ndriçim dielli llogariten në 2682 orë. Të dyja bashkitë bëjnë pjesë në zonën klimatike mesdhetare fushore në nënzonën qendrore. Karakteristikat klimatike të zonës janë të ndjeshme në ekonominë bujqësore. Muajt me prezencë të thatësirës dhe vlera të larta të temperaturës, karakteristike për stinën e verës, kërkojnë intensifikimin e procesit të vaditjes në bujqësi. Larmia e kulturave bujqësore në varësi të vlerave të temperaturave të vegjetacionit është e madhe. Zgjatja e periudhës së ngrohtë (në muaj) për bashkinë e Lushnjës është 9,7 muaj. Kjo shihet si një tregues pozitiv për bujqësinë dhe florën në përgjithësi. (*Dhimitri, 2008*)

Lushnja dallohet për disa pasuri hidrike. Përmendim kufizimet territoriale në rrjedhat e poshtme lumore të Shkumbinit (veri) dhe Semanit (në jug), të cilët paraqiten të meandrueshëm; përroin e Lushnjës dhe lagunën e Karavastasë (vetëm bashkia Divjakë).



Fig. 4. Lumi Seman, qershor 2021, Foto: J. Dhimitri, Xh. Zdrava, Çukas i Vjetër

Një pjesë e pasurive hidrike natyrore apo artificiale, p.sh. rezervuarët, kanë shërbyer për ujitje gjatë muajve të thatë të verës (2-3 muaj).

Kushtet natyrore të bashkisë së Lushnjës dhe Divjakës janë shumë të mira për zhvillim ekonomik, veçanërisht të ekonomisë bujqësore. Ajo është një nga drejtimet bazë të zhvillimit ekonomik të zonës, e cila ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, në të cilët përmendim: copëtimin e tokës, rënia e prodhimit në disa drithëra, dëmtime por dhe përmirësime të kanalizimeve vaditëse dhe kulluese, çmimet e larta të imputeve bujqësore, konkurrenca nga produkte bujqësore të importuara, ndikimi nga kriza në sektorë të tjerë të ekonomisë etj. (Dhimitri, 2013).

Në fakt, gjatë periudhave të ndryshme historike, këto pasuri janë parë herë si pengesë dhe herë si potenciale zhvillimi, që ka influencuar në vendosjen e popullsisë dhe shtrirjen gjeografike të vendbanimeve. Faktorët kryesorë në shpërndarjen gjeografike të

vendbanimeve mbeten faktorët gjeografike-natyrorë, socio-ekonomikë dhe demografikë.

## 2. Vendbanimet dhe shtrirja e tyre gjeografike në dinamikë kohore

Tiparet socio-ekonomike, demografike, politike, të ndikuara dhe nga karakteristikat natyrore të një hapësire ndikojnë në shtrirjen e përhapjen gjeografike të vendbanimeve dhe përcaktimin e numrit të popullsisë në një zonë si në shkallë lokale, rajonale apo kombëtare.

Pas vitit 1989 popullsia në rrethin e Lushnjës ishte vendosur në 2 qytete dhe 122 fshatra. Harta administrative e saj ka ndryshuar prej vitit 1989 me 4 ndryshime hapësinore, duke u riorganizuar qysh nga viti 2014 në ndarjen e saj në 2 bashki, atë të Lushnjës (1 qytet dhe 85 fshatra) dhe Divjakës, (1 qytet dhe 36 fshatra). (Shih fig.1.)

*a) Në këndvështrimin historik dallohen këto organizime territoriale*

\* Pas shpalljes së Pavarësisë u ruajt struktura e trashëguar e organizimit administrativo-territoriale (*SHEME, Dhimitri, 2013*):

\* “Kanuni i Përgjithshëm i Administratës Civile të Shqipërisë”, 22 nëntor 1913, organizoi territoret ne prefektura dhe nënprefektura. Me “ligjin organik të bashkive”, më 26 nëntor 2021, shtohet elementi “bashki”.

\* më tej, pas 21 janarit 1925, territori i Republikës së Shqipërisë organizohet në prefektura, nënprefektura dhe krahina. Në vitin 1927, nënprefektura e Lushnjës kishte 1 rreth qendër (99 katunde) dhe një krahinë, ajo e Libofshës (54 fshatra)

\*Më 1 shtator 1928 organizimi i ri administrativ territorial u përbë nga 10 njësi të mëdha lokale, u ul numri i prefekturave dhe krahina u zëvendësua me komunë.



Foto 5. Foto e qytetit në vitin 1931 (Burimi: Dhana P., Arsimi dhe Kultura në Myzeqe, Tiranë 2010, f.18)

\*Më 1940- territori ishte i organizuar në prefektura, nënprefektura, bashki, komuna dhe fshatra.

\*Gjatë periudhës së socializmit, Shqipëria përbëhej nga 26 rrethe, 67 qytete, 589 fshatra të bashkuara dhe 2848 fshatra të thjeshta. Në vitin 1991, rrethi i Lushnjës përbëhej nga 1 qytet, 8 lagje qyteti, 22 fshatra të bashkuara dhe 114 fshatra.

\*Më 1992-2000 Shqipëria ndahet në 36 rrethe. Lushnja paraqitet me rrethin e Lushnjës.

\* Më 2001 rrethet u bashkuan në 12 qarqe, 65 bashki, 308 komuna dhe më shumë se 3000 fshatra. Lushnja kishte 2 bashki: bashkinë e Lushnjës dhe Divjakës, 14 komuna dhe 122 fshatra. Në bazë të Ligjit Nr. 8653, dt 31.07.2000 “Mbi ndarjen administrative territoriale”, bashkitë dhe komunat përfaqësojnë ndarjen e parë të qeverisjes vendore. Qarku i Fierit përfaqëson nivelin e dytë të qeverisjes vendore.

\* Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (Fletore Zyrtare, Nr. 137, 2014), e vendos Lushnjën në organizimin e sotëm gjeohapësinor, përmendur më sipër.

*b) Reflektime gjeohapësinore për vendbanimet në rrethin e Lushnjës para vitit 1990*

\* Shkëputje të pjesshme të hapësirës territoriale të Libofshës dhe disa fshatrave të nënprefekturës së Lushnjës dhe kalimi i tyre në rrethin e Fierit (v. 1950).

\* Shkëputja e fshatrave Kosovë e Madhe dhe Çërragë dhe kalimi i tyre në rrethin e Elbasanit (v.1976).

\* Krijimi i vendbanimit të ri Pluk (v. 1976). Më herët ai ishte pjesë e qytetit të Lushnjës.

\* Krijimi i fshatrave të bashkuara dhe ndërmarrjeve bujqësore si njësi ekonomike dhe njësi hapësinore. Deri në v. 1992 në rrethin e Lushnjës kishte 6 ndërmarrje bujqësore dhe 18 fshatra të bashkuara, 9114 fshatra.

*c) Reflektime gjeohapësinore për vendbanimet në rrethin e Lushnjës pas vitit 1990*

\*. Kthimi i Divjakës në zonë urbane (v.1995);

\*. Përfshirja e Karbunarës së Poshtme dhe Savrës në zonën urbane të qytetit të Lushnjës;

\*. Krijimi i disa vendbanimeve të reja: fshati Adriatik (komuna Remas, v. 1997); fshati Kupas (komuna Hyzgjokaj, krijuar duke u ndarë nga fshati Hyzgjokaj, v. 1996); fshati Hallvaxhias (bashkia Divjakë, krijuar duke u ndarë nga fshati Gërmenj i Madh, v. 1996); fshati DushkCan (bashkia Divjakë, krijuar, duke u ndarë nga fshati Bregas-Dushk, v. 1996); fshati Tre Urat (komuna Grabian, është krijuar si fshat i ri; fshat i ri është dhe fshati Stravec, 2001); fshati Matjan (komuna Ballagat, krijuar nga ndarja e fshatit Garunjas pas v. 2002); fshati Golem i Vogël (komuna Golem, fshati Golem ndahet në Golem i Madh dhe Golem i Vogël, pas v. 2002); fshati Babunjë e Re (komuna Gradishtë, fshati Babunjë ndahet në fshatrat Babunjë e Re dhe Babunjë e Vjetër, pas v. 2002;

Në vitin 1997<sup>1</sup>, fshati Zharrnec shkëputet nga komuna Remas dhe i bashkohet bashkisë Divjakë. (Dhimitri, 2011). Një pjesë e fshatrave të reja janë krijuar me popullsi të ardhur nga zonat e brendshme të vendit si Kukës (Tre Urat, Stravec), nga Librazhdi, Gramshi (Golem i Vogël).




Fig. 5. Shpërndarja gjeografike e familjeve të ardhura pas 1990 në bashkinë e Lushnjës (Të dhënat tematike deri në 2009). Përpunimi tematik dhe hartografik nga prof. as. sr. J. Dhimitri).

<sup>1</sup> Shënim: Vitet e krijimit të fshatrave të reja janë marrë në vjetarët statistikorë për rrethin e Lushnjës.



Referuar vlerave të sipërfaqes dhe qendrave të banuara llogaritet distanca mesatare e vendbanimeve. Ajo paraqitet e tillë për rrethin e Lushnjës: 2.68 km (1989) dhe 2.59 km (2008), ndërsa për vitin 2022, për bashkinë e Lushnjës kjo vlerë është 2.25 km dhe për bashkinë e Divjakës është 3,15 km.<sup>1</sup> Rrethi i Lushnjës pas viteve 1990 është konsideruar një rreth pritës. Shtimi i numrit të fshatrave si rrjedhojë e lëvizjeve migruese (të të ardhurve), ndarjes së fshatrave ekzistuese, reflekton zvogëlimin e distancës mesatare të vendbanimeve. Krahasuar me distancë mesatare të vendbanimeve për Ultësirën Perëndimore (2.8 km), vendbanimet në bashkinë e Lushnjës paraqiten të vendosura pranë njëri-tjetrit. Kryesisht vendbanimet për të dyja bashkitë e sotme janë pozicionuar rrëzë kodrave, duke u qëndruar larg kënetave të dikurshme dhe më vonë tokave të bonifikuara dhe që u përdoren dhe përdoren në dobi të ekonomisë bujqësore.

Dendësia e vendbanimeve për 100 km<sup>2</sup>, ka lëvizur ndër vite. Ajo paraqitet si 16 vendbanime për 100 km<sup>2</sup> në vitin 1989; në 17.1 vendbanime për 100 km<sup>2</sup> në vitin 2008 dhe 11,9 vendbanime për 100 km<sup>2</sup> në vitin 2022 për bashkinë e Divjakës dhe 23 vendbanime për 100 km<sup>2</sup> në vitin 2022 për bashkinë e Lushnjës. Dendësia e vendbanimeve konsiderohet më e lartë se dendësia e vendbanimeve mesatare për Ultësirën Perëndimore.

*d) Në varësi të relievit dhe shpërndarjes së popullsisë për bashkinë e Lushnjës, dallojmë tri kategori vendbanimesh:*

1) vendbanime rurale të pozicionuara vetëm në reliev kodrinor: Njësia administrative: Ballagat dhe Hyzgjokaj.

2) vendbanime të pozicionuara pjesërisht në reliev kodrinor dhe pjesërisht në reliev fushor: Njësia administrative Karbunarë, Dushk, Golem.

---

<sup>1</sup> Vlerat e treguesit të distancës mesatare të vendbanimeve janë përlllogaritur nga autorët, duke marrë në konsideratë sipërfaqen e bashkive, numrin e vendbanimeve për secilën bashki dhe koeficientin standard = 1.07457.

3) vendbanime të pozicionuara vetëm në reliev fushor: Njësia administrative: Allkaj, Bubullimë, Fiershegan, Kolonjë, Krutje, qyteti i Lushnjës, me Karbunarën dhe Savrën.

Relievi fushor dallohet për numrin më të lartë të vendbanimeve, rrjedhimisht dhe të popullsisë, e cila është e orientuar në zhvillimin e bujqësisë, ndërsa relievi kodrinor paraqet përqendrim më të vogël të popullsisë. Këto relieve krijojnë kushte më favorizuese për zhvillimin e pemëtarisë dhe kërkojnë më shumë përkujdesje ndaj proceseve denuduese dhe degradimit të tokave. Zonat fushore me vlera të vogla të energjisë së relievit nxisin zhvillim intensiv të bujqësisë.

*e) vendbanime fshatare sipas aktivitetit ekonomik që ushtrojnë:*

1) Qendra banimi me aktivitet bujqësor. Këtu përfshihen numri më i madhi i vendbanimeve rurale ku popullsia aktive merret përgjithësisht me bujqësi. Aktiviteti bujqësor shërben si burimi kryesor i të ardhurave të popullsisë. Një pjesë e vogël e popullsisë në këto vendbanime merret me aktivitete të tjera si arsim, punë në shëndetësi, komunikacion, shërbime etj.

2) Qendra banimi me aktivitet të përzier. Popullsia në këto vendbanime merret me aktivitete jashtë bujqësisë, dikur me nxjerrjen e naftës dhe gazit (fshatrat Bubullime, Kolonjë, Divjakë) dhe nxjerrjen dhe përpunimin e mermerit (fshatrat rreth Karbunarës). Zvogëlimi i vëllimit të punës në këto aktivitete i ka orientuar këto vendbanime në shërbime të tjera ose orientimin e tyre drejt kategorisë së vendbanimeve me aktivitet bujqësor.

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar *Shqipëria 2030 (AKPT, 2016, f. 94-95)*, evidentohet se tipologjia e komunave dhe bashkive për bashkinë e Lushnjës përbëhet nga tre tipa: për zonën urbane të Lushnjës, kategorizohet si qendër rajonale e aglomerateve, ndërsa vendbanimet rurale kategorizohen në shumicën e tyre si njësi vendore bujqësore mikse fushore dhe njësi vendore bujqësore fushore.

*f). vendbanime sipas paraqitjes skematike të vendosjes:*

1) *vendbanime lineare kundrejt rrjetit rrugor, lumor etj.* Shumica e vendbanimeve janë të përqendruara pranë rrugëve automobilistike të kategorive të ndryshme, përmendim vendbanimet përgjatë rrugës ndërqytetëse Rrogozhinë, Lushnjë, Fier etj.

2) *vendbanime me shtrirje rrethore: zona urbane e Lushnjës etj.*

3) *vendbanime me strukturë të çrregullt: zona suburbane Savër etj.*

4) *vendbanime të rreshtuara, p.sh. fshatrat e komunës Dushk etj.*

### **Përfundime**

Lushnja e paravitit 2014, por dhe bashkia e sotme, karakterizohet nga një pozitë gjeografike e cila ka favorizuar një jetesë të përshtatshme për popullsinë vendëse dhe të ardhurit. Popullimi i saj është i hershëm dhe ka vazhdimësi. Ekzistenca dhe përmirësimi i rrjetit rrugor përbën një avantazh në drejtim të sigurimit të perspektivave të zhvillimit, sidomos në drejtim të transportit dhe marketimit.

Kushtet natyrore, si ato klimatike dhe prania e tokave pjellore, relievi i ulët fushor dhe më pak ai kodrinor kanë orientuar shtrirjen gjeohapësinore të vendbanimeve si dhe tipologjinë e tyre të disallojshme, por dhe kundrejt funksionalitetit ekonomik. Ndikimet e zhvillimeve politike, socio-ekonomike dhe avantazhet e cilësive fiziko-gjeografike të Lushnjës kanë ndryshuar organizimin gjeohapësinor të vendbanimeve gjatë dinamikës kohore. Treguesit e distancës mesatare të vendbanimeve dhe të dendësisë së vendbanimeve për 100 km<sup>2</sup>, tregojnë vlera mbi mesataren e vendit për Ultësirën Perëndimore, pra territor i mirëpopulluar. Organizimi hapësinor i këtyre vendbanimeve është i shumëllojshëm, por ruan tokën bujqësore duke

kategorizuar vendbanimet si qendër rajonale e aglomerateve, njësi vendore bujqësore mikse fushore dhe njësi vendore bujqësore fushore.

Studimet e vendbanimeve shoqërohen me studime të karakterit gjeopopullativ demografik të popullsisë që përbën një territor, pasi, siç vëmë re dhe në këtë studim, disa qendra të banuara janë krijuar nga të ardhurit, kryesisht nga zona e Kukësit, Gramshit dhe Librazhdit (Fig. 5). Qëndrueshmëria e karakteristikave të tilla demografike dhe përmirësimi i tyre në favor të popullimit të këtyre zonave faktorizohet me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, modernizimin e infrastrukturës arsimore, shëndetësore, mbështetjen financiare të bizneseve prodhuese dhe përpunuese, me qëllim që fitimet të rriten e të mbeten brenda komuniteteve të njësive vendore.

### Literatura

- AKPT, (2016), Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030, f. 94-95.
- Arsimi dhe Kultura në Myzeqe, Tiranë 2010, f.19.
- Bërzholi, A., Mecaj, B., “Organizimi administrative-tokësor në Shqipëri (Retrospektivë)”.
- Dhana P., (2010), Arsimi dhe Kultura në Myzeqe, Tiranë
- Dhimitri, J. (2013). Geographical assessments on the relationships between agrarian economy and population after 1990s (case study in Albania). In conference proceedings, Vol. 2 (p. 33).
- Dhimitri, J., (2008). Ecuria e profilit industrial-ekonomik të qytetit të Lushnjës dhe organizimi hapësinor i sotëm, Studime albanologjike, gjeografi, XIII, 4, f. 213.
- Dhimitri, J., (2009), Pasuritë minerale në gjeohapësirën e rrethit të Lushnjës dhe shfrytëzimi i tyre, Kërkime Universitare, Nr.25, f.97.
- Dhimitri, J., (2012), Pasoja gjeohapësinore të të ardhurve nga lëvizjet migruese në zonat fushore, raste në rrethin e Lushnjës, Standardet e zhvillimeve rajonale në Shqipëri dhe eksperiencia gjermane, Friedrich Erbert Stiftung. Tiranë, f. 201.
- Dhimitri, J., Sinani, A., Todi, J., (2015), The landscape of Divjake-Karavasta National Park in information among youth, Agriculture and Agricultural

Science Procedia 4 (2015) 158 – 166 DOI: 10.1016/J.AASPRO.2015.03.019, aksesuar më, 28.03.2022

Grup autorësh, (1982), Gjeologjia e përgjithshme, f.139.

Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë”, (Fletore Zyrtare, Nr. 137, 2014 Ligjit Nr. 8653, dt 31.07.2000, “Mbi ndarjen administrativo-territoriale”.

Pumo, E., Krutaj, F., Lamani, F., Gruda, Gj. Kabo, M., Demiri, M., Mecaj, N., Pano, N., Qirjazi, Jaho, P., Sala, S., Aliaj, S., Spaho, Sh., Melo, Sh., V., (1990), Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Vëllimi 1. Tiranë, Qendra e studimeve gjeografike. f. 72, 200, 272.

Qiriazhi, P., (2001) Gjeografia Fizike e Shqipërisë, f. 12, 22, Tiranë. 68.70

Sheme, S., Dhimitri, J., (2013), Riorganizimi administrative-territorial instrument për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe humane, Studime Albanologjike, IV, 2013/4, f. 62-63.

Sulstarova, S., Kociaj, S., Aliaj, Sh., (1980) Akademia e Shkencave të RSH, Qendra sizmologjike (rajonizimi sizmik i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë), Tiranë. f. 48, 49, 41. 42

Ziu, T., (2004), Revista “Myzeqeja”, nr. 1 dhjetor 2004, f.4

**Dr. Mirela Tase<sup>1</sup>**

**Dr. Manjola Xhaferri<sup>2</sup>**

## **VLERËSIMI I POTENCIALEVE NATYRORE DHE KULTURORE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË ZONËN E SHËNGJERGJIT**

### **Abstrakt**

Vendi ynë po spikat gjithnjë e më tepër si një vend me destinacione tepër tërheqëse, me bukuri natyrore, arkeologjike e kulturore. Shëngjergji bën pjesë te destinacionet atraktive, me bukuri të rralla natyrore, histori e kulturë të pasur. Shëngjergji ndodhet në lindje të Tiranës rreth 40 km larg kryeqytetit. Disa vjet më parë ishte komunë më vete, ndërsa sot është njësi administrative e përfshirë në bashkinë e Tiranës. Vitet e fundit Shëngjergji (si pjesë dhe e projektit 100 fshatrat turistike) është bërë destinacion i dashur e mjaft i kërkuar për turistët shqiptarë e të huaj, të cilët shijojnë bukuritë natyrore, kulturore dhe historike, si dhe mundësinë për të bërë hiking, kamping, por nuk mund të harrojmë të përmendim edhe gatimet e shijshme tradicionale të kësaj zone.

Ky punim bazohet në vlerësimin e potencialeve të Shëngjergjit, i cili përbën një atraksion turistik shumë të rëndësishëm për zonën. Transformimi i tij dhe kthimi i banorëve përbën një fakt premtues për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Punimi është me karakter narrativ, pasi përshkruan, analizon dhe vlerëson potencialin turistik natyror e kulturor të zonës, si dhe cilësor sepse ky punim përfshin anketa të realizuara me banorët vendës.

---

<sup>1</sup>Dr. Mirela Tase, Departamenti i Turizmit, Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, E-mail: mirelatase@hotmail.com

<sup>2</sup>Dr. Manjola Xhaferri, Departamenti i Shkencave Politike, Fakulteti Juridik, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, E-mail: mxhaferri@yahoo.com

*Fjalë çelës: Turizëm i qëndrueshëm, potenciale natyrore, potenciale kulturore,*

### **Abstract**

Our country is becoming more and more frequented as a country with very attractive destinations, with natural beauty, archeological and cultural. Shwngjergji is one of the attractive destinations, with rare natural beauties and history of wealth culture. Shwngjergji is located in the east of Tirana about 40 km from the capital city. A few years ago, it was a separate from municipality, while today it is an administrative unit included in the municipality of Tirana. Tourism is a key factor of Shwngjergji, and has served as an advertiser and representative of the cultures, knowledge, special traditions and natural beauties that this country offers. In recent years Shwngjergji as a part of project 100 villages has become a loved and sought-after destination for many Albanian and foreign tourists who enjoyed the natural beauty, cultural and historical side, the opportunity to go hiking, camping but we can't forget to mention the delicious traditional dishes of this country.

This paper is based on the evaluation of the potentials of Shwngjergji destination, which is a very important tourist attraction for the area. Its transformation and return of inhabitants are a promising fact for the development of sustainable tourism

The paper is descriptive, because describe, analyze and evaluate the natural and cultural potential of Shwngjergji. The research based on quantitative and qualitative questionnaires The paper is essential, as for its realization based on extensive literature of Albanian authors and quality because this paper has been used interviews conducted with local residents in Shwngjergji destination

*Keywords: Sustainable tourism, natural potentials cultural potentials*

### **I. Hyrje**


Turizmi është një sektor prioritar i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror edhe për ekonominë e Shqipërisë. Ai gjeneron të ardhura më të larta edhe në një sërë aktiviteteve ekonomike të lidhura me të, si dhe garanton punësim dhe mundësi vetëpunësimi në vend. Me pasuri të veçanta natyrore, historike dhe me një pasuri të trashëgimisë kulturore, Shqipëria ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik, i cili do të krijojë një identitet më të njohur për turizmin shqiptar, do të përmirësojë

konkurrencën dhe përmirësojë pozicionin e Shqipërisë në tregun turistik kombëtar, rajonal, europian dhe global. Dekadën e fundit po shihet një rritje e interesit të turistëve vendës dhe të huaj për të eksploruar destinacione ku ndërthuret më së miri kultura, natyra së bashku me gastronominë. Prandaj punimi ynë ka në fokus vlerësimin e këtyre potencialeve në funksion të zhvillimit të turizmit në njësinë administrative të Shëngjergjit. Ky destinacion është pjesë dhe e projektit *100 fshatrat*, projektuar nga qeveria në vitin 2017.

## II. Hapësira e studimit

Shëngjergji ndodhet në lindje të Tiranës, rreth 40 km larg kryeqytetit. Disa vjet më parë ishte komunë më vete, ndërsa sot është njësi administrative e përfshirë në bashkinë e Tiranës. Në territorin e saj bëjnë pjesë edhe disa fshatra të tjera si: Shënmëria (Burimasi), Biza, Derja, Domja e malit, Façeshi, Fagu, Parpunja, Ura, Vakumona, Vërria dhe Shëngjergji. Shëngjergji ka një sipërfaqe 206.3 km<sup>2</sup>.

Në këtë sipërfaqe, sipas drejtorisë së përgjithshme të gjendjes civile gjenden 2 541 banorë (*Bashkia Tiranë, 2020*). Mosha mesatare është 38 vjeç dhe 48.30% janë femra dhe 52% janë meshkuj.



Grafik 1. Raporti meshkuj/femra, realizuar nga Mirela Tase, 2021  
Burimi: Bashkia Tiranë, 2021

Shëngjergji ka një reliev malor, ku kuota më e ulët është shtrati i lumit Erzen dhe kuota më e lartë është Mali me Gropa. Klima



dhe elementet e saj luajnë rol të rëndësishëm në popullimin e një hapësire të caktuar. Ato ndikojnë drejtpërsëdrejti në veprimtarinë social-ekonomike dhe sigurimin e të mirave materiale të njerëzve që ndodhen në të.

Klima e zonës së marrë në studim është mesdhetare- kodrinore dhe paramalore, me dimër të ftohtë e të lagësht dhe verë të ngrohtë e të thatë.

*Kullotat* zënë rreth 40% të sipërfaqes. Terreni i kullotave ka një florë mjaft të pasur dhe fshatrat e krahinës së Shëngjergjit e kanë shfrytëzuar për të mbajtur blegtorinë. Kullotat në fshatin e Shëngjergjit zënë territorin më të madh të gjithë krahinës.

Një pjesë të relievit e zënë edhe pyjet. Drunjtë jofrutore të masiveve pyjore, kryesisht drunj ahu gjenden në veri- lindje, lindje, juglindje, e deri në lartësinë e malit të Fagut. Llojet kryesore të drunjve që përbëjnë këto pyje janë 85% ah, 3% bredh, 4% pisha dhe pjesën tjetër e zënë drurë të ndryshëm. Në juglindje të Shëngjergjit ndodhen pyjet e Shtogut, Batrës, Shpellzës, Këslushit (*Shtepani, 2003*).



Foto 1. Pamje nga kullotat (Mirela Tase, maj 2021)

### III. Metoda

Punimi është me karakter përshkrues pasi përshkruan, analizon dhe vlerëson potencialin turistik natyror e kulturor të Shëngjergjit. Kërkimet janë të karakterit sasior dhe cilësor.

*Së pari*, punimi është sasior pasi për realizimin e tij është shfrytëzuar një literaturë e gjerë e autorëve shqiptarë. Veç këtyre janë shfrytëzuar edhe burime të ndryshme si: revista e shkrime të tjera të shtypit të periudhave të ndryshme, të cilat japin informacione rreth zhvillimit të zonës së Shëngjergjit si dhe historikut të popullimit të tij. Për të ilustruar janë shfrytëzuar edhe burime të tjera si: fotografi të realizuara në terren.

*Së dyti*, kemi realizuar anketa për probleme të ndryshme, sidomos për ato që kanë të bëjnë me përdorimin e potencialeve natyrore dhe kulturore që ofron zona në funksion të turizmit. Ky punim përfshin 50 anketa të realizuara me banorët vendës në Shëngjergj. Të anketuarit kanë qenë persona të rastësishëm. Punimi është i ndarë në dy variabla kryesore, pjesën natyrore dhe atë kulturore, të cilët kanë lidhje mes tyre. Më pas pyetësorët përbëhen nga pyetje të shkallëzuara.

#### **IV. Gjetjet dhe rezultatet**

Në bazë të gjetjeve në terren tregohet se potencialet natyrore e ato kulturore konsiderohen si faktorë të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit në këtë zonë, pa lënë dhe historinë e traditat e saj. Në bazë të anketave rezulton se 80 % e përgjigjeve tregon se kjo zonë mund të shfrytëzohet për turizëm gjatë gjithë vitit, si në pranverë-verë, ku mund të eksplorohet zona, të bëhet kamping, hiking ose thjesht të qëndrosh në natyrë, po ashtu në vjeshtë dhe në dimër kur vendi zbardhet nga dëbora. Turistët vendës preferojnë të qëndrojnë kryesisht një natë ose dy, ndërsa turistët e huaj qëndrojnë më shumë. Banorët e zonës kërkojnë më shumë nga strukturat shtetërore si: *dhënia e granteve, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete për promovimin e zonës.*

##### **1. Historiku i zonës**

Duke iu referuar dëshmimeve arkeologjike në rrethin e Tiranës, mendohet se kushtet gjeo-klimaterike të favorshme për banim,

kanë bërë të mundur banimin e saj qysh në fillimet e shoqërisë njerëzore. Këtë e dëshmojnë gjetjet arkeologjike rrëzë Dajtit dhe në Shpellën e Pëllumbasit, që i takojnë epokës së paleolitit (gurit të vjetër). Kjo trevë vazhdoi të banohej gjatë epokës së gurit të ri, epokës së metaleve dhe në vazhdimësi gjatë tërë epokës historike. Dëshmi e këtyre vendbanimeve janë kalatë, rrënojat e monumenteve të ndryshme, të cilat janë ruajtur deri në ditët tona. Dëshmi të tjera më të besueshme janë gjetjet në rrëzën e Dajtit nga geologu austriak B. Richthofen, i cili zbuloi në afërsi të gurores së sotme të Dajtit disa vegla stralli që i përkasin epokës së paleolitit të lartë (*Xhafferri, 2013*).

Gjurmët e vendbanimeve të vjetra vazhdojnë deri rrëzë Malit me Gropa, te vendi i quajtur nga banorët si *Qyteti i trimave*. Janë hedhur disa hipoteza pse është quajtur *Qyteti i trimave*, ku një nga hipotezat është që në këtë vend qëndronte Muzaka i Angjelinës, djali i Vladan Arianitit dhe i Angjelina Kastriotit dhe nip i Skënderbeut. Akoma është një lagje që quhet *lagja e trimave* dhe banon vetëm një familje sepse pjesa tjetër e lagjes është shpërngulur drejt qyteteve. Sipas banorëve këtu janë gjetur qeramikë e tjegulla ndër vite.

Pas vitit 1600, kjo zonë figuron me emrin Shëngjergji. Këtë emër duhet ta ketë marrë gjatë mesjetës, me përhapjen e krishterimit në territorin e Shqipërisë. Gërmimet arkeologjike në zonën e sotme të Shëngjergjit kanë zbuluar shumë kisha mesjetare në trajtë rrënoje. Ndoshta, emrat e fshatrave Shëngjergj, Shënmëri, Shëngjin etj., në zonë lidhen pikërisht me emrat e kishave që mund të kenë ekzistuar në këtë territor gjatë mesjetës, ku u ruajt toponimia pas shkatërrimit të kishave. Me emrat e kishave mesjetare u quajtën fshatrat e zonës së sotme të Tiranës, por u ruajt edhe toponimimi “Tomadhe” ose “Tame Dea”.

## 2. Destinacionet kulturore dhe historike të zonës

Pranë vijës kufitare midis dy fshatrave Fag dhe Shëngjin, në majën me lartësi 800 m, ndodhen rrënojat e një kalaje shumë të vjetër. Në toponiminë e banorëve të zonës, kalaja njihet me disa emra si: e Koslushit, e Skënderbeut, e Shëngjinit, e Fagut etj. Ndoshta, emrat e shumtë me të cilët njihet kjo kala vijnë nga sunduesit e shumtë që e kanë pasur nën zotërim gjatë kohërave të ndryshme dhe e kanë riparuar. Në ditët e sotme janë bërë pak gërmime arkeologjike në këtë kala për të përcaktuar më qartë planimetrinë e saj dhe kur është ndërtuar ajo. Sipas ekspeditave arkeologjike të ndërmarra në vitin 1965, *kalaja e Shëngjinit* në Shëngjergj të Tiranës daton rreth shek. V, ndoshta nga bizantinët. Ajo është ndërtuar në kohën e dyndjeve barbare, me qëllim që të mbronte zonën nga këto sulme (*Karaiskaj, 1981*). Kalaja në Shëngjergj të Tiranës është përdorur dhe riparuar gjatë shekujve nga sundimtarë të ndryshëm, edhe nga vetë Skënderbeu. Ajo kishte një rëndësi strategjike për të mbrojtur e kontrolluar zonën e rrugët tregtare që kalonin në atë zonë. Në kala shkohet duke u ngjitur nga fshati Shëngjin, por rruga është e pahapur nga shkurret dhe shumë e përpjetë dhe zgjat 60-90 minuta. Edhe sot kjo kala është e paaksesueshme nga turistët e sotëm. Ajo është lënë pa përkujdesje dhe nën mëshirën e forcave natyrore që e dëmtojnë çdo ditë.



Foto 2. Vendndodhja e Kalasë së Shëngjinit në Shëngjergj (Websit , Bashkia e Tiranës, 2020)

**2.1 Vendi i Shenjtë dhe Varri i Vjetër në Shëngjergj të Tiranës.**  
 "Shpella e Mirë" ose ndryshe "Shpella e Shëngjergjit", ndodhet në fshatin Besh-Livadh të Tiranës. Ajo gjendet në malin e Brrarit në pjesën verilindore të tij. Shpella është pozicionuar në një lartësi të konsiderueshme nga fshati Besh-Livadh. Ajo është një shpellë me thellësi mbi 150 m dhe me lartësi të ndryshueshme që varion nga 2 m deri në 10 m. Sipas gojëdhënave, shpella ka shërbyer dhe shërben si një vend pagan ku bëhen rituale fetare. Quhet "e mirë" se uji që pikon në të ka fuqi shëruese dhe magjike. Në fillim të shpellës janë vendosur disa enë të cilat mbushen nga uji që pikon nga lart. Njerëzit shkojnë në të për t'u shëruar nga sëmundje, nga "syri i keq" etj., duke pirë nga uji i mbledhur në enë ose duke u larë me atë ujë. Ditën e Shën Gjergjit (6 qershor), banorë të zonës përreth shkojnë dhe kalojnë një natë në shpellë dhe bëjnë kurban e pjekin mish në zjarr. Në këtë shpellë ka një sërë besimesh që praktikohen në të njëjtin vend.

Në këtë shpellë organizohet festa e Shën Gjergjit. Kjo është një festë mbarëballkanike, që te shqiptarët festohet nga të gjitha besimet, sipas kalendarit të vjetër Julian më 23 prill. Në një pjesë të Shqipërisë së Veriut dhe në Kosovë ajo zhvillohet sipas kalendarit Gregorian dhe festohet më 5 maj (Muca, 2004). Në Shqipërinë e Mesme, në zonën e Tiranës, kjo festë festohet më 6 qershor. Festa e Shën Gjergjit në zona të ndryshme ka përvetësuar dhe shumë nga ceremonitë që më parë i përkisnin Ditës së Verës, duke u kthyer në një festë kryesisht familjare, lagjeje dhe më pak në bazë fshati. Në zonën e Tiranës, praktikisht në fshatin që mban të njëjtin emër Shën Gjergj, ajo është një festë me një pjesëmarrje më të gjerë. Kjo festë organizohet në majën e malit ku ndodhet "Shpella e mirë".

## 2.2 Xhamia e Shëngjergjit

Një ndër atraksionet e zonës së Shëngjergjit janë edhe destinacionet religjioze të zonës. Një ndër to janë rrënojat e xhamisë në Urë. Kjo xhami është ndërtuar rreth viteve 1772-1776. Si shumë objekte të tjera fetare, në vitin 1967 edhe kjo xhami u shkatërrua nga shteti komunist që vendosi ateizmin në Shqipëri. Sot ajo është një atraksion turistik pak i shfrytëzuar për zonën dhe nuk është ende në gjendje të presë vizitorët apo grupet turistike (Meksi, 2015).

## 2.3 Shkolla e parë në gjuhën shqipe në Shëngjergj të Tiranës

Mësimi i gjuhës shqipe në Shëngjergj të Tiranës ka filluar para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Këtë fakt e përforcojnë shumë dëshmi të cilat hedhin dritë mbi kohën ku filloi mësimi në gjuhën shqipe. Ndërsa shkolla e parë shqipe (ilegale) ka filluar në fund të vitit 1911, me ardhjen në Shëngjergj të mësuesit Ramiz Hatibi. Gjithçka ishte e përgatitur dhe e studiuar mirë, që te justifikimi tek autoritetet se ishte hoxhë dhe se do t'u mësonte fëmijëve të Shëngjergjit turqishten dhe deri te mësimi i shqipes në fshehtësi të plotë (Pepo, 1981). Mësuesi tjetër që ka dhënë mësim në Shëngjergj është Cen Bylyku. Ai ka shkruar në ato vite një material dyfaqësh, ku thotë se: “Në Shëngjergj kam qenë dy herë, si mësues kam shkuar në vitin 1912 dhe në vitin 1917. Kërkesa e banorëve të Shëngjergjit për konvikt”. Në një artikull të botuar në gazetën “Telegraf” të 11 korrikut 1928 thuhet se kryepërqësia e krahinës së Shëngjergjit i bëri një kërkesë Ministrisë së Arsimit për hapjen e një konvikti në qendrën e Shëngjergjit.



Foto 3. Vendi ku u ndërtua shkolla e parë në gjuhën shqipe në Shëngjergj (Manjola Xhaferri, Maj 2021)

## 2. Destinacionet natyrore të zonës

Zona e Shëngjergjit është e bekuar nga aspekti natyror. Në të gjejmë atraksione të shumta, por një nga atraksionet kryesore që duhet të vizitohet në Shëngjergj është ujëvara e *Shën Pjetrit* që gjendet me fshatin Shëngjin.



Foto 4. Ujëvara e Shën Pjetrit (Mirela Tase në ekspeditën me studentët, prill 2020)

Uji i ujëvarës rrjedh nëpër shkëmbinj dhe vjen nga Mali me Gropa ka një lartësi prej 30 metrash. Për të shkuar tek ujëvara

mjafton të ngjitesh rreth 20 minuta, ku në buzë të rrugës ndodhet një tabelë e drunjtë për të na orientuar shtegun ku do të ngjitemi, gjithashtu ka dhe gurë të shumtë orientues deri në momentin që afrohemi tek ujëvara. Shkëmbinjtë e Shën Pjetrit janë shtresëzore dhe mbizotërohen nga një ngjyrë e kuqe, duke i dhënë në këtë mënyrë një pamje fantastike, duke u konsideruar si një nga bukuritë natyrore të Shëngjergjit.

**3.1 Liqeni i lepurit**, ky burim uji i karakterizuar nga një ngjyrë e gjelbër rrethohet nga natyra e mrekullueshme me male, pisha të larta, një nga bukuritë më mbresëlënëse të Shëngjergjit. Preferohet për hiking, kamping madje edhe për të gjithë ata që adhurojnë sportet e ngjitjet me biçikletë në terrene të vështira.

**3.2** Në këtë zonë ka shumë *kroje e çezma* dhe pjesa më e madhe e tyre gjenden në pjesën lindore të zonës. Rrjedhja e këtyre krojeve në formë rrëkesh dhe përrenjsh është me drejtim nga lindja në perëndim. Disa nga krojet që mund të përmendim janë:

- Kroi i Kusarit i cili ndodhet në kufi midis Shëngjergjit dhe Martaneshit.
- Kroi i Sanxhakut, ka pak ujë, por nga topografët italianë që punonin këtu në kohën e Zogut është cilësuar si një nga burimet më të mira të kësaj zone.
- Kroi i Zi, buron nga një territor që karakterizohet nga gurë të zinj. Ka shumë ujë, por nuk përdoret për t'u pirë (Shtepani, 2003)
- Kroi i Manishit, mendohet ta ketë marrë emrin në nder të Gjon e Pal Maneshit, gjeneral i heroit tonë kombëtar, Skënderbeut.

#### **4. Zhvillimi i turizmit në zonën e Shëngjergjit**

Projekti *100 fshatrat* dhe përfshirja e fshatit Shëngjergj në këtë projekt i ka dhënë një impuls zhvillimit ekonomik të zonës dhe ka



rritur optimizmin për investime të reja. Objektivat e programit kanë si synim:

a) *Përmirësimin e infrastrukturës publike (mbështetja për infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/urbane, infrastrukturë komunitare, shërbime publike, infrastruktura mjedisore, turistike, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra multifunksionale komunitare, peizazhi mjedisor etj.)*

b) *Zhvillim ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investime në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbime të tjera ekonomiko-financiare etj. Mbështetja për inkubatorë të produkteve rurale tradicionale, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transporti, panair dhe festat lokale etj.)*

c) *Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat etj.)*

Por kohët e fundit, falë natyrës së mrekullueshme ka marrë zhvillim turizmi, ndërtimi i bujtinave, bareve e restoranteve. Një nga perimet kryesore për të cilën njihet Shëngjergji është domatja. Këtu zhvillohet edhe festa tradicionale e domates. *Domate Fest* është një panair ku banorët e zonës dhe bizneset prezantojnë pjatat e tyre në mes të gjelbërimit. Domatja e Shëngjergjit njihet ndryshe edhe si domatja e lartësive dhe është tërësisht organike.

Të gjitha pikat e sipërpërmendura të programit kanë sjellë zhvillim dhe kanë bërë që të rikthehen për të investuar edhe banorët të cilët kanë vite të larguar nga fshati Shëngjergj.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe dhënia e granteve nga shteti i ka sjellë zonës një tjetër perspektivë. Nëse deri para pak vitesh shumë pak e njihnin kur përmendej emri Shëngjergj,

sot është shndërruar në një nga destinacionet më të bukura që duhet vizituar në Tiranë.

### **Diskutim**

Turizmi duhet të zhvillohet në atë mënyrë që të sigurojë shfrytëzimin racional të resurseve, të respektohen vlerat kulturore e të ruhen vlerat autentike të mjediseve të caktuara.

Nga anketat me banorët e kësaj zone u panë disa problematika që sigurisht konsiderohen si nevojë e detyrë jo vetëm për pushtetin vendor, por dhe për komunitetin për të nxitur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm në të ardhmen.

*Infrastruktura.* Rruga në Shëngjergj ka dukshëm ndryshim në krahasim me vitet e tjera, por ka akoma nevojë për përmirësime në zona të caktuara, gjithashtu ndriçimi është një element që mungon.

*Mungesa e kapaciteteve akomoduese.* Sado që në vitet e fundit është shtuar numri i bujtinave në zonë, sërish mbeten të pakta për të mirëpritur dhe akomoduar një numër më të madh turistësh vendës e të huaj.

*Personel i pakualifikuar dhe i patrajnuar* në sektorin e turizmit.

*Mbulimi jo i mirë* nga ana e kompanive celulare dhe *mungesa e internetit* në zona më të thella të Shëngjergjit.

*Mungesa e informacionit* Për këtë arsye duhet të këtë një info-point funksional në fshat dhe përmirësimi i të dhënave që hidhen në internet në lidhje me fshatin.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Krahina e Shëngjergjit, kjo mrekulli e fshehur në malësinë e Tiranës zotëron potenciale të shumta kulturore e natyrore. Të gjitha këto potenciale shërbejnë në njohjen dhe zhvillimin e zonës, si dhe kthimin në një destinacion turistik tepër të vizituar. *Turizmi malor* do të sjellë rritjen e të ardhurave të banorët e zonës me anë

të blerjes së produkteve nga vizitorët, frekuentimin e bareve dhe restoranteve, qëndrimin në bujtinat e tyre etj. *Potenciali kulturor dhe historia* që përmban zona shihen si mundësi për të promovuar vlerat e krahinës së Shëngjergjit, duke ndikuar në rritjen e numrit të turistëve vendës e të huaj.

*Për zhvillimin e mëtejshëm të zonës mendoj se është e nevojshme të:*

- ❖ Jepet informacioni i duhur për zonën nëpërmjet medieve online, info-pointeve, broshurave e revistave.
- ❖ Të ketë më shumë investime dhe vëmendje nga bashkia.
- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës turistike e shoqëruar kjo dhe me sinjalistikën rrugore.
- ❖ Përmirësimi i shërbimeve turistike.
- ❖ Më shumë persona të kualifikuar në dhënien e shërbimit të turisti.
- ❖ Rritja e kapaciteteve akomoduese për pritjen e një numri më të madh turistësh.

## Literatura

Bashkia Tiranë, (2020), URL: <https://tirana.al/pika-interesi/kalaja-e-shëngjergjit>

<https://www.tirana.al/njësiaadministrative/shëngjergj/info> (Aksesuar më 20.1.2022)

Karaiskaj, GJ., (1981). “Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri”, Tiranë, 8 Nëntori

Meksi, A., (2015). “Xhamitë e Shqipërisë, Historia, Arkitektura (shekulli XV-XIX)”, Tiranë, AIITC

Ministria e Bujqësisë, 2017, URL: [https://bujqësia.gov.al/programi-i-integruar-për-zhvillimin-rural\\_-programi-i-100-fshatrave-2/](https://bujqësia.gov.al/programi-i-integruar-për-zhvillimin-rural_-programi-i-100-fshatrave-2/) (Aksesuar më 30.12.2021)

Muça, S., (2004), “Vendet e Shenjta të pelegrinazhit në Shqipëri, Candavia, nr. 4, Tiranë, Instituti i Arkeologjisë

Open Data, (2020), URL: <https://opendata.tirana.al/?q=sh%C3%Shëngjergj> (Aksesuar më 30.1.2021)

Qarku i Tiranës, (2020), URL: <https://ëëë.shqipëria.com/Qarku-i-Tiranës-shkolla-e-parë-shqipe-ne-Shëngjergj-si-i-hapi-dyert-xhamia-për-nxënësit.19130> (Aksesuar më 20.08.2021)

Shtepani, Rr., (2003) “Shëngjergji, krahina e Tomadhesë në qarkun e Tiranës”, Mediaprint, Tiranë

Xhaferri, M., (2013), “Aspekte të mënyrës së jetesës në rrethinat e Tiranës (Fillimi i shek. XX- shek. XXI)” studim doktoraturë, Qendra e Studimeve Albanologjike, <http://asa.edu.al/images/Manjola%20Xhaferri.pdf>

Xhaferri, M., Tase, M., (2012), Environment in Tirana and its pollution as a result of urban development after 90 years, Journal of, “Environmental Science and Engineering” (USA), 8(1), TT, f. 85-91

Edlir Dervishi<sup>1</sup>

## EKONOMIA E VENDBANIMEVE TË BASHKISË SË BELSHIT

### Abstrakt

Territori i bashkisë së Belshit ka kushte të mira klimatike për zhvillimin e bujqësisë, sidomos të kulturave tradicionale: duhan, vreshta, bimë mjekësore dhe së fundmi, ullishtat. Duke qenë një bashki ku 70% e popullsisë merret me bujqësi, popullsia e zonës ka pak alternativa. Po cilat janë problemet e fermerit të zonës?

Problemi i copëzimit të tokës në disa ngastra sipas Ligjit 7501, është pengesa kryesore. Kjo ndarje detyrimisht rrit kostot e prodhimit, pengon mekanizimin dhe investimet afatgjata. Mungesa e sistemit vaditës është shkak i tjetër i rëndësishëm i braktisjes së bujqësisë. Nëse do të funksiononte, tokës i merren

të paktën dy prodhime. Po kështu prodhimi i duhanit, ullirit, vreshtave, rigoanit do të rritej me të paktën 50%. Furnizimi me ujë mund të sigurohet nga liqenet që zënë 640 hektarë sipërfaqe, me një vëllim prej 26 milionë metër kub ujë. (Plani zhvillimor i bashkisë Belsh). Pikat e grumbullimit janë hallka e dobët e zinxhirit prodhues bujqësor. Ato mungojnë krejtësisht. Duhet politika qendrore nxitëse në këtë drejtim. Duke qenë se pjesa dërrmuese e popullsisë së zonës merret me bujqësi, duhen rritur investimet në këtë sektor, si p.sh.:

-Përshpejtimi i procesit të legalizimit të tokave bujqësore.

-Investimet në sistemin vaditës, që do rriste me të paktën 50% rendimentin e prodhimeve.

-Mekanizma fiskalë lehtësues për futjen e makinerive bujqësore dhe plehrave kimikë.

-Mundësia e rihapjes së shkollave me profil bujqësor.

---

<sup>1</sup> Mësues specialist i Historisë dhe Gjeografisë, Zyra Vendore Arsimore Belsh, E-mail: [edi\\_dervishi@yahoo.com](mailto:edi_dervishi@yahoo.com)

*-Trajnime me fermerët e zonës për aplikimin e metodave të bujqësisë intensive, sidomos për kulturat tradicionale (duhan, vreshta, rigon, ullinj).*

**Fjalë çelës:** *Belsh, bujqësi, sistem vaditës, Ligji 7501, pika grumbullimi.*

### **Abstract**

Being one where 70% of the family reunification with agriculture, the population of the areas has few alternatives. But what are the problems of the area farmer?

The problem of land fragmentation in some plots, according to Law 7501, is the main obstacle. Lack of irrigation system is another reason for abandoning agriculture! If it works, all crops are taken from the land. Water supply can be provided from the lakes, which occupy an area of 640 hectares, with a volume of 26 million cubic meters of water. (*Belsh municipality development plan*). Collection points are the weak link of the agriculture production chain. They lack. There are needed incentives policies in this direction. However, the vast majority of the area's population will continue to rely on agriculture. Therefore, investments in this sector should be increased, such as:

Accelerating the process of legalization of agricultural lands.

-Investments in the irrigation system, which would increase by at least 50% the yield of products.

-Fiscal facilitation mechanisms for the introduction of agricultural machinery and chemical fertilizers. Possibility of reopening schools with agricultural profile.

-Training with farmers in the area, for the application of intensive farming methods, especially for traditional crops (tobacco, vineyards, oregano, olives).

**Keywords:** *Belsh, agriculture, irrigation system, Law 7501, oregano, collection point.*

## **I. HYRJE**

Me Reformën Territoriale të vitit 2014, pjesa më e madhe e trevës së Dumresë u përfshi në një bashki të re, bashkinë e Belshit. Para këtij viti, Belshi dhe fshatrat e tij ishin pjesë e rrethit të Elbasanit. Territori i bashkisë së Belshit përfshin një sipërfaqe rreth 196.44 km<sup>2</sup>, me një relief kryesisht kodrinor dhe ku bien në sy liqenet e shumta karstike. Ai shtrihet në Rajonin Perëndimor të Republikës së Shqipërisë.

Gërmimet arkeologjike të kryera nga arkeologu i njohur *Neritan Ceka* në vitet '70 të shekullit XX, kryesisht në Malin e Gradishtës, vërtetojnë lashtësinë e kësaj treve. Periudha e bronzit, e hekurit, antikiteti (i vërtetuar së fundmi me gjetjen e një terme romake në fshatin Rrasë) janë kudo të pranishme. Ato janë vazhdimësi hapësinore dhe kohore e siteve të rëndësishme përreth, si Tumat Ilire në fushën e Pazhokut (fshati i Shalës, 9 km në lindje të Belshit), rrugës Egnatia, një segment i së cilës kalonte në aksin Fier-Lushnjë-Dumre-Elbasan.

Klima e territorit të bashkisë së Belshit është tipike mesdhetare kodrinore, me dimër të butë dhe verë të nxehtë dhe të thatë. Numri i ditëve me temperature nën 0 gradë celsius është mjaft i vogël.

Nga aspekti demografik, popullsia e bashkisë po tkurret nga viti në vit. Sipas Regjistrat Civil (2017), në territorin e bashkisë banojnë 32.878 banorë. Ky numër po vjen në ulje për shkak të emigrimit të brendshëm dhe të jashtëm. Sipas Planit Zhvillimor të bashkisë, f. 44, në vitin 2030 popullsia do të ulet në 28.000 banorë.

Sipas INSTAT-it ([nstatgis.gov.al/#/!//prefectures/population/prefpop1](http://nstatgis.gov.al/#/!//prefectures/population/prefpop1)), bashkia e Belshit zë vendin e dytë në shkallë vendi për numrin e të vetëpunësuarve në bujqësi, pas asaj të Xarës. Afro 70% e krahut të aftë të punës merret me punë bujqësore. Pjesa tjetër është e ndarë mes sektorit të shërbimeve dhe pak industri (kryesisht fabrika vaji, mielli, punishte alumini apo druri).

## II. Metoda

Metodologjia e përdorur konsiston në: intervista me fermerë, vizita në vende që lidhen me qëllimin e studimit si ferma bujqësore, agrobiznese, pika të shitjes së plehrave kimike, intervista me anë të kontakteve të drejtpërdrejta në terren, intervista dhe biseda me specialistë dhe ish- specialistë bujqësie.

### III. Gjetjet

Përpara zbatimit të projektit, Belshi mbetej një qytezë thuajse e pashkelur, me pak lëvizje. Liqeni rrethohej nga lokale shërbimesh: kafene, restorante, dyqane të ndërtuara pa kriter. Ndotja dhe ujërat e zeza shiheshin kudo. Sot qyteti ka tjetër fytyrë. Një pamje tërësisht e hapur rreth liqenit, shëtitore në qendër, 240 metra e gjatë, me objekte arti si skulptura, shatërvanë, disa mole të vogla dhe një shëtitore rreth liqenit, me gjatësi 2.4 kilometra.

Numri i vizitorëve gjatë fundjavave të verës arrin në mijëra në ditë. Është rritur standardi i ambienteve të shërbimit. Aktualisht gjenden rreth 10 restorante të një niveli cilësie të kënaqshme, që ofrojnë shumëllojshmëri gatimesh. Risi e dy viteve të fundit janë bujtinat dhe hotelet. Aktualisht ato kanë një kapacitet prej rreth 80 shtretërisht.

#### 1) Rruga Papër-Cërrik-Belsh-Kuçovë

Pas rehabilitimit të qendrës, është ndoshta investimi më jetik për tërë bashkinë. Zgjerimi i saj, pajisja me infrastrukturën e duhur të sigurisë solli menjëherë rezultat: një fluks i shtuar i lëvizjes nga kryeqyteti dhe akset kombëtare drejt Beratit, duke kaluar detyrimisht nga qendra e bashkisë së Belshit. Pikërisht kjo rrugë (foto nr. 2) nxori në pah bukuritë e zonës, pasi përshkon dhe liqene të tjera, fshatra dhe pyllin e Marinës.




Foto. 1: Qendra e Belshit pas Rilindjes Urbane dhe 2 Rruga Cërrik-Belsh-Kuçovë (fshati Marinë (E. Dervishi)



Në tabelën numër 1, paraqet një analizë me pikat e forta, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet e mundshme në një këndvështrim të gjerë, për tërë territorin e bashkisë së Belshit.

Tabela 1: ANALIZA SWOT për territorin e bashkisë Belsh

PIKAT E FORTA (S)	PIKAT E DOBËTA (W)	MUNDËSITË (O)	RREZIQET (T)
1. Pozita e përshtatshme gjeografike në qendër të vendit. 2. Klima e butë. Prania e ujit të liqeneve. 3. Bukuritë natyrore. 4. Afërsia me tregjet dhe qytetet e mëdha. 5. Mosha relativisht e re e popullsisë.	1. Thatësitrat, mungesa e ujit për vaditje. 2. Mungesa e krahut të specializuar të punës. 3. Mungesa e eksperiencës në sektorin e shërbimeve (hotele, bujtina). 4. Bizneset janë kryesisht familjare, me pak të punësuar.	1. Mundësi lidhjeje me sistemin hidrik të Banjës. 2. Prania potencialisht mundshme 3. Ditët e shumta me diell, për energji diellore. 4. Përfshirja në guidat rajonale dhe kombëtare. 5. Nëntoka fshhe pasuri arkeologjike të pazbuluara.	1. Parcelizimi i tokave sipas Ligjit 7501. 2. Procesi i legalizimit të tokave ecën mjaft ngadalë. 3. Investimet kolosale në vreshta dhe ullishta, por mungon studimi i tregut. 4. Kostot e larta të prodhimeve bujqësore. 5. Probleme mjedisore që mund të sjellë kërkimi për naftë dhe gaz.

Burimi: Bashkia Belsh

Bashkia e Belshit ka një avantazh të madh. Është ndoshta i vetmi qytet nga ku për më pak se një orë mund të arrish në të paktën 7 qytete të tjera, në drejtime të ndryshme.

Tabela 2: Distancat nga Belshi për në qytetet më të afërta.

Përpunoi: E. Dervishi

Itinerari	Distanca	Koha
Belsh-Tiranë	60 km	50 min
Belsh-Elbasan	28 km	40 min
Belsh-Berat	50 km	50 min
Belsh-Kuçovë	24 km	28 min

Belsh-Lushnjë	29 km	43 min
Belsh-Gramsh	40 km	52 min
Belsh-Peqin	25 km	35 min

Burimi: Bashkia Belsh

Vlen të theksohet se metropoli më i madh i vendit-Tirana, është e arritshme në më pak se një orë. Me rëndësi është lidhja me Lushnjën, pasi ajo ka tregun më të madh të produkteve bujqësore. Nga aty, prodhimet e zonave përreth shkojnë deri në Kosovë e më gjerë. Po kështu, dhe lidhja me Beratin. Si qytet mjaft i vizituar, ai tërheq një fluks të madh vizitorësh vendës e të huaj. Duke kaluar nëpërmjet Dumresë, një pjesë e madhe e tyre e kanë plotësisht të mundshme një ndalesë në Belsh.

Emigrimi masiv është kthyer në një problem të madh demografik. Banorët largohen si jashtë vendit, por edhe drejt qendrave urbane, kryesisht Tiranë dhe Durrës. Pasojat e zbrazjes së popullsisë po ndihen në çdo sektor. Një shembull: Në tri shkolla të marra në shqyrtim: e Seferanit, e Belshit qendër dhe fshati Shkëndi, numri i nxënësve ka rënë me gati 100 % për 10 vjet (2011-2021).

Në fshatrat e bashkisë së Belshit ka mungesë të fuqisë punëtore për punët e stinës. Ambientet e shërbimit (*kafene, restorante, servise*) nuk gjejnë personel. Megjithatë, boshatisja duket më tepër në fshatrat e zonës. Disa fshatra të vogla ose lagje po boshatisen krejtësisht si p.sh. Stanaj, Përroi i Zi, Gjolenë, Lisaj, Turbull, Shtith, Dushk, Cestije etj. Shkaku kryesor është kostoja e lartë me të cilën dalin produktet e fermerëve. Në periudhën *tetor-nëntor 2021*, bëra mjaft anketa, pyetësorë dhe sondazhe me banorët, kryesisht fermerë të zonës, në funksion të prezantimit tim.

Tradicionalisht, zona e Dumresë ka kultivuar duhanin si prodhimin më fitimprurës. Më pas, vreshtaria dhe bimët e arave

zinin vend të rëndësishëm. Në 10 vitet e fundit u përhap kultura e rigonit, kryesisht për shkak të proceseve më të pakta të punës, krahasimisht me të tjerat. Tab.3 tregon kostot e një fermeri, për prodhim në njësi prodhimi (dynym).

Tabela 3: Kostot për prodhimet bujqësore, nëntor 2021

Procesi i punës	Çmimi (lekë të reja)
Plugim	2000
Frezim	1000
Mbjellje	600-1000
Korrje	1500
Spërkatje	1000
1 kv D. A. P.	8000
1 kv ure	7000
1 kv nitrat	6500-8000
Punë krahu (1 punëtor/ditë)	1500-3000

Burimi: Bashkia Belsh, përpunoi E. Dervishi

Faktori kryesor në këto kosto të rritura është çmimi i naftës, po edhe fakti se plehurat kimike vijnë nga importi. Edhe në rastet kur prodhimi është i bollshëm, tregu i shitjes mungon. Sipas fermerëve, kjo i ka çuar ata drejt orientimit nga ato kultura që kanë më pak kosto, si ulliri dhe rigoni (foto nr. 3).

Një problem i madh që pengon zhvillimin e bujqësisë është parcelizimi i tokës në ngastra të vogla. Toka u nda për frymë, sipas Ligjit 7501. Sasia e saj ndryshonte nga fshati në fshat, mesatarisht 2 dynym për frymë. Çdo kryefamiljar mori në dorëzim parcela të vogla, në disa raste 5-6 të tilla (*fushë, kodër, vresht, ullishtë, mbi ujë, nën ujë, etj*).



Foto 3: Kultura e rignonit, fshati Gradishtë, nëntor 2021 ( E. Dervishi)

Në foton nr 4, bërë nga Mali i Gradishtës, duken parcela fermerësh të fshatit Shtith, bashkia Belsh. Ky fragmentarizim i tokës pengon mekanizimin dhe investimet.



Foto 4. Toka të fermerëve të fshatit Shtith, nëntor 2021 (E. Dervishi)

Mungesa e ujit për vaditje mbetet një shqetësim i madh për fermerët. Sipas z. Fatmir Çekrezi, deri në vitin 1990, 80% e tokave të Dumresë vaditeshin 7-11 herë gjatë stinës së thatë.

Ishte ndërtuar një sistem kanalesh me gjatësi 370 km. Uji për mbushjen e liqeneve sigurohej nga 3 drejtime:

- 1-Nga lumi Shkumbin, me anë të kanalit “Naum Panxhi”
- 2-Nga lumi Devoll në lagjen *Shelg*
- 3-Nga ujëmbledhësi i Thanës.

Sot ky sistem vaditës është tërësisht jofunksional. Pompat nuk punojnë (foto nr. 5), kurse kanalet janë tërësisht të shkatërruara. Sipas bisedës me fermerin Asqeri Tafani, nëse do të ujiteshin tokat, prodhimi bujqësor do të ishte nga 30% deri në 100% më i lartë.



Foto 5 Stacioni i pompave, Belsh (E. Dervishi)

Pikat e grumbullimit të prodhimeve bujqësore mungojnë. Fermerët detyrohen që prodhimet e tyre t'i çojnë në tregun e Lushnjës, apo t'i shesin në mënyrë ambulante.

### **Diskutime**

Investimet e fundit në infrastrukturë, së bashku me Reformën Territoriale, kanë krijuar një hapësirë të re për prioritetet ekonomike në territorin e bashkisë. Gjithsesi, bujqësia do të mbetet përparësi për shumicën e ekonomive familjare. Nxitja e investimeve në agrobiznes, në fermat me teknologji të përparuar

apo dhe turizëm, do shmangte zbrazjen e zonës. Shembuj pozitivë janë ato biznese që u hapen në kuadër të projektit të “100 fshatrave turistike”- “Bujtina Zejtaria” dhe “Rubin” në fshatin Seferan. Përveç punësimit, ato angazhojnë dhe bujqit vendës me prodhimet e tyre bio.

Sektori bujqësor ka problematika të theksuara. Disa prej tyre janë të mbartura dhe vijnë si shkak i copëzimit të fermave. Akoma më i vështirë bëhet problemi kur vëren në terren se shumica e tokave bujqësore janë të pacertifikuara nga ana e fermerëve, pra të papajisura me dokumentin e pronësisë. Nga këtu nis dhe vështirësia në investimet afatgjata, përmirësimin e teknologjisë apo në krijimin e fermave sipas konceptit modern.

### **Përfundime**

Territori i bashkisë së Belshit ka kushte të mira klimatike për zhvillimin e bujqësisë, sidomos të kulturave tradicionale: duhan, vreshta, bimë mjekësore dhe së fundmi ullishtat. Duke qenë një bashki ku 70% e popullsisë merret me bujqësi, popullsia e zonës ka pak alternativa.

#### *Po cilat janë problemet e fermerit të zonës?*

-Problemi i copëzimit të tokës në disa ngastra sipas Ligjit 7501, është pengesa kryesore. Kjo ndarje detyrimisht rrit kostot e prodhimit, pengon mekanizimin dhe investimet afatgjata.

-Mungesa e sistemit vaditës është shkak i tjetër i rëndësishëm i braktisjes së bujqësisë. Nëse do të funksiononte, tokës i merren të paktën dy prodhime. Po kështu prodhimi i duhanit, ullirit, vreshtave, rigonit, do të rritej me të paktën 50%.

Furnizimi me ujë mund të sigurohet nga liqenet që zënë 640 hektarë sipërfaqe, me një vëllim 26 milionë metër kub ujë.

-Pikat e grumbullimit janë hallka e dobët e zinxhirit prodhues bujqësor. Ato mungojnë krejtësisht. Duhet politika qendrore nxitëse në këtë drejtim.

## Rekomandime

Duke qenë se pjesa dërrmuese e popullsisë së zonës merret me bujqësi, duhen rritur investimet në këtë sektor, si p.sh.:

- Përsheptimi i procesit të legalizimit të tokave bujqësore.
- Investimet në sistemin vaditës, që do rriste me të paktën 50% rendimentin e prodhimeve.
- Mekanizma financiarë lehtësues për futjen e makinerive bujqësore dhe plehrave kimike.
- Mundësia e rihapjes së shkollave me profil bujqësor.
- Trajnime me fermerët e zonës, për aplikimin e metodave të bujqësisë intensive sidomos për kulturat tradicionale: duhan, vreshta, rigon, ullinj.
- Shtimi i shkëmbimeve dhe përvojave me bashki brenda dhe jashtë vendit, që kanë ngjashmëri fiziko-gjeografike, klimatike apo nga pikëpamja e tokave bujqësore me territorin e bashkisë së Belshit (binjakëzime).

## Literatura

- INSTAT, (2021), Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë.  
 Intervista e z. Fatmir Çekrezi, TV BELSHI, 31 tetor 2021  
 Kristo, V., (1991), Gjeografike Fizike e Përgjithshme, Akademia e Shkencave, vëll. II, f. 511.  
 Bashkia Belsh, (2018), Plani i Përgjithshëm Vendor
-

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Qendrat e banuara të Shqipërisë - gjendja dhe e ardhmja :  
(17 dhjetor 2021) : libri i kumtesave : konferencë shkencore /  
red. shkenc. Perikli Qiriazhi, Merita Koka Karaguni, Jostina  
Dhimitri. – Tiranë : Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2023  
735 f. ; 16x23 cm.  
ISBN 978-9928-339-91-1

1.Vendbanime 2.Gjeografia humane 3.Studime sociale  
4.Historia 5.Konferenca 6.Shqipëri

911.3(496.5) (062)